PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME NË ÇËSHTJE PENALE DHE CIVILE

Prishtinë, 2023

PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME NË ÇËSHTJE PENALE DHE CIVILE

Prishtinë, 2023

Dhjetor 2023

Shtypur në Prishtinë

Hartimi dhe botimi i materialit udhëzues : “Përmbeldhje nga praktika e Gjykatës Supreme në çështje penale dhe civile ” është mundësuar nga Akademia e Drejtësisë, ndërkaq shtypja dhe printimi nga Projekti: Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI) Chemonics.

PËRMBAJTJA

HYRJE..... 4

PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA GJYQËSORE NË ÇËSHTJET PENALE

KAPITULLI I - Afrim Shala, Gjyqtar
Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.....6-144

KAPITULLI II - Rasim Rasimi, Gjyqtar
Kthimi i çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.....145-190

KAPITULLI III – Mejreme Mema, Gjyqtare
Ndryshimi i aktgjykimeve të instancave me të ulëta.....191-282

KAPITULLI IV - Agim Maliqi, Gjyqtar
Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit.....283-403

KAPITULLI V - Valdete Daka, Gjyqtare
Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.....404-437

PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA GJYQËSORE NË ÇËSHTJET CIVILE

KAPITULLI VI - Beshir Islami, Gjyqtar
Cenimi i pjesës së domosdoshme, anulimi i kontratave, testamenteve e të tjera.....439-457

KAPUTULLI VII – Rrustem Thaqi, Gjyqtar

Vendimi dhe ndryshimi i vendimeve të Gjykatës për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave prindërore.....458-479

Fitimi i humbur, renta e arritur dhe renta për te ardhmen.....480-497

Kontestet e punës, shqyrtimi paraprak i padisë, afati për paraqitjen/lejueshmërinë e padisë si prezumim procedural.....498-513

KAPITULLI VIII – Shukri Sylejmani, Gjyqtar
Shpronësimi dhe kompensimi i pronës së shpronësuar.....514-530

E drejta e parablerjes.....531-547

KAPITULLI IX – Muhamet Rexha, Gjyqtar
Hudhja e mjeteve të jashtzakonshme juridike - me vështrim të veçantë revizioni.....548-573

KAPITULLI X- Zenel Leku, Gjyqtar
Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve.....574-587

Fitimi i pronësisë në bazë të trashëgimit - Radha e dytë dhe e drejta e përfaqësimit.....588-598

Mungesa e arsyetimit ligjor të vendimeve.....599-609

KAPITULLI XI- Milena Đerić, Gjyqtare
Procedura e caktimit të ekspertizës dhe zbatimi adekuat i LPK-së.....610-626

KAPITULLI XII- Nenad Lazić, Gjyqtar
Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale si dhe zotësia procedurale e palëve.....627-632

HYRJE

Kjo përmbledhje nga praktika gjyqësore, pasqyron praktikat e deritanishme në trajtimin e rasteve penale dhe civile nga gjykatat e instancave më të ulëta në Republikën e Kosovës, gjetjet e Gjykatës Supreme dhe evidentimin e shkeljeve të dispozitave procedurale dhe ligjit material.

Në këtë përmbledhje janë paraqitur disa nga rastet më karakteristike të Gjykatës Supreme, në lëmin penal dhe civil, për të cilat janë gjetur shkelje nga gjykatat e instancave më të ulëta dhe me pasqyrimin e tyre në këtë përmbledhje vëhet në pah nevoja për zbatimin unik të ligjit, harmonizimit, dhe interpretimit të unifikuar të dispozitave ligjore, të elaboruara më detajisht në këtë përmbledhje.

Qëllimi i hartimit të kësaj përmbledhje është ofrimi i zgjidhjeve për çështjet dhe dilemat e ndryshme me të cilat ballafaqohen gjyqtarët e instancave më të ulëta dhe udhëzimi i tyre se si të veprohet në situatat e ngjashme duke respektuar dhe aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore dhe njëherit duke marrë për bazë edhe praktikat dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Përmbledhja nga pjesa penale është e fokusuar në temat si: kthimi i cështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe të dytë, ndryshimi i aktgjykimeve të instancave më të ulëta, masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale dhe kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ndërsa pjesa civile fokusohet kryesisht në cënimin e pjesës së domosdoshme, kontestet e punës, të drejtën e parablerjes, pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, hudhjen e mjeteve të jashtëzakonshme, shpronësimin, mungesën e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, etj.

Falenderojmë autorët dhe të gjithë kontribuesit që mundësuan botimin e kësaj përmbledhje nga Praktika Gjyqësore e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në çështjet penale dhe civile, për përkushtimin dhe angazhimin e tyre, me theks të veçantë Akademinë e Drejtësisë dhe projektin Ëestern Balkans Rule of Laë Initiative (WBROLI) Chemonics..

PRAKTIKA GJYQËSORE E GJYKATËS SUPREME NË ÇËSHTJET PENALE

KAPITULLI I

KTHIMI I ÇËSHTJEVE NË RIGJYKIM NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË

1. Shqyrtime të përgjithshme në lidhje me kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet penale

Bazuar në nenin 103, paragrafi 2. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 25, paragrafi 1. të Ligjit për Gjykatat,[1] Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor dhe ka juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Si autoriteti më i lartë gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës[2] në procedurë penale ka kompetencë të vendosë në lidhje me:

1) kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit;[3]
2) ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Gjykatën Supreme të Kosovës, sipas paragrafit 1. të nenit 407 të KPP-së;[4]
3) ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin apo kur paraburgimi caktohet për herë të parë nga kjo Gjykatë[5] dhe
4) çështje të tjera të parapara me ligj.[6]

---

[1] Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat i datës 23.11.2018.
[2] Neni 26, paragrafi 1. i Ligjit për Gjykatat.
[3] Neni 419, paragrafët 2. dhe 3. të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale i datës 17.08.2022 (në vijim KPP), pastaj, nenet 431, 435, etj.
[4] Në nenin 407, paragrafi 1. të KPP-së është parashikuar se ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin kur:
1.1. Gjykata e Apelit e Kosovës shqipton dënim me burgim të përjetshëm ose vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore me të cilin është shqiptuar dënim i tillë;
1.2. Gjykata e Apelit e Kosovës pas shqyrtimit vërteton ndryshe gjendjen faktike nga gjykata themelore dhe aktgjykimin e bazon në gjendjen e tillë faktike të vërtetuar; ose
1.3.Gjykata e Apelit e Kosovës ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin.
[5] Neni 374, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. i KPP-së.
[6] Neni 26, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.7. i Ligjit për Gjykatat.

Është e rëndësishme të theksohet se Gjykata Supreme e Kosovës shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegj të përbërë prej (3) gjyqtarëve, me përjashtim kur me ligj parashihet ndryshe.[7]

Gjithashtu, për dallim nga organizimi i brendshëm i gjykatave themelore dhe i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duhet të bëhet e qartë se kolegji prej tre (3) gjyqtarëve i Degës Penale i Gjykatës Supreme të Kosovës i shqyrton dhe gjykon të gjitha çështjet penale, duke përshirë këtu çështjet penale të gjykuara nga Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti për të Mitur, Departamenti Special dhe Divizioni Penal i Departamentit të Përgjithshëm i gjykatave të lartcekura.

Nga statistikat e publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës[8] rezulton se përqindja më e madhe e çështjeve penale që shqyrtohen dhe gjykohen në Gjykatën Supreme të Kosovës iniciohen sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Arsyet për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm juridik, janë të përcaktuara në nenin 432, paragrafi 1. të KPP-së.

Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se *"Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:*
1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;
1.2. në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose
1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor."

Mirëpo, përtej këtyre arsyeve, është e rëndësishme që të theksohet se duke u bazuar në nenin 440 të KPP-së, mjetet e jashtëzakonshme juridike, përkatësisht kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqiten edhe në bazë të të drejtave të siguruara me KPP dhe të mbrojtura me Kushtetutën

[7] Neni 28, paragrafi 2. i KPP-së dhe neni 25, paragrafi 6. i Ligjit për Gjykatat. Kështu, p.sh. në nenet 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë është parashikuar se urdhrat gjyqësor për përgjim apo për hyrje në objekte dhe urdhrat për përgjim emergjent i lëshon një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës.
[8] https://ëëë.gjyqesori-rks.org/

e Republikës së Kosovës ose Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendim e hedhë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse kërkesa është e papranueshme ose janë plotësuar kushtet nga neni 434, paragrafi 2. i KPP-së. Në të kundërtën, kopjen e kërkesës ia dërgon palës tjetër, e cila në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës mund të paraqesë përgjigje në kërkesë.[9]

Nëse Gjykata Supreme e Kosovës nuk e hedhë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, atëherë e njëjta duhet që të vlerëson dhe të vendos në lidhje me meritat e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Në këtë drejtim, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës është vërejtur se mund të paraqiten këto situata:

1) që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë;
2) që të aprovohet/refuzohet pjesërisht kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ose
3) që të aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në rastet kur kemi disa të pandehur/dënuar për vepra penale të ndryshme apo të njëjta dhe janë paraqitur disa kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, atëherë për secilën kërkesë për mbrojtje të të ligjshmërisë veç e veç mund të paraqiten tre (3) situatat e lartcekura.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim refuzon si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kur vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, nga nenet 386 dhe 432, paragrafi 2. të KPP-së.[10]

Ndërsa, nëse Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;

[9] Neni 435, paragrafi 2. i KPP-së.
[10] Neni 437 i KPP-së.

1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose
1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.[11]

Në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit, pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë.[12]

Duke e pasur parasysh se tani një mundësi e tillë është risi në KPP, kurse në anën tjetër, në dispozitat ligjore të KPP-së nuk është sqaruar se kur *"vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm"* ose *"i bazuar në gabim të rëndë"*, atëherë do t'i mbetet praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës që të definojë këto nocione, gjithnjë duke ju referuar edhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

2. Arsyet për kthimin e rastit në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë

Siç është theksuar edhe më parë, nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, atëherë varësisht nga rrethanat e secilit rast veç e veç, përveç tjerash, Gjykata Supreme e Kosovës merr aktgjykim me të cilin në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore.

Siç shihet, aktgjykimet e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, mund të anulohen:

1) Në tërësi ose
2) Pjesërisht.

Për t'u kthyer lënda për rigjykim në gjykatën themelore, përkatësisht në gjykatën e shkallës së parë, atëherë duhet që Gjykata Supreme e Kosovës të anulojë si aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, ashtu edhe aktgjykimin e gjykatës themelore.

[11] Neni 438, paragrafi 1. i KPP-së.
[12] Neni 438, paragrafi 2. i KPP-së.

Nëse janë anuluar vetëm pjesërisht aktgjykimet e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, atëherë procedura penale në gjykatën themelore zhvillohet për atë pjesë të aktakuzës që ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit.[13]

Anulimi i pjesërishëm i aktgjykimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës bëhet vetëm kur pjesët e posaçme të këtyre aktgjykimeve mund të veçohen pa ndonjë pasojë për gjykim të drejtë.

Në parim, shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i KPP-së ose shkeljet tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor janë arsye për anulimin e aktgjykimit gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe kthimin e çështjes në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përveç konstatimit të shkeljeve të lartcekura, për t'u anuluar aktgjykimet e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe kthyer çështja në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë duhet që të përmbushet edhe një 1 (një) kusht që është parashikuar në nenin 402, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, e cila dispozitë ligjore aplikohet përshtatshmërisht edhe në procedurën e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore, përveç konstatimit të shkeljeve të lartcekura, anulimi i aktgjykimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës do të mund të vie në shprehje, vetëm në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të KPP-së, dispozitë ligjore kjo që e rregullon ndryshimin e aktgjykimeve të lartcekura.

Pra, me fjalë të tjera, sipas kësaj dispozite ligjore, anulimi i aktgjykimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës mund të bëhet vetëm në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të ndryshojë këto aktgjykime, për shkak të specifikave të rasteve përkatëse dhe natyrës së shkeljeve ligjore që janë përfshirë këto aktgjykime.

Megjithatë, duhet theksohet se sipas dispozitave ligjore të KPP-së, jo çdo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale është arsye për anulimin e aktgjykimit të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

[13] Neni 439, paragrafi 1. i KPP-së.

Njëra prej ndryshimeve, përkatësisht risive të KPP-së është pikërisht ky aspekt i kufizimit të arsyeve për anulimin e aktgjykimeve të gjykatave të lartcekura.

Kështu, në nenin 403, paragrafët 2 dhe 3 të KPP-së janë parashikuar situatat kur Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore, edhe pse bëhet fjalë për disa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ndërsa këto dispozita ligjore aplikohen përshtatshmërisht edhe me rastin e vendosjes në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Përveç kufizimit të arsyeve për anulimin e aktgjykimeve, tjetër risi e KPP-së që i referohet kësaj çështje, në rastet kur është vendosur që të kthehen çështjet në rigjykim, është edhe parashikimi i detyrimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, përkatësisht Gjykatës Supreme të Kosovës për të paraqitur në mënyrë të qartë arsyet dhe bazat se pse nuk kanë mundur që të procedojnë sipas nenit 403 të KPP-së, përkatësisht se pse nuk kanë mundur që të ndryshojnë aktgjykimet, në vend se t'i anulojnë.

Gjithashtu, duhet theksuar se në rastet kur anulohen aktgjykimi i gjykatës themelore dhe i Gjykatës së Apelit të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, atëherë në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës duhet të shënohen dispozitat ligjore të shkelura dhe në çka konsistojnë shkeljet, në pajtim me nenin 384 të KPP-së.

Duke u bazuar në nenin 439, paragrafi 2. të KPP-së, nëse është vendosur që të anulohen aktgjykimet e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, atëherë gjykatat në fjalë detyrohen t'i ndërmarrin të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet për të cilat e ka paralajmëruar Gjykata Supreme e Kosovës.

Anulimi i aktgjykimeve dhe kthimi i çështjeve në rigjykim, kohët e fundit ka qenë një temë dhe shqetësim që është ngritur vazhdimisht nga opinioni i gjerë dhe shoqëria civile në vendin tonë, por edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, për shkak të vonesave që po shkaktohen në trajtimin e sërishëm të çështjeve nga gjykatat. Si duket kjo ka qenë arsye që ka ndikuar që tani në dispozitat ligjore të KPP-së, siç është thënë edhe më lart, ligjdhënësi ka parashikuar që jo çdo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale të jetë shkak për anulimin e aktgjykimeve, si dhe ka parashikuar detyrimin që në aktgjykimin me të cilin kthehet çështja në rigjykim të paraqiten arsye

në mënyrë të qartë se pse gjykata e instancës më të lartë nuk ka mundur që ta ndryshojë aktgjykimin, në vend se ta anulojë.

Në vijim të këtij punimi janë elaboruar disa çështje më tipike që kanë qenë arsye që Gjykata Supreme e Kosovës të vendos anulimin e aktgjykimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Për secilën prej këtyre çështjeve që do të elaborohen do të prezantohen edhe raste nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës, duke i sqaruar mandej qëndrimet e kësaj Gjykate sa i përket këtyre situatave.

3. *Pjesëmarrja në shqyrtim gjyqësor e gjyqtarit i cili është dashur të përjashtohet*

3.1. Dispozitat ligjore

a) Neni 38, paragrafi 2. i KPP-së

Bazat për përjashtimin e gjyqtarëve

"Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal. Megjithatë, gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues".

b) Neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

"Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale që njihet sipas detyrës zyrtare apo propozimit të palëve konsiderohet nëse:
- në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet sipas neneve 38-42 të këtij Kodi".

3.2. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Përjashtimi i gjyqtarit është një institut i procedurës penale që shpie në përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i rastit përkatës. Arsyet dhe bazat mbi të cilat përjashtohet gjyqtari janë të natyrave të ndryshme dhe ato mund të jenë të karakterit objektiv dhe subjektiv. Arsyet me natyrë subjektive kanë të bëjnë me bindjet subjektive të gjyqtarit ose me paragjykimet të cilat gjyqtari mund t'i ketë lidhur me lëndën apo palët që janë të përfshira në atë lëndë. Në këto raste, gjyqtari mund të ketë paragjykime për fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit, vërtetësinë apo pavërtetësinë e ndonjë prove, rrethanat e kryerjes së veprës penale, etj. Këtu duhet të jenë në pyetje paragjykimet të cilat mund t'i ketë shprehur gjyqtari apo supozohen në bazë të sjelljeve të tij. Në anën tjetër, arsyet apo shkaqet me natyrë objektive janë ato shkaqe të cilat realisht ekzistojnë dhe si të tilla mund të provohen pa ndonjë vështirësi.[14]

Arsyet apo shkaqet e përjashtimit të gjyqtarit sipas KPP-së ndahen në dy (2) grupe:

1) Arsyet apo shkaqet të cilat detyrimisht sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit, ndryshe i ashtuquajturi *"përjashtimi i detyrueshëm"* dhe

2) Arsyet apo shkaqet të cilat mund të sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit, ndryshe i ashtuquajturi *"përjashtimi fakultativ"*.

Arsyet apo shkaqet të cilat detyrimisht sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit janë të parashikuara në nenin 38, paragrafët 1. dhe 2. të KPP-së *("përjashtimi i detyrueshëm"),*[15] kurse ato të cilat mund të sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit janë të parashikuara në nenin 38, paragrafi 3. të KPP-së *("përjashtimi fakultativ")*.[16]

---

[14] HAJDARI, AZEM : Komentar i Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, fq. 96.

[15] Në nenin 38, paragrafi 1. të KPP-së është parashikuar se *"Gjyqtari përjashtohet nga shqyrtimi i rastit kur: është vetë palë apo i dëmtuar me veprën penale e cila është subjekt i rastit konkret gjyqësor; është bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, ish – bashkëshort, person në afri gjinie në vijë të drejtpërdrejtë të çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin e shtetit, të dëmtuarin ose viktimën ose mbrojtësin e viktimave apo përfaqësuesin e viktimës; është kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit ose viktimës; në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si prokuror, mbrojtës, mbrojtës i viktimave apo përfaqësues i viktimës ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert; ekziston konflikti i interesit siç përcaktohet me legjislacionin përkatës"*.

[16] Në nenin 38, paragrafi 2. të KPP-së është parashikuar se "*Gjyqtari gjithashtu mund të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rast konkret, nëse përpos rasteve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, paraqiten rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij"*.

Dallimi i ndërmjet këtyre dy (2) grupeve të arsyeve apo shkaqeve konsiston në atë se në rastin e parë të përjashtimit, këto arsye apo shkaqe janë të parashikuara në mënyrë taksative dhe kanë karakter absolut, që do të thotë se nëse paraqiten të njëjtat, atëherë gjyqtari duhet të përjashtohet nga gjykimi i çështjes penale konkrete, pavarësisht se a e kanë kërkuar një gjë të tillë palët, apo jo. Përndryshe shkelja e kësaj ndalese, përkatësisht gjykimi i një çështje penale, edhe pse kanë ekzistuar këto arsye apo rrethana sipas nenit 39, paragrafët 1. dhe 2. të KPP-së për përjashtimin e gjyqtarit, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale.[17]

Gjyqtari duhet që posa të mësojë se ekziston ndonjë arsye për përjashtim nga neni 38, paragrafët 1. ose 2. të KPP *("përjashtimi i detyrueshëm")*, të ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë të njofton kryetarin e gjykatës, i cili sipas procedurave apo rregullave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij.[18]

Kurse, grupi i dytë i arsyeve apo shkaqeve të cilat mund të sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit *("përjashtimi fakultativ")* janë të përcaktuara me një formulim të përgjithshëm dhe kanë një veprim relativ, për dallim nga grupi i parë.

Në nenin 39, paragrafi 2. të KPP-së janë parashikuar situatat kur gjyqtari duhet të përjashtohet nga gjykimi për shkak të pjesëmarrjes në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal *("përjashtimi i detyrueshëm")*. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal.[19]

Në këtë dispozitë ligjore nuk është sqaruar se në çka konsiston pjesëmarrja në procedurë të mëhershme në të njëjtin rast penal, mirëpo një gjë e tillë është trajtuar në disa raste nga praktika gjyqësore në vend, por edhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), siç do të paraqiten në vijim.

---

[17] SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010, fq. 101; SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 162.

[18] Neni 39, paragrafi 1. i KPP-së.

[19] Edhe pse në këtë dispozitë ligjore nuk është parashikuar shprehimisht, arsyet e tilla do të vlejnë edhe për përjashtimin e gjyqtarit zëvendësues, duke i pasur parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë që ka, bazuar në nenet 284 dhe 293, paragrafi 1. të KPP-së.

Në anën tjetër, me fjalinë e fundit të paragrafit të lartcekur, është përcaktuar se megjithatë, gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues.[20] Pra, nëse gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues, anëtari i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës kanë qenë të përfshirë në procedurat e mëparshme vetëm si anëtar i kolegjit shqyrtues, atëherë të njëjtit nuk do të përjashtohet nga shqyrtimi i rastit. Përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi i rastit përkatës për shkak të pjesëmarrjes në procedura të mëparshme në të njëjtit rast penal ndërlidhet edhe me paanësisë së tij dhe një aspekt i tillë është trajtuar mjaftueshëm edhe nga GJEDNJ -ja.

Në këtë drejtim, GJEDNJ -ja ka sqaruar se paanësia e gjyqtarit në raste të tilla, duhet të shqyrtohet në bazë të dy (2) kritereve apo testeve:

1) *Testi subjektiv* që ka të bëjë me bindjet dhe sjelljet personale të një gjyqtari, duke nënkuptuar që një gjyqtar mund të ketë pasur paragjykime personale apo anshmëri në lidhje me rastin konkret dhe

2) *Testi objektiv* që ka të bëjë me konstatimin nëse vetë përbërja e gjykatës ka ofruar garancione të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim.[21]

Sa i përket testit objektiv, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, situatat në kuadër të të cilave mund të ngritën çështje lidhur me mungesën e paanshmërisë mund të jenë:

1) *Të natyrës funksionale* dhe

2) *Të natyrës personale*.

---

[20] Kolegji shqyrtues është kolegji i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve i cili formohet nga departamenti i njëjtë ose nga gjykata themelore për të shqyrtuar dhe vendosur mbi një kundërshtim ose ankesë kundër urdhrit ose aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake (neni 19, paragrafi 1.21. i KPP-së). Përndryshe, autorizimet e kolegjit shqyrtues janë të parashikuara më hollësisht edhe në nenin 418 të KPP-së.

[21] Në rastin *"Korzeniak kundër Polonisë",* aktgjykimi i datës 10.01.2017, paragrafi 46, GjEDNj-ja ka theksuar se *"Është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim te publiku. Për këtë qëllim, neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj) kërkon që një gjykatë sa i përket përgjegjësive së saj të jetë e paanshme. Paanshmëria normalisht nënkupton mungesën e paragjykimit dhe një gjë e tillë mund të testohet në mënyra të ndryshme. Gjykata ka bërë kështu dallimin midis "një qasje subjektive" - që do të thotë, përpjekje për të konstatuar bindjen personale ose interesin e një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar - dhe "një qasje objektive" - që do të thotë, duke përcaktuar nëse ai ose ajo ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë aspekt"*. Qëndrim të njëjtë, GjEDNj-ja ka theksuar edhe në rastet *"Piersack kundër Belgjikës"*, aktgjykimi i datës 01.10.1982, paragrafi 30; *"Grieves kundër Mbretërisë së Bashkuar"*, aktgjykimi i datës 16.12.2003, paragrafi 69, etj.

Mungesa e paanshmërisë funksionale ndërlidhet me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda një procesi gjyqësor nga i njëjti gjyqtar ose lidhjeve të natyrës hierarkike apo të ndonjë natyre tjetër në mes të gjyqtarit dhe palëve tjera në një proces të caktuar gjyqësor.

Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, këto situata të natyrës funksionale, përveç tjerash mund të përfshijnë situatat kur në të njëjtin rast janë ushtruar funksione të ndryshme nga i njëjti gjyqtar. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka theksuar se vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të procedurës gjyqësore mund të ketë rezultuar me paanësinë e tij, duhet të vlerësohet nga rasti në rast dhe një gjë e tillë varet nga specifikat e secilit rast. Me fjalë të tjera, GJEDNJ-ja e ka bërë të qartë që situatat e tilla në kuptim të vlerësimit të paanësisë së një gjyqtari i cili ka vepruar edhe në procedura të mëparshme në të njëjtin rast, duhet të vlerësohet në çdo rast veç e veç, duke i pasur parasysh rrethanat specifike të secilit rast.

Edhe pse ushtrimi i funksioneve të ndryshme në një proces gjyqësor nga gjyqtari i njëjtë paraqet kategori të çështjeve të natyrës funksionale dhe janë të rëndësishme për vlerësimin e paanshmërisë së një gjykate, në raste të tilla, në parim, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se ka dyshime legjitime për një paanshmëri të tillë, mirëpo dyshimet e tilla duhet të jenë objektivisht të justifikueshme dhe të vlerësohen nën dritën e rrethanave të secilit rast veç e veç.[22]

Sa i përket vlerësimit të dyshimeve të tilla në paanshmëri kur një gjyqtar ka ushtruar shumë funksione në të njëjtën çështje, GJEDNJ-ja ka theksuar se dy (2) kategori të çështjeve janë të rëndësishme:

Së pari, një vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet specifikave të ligjit që janë të aplikueshme në një rast konkret dhe

Së dyti, duhet të vlerësohet ndërlidhja në mes të aspekteve përmbajtësore të cilat i ka shqyrtuar gjyqtari i njëjtë në faza të ndryshme të procedurës të rastit përkatës, në mënyrë që më pastaj të konstatohet nëse aspekte të tilla do ta vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit në fjalë.[23]

---

[22] Në lidhje me këtë dimension, shih rastin *"Korzeniak kundër Polonisë",* aktgjykimi i datës 10.01.2017, paragrafët 51, 52, etj.

[23] Rasti *"Ẃarsicka kundër Polonisë"*, aktgjykimi i datës 16.01.2007, paragrafi 40; *"Tozicska kundër Polonisë"*, aktgjykimi i datës 24.07.2012, paragrafi 36, etj.

Pra, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, për të konstatuar nëse ushtrimi i funksioneve të ndryshme në një proces gjyqësor nga ana nga gjyqtari i njëjtë mund të shpie në paanësinë e tij, duhet të vlerësohet në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore që zbatohen në lidhje me atë rast, si dhe gjithashtu duhet të vlerësohet edhe aspekti përmbajtjesor i vendimeve të cilat i ka marrë gjyqtari në faza të ndryshme të procedurës, ndërsa një gjë e tillë duhet të bëhet, duke i pasur parasysh rrethanat specifike të secilit rast veç e veç.

Kështu, në rastin *"Hauschildt kundër Danimarkës"*, aktgjykimi i datës 24.05.1989, paragrafët 51-53, GJEDNJ-ja kishte theksuar *"...vetëm fakti që një gjyqtar gjykues apo gjyqtar i apelit ka marrë gjithashtu vendime në procedurë paraprake, duke përfshirë ato në lidhje me paraburgimin, nuk mund të konsiderohet në vetevete, si shkak për të justifikuar frikën për paanshmërinë e gjyqtarit në fjalë…". "...Megjithatë, rrethanat e veçanta të një rasti të caktuar mund të jenë të tilla që japin një përfundim tjetër..."*.

Në çështjen në fjalë, *"gjyqtari Larsen, i cili kishte marrë pjesë në nëntë (9) nga vendimet për të vazhduar paraburgimin, ishte mbështetur veçanërisht në nenin 762(2) të ligjit danez, e cila dispozitë ligjore kërkonte që gjyqtari duhet të bindet se ekziston një "dyshim i konfirmuar veçanërisht" se i akuzuari ka kryer vepra penale për të cilat dyshohet, përkatësisht gjyqtari duhet të jetë i bindur se ka "një shkallë shumë të lartë qartësie" për sa i përket çështjes së fajit. Kështu, ndryshimi midis çështjes që gjyqtari duhet të zgjidhë gjatë caktimin/vazhdimit të paraburgimit dhe çështjes që ai do të duhet të zgjidhë gjatë marrjes së aktgjykimit është i vogël"*.

Prandaj, GJEDNJ-ja ishte e mendimit se në rrethanat e çështjes, paanshmëria e gjykatës në fjalë mund të dukej e hapur për dyshime dhe se frika e kërkuesit në këtë drejtim mund të konsiderohet objektivisht e justifikuar, kështu që edhe mbi bazën e kësaj, kishte konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1. të KEDNJ-së.

Përndryshe, duhet theksuar se pjesëmarrja e një gjyqtari në shqyrtim gjyqësor (dhe fillestar) i cili është dashur të përjashtohet përbën shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, shkelje kjo e cila për shkak të rëndësisë së madhe që ka, trajtohet jo vetëm sipas propozimit të palëve, por edhe sipas detyrës zyrtare *("Ex officio")*.

Një shkelje e tillë sipas nenit 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, vjen në shprehje në rastet kur pavarësisht se është dashur që përjashtohet, sipas neneve 38-42, gjyqtari ka marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor (dhe fillestar), ndërsa nuk kemi një aktvendim për përjashtimin e gjyqësor. Kjo për faktin se nëse gjyqtari është përjashtuar me aktvendimin e kryetarit të gjykatës, mirëpo, nëse pavarësisht kësaj, ai ka marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor (dhe fillestar), atëherë bëhet fjalë për shkeljen tjetër esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së.

Gjithashtu, për shkak të rëndësisë së saj dhe duke ju referuar dispozitave ligjore të KPP-së, pjesëmarrja në shqyrtim gjyqësor (dhe fillestar) e gjyqtarit që është dashur të përjashtohet, është shkelje e asaj natyre që detyrimisht imponon nevojën e anulimit të aktgjykimit dhe kthimin e rastit në rigjykim.

Instituti juridik i përjashtimit të gjyqtarit zbatohet edhe në procedurën ndaj të miturve.

Me dispozitat ligjore të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM)[24] nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore procedura e përjashtimit dhe se në cilat raste duhet përjashtohet gjyqtari, qoftë si gjyqtar për të mitur, anëtarë i trupit gjykues për të mitur apo anëtarë i kolegjit për të mitur.

Meqenëse me dispozitat ligjore të KDM-së nuk është parashikuar procedura e përjashtimit dhe në cilat raste përjashtohet gjyqtari, atëherë në lidhje me këto çështje duhet që përshtatshmërisht të zbatohen dispozitat ligjore të KPP-së, duke u bazuar në nenin 6 të KDM-së.

Në nenin 6 të KDM-së është parashikuar zbatimi subsidiar i ligjeve tjera. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore *"Ndaj kryesit të mitur të veprës penale dhe fëmijëve viktima apo dëshmitarë, në procedurën penale, në çështjet të cilat nuk janë rregulluar ndryshe më këtë Kod, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe dispozitat tjera penalo juridike"*.

Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart rezulton se dispozitat ligjore të KPP-së sa i përket procedurës së përjashtimit të gjyqtarit dhe rastet e përjashtimit duhet të zbatohen përshtatshmërisht

[24] Kodi nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, i datës 14.09.2018.

edhe në procedurën ndaj të miturve, pasi që me dispozitat ligjore të KDM-së nuk janë rregulluar këto çështje.

3.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e pjesëmarrjes në shqyrtim gjyqësor të gjyqtarit i cili është dashur që të përjashtohet

Çështja e pjesëmarrjes në shqyrtim gjyqësor të gjyqtarit i cili është dashur që të përjashtohet ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kështu, në vijim do të paraqiten dy (2) raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë çështja e pjesëmarrjes së në shqyrtim gjyqësor të gjyqtarit i cili është dashur që të përjashtohet, ku njëri prej këtyre rasteve ka të bëjë me procedurën penale ndaj të miturve.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.239/2022, i datës 18.07.2022**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit V.H., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.34/2020, të datës 13.09.2022 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.498/2021 të datës 12.01.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.34/2020 të datës 13.09.2022, të dënuarin V.H. e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale: vrasja e rëndë nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi1.5 të KPRK-së dhe i ka caktuar dënim me burgim

në kohëzgjatje prej njëzetetre (23) vjet; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK-së dhe i ka caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367, paragrafët 1. dhe 3. të KPRK-së, duke i caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vjet, ashtu që në aplikim të nenit 76, paragrafi 1. të KPRK-së e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzetepesë (25) vjet, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.12.2019 e tutje.

Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit V.H., avokati Y.H. nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, meqë në përbërje të trupit gjykues të gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht kryetarit të trupit gjykues ka marrë pjesë gjyqtari I.Th. i cili po ashtu ka marrë pjesë në cilësinë e gjyqtarit të procedurës penale me rastin e dhënies së urdhrit verbal për bastisjen e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të pronës së të dënuarit, pra sipas të njëjtës çështje penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi shqyrtojë të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e neneve 435, paragrafi 1. dhe 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se janë të bazuara pretendimet e paraqitura se gjatë procedurës penale është shkelur dispozita e procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, sepse në marrjen e këtij vendimi ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohej.

Siç rezulton në shkresat e lëndës në trupin gjykues të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht kryetarit të trupit gjykues, ka marrë pjesë gjyqtari I.Th., i cili ka qenë dashur të përjashtohej, pasi që në të njëjtën çështje penale ka marrë pjesë në cilësinë e gjyqtarit të procedurës paraprake gjatë procedurës hetimore, duke dhënë urdhër verbal për bastisje të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të pronë së të dënuarit.

Me dispozitën e nenit 39, paragrafi 2. të KPP-së, është përcaktuar se "Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues", andaj në rastin konkret në kundërshtim me dispozitën e lartcekur rezulton se në përbërjen e trupit gjykues ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në shkeljen e potencuar më lartë nuk ka vlerësuar shkeljet tjera të pretenduara, meqenëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin, përkatësisht se në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili ka qenë dashur të përjashtohet, e që kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së dhe si e tillë kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.147/2020, i datës 09.06.2020.**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të miturve G.H. dhe R.G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për të Mitur, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesa, pretendimet e mbrojtësve të të miturve janë të bazuara, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2 të KPP-së, sepse në marrjen e këtij vendimi ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohej.

Siç rezulton në shkresat e lëndës, anëtare e kolegjit për të mitur të gjykatës së shkallës së shkallës së parë të evidentuar PM.nr.163/2019, të datës 02.12.2019, ka qenë gjyqtarja E.U., e cila ka qenë dashur të përjashtohej, pasi që në të njëjtën çështje penale ka marrë pjesë edhe në cilësi të gjyqtares për të mitur në procedurën përgatitore, me rastin e caktimit të masës së paraburgimit ndaj të miturve G.H. dhe R.G., sipas aktvendimit PPRM.nr.110/2017, të datës 18.09.2017, dhe për më tepër, gjithashtu si gjyqtare për të mitur përkatësisht si kryetare e kolegjit për të mitur ka vazhduar masën e paraburgimit ndaj të miturve në fjalë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në shkeljen e potencuar më lartë nuk ka vlerësuar shkeljet tjera të pretenduara, meqenëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin, përkatësisht se në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili ka qenë dashur të përjashtohet, e që kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së dhe meqenëse kjo shkelje nuk ishte korrektuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë si e tillë kushtëzoi anulimin e të dy aktgjykimeve të kundërshtuara dhe kthimin e çështjes në gjykatën së shkallës së parë.

Duke pasur parasysh faktin se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur vetëm në dobi të të miturve G.H. dhe R.G., Gjykata Supreme e Kosovës, konform dispozitës së nenit 436,

paragrafi 2. të KPP-së, ka aplikuar institutin "Beneficium Cohaesionis", meqë shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të miturve, nuk janë të natyrës personale dhe shkojnë në dobi edhe për të miturin tjetër L.Ll., i cili nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

3.4. Komente përmbledhëse

Në rastin Pml.nr.239/2022, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit dhe kishte anuluar aktgjykimin e gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke e kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në këtë rast, mbrojtësi i të dënuarit kishte pretenduar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ishte marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, meqë në përbërje të trupit gjykues të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht kryetarit të trupit gjykues ka marrë pjesë gjyqtari i cili po ashtu ka marrë pjesë në cilësinë e gjyqtarit të procedurës penale me rastin e dhënies së urdhrit verbal për bastisjen e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të pronës së të dënuarit, pra sipas të njëjtës çështje penale.

Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar se një pretendim i tillë i mbrojtësit të të dënuarit ishte i bazuar, duke konsideruar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, sepse në trupin gjykues të gjykatës së shkallës së parë kishte marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohej.

Në këtë drejtim, është konstatuar se në përbërjen e trupit gjykues të gjykatës së shkallës së parë ka marrë pjesë gjyqtari i cili në këtë çështje penale ka marrë pjesë në cilësinë e gjyqtarit të procedurës paraprake gjatë procedurës hetimore, duke dhënë urdhër verbal për bastisje të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të pronë së të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë rast i është referuar edhe dispozitës ligjore të nenit 39, paragrafi 2. të KPP-së, në të cilën është parashikuar se *"Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë".*

Kurse, në rastin Pml.nr.147/2020, Gjykata Supreme e Kosovës kishte miratuar kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të miturve, duke e kthyer rastin në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, pasi që si anëtare e trupit gjykues për të mitur kishte marrë pjesë gjyqtarja e cila në procedurën përgatitore ja kishte caktuar paraburgimin të miturve G.H. dhe R.G.

Edhe në këtë rast, ishte konstatuar shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, pasi që në trup gjykues për të mitur kishte marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur që të përjashtohet.

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës mund të nxjerrën këto tre (3) konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1) Se pjesëmarrja në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç tjerash, i referohet edhe rasteve kur gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues, anëtari i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme ka vepruar si gjyqtar i procedurës paraprake[25] duke lëshuar urdhër verbal për kontroll.

Edhe tani me dispozitat ligjore të KPP-së nuk është parashikuar mundësia e kontrollit në bazë të lejes gojore të gjyqtarit, siç ka qenë e parashikuar me nenin 110, paragrafi 3. të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale,[26] megjithatë, përshtatshmërisht mund të konstatohet se pjesëmarrja në cilësinë e gjyqtarit të procedurës paraprake, i cili ka lëshuar një urdhër për kontroll do të ishte arsye që gjyqtari në fjalë të përjashtohet nga gjykimi i rastit si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme.

Gjithashtu, bazuar në rastin Pml.nr.147/2020, gjyqtari për të mitur i cili në pro

cedurën përgatitore ja ka caktuar paraburgimin të miturit, nuk duhet që të jetë anëtar i trupit gjykues për të mitur.

2) Se përbërja e rregullt e gjykatës është një kusht i domosdoshëm *("sine qua non")* dhe kusht paraprak që do të mundësonte vlerësimin e mëtejmë të pretendimeve tjera nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

[25] Kompetencat e përgjithshme të gjyqtarit të procedurës paraprake janë parashikuar në nenet 23 dhe 24 të KPP-së.
[26] Kodi Nr.04/ L-123 i Procedurës Penale, i datës 13.12.2012

Siç shihet edhe nga aktgjykimi i lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në shkeljen e konstatuar, nuk kishte vlerësuar mandej shkeljet tjera të pretenduara, meqenëse përbërja e gjykatës nuk kishte qenë në pajtim me ligjin, përkatësisht se në marrjen e aktgjykimit kishte marrë pjesë gjyqtari i cili ka qenë dashur të përjashtohet.

3) Se marrja pjesë në trup gjykues të gjykatës së shkallës së parë e gjyqtarit që është dashur të përjashtohet, ka qenë arsye që ka kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të gjykatës themelore, si dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe kthimin e çështjes në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

4. Mos sigurimi i përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilën i akuzuari nuk e kupton

4.1. Dispozitat ligjore

a) Neni 14, paragrafët 3., 4., 5. dhe 8. të KPP-së

Gjuhët dhe shkrimi

"I pandehuri, i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ka të drejtë në përkthim të cilësisë së mjaftueshme në mënyrë që të garantohet paanshmëria e procedurës, veçanërisht për të siguruar që ai ka njohuri të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes.

I pandehuri, i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ka të drejtën e përkthimit për komunikim me mbrojtësin e tij, nëse ai nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e të pandehurit:
4.1. kur i pandehuri merret në pyetje;
4.2. gjatë cilësdo seance dëgjimore; ose
4.3. kur paraqet parashtresë me shkrim ose ankesë.

Personi nga paragrafi 2, 3 dhe 4 i këtij neni njoftohet për të drejtën e tij në përkthim. Ai mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore. Nëse personi është i pandehur, heqja dorë e tillë bëhet pasi ai të ketë marrë këshilla ligjore paraprake ose nëse ka njohuri të plota për pasojat e heqjes dorë të tillë dhe që heqja dorë është e qartë dhe e dhënë

vullnetarisht. Njoftimi për këtë të drejtë dhe deklarata e pjesëmarrësit ose të pandehurit shënohet në procesverbal.

Të pandehurit dhe personit i cili është në vuajtje të dënimit i cili nuk e kupton gjuhën e procedurës duhet siguruar, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtresave, në tërësi ose pjesërisht, varësisht nga fakti nëse ato janë relevante për qëllimin e mundësimit të të pandehurit ose personit që është në vuajtje të dënimit të ketë njohuri të rastit kundër tij, në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë, ose dokumenteve të tjera të cilat janë thelbësore për të siguruar që ai të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes dhe të sigurohet paanshmëria e procedurave".

b) Neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. të KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

"Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale që njihet sipas detyrës zyrtare apo propozimit të palëve konsiderohet nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në një gjuhë të cilën i akuzuari nuk e kupton dhe nuk është siguruar përkthimi".

4.2. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Përveç dispozitave të lartcekura ligjore, fillimisht duhet theksuar se çështja e përdorimit të gjuhës është e rregulluar edhe me dispozita tjera si vendore, ashtu edhe ndërkombëtare.

Kështu, me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar se cilat janë gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, kurse me Ligjin për përdorimin e gjuhëve[27] janë rregulluar në mënyrë më detaje shumë çështje që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve.

Në anën tjetër, nëse i referohemi procedurës penale, atëherë është e nevojshme që të theksohet se në nenin 3, paragrafi 3/a të KEDNJ-së, është parashikuar se *"Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

[27] Ligji Nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, i datës 27.07.2006.

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij".

Përdorimi i gjuhës konsiderohet njëra nga të drejtat themelore të të pandehurit në procedurë penale, që garantohet me shumë akte juridike.

Sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 14, paragrafi 3. të KPP-së, nëse i pandehuri nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ai ka të drejtë në përkthim të cilësisë së mjaftueshme në mënyrë që të garantohet paanshmëria e procedurës, veçanërisht për të siguruar që ai ka njohuri të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes.

Në lidhje me gjuhën e procedurës, duhet përmendur edhe nenin 14, paragrafi 1. të KPP-së, në të cilin është parashikuar se *"Gjuha dhe shkrimet që mund të përdoren në procedurë penale janë gjuha shqipe dhe serbe, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj".*

Gjithashtu, edhe në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar se *"Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj".*

Kurse, në nenin 12 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve thuhet se *"Gjuhët zyrtare përdoren në mënyrë të barabartë në procedurat gjyqësore. Gjykatat dhe organet për ndjekje penale, si dhe autoritetet e tjera të përfshira në procedurë penale dhe në procedurat e tjera gjyqësore, sigurojnë që çdo person që merr pjesë në procedurat penale, si dhe në procedura të tjera gjyqësore mund të përdorë gjuhën zyrtare të cilën ai/ajo e zgjedh".*

Mandej, në nenin 13 të Ligjit të lartcekur është parashikuar *"Gjykatat zhvillojnë procedurat në gjuhën zyrtare apo në gjuhët zyrtare të zgjedhura nga palët në procedura. Me kërkesën e palës në procedura, pajisjet duhet të sigurohen për përkthim simultan, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën. Gjykatat mund të sigurojnë pajisjet për përkthim simultan të procedurave, duke përfshirë dëshmitë e dhëna, nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, atëherë kur konsiderojnë se procedurat të jenë në interesin e përgjithshëm publik".*

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se nëse i pandehuri nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ai ka të drejtë në përkthim të cilësisë së mjaftueshme, kjo me qëllim që të garantohet paanshmëria e procedurës, veçanërisht për të siguruar që ai ka njohuri të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes.

Përveç që gëzon të drejtën e përdorimit të gjuhës së vetë në procedurë penale, i pandehuri, i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ka të drejtën edhe të përkthimit për komunikim me mbrojtësin e tij, nëse mbrojtësi nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e të pandehurit:

- kur i pandehuri merret në pyetje;
- gjatë cilësdo seance dëgjimore; ose
- kur paraqet parashtresë me shkrim ose ankesë.[28]

I pandehuri duhet të njoftohet për të drejtën e tij në përkthim, mirëpo ai mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore, ndërsa një gjë e tillë bëhet pasi ai të ketë marrë këshilla ligjore paraprake ose nëse ka njohuri të plota për pasojat e heqjes dorë dhe që heqja dorë është e qartë dhe e dhënë vullnetarisht. Njoftimi për këtë të drejtë dhe deklarata e të pandehurit shënohet në procesverbal.[29]

Gjithashtu, të pandehurit dhe personit i cili është në mbajtje të dënimit i cili nuk e kupton gjuhën e procedurës duhet siguruar, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtresave, në tërësi ose pjesërisht, varësisht nga fakti nëse ato janë relevante për qëllimin e mundësimit të të pandehurit ose personit që është në vuajtje të dënimit të ketë njohuri të rastit kundër tij, në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë, ose dokumenteve të tjera të cilat janë thelbësore për të siguruar që ai të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes dhe të sigurohet paanshmëria e procedurave.[30]

Të gjitha organet shtetërore që veprojnë në procedurë penale janë të detyruara që ta njoftojnë të pandehurin për të drejtën e tij që ta përdorë gjuhën e tij, nëse nuk e kupton gjuhën e procedurës dhe një gjë e tillë duhet të konstatohet edhe në procesverbalin e seancës përkatëse.

[28] Neni 14, paragrafi 4. i KPP-së.
[29] Neni 14, paragrafi 5. i KPP-së.
[30] Neni 14, paragrafi 8. i KPP-së.

Nëse i pandehuri nuk e kupton gjuhën e procedurës, atëherë të gjitha organet shtetërore janë të detyruara të njëjtit t'ia sigurojnë përkthimin e cilësisë së mjaftueshme, ndërsa këtë do të mund ta bëjë vetëm një përkthyes profesionist.

Përndryshe, duhet theksuar se konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në një gjuhë të cilën i pandehuri nuk e kupton dhe nuk është siguruar përkthimi.

Edhe pse neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. i KPP-së i referohet vetëm shqyrtimit gjyqësor, një shkelje e tillë do të konsumohej, edhe në rastet kur shqyrtimi fillestar apo shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve, nga neni 247 i KPP-së janë mbajtur në një gjuhë të cilin e pandehuri nuk e kupton dhe nuk është siguruar përkthimi.

Sigurisht se një shkelje e tillë do të vjen në shprehje, edhe nëse gjatë seancave të kolegjit apo shqyrtimeve pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, të pandehurit i është mohuar një e drejtë.

Edhe GJEDNJ-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore i ka kushtuar një rëndësi të madhe të drejtës së të pandehurit që të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjykatë, sipas nenit 6, paragrafi 3/e të KEDNJ-së.

GJEDNJ-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka konstatuar shkelje të nenit të lartcekur, pikërisht për shkak të mos respektimit të kësaj të drejte nga ana e autoriteteve gjyqësore të shteteve përkatëse.[31]

4.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos sigurimit të përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilën i akuzuari nuk e kupton

[31] Shih rastet: *"Borizeck kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 19.12.1989, paragrafi 40; "*Hermi kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 16.10.2006, paragrafi 68; *"Sejdovic kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 01.03.2006, paragrafi 89; *"Kamasinski kundër Austrisë"*, aktgjykimi i datës 19.12.1989, paragrafi 79; *"Tabaï kundër Francës"*, vendimi nr. 73805/01, i datës 17.02.2004, etj. Në rastin *"Kamasinski kundër Austrisë"*, aktgjykimi i datës 19.12.1989, paragrafi 79, GjEDNj-ja ka bërë të qartë të drejtën e të pandehurit *"për t'u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzës ndaj tij"* dhe se *"Një i pandehur që nuk e njeh gjuhën e gjykatës, në fakt mund të vihet në disavantazh, nëse nuk i sigurohet edhe një përkthim me shkrim i aktakuzës në një gjuhë që ai e kupton"*.

Çështja e mos sigurimit të përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilin i akuzuari nuk e ka kuptuar ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Kështu, në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.104/2021, ku objekt i shqyrtimit ka qenë çështja e mos sigurimit të përthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilin i akuzuari nuk e ka kuptuar:

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.104/2021, i datës 28.04.2021**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit B.G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.20/2021, të datës 29.01.2021...

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi:

- kërkesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se i dënuari nuk e fletë e as nuk e kupton mirë gjuhën shqipe dhe në procedurën pranë gjykatës së shkallës së parë të gjitha veprimet janë ndërmarrë me pjesëmarrjen e përkthyesit të gjuhës gjermane.

Ndërsa, nga procesverbali i seancës pranë gjykatës së shkallës së dytë të datës 29.01.2021, rezulton se të dënuarit nuk i është caktuar përkthyesi, ndërsa gjykata duhej ta dinte për nevojën e angazhimit të përkthyesit, pasi që kjo qartazi rrjedh nga kërkesa e tij gjatë zhvillimit të procedurës penale në gjykatën e shkallës së parë.

Meqë të dënuarit i është mohuar përdorimi i gjuhës së tij dhe përcjellja e seancës gjyqësore në gjuhën e tij, atëherë kjo përbënë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj edhe nga këto arsye është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi (anulimi i aktgjykimit), me sugjerimin se të dënuarit duhet t'i mundësohet përcjellja e seancës në gjuhën të cilën e kupton dhe të merret një vendim i ligjshëm.

4.4. Komente përmbledhëse

Në rastin e paraqitur mësipër, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, pasi që kishte konstatuar se aktgjykimi i kundërshtuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Nga shkresat e lëndës është vërejtur se i dënuari nuk e flet e as nuk e kupton mirë gjuhën shqipe dhe në procedurën pranë gjykatës së shkallës së parë të gjitha veprimet ishin ndërmarrë me pjesëmarrjen e përkthyesit të gjuhës gjermane, mirëpo nga procesverbali i seancës pranë gjykatës së shkallës së dytë të datës 29.01.2021, rezulton se të dënuarit nuk i është caktuar përkthyesi, ndërsa gjykata e shkallës së dytë do të duhej ta dinte për nevojën e angazhimit të përkthyesit, pasi që kjo qartazi rrjedh nga kërkesa e tij gjatë zhvillimit të procedurës penale në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar se meqë të dënuarit i është mohuar përdorimi i gjuhës së tij dhe përcjellja e seancës gjyqësore në gjuhën e tij, atëherë kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe kjo shkelje kishte qenë arsye e mjaftueshme për ta aprovuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe për ta kthyer rastin në rigjykim.

Në rigjykim, është sugjeruar që të dënuarit duhet t'i mundësohet përcjellja e seancës në gjuhën të cilën e kupton dhe të merret një vendim i ligjshëm.

Nga aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe duke ju referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe dispozitave ligjore të trajtuara më lart, mund të nxjerrën këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1) Se të pandehurit i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës t'i sigurohet e drejta e përdorimit të gjuhës së tij dhe një gjë e tillë t'i mundësohet përmes një përkthimi të cilësisë së mjaftueshme, në mënyrë që të garantohet paanshmëria e procedurës, veçanërisht për të siguruar që ai ka njohuri të rastit kundër tij dhe është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes;

2) Që të pandehurit i cili nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, t'i mundësohet përkthimi për komunikim me mbrojtësin e tij, nëse mbrojtësi nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e të pandehurit;

3) Se të gjitha organet shtetërore që veprojnë procedurë penale janë të detyruara që ta njoftojnë të pandehurin për të drejtën që të ketë ndihmën e një përkthyesi pa pagesë, kur nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën e procedurës, ndërsa një gjë e tillë edhe të konstatohet në procesverbal të seancës gjyqësore dhe

4) Mos sigurimi i përkthimit gjatë seancës gjyqësore e cila është mbajtur në një gjuhë të cilin i pandehuri nuk e kupton, konsiderohet shkelje e të drejtave të të pandehurit dhe njëkohësisht edhe shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale e cila ka për pasojë edhe anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e rastit në rigjykim.

I akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj, ndërsa është marrë në pyetje para prezantimit të provave

5.1. Dispozitat ligjore

Neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.8. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

"Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale që njihet sipas detyrës zyrtare apo propozimit të palëve konsiderohet nëse i akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezantimit të provave".

5.2. Komentim i shkurtër i dispozitës ligjore të lartcekur

Sipas KPP-së, në parim, shqyrtimi gjyqësor përbëhet prej disa fazave dhe e gjithë veprimtaria e shqyrtimit gjyqësor përmblidhet në: fillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimin e të akuzuarit; paraqitjen e provave; fjalën përfundimtare të palëve dhe seancën për caktimin e dënimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, duhet të ndërmerren një mori e veprimeve procedurale të përcaktuara me dispozitat e KPP-së. Të gjitha këto veprime procedurale duhet të ndërmerren sipas radhës e cila gjithashtu është e përcaktuar në mënyrë decidive me dispozitat e KPP-së.

Duhet theksuar se nëse pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor i akuzuari e pranon fajësinë, atëherë, kalohet menjëherë në leximin e të dhënave penale nga evidenca e të dënuarve,[32] mandej në fjalën përfundimtare dhe seancën për caktimin e dënimit.

Nëse i akuzuari nuk e pranon fajësinë apo nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e refuzojnë pranimin e fajësisë, sipas nenit 322, paragrafi 3. lidhur me nenin 242, paragrafi 4. të KPP-së, atëherë vazhdohet me procedurën e paraqitjes së provave.

Bazuar në nenin 323 të KPP-së, provat në shqyrtimin gjyqësor paraqiten sipas radhës së mëposhtme:

1. Provat e paraqitura nga prokurori i shtetit;
2. Provat e paraqitura nga i dëmtuari, nëse ka të dëmtuar dhe
3. Provat e paraqitura nga i akuzuari dhe mbrojtësi.

[32] Neni 347 i KPP-së.

Përveç provave të propozuara nga palët, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues ka të drejtë të sigurojë provën që e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale.[33]

Në parim, provat administrohen sipas kësaj renditje:

Së pari, fillohet me marrjen në pyetje të dëshmitarëve;[34]
Së dyti, me marrjen në pyetje të ekspertëve;
Së treti, paraqitjen e provave materiale dhe
Së katërti, me marrjen në pyetje të të akuzuarit, i cili nuk e pranuar fajësinë.

Në nenin 343, paragrafi 1. të KPP-së është parashikuar se *"Pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve e ekspertëve dhe pas prezantimit të provave materiale vazhdohet me marrjen në pyetje të të akuzuarit i cili nuk ka pranuar fajësinë"*.

Shqyrtimi gjyqësor zbatohet sipas rregullave të parapara me KPP, por për shkaqe të arsyeshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndryshojë radhën e zakonshme të shqyrtimit të provave, sidomos për shkak të numrit të të akuzuarve, numrit të veprave penale ose të vëllimit të materialit provues.[35]

Mirëpo, pavarësisht kësaj, edhe nëse është ndryshuar radha e zakonshme e shqyrtimit të provave, prapëseprapë, i akuzuari duhet që të merret në pyetje në fund të procedurës së provave, përkatësisht pas paraqitjes apo prezantimit të provave tjera.

Përndryshe, nëse i akuzuari është marrë në pyetje para paraqitjes së provave, kjo përbën shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.8. të KPP-së.

[33] Neni 325, paragrafi 4. i KPP-së.
[34] Në nenin 360, paragrafi 3. të Kodit të Procedurës Penale (Rregullorja e UNMIK-ut, nr.2003/26) i cili kishte hyrë në fuqi më datën 06.04.2004, ishte parashikuar se *"Dëshmia e të dëmtuarit si dëshmitar dëgjohet para dëshmive të dëshmitarëve të tjerë"*.
[35] Neni 295 i KPP-së.

Pra, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale mund të vjen në shprehje vetëm në rastet kur i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës ose ndonjë pikë të saj, ndërsa është marrë në pyetje para paraqitjes së provave.

Edhe në rastet kur pas përfundimit të fjalës përfundimtare të palëve, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues çmon se duhet marrë prova të tjera,[36] atëherë edhe në situatat të tilla, pas paraqitjes së këtyre provave tjera, përsëri duhet që i akuzuari të merret në pyetje në kontekst të çështjeve që janë trajtuar gjatë administrimit të këtyre provave tjera.

Gjithashtu, edhe në rastet kur trupi gjykues gjatë seancës së këshillim dhe votim e sheh të nevojshme që përsëri të hapet shqyrtimi gjyqësor për plotësimin e procedurës së provave, duke u bazuar në nenin 358, paragrafi 1. dhe nenin 471, paragrafi 1. të KPP-së, atëherë edhe në situata të tilla, i akuzuari duhet që përsëri të merret në pyetje, pas paraqitjes së këtyre provave, kuptohet në kontekst, të çështjeve që janë trajtuar nga këto prova.

Pra, sipas KPP-së, në çdo rast, i akuzuari duhet të merret në pyetje pas paraqitjes së provave dhe një gjë e tillë është parashikuar me qëllim që i akuzuari të ketë mundësi që të vlerësojë nga pikëpamja e mbrojtjes rezultatet e procedurës së provave dhe të ketë mundësi që të deklarohet në lidhje me të gjitha provat gjatë marrjes së tij në pyetje.

Marrja në pyetje e të akuzuarit duhet të dallohet nga deklarimi i tij për aktakuzën, pasi që këto janë dy (2) institute të ndryshme të procedurës penale.

Deklarimi i të akuzuarit për aktakuzën vjen në shprehje pasi prokurori i shtetit ta lexon aktakuzën në fillim të shqyrtimit gjyqësor, ku të akuzuarit i jepet mundësia që ta pranojë ose të mos e pranojë fajësinë,[37] kurse, marrja në pyetje e të akuzuarit bëhet pas paraqitjes së provave në shqyrtim gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në nenet 343-345 të KPP-së.

5.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen kur i akuzuari ~~i cili~~ nuk e kishte pranuar fajësinë, ndërsa ishte marrë në pyetje para prezantimit të provave

[36] Neni 355, paragrafi 1. i KPP-së.
[37] Neni 321, paragrafi 1. i KPP-së.

Çështja e marrjes në pyetje të të akuzuarit para paraqitjes apo prezantimit të provave, në rastet kur i njëjti nuk e kishte pranuar fajësinë, ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Kështu, në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.70/2020, ku objekt i shqyrtimit ka qenë çështja e marrjes në pyetje të të akuzuarit, para paraqitjes së provave në shqyrtim gjyqësor:

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.70/2020, i datës 08.04.2020**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit dhe të dënuarit A.M., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.420/2016, i datës 20.05.2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.424/2010, i datës 22.10.2019 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, pa vlerësuar pretendimet e tjera të theksuara në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatojë se janë të bazuara pretendimet të paraqitura se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me dispozitën e nenit 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.9. të KPP-së.

Me dispozitën e lartcekur ligjore është përcaktuar se shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale bëhet në rastin kur “i akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezantimit të provave”.

Në rastin konkret, duke u bazuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, del se i dënuari pas prezantimit të provave, përkatësisht konstatimit të leximit të tyre, kishte paraqitur mbrojtjen e tij,

përkatësisht ishte konstatuar se kishte mbetur pranë mbrojtjes së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të mëparshëm.

Mirëpo, pas kësaj gjykata e shkallës së parë sipas detyrës zyrtare kishte vendosur që në cilësi të dëshmitares të dëgjohej V.M. dhe e cila bazuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor ishte marrë në pyetje në cilësi të dëshmitares, kurse pas kësaj, ishte vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Duke u bazuar në procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore del se qëndrojnë pretendimet e paraqitura se pas dëgjimit të dëshmitares V.M., përkatësisht dhënies së dëshmisë së saj, gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë mundësi të dënuarit që të paraqes mbrojtjen e tij, ku në këtë mënyrë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.9. të KPP-së dhe bazuar në faktin se të metat e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë eliminuar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, atëherë është vendosur që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera dhe të eliminoj shkeljen e potencuar në këtë aktgjykim e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

5.4. Komente përmbledhëse

Në rastin e paraqitur më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, pasi që kishte konstatuar se aktgjykimi i kundërshtuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Nga shkresat e lëndës është vërejtur se në shqyrtim gjyqësor ishte marrë në pyetje edhe një dëshmitare, ndërsa pas marrjes në pyetje të dëshmitares, ishte vazhduar me fjalën përfundimtare

të palëve, pa ju dhënë mundësia të akuzuarit që të deklarohet, përkatësisht pa u marrë në pyetje i akuzuari në lidhje me deklarimin e kësaj dëshmitare.

Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar se meqë i dënuari nuk është marrë në pyetje pas paraqitjes së provave, atëherë kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe kjo shkelje kishte qenë arsye e mjaftueshme për ta aprovuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe për ta kthyer rastin në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Nga aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe duke ju referuar dispozitave ligjore të trajtuara më lart, mund të nxjerrën këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1) Se i akuzuari i cili nuk e ka pranuar fajësinë duhet të merret në pyetje pas paraqitjes së provave në shqyrtim gjyqësor dhe një gjë e tillë duhet vjen në shprehje edhe në rastet kur është ndryshuar rrjedha e zakonshme e shqyrtimit të provave, sipas nenit 295 të KPP-së.

2) Se i akuzuari i cili nuk e ka pranuar fajësinë dhe është marrë në pyetje në shqyrtim gjyqësor, duhet të merret rishtas në pyetje, edhe në rastet kur pas përfundimit të fjalës përfundimtare të palëve, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues çmon se duhet marrë prova të tjera.[38] Marrja e serishme në pyetje e të akuzuarit, në situatat të tilla, zbatohet pas paraqitjes së këtyre provave tjera dhe një marrje e serishme në pyetje e të akuzuarit, duhet të bëhet në drejtim të çështjeve që janë trajtuar gjatë administrimit të këtyre provave tjera.

Gjithashtu, edhe në rastet kur trupi gjykues gjatë seancës së këshillimit dhe votimit e sheh të nevojshme që përsëri të hapet shqyrtimi gjyqësor për plotësimin e procedurës së provave, duke u bazuar në nenin 358, paragrafi 1. dhe nenin 471, paragrafi 1. të KPP-së, atëherë edhe në situata të tilla, i akuzuari duhet që përsëri të merret në pyetje, pas paraqitjes së këtyre provave, kuptohet në kontekst, të çështjeve që janë trajtuar nga këto prova.

3) Përndryshe, marrja në pyetje e të akuzuarit i cili nuk e ka pranuar fajësinë, para paraqitjes së provave konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, e cila ka për pasojë edhe anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e rastit në rigjykim.

[38] Neni 355, paragrafi 1. i KPP-së.

6. Nëse aktgjykimi tejkalon fushëveprimin e fakteve nga aktakuza

6.1 Dispozitat ligjore

Neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.6. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

"Sipas propozimit të palëve, shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet vetëm ajo shkelje e cila ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë, në rastet kur aktgjykimi tejkalon fushëveprimin e fakteve nga aktakuza".

6.2. Komentim i shkurtër i dispozitës ligjore të lartcekur

KPP-ja tani përmban një zgjidhje tjetër në raport me çështjen e ndërlidhjes së aktakuzës me aktgjykimin.

Me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale (neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.10.), është konsideruar shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, për të cilën është dashur që Gjykata e Apelit e Kosovës të kujdeset sipas detyrës zyrtare, nëse aktgjykimi ka tejkaluar akuzën.

Tejkalimi i akuzës ka mundur të jetë i natyrës subjektive, objektive, apo edhe i kombinuar.[39]

Tejkalimi i akuzës në kuptimin subjektiv ka nënkuptuar rastet kur gjykata ka shpallur fajtor ndonjë person që nuk ka qenë i akuzuar, kurse tejkalimi i akuzës në kuptimin objektiv ka nënkuptuar rastet kur me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë vepër tjetër penale e cila nuk ka qenë objekt i

[39] Në nenin 359, paragrafi 1. të KPP-së është përcaktuar se *"Aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor"*. Në lidhje me këtë çështje *"Ruajtja e identitetit subjektiv dhe objektiv është e domosdoshme edhe për faktin e shmangies së gjykimit të dyfishtë, në rast së personi i njëjtë akuzohet përsëri për të njëjtën ngjarje. Me këtë rast nuk është me rëndësi cilësimi juridik i veprës i dhënë në aktakuzë, pasi gjykata nuk është e lidhur me të, por ajo duhet t'i përmbahet përshkrimit faktik të veprës penale të dhënë në aktakuzë, në të kundërtën mund të kemi tejkalim të aktakuzës ose moszgjidhje të objektit të akuzës që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me nenin 384, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.7. dhe 1.10. të KPP"*, sipas : SHALA, AFRIM : Doracaku i gjyqtarëve për procedurën penale, Prishtinë, 2015, fq. 157, (Bashkautor).

aktakuzës, përkatësisht kur gjykata ka gjykuar për ngjarjen tjetër nga e kaluara ose për përshkrimin tjetër faktik dhe jo për ngjarjen dhe përshkrimin faktik të dhënë në aktakuzën e paraqitur fillimisht ose aktakuzën e ndryshuar ose të zgjeruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.[40]

Ndërsa, tani sipas nenit 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.6. të KPP-së, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, sipas propozimit të palëve, nëse aktgjykimi ka tejkaluar fushëveprimin e fakteve nga aktakuza, me kusht që kjo shkelje të ketë ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë.

Sipas zgjidhjes së përcaktuar me këtë dispozitë ligjore, kjo shkelje ligjore, për dallim nga zgjidhja që ishte parashikuar me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale, përbëhet nga këto elemente:

1) Është shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit e Kosovës vetëm sipas propozimit të palëve, pra nuk është shkelje për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare;
2) Nëse aktgjykimi ka tejkaluar fushëveprimin e fakteve nga aktakuza konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, vetëm nëse një shkelje e tillë ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë. Me fjalë të tjera, jo çdo tejkalim i tillë i fakteve nga aktakuza konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, por vetëm në rastet kur natyra e tejkalimeve të tilla ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë. Me dispozitat ligjore të KPP-së nuk është përcaktuar se kur konsiderohet një *"aktgjykim i ligjshëm dhe i drejtë"*, mirëpo, praktikës gjyqësore do t'i mbetet përgjegjësia që të të përcaktojë dhe të definojë një aspekt të tillë.
3) Që aktgjykimi të tejkalon fushëveprimin e fakteve nga aktakuza.

Zgjidhja e përcaktuar në këtë dispozitë ligjore e detyron gjykatën që mos të tejkalon fushëveprimin e fakteve nga aktakuza. Gjithashtu, edhe sa i përket këtij aspekti, me dispozitat ligjore të KPP-së nuk është sqaruar se në cilat raste konsiderohet tejkalim i fushëveprimit të fakteve që janë të parashikuara me aktakuzë. Në një mënyrë, një element i tillë do të mund të identifikohet edhe me

[40] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, fq. 899.

të ashtuquajturin *"tejkalim të aktakuzës në kuptimin objektiv"* duke e ndërlidhur këtu vetëm me dimensionin e fakteve nga aktakuza.

Në lidhje me këtë çështje, fillimisht, është e rëndësishme që të përcaktohet nocioni i faktit. Sipas profesorit të nderuar, Dr. Ejup Sahiti, *"fakti është ekzistimi objektivo real i ndonjë sendi, dukurie, procesi, ndodhie, cilësie ose raporti i vërtetuar në mënyrë mendore perceptuese. Fakti ka kuptimin e ndonjë ngjarje, ndodhie apo fragmenti të realitetit objektiv".*[41]

Pjesë përbërëse e aktakuzës është edhe aspekti faktik i ngjarjes, përkatësisht i çështjes penale.

Bazuar në atë që u theksua më lart, tejkalimi i fushëveprimit të fakteve nga aktakuza, do të duhej nënkuptuar rastet kur me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë vepër tjetër penale e cila nuk ka qenë objekt i përshkrimit faktik të aktakuzës, përkatësisht kur gjykata ka gjykuar për ngjarjen tjetër nga e kaluara ose për përshkrimin tjetër faktik dhe jo për ngjarjen dhe përshkrimin faktik të dhënë në aktakuzën e paraqitur fillimisht ose aktakuzën e ndryshuar ose të zgjeruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.[42]

Nuk do të duhej të konsiderohet tejkalim i fushëveprimit të fakteve nga aktakuza, nëse gjykata në përshkrimin e veprës penale ka përfshirë detaje të cilat nuk i përmban aktakuza dhe shërbejnë për të precizuar më afër veprën penale.[43]

6.3 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e tejkalimit të akuzës

Çështja e tejkalimit të akuzës, ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në disa çështje nga praktika e saj gjyqësore.

---

[41] SAHITI, EJUP: Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë, 1999, fq. 106.

[42] Tejkalimi i objektiv i akuzës do të vinte në shprehje në rastin kur prokurori i shtetit ka ngritë aktakuzë kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale *"Vjedhja"*, nga neni 313, paragrafi 1. i KPRK-së, pasi i akuzuari kishte hyrë në shtëpinë e të dëmtuarit dhe kishte marrë stoli ari në vlerë prej katërmijë (4.000) euro. Pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, gjykata kishte vërtetuar së vlera e stolive të arit ka qenë gjashtëmijë (6.000) euro, e jo katërmijë (4.000) euro, siç është thënë në aktakuzë, por prokurori i shtetit nuk e kishte ndryshuar aktakuzën e tij dhe nuk e kishte bërë ricilësimin e veprës penale në *"Vjedhja e rëndë"*, nga neni 315, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së. Në një situatë të tillë, gjykata duke u bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor e shpallë të akuzuarin fajtor për vepër penale *"Vjedhja e rëndë"*, nga neni 315, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. i KPRK-së. Në këtë rast, gjykata e ka tejkaluar akuzën, pasi të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale që nuk ka qenë i akuzuar. Shih edhe : SHALA, AFRIM: Doracaku i gjyqtarëve për procedurën penale, fq. 159.

[43] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, fq. 900.

Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste, ku objekt i shqyrtimit ka qenë tejkalimi i akuzës, duke ju referuar dispozitave ligjore të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, ndërsa me qëllim të sqarimit të kësaj teme duke e pasur parasysh edhe kompleksitetin e saj, janë paraqitur edhe disa raste kur kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë refuzuar si të pabazuar.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.412/2022, i datës 10.11.2022**

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit N.K., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.51/2019, të datës 13.12.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.20/2022, të datës 20.04.2022.

A r s y e t i m i

Mbrojtësi i të dënuarit N.K., avokati G.K., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë, përveç tjerash kishte pretenduar në tejkalimin e akuzës nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që në dispozitiv të aktgjykimit janë shtuar rrethanat kualifikuese-rënduese të cilat nuk kanë ekzistuar në aktakuzën bazë dhe të ndryshuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit N.K., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat nuk qëndrojnë. Kjo për faktin se si aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, ashtu edhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës nuk janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat do të ndikonin në ligjshmërinë e këtyre aktgjykimeve.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për tejkalim të aktakuzës në kuptimin objektiv, për faktin se nga fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit të

përpiluar në formë të shkruar më datën 28.10.2021, shihet se për të dënuarin N.K., kishte bërë rikualifikimin juridik të veprës penale, ashtu që sipas pikës I., të njëjtin e kishte akuzuar për shkak të veprës penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion, nga neni 241, paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së, ndërsa sipas pikës II. të dënuarin e kishte akuzuar për shkak të veprës penale fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara, nga neni 205, paragrafi 2. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së. Meqenëse gjykata e shkallës së parë kishte vendosur që të rihap edhe një herë shqyrtimin gjyqësor, atëherë gjatë fjalës së serishme përfundimtare të datës 10.11.2021, prokurorja e çështjes kishte deklaruar se veprimet inkriminuese të të dënuarit N.K., në lidhje me veprën penale fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara, nga neni 205, paragrafi 2. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së janë inkorporuar në veprën penale të rikualifikuar mundësimi ose detyrimi në prostitucion, nga neni 241, paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së. Kështu, që edhe ka hequr dorë nga ndjekja për veprën penale fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara, nga neni 205, paragrafi 2. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së. Mbi bazën e këtij përmirësimi dhe rikualifikimi të veprës penale nga ana e prokurorit të shtetit, mandej, gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor të dënuarin N.K. për shkak të veprës penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion, nga neni 241, paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së (pika I. e dispozitivit), kurse është refuzuar akuza për shkak të veprës penale fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara, nga neni 205, paragrafi 2. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së (pika III. e dispozitivit).

Në anën tjetër, qëndron fakti se gjykata e shkallës së parë, në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit, ku janë përshkruar veprimet inkriminuese të të dënuarit N.K., në lidhje me veprën penale për të cilën ishte shpallur fajtor, kishte paraqitur dhe përshkruar edhe disa detaje dhe disa veprime tjera, të cilat nuk janë përmendur në aktakuzën e paraqitur fillimisht dhe të ndryshuar gjatë fjalës përfundimtare.

Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës edhe në situatën e tillë nuk mund të bëhet fjalë për tejkalim të akuzës në kuptimin objektiv, për disa arsye. Së pari, në rastin konkret bëhet fjalë për ngjarjen e njëjtë, por që janë sqaruar dhe precizuar më tepër rrethanat e rastit konkret, duke u bërë më të qartë dhe më të plotë vetë përshkrimin e veprës penale. Së dyti, këto detaje dhe veprime që janë shtuar nuk kanë bëjnë me elementet themelore të veprës penale. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se “do të konsiderohej tejkalim i akuzës në kuptimin

objektiv, në rastet kur gjykata e ndryshon përshkrimin faktik të ngjarjes, duke vendosur në të elemente të caktuara të cilat do të rezultonin me një kualifikim më të rëndë të veprës penale, në krahasim me veprën penale e cila është përfshirë në aktakuzë". Mirëpo, në këtë çështje penale, nuk vjen në shprehje një segment i tillë, pasi që gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor të dënuarin N.K., për kualifikimin juridik të njëjtë me atë që është i përfshirë në aktakuzën e ndryshuar gjatë fjalës përfundimtare.

Nga përshkrimi faktik i veprimeve inkriminuese, shihet se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur disa detaje dhe veprime tjera, të cilat vetëm se e kanë precizuar dhe sqaruar më afër veprën penale përkatëse, si dhe është bërë një përshkrim më i plotë dhe më i saktë i veprës penale, ndërsa në një situatë të tillë, bëhet fjalë për një ngjarje të njëjtë dhe se këto ndryshime nuk kanë të bëjnë me elementet themelore të kësaj vepre penale. Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se pretendimet për tejkalim të akuzës edhe në këtë drejtim janë të pabazuara.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.255/2019, i datës 26.02.2020**

A r s y e t i m i

Sipas mbrojtësit, aktgjykimi i shkallës së parë është i përshirë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.10. të KPP-së, për shkak të tejkalimit objektiv të akuzës. I dënuari K.H. sipas pikës II të aktakuzës së konfirmuar është akuzuar se "me datë 20.08.2006, rreth orës 5:45 min., në fshatin B., Komuna e I. në udhëkryqin rrugor B.-I.-P., me dashje dhe për motive të ulta ka privuar nga jeta të ndjerin J.O....", duke u akuzuar për veprën penale vrasje e rëndë, nga neni 147, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. të KPK-së, ndërsa në dispozitivin e aktgjykimit përmbajtja e akuzës është tjetër nga siç parashihet në akuzë siç janë fjalët me dashje dhe për motive të ulta ka privuar nga jeta të ndjerin J., çka edhe veprën penale të vrasjes e kualifikojnë si vrasje e rëndë e të cilat fjalë fare nuk ekzistojnë, kjo me qëllimin e vetëm se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në asnjë rast nuk ka mundur ta provoj faktin se i pandehuri e ka privuar nga jeta me dashje e për qëllim të ultë, ngase siç del nga

provat e administruara në asnjë moment nuk mund të flitet për elementin e dashjes, e as që vepra penale është kryer për motiv të ultë e me ketë rast gjykata e ka tejkaluar akuzën duke e kualifikuar veprën penale me nën-paragrafin 1.4. të nenit 147 të KPK-së, e meqë i pandehuri është akuzuar për ketë vepër penale gjykata e shkallës së parë është dashtë që vetvetiu ta bëjë rikualifikimin e veprës penale në vrasje sipas nenit 146 lidhur me nenin 8 paragrafi 1. dhe paragrafi 4. të KPP-së të marr aktgjykim lirues.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit se aktgjykimi i shkallës së parë është i përshirë edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.10. të KPP-së për shkak të tejkalimit objektiv të akuzës janë jo vetëm të pabazuara, por edhe të paqarta. Sepse, tejkalimi i aktakuzës në kuptimin objektiv nënkupton tejkalimin e aktakuzës kur me aktgjykim përfshihet edhe ndonjë vepër tjetër penale e cila nuk ka qenë objekt i aktakuzës. Në rastin konkret, pavarësisht faktit se fillimisht me akuzë i dënuari është akuzuar se veprën penale të vrasjes së rëndë e ka kryer për motiv të ultë as gjykata e shkallës së parë dhe as ajo e shkallës së dytë nuk kanë gjetur se vepra penale e cila i është vënë në barrë të dënuarit të jetë kryer për motiv të ultë për çka edhe në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë nuk theksohet në fakt i tillë, prandaj edhe është e paqartë se në çka konsiston mbrojtësi në ketë drejtim, kur kihet parasysh fakti se ai nuk është shpall fajtor se veprën penale ta ketë kryer për motiv të ultë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.375/2019, i datës 12.02.2020**

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit B.B., e paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.356/2017, të datës 15.02.2019.

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.10. të KPP-së janë të pabazuara. Tejkalimi i aktakuzës në kuptimin objektiv nënkupton tejkalimin e aktakuzës kur me aktgjykim përfshihet edhe ndonjë vepër tjetër penale e cila nuk ka qenë objekt i aktakuzës, kurse tejkalimi i aktakuzës në kuptimin subjektiv nënkupton kur me aktgjykim është përfshirë edhe ndonjë person i cili nuk ka qenë i përfshirë me aktakuzë ose i cili fare nuk ka qenë i akuzuar. Në rastin konkret, i dënuari është akuzuar për një vepër penale dhe për të është gjykuar dhe shpall fajtor.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.87/2023, i datës 03.04.2023**

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit M.J., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.104/2021, të datës 26.10.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.692/2022, të datës 12.01.2023.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtojë të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse gjykata e shkallës së parë ka përshkruar një gjendje tjetër faktike nga ajo që përshkruhet në dispozitiv të aktakuzës dhe atë në aktakuzë thuhet: "...e therrë 8 herë me thikë...", ndërsa në aktgjykim thuhet e "...e therrë disa herë me thikë, fillimisht në qaftë...". Pra, gjykata e shkallës së parë ka tejkaluar akuzën me çka ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 10. të KPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes, gjen se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ashtu siç pretendohet. Të dy aktgjykimet janë të qarta dhe të kuptueshme dhe janë në harmoni me vetveten dhe arsyetimin ku janë dhënë arsye të mjaftueshme ligjore dhe konkludimet e qarta për të gjitha faktet relevante lidhur me fajësinë e të dënuarit. Sa i përket pretendimit se gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të dispozitivit ka bërë tejkalim të akuzës në kuptim të nenit 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 10. të KPP-së, kjo gjykatë gjen se në aktgjykimin e shkallës së parë është konstatuar në bazë të ekspertizës mjeko-ligjore nga eksperti mjeko-ligjor, Dr.V.H., se e dëmtuara ka pësuar lëndime duke, mos cekur numrin e lëndimeve, por duke i përshkruar si dëmtime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, si dhe duke mos përcaktuar radhën e shkaktimit të lëndimeve. Andaj, edhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë në përshkrim faktik të aktgjykimit ka konstatuar se i dënuari e therrë disa herë me thikë të dëmtuarën duke bazuar edhe në deklaratën e dëshmitarit G.P. i cili e kishte parë nga distanca 20-30 m tërë ngjarjen. Kjo gjykatë, po ashtu, vlerëson se nuk është me rëndësi sa herë është goditur e dëmtuara dhe radhitjen e shkaktimit të lëndimeve, sepse nga provat tjera është vërtetuar se i dënuari qëllimin e kishte që ta privojë nga jeta të dëmtuarën.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.19/2022, i datës 08.03.2022**

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Z.Gj., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.15/2019, të datës 11.02.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, APS.nr.22/2021, të datës 12.10.2021.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtojë të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit pretendohet se gjykata e shkallës së parë e ka tejkaluar akuzën kur të dënuarin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar për veprimet për të cilat nuk është i akuzuar, për shkak se gjykata e ka konsideruar "se i dënuari Z., tani të ndjerin B. e ka nxjerr me forcë nga shtëpia e tij", kurse në aktakuzën e prokurorisë thuhet se "Tani të ndjerin B., forcat serbe e kanë detyruar të largohet nga shtëpia". Pra, prokuroria nuk e ka akuzuar të dënuarin Z., për veprimet e dëbimit me dhunë nga shtëpia ndaj tani të ndjerit B.

Lidhur me pretendimin e mbrojtësit se gjykata e shkallës së parë e ka tejkaluar akuzën, kur ka konstatuar se i dënuari dhunshëm e ka nxjerrë nga shtëpia B.B., ndërsa ky veprim të dënuarit nuk i vihet në barrë në aktakuzë, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës është i pabazuar, për faktin se gjykata në aktgjykim e ka konstatuar një fakt të tillë në bazë të dëshmisë së të dëmtuarës V., B., e që kjo nuk konsiderohet tejkalim i aktakuzës për arsye se: nuk është ndryshuar kualifikimi juridik i veprës penale; nuk ndryshohet roli i tij në kryerjen e veprës penale, sipas aktakuzës dhe aktgjykimit, pasi që i akuzuari akuzohet si bashkëkryes me persona tjerë dhe ka mbetur i tillë edhe sipas aktgjykimit dhe se ndryshimi konsiston në kuadër të ngjarjes së njëjtë penale që ka ndodhur dhe në pajtueshmëri me rezultatin provues.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.56/2019, i datës 13.03.2019**

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit K.E. e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.169/2018, të datës 13.09.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.502/2018, të datës 06.11.2018.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtojë të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të dënuarit K.E., avokati H.R., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.10. të KPP-së, shkelje kjo e cila konsiston në faktin se me aktgjykim të shkallës së parë është tejkaluar aktakuza dhe se gjykata nuk ka gjykuar sipas përshkrimit faktik të dhënë në aktakuzë, por ka bërë përshkrimin faktik krejtësisht tjetër. Sipas mbrojtjes gjykata nuk ka mundur vet ta ndryshojë përshkrimin faktik të veprës penale dhe se me pikën I. të aktgjykimit të shkallës së parë përshkrimi i kryerjes së veprës penale në tërësi ndryshohet nga gjykata, duke konstatuar "...se i akuzuari K. së bashku me të akuzuarit tjerë, sipas marrëveshjes paraprake, në bashkëkryerje, duke i ndarë rolet secili veç e veç e kanë sulmuar të dëmtuarin, etj...", edhe pse në asnjë fazë të procedurës penale nuk është përmendur marrëveshja paraprake e as ndarja e roleve. Andaj, gjykata ka tejkaluar aktakuzën duke u munduar të përshkruaj veprimet e secilit të akuzuar edhe pse këto veprime janë në kundërshtim me aktakuzën dhe për to nuk është nxjerrë asnjë provë. Këto ndryshime thelbësore në mes të aktakuzës dhe përshkrimit faktik të aktgjykimit e bëjnë aktgjykimin juridikisht të paqëndrueshëm, pasi që aktakuzën e ndryshon prokurori e jo gjykata.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes konstatoi se qëndron fakti se aktakuza dhe përshkrimi faktik i aktgjykimit të shkallës së parë kanë ndryshime dhe se gjykata e shkallës së parë ka bërë këtë ndryshim. Por kjo gjykatë gjen se ky ndryshim i bërë nga gjykata e shkallës së parë është bërë pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike dhe se ky ndryshim është si rezultat i gjendjes së vërtetuar faktike në shqyrtim gjyqësor. Po ashtu, qëndron fakti se gjykata e shkallës së parë ka gjetur se të dënuarit kanë pasur marrëveshje paraprake dhe se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe se gjykata ka bërë ri cilësimin e veprës penale nga vepra vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147, paragrafi 1., nën-paragrafët 3. dhe 9. lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, në veprën penale për të cilën janë gjykuar, por kjo ka ndodh pasi që është përfunduar procedura penale dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në këtë procedurë. Kjo gjykatë ka konstatuar se nuk është bërë tejkalimi i aktakuzës nga ana e gjykatës së shkallës së parë, meqenëse në përshkrimin e ri faktik janë precizuar veprimet e të dënuarit K., sa i përket kontributit të tij në kryerjen e veprës penale dhe janë përfshirë detaje të cilat nuk i përmban akuza, por shërbejnë për të precizuar më afër kryerjen e veprës penale. Në rastin konkret nuk ka tejkalim të aktakuzës sepse aktgjykimi ka të bëjë me personin e njëjtë të akuzuar dhe nuk është përfshirë ndonjë vepër penale e cila nuk ka qenë objekt i akuzës, përkatësisht ngjarja tjetër dhe jo ngjarja e paraqitur me aktakuzë. Gjithashtu, edhe pse cilësimi juridik i veprës penale është ndryshuar, ky cilësim juridik është më i favorshëm për të dënuarin dhe ky ndryshim i cilësimit ka të bëjë me ngjarjen e njëjtë nga akuza.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.13/2016, i datës 10.02.2016**

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit Xh.K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.42/2014, të datës 12.02.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr.230/2015, të datës 07.09.2015.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtojë të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

I dënuari në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se gjykata e ka tejkaluar akuzën e cila shkelje konsiston në atë se Prokurori i Shtetit në shqyrtimin gjyqësor e ka modifikuar aktakuzën si vijon: "Fjalia në rreshtin e 5 të pikës 3 është ndryshuar duke e fshirë pjesën "punëtorët e UNMIK-ut" dhe pjesa tjetër e dispozitivit të pikës 3 mbetet e pandryshuar, pra nga kjo del që është ndryshuar pika 2 e jo 3 të dispozitivit.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se qëndron fakti se Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 28.01.2015, ka ndryshuar aktakuzën si në vijim: "Nga akuza 2 fjalia e rreshtit të 5 të akuzës së 3 duke fshirë fjalinë "punëtorët e UNMIK-ut", pjesa tjetër e dispozitivit të akuzës 3 (tash akuza 2) është e pandryshuar". Pra, këtu është bërë vetëm precizimi i dispozitivit. Mirëpo, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret fare nuk bëhet fjalë për tejkalimin e akuzës, për faktin se përfshirja e fjalës së cituar më lartë në dispozitivin e aktgjykimit e cila më parë është fshirë ka të bëjë vetëm me një gabim teknik e jo me shkeljet e pretenduara më lartë, për faktin se është ruajtur identiteti objektiv i akuzës.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.271/2021, i datës 15.09.2021**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të dënuarit M.G. dhe të mbrojtësit të dënuarit Sh.K., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.269/2019, i datës 18.12.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.95/2021, i datës 02.04.2021, ashtu që lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se janë të bazuara pretendimet për cenimin e identitetit objektiv në mes të aktakuzës dh aktgjykimit, sepse të dënuarit janë shpallur fajtor për veprime të cilat thelbësisht dallojnë nga ato për çka janë të akuzuar. Sa i përket të dënuarit M.G., ai është shpallur fajtor për veprimin konkret të privimit nga jeta e tani të ndjerit Rr.U. edhe pse për këtë është akuzuar i dënuari Sh.K., ndërsa i dënuari Sh.K. është akuzuar për privim nga jeta e tani të ndjerit Rr.U., kurse është shpallur fajtor për atë se e ka goditur dhe e ka kapur nga mbrapa tani të ndjerin Rr.U. të cilin (më vonë) e ka privuar nga jeta i dënuari M.G., duke kontribuar në këtë mënyrë kryerjes së veprës penale të vrasjes. Këto veprime nuk ceken në aktakuzë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.323/2022, i datës 15.09.2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ,të mbrojtësit të dënuarit A.G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.61/2019, i datës 24.12.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.166/2022, i datës 30.05.2022, ndërsa çështja i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtojë të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të dënuarit A.G., avokati R.H., pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.5. dhe 1.10. të KPP-së, të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjykim, respektivisht në dispozitiv të tij e tejkalon aktakuzën duke i shtuar të dënuarit edhe një vepër penale, ku theksohet se "i akuzuari A.G. ia mundësoi investitorit H.K. ta uzurpoj edhe ngastrën 2429-0, pasuri shoqërore - ujërat në rrjedhën e lumit "L..", duke uzurpuar një sipërfaqe prej 84 m²", edhe pse me aktakuzë kjo nuk ishte e paraparë e gjithashtu prokurori i shtetit në fjalën e fundit nuk kishte bërë precizimin e aktakuzës në këtë drejtim e as nuk ka bërë zgjerimin e aktakuzës sipas nenit 351 të KPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa, si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.5. dhe 1.10. të KPP-së, meqenëse ashtu siç me të drejtë potencohet në kërkesë të mbrojtësit, gjykata nuk ka mundur të bëjë tejkalimin e aktakuzës, duke e ngarkuar të dënuarin për veprime të cilat nuk janë paraparë me aktakuzë. Prokurori i Shtetit i cili ka përfaqësuar akuzën në shqyrtim gjyqësor, pas administrimit të provave dhe gjendjes së re faktike ka mundur që të bëjë precizimin e aktakuzës në fjalën e fundit apo edhe të bëjë zgjerimin e saj. Fakti që kjo nuk ka ndodhë, nuk i jep të drejtë gjykatës që pa autorizim të organit të akuzës të shpallë fajtor të dënuarin për diçka që nuk është akuzuar, ndërsa, gjykata e shkallës së dytë edhe pse sipas detyrës zyrtare kujdeset për shkelje të tilla, nuk i ka eliminuar të njëjtat. Këto shkelje i bëjnë të dy aktgjykimet juridikisht të paqëndrueshme dhe kushtëzojnë anulimin e tyre.

6.4. Komente përmbledhëse

Nga rastet e paraqitura më sipër, shihet që Gjykata Supreme e Kosovës i kishte sqaruar disa nga çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me tejkalimin e akuzës.

Në çështjen penale Pml.nr.412/2022, Gjykata Supreme e Kosovës, ndër të tjera, kishte konstatuar se gjykata e shkallës së parë, në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit, ku janë përshkruar veprimet inkriminuese, kishte paraqitur dhe përshkruar edhe disa detaje dhe disa veprime tjera, të cilat nuk janë përmendur në aktakuzën e paraqitur fillimisht dhe të ndryshuar gjatë fjalës përfundimtare. Mirëpo, në situatën e tillë nuk mund të bëhet fjalë për tejkalim të akuzës në kuptimin objektiv, për disa arsye. *Së pari,* në rastin konkret bëhet fjalë për ngjarjen e njëjtë, por që janë sqaruar dhe precizuar më tepër rrethanat e rastit konkret, duke u bërë më të qartë dhe më të plotë vetë përshkrimin e veprës penale. Dhe *së dyti,* këto detaje dhe veprime që janë shtuar nuk kanë bëjnë me elementet themelore të veprës penale. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Kosovës kishte theksuar se *"do të konsiderohej tejkalim i akuzës në kuptimin objektiv, në rastet kur gjykata e ndryshon përshkrimin faktik të ngjarjes, duke vendosur në të elemente të caktuara të cilat do të rezultonin me një kualifikim më të rëndë të veprës penale, në krahasim me veprën penale e cila është përfshirë në aktakuzë"*. Mirëpo, në çështjen në fjalë, nuk kishte ardhur në shprehje një segment i tillë, pasi që gjykata e shkallës së parë e kishte shpallur fajtor të dënuarin për kualifikimin juridik të njëjtë me atë që është i përfshirë në aktakuzën e ndryshuar gjatë fjalës përfundimtare. Nga përshkrimi faktik i veprimeve inkriminuese, ishte parë se gjykata e shkallës së parë kishte paraqitur disa detaje dhe veprime tjera, të cilat vetëm se e kanë precizuar dhe sqaruar më afër veprën penale përkatëse, si dhe kishte bërë një përshkrim më të plotë dhe më të saktë të veprës penale, ndërsa në një situatë të tillë, bëhet fjalë për një ngjarje të njëjtë dhe se këto ndryshime nuk kanë të bëjnë me elementet themelore të kësaj vepre penale.

Edhe në çështjen penale Pml.nr.56/2019, Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar se nuk ka tejkalim të aktakuzës, sepse aktgjykimi ka të bëjë me personin e njëjtë të akuzuar dhe nuk ishte përfshirë ndonjë vepër penale e cila nuk ka qenë objekt i akuzës, përkatësisht ngjarja tjetër dhe jo ngjarja e paraqitur me aktakuzë. Gjithashtu, në këtë çështje penale ishte konstatuar se edhe pse cilësimi juridik i veprës penale është ndryshuar, ky cilësim juridik është më i favorshëm për të dënuarin dhe ky ndryshim i cilësimit ka të bëjë me ngjarjen e njëjtë nga akuza, e që rrjedhimisht nuk bëhet fjalë as për tejkalim të akuzës.

Ndërsa, në çështjen penale Pml.nr.271/2021, Gjykata Supreme e Kosovës, me aprovimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë, kishte anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, duke e kthyer lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, sepse të dënuarit ishin shpallur fajtor për veprime të cilat thelbësisht dallojnë nga ato për çka ishin akuzuar. Kështu, i dënuari i parë ishte shpallur fajtor për veprimin konkret të privimit nga jeta të të ndjerit Rr.U. edhe pse për këtë ishte akuzuar i dënuari i dytë, ndërsa i dënuari i dytë, ishte akuzuar për privimin nga jeta të të ndjerit Rr.U., kurse ishte shpallur fajtor për atë se e ka goditur dhe e ka kapur nga mbrapa të ndjerin Rr.U. të cilin (më vonë) e ka privuar nga jeta i dënuari i parë, duke i kontribuar në këtë mënyrë kryerjes së veprës penale të vrasjes, edhe pse këto veprime nuk ishin cekur në aktakuzë.

Në anën tjetër, siç është theksuar edhe më parë, bazuar në nenin 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.6. të KPP-së, kjo shkelje ligjore, përbëhet nga këto elemente:

1) Është shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit e Kosovës vetëm sipas propozimit të palëve;

2) Nëse aktgjykimi ka tejkaluar fushëveprimin e fakteve nga aktakuza konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, vetëm nëse një shkelje e tillë ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshshëm dhe të drejtë dhe

3) Që aktgjykimi të tejkalon fushëveprimin e fakteve nga aktakuza.

Në fund, është e rëndësishme që të sqarohet se nuk do të duhej të konsiderohet tejkalim i fushëveprimit të fakteve nga aktakuza, nëse gjykata në përshkrimin e veprës penale ka përfshirë detaje të cilat nuk i përmban aktakuza dhe shërbejnë për të precizuar dhe sqaruar më afër veprën penale dhe përshkrimin faktik të saj.

7. Mbajtja e shqyrtimit gjyqësor pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj

7.1 Dispozitat ligjore

Neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

"Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale që njihet sipas detyrës zyrtare apo propozimit të palëve konsiderohet nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj".

7.2 Komentim i shkurtër i dispozitës ligjore të lartcekur

Kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale vjen në shprehje në rastet kur shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj. Pra, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale ekziston në rastet kur në shqyrtim gjyqësor nuk marrin pjesë personat e caktuar, të cilët janë të detyruar që të marrin pjesë sipas ligjit.

Me ligj në kuptim të shkeljes së lartcekur do të duhej kuptuar ato dispozita ligjore që parashohin detyrimin e personave të caktuar për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor.

Natyrisht, se në rend të parë, bëjnë pjesë dispozitat ligjore të KPP-së, mandej, dispozitat ligjore të KDM-së, të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale,[44] etj.

Rrjedhimisht, si parakusht ose supozim për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor paraqitet edhe prania e subjekteve themelore të procedurës penale.[45]

Në nenin 282, paragrafi 1. të KPP-së është parashikuar se *"Në shqyrtim gjyqësor thirret i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari ose viktima dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës, si dhe përkthyesi. Dëshmitarët dhe ekspertët e propozuar nga prokurori i shtetit në aktakuzë dhe nga i akuzuari sipas nenit 250 të këtij Kodi thirren po ashtu në shqyrtimin gjyqësor".*

Kurse, në paragrafin 6. të nenit të lartcekur, është parashikuar se *"Me kërkesë të Avokatit të Popullit, Avokati i Popullit gjithashtu njoftohet për shqyrtimin gjyqësor me qëllim të monitorimit të procedurës penale në kufijtë e autorizimeve të tij".*

---

[44] Ligji nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale i datës 31.08.2011.
[45] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq. 371.

Mirëpo, pavarësisht faktit se gjykata është e detyruar që t'i ftojë personat e theksuar më lart, në situata të caktuara të parashikuara në mënyrë shprehimore me dispozita ligjore, shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet edhe pa prezencën e disa prej këtyre prej personave.

Megjithatë, prania e prokurorit të shtetit në shqyrtim gjyqësor është e detyrueshme dhe është parakusht për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor në çdo rast. Në rast të mos ardhjes së prokurorit të shtetit, atëherë detyrimisht duhet që të shtyhet shqyrtimi gjyqësor dhe duhet që të njoftohet kryeprokurori i prokurorisë përkatëse.

Në këtë drejtim, në nenin 301 të KPP-së është parashikuar se *"Kur prokurori i shtetit nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor të caktuar në bazë të aktakuzës së prokurorit të shtetit, shqyrtimi gjyqësor shtyhet dhe për këtë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e njofton kryeprokurorin e prokurorit të shtetit"*.

Përndryshe, mbajtja e shqyrtimit gjyqësor pa prezencën e prokurorit të shtetit përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. të KPP-së.

Jo vetëm që përbën shkelje eseciale të dispozitave të procedurës penale, por mbajtja e shqyrtimit gjyqësor pa pjesëmarrjën e prokurorit të shtetit, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së konsiderohet edhe shkelje e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, nga neni 6 § 1 të KEDNJ-së.[46]

Duke u mbështetur në rëndësinë që ka pjesëmarrja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor, ligjdhënësi kur është në pyetje mungesa e tij ka parashikuar disa zgjidhje ligjore.

Në parim, prania e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor është e detyrueshme, përveç rasteve kur ndaj tij zbatohen dispozitat ligjore të gjykimit në mungesë.

Pa paragjykuar nenin 303 të KPP-së ("Gjykimi në mungesë"), kur i akuzuari i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për të akuzuarin lëshon urdhër arrest në pajtim me nenin 173 të KPP-së. Kur i akuzuari nuk mund të sillet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e shtyn

[46] Rasti *"Krivoshapkin kundër Rusisë"*, aktgjykimi i datës 27.04.2011, paragrafët 44-46; Rasti *"Ozerov kundër Rusisë"*, aktgjykimi i datës 18.08.2010, paragrafët 55-58, etj.

shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të sillet me forcë ose në të kundërtën nxjerr aktvendim për pezullimin e procedurës penale, derisa i akuzuari të sjellët në gjykatë. Kur i akuzuari e arsyeton mungesën para arrestimit të tij, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e revokon urdhër arrestin. Shqyrtimi gjyqësor rifillon kur arrestohet i pandehuri.[47]

Përveç kësaj, në paragrafin 2. të nenit 302 të KPP-së është parashikuar edhe mundësia e caktimit të paraburgimit ndaj të akuzuarit, i cili është ftuar në mënyrë të rregullt dhe qartazi i shmanget paraqitjes në shqyrtimin gjyqësor. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, në rastet kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 184 i KPP-së, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit, ndërsa për paraburgimin i cili është caktuar për këto shkaqe, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e neneve 185 deri 203 të KPP-së. Po qe se paraburgimi i tillë nuk hiqet më parë, ai zgjat derisa të shpallet aktgjykimi, por jo më shumë se 1 (një) muaj.[48]

Në parim, siç është theksuar edhe më lart, nuk do të mund të zbatohet procedura penale në përgjithësi dhe nuk do të mund që të mbahet shqyrtimi gjyqësor, në veçanti, në rastet kur në të nuk merr pjesë i akuzuari. Mirëpo, ngjashëm sikur në legjislacionet e disa vendeve të tjera,[49] edhe në Republikën e Kosovës është parashikuar mundësia, që nën kushte të caktuara të mbahet gjykimi në mungesë, përkatësisht që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në mungesë të të akuzuarit.

Kështu, në nenin 303 të KPP-së është parashikuar mundësia e mbajtjes së gjykimit në mungesë, ku janë përcaktuar kushtet dhe procedura që duhet respektuar.

Gjykimi në mungesë është trajtuar edhe nga GJEDNJ -ja, e cila në disa raste nga praktika gjyqësore ka sqaruar se mungesa e të akuzuarit në një proces gjyqësor nuk është në vetëvete e papajtueshme me nenin 6 të KEDNJ-së, kuptohet nëse përmbushen edhe disa kushte tjera.

---

[47] Neni 302, paragrafi 1. i KPP-së.
[48] SHALA, AFRIM : Shqyrtimi gjyqësor, Moduli Trajnues, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2023, fq. 302.
[49] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (neni 352); Ligji i Procedurës Penale të Republikës së Kroacisë (neni 322); Kodi i Procedurës Penale të Malit të Zi (neni 324), etj.

Kështu, GJEDNJ-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore thekson se është e vështirë të përfytyrohet se si do të mund t'i ushtronte një i akuzuar të drejtat që i garantohen atij shprehimisht nga neni 6 § 3 c), d) dhe e) i KEDNJ-së konkretisht të drejtën që *"të mbrohet vetë"*, *"të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët"* dhe *"të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq"*, po qe se ai nuk është i pranishëm në procesin e tij. Detyrimi për t'i garantuar të akuzuarit të drejtën për të qenë i pranishëm në sallën e gjyqit është prej elementeve thelbësore të nenit 6 të KEDNJ-së.[50] Ndonëse një procedurë që zhvillohet në mungesë të të pandehurit nuk është në vetvete e papajtueshme me nenin 6 të KEDNJ-së, përbën sidoqoftë mohim të drejtësisë, nëse i pandehuri i dënuar në mungesë (*"in absentia"*) nuk mund të fitojë më pas të drejtën që një juridiksion të vendosë sërish, pasi ta ketë dëgjuar atë, rreth bazueshmërisë faktike dhe juridike të akuzës, ndërkohë që nuk është vërtetuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjyq e për t'u mbrojtur, apo që ai ka pasur qëllimin për t'iu shmangur drejtësisë.[51]

Duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që një gjykim në mungesë të konsiderohet i rregullt dhe legjitim, duhet të plotësohen garancitë procedurale të mëposhtme:

1. Duhet që i akuzuari të jetë informuar për procedurën dhe për të duhet të vërtetohet se i akuzuari ka pasur njohuri reale;
2. Duhet vërtetuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjyq e për t'u mbrojtur;
3. Të akuzuarit duhet t'i jepet e drejta për t'u paraqitur në gjykatë në çdo moment dhe të kërkojë rigjykim;
4. I akuzuari duhet të përfaqësohet nga një mbrojtës i kualifikuar;
5. Duhet të tregohet qartë se i akuzuari është në arrati dhe jo thjeshtë se ai nuk mund të lokalizohet, etj.

Në anën tjetër, nëse në shqyrtim gjyqësor nuk paraqitet mbrojtësi i thirrur me rregull dhe për arsyet e mosardhjes nuk e njofton gjykatën posa të ketë mësuar për ato, ose nëse mbrojtësi lëshon

[50] Rasti *"Hermi kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 18.10.2006, paragrafët 58-59; Rasti *"Sejdovic kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 01.03.2006, paragrafi 81; Rasti *"Colozza kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 12.02.1985, paragrafi 27, etj.

[51] Rasti *"Sejdovic kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 01.03.2006, paragrafi 82; Rasti *"Colozza kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 12.02.1985, paragrafi 29; Rasti *"Krombach kundër Francës"*, aktgjykimi i datës 13.02.2001, paragrafi 85; Rasti *"Somogyi kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 10.11.2004, paragrafi 66. etj.

shqyrtimin gjyqësor pa lejen e gjyqtarit të vetëm gjykues apo të trupit gjykues, gjykata kërkon menjëherë nga i akuzuari që të angazhojë mbrojtës tjetër. Nëse i akuzuari nuk e bën këtë, kurse caktimi i mbrojtësit nuk mund të bëhet pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor shtyhet.[52]

Në rastet tjera, me dispozitat përkatëse ligjore është parashikuar edhe mbrojtja e detyruar, kështu që në këto raste, në shqyrtim gjyqësor duhet që të marrë pjesë edhe mbrojtësi i të akuzuarit.[53]

Edhe pse në nenin 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, nuk është theksuar në mënyrë shprehimore, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale vjen në shprehje edhe në rastet kur shqyrtimi fillestar është mbajtur pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj. Kjo për faktin se dispozitat ligjore të i referohen shqyrtimit gjyqësor në situata të caktuara aplikohen përshtatshmërisht edhe në shqyrtim fillestar, nëse me dispozitat ligjore që i referohen shqyrtimin fillestar nuk është parashikuar ndryshe.[54]

Në nenin 236, paragrafi 6. të KPP-së, është parashikuar se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton prokurorin e shtetit, të pandehurit, mbrojtësit e tyre, palën e dëmtuar ose viktimën dhe mbrojtësin e viktimave ose përfaqësuesin e viktimës për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

Siç shihet, tani me dispozitat ligjore të KPP-së për dallim nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale është parashikuar në mënyrë shprehimore që për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar duhet të njoftohet edhe pala e dëmtuar ose viktima dhe mbrojtësi i viktmave ose përfaqësuesi i viktimës.

Kurse, në nenin 240, paragrafi 1. të KPP-së, është parashikuar se gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit.

---

[52] Neni 304, paragrafi 1. i KPP-së.

[53] Neni 56, paragrafi 1. i KPP-së. Sipas kësaj dispozite ligjore, i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste: 1.1. nga marrja në pyetje për herë të parë e deri në përfundim të procedurës penale me vendim të formës së prerë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses; 1.2. nga arrestimi, gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim; 1.3. nga momenti i marrjes në pyetje për herën e parë për vepër penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim; 1.4. në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm; 1.5. në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë; ose 1.6. në të gjitha rastet kur i akuzuari gjykohet në mungesë sipas nenit 303 të këtij Kodi.

[54] SHALA, AFRIM : Doracaku i gjyqtarëve për procedurën penale, fq. 97-98.

Megjithatë, sipas nenit 240, paragrafi 2. të KPP-së, pala e dëmtuar ose viktima dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës njoftohen për seancën e shqyrtimit fillestar dhe ata kanë të drejtë të jenë të pranishëm, por mungesa e tyre nuk është pengesë për mbajtjen e seancës.

Gjithashtu, në shqyrtim gjyqësor duhet që të marrin pjesë edhe dëshmitarët dhe ekspertët, megjithëse në KPP është parashikuar mundësia që në situata të caktuara, të mbahet shqyrtimi gjyqësor edhe pa prezencën e dëshmitarëve dhe të ekspertëve, duke lexuar deklarimet e tyre të mëparshme.[55]

Në procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, përveç personave të cilët duhet të thirren, në shqyrtimin gjyqësor duhet të thirren edhe eksperti ose psikiatri nga institucioni i kujdesit shëndetësor të cilit i është besuar kryerja e ekzaminimit psikiatrik mbi aftësinë mendore të të akuzuarit. Bashkëshorti/ja e të pandehurit dhe prindërit e tij ose prindërit adoptues, gjithashtu njoftohen për shqyrtimin gjyqësor.[56]

Eksperti duhet të jetë i pranishëm edhe në procedurën penale ndaj personave të cilët kanë kryer vepër penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës.[57]

Është e rëndësishme që të theksohet se sipas dispozitat ligjore të KDM-së, i mituri, mbrojtësi dhe prokurori i shtetit për të mitur duhet të jenë të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor. Përveç personave të paraparë me dispozitat ligjore të KPP-së, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, përfaqësuesi i organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesi i shërbimit sprovues thirren në shqyrtimin gjyqësor. Mosparaqitja e personave të tillë nuk e pengon gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor.[58]

Edhe në procedrën penale që zhvillohet ndaj madhorve për vepra penale të kryer ndaj fëmijëve sipas nenit 108 të KDM-së duhet që për shqyrtim gjyqësor të ftohen dhe të marrin pjesë edhe disa persona tjerë.

---

[55] Neni 335 i KPP-së.
[56] Neni 513, paragrafi 2. i KPP-së.
[57] Në nenin 503, paragrafi 3. të KPP-së është parashikuar se gjykata vendos për zbatimin e masës së trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin e kryesve të varur nga alkooli ose nga droga pas dëgjimit të mendimit të ekspertit dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtjes. Mendimi i ekspertit duhet t'i analizojë mundësitë për trajtimin e të pandehurit.
[58] Neni 65, paragrafët 1. dhe 2. të KDM-së

Kështu, në nenin 112, paragrafi 4. të KDM-së është parashikuar se nëse fëmija ndaj të cilit është kryer vepra penale sipas nenit 108 të KDM-së merret në pyetje si viktimë apo dëshmitar, marrja e tillë në pyetje zbatohet më së shumti dy (2) herë. Marrja në pyetje për herë të dytë bëhet me ndihmën e psikologut dhe udhëheqet nga ana e gjyqtarit kompetent. Në pamundësi të sigurimit të psikologut, marrja në pyetje zbatohet nga ana e gjyqtarit kompetent, pa prezencën e tij. Pra, në raste të tilla paraqitet nevoja që për shqyrtim gjyqësor të ftohet edhe një psikolog, me ndihmën e të cilit do të bëhet marrja në pyetje të fëmiut që shtë viktimë e veprave penale nga neni 108 i KDM-së.

Kurse, në paragrafin 6. të nenit të lartcekur është parashikuar se *"Fëmiu si viktimë e veprës penale duhet të ketë përfaqësues të autorizuar në të gjitha fazat e procedurës penale"*.

Në anën tjetër, përveç personave të theksuar më lart, në shqyrtimin gjyqësor për shkak të peshës së madhe që ka duhet të jenë vazhdimisht të pranishëm gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues, procesmbajtësi dhe gjyqtari zëvendësues.[59] Për prezencën e tyre dhe për nevojën që trupi gjykues të jetë i përbërë në përputhje me ligjin, duhet që të kujdeset gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues.

Mirëpo, duhet qartësuar se në rastet kur në shqyrtim gjyqësor nuk ka qenë i pranishëm gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues apo gjyqtari zëvendësues, atëherë kjo përbën shkelje tjetër esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së.

7.3 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj

Çështja e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, pa personat, prania e të cilëve kërkohet me ligj, ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore.

Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste që kanë të bëjnë me këtë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale:

[59] Paragrafët 1. të neneve 292 dhe 293 të KPP-së.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.350/2020, i datës 24.12.2020**

A K T GJ Y K I M

*M*e miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit B.V. e sipas detyrës zyrtare edhe për të dënuarit A.P. dhe F.P., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, P.nr. 87/2016, i datës 07.02.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.674/2020, i datës 05.11.2020 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, vlerësoi se lënda duhet anuluar dhe kthyer në rigjykim, për shkak se aktgjykimet e kundërshtuar janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, përkatësisht nga neni 57, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. dhe paragrafi 2. të KPP-së. Dispozita e nenit 57, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, parasheh se i pandehuri duhet të ketë mbrojtës për rastin e mbrojtjes së detyruar nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për një vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë (10) burgim, ndërsa dispozita e nenit 57, paragrafi 2. të KPP-së, parasheh se në qoftë se i pandehuri, në rastin e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush nga personat në nenin 53, paragrafi 8. të KPP-së, gjykata ose një organ tjetër kompetent i cakton një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike. Gjykata gjen se edhe pse tani i dënuari, sipas shkresave të lëndës në fazën e hetimeve në Kaçanik-në Polici më datën 04.06.2014 është dorëhequr me shkrim nga e drejta e mbrojtësit, pra përkundër faktit se (në një fazë të mëhershme) i dënuari nuk ka dashur të angazhoj mbrojtës, në rastin konkret gjykatat është dashur që të caktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së cituar më lartë lidhur me rastet e mbrojtjes së detyrueshme, të cilat parashohin detyrimin për gjykatën ose për organin që e zbaton procedurën në fazën paraprake, që të caktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

Konform nenit 436, paragrafi 2. lidhur me nenin 397 të KPP-së (“Beneficium cohaesionis”), Gjykata Supreme e Kosovës vendosi edhe për të dënuarit A.D. dhe F.P., edhe pse ata nuk kanë ushtruar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, mirëpo nga shkresat e lëndës del se as ata nuk kanë pasur mbrojtës gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanojë shkeljen e theksuar më lart dhe të caktojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare, nëse të dënuarit nuk kanë mundësi për të angazhuar një të tillë dhe të nxjerrë një vendim të ligjshëm.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.164/2021, i datës 16.06.2021**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të miturit E.E., anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PM.nr.45/2018, i datës 01.02.2021 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAM.nr.15/2021, i datës 12.04.2021, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se pretendimi nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës dhe aktvendimet e kundërshtuara rezulton se nuk ka qenë kontestues se në vendin dhe kohen e cekur janë ndërmarr veprime inkriminuese, sepse për këtë tregojnë të gjitha provat materiale dhe ato formale-deklarata e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve të dëgjuar.

Megjithatë, sa i përket asaj se kush është kryes i veprës penale, nga këto shkresa rrjedh se i mituri gjatë tërë procedurës ka mohuar të ketë qenë kryes i saj, me përjashtim të deklaratës së dhënë në stacion policor 09.08.2018, në të cilinë ka pranuar kryerjen e veprës penale dhe në kërkesën e

policisë ka shkuar në vendin e ngjarjes, duke treguar vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Nga ky procesverbal rezulton se i mituri nuk ka pasur mbrojtës.

Konform dispozitës së nenit 43, paragrafi 1. të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, i mituri duhet të ketë mbrojtës që nga fillimi e deri në përfundim të procedurës, ndërsa konform paragrafi 2. të këtij neni, në rastet kur i mituri, përfaqësuesi ligjor ose anëtari i familjes së tij nuk angazhojnë mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetent që zbaton procedurën, emëron një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.

Në rastin konkret, i mituri e as personi tjetër nuk ka angazhuar mbrojtësin e as organi i cili ka zhvilluar procedurën ka angazhuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare. Në këtë mënyrë të miturit i është shkelur e drejta në mbrojtës dhe kjo ka ndikuar në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë, sepse kjo ka qenë deklaratë e vetme për identitetin e kryesit.

Duhet të ceket se arsyet e dhëna në aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë se "i mituri është marrë në pyetje pa prezencën e mbrojtësit, por në prezencën e nënës së tij, mirëpo, një deklaratë e tillë e të miturit nuk është marrë për bazë me rastin e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë, pasi që me prova tjera është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i mituri e ka kryer veprën penale barë" janë të paqarta dhe në kundërshtim me përmbajtjen e aktvendimit të shkallës së parë nga i cili rezulton se i njëjti është bazuar ekskluzivisht në këtë deklaratë.

Për shkak se që ë dy aktvendimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga dispozitat e cekura më lart, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, si e tillë u aprovua dhe u vendos që aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, në të cilën shkelje duhet të mënjanohet dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave që do të administrohen, të merret vendim i ligjshëm.

7.4. Komente përmbledhëse

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe duke ju referuar dispozitave ligjore të trajtuara më lart, mund të nxjerrën këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1. Konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. i KPP-së, në rastet kur shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj.
2. Kjo shkelje bënë pjesë në kuadër të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat gjykata kujdeset sipas propozimit të palëve, por edhe sipas detyrës zytare.[60]
3. Për shkak të natyrës së saj, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, ndikon edhe në anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e rastit në rigjykim. Në te dy rastet e theksuara më lart, shihet se procedura penale ishte zhvilluar pa pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës, edhe pse me dispozitat përkatëse ligjore ishte parashikuar një gjë e tillë. Mospjesëmarrja e avokatit mbrojtës në shqyrtim gjyqësor, në rastin Pml.nr.350/2020, kishte qenë arsye për kthimin e rastit në rigjykim. Tani, duke e pasur parasysh se ka hyrë në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale, është e rëndësishme që të sqarohet se për dallim nga legjislacioni i mëparshëm, i pandehuri duhet të ketë mbrojtës *"nga momenti i marrjes në pyetje për herën e parë për vepër penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim"*.[61] Bazuar në këtë dispozitë ligjore, mbizotëron mendimi se vepër e tillë penale për të cilën i pandehuri duhet të ketë mbrojtës nga momenti i marrjes në pyetje për herën e parë është p.sh. vepra penale *"Detyrimi"*, nga neni 328, paragrafi 1. i KPRK-së, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Është e nevojshme që të theksohet edhe fakti se për shkak të peshës dhe rëndësisë së kësaj shkelje, në rastin Pml.nr.350/2020, duke e aplikuar institutin juridik *"Beneficium Cohaesionis"*, Gjykata Supreme e Kosovës, sipas detyrës zyrtare, kishte vendosur edhe për dy (2) të dënuarit tjerë, edhe pse ata nuk kanë ushtruar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, duke i anuluar aktgjykimet në tërësi, pasi që nga shkresat e lëndës kishte rezultuar as ata nuk kanë pasur mbrojtës gjatë shqyrtimit gjyqësor.

[60] Neni 394, paragrafi 1. i KPP-së.

[61] Neni 56, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. të KPP-së. Në nenin 57, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, ka qenë e parashikuar se i pandehuri është dashur që të ketë mbrojtës *"nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë (10) vjet burgim"*.

8. Nëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë e duhur ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi

8.1. Dispozitat ligjore

Neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

"Përbërja e gjykatës nuk ka qenë e duhur ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi".

8.2. Komentim i shkurtër i dispozitës ligjore të lartcekur

Kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale paraqitet në këto tre (3) forma:

1. Nëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë e duhur;[62]
2. Nëse në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor ose
3. Nëse në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi.

Është parim themelor i shtetit të së drejtës që çështjet penale të shqyrtohen dhe gjykohen nga një gjykatë e themeluar sipas ligjit.

Një parim i tillë i shtetit të së drejtës derivon edhe nga dispozita e nenit 6, paragrafit 1. të KEDNJ-së, sipas së cilës *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj"*.

Për rëndësinë që ka ky parim, tregon edhe fakti se vetëm gjykata e themeluar me ligj mund të shqiptoj sanksionin penal dhe masat tjera të trajtimit të detyrueshëm. Kështu, në nenin 2 të KPP-

[62] Në nenin 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale kjo formë e kësaj shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ka pasur këtë formulim *"përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin"*.

së është parashikuar se *"Vetëm gjykata kompetente, e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj mund t'i shqiptojë dënim ose sanksion tjetër penal kryesit të veprës penale në procedurë të filluar dhe të zbatuar sipas këtij Kodi"*. Forma e parë e kësaj shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale vjen në shprehje në situatat kur përbërja e gjykatës e cila e ka shqyrtuar dhe gjykuar çështjen penale nuk ka qenë e duhur ose e rregullt, përkatësisht kur përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin.[63]

Kjo formë e parë e kësaj shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale ndërlidhet në një mënyrë edhe me kompetencën e gjykatës,[64] por jo vetëm.

Kompetencat e gjykatës në çështjet penale janë të rregulluara në radhë të parë me dispozitat ligjore të KPP-së, KDM-së, Ligjit për Gjykatat,[65] etj.

Në lidhje me këtë çështje, GJEDNJ-ja thekson se *"Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion për të gjykuar një të pandehur në përputhje me dispozitat e zbatueshme sipas ligjit të brendshëm, atëherë ajo nuk është "e krijuar me ligj" në kuptim të nenit 6, paragrafi 1. të KEDNJ-së".*[66]

Me dispozitat ligjore të lartcekura janë rregulluar dhe parashikuar kompetencat e secilit departament (Departamenti për Krime të Rënda,[67] Departamenti Special,[68] Departamenti për të

---

[63] Sipas GjEDNj-së, shprehja e *"krijuar me ligj"* përfshin jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e një gjykate, por edhe pajtueshmërinë nga gjykata, me rregullat e veçanta që e rregullojnë atë dhe përbërjen e trupit gjykues çdo rast. Në lidhje me këtë çështje, shih rastin *"Posokhov kundër Rusisë"*, aktgjykimi i datës 04.06.2003, paragrafi 39.

[64] Në rastin *"Richert kundër Polonisë"*, aktgjykimi i datës 25.01.2012, paragrafi 41., GjEDNj-ja thekson se: *"Ligji në kuptim të nenit 6, paragrafi 1. të KEDNj-së, përfshinë veçanarisht legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore".* Gjithashtu, shih edhe rastin *"Lavents kundër Letonisë",* aktgjykimi i datës 28.12.2022, paragrafi 114.

[65] Ligji nr.06/L-054 për Gjykatat, i datës 23.11.2018.

[66] Rasti *"Richert kundër Polonisë"*, aktgjykimi i datës 25.01.2012, paragrafi 41.; Rasti *"Lavents kundër Letonisë",* aktgjykimi i datës 28.12.2022, paragrafi 114.; Rasti *"Coëme dhe të tjerët kundër Belgjikës"*, aktgjykimi i datës 18.10.2000, paragrafi 99.; Rasti *"Jorgic kundër Gjermanisë"*, aktgjykimi i datës 12.10.2007, paragrafi 64., etj.

[67] Në nenin 21, paragrafi 4. të KPP-së është parashikuar se *"Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore zhvillon dhe çështjen e gjykon në çfarëdo procedure penale ku prokurori i shtetit pretendon apo ka ngritur akuzë për një ose më shumë vepra të mundshme penale për të cilat është paraparë dënim me burgim mbi dhjetë (10) vjet, si dhe veprat penale që konsiderohen krime të rënda sipas nenit 22 të këtij Kodi"*.

[68] Në nenin 21, paragrafi 5. të KPP-së është parashikuar se *"Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë zhvillon dhe çështjen e gjykon në të gjitha procedurat penale për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Gjykatat"*.

Mitur[69] dhe Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal[70]) që gjykon çështje penale, si dhe në çfarë përbërje vendos (gjyqtar individual, trup gjykues apo kolegj).

Në këtë drejtim, janë përcaktuar kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetë gjykues, kryetarit të trupit gjykues, trupit gjykues, kolegjit shqyrtues, kryetarit të gjykatës, etj.

Në nenin 23, paragrafët 2-4. të KPP-së është parashikuar se *"Gjyqtari i procedurës paraprake mbikëqyrë procedurën penale gjatë fazës së hetimit. Me paraqitjen e aktakuzës, gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka më kompetencë mbi të pandehurit e përmendur në aktakuzë. Gjyqtari i procedurës paraprake është kompetent për të pranuar kërkesat nga prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimave dhe i dëmtuari ose viktima dhe të nxjerr vendime dhe urdhra bazuar mbi këto kërkesa, në pajtim me këtë Kod. Gjyqtari i procedurës paraprake është kompetent për të përcaktuar në mënyrë të pavarur nëse shqiptimi apo vazhdimi i privimit të lirisë së të pandehurit është proceduralisht apo kushtetutshmërisht i lejuar. Gjyqtari i procedurës paraprake ka për detyrë që të urdhërojë lirimin e të pandehurit, heqja e lirisë të së cilit nuk është proceduralisht apo kushtetutshmërisht e lejuar".*

Pas ngritjes së aktakuzës nga prokurori i shtetit në gjykatën themelore, por para shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues janë kompetentë për të marrë merr vendime në përputhje me dispozitat përkatëse të KPP-së.[71]

Kryetari i trupit gjykues është gjyqtari në Departamentin për Krime të Rënda dhe në Departamentin Special të gjykatës themelore, i cili pranon aktakuzën, merr vendim për të gjitha propozimet paraprake dhe të provave në shqyrtimin fillestar[72] dhe kryeson trupin gjykues që gjykon në

[69] Në nenin 21, paragrafi 2. të KPP-së është parashikuar se *"Kur një fëmijë është i pandehur në një rast penal, ai rast do të ndahet nga çdo rast tjetër dhe do të shqyrtohet vetëm nga Departamenti për të Mitur në kuadër të Gjykatës Themelore, sipas Kodit përkatës të Drejtësisë për të Mitur në fuqi apo ligjit pasues"*.

[70] Në nenin 21, paragrafi 3. të KPP-së është parashikuar se *"Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore zhvillon dhe çështjen e gjykon në të gjitha procedurat penale që nuk janë brenda juridiksionit të Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit për të Miturit ose ndonjë Divizionit apo Departamentit të themeluar sipas Ligjit përkatës për Gjykatat që ka juridiksion mbi veprat penale"*.

[71] Neni 26, paragrafi 1. të KPP-së.

[72] Pas hyrjes në fuqi të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, më datën 01.01.2013, ka pasur dilema dhe qëndrime të ndryshme në praktikën tonë gjyqësore sa i përket rasteve kur kryetari i trupit gjykues pranë Departamentit për Krime të Rënda të gjykatës themelore e pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vendos që të shqiptojë dënimin, atëherë a duhet që dënimin ta shqiptojë vetëm kryetari i trupit gjykues apo dënimin duhet ta shqiptojë trupi gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë profesional, njëri nga të cilët e kryeson trupin gjykues. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, përmes mendimit juridik GJA.nr.207/13, të datës 19.03.2013, ka sqaruar se *"nëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar para gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues*

shqyrtimin gjyqësor, ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues është gjyqtari në departamentin e përgjithshëm të gjykatës themelore i cili pranon aktakuzën, merr vendim për të gjitha propozimet paraprake dhe të provave në shqyrtimin fillestar dhe gjykon në shqyrtim gjyqësor.[73]

Në rastet penale kundër personave madhor për veprat penale, të cilat viktima paraqitet fëmijë, sipas nenit 108 të KDM-së, atëherë është gjyqtari për të mitur ose kryetari i trupit gjykues për të mitur i cili pranon aktakuzën, merr vendim për të gjitha propozimet paraprake dhe të provave në shqyrtimin fillestar. Nëse këto raste gjykohen në trup gjykues për të mitur, atëherë kryetari i trupit gjykues për të mitur e kryeson këtë trup gjykues që gjykon në shqyrtim gjyqësor.

Në procedurën penale në kuadër të departamentit të përgjithshëm të gjykatës themelore, rastet në shqyrtim gjyqësor gjykohen nga gjyqtari i cili shërben si gjyqtar i vetëm gjykues, kurse në procedurën penale në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda dhe Departamentit Special të gjykatës themelore, rastet në shqyrtim gjyqësor gjykohen nga trupi gjykues i përbërë nga tre (3) gjyqtarë, të caktuar në atë departament, njëri nga të cilët është kryetar i trupit gjykues.[74]

Kolegji shqyrtues përbëhet prej tre (3) gjyqtarëve dhe formohet nga departamenti i njëjtë ose nga gjykata themelore për të shqyrtuar dhe vendosur mbi një kundërshtim ose ankesë kundër urdhrit ose aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, kurse trupi gjykues përbëhet prej kryetarit të trupit gjykues dhe dy (2) gjyqtarëve profesional të cilët shqyrtojnë provat dhe gjykojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor.[75]

Në procedurën ndaj të miturve gjykon gjyqtari për të mitur, trupi gjykues për të mitur dhe kolegji për të mitur.

Gjyqtari për të mitur është gjyqtari i cili është ekspert në çështjet penale ku është përfshirë i mituri, fëmiu dhe madhor i ri, i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive sipas KDM-së.

---

dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi është bërë në pajtim me ligjin, d.m.th. janë përmbushur të gjitha parakushtet ligjore për pranimin e fajësisë që kërkohen me ligj, në një situatë të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues përkatësisht kryetari i trupit gjykues mund të vazhdojë procesin me shqiptimin e dënimit, pa shkuar fare në shqyrtim dhe pa plotësuar fare trupin gjykues edhe kur ligji për vepra të tilla parashikon që trupin gjykues ta përbëjnë tre gjyqtarë profesionistë".

[73] Neni 19, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.24. dhe 1.25. të KPP-së.

[74] Neni 25, paragrafët 2-4. të KPP-së.

[75] Neni 19, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.21. dhe 1.22. të KPP-së. Autorizimet e kolegjit shqyrtues janë të parashikuara edhe në nenin 418 të KPP-së

Trupi gjykues për të mitur është trupi i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve prej të cilëve kryetari i trupit gjykues për të mitur është gjyqtar për të mitur i cili gjykon gjatë shqyrtimit gjyqësor, kurse kolegji për të mitur është kolegji i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve prej të cilëve kryetari është gjyqtar për të mitur i cili merr vendime në seancë jashtë shqyrtimit gjyqësor.[76]

Në gjykatën e shkallës së parë, gjyqtari për të mitur gjykon për veprat penale për të cilat si dënim kryesor është i paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, kurse trupi gjykues për të mitur[77] i përbërë nga tre (3) gjyqtar prej të cilëve kryetari i trupit gjykues është gjyqtar për të mitur, gjykon për veprat penale për të cilat është i paraparë dënimi me burgim mbi dhjetë (10) vjet ose dënimi më i rëndë.

Në gjykatën e shkallës së dytë gjykon kolegji për të mitur i përbërë prej tre (3) gjyqtarëve, prej të cilëve gjyqtari referues është gjyqtari për të mitur.[78]

Gjithashtu, gjyqtari për të mitur apo trupi gjykues për të mitur, i gjykojnë edhe personat madhor për veprat penale kur viktima paraqitet fëmijë, sipas nenit 108 të KDM-së.

Në kontekst të kësaj shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale është e rëndësishme që të theksohet se me nenin 32 të Ligjit për Gjykatat janë parashikuar edhe kushtet e veçanta për emërimin apo avancimin e gjyqtarëve në gjykata.

Sipas kësaj dispozite ligjore, përveç kualifikimeve minimale, të gjithë kandidatët për emërim për gjyqtarë, me qëllim të emërimit apo avancimit në gjykata, duhet të kenë kualifikimet si në vijim:

- për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda apo në Departamentin për të Mitur në gjykatën themelore, kandidati duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë si gjyqtar në lëmin penal;

[76] Neni 3, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.11., 1.13. dhe 1.14. të KDM-së.
[77] Sipas Kodit të mëparshëm të Drejtësisë për të Mitur, trupi gjykues për të mitur ishte përbërë nga një (1) gjyqtar për të mitur dhe nga dy (2) gjyqtarë porotë. Gjyqtarët porotë në trupin gjykues për të mitur është dashur që të emërohen nga mesi i profesorëve, arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve. Gjithashtu, gjyqtarët porotë që kanë marrë pjesë pjesë në trupin gjykues për të mitur është dashur të jenë të gjinive të ndryshme (neni 51).
[78] Neni 48 i KDM-së.

- për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet për të punuar si gjyqtar në Departamentin për Krime të rënda, si dhe të ketë vlerësim pozitiv të performancës.

Andaj, bazuar në këto që u theksuan më lart, forma e parë e kësaj shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale do të manifestohet në rastet kur gjykata që e ka gjykuar rastin nuk ka qenë në përbërje të duhur apo të rregullt, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Përveç që do të konsiderohej shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, një aspekt i tillë do të kishte konsekuenca edhe në kuptim të nenit 6, paragrafi 1. të KEDNJ-së.

Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka theksuar se *"Në parim, një shkelje e dispozitave ligjore të brendshme për krijimin dhe kompetencën e organeve nga një gjykatë shkakton edhe shkelje të nenit 6, paragrafi 1. të KEDNJ-së".*[79]

Në këtë mënyrë, në parim kjo formë e parë e kësaj shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, ku përbërja e gjykatës nuk ka qenë e duhur, do të ekzistonte në këto situata:

- Nëse çështjen e ka gjykuar gjyqtari i vetëm gjykues, ndërsa është dashur që ta gjykoj trupi gjykues.[80] Kështu, në nenin 309 të KPP-së është parashikuar se *"Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor të drejtuar nga gjyqtari i vetëm gjykues, faktet në të cilat bazohet akuza tregojnë se për shqyrtimin e asaj vepre penale është kompetent trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve, gjykimi i kalohet trupit përkatës në kuadër të gjykatës themelore dhe shqyrtimi gjyqësor fillon rishtas"*;
- Nëse çështja është gjykuar nga trupi gjykues, ndërsa është dashur që të gjykohet nga trupi gjykues për të mitur;[81]
- Nëse për çështjen ka vendosur gjyqtari për të mitur, ndërsa është dashur që të vendos kryetari i trupit gjykues për të mitur;
- Nëse për çështjen ka vendosur gjyqtari për të mitur ose kryetari i trupit gjykues për të mitur, ndërsa është dashur që të vendos trupi gjykues për të mitur;

[79] Rasti *"Tempel kundër Republikës së Çekisë"*, aktgjykimi i datës 16.11.2020, paragrafët 65-72.
[80] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Vepra e cituar, fq. 890; HAJDARI, AZEM: Vepra e cituar, fq. 934.
[81] SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 100.

- Nëse kryetari i trupit gjykues për të mitur nuk është gjyqtar për të mitur ose nëse gjyqtari referues i kolegjit për të mitur që gjykon në gjykatën e shkallës së dytë nuk është gjyqtar për të mitur;
- Nëse për çështjen është dashur që të vendos gjyqtari i procedurës paraprake, kurse ka vendosur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues;
- Nëse për çështjen është dashur që të vendos trupi gjykues, ndërsa ka vendosur kolegji shqyrtues;
- Nëse çështjen e ka gjykuar gjyqtari të cilit i ka përfunduar mandati, sipas nenit 34 të Ligjit për Gjykatat;
- Nëse çështjen e ka gjykuar gjyqtari i cili nuk i ka përmbushur kualifikimet për emërim apo avancim, sipas nenit 32 të Ligjit për Gjykatat, etj.

Forma e dytë e kësaj shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konsiston në rastet kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor.

Kjo formë e dytë e kësaj shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ndërlidhet me zbatimin e parimit të drejtpërdrejt, sipas të cilit gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues, anëtari i trupit gjykues, gjyqtari zëvendësues dhe procesmbajtësi duhet që të jenë të pranishëm vazhdimisht në shqyrtim gjyqësor.

Pra, për shkak të peshës dhe rëndësisë së madhe, duhet që në shqyrtim gjyqësor të jenë vazhdimisht të pranishëm gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues, procesmbajtësi dhe gjyqtari zëvendësues.[82] Për prezencën e tyre dhe për nevojën që trupi gjykues të jetë i përbërë në përputhje me ligjin, duhet që të kujdeset gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues.

Në rastet kur gjyqtari largohet nga shqyrtimi gjyqësor, atëherë duhet që të ndërprehet shqyrtimi gjyqësor dhe asesi të mos mbahet shqyrtimi gjyqësor pa pjesëmarrjen e gjyqtarëve.

[82] Paragrafët 1. të neneve 292 dhe 293 të KPP-së.

Ndërsa, forma e tretë e kësaj shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale manifestohet në rastet kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi.

GJEDNJ-ja në rastin *"Lavents kundër Letonisë"*, aktgjykimi i datës 28.02.2003, paragrafi 115, kishte konstatuar shkelje të nenit 6, paragrafi 1. të KEDNJ-së, sepse *"gjykata nuk kishte qenë në përputhje me ligjin, pasi dy (2) nga gjyqtarët ishin diskualifikuan me ligj nga seanca në këtë rast"*.

8.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me këtë shkelje esenciale

Çështja nëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë e duhur, përkatësisht sipas ligjit, ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kështu, në vijim do të paraqitet një rast që i referohet kësaj shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale:

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.105/2019, i datës 13.05.2019**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të miturës R.G., ndërsa sipas detyrës zyrtare edhe në pjesën që ka të bëjë me të miturin G.H. dhe L.Ll, anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.175/2018, i datës 10.10.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAM.nr.81/2018, i datës 13.12.2018, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa e mbrojtësit të të miturës R.G., është e bazuar.

Aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuar nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së lidhur me nenin 51, paragrafi 4. të KDM-së (Kodit të mëparshëm të Drejtësisë për të Mitur), siç me të drejtë pretendohet në kërkesë, sepse gjyqtarët porotë që kanë marrë pjesë në trupin gjykues kanë qenë të gjinisë së njëjtë.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës dhe nga aktgjykimi i kundërshtuar, trupi gjykues përbëhej nga gjyqtarët porotë H.U. dhe N.K., të dy të gjinisë mashkullore, çka e përfshin aktgjykimin me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së lidhur me nenin 51, paragrafi 4. të KDM-së.

Neni 51, paragrafi 4. i KDM-së përmban formulimin e qartë dhe përcakton në mënyrë decidive se gjyqtarët porotë që marrin pjesë në trupin gjykues për të mitur duhet të jenë të gjinive të ndryshme, andaj dhe ndalon mundësi të tjera alternative të përbërjes së ndryshme të trupit gjykues, siç gabimisht ka vepruar gjykata e shkallës së parë.

Andaj, edhe Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në këtë çështje penalo juridike nuk ka gjykuar trupi gjykues për të mitur, ashtu siç parashihet me nenin 51, paragrafi 4. të KDM-së.

8.4. Komente përmbledhëse

Nga aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe duke ju referuar dispozitave ligjore të trajtuara më lart, si dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së mund të nxjerrën këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

2. Konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. i KPP-së, në rastet kur përbërja e gjykatës nuk ka qenë e duhur ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi.

3. Kjo shkelje bënë pjesë në kuadër të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat gjykata kujdeset sipas propozimit të palëve, por edhe sipas detyrës zytare.[83]
4. Për shkak të natyrës së saj, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, ndikon edhe në anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e rastit në rigjykim. Te rasti i paraqitur më lart, shihet që janë anuluar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, pasi që përbërja e trupit gjykues për të mitur nuk kishte qenë në pajtim me ligjin, përkatësisht me dispozitat ligjore të Kodit të mëparëshëm të Drejtësisë për të Mitur. Kjo për faktin se në dispozitat ligjore të këtij Kodi, ka qenë e parashikuar se gjyqtarët porotë të trupit gjykues për të mitur duhet të ishin të gjinive të ndryshme, ndërsa te rasti i lartcekur, gjyqtarët porotë kishin qenë të gjinisë së njejtë. Andaj, edhe kjo kishte qenë arsye që çështja penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
5. Se kur konsiderohet që përbërja e gjykatës nuk ka qenë e duhur, kjo duhet të vlerësohet në secilin rast e veç e veç, varësisht nga kompetenca funksionale e gjykatës dhe nga përbërja e gjykatës që ka vendosur në rastin përkatës, siç është theksuar më lart.

9. Nëse aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 të KPP-së

9.1. Dispozitat ligjore

Neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.7. i KPP-së

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

"Sipas propozimit të palëve, shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet vetëm ajo shkelje e cila ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë, në rastet kur aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 të këtij Kodi".

9.2. Komentim i shkurtër i dispozitës ligjor të lartcekur

[83] Neni 394, paragrafi 1. i KPP-së.

Sipas zgjidhjes së përcaktuar me këtë dispozitë ligjore, kjo shkelje, përbëhet nga këto elemente:

1. Është shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale e cila shqyrtohet nga Gjykata e Apelit e Kosovës vetëm sipas propozimit të palëve, pra nuk është shkelje për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare;
2. Duhet që aktgjykimi të mos hartohet në pajtim me nenin 369 të KPP-së dhe
3. Konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, vetëm nëse një shkelje e tillë ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshshëm dhe të drejtë.

Kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale ka të bëjë me pa rregullësitë formale të aktgjykimit dhe përbën shkeljen më të shpeshtë në praktikën gjyqësore, për të cilën shkelje, gjykatat më të larta i anulonin aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë.[84]

Siç është theksuar edhe më lart, kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale ekziston në rastet kur aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim 369 të KPP-së dhe një gjë e tillë duhet të ndikojë në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë.

Pra, për të ekzistuar kjo shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, duhet që në mënyrë kumulative të përmbushën këto dy (2) kushte dhe një gjë e tillë duhet të vlerësohet në secilin rast veç e veç. Në këtë mënyrë, për të vlerësuar nëse bëhet fjalë për këtë shkelje, është e nevojshme që të analizohet dhe elaborohet neni 369 i KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është parashikuar përmbajtja dhe forma me shkrim e aktgjykimit.

Në nenin 369, paragrafi 1. të KPP-së është parashikuar se *"Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur. Aktgjykimi përfshinë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin".*

Kjo dispozitë ligjore përcakton strukturën e aktgjykimin dhe specifikon çështjen e njëjtësisë së aktgjykimit të përpiluar me shkrim me aktgjykimin e shpallur.

Aktgjykimi konsiderohet vendimi më i rëndësishëm në procedurë penale dhe me të sipas rregullit zgjidhet çështja penale në mënyrë meritore.

[84] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, fq. 902.

Aktgjykimi është njëri nga tri format e mundshme të vendimeve që merren nga gjykata gjatë procedurës penale, krahas aktvendimit dhe urdhrit. Sipas nenit 469, paragrafi 1. të KPP-së, në procedurën penale vendimet merren *"në formë të aktgjykimit, të aktvendimit dhe të urdhrit"*.

Vetëm gjykata mund ta marrë aktgjykimin, kurse aktvendimin mund ta marrë edhe prokurori i shtetit, ndërsa urdhrin mund marrin edhe organet e tjera publike që marrin pjesë në procedurë penale.[85]

Siç do të shohim edhe më poshtë, aktgjykimi është vendim gjyqësor i cili merret dhe shpallet në emër të popullit dhe, njëherit, përfaqëson zbatimin e kodit penal në një rast konkret. Nëpërmjet tij zbatohen masat e shtrëngimit shtetëror kundër atyre që është vërtetuar se kanë kryer ndonjë vepër penale. Aktgjykimi i formës së prerë e ka fuqinë e ligjit për çështjen konkrete penale që është zgjidhur me të dhe si i tillë është i detyrueshëm për të gjithë.[86] Dhënia e aktgjykimit, pra është e drejtë ekskluzive e gjykatës. Me të bëhet formimi faktik dhe juridik i çështjes penale, ndërsa ai jepet pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.[87]

Në rastet kur i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga neni 242, paragrafi 2. të KPP-së, atëherë merr aktvendim për miratimin e pranimit të fajësisë dhe procedon me shqiptimin e dënimit, e cakton seancën sipas nenit 356 të këtij Kodi për të përcaktuar çështje që janë të rëndësishme për shqiptimin e dënimit[88] ose e pezullon shqiptimin e dënimit deri në përfundimin e bashkëpunimit nga i pandehuri me prokurorin e shtetit. Në këto situata, mandej merret aktgjykim pas përfundimit të shqyrtimi fillestar dhe një aktgjykim i tillë bazohet mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe të miratuar nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues.

---

[85] Neni 469, paragrafi 2. të KPP-së.

[86] Vendimi përfundimtar i gjykatës është sinteza e gjykimit dhe përfaqëson zgjidhjen e çështjes në themel mbi bazën e provave të administruara në shqyrtim gjyqësor. Ai shpreh bindjen e gjyqtarëve për ekzistencën ose jo të faktit, për fajësinë e të pandehurit dhe për shkallën e rrezikshmërisë së tij shoqërore. Kjo bindje duhet të përputhet me kërkesat e ligjit penal, të atij material dhe procedural. Në bazë të nenit 380 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, për marrjen e vendimit, gjykata përdorë vetëm provat që janë marrë ose janë verifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. ISLAMI, HALIM; HOXHA, ARTAN; PANDA, ILIR: Procedura penale, Komentar, Tiranë, 2003, fq. 496.

[87] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: E drejta e procedurës penale, fq. 387.

[88] SHALA, AFRIM: Disa aspekte praktike të seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, Revista shkencore juridike *"Opinio Juris"*, Prishtinë, 2016, fq. 1-8.

Duke u bazuar në nenin 369, paragrafi 1. të KPP-së, aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin e shpallur.[89] Pra, aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë identik me aktgjykimin të cilin e ka shpallur gjykata. Gjithashtu, edhe aktgjykimi i shpallur nga gjykata duhet të jetë në përputhje, përkatësisht identik me dispozitivin e aktgjykimit të shënuar në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor.[90]

9.3. Pjesët përbërëse të aktgjykimit

Sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369, paragrafi 1. të KPP-së, aktgjykimi duhet të përfshinë : **hyrjen, dispozitivin** dhe **arsyetimin.**[91]

9.3.1 Pjesa hyrëse

Hyrja e aktgjykimit përfshin: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit,[92] emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ditën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, mbrojtësit të viktimave ose përfaqësuesit të viktimës të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.[93]

---

[89] Shpalljen e aktgjykimit e rregullon neni 365 i KPP-së.
[90] Neni 315, paragrafi 1. të KPP-së.
[91] Gjithashtu, pjesë përbërëse e aktgjykimit duhet të jetë edhe *"Udhëzimi për të drejtën në ankesë"*. Shih nenin 369, paragrafët 5. dhe 6. dhe nenin 473, paragrafi 3. të KPP-së. Udhëzimi për të drejtën në ankesë përmban këshilla juridike se kundër aktgjykimit lejohet paraqitja e ankesës, nga palët dhe personat tjerë të autorizuar, sipas nenit 381 të KPP-së, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes aktgjykimit. Ankesa duhet që t'i dorëzohet gjykatës themelore në numër të mjaftueshëm kopjesh për gjykatën dhe për palën tjetër.
[92] Në Republikën e Shqipërisë, gjykatat i japin vendimet *"Në emër të Republikës"* (Neni 146, paragrafi 1. i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 112, paragrafi 2. i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë). Në Republikën e Kroacisë, aktgjykimi merret dhe shpallet *"Në emër të Republikës së Kroacisë"* (neni 117, paragrafi 1. i Kushtetutës së Republikës së Kroacisë, si dhe neni 366, paragrafi 2. dhe neni 376, paragrafi 2. i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kroacisë), kurse në Mbretërinë e Holandës, aktgjykimi merret *"Në emër të Mbretit"* (neni 554, paragrafi 1. i Kodit të Procedurës Penale).
[93] Neni 369, paragrafi 2. i KPP-së.

9.3.2 Dispozitivi i aktgjykimit

Dispozitivi i aktgjykimit përfshin: të dhënat personale të të akuzuarit dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për vepër penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë vepër apo me të cilin refuzohet aktakuza.[94]

"Të dhëna personale" përfshijnë informacionin personal si vijon: emrin, mbiemrin, emrin e qytetit të lindjes ose vendbanimit, funksionin publik të të pandehurit nëse ka dhe numrin personal. Kur numri personal nuk është në dispozicion, atëherë në vend të tij mund të përdoren data e lindjes, emri i njërit prind dhe vendlindja.

Të dhënat personale shtesë, ashtu siç kuptohet ky term nga ligjet tjera, mund të shtohen vetëm nëse është e nevojshme për të shpjeguar rrethanat kontekstuale të veprave penale.[95]

Është e rëndësishme që të theksohet se përveç numrit personal, datës së lindjes, emrit të prindërve dhe vendlindjes, publikimi i të dhënave të tjera personale të lartcekura, nuk konsiderohet shkelje e privatësisë, për shkak të interesit të publikut për një gjyqësor të hapur dhe publik.[96]

Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të KPP-së, ndërsa kur ai është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar, vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike, nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.

Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1. Veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;

---

[94] Sipas nenit 361 të KPP-së, me aktgjykim ose refuzohet akuza, ose i akuzuari lirohet nga akuza, ose shpallet fajtor. Kur akuza përfshin disa vepra penale, në aktgjykim shënohet nëse dhe për cilën vepër është refuzuar akuza, apo nëse dhe për cilën vepër i akuzuari lirohet ose shpallet fajtor. Andaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore ekzistojnë këto katër (4) forma të aktgjykimit : 1) aktgjykim refuzues; 2) aktgjykim lirues; 3) aktgjykim fajësues dhe 4) variante të kombinuara të këtyre aktgjykimeve. Aktgjykimi fajësues është një nocion më i gjerë se sa aktgjykimi dënues, pasi që në vetë ngërthen edhe aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor, por që është liruar nga dënimi, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK-së.

[95] Neni 369, paragrafi 12. të KPP-së.

[96] Neni 369, paragrafi 13. i KPP-së.

2. Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit;
3. Vendimin për konfiskimin e pasurisë së specifikuar;
4. Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike;
5. Taksën për Programin e Kompensimit të Viktimave sipas ligjit në fuqi; dhe
6. Aktgjykimi gjithashtu duhet të theksojë nëse aktgjykimi i formës së prerë duhet të shpallet në shtyp, radio ose televizion.[97]

Nëse nuk është bërë kërkesë për seancën për caktimin e dënimit[98] nga prokurori i shtetit, i akuzuari ose mbrojtësi i tij, gjykata në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor gjithashtu shënon:

1. Dënimin e shqiptuar të akuzuarit, duke përfshirë edhe dënimin alternativ nga Kodi Penal ose lirimin nga dënimi;
2. Vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit;
3. Urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryesve të varur nga droga dhe alkooli;
4. Kur i akuzuari dënohet me gjobë, në aktgjykim shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës kur gjoba forcërisht nuk mund të arkëtohet.

Siç është theksuar edhe më lart, në nenin 369, paragrafi 4. të KPP-së është parashikuar se kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të këtij Kodi, ndërsa, në nën-paragrafin 1.1., paragrafi 1. të këtij neni është parashikuar se gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal.

Pikërisht ky element i dispozitivit të aktgjykimit dënues ka qenë njëri prej pretendimeve që është paraqitur mjaft shpesh në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe është trajtuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, andaj edhe si i tillë, është vlerësuar se është e rëndësishme që të elaborohet më hollësisht. Kjo edhe për faktin se pikërisht ky element i dispozitivit të aktgjykimit

[97] Neni 364, paragrafi 1. i KPP-së.
[98] Seanca për caktimin e dënimit është rregulluar më hollësisht me dispozitat ligjore të nenit 356 të KPP-së.

dënues ka qenë arsye për anulimin e disa aktgjykimeve nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe kthimin e rasteve në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Pra, bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata duhet që në dispozitivin e aktgjykimit dënues të shënon veprën për të cilën shpallet fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal.

Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.[99]

Secila vepër penale në vete posedon elementet e saja, të cilat ndahen në dy (2) grupe:

1. Elemente themelore apo të përgjithshme të veprës penale dhe
2. Elemente të posaçme të veprës penale.

1) Elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale janë:

a) Veprimi i njeriut;
b) Kundërligjshmëria;
c) Përcaktueshmëria e veprës penale në ligj dhe
d) Përgjegjësia penale e kryesit.

Çdo veprim apo mosveprim, për t'u konsideruar vepër penale, duhet të posedojë në mënyrë kumulative të gjitha këto elemente. Të gjitha këto elemente së bashku përbëjnë anatominë e veprës penale dhe çdonjëri prej tyre është pjesë e strukturës së veprës penale. Këto elemente e përbëjnë të ashtuquajturën **"figurë të përgjithshme të veprës penale"**.[100] Me gjithë faktin se vepra penale përbëhet prej këtyre katër (4) elementeve themelore, vepra penale është unike, një tërësi, ngase vetëm tërësia e tyre formon kuptimin e plotë social dhe juridik. Për nga rëndësia e tyre shoqërore dhe juridike, të gjitha këto elemente janë të njëjta. Së këndejmi, nëse mungon njëri prej këtyre elementeve, vepra penale nuk mund të ekzistojë. Pra, të gjitha këto elemente janë pjesë konstituive të çdo vepre penale.

[99] Neni 7 i KPRK-së.
[100] SHALA, AFRIM: Hyrje në të drejtën penale, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023, fq. 50.

Varësisht se prej çfarë këndi vështrohen, elementet themelore të veprës penale mund të ndahen në dy (2) grupe :

1. Elemente objektive dhe
2. Elemente subjektive.

Në grupin e elementeve objektive bëjnë pjesë: veprimi i njeriut (veprimi me pasojën e shkaktuar); kundërligjshmëria dhe përcaktueshmëria e veprës penale në ligj, ndërsa, në grupin e elementeve subjektive bën pjesë vetëm përgjegjësia penale e kryesit (fajësia).[101]

2) Elementet e posaçme të veprës penale janë ato elemente që nuk janë të përbashkëta për të gjitha veprat penale, por që paraqiten te disa vepra penale dhe janë elemente që ndikojnë që një vepër penale të dallohet prej një vepre tjetër penale.[102] Elementet e posaçme të veprës penale ndryshe emërtohen edhe si **"tipare të veprës së caktuar penale"** dhe njëherazi tërësia e elementeve të veprës penale të caktuar e përbëjnë **"figurën e veprës penale"**, që specifikohet në nenin 364, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së. Ndërsa, elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale duhet të shprehen te çdo vepër penale dhe ato në fakt e sajojnë kuptimin e përgjithshëm të veprës penale. Nga kjo del se, përderisa elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale (veprimi, kundërligjshmëria etj.), duhet të shprehen te çdo vepër penale, elementet e posaçme janë tipare apo janë karakteristikë e veprës penale të caktuar dhe këto shprehen krahas elementeve të përgjithshme. Pra, çdo vepër penale i posedon elementet e veta të posaçme, që shprehen krahas elementeve të përgjithshme dhe që bëjnë që një vepër penale të dallohet nga vepra tjetër penale.

Figura e veprës penale sajohet duke përcaktuar elementet e posaçme veç e veç dhe duke bërë sintetizimin dhe përgjithësimin e tyre në dispozitën e caktuar penalo-juridike.

Kështu, p.sh. vepra penale *"Grabitja"*, nga neni 317, paragrafi 1. i KPRK-së, përbëhet prej këtyre elementeve:[103]

1. Kryesi duke e përdorur forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër;

[101] SHALA, AFRIM: Hyrje në të drejtën penale, fq. 51.
[102] SHALA, AFRIM: Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010, fq. 27.
[103] SHALA, AFRIM: Hyrje në të drejtën penale, fq. 51-52.

2. E përvetëson;
3. Pasurinë e luajtshme;
4. Të personit të tillë dhe
5. Me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme.

Vepra penale *"Marrja e ryshfetit"*, nga neni 421, paragrafi 1. i KPRK-së, përbëhet prej këtyre elementeve:

1) Personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj;
2) I cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë,
3) Kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë,
4) Në mënyrë që personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

Ose vepra penale *"Vjedhja"*, nga neni 313 paragrafi 1. i KPRK-së, përbëhet prej këtyre elementeve:

1) marrja;
2) e pasurisë së tjetrit;
3) pasuria të jetë vlerësuar në shumën prej pesëdhjetë (50) euro dhe
4) me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ose për personin tjetër.[104]

Pra, me figurë të veprës penale kuptojmë të gjitha elementet e posaçme të një vepre penale. Andaj, edhe shtrohet pyetja se çka kuptojmë me elemente të posaçme të veprës penale konkrete?

Elementet e posaçme të veprës penale të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale janë ato elemente që nuk janë të përbashkëta për të gjitha veprat penale, por që paraqiten te disa vepra penale dhe që e dallojnë një vepër penale prej një vepre tjetër penale. Çdo vepër penale i posedon elementet e veta të posaçme. Në raport me elementet e përgjithshme, elementet e posaçme të veprës penale në

[104] SHALA, AFRIM: Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, 2021 (bashkautor), fq. 120.

fakt janë një lloj konkretizimi i elementeve të përgjithshme. Pa përcaktimin e elementeve të posaçme nuk mund të bëhet kualifikimi ose cilësimi i veprës penale.[105]

Sikur elementet e përgjithshme, edhe elementet e posaçme të veprës penale, mund të ndahen në dy (2) grupe :

1) Elemente të karakterit objektiv dhe
2) Elemente të karakterit subjektiv.

Elementet e karakterit objektiv - Njëri ndër elementet e figurës së veprës penale të caktuar, i natyrës objektive është **veprimi i kryerjes së veprës penale konkrete**. Çdo vepër penale e parashikuar në pjesën e posaçme të KPRK-së nënkupton ndërmarrjen e një veprimi të caktuar.

Veprimi i kryerjes së veprës penale mund të jetë i natyrave të ndryshme, kështu p.sh.
- gjuajtja me armë, te vepra penale *"Vrasja"*, nga neni 172 i KPRK-së,
- marrja e pasurisë së huaj, te vepra penale *"Vjedhja"*, nga neni 313 i KPRK-së,
- kryerja e aktit seksual me paraardhës apo pasardhës, te vepra penale *"Marrëdhëniet seksuale brenda familjeve"*, nga neni 236 i KPRK-së, etj.

Në të gjitha këto raste, ekziston veprimi i kryerjes, mirëpo veprimi i kryerjes është i natyrës së ndryshme dhe si rezultat i kësaj, një vepër penale dallohet prej veprës tjetër penale, p.sh. gjuajtja me armë, marrja e sendit të huaj, kryerja e aktit seksual me paraardhës apo pasardhës, janë veprime të kryerjes së veprës penale të caktuar. Meqë këto veprime janë të ndryshme, atëherë bëjnë që edhe veprat penale të jenë të ndryshme.

Element tjetër i natyrës objektive i figurës së veprës penale është edhe **pasoja**. Në disa raste për të ekzistuar vepra penale konkrete, duhet që të ekzistojë pasoja e caktuar. Pasoja e veprës penale, në disa raste është element që e dallon një vepër penale prej veprës tjetër penale. Pasoja e veprës penale mund të jetë e natyrave të ndryshme, kështu p.sh.
- te vepra penale *"Privimi i kundërligjshëm nga liria"*, nga neni 193 i KPRK-së, pasoja qëndron në privimin e kundërligjshëm të një personi nga liria;
- te vepra penale *"Asgjësimi ose dëmtimi i pasurisë"*, nga neni 321 i KPRK-së, pasoja qëndron në asgjësimin, dëmtimin apo bërjen të papërdorshme të pasurisë së personit tjetër;

[105] SHALA, AFRIM: Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, fq. 27.

- te vepra penale *"Vrasja"*, nga neni 172 i KPRK, pasoja qëndron në privimin e një personi tjetër nga jeta, etj.

Në të gjitha këto raste pasojat e veprave penale janë të ndryshme dhe si rezultat i kësaj bëjnë që të jenë të ndryshme edhe veprat penale.[106]

Në disa raste një vepër penale dallohet prej një vepre tjetër penale, varësisht nga fakti se në çfarë mënyre është kryer vepra penale. Pra, **mënyra e posaçme e kryerjes së veprës penale** është element që e dallon një vepër penale prej veprës tjetër. Kështu, element që e dallon veprën penale *"Vrasja"*, nga neni 172 i KPRK-së nga vepra penale *"Vrasja e rëndë"*, nga neni 173 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. i KPRK-së, është mënyra e kryerjes së veprës penale. P.sh. nëse personi A. e privon nga jeta personin B. në mënyrë mizore apo dinake, atëherë në veprimet e personit A. qëndrojnë elementet e veprës penale *"Vrasja e rëndë"*, nga neni 173 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. të KPRK-së, e jo të veprës penale *"Vrasja"*, nga neni 172 i KPRK-së.

Po ashtu, edhe **vlera e objektit të mbrojtur** në të drejtën penale mund të jetë rrethanë vendimtare për ta kualifikuar një vepër penale. Kështu, nëse personi A. e vjedh një send që ka vlerë mbi pesëmijë (5000) Euro dhe personi A. ka vepruar me qëllim të përvetësimit të sendit me vlerë të tillë, atëherë në veprimet e personit A. qëndrojnë elementet e veprës penale *"Vjedhja e rëndë"*, nga neni 315, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së, e jo të veprës penale *"Vjedhja"*, nga neni 313, paragrafi 1. të KPRK-së. Pra, këto dy vepra penale dallojnë në mes vete, edhe për shkak të vlerës së sendit të vjedhur.

Në rastet e tjera, për të ekzistuar vepra penale e caktuar, është e nevojshme që të jenë përdorur **mjetet e caktuara**. Kështu, vepra penale *"Peshkimi i kundërligjshëm"*, nga neni 353, paragrafi 2. të KPRK-së, ekziston nëse kryesi peshkon duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese.

Te disa vepra penale është i nevojshëm që veprimi të jetë ndërmarrë gjatë **kohës së caktuar**. Kështu, vepra penale *"Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë"*, nga neni 250 i KPRK-së, mund të kryhet vetëm gjatë kohës së epidemisë; *"Krimet e luftës në kundërshtim të*

[106] SHALA, AFRIM: Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional, fq. 121.

rëndë me Konventat e Gjenevës", nga neni 144 i KPRK-së mund të kryhen vetëm gjatë kohës së luftës (konfliktit të armatosur), etj.

Edhe **vendi i kryerjes së veprës penale**, mund të jetë element konstituiv i veprës penale. Kështu, vepra penale *"Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare"*, nga neni 140 i KPRK-së mund të kryhet në vendet rreth kufirit ose vijës kufitare të Republikës së Kosovës, përveç në kufirin ose vendkalimet e autorizuara kufitare.

Cilësia e caktuar personale e kryesit apo **marrëdhënia e caktuar**, janë tipare të një varg veprash penale, kështu që këto vepra penale mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara apo që gjenden në raporte të caktuara. Veprat penale të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara apo që gjenden në marrëdhënie të caktuar, ndryshe quhen edhe si "*delicta propria"*. Në këtë aspekt, disa vepra penale mund t'i kryejnë vetëm *"personat zyrtarë"* (neni 194, 195, 198, 414, 416, 417, 418, 421, etj.) apo *"personat përgjegjës"* (neni 279, 284, 285, etj.), *"mjeku"* (neni 254, 255, etj), *"farmacisti"* (neni 258, etj), *"gjyqtari"* (neni 425, etj.), *"dëshmitari"* (neni 384), etj. Kurse, disa vepra tjera mund t'i kryejnë vetëm personat që gjenden në marrëdhënie të caktuar, *"marrëdhënie familjare"*, (neni 182 paragrafi 2, etj.), etj. Ose, veprën penale *"Vrasja e foshnjeve gjatë lindjes"*, nga neni 176 i KPRK-së, mund ta kryejë vetëm *"nëna"*, e cila gjendet në raporte personale me viktimen - foshnjën.

Gjithashtu, edhe **cilësia personale e viktimës** mund të jetë element konstituiv i një vepre penale. Kështu, vepra penale *"Vrasja e rëndë"*, nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafët 1. dhe 2. të KPRK-së, ekziston nëse privohet nga jeta fëmija përkatësisht gruaja shtatëzënë.

Përveç këtyre, në pjesën e posaçme të KPRK-së, janë parashikuar edhe shumë elemente tjera të natyës objektive.

Elementet e karakterit subjektiv - Për ekzistimin e disa veprave penale duhet që te kryesi i veprës penale të manifestohen edhe elemente të karakterit subjektiv. Në këtë aspekt, rëndësi të posaçme ka qëllimi dhe motivi i kryesit, të cilat duhet të ekzistojnë në momentin e kryerjes së veprës penale. Për ekzistimin e disa veprave penale duhet që ato të jenë kryer me **qëllim të caktuar**. Vepra penale *"Vjedhja"*, nga neni 313, paragrafi 1. i KPRK-së, ekziston vetëm nëse personi A. e merr automjetin e personit B. me qëllim të përvetësimit të tij për vete ose për personin tjetër. Nëse personi A.

automjetin e personit B. nuk e ka marr me këtë qëllim, por vetëm sa për t'i kryer disa punë në qytetet tjera, atëherë do të ekziston vepra penale *"Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme"*, nga neni 319 i KPRK-së. Pastaj, vepra penale *"Falsifikimi i dokumenteve"*, nga neni 390 i KPRK-së, konsiderohet se është kryer vetëm nëse falsifikimi i dokumentit është bërë me qëllim që ai dokument të përdoret si i vërtetë.

Në disa raste edhe **motivi** është parashikuar si element konstituiv i veprës së caktuar penale. Në këtë drejtim, vepra penale *"Vrasja e rëndë"*, nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.10 i KPRK-së, ekziston vetëm nëse kryrësi e privon nga jeta personin tjetër i motivuar në bazë kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit, etj.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, gjykata duhet që në aktgjykim të shënon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme veprën penale për të cilën shpallet fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës ligjore përkatëse të KPRK-së.

Përveç kësaj, në dispozitiv të aktgjykimit duhet shënuar edhe emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit.

Njëherit, këto dy (2) elemente, vepra penale, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe emërtimi ligjor i veprës penale, së bashku me dispozitat e ligjit penal, janë pjesë tejet të rëndësishme të dispozitivit të aktgjykimit.

Emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal janë të ndërlidhura në mes vete dhe trajtohen së bashku, andaj edhe si të tilla nuk duhet të jenë në kundështim njëra me tjetrën. Kështu, p.sh. te vepra penale *"Vrasja"*, nga neni 172 i KPRK-së, emërtimi ligjor i veprës penale është *"Vrasja"*, kurse dispozita e ligjit penal është neni 172 i KPRK-së, në të cilën është parashikuar kjo vepër penale. Apo, te vepra penale *"Vjedhja"*, nga neni 313 i KPRK-së, emërtimi ligjor i veprës penale është *"Vjedhja"*, kurse dispozita e ligjit penal është neni 313 i KPRK-së, në të cilën është parashikuar kjo vepër penale.

Gjithashtu, dispozitivi i aktgjykimit duhet të përfshijë edhe dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit ose lirimin nga dënimi, si dhe vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit.[107]

Në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata duhet që të precizojë në mënyrë të qartë llojin e dënimit të cilin ja ka shqiptuar të akuzuarit dhe kohëzgjatjen e tij apo shumën e dënimit me gjobë, duke përfshirë këtu edhe mënyrën e ekzekutimit.

Po ashtu, në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata duhet të shënon edhe vendimin për konfiskimin e pasurisë së specifikuar, vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike, taksën për Programin e Kompensimit të Viktimave sipas ligjit në fuqi, nëse aktgjykimi i formës së prerë duhet të shpallet në shtyp, radio ose television dhe urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryesve të varur nga droga dhe alkooli, ndërsa nëse është shqiptuar dënimi me gjobë, atëherë në aktgjykim, atëherë shënohet afati kur duhet paguar gjoba dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës kur gjoba forcërisht nuk mund të arkëtohet.[108]

Në rastet rastet e veprave penale në bashkim,[109] atëherë sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369, paragrafi 5. të KPP-së, në rastin e gjykimit të veprave penale të tilla, gjykata në dispozitivin e aktgjykimit shënon dënimet e shqiptuara për secilën vepër penale, e pastaj dënimin për të gjitha veprat në bashkim.[110]

Të gjitha këto elemente që u paraqiten më lart duhet që të shënohen në dispozitiv të aktgjykimit në mënyrë të qartë dhe kuptueshme. Përndryshe, kur dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban këto elemente, të cilat është dashur të shënohen apo në dispozitiv të aktgjykimit nuk janë shënuar dhe specifikuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme këto elemente, ndërsa kjo ndikon në marrjen e një aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, atëherë një gjë e tillë paraqet shkelje esenciale e

[107] Llogaritja e paraburgimit, arrestit shtëpiak dhe çdo periudhe të heqjes së lirisë lidhur me veprën penale bëhet duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së. Në këtë drejtim, për qëllime të llogaritjes: një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim dhe njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë janë të barabartë. Ndërsa, sipas nenit 57 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, një (1) ditë paraburgim barazohet me një (1) ditë e gjysmë burgim.
[108] Neni 364 i KPRK-së.
[109] Bashkimi i veprave penale ekziston atëherë kur kryesi kryen dy apo më shumë vepra penale, për të cilat në të njëjtën kohë zhvillohet procedura penale dhe për të gjitha veprat penale të kryera shqiptohet një dënim unik. Nga kjo shihet se për t'u konsideruar se ekziston bashkimi i veprave penale, duhet të përmbushen këto kushte në mënyrë kumulative: që të jenë kryer dy apo më shumë vepra penale; që këto vepra të jenë kryer nga i njëjti person dhe që për këto vepra kryesi të mos ketë qenë i dënuar më parë. Më gjerësisht lidhur me këtë temë, shih: SHALA, AFRIM: Hyrje në të drejtën penale, fq. 159-166.
[110] Në nenin 76 të KPRK-së janë përcaktuar rregullat për shqiptimin e dënimeve për bashkim të veprave penale.

dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin me nenin 369, paragrafët 3., 4. dhe 5. të KPP-së.

9.3.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e dispozitivit të aktgjykimit

Çështja e dispozitivit të aktgjykimin është trajtuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore.

Në shumë raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, është vërejtur se çështja e dispozitivit të aktgjykimit është ndërlidhur edhe me çështjen e arsyetimit, e cila temë do të trajtohet në vijim.

Sidoqoftë, në vijim do të paraqiten disa raste që kanë të bëjnë me këtë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që ndërlidhet me dispozitivin e aktgjykimit, ndërsa disa raste tjera me dispozitivin dhe arsyetimin e aktgjykimit:

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.430/2022, i datës 17.01.2023**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit P.P., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.184/2021, i datës 11.10.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.81/2022, i datës 13.10.2022, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit P.P., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i

lartcekur i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. lidhur me nenin 370, paragrafët 4. dhe 7. të KPP-së, si dhe me shkelje të ligjit penal, nga neni 385, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. të KPP-së, ndërsa këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Në këtë drejtim, nga shkresat e lëndës shihet se nga veprimet kryese të veprës penale të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk rezulton të jetë caktuar në mënyrë të qartë shuma e dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme ose shuma e dëmit të shkaktuar, edhe për kundër faktit se i dënuari P.P., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335, paragrafi 2. të KPRK-së, ku shuma e dobisë pasurore apo dëmit të shkaktuar është element themelor i figurës së kësaj vepre penale.

Në nenin 335, paragrafi 2. të KPRK-së, është parashikuar se kjo formë e rëndë e veprës penale të mashtrimit kryhet "Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëme në vlerë prej 10.000 (dhjetëmijë) euro apo më shumë..". Pra, nga kjo dispozitë ligjore shihet se për t'u konsideruar se është kryer kjo formë e veprës penale të mashtrimit, përveç elementeve tjera që e përbëjnë figurën e kësaj vepre penale, duhet që edhe shuma e dobisë pasurore të kundërligjshme ose dëmit të shkaktuar të jetë prej 10.000 (dhjetëmijë) Euro apo më shumë.

Në nenin 370, paragrafi 4. të KPP-së, është parashikuar se "Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të këtij Kodi...", kurse, në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, është parashikuar se "Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal...".

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se gjykatat, në aktgjykimet me të cilat të dënuarit shpallen fajtor, duhet të shënojnë, përveç tjerash, edhe veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPRK-së.

Ndërsa, në rastin konkret nuk është vepruar në këtë mënyrë, pasi që në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë shënuar të gjitha faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale mashtrimi, nga neni 335, paragrafi 2. të KPRK-së, për të cilën edhe është shpallur fajtor i dënuari P.P.. Kjo për faktin se në aktgjykimin në fjalë nuk është theksuar dhe konstatuar një element themelor i figurës së kësaj vepre penale, e që është shuma e dobisë pasurore të kundërligjshme ose dëmit të shkaktuar prej 10.000 (dhjetëmijë) euro apo më shumë, pavarësisht faktit se në këtë rast bëhet fjalë për një paluajtshmëri, vlera e të cilës nuk është përcaktuar.

Po ashtu, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, rezulton se mbrojtësi i të dënuarit, si gjatë pjesës hyrëse, ashtu edhe gjatë fjalës përfundimtare, e ka ngritur si pretendim faktin se dëshmitari M.P. është shpallur fajtor me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë P.nr.126/2018, për deklarime të rreme të dhëna në këtë lëndë, mirëpo nga arsyetimi i këtij aktgjykimi nuk rezulton që të jetë vlerësuar dhe arsyetuar një rrethanë e tillë. Duhet theksuar se një rrethanë e tillë nuk është vlerësuar dhe arsyetuar mjaftueshëm as nga gjykata e shkallës së dytë, pavarësisht faktit se një gjë e tillë kishte qenë edhe pretendim në ankesën e mbrojtësit të të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në anën tjetër, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor dhe nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vendosur që të lexohen deklaratat e dëshmitarëve D.P. dhe M.P., mirëpo nuk është e qartë dhe nuk është arsyetuar mjaftueshëm një gjë e tillë, përkatësisht nëse leximi i deklaratave të këtyre dy dëshmitarëve është bërë në harmoni me nenin 338, paragrafi 2. të KPP-së dhe nëse këta dy dëshmitarë janë ftuar në mënyrë të rregullt konform sipas dispozitave përkatëse të KPP-së (Kapitulli XXVII). Kjo për faktin se dëshmitarët në fjalë e kanë vëlla të dënuarin P.P., andaj edhe sipas nenit 127, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të KPP-së dhe duke e pasur parasysh natyrën e kësaj vepre penale, të njëjtit janë dëshmitarë të liruar nga detyrimi për të dëshmuar.

Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal, siç është theksuar edhe më lart dhe këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa

të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, duke e kthyer këtë çështje penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitoj të gjitha shkeljet e lartcekura, duke i ndërmarr veprimet përkatëse procedurale dhe pas administrimit të serishëm të provave, të marrë një vendim, i cili duhet të përpilohet dhe arsyetohet në mënyrën e parashikuar me ligj.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.144/2016, i datës 17.08.2016**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit F.K., të dënuarve V.K. dhe L.K. dhe kërkesës së përbashkët të S., I. dhe N.M., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr.285/2013, i datës 03.04.2014 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.67/2015, i datës 28.10.2015 dhe çështja i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.285/2013, e datës 03.04.2014, ka shpallur fajtor të dënuarit F.K., L.K., V.K., S.M., I.M. dhe N.M., sepse në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale kontrabandim i mallrave nga neni 317, paragrafi 1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale importi, eksporti, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve ose materieve plasëse nga neni 372, paragrafi 2. lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. KPP-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë konstatoi se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës duke i vlerësuar pretendimet e cekura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të dënuarve gjen se pretendimet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale qëndrojnë, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është plotësisht i paqartë dhe kontradiktor me provat dhe arsyetimin i cili gjendet në shkresat e çështjes.

Kështu, nga dispozitivi i përshkruar nuk mund të vërtetohet koha e kryerjes së veprës së parë penale, nuk mund të konstatohet cilat janë mallrat e kontrabanduara, sasia e mallrave, mënyra se si është bërë kontrabandimi, si dhe veprimet e të dënuarve të cilat inkriminojnë të njëjtit. Po ashtu, nga i njëjti dispozitiv është plotësisht e pakuptueshme se si është bërë kontrabandimi me armë, aq më tepër kur në të njëjtin dispozitiv konstatohet se kontrabandimi i mallrave, e në mes të tyre edhe i armëve, është bërë me qëllim të shmangies së tatimit, kur dihet se armët nuk mund të jenë objekt i kryerjes së kësaj vepre penale. Edhe sa i përket veprës së dytë penale dispozitivi është i paqëndrueshëm për faktin se nuk mund të përcaktohet koha e kryerjes së veprës penale, veprimet inkriminuese të secilit të dënuar, si dhe fakti se si karikatorët e zbrazët dhe kutitë me duhan konsiderohen armë apo materie plasëse, ashtu siç parashihet me nenit 372, paragrafi 2. të KPRK-së. Të gjitha këto i bëjnë dispozitivat e cekura të paqëndrueshme, të paqarta dhe kundërthënës me arsyetimin e dhënë në aktgjykim.

Sa i përket aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se i njëjti po ashtu është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, sepse në arsyetim nuk janë dhënë arsyet e duhura ligjore se pse është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe nuk janë dhënë arsyet lidhur me të gjitha pretendimet ankimore.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet t'i mënjanojë të gjitha shkeljet e potencuara, të administroj edhe njëherë provat secilën veç e veç dhe pastaj t'i vlerësojë të njëjtat dhe të vendos në mënyrë meritore.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.76/2022, i datës 28.02.2022**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarës Sh.Sh., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2547/2020, i datës 30.03.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.783/2021, i datës 02.08.2021, ndërsa çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Duhet të theksohet se aktgjykimi nuk është përpiluar konform nenit 370, paragrafi 3. të KPP-së, sepse në dispozitiv duhet të përfshihen të dhënat personale e të akuzuarit dhe vendimi me të cilin është shpallur fajtor për vepër penale për të cilën është akuzuar apo është liruar nga akuza për atë vepër penale. Ndërsa, në rastin konkret nuk është e qartë se kush është shpallur fajtor e kush është liruar nga akuza, meqenëse mungojnë shënimet personale për të akuzuarin H. dhe fakti se i njëjti është liruar apo jo nga akuza.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në përshkrimet faktike edhe në pikën I. edhe në pikën II. të dispozitivit janë të përfshirë edhe e dënuara Sh. edhe i pandehuri H., ndërsa mbetet e paqartë se për cilat veprime është shpallur fajtor e dënuara Sh. e për cilat është liruar nga akuza, gjithmonë duke iu referuar dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë edhe pse për shkelje esenciale të dispozitave procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12 të KPP-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare, të njëjtat nuk i ka eliminuar, ndërsa të gjitha këto i bëjnë aktgjykimet juridikisht të paqëndrueshme dhe kushtëzojnë anulimin e tyre.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.177/2022, i datës 05.05.2022**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit I.Xh., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2017/17, i datës 05.11.2021, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1583/2021, i datës 14.02.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësit të dënuarit. Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. lidhur me nenin 370 të KPP-së. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale konsistojnë në atë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, njëherit i njëjti nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, ndërsa arsyet të cilat janë dhënë, janë të pakta dhe tërësisht të paqarta.

Nga dispozitivi i aktgjykimit assesi nuk mund të kuptohet se cilat qenkan ato veprime inkriminuese të të dënuarit dhe në çfarë mënyre janë sajuar tiparet e veprës penale të përshkruar në dispozitiv, kur faktet juridike relevante kanë një përmbajtje krejtësisht tjetër dhe aktgjykimi nuk përmban arsyet për faktet qenësore dhe ato të cilat janë dhënë janë të pakta dhe të paqarta, të pakuptueshme, shkelje këto që aktgjykimin e bëjnë tërësisht të paqëndrueshëm. Derisa në dispozitivin e aktgjykimit, të dënuarit i përshkruhen veprimet e veprës penale të mashtrimit nga neni 335, paragrafi 1. të KPRK-së, nga shkresat e lëndës me provat e administruara, kjo tani për tani nuk mund të merr si të qëndrueshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur elementet e veprës penale sipas kualifikimit të kësaj vepre penale.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare dhe ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyet e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e procesverbaleve për deklarimet e të dëmtuarit dhe mbrojtjes së të dënuarit. Nga arsyetimi i aktgjykimit rezulton se gjykata e shkallës së parë, përveç që ka shënuar përmbajtjen e deklaratës së të dëmtuarit, deklaratë e dhënë vetëm në stacionin policor, duke i dhënë rëndësi vendimtare, përkatësisht duke e mbështetur aktgjykimin vetëm në një dëshmi apo provë të cilën nuk ka mundur ta kundërshtoj i dënuari e as mbrojtësi i tij përmes marrjes në pyetje të asnjë faze të procedurës penale. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 338,

paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. dhe paraburgimin paragrafin 3. të KPP-së, duke lexuar deklaratën e të dëmtuarit të dhënë në polici me datën 26.10.2016, deklaratë kjo që është lexuar pa pajtimin e palëve në procedurë dhe është kundërshtuar nga mbrojtësi i të dënuarit dhe i dënuari, e që vërtetohet nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 13.10.2021, ku palët kundërshtuan leximin e deklaratës së të dëmtuarit. Kjo deklaratë e të dëmtuarit është lexuar në kundërshtim me dispozitën e nenit 338, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, në bazë të cilës deklaratë i dënuari është shpallur fajtor. Gjykata e shkallës së parë këto fakte i mori si të vërtetuara edhe pse është detyrim i saj që, sipas dispozitës së nenit 329 të KPP-së të nxjerrë prova për vërtetimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave që janë objekt i akuzës, kurse sipas nenit 361 të KPP-së, gjykata duhet ta bazojë vendimin vetëm në faktet dhe provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, ndërkaq në këtë çështje penale gjykata i ka lexuar deklaratën e të dëmtuarit pa pajtimin e palëve e në kundërshtim me dispozitën e nenit 338, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, e po ashtu i ka lexuar edhe provat tjera materiale. Në këtë mënyrë, edhe pse është detyrim i gjykatës të vlerësojë çdo provë dhe të nxjerrë përfundime të qarta, gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e sipërpërmendura, duke i marrë të gjitha ato si fakte të vërtetuara, gjë që është në kundërshtim me rregullat e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, duke paragjykuar kështu çështjen penale, pa i nxjerrë provat e nevojshme, siç është parashikuar në dispozitat ligjore për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.315/2022, i datës 17.08.2022**

A K T GJ Y K I M

Me rastin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit Xh.Sh., anulohet aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.125/2019, i datës 31.01.2022, dhe lënda i kthehet kësaj gjykate në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi se aktgjykimi i kundërshtuar përmban dyshim të konsiderueshëm për saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara, për shkak të cilave, me rastin e kërkesës së paraqitur, e në bazë të nenit 439 të KPP-së, i njëjti duhet të anulohet.

Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, në përshkrimin e veprimeve inkriminuese të dënuarit është cekur se ai e ka goditur të dëmtuarin me "bokser të hekurt" duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor dhe se edhe kualifikimi ligjor nga neni 188, paragrafi 1. lidhur me paragrafin 1. 1 të KPRK-së, i përgjigjet këtij përshkrimi faktik.

Megjithatë, i dëmtuari A.M. ka deklaruar se i dënuari e ka goditur me grusht, por jo me bokser të hekurit. Asnjëri prej dëshmitarëve të dëgjuar nuk ka deklaruar se goditja është bërë me bokser të hekurit dhe ky mjet nuk përmendet në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë.

Bokser i hekurit është një mjet i cili ngjitet në pjesën e jashtme të grushtit, aty ku fillojnë gishtat, përdoret për të qëlluar tjetrin dhe paraqet mjet me të cilin mund të shkaktohen lëndime të rënda trupore. Pikërisht mjeti i përdorur për të kryer veprën penale është veprim i cili veprën bazë të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188, paragrafi 1. të KPRK-së e bënë të cilësuar dhe kualifikimin juridik e shndërron në këtë vepër penale, por nga neni 188, paragrafi 2. të KPRK-së, për të cilën ligji parasheh dënim më të rëndë.

Pasi që në rastin konkret ekziston dyshimi i konsiderueshëm për saktësinë e këtij fakti vendimtar, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore, u vendos që aktgjykimi i formës së prerë të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, në të cilin duhet të sqarohet përdorimi eventual i bokserit të hekurit nga i dënuari dhe në bazë të vërtetimit të saktë dhe të plotë të këtij fakti të merret vendim i ligjshëm.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.374/2021, i datës 04.11.2021**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit F.G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, 2019:287841, i datës 21.01.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.175/2021, i datës 01.07.2021 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës konstaton se qëndrojnë pretendimet e të mbrojtësit të dënuarit. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12 lidhur me nenet 370 dhe 365 të KPP-së.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale konsistojnë në atë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, njëherit i njëjti nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, ndërsa arsyet të cilat janë dhënë, janë të pakta dhe tërësisht të paqarta.

Nga dispozitivi i aktgjykimit assesi nuk mund të kuptohet se cilat qenkan ato veprime inkriminuese të të dënuarit, dhe në çfarë mënyre janë sajuar tiparet e veprës penale të përshkruara në dispozitiv kur faktet juridike relevante kanë një përmbajtje krejtësisht tjetër dhe aktgjykimi nuk përmban arsyet për faktet qenësore dhe ato të cilat janë dhënë janë të pakta dhe të paqarta, të pakuptueshme, shkelje këto që aktgjykimin e bëjnë tërësisht të paqëndrueshëm. Derisa, në dispozitivin e aktgjykimit, të dënuarit i përshkruhen veprimet e veprës penale të ngacmimit nga neni 181, paragrafi 1. lidhur me paragrafin 4. të KPRK-së, nga shkresat e lëndës me provat e administruara, Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund ta merr si qëndrueshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur elementet e veprës penale sipas kualifikimit të kësaj vepre penale.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare dhe ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyet e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e procesverbaleve për deklarimet e të dëmtuarës dhe mbrojtjes së të dënuarit.

Nga arsyetimi i aktgjykimit rezulton se gjykata e shkallës së parë, përveç që ka shënuar përmbajtjen e deklaratës së të dëmtuarës dhe mbrojtjen e dhënë nga i dënuari në arsyetimin e aktgjykimit, nuk jepen arsye përmbajtësore lidhur me administrimin e këtyre provave dhe nuk bëhet vlerësimi i tyre në kontekst të provuarit të qartë të këtyre dëshmive dhe vërtetimit të drejtë të ekzistimit apo mosekzistimit të veprës penale për të cilën i dënuari ngarkohej sipas aktit akuzues.

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së dhe me të njëjtën shkelje është i përfshirë edhe aktgjykimi i shkallës së dytë, me të cilën e njëjta nuk është mënjanuar.

Nga këto arsye u vendos që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet dhe aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.259/2019, i datës 05.09.2019**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.Sh., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1870/2018, i datë 12.02.2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.568/2019, i datës 17.07.2019 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1870/2018, e datës 12.02.2019, të dënuarin B.Sh., duke aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 327, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, si dhe dënim me gjobë në lartësi prej pesëqind (500) euro, kurse dënimin e shqiptuar me burgim ia ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej katërmijë (4000) euro, ashtu që nëse

dënimi i zëvendësuar me gjobë nëse nuk mund të paguhet i njëjti do të i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.568/2019, të datës 17.07.2019, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit për zëvendësimin e dënimit të shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj në dënim me gjobë në shumë prej katërmijë (4000) euro dhe në rast të pamundësisë së pagesës së dënimit me gjobë rikthimin e dënimit me burgim, paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.2. të KPP-së.

Kjo mënyrë e zëvendësimit të dënimit të shqiptuar është bërë në zbatim të dispozitës së nenit 47 të KPRK-së, mirëpo, përkundër zëvendësimit të dënimit në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është theksuar se në rast se dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mund të paguhet, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

Sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, mënyra e tillë e zëvendësimit të dënimit është në kundërshtim me dispozitën e nenit 47 të KPRK-së, meqë në momentin e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë, dënimi me burgim suspendohet dhe hyn në fuqi dënimi me gjobë, kurse në rast të pamundësisë së pagesës së gjobës së shqiptuar duhet të aplikohen dispozitat e dënimit me gjobë, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 46 të KPRK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se zëvendësimi i dënimit në këtë mënyrë e bën të paqartë dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së dhe hap dilema se cili dënim duhet të ekzekutohet, dënimi me burgim i caktuar, dënimi me gjobë i

zëvendësuar apo dënimi me burgim në rast të pamundësisë së pagesës së dënimit me gjobë të shqiptuar. Pasi që edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka eliminuar shkeljen e tillë, edhe ky aktgjykim përmban shkelje të njëjtë të dispozitave të procedurës penale dhe për këtë arsye u anuluan dy aktgjykimet e instancave më të ulëta, duke u bazuar në ekzistimin e kësaj shkelje të pretenduar.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.471/2021, i datës 19.01.2022**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit M.K., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.531/2021, i datës 06.10.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.450/2021, i datës 24.11.2021 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se janë të bazuara pretendimet e paraqitura se gjatë procedurës penale është shkelur dispozita e procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të të KPP-së, pasi që gabimisht është zbatuar dispozita e nenit 248 paragrafi 1. të KPP-së.

Bazuar në shkresat e lëndës dhe posaçërisht procesverbali i shqyrtimit fillestar del se i dënuari kishte bërë pranimin e fajësisë dhe pas konstatimit se janë plotësuar kriteret e pranimit të fajësisë sipas nenit 248 të KPP-së, ishte vazhduar me shqiptimin e dënimit. Kurse me aktgjykimin e gjykatëse së shkallës së parë ishte konstatuar fakti se në rastin konkret ishin plotësuar kriteret për

pranimin e fajësisë të përcaktuara me dispozitën e nenit 248, paragrafi 1. të KPP-së, mirëpo me këtë rast sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e pranimit të fajësisë nuk ishin plotësuar kriteret e kërkuara ligjore. Dispozita e nenit 248, paragrafi 1. të KPP-së ka përcaktuar se: "Kur i pandehuri pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 246 ose 247 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse:1.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit: 1.2. pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës: 1.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri: dhe 1.4. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike". Nga leximi i dispozitës ligjore nënkuptohet se për tu bërë pranimi i fajësisë të gjitha kriteret duhet të plotësohen në mënyra kumulative dhe në të kundërtën, pranimi i fajësisë nuk do të ishte në harmoni me dispozitën ligjore. Kurse, në rastin konkret nga përmbajtja e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rrjedh se përkundër faktit se i dënuari ishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 317, paragrafi 1. të KPRK-së, nuk ishte përshkruar elementi esencial i veprimit të tij se në rastin konkret, si ishte manifestuar përdorimi i forcës. Për më tepër, përdorimi i forcës, përkatësisht mënyra e përdorimit të forcës apo kanosjes duhet të jetë i natyrës serioze dhe për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, që paraqesin elementet e veçanta dhe tipare dalluese të kësaj vepre penale në raport me ndonjë vepër tjetër penale. Përkundër faktit të pakontestueshëm se i dënuari është deklaruar fajtor, megjithatë, është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë që pranimin e fajësisë ta vlerësoj në dritën e dispozitës ligjore të nenit 248, paragrafi 1. të KPP-së, të cilat shkelje nuk janë eliminuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe me këtë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe kthimin e çështjes në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.153/2020, i datës 11.05.2021**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës së mbrojtësit të të dënuarit N.H. për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.233/2020, i datës 14.08.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.1109/202, i datës 08.02.2021, anulohen dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.233/2020, të datës 14.08.2020, i dënuari N.H. është shpallur fajtor për veprën penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 189, paragrafi 1.3. të KPRK-së.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA.1.nr.1109/2020, të datës 08.02.2021, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pas shqyrtimit të shkresave të kësaj çështje juridiko penale, vlerëson se pretendimet e mbrojtjes janë të bazuara, për faktin se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i paqartë, kundërthënës dhe në kundërshtim me vetveten dhe arsyetimin e dhënë.

Në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar nuk theksohet personi i dëmtuar ndaj të cilit se i dënuari e ka kryer veprën penale, pastaj, nuk theksohet po ashtu mjeti me të cilin është kryer vepra penale, andaj, edhe si i tillë aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit në përshkrimin faktik përkitazi me faktet vendimtare është kundërthënës në vetvete, e që aktgjykimin e bëjnë të paqartë dhe të pakuptueshëm.

Nga arsyet që u parashtruan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës i anuloi aktgjykimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe urdhërojë mbajtjen e rigjykimit në gjykatën e shkallës së parë, me vërejtjen që në rigjykim dhe adiministrimit të gjitha provave, evitimit të shkeljeve, vlerësimit të tyre veç e veç dhe në tërësi, të nxirren konkluzione të drejta të bazuara në prova të administruara e pastaj merret një vendim përkatës në këtë çështje juridiko-penale.

9.3.4. Arsyetimi i aktgjykimit

Arsyetimi i aktgjykimit është pjesë tejet e rëndësishme e aktgjykimit dhe në të, gjykata duhet që të përfshijë arsyet mbi bazën e të cilave e ka dhënë aktgjykimin.

Në nenin 369, paragrafi 6. të KPP-së, është parashikuar se *"gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit".* Kjo nënkupton që në arsyetim të aktgjykimit duhet të paraqiten arsye për fajësinë e të akuzuarit, veprën penale, dispozitat përkatëse ligjore, dënimet, konfiskimin, paraburgimin, shpenzimet e procedurës penale, si dhe çështjet tjera më specifike që do të paraqiten më poshtë.

Paraqitja e arsyeve ka të bëjë me arsyet faktike dhe juridike. Arsyetimi i anës faktike mbështetet në çmuarjen e lirë të provave, ku gjykata duhet që të analizojë çdo provë veç e veç, duke përfshirë tërësinë e tyre, raportin ndërmjet provave dhe të shprehet qartë se cilat prova dhe për çfarë arsyesh i ka pranuar ose nuk i ka pranuar.[111] Kurse, arsyetimi i anës juridik i referohet interpretimit dhe konkretizimit të dispozitave ligjore përkatëse.

Gjendja e vërtetuar në dispozitiv të aktgjykimit patjetër duhet të arsyetohet, duke e parashtruar procesin logjik nëpërmjet të të cilit është arritur deri te bindja e caktuar. Në këtë drejtim, sipas zgjidhjes së përcaktuar në nenin 369, paragrafi 7. të KPP-së, gjykata duhet që të paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë duhet të vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, në arsyetimin e aktgjykimit duhet që gjykata në mënyrë të veçantë të vlerësojë: a) saktësinë e provave kundërthënëse, b) arsyet e mos miratimit të

[111] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, fq. 864.

propozimit konkret të palëve dhe c) arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike.

Me fjalë të tjera, arsyetimi i aktgjykimit duhet të jep sqarime për krejt atë që është vendosur në dispozitiv. Posaçërisht duhet të theksohet se cili fakt dhe rrethanë me çfarë prove është provuar, e jo vetëm shkurtimisht të numërohen provat e të paraqitet përmbajtja e tyre.[112]

Në rastet kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.[113] Në nenin 70, paragrafët 2. dhe 3. të KPRK-së, janë parashikuar rrethanat të cilat gjykata duhet t'i marrë parasysh gjatë matjes së dënimit, si rrethanat rënduese, ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Sipas këtyre dispozitave ligjore, përveç këtyre rrethanave që janë cekur në mënyrë taksative, gjykatës i është dhënë mundësia që në çdo rast konkret të marrë parasysh edhe rrethana të tjera, të cilat mund të ndikojnë që të caktohet një dënim më i rreptë apo më i butë. Në kuadër të këtyre rrethanave, gjenden rrethanat objektive, që i referohen veprës penale dhe rrethanat subjektive, që i referohen kryesit. Me rrethana rënduese kuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i rëndë brenda kufijve të parashikuar me ligj për atë vepër penale, ndërsa me rrethana lehtësuese kuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i butë, gjithashtu brenda kufijve të përcaktuar me ligj.[114]

Të gjitha rrethanat, si rënduese, ashtu edhe ato lehtësuese, të cilat janë marrë për bazë nga gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim duhet që të paraqiten në arsyetim të aktgjykimit.

Gjithashtu, gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim më të rëndë se dënimi i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitues ose konfiskimin e pasurisë së fituar përmes kryerjes së veprës penale.

Sa i përket çështjes së konfiskimit, aktgjykimi duhet të përmban arsyetimin për konfiskimin e secilit send për të cilën urdhërohet konfiskimi dhe arsyetimin për secilin send për të cilën nuk urdhërohet konfiskimi.

---

[112] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: E drejta e procedurës penale, fq. 396.
[113] Neni 369, paragrafi 8. i KPP-së.
[114] SHALA, AFRIM: Hyrje në të drejtën penale, fq. 259-260.

Në rastet kur i akuzuari lirohet nga akuza, në arsyetim veçanërisht shënohet arsyeja e paraparë në nenin 363 të KPP-së, mbi bazën e të cilit është marrë aktgjykimi lirues, kurse, në arsyetimin e aktgjykimit me të cilin refuzohet akuza, gjykata nuk e vlerëson çështjen kryesore, por kufizohet vetëm në arsyet e refuzimit të akuzës.[115]

Arsyetimi i aktgjykimit është shumë i rëndësishëm dhe kualiteti i vendimeve gjyqësore varet nga kualiteti i arsyetimit.

Arsyetimi i aktgjykimit ju mundëson palëve, përfaqësuesve të tyre dhe publikut të gjerë që të njoftohet me arsyet se pse gjykata ka vendosur në një mënyrë të caktuar.

Rëndësia e arsyetimit shihet edhe nga fakti se mos hartimi i aktgjykimit me dispozitat ligjore që i referohen arsyetimit të aktgjykimit, nga neni 369, paragrafët 1., dhe 6.-11. të KPP-së paraqet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, e cila shkelje në shumë raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës ka qenë arsye për anulimin e aktgjykimeve dhe kthimin e rastit në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Arsyetimi i aktgjykimit duhet shikuar edhe si detyrë të gjykatës që buron nga dispozitat ligjore të brendshme, por nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, siç do të elabrohet edhe në vijim të këtij punimi.

GJEDNJ-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka theksuar se *"vendimet e gjykatave duhet të paraqesin në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ato janë bazuar"*.

Njëkohësisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, çështjen e arsyetimit të vendimit gjyqësor duhet shikuar edhe nga aspekti i të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor i përcaktuar me nenin 6, paragrafi 1. të KEDNJ-së.

Tani arsyetimi i vendimeve gjyqësore përbën një standard në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt, sipas së cilit interesat e drejtësisë nuk mund të arrihen nëse vendimi gjyqësor nuk është i arsyetuar.

[115] Neni 369, paragrafët 10.-11. të KPP-së.

Detyrimi për të paraqitur arsye në një vendim gjyqësor siguron të drejtën për një proces transparent dhe siguron publikun që vendimi gjyqësor nuk është arbitrar dhe është në harmoni me parimet kushtetuese dhe ligjore.

Gjithashtu, vendimet gjyqësore të arsyetura i shërbejnë qëllimit për t'u demostruar palëve se janë dëgjuar, si dhe i detyrojnë gjyqtarët që arsyetimet e tyre t'i bazojnë në argumente objektive. Vendimi gjyqësor i arsyetuar është i rëndësishëm edhe për faktin se përmes tij i mundësohet çdo personi që ta shfrytëzojë të drejtën në ankesë, duke ju referuar edhe arsyeve që janë paraqitur në atë vendim.

Megjithatë, duhet theksuar se detyrimi i gjykatave që të paraqesin arsye në vendimet përkatëse gjyqësore, nuk nënkupton përgjigje të hollësishme në çdo argument.

Vëllimi dhe shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshon varësisht nga natyra e vendimit gjyqësor dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast veç e veç.[116]

Janë argumentet thelbësore të palëve që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.[117]

Në shtetet e së drejtës anglosaksone, me rastin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore zbatohet metoda e ashtuquajtur "IRAC".

Gjyqtarët gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore, përmes kësaj metode, i strukturojnë, organizojnë dhe i trajtojnë çështjet, si ligjore, ashtu edhe faktike, duke përdorur një metodologji dhe analizë e cila kalon nëpër disa etapa apo faza.

IRAC është një shkurtesë e fjalëve *"Issue, Rule, Application, Conclusion"*, që në gjuhën shqipe përkthehet:

"Çështja/Problemi, Rregullat/Dispozitat, Aplikimi/Zbatimi dhe Konkuzioni/Përfundimi".

---

[116] Rasti *"Hadjianastassiou kundër Greqisë"*, aktgjykimi i datës 16.12.1992, paragrafi 33.

[117] Rasti *"Hiro Balani kundër Spanjës"*, aktgjykimi i datës 09.12.1994, paragrafi 27; Rasti *"Van de Hurk kundër Holandës"*, aktgjykimi i datës 19.04.1994, paragrafi 61; Rasti *"Higgins dhe të tjerët kundër Francës"*, aktgjykimi i datës 19.02.1998, paragrafi 42.

Një metodë e tillë e të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore përdoret edhe në disa gjykata ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe GJEDNJ-në, si dhe nga disa gjykata kushtetuese të shteteve të ndryshme.[118]

Sipas kësaj metode, procesi i të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore, në parim, kalon nëpër këto katër (4) etapa apo hapa:

Së pari, duhet që të identifikohet çështja apo problemi që duhet të adresohet dhe zgjidhet;

Së dyti, duhet që të identifikohen rregullat apo dispozitat ligjore (kushtetuese) që janë të rëndësishme zgjidhjen e çështjes apo problemit;

Së treti, duhet që të analizohet dhe përcaktohet nëse elementet e rregullave, përkatësisht dispozitave ligjore aplikohen ndaj fakteve të çështjes përkatëse gjyqësore dhe

Së katërti, duhet të paraqiten konkulzionet apo përfundimet në lidhje me aspektet e vendimmarrjes në çështjen e caktuar gjyqësore.

9.3.5. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e arsyetimit të aktgjykimit

Çështja e arsyetimit të aktgjykimin është trajtuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore.

Në vijim do të paraqiten disa raste që kanë të bëjnë me këtë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që ndërlidhet me arsyetimin e aktgjykimit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.447/2022, i datës 06.12.2022**

[118] Në përgjithësi, kjo metodë e të shkruarit dhe arsyetuarit të vendimeve gjyqësore zbatohet edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. https://gjk-ks.org/vendimet/

A r s y e t i m i

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit G.A. të paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara.

Kjo për faktin se aktgjykimi i lartcekur i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12. lidhur me nenin 370, paragrafi 7. të KPP-së, si dhe me shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e këtij aktgjykimi, ndërsa këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Në këtë drejtim, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë arsye në lidhje me vlerësimin e saktësisë së provave kundërthënëse, si dhe nuk janë paraqitur arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, me theks të veçantë në propozimet e mbrojtjes për dëgjimin e dy (2) dëshmitarëve të theksuar më parë.

Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 28.04.2022 (faqja 15) rezulton se mbrojtësi i të dënuarit, avokati J.I., i kishte propozuar trupit gjykues të gjykatës së shkallës së parë dëgjimin edhe të dy (2) dëshmitarëve dhe atë: A.M. dhe V.B., me pretendimin e mbrojtësit se nga këta dëshmitarë mund të vërtetohet alibia e të dënuarit. Ndërsa, nga po ky procesverbal, shihet se trupi gjykues e ka refuzuar një propozim të tillë të mbrojtësit, me arsyetimin se “në këtë rast nuk është precizuar koha e saktë se kur ka mundur eventualisht i akuzuari të qëndroj me dëshmitarët, por që janë përmendur vetëm datat e caktuara”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, natyrën e veprave penale, si dhe vetë deklarimin e të dënuarit, ky arsyetim i gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e dëgjimit të këtyre dy (2) dëshmitarëve nuk është bindës, andaj edhe si rezultat i kësaj, edhe është i papranueshëm.

Fillimisht, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se njëra prej të drejtave themelore të të pandehurit në procedurë penale është edhe “E drejta e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij,

në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës", e drejtë kjo, që përveç tjerash, është e garantuar edhe me nenin 6, paragrafi 3, pika d. të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga kjo dispozitë ligjore shihet se i pandehuri ka të drejtë që të thërras dhe të pyes edhe dëshmitarët në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës. Kjo e drejtë e të pandehurit në procedurë penale mund të kufizohet nga gjykata, vetëm në rastet e parashikuar me ligj, duke paraqitur arsye të qarta, të mjaftueshme dhe bindëse për një gjë të tillë.

Në nenin 258, paragrafi 2. të KPP, janë parashikuar situatat se kur mundet gjykata që të ndalojë marrjen e një prove.

Sipas kësaj dispozite ligjore Gjykata mund të ndalojë marrjen e provave, nëse:
2.1. marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt sepse çështja në fjalë është e njohur në vija të përgjithshme;
2.2. fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar;
2.3. prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme ose
2.4. kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën".

Në rastin konkret, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë i paraqitur në procesverbal të gjyqësor për refuzimin e propozimit të mbrojtësit për dëgjimin e dëshmitarëve A.M. dhe V.B., nuk gjen mbështetje në dispozitën e lartcekur ligjore.

Përveç kësaj, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur arsyet në lidhje me propozimin e lartcekur të mbrojtësit të të dënuarit për dëgjimin e dëshmitarëve, ashtu siç parashihet në nenin 370, paragrafi 7. të KPP ("Forma dhe përmbajtja e aktgjykimit me shkrim"). Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se "Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve,...".

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, si dhe duke e pasur parasysh se bëhet fjalë për një propozim thelbësor të mbrojtësit të të dënuarit në lidhje me shfrytëzimin e të drejtës për dëgjimin e dëshmitarëve, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykata e shkallës së parë është dashur që në arsyetim të aktgjykimit të saj të paraqes arsye të qarta dhe bindëse, se pse e ka refuzuar këtë

propozim të mbrojtësit të të dënuarit, e nuk është dashur që të mjaftohet që një gjë të tillë ta bëjë vetëm në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, edhe pse as arsyetimi i dhënë në këtë rast në këtë procesverbal nuk është bindës dhe i pranueshëm, për arsyet e cekura më lart.

Në mënyrë të njëjtë, është vepruar edhe me propozimin e mbrojtësit të të dënuarit për dërgimin e jaknës për ekzaminim në Agjencionin e Forenzikës, ku nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 31.05.2022 (faqja 2), gjykata e shkallës së parë e kishte refuzuar një propozim të tillë pa paraqitur asnjë arsyetim të qartë dhe bindës, jo vetëm në procesverbal, por as në arsyetim të aktgjykimit të saj.

Në anën tjetër, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor shihet se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të bëjë administrimin e provave materiale në mënyrën e parashikuar me ligj. Në ky procesverbal shihet se gjykata e shkallës së parë është mjaftuar me shikimin e tetëdhjetë (88) fotove, video-incizimeve të kamerave, formularë prone, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe fotoalbumit, mirëpo është dashur që të shqyrtohet edhe mundësia e administrimit të drejtpërdrejtë të provave materiale, në veçanti të jaknes dhe thikës, në mënyrë që më pastaj palët të kenë mundësi që edhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të bëjnë duke i ballafaquar dëshmitarët me këto provave materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka parasysh faktin se shpeshherë në praktikën gjyqësore provat materiale, në veçanti mjetet e kryerjes së veprës penale, administrohen në shqyrtim gjyqësor pa u sjellë fare në gjykatore, ngase edhe ashtu duke u bazuar në nenin 344, paragrafi 1. të KPP-së, është në diskrecionin e gjykatës që të vlerësoj nëse një gjë e tillë është e nevojshme apo jo. Mirëpo, në këtë rast, duke e pasur parasysh se mënyrën se i ka vepruar kryesi i veprave penale të grabitjes dhe me qëllim të nxjerrjes së konkluzioneve të drejta, gjykata e shkallës së parë është dashur që ta ketë në konsideratë edhe mundësinë e sjelljes së këtyre dy provave në gjykatore, për t'i parë palët, të dëmtuarit, dëshmitarët dhe vetë trupi gjykues, e nuk është dashur që të mjaftohen vetëm në shikimin e tyre në foto dhe në video-incizim të kamerave. Sjellja e këtyre dy provave në gjykatore do të mundësonte që më lehtë të bëhet krahasimi dhe identifikimi i tyre, ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsye se pse ka vepruar në këtë mënyrë.

Në lidhje me këtë çështje, në nenin 344, paragrafi 2. të KPP-së, është parashikuar se "Sendet që gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të shërbejnë për sqarimin e çështjes, mund t'i tregohen të akuzuarit, e në rast nevoje, edhe dëshmitarëve dhe ekspertëve".

Kurse, në nenin 336, paragrafi 1. të KPP-së është parashikuar e drejta e palës që t'ia paraqes provën materiale dëshmitarit dhe të njëjtit t'i parashtroj pyetje në lidhje me këtë provë materiale. Kështu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se "Pala mund t'i paraqesë dëshmitarit provën materiale dhe t'i parashtrojë pyetje dëshmitarit lidhur me atë provë materiale gjatë marrjes në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje ose rimarrjes në pyetje".

Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç është theksuar edhe më lart dhe këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, duke e kthyer këtë çështje penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke e vlerësuar në mënyrë të veçantë edhe një herë propozimin e mbrojtjes për dëgjimin e dy (2) dëshmitarëve të lartcekur, si dhe duke paraqitur arsye të qarta dhe bindëse në lidhje me çdo refuzim apo mos aprovim të propozimeve të palëve, në kuptim të mënyrës së administrimit të provave materiale.

Pas administrimit të serishëm të provave, gjykata e shkallës së parë të nxjerr konkluzione të caktuara, mbi bazën e të cilave mandej të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.36/2023, i datës 02.05.2023**

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës pas mbajtjes së seancës së kolegjit ka ardhur në përfundim se pretendimet mbrojtësve të të dënuarve E.I. dhe P.I. janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i lartcekur i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6. dhe 7. të KPP, ndërsa me shkelje të njëjta është përfshirë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, në kuptim të vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe mos paraqitjes së arsyeve të mjaftueshme në lidhje me këto pretendime.

Gjykata Supreme e Kosovës, fillimisht e sheh të nevojshme që të sqaron se me nenin 369 të KPP-së është parashikuar në përgjithësi "Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim", ku në paragrafin 6. të këtij neni është parashikuar se "Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit", ndërsa në paragrafin 7. të këtij neni është parashikuar se "Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij".

Bazuar në këto dispozita ligjore, rezulton se gjykata duhet që në arsyetimin e aktgjykimit të paraqes arsyet për çdo pikë të aktgjykimit (paragrafi 6. i nenit të lartcekur), ndërsa paraqitja e arsyeve ka të bëjë si me aspekte faktike, ashtu edhe me aspekte juridike të rastit përkatës.

Aspekti faktik do të duhej të përfshinte arsyetime të qarta dhe të plota në lidhje me faktet, përkatësisht faktet relevante juridike, duke paraqitur se arsye se cilat fakte konsiderohen të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe duke paraqitur arsye se pse ka ardhur deri tek përfundimet e tilla.

Kurse, aspekti juridik i referohet interpretimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse materiale, që i përkatësin si veprës penale (në tërësinë e saj), ashtu edhe përgjegjësisë penale të të dënuarit, por jo vetëm. Një aspekt i tillë, do të duhej që t'i referohet edhe interpretimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse procedurale.

Në këtë drejtim, mos paraqitja e arsyeve në aktgjykim në lidhje me aspektet e theksuara më lartë sipas dispozitave të lartcekura ligjore, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 7. të KPP. Përveç kësaj, edhe në Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale, një gjë e tillë është konsideruar shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale (neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12.).

Nën dritën e këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që në arsyetimin e aktgjykimit të saj të paraqes arsye të qarta dhe të mjaftueshme në lidhje me faktet relevante juridike, e që rezulton se këtë të rast, aktgjykimi në fjalë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje këto të përmendura më lart.

Në këtë drejtim, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me armën "Ekol Special", model 99, e kalibrit 9mm, me numër serik "EV-10221629", e ridizajnuar për fishekët 7.65x17mm, me mbushje të barotit, e cila armë kishte qenë në vendin e ngjarjes, pranë vendit ku kishte qenë i shtrirë i ndjeri L.B.

Në lidhje me këtë rrethanë, gjykata e shkallës së parë vetëm është mjaftuar që të thekson se nuk ka arritur që të vërtetojë rrethanën se i ndjeri L.B. të ketë shtënë me këtë armë në drejtim të të dënuarit E.I., pa bërë një vlerësim të mirëfilltë dhe të gjithanshëm të të gjitha provave që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se një arsyetim i tillë i gjykatës së shkallës së parë është tejet i mëngët, duke i pasur parasysh provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, në veçanti konstatimet dhe mendimet e ekspertëve mjeko-ligjor dhe të balistikës.

Në lidhje me këtë aspekt, eksperti mjeko-ligjor Dr.N.U., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pohuar se në gjendje çfarë ka qenë tani i ndjeri nuk ka mundur të ndërmerr ndonjë veprim që bazohet në forcën fizike të personit që pëson lëndime të tilla, pasi që në përgjithësi është punë e disa sekondave kur fillon humbja e vetëdijes, për faktin se kjo është rezultat i dëmtimeve të shumëfishta traumatike të shoqëruara me gjakderdhje masive trurore, ku pason humbja e orientimit në kohë dhe hapësirë-në sekondat e parë. Në fund, eksperti ka sqaruar se e shtëna ka ardhur nga ana e djathtë e tani të ndjerit

dhe pozicioni i tij ka qenë vertikal apo në këmbë dhe logjikisht edhe pozicioni i personit që ka shtënë në drejtim të tij ka qenë i njëjtë-në këmbë.

Kurse, nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, si dhe nga fotot që gjenden në shkresa të lëndës shihet se në vendin e ngjarjes - në rrugën "Hys Popova", përveç tjerash janë gjetur edhe 2 (dy) gëzhoja - të evidentuara si: Dëshmia VN#1 dhe Dëshmia VN#2, mandej 1 (një) brisk me dorezë ngjyrë të zezë me gjatësi të tehut 5.5 cm, e cila është evidentuar si Dëshmia VN#4, si dhe 1 (një) pistoletë me numër serik EV-10121629, e evidentuar si Dëshmia VN#5.

Gjithashtu, pjesë përbërëse e provave materiale që vlen të përmenden janë edhe : Dëshmia VN#9 që është një pistoletë me karikator të zbrazët me mbishkrimin "Zoragy" 02190 400675, si dhe Dëshmia L.B# - 1 (një) predhë fisheku e nxjerrë nga trupi i të ndjerit L.B..

Në anën tjetër, ekspertja e balistikës H.H., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se qëndron pranë raportit të ekspertimit balistik në përpiluar me shkrim.

Përmes këtij raporti të ekspertimit vërtetohet se:

- Gëzhoja e kalibirit 7.65x17 mm nga dëshmia VN#1 është gjuajtur nga pistoleta "Zoragy", model 2906B, e kalibrit 7.65x17mm, me numër serik 190400675;

- Gëzhoja e kalibrit 7.65x17 mm nga dëshmia VN#2 është gjuajtur (shkrepur) nga pistoleta "Ekol Special", e kalibrit 7.65x17 mm, me numër serik Ev101201629;

- Dëshmia e evidentuar me L.B#5, që është një plumb i dëmtuar i kalibrit 7.65x17 mm është gjuajtur shkrepur nga pistoleta "Zoragy", model 2906B, e kalibrit 7.65x17 mm, me numër serik 190400675.

Duke u bazuar në këtë raport të ekspertimit balistik, shihet se gëzhojat që janë gjetur në vendin e ngjarjes janë shkrepur nga dy (2) armët e theksuara më lart, duke përfshirë edhe armën "Ekol Special", e cila është gjetur pranë vendit ku ka qenë i shtrirë i ndjeri L.B..

Në lidhje me këtë armë, arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë janë të mangëta, kështu që edhe përfundimet e kësaj gjykate sa i përket kësaj çështje kanë mbetur të pa ndriçuara dhe të pa sqaruara mjaftueshëm.

Përveç sqarimit dhe arsyetimit të rrethanave në lidhje me armën e lartcekur, gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të sqaron dhe arsyeton mjaftueshëm edhe njërin prej elementeve kualifikuese të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.5. të KPRK-së për të cilën është shpallur fajtor i dënuari E.I., që i referohet rasteve kur "kryesi e privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë".

Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë shihet se i dënuari E.I. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1. dhe 1.5. të KPRK-së, mirëpo në dispozitiv të këtij aktgjykimi nuk është sqaruar mjaftueshëm se si ka ardhur deri tek rreziku i jetës së të dëmtuarve R.G. dhe B.S., ndërsa në arsyetim nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me këtë element kualifikues dhe nëse rreziku ndaj të dëmtuarve kishte qenë konkret.

Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se për të ardhur në shprehje elementi kualifikues i veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 173, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.5. të KPRK-së, është e domosdoshme që të shkaktohet rrezikshmëri konkrete e një ose më shumë personave të tjerë, pasi që jo çdo lloj i rrezikut mund të justifikoj një element të tillë.

Se a është fjala për rrezikshmëri konkrete, këtë më së miri dhe më së lehti do të mund ta vërtetonte gjykata e shkallës së parë, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret.

Me qëllim të vërtetimit të këtyre të dy rrethanave (çështja e armës dhe rrezikshmërisë konkrete), gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që të mjaftohet me konstatimin se "Të gjitha palët në procedurë, si dhe prokurori i çështjes janë deklaruar se nuk e shohin të arsyeshme që lidhur me këtë çështje të bëhet rikonstruimi i vendit të ngjarjes", pasi si me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale (neni 329, paragrafi 4.), ashtu edhe tani me nenin 325, paragrafi 4. të KPP-së, është parashikuar mundësia e administrimit të provave "ex officio" nga ana e gjykatës. Por, që me një përkushtim maksimal, është dashur që të shqyrtohet edhe mundësia e rikonstruksionit të veprës penale, me qëllim të sqarimit të drejtë dhe të plotë të të gjitha rrethanave të rastit, në veçanti çështjes së armës së lartcekur dhe rrethanave se si është shkrepur nga dy (2) armët e theksuara më lart, pozicionet e personave të përfshirë, si dhe shumë çështjeve tjera të rëndësishme.

Edhe sa i përket arsyetimit të elementeve të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale nga neni 380, paragrafi 1. lidhur me paragrafin 2., nën-paragrafi 2.1. të KPRK-së për të cilën është shpallur fajtor P.I., gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me paraqitjen e disa elementeve faktike të ngjarjes, pa bërë në një analizë dhe pa paraqitur arsye të mjaftueshme nëse në rastin konkret janë përmbushur të gjitha këto elemente.

Dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme, arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me rrethanat rënduese, sa janë kundërthënës, janë edhe të pakuptueshme, e që si rezultat i kësaj janë edhe të papranueshme, pasi që me rastin e matjes së dënimit janë marrë për bazë si rrethana rënduese, edhe elementet e figurës së veprave penale përkatëse.

Kështu, me rastin e matjes së dënimit ndaj të dënuarit E.I., janë marrë për bazë shkalla e lartë e pjesëmarrjes dhe e dashjes për të kryer veprën penale dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, pa dhënë sqarime dhe shpjegime konkrete se në çka konsistojnë këto rrethana.

Në anën tjetër, me rastin e matjes së dënimit ndaj të dënuarit E.I., si rrethana rënduese janë marrë për bazë edhe elementet e figurës së veprës penale, pasi që gjykata e shkallës së parë, në lidhje me këtë çështje thekson: "...duke shtënë nga pas tani në të ndjerin dhe rrezikuar edhe të tjerët që kanë qenë afër tij, mosha e tani të ndjerit-i mitur, shkalla e dëmit të shkaktuar, duke përfshirë edhe vdekjen e tani të miturit".

Gjithashtu, edhe sa i përket të dënuarit P.I., janë marrë për bazë si rrethana rënduese elementet e figurës së veprës penale, pasi që gjykata e shkallës së parë e konsideron si rrethanë rënduese "dashjen për t'i dhënë ndihmë të dënuarit të parë E.I.,".

Edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të rithekson se elementet e figurës së veprave penale nuk mund të trajtohen, përkatësisht të merren për bazë edhe si rrethana rënduese apo lehtësuese me rastin e matjes së dënimit.

Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç është theksuar edhe më lart dhe këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Përkundrazi, edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban një arsyetim të përgjithësuar dhe të mangët, duke mos i elaboruar dhe shtjelluar pretendimet thelbësore të paraqitura në ankesa, të cilat edhe nuk kanë qenë të pakta, si dhe duke i anashkaluar dhe konsideruara si të drejta dhe të ligjshme konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, edhe pse të njëjtat kanë qenë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që t'i aprovoj si të bazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve E.I. dhe P.I., ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat janë përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktoj edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitoj të gjitha shkeljet e lartcekura, ku pas administrimit të serishëm të të gjitha provave, duhet të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që t'i evitoj të metat e theksuara me parë, përveç tjerash edhe:

- duke sqaruar dhe arsyetuar mjaftueshëm dinamikën e rrjedhjes së ngjarjes ditën kritike, në veçanti se si ka ardhur deri tek shkrepja nga dy armët e theksuara më lart, se kush ka shkrepur dhe në cilin moment, si dhe të gjitha rrethanat tjera që janë të rëndësishme për vendosjen e drejtë të kësaj çështje penale. I mbetet në vlerësim të gjykatës së shkallës së parë se si dhe me cilat prova do ta vlerësoj një dinamikë të tillë të rrjedhës së ngjarjes, duke ja lënë në kompetencë të saj që të shqyrtoj edhe mundësinë e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes, me pjesëmarrjen e ekspertëve të mjekësisë ligjore dhe të balistikës, si dhe të gjithë personave të tjerë, ashtu siç parashihet me ligj, nëse vlerësohet i arsyeshëm dhe i nevojshëm një veprim i tillë;

- të sqarohet dhe arsyetohet mjaftueshëm edhe aspekti i rrezikshmërisë konkrete në drejtim të të dëmtuarve R.G. dhe B.S., siç është theksuar më lart;
- që vendimin e saj përfundimtar ta përpiloj sipas dispozitave përkatëse ligjore, duke paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha fakteve vendimtare, e në këtë rast edhe sa i përket rrethanave relevante me rastin e matjes së dënimeve, si dhe
- sipas nevojës dhe arsyeshmërisë të vlerësohen edhe pretendimet tjera të palëve, në drejtim të respektimit dispozitave përkatëse ligjore që rregullojnë procedurën penale.

Duke e pasur parasysh ndërlidhjen reciproke të veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor të dënuarit E.I., P.I., E.M. dhe L.B., atëherë Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në nenin 436, paragrafi 2. të KPP-së, vendosi që të anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, edhe sa i përket të dy dënuarve të fundit, pavarësisht se të njëjtit nuk kanë paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.191/2022, i datës 18.07.2022**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarës G.C. dhe mbrojtësit të dënuarit A.F., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për të Mitur, PM.nr.272/2018, i datës 04.10.2021, si dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për të Mitur, PAKR.nr.523/2021, i datës 16.02.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim para një trupi tjetër gjykues.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, me aktgjykimin PM.nr.272/2018, të datës 04.10.2021, ka shpallur fajtor të dënuarën G.C. dhe A.F. për shkak të veprës penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, nga neni 235, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPK-së dhe e ka gjykuar secilin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegji, pasi i shqyrtoi shkresat e kësaj çështje penale në kuptim të dispozitës së nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë të bazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke i vlerësuar pretendimet e cekura në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe bazuar në shkresat e kësaj çështje penale, gjeti se janë të bazuara pretendimet të paraqitura nga mbrojtësit e të dënuarve dhe se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kushtëzojnë anulimin e tyre. Kështu, nga dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë thuhet se " i kanë ndihmuar tani të dënuarit L.B., në kryerjen e veprës penale të dhunimit, duke i krijuar kushtet për kryerjen e kësaj vepre", por në aktgjykim nuk është dhënë arsyetim dhe nuk është specifikuar mënyra se në çka konsiston krijimi i kushteve, respektivisht dhënia e ndihmës kryesit të veprës penale nga ana e të dënuarve G.C. dhe A.F. Në këtë aktgjykim i cili në fakt është aktgjykim pothuajse identik me aktgjykimin i cili është anuluar nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin PML.nr.250/2018, të datës 06.11.2018, është udhëzuar gjykata e shkallës së parë se si duhet të veprojë dhe ku qëndrojnë arsyet për anulimin e këtij aktgjykimi. Megjithatë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë i cili tani është në shqyrtim, është aktgjykim identik dhe në të njëjtin përsëriten shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së dhe të njëjtat shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së parë e as nga gjykata e shkallës së dytë, andaj edhe u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë konform vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, ashtu që pasi të administrojë provat ekzistuese dhe sipas nevojës edhe prova të tjera, si dhe pas vlerësimit të të njëjtave të merr vendim meritor lidhur me këtë çështje penale. Gjykata e shkallës së parë duhet të vërtetojë veprimet e të dënuarve dhe rolin e tyre në drejtim të kryerjes së veprës penale, respektivisht ndihmës së dhënë kryesit për kryerjen e veprës penale. Më saktësisht, gjykata e shkallës së parë duke iu referuar dispozitës së nenit 33 të KPK-së, të përcaktojë saktësisht se cilat janë veprimet inkriminuese të dënuarve të cilat përbëjnë elementet e figurës së veprës penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet në ndihmë, nga neni 235, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 3 të KPK-së.

Duhet të theksohet se konform dispozitës së nenit 33 të KPK-së, ndihma për të kryer një vepër penale përfshinë, por nuk kufizohet: në dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimin paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë duhet të saktësojë se cilat veprime inkriminuese të të dënuarve përfshihen në një nga elementet e cekura në dispozitën e nenit 33 të KPK-së, dashjen e të dënuarve për dhënien e ndihmës personit tjetër për kryerjen e veprës penale dhe për këtë të jep arsyetim ligjor.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që të urdhërojë që në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë të vendosë një trup tjetër gjykues.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.71/2022, i datës 28.02.2022**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të ...., anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, PM.nr.42/2021, i datës 23.03.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAM.nr.85/2021, i datës 10.11.2021 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses të miturit L.L. në mes tjerash pretendohet se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar me pranimin e fajësisë, të cilin gjykata e ka aprovuar, por nuk janë administruar prova për personalitetin e të miturit konform neni 13 të KDM-së.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se siç rezulton nga shkresat e lëndës procesverbali i shqyrtimit gjyqësor dhe aktvendimi i kundërshtuar, gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në pajtim me nenin 68, paragrafi 6. të KDM-së, sepse pas aprovimit të fajësisë për të miturit, gjykata ka administruar prova për moshën e të miturve, por jo edhe për personalitetin e tyre, duke i shqiptuar mandej masat edukative të miturve në kohëzgjatjen si në dispozitiv të aktvendimit, për çka aktvendimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të KPP-së lidhur me nenin 68, paragrafi 6. të KDM-së dhe kjo ka ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm.

Neni 68, paragrafi 6. i KDM-së, përmban formulimin e qartë dhe përcakton në mënyrë decidive se nëse shqyrtimi gjyqësor përfundon me pranimin e fajësisë të cilën gjykata e ka aprovuar, gjykata është e obliguar të administroi prova për moshën dhe personalitetin e të miturit konform nenit 13 të KDM-së.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se konform nenit 361, paragrafi 1. të KPP-së, gjykata bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtim gjyqësor, por në këtë rast nuk janë proceduar provat për personalitetin e të miturve.

Për shkaqet e paraqitura si më lart, aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë janë anuluar, pa i vlerësuar pretendimet tjera nga kërkesa, të cilat gjykata e shkallës së parë me rastin e rigjykimit të çështjes duhet t'i merr parasysh dhe t'i eliminoj.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.313/2022, i datës 17.08.2022**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit I.I., anulohet aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.12/2022, i datës 31.01.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Një prej pretendimeve në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë është se të dënuarit, i cili ka qenë në paraburgim, nuk i është dorëzuar aktakuza e as ftesa për seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin procedura penale pranë gjykatës së shkallës së parë edhe ka përfunduar. Në këtë mënyrë, të dënuarit nuk i është mundësuar që të përgatitë mbrojtjen e vet, gjegjësisht i janë shkelur të drejtat e mbrojtjes dhe kjo paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse ka ndikuar në marrjen e vendimit të ligjshëm.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shikimit të shkresave të lëndës, vërtetoi se nuk ka prova se të dënuarit i është dorëzuar as aktakuza e as ftesa për shqyrtimin fillestar. Ftesat i janë dërguar pjesëtarëve tjerë të seancës, ndërsa institucionit në të cilin i dënuari ka qenë në paraburgim, i është dërguar urdhëresa për sjelljen e të dënuarit në gjykatë. Në këtë mënyrë është vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 242, paragrafët 5. dhe 6. të KPP-së, sipas së cilit nëse i pandehuri gjendet në mbajtjen e paraburgimit, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas ngritjes së aktakuzës dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton prokurorin e shtetit, të pandehurin dhe mbrojtësin e tij për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar, ndërsa në rastin konkret kjo dispozitë ligjore nuk është përfillur. Në bazë të nenit 245, paragrafi 2. të KPP-së, lejohet mundësia që në shqyrtimin fillestar të pandehurit t'i dorëzohet aktakuza, nëse nuk i është dorëzuar më parë. Pasi që në shkresat e lëndës nuk ka prova se të dënuarit aktakuza i është dorëzuar më parë, është e qartë se i është dorëzuar në shqyrtimin fillestar. Edhe pse, siç u theksua më lartë, kjo mund të lejohet, megjithatë në rastin konkret, i dënuari para shqyrtimit fillestar nuk ka qenë i njoftuar se pse akuzohet dhe është sjellë nga institucioni ku ka mbajtur paraburgimin, pa e ditur paraprakisht se atë ditë do të mbahet seanca. Në këtë situatë, është për të besuar se vërtetë nuk është përgatitur dhe nuk i është dhënë kohë për përgatitjen e mbrojtjes, që është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur ligjore.

Duke vepruar kështu, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 1. të KPP-së, sepse nuk ka zbatuar dispozitat e cekura ligjore dhe nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.2. të KPP-së, sepse janë shkelur të drejtat e mbrojtjes dhe kjo ka mundur të ndikojë në marrjen e vendimit të ligjshëm, siç drejtë me pretendohet në kërkesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ardhja në seancë vetëm duke qenë i sjellur nga paraburgimi nga punëtorët e institucionit të mbajtjes së paraburgimit, pa ditur se atë ditë do të

mbahet seanca dhe pa e ditur përmbajtjen e aktakuzës, ka mundur të ndikojë në ligjshmërinë e aktgjykimit, sepse po të kishte qenë i njoftuar, i dënuari do të kishte pasur mundësi për mbrojtje më kualitative, sipas vlerësimit të vet.

Për këto shkaqe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë pjesë u aprovua dhe u vendos që aktgjykimi i formës së prerë të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, në të cilin shkelja duhet të eliminohet, drejt të aplikohet dispozita e nenit 242, paragrafi 6. të KPP-së dhe të merret vendim i ligjshëm.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.295/2022, i datës 04.08.2022**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit Sh.M., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3063/2021, i datës 12.11.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.1745/2021, i datës 20.06.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. lidhur me nenin 370, paragrafi 7. të KPP-së dhe të cilat shkelje konsistojnë në pjesën e arsyetimit për ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit dhe mos identifikimin e veprimeve konkrete inkriminuese të të dënuarit, posaçërisht pjesa ku i dënuari shpallet fajtor. Nga shkresat e lëndës, përkatësisht dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se nuk është përcaktuar dispozita blankete e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, të cilin e ka shkelur i dënuari. Dispozita e nenit 370, paragrafi 1. të KPRK-së, ka përcaktuar se “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm material ...”. Nga kjo rrjedh se sipas këtij përkufizimi ligjor, për t’u realizuar vepra penale duhet të përmbushen dy kushte dhe atë së pari që përmes

normës blankete e cila është e paraparë në ligjin përkatës të komunikacionit rrugor dhe e cila dispozitë ka përcaktuar mënyrën e veprimit përkatësisht lëshimet e pjesëmarrësve në komunikacion dhe si rezultat i këtij lëshimi të shkaktohet pasoja. Ndërsa, në rastin konkret është përmbushur vetëm kushti i dytë gjegjësisht pjesa e dytë e dispozitës ligjore, meqë në rastin konkret është shkaktuar pasoja, përkatësisht në aksident ka humbur jetën fëmija D.S. (e moshës rreth dy vjeçare), por nuk është përshkruar dispozita konkrete që eventualisht është shkelur nga ana e tani të dënuarit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të gjitha këto fakte të lartcekura e bëjnë të paqartë edhe përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale duke marrë parasysh dispozitat përkatëse të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor.

Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12 lidhur me nenin 370, paragrafi 7. të KPP-së, dhe të cilat shkelje nuk janë mënjanuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe për këtë arsye u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të shqyrtoj edhe një herë provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike. Më konkretisht, gjykata e shkallës së parë, duhet të qartësoj mënyrën e veprimit dhe lëshimet eventuale drejtuesit të kamionit dhe të cilat lëshime duhet të harmonizohen me dispozitën konkrete të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.195/2022, i datës 31.05.2022**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit K.B., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Istog, P.nr.61/2020, i datës 30.04.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.918/2021, i datës 25.10.2021 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa, si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se me të drejtë mbrojtësi i të dënuarit thekson në kërkesë se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit në arsyetim potencon rrethanat lehtësuese të cilat kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë dënimit, ndërsa si rrethana rënduese gjen shkallen e lartë të pjesëmarrjes dhe dashjes direkte në drejtim të kryerjes së veprës penale, motivin e kryesit i cili ishte pasurimi i pa bazë dhe jo proporcional, si dhe rrethanat në të cilën janë kryer këto vepra penale, duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të dy të dëmtuarve, e të cilat rrethana janë elemente konstituive të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari.

Edhe Gjykata e Apelit e Kosovës me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të mbrojtësit të të dënuarit sa i përket vendimeve mbi dënim e pranon një vlerësim të këtillë të rrethanave rënduese dhe i merr si rrethana drejt të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë duke e vërtetur aktgjykimin.

Duhet të theksohet se konform dispozitës së nenit 331 të KPRK-së, elementet konstituive të veprës penale fajdeja janë “kushdo që për vete apo për personin tjetër pranon ose kontrakton një shumë dukshëm jo proporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të tillë, gjendjen e rëndë të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë të gjykuar”. I dënuari është shpallur fajtor për këtë vepër penale të fajdesë nga nenin 331 të KPRK-së, për shkak se në veprimet e të njëjtit janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale dhe kjo tani më është marrë parasysh me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit. Elementet konstituive të veprës penale si pasurimi i pabazë dhe jo proporcionale, si dhe rrethanat në të cilat janë kryer këto vepra penale duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të dy të dëmtuarve, nuk mund të merren edhe si rrethana rënduese, sepse nuk janë rrethana të cilat janë të përfshira si rrethana të cilat mund të ndikojnë në ashpërsimin e dënimit, ashtu si e parasheh neni

70 i KPRK-së, meqenëse këto rrethana tanimë janë përfshirë si elemente të veprës penal. Të gjitha këto e bëjnë arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të paqartë, andaj edhe aktgjykimi si i tillë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, e të cilat shkelje kushtëzojnë anulimin e të njëjtit.

Edhe gjykata e shkallës së dytë me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të mbrojtësit të të dënuarit, edhe pse sipas detyrës zyrtare kujdeset për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk i eliminon shkeljet e përmendura më lart dhe e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë, duke mos dhënë arsye ligjore se pse nuk i ka marrë parasysh pretendimet ankimore të paraqitura në këtë drejtim.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.208/2021, i datës 13.07.2021**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit A.K., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur PM.nr.345/2019, të datës 29.07.2020 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës -Departamenti për të Mitur, PAKR.nr.401/2020, të dates 10.02.2021, vetëm për pjesën dënuese dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Pjesa refuzuese e aktgjykimit mbetet e pandryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoj se janë bazuar pretendimet të paraqitura nga mbrojtësja e të dënuarit se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se nuk përmbanë arsye lidhur me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit. Për më tepër, shkeljet e theksuara më lartë nuk janë eliminuar me aktgjykim e gjykatës së shkallës së dytë i cili gjithashtu është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave

të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. lidhur me nenin 370, paragrafi 7. të KPP-së.

Bazuar në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë del se janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë se nuk janë dhënë arsyet përkitazi me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit dhe posaçërisht fakti i veprimit të të dënuarit dhe se veprimi i tij a kishte të bënte me mashtrim apo premtim të rrejshëm për martesë dhe të cilat aspekte nuk janë arsyetuar mjaftueshëm në aktgjykimin e kundërshtuar.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar se si janë manifestuar elementet e veprës penale siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 233 të KPRK-së "Kushdo që premton rrejshëm martesën në mënyrë që të nxisë personin i cili është në mes të moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet që të përfshihet në një akt seksual".

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj nuk ka dhënë arsyetim përkitazi me mënyrën dhe rrethanat që i dënuari i kishte premtuar martesë të rrejshëm të dëmtuarës. Megjithatë, për tu realizuar figura e veprës penale për të cilin është shpallur fajtor është e domosdoshme që të plotësohen tri (3) kushte dhe atë; së pari do të duhej qartazi të definohej se kryesi të ketë premtuar në mënyrë të rrejshme martesë, së dyti, e dëmtuara të jetë në mes të moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet dhe si rezultat i këtij premtimi, pastaj të përfshihen në marrëdhënie seksuale i dënuari me të dëmtuarën. Në rastin konkret janë realizuar vetëm këto dy elemente qenësore të kësaj vepre penale dhe atë se ka ndodhur marrëdhënia seksuale dhe se mosha e të dëmtuarës ka qenë gjashtëmbëdhjetë vjeçare, kurse ka mbetur e papërcaktuarat mënyra e premtimit të rrejshëm dhe i cili paraqet disharmoni edhe me dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, meqë nuk janë përshkruar aspektet e veprimit të të dënuarit dhe me këtë kanë mbetur të pa përcaktuara elementet esenciale të veprës penale për të cilin i dënuari është shpallur fajtor.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.279/2022, i datës 25.07.2022**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit G.K., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1503/2020, i datës 08.10.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1739/2021, i datës 07.02.2022 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje t ligjshmërisë dhe konstatoj se:

-kërkesa është e bazuar.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në kërkesë pretendohet se ato manifestohen në faktin se aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka arsyetuar për atë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo jo të vërtetuara, për saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet për atë se në çka është bazuar në rastin e zgjedhjeve së çështjeve juridike dhe për përgjegjësin penale e të dënuarit. Në anën tjetër, në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk janë dhënë arsye për të gjitha pretendimet që janë paraqitur në ankesë, por ankesa është shqyrtuar në mënyrë sipërfaqësore, ashtu që vetëm janë cituar pretendimet, por ato nuk janë arsyetuar.

Gjykata Supreme gjeti se janë të bazuara pretendimet sa i përket mungesës së arsyetimit për elementet thelbësore të veprës penale, që parqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së.

Pasi që aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat nuk janë eliminuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, u vendos që të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim. Në rigjykim, duhet që secila deklaratë si dhe mbrojtja e të dënuarit të vlerësohet veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, siç kërkohet me dispozitën e nenit 361, paragrafi 2. të KPP-së, të arsyetohen veprimet konkrete e të dënuarit dhe të vlerësohen se a kanë elemente që kërkohen me dispozitën e nenit 182 të KPRK-së, të jepen arsye ligjore për faktet vendimtare dhe të merret vendim i ligjshëm. Duhet të sqarohet dhe të arsyetohet edhe fakti

përse në kualifikim juridik të veprës penale qëndron edhe neni 77 të KPRK-së, kurse i dënuari nuk është shpallur fajtor për veprën penale të ngacmimit në vazhdim, por për veprën penale ngacmim.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.290/2021, i datës 15.09.2021**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit Sh.T., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, P.nr.605/2019, i datës 20 nëntor 2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PA1.nr.85/2021, i datës 21 maj 2021, kurse çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Janë të bazuar pretendimet e theksuara në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara me nenin 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, sepse nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 370 të KPP-së, shkelje kjo që nuk është mënjanuar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Sipas dispozitës së nenit 370, paragrafi 7. të KPP-së, gjykata paraqet në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë në veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dh arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjeve së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.

Pas shqyrtimit të aktgjykimeve të kundërshtuara, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përpiluar konform dispozitës së lartcekur, sepse nuk përmban gjendjen e fakteve të cilën e ka vërtetuar në bazë të provave të administruara. Në arsyetim

të aktgjykimit në mënyrë narrative është bërë përshkrimi i dëshmive të dëshmitarëve dhe provave tjera, por nuk është bërë vlerësimi i tyre se cilës provë gjykata ja ka fal besimin e cilës jo, dhe nuk është dhënë vlerësimi as përkitazi me kundërthëniet e tyre dhe konkludimi përkitazi me ekzistimin e veprës penale për të cilin i dënuari është akuzua respektivisht se në bazë të cilave provave të administruara është vërtetuar se në veprimet e t dënuarit përmbushen elementet e veprës penale. Konform dispozitës ligjore, detyrim i gjykatës është që të vlerësoj ekzistimin ose mos ekzistimin e fakteve dhe në këtë drejtim ajo nuk është kufizuar me rregulla formale. Por, sipas dispozitës së lartcekur është detyrë e gjykatës që të paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Kështu nuk ka vepruar gjykata e shkallës së parë dhe të njëjtën gjë e ka bërë edhe gjykata e shkalla e dytë duke e pranuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Në fakt, mos arsyetimi i aktgjykimit konform kësaj dispozite paraqet shkelje esenciale absolute të dispozitave procedurale, gjë që aktgjykimet i bënë juridikisht të pa qarta për vlerësim të mëtejmë, për çka ato u anuluan dhe çështja ju kthye gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.28/2019, i datës 19.02.2019**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit M.A., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.40/2017, i datës 27.11.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.155/2018, i datës 08.05.2018 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoi se janë të bazuara pretendimet e paraqitura nga mbrojtësi i të dënuarit se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se, aktgjykimi i shkallës së parë është kundërthënës me vetveten dhe arsyet e dhëna dhe, si aktgjykimi nuk përmban arsye të qarta për faktet vendimtare. Arsyetimi i aktgjykimit

ka kontradita të theksuara në raport edhe me dëshmitë e dëshmitarëve dhe mbrojtjen e të dënuarit, pikërisht për vërtetimin e fakteve vendimtare se si ishte zhvilluar ngjarja në momentin e vrasjes.

Gjithashtu, janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë se nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe atë momenti i dy të shtënave me armë të kryera nga ana e të dënuarit, për më tepër siç është konstatuar edhe përmes provave materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor (fotografitë e vendit të ngjarjes) rezulton të mos jetë kontestues fakti se një revole është gjetur afër trupit të pa jetë të viktimës, e i cili fakt potencohet edhe nga mbrojtja e të dënuarit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj nuk përgjigjet në asnjë pretendim të mbrojtjes përkitazi me versionin e të dënuarit përkitazi me ngjarjen e zhvilluar e po ashtu nuk vlerëson mbrojtjen e të dënuarit përkatësisht pretendimet e tij se para se të shtënë me armë në drejtim të viktimës, i njëjti kishte drejtuar revolen në drejtim të tij dhe se veprimi i tij ishte pasojë e frikës.

Në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë nuk është dhënë vlerësim për faktet vendimtare në raport me provat e administruara dhe nuk jep përgjigje në pretendimet e mbrojtjes, për më tepër vetëm ka listuar provat dhe ka bërë përshkrimin e tyre pa bërë analizë të plotë dhe pa nxjerrë konkludime përkitazi me faktet vendimtare.

Aktgjykimi i shkallës së parë, gjithashtu përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, meqë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370, paragrafi 6. të KPP-së.

Në rastin konkret, gjykatat e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsyetim për çdo pikë të aktgjykimit e po ashtu nuk ka arritur të arsyetoj se cilat fakte i konsideron të vërtetuara dhe cilat të pavërtetuara, sidomos mbrojtjen e të dënuarit përkatësisht nuk ka arsyetuar faktin se cila është arsyeja që nuk i besoi mbrojtjes së tij për veprimet në momentin e kryerjes së veprës penale dhe pretendimin e tij se si ka rrjedhur ngjarja.

Bazuar në faktin se gjykatat e shkallës së parë nuk jep arsyetim për faktet vendimtare dhe pretendimet e paraqitura nga mbrojtja dhe si rezultat i kësaj kemi edhe shkelje të ligjit penal, meqë nuk jepen konkludime të qarta dhe konkrete përkitazi me pretendimet e të dënuarit dhe mbrojtësit të tij për faktin se në veprimet e të dënuarit nuk manifestohen elementet e veprës penale të vrasjes nga neni 178 i KPRK-së. Bazuar në pretendimet e paraqitura nga mbrojtja se në rastin konkret kemi të bëjmë me vrasje në mbrojtje të nevojshme përkatësisht tejkalim të mbrojtjes së nevojshme

apo vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 180 i KPRK-së, ashtu që pretendimet e shprehura në shqyrtimin gjyqësor dhe po ashtu edhe gjatë fazës ankimore nuk janë shqyrtuar përkatësisht nuk janë arsyetuar nga gjykata e shkallës së parë e as nga gjykata e shkallës së dytë, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se këto paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, përkatësisht neni 370, paragrafi 6. të KPP-së, pasi që mungon arsyetimi përkitazi me pretendimet e mbrojtjes gjegjësisht arsyetimi për faktet vendimtare.

Duke vepruar kështu, aktgjykimi i shkallës së parë, përmban shkelje esenciale të dispozitës së procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së e të cilat shkelje nuk janë evituar nga gjykatat e shkallës së dytë dhe për këtë arsye u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike. Në rend të parë duhet të eliminoj paqartësitë e zhvillimit të ngjarjes, përkatësisht të arsyetoj hollësisht mbrojtjen e të dënuarit, përkatësisht të sqarohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë momenti i vrasjes së tani të ndjerit, meqë sipas arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk rezulton se janë qartësuar versioni i mbrojtjes së të dënuarit në raport me provat e tjera.

Përveç kësaj, duhet të vërtetohet edhe pjesa e mbrojtjes së të dënuarit se tani i ndjeri i pari e ka nxjerr revolen dhe ia ka mbështetur të dënuarit për të vërtetuar dhe sqaruar se a është reale, mbrojtja e tij se ai prapë se prapë nuk ka pasur kohë dhe mundësi të nxjerr revolen e vet, të repetoj atë, të e drejtoj kah koka e tani të ndjerit dhe ta privoj nga jeta e gjatë kësaj kohe tani i ndjeri ka mbetur pasiv.

Më tutje, gjykata e shkallës së parë, duhet të eliminoj paqartësitë dhe kontradiktat e zhvillimit të ngjarjes dhe të arsyetoj qartë veprimet e të dënuarit përkitazi me veprën penale përkatësisht veprën penale e ka kryer në mbrojtje të nevojshme – tejkalim të mbrojtjes së nevojshme apo në gjendje të tronditjes së fortë mendore.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.97/2020, i datës 08.04.2020**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit A.I., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.29/2018, i datës 22.05.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.421/2018, i datës 04.10.2018 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.29/2018, të datës 22.05.2018, të dënuarin A.I. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, paragrafi 1. lidhur me nenin 281, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.7. të KPRK-së dhe e ka dënuar me dënim burgimin në kohëzgjatje prej pesë (5) muajve dhe dënim me gjobë në lartësi prej treqind (300) euro, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 03.10.2017. I dënuari është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej pesëdhjetë (50) euro.

Gjykata Supreme e Kosovës, pa vlerësuar pretendimet e tjera të paraqitura në kërkesë, gjeti si të bazuar pretendimin se aktgjykimi i shkallës së parë, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, meqë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370, paragrafi 8. të KPP-së.

Bazuar në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se me rastin e çmuarjes së rrethanave për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit mes rrethanave tjera rënduese është çmuar posaçërisht edhe rrethana se “vepra penale është kryer në oborrin e shkollës fillore dhe në kohën kur hapësirën e oborrit e frekuentonin nxënësit e shkollës fillore”. Me këtë rrethanë, gjykata e shkallës së parë ka marrë si rrethanë rënduese elementin qenësor të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 273, paragrafi 1. lidhur me nenin 281, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.7 të KPRK-së, me që pikërisht kjo rrethanë e përcaktuar me dispozitën e nenit 281, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.7. të KPRK-së, i

jep veprës penale formën e kualifikuar të saj, pasi që inkriminon rastet kur vepra penale kryhet "brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë metrash nga cilido institucion i edukimit", andaj, në këtë mënyrë arsyet për faktin vendimtar-lartësinë e dënimit janë të paqarta.

Duke vepruar kështu, aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje të dispozitës së procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së dhe në këtë mënyrë aktgjykimin e bën juridikisht të paqëndrueshëm e cila shkelje nuk është evituar as nga gjykata e shkallës së dytë dhe për këtë arsye u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të marr një vendim të drejt dhe të ligjshëm në këtë çështje juridike, ashtu që me rastin e vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të jep arsye të qarta për rrethanat nga neni 74 të KPRK-së dhe të evitoj shkeljen në fjalë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.211/2018, i datës 01.10.2018**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit E.D., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, P.nr.24/2016, i datës 22.12.2016 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.130/2017, i datës 08.11.2017 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog, me aktgjykimin, P.nr.24/2016, të datës 122.12.2016, të dënuarin E.D., e ka shpallur fajtor për veprën penale kanosja nga neni 185, paragrafi 2. të KPRK-

së dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda afatit prej një (1) viti, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë nuk kryen vepër tjetër penale.

Janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur fakte të plota dhe të qarta dhe në mënyrë të detajuar nuk janë arsyetuar të gjeturat e gjykatës. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë faktet vendimtare përkatësisht vërtetimin e ekzistimit të veprës penale dhe faktin se i dënuari ka qenë personi që ka shfrytëzuar llogarinë në rrjetin social facebook në profilin e L.M., dhe përmes kësaj ka bërë kanosjen ndaj të dëmtuarit B.B.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e neni 370, paragrafi 7. të KPP-së dhe nuk janë dhënë arsyetime se cilat fakte i konsideron të vërtetuara përkitazi me veprimet e të dënuarit, pasi që nuk është vërtetuar me saktësi fakti kryesor se kanosjen e ka bërë i dënuari, meqë vepra penale ka qenë e kryer përmes rrjetit social dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim përkitazi me provat kontradiktore dhe nuk ka dhënë arsye të qarta se në bazë të cilave prova e bazon vendimin e saj, përveç që në mënyrë narrative ka përshkruar provat, përkatësisht dëshmitë e dëshmitarëve të cilët nuk kanë vërtetuar faktin vendimtar se pikërisht i dënuari kishte bërë kanosjen e për më tepër nuk ka paraqitur arsye se pse nuk i ka besuar mbrojtjes së të dënuarit, mirëpo këtë e ka përshkruar se "... gjykata nuk ia fali besimin pasi që një mbrojtje e tillë është e pa bazë dhe e pa argumentuar...", cili arsyetim është vetëm përshkrues dhe pa ndonjë vlerësim kritik dhe të qëndrueshëm përkitazi me mbrojtjen e të dënuarit në raport me provat e tjera të administruara.

Po ashtu, edhe gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës nuk ka evituar shkeljet e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht nuk ka vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së dhe mbi këtë bazë të dy aktgjykimet janë të paligjshme dhe të cilat konstatime nuk mund të pranohen nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të eliminoj shkeljet e konstatuara, të shqyrtoj provat e propozuara, si dhe prova tjera të nevojshme e të cilat duhet t'i vlerësoj në kuptim të nenit 361,

paragrafi 1. të KPP-së dhe të jep arsyetim të qartë dhe të plotë për faktin se përmes profilit të L.M., mesazhe të kanosjes ka postuar i dënuari dhe nëse është e nevojshme për këtë të bëj edhe ekspertizë përkatëse dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo - juridike.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.358/2019, i datës 21.01.2020**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit B.M. dhe sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.386/2016, të datës 23 mars 2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1084/2019, të datës 19 shtator 2019, anulohen dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së pare në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, P.nr.386/2016, të datës 23 mars 2019, të dënuarin B.M., e ka shpallë fajtor për veprën penale hyrja në sistemet kompjuterike, parashikuar me nenin 339, paragrafi 1. të KPRK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ngritura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, kurse arsyet e dhëna në arsyetim janë të paqarta, dhe këtë shkelje nuk e ka evituar gjykata e shkallës së dytë.

Kështu, në dispozitiv të aktgjykimit thuhet se i dënuari pa autorizim i ka thyer fjalëkalimet e emaileve zyrtare të dëmtuarve gjatë shtatorit të vitit 2015 , mirëpo përkitazi me këtë fakt provat janë kontradiktore. Kështu, gjykata e shkallës së parë e merr si të vërtetuar faktin se i dënuari ka ndërhyrë gjatë shtatorit të vitit 2015 bazuar në dëshmitë e të dëmtuarve, mirëpo, nga provat materiale të administruara del se i dënuari i ka ndërhyrë pas datës 17.01.2016 pasi që në mbledhjen

e mbajtur nga anëtarët e kuvendit të OJR-së "C.A.", është marrë vendim për bllokimin e emailave zyrtare dhe vendimi i është dërguar atij (i dënuari ka punuar për OJQ-C.A.) për zbatim. Kundërthëniet në mes dëshmive e të të dëmtuarve dhe provave materiale të administruara e vëjnë në dyshim dispozitivin e aktgjykimit jo vetëm sa i përket kohës së kryerjes së veprës penale, por edhe sa i përket elementit qenësor të veprës penale - veprimit pa autorizim, pa të cilin element nuk ka vepër penale.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet t'i evitoj shkeljet e theksuara, t'i administrojë edhe një herë provat e propozuara, duke angazhuar ekspert të fushës përkatëse për ta përcaktuar kohën se kur ka ndërhyrë i dënuari në emailat zyrtar të të dëmtuarve, e pastaj pas vlerësimit të drejtë dhe logjik të secilës provë veç e veç dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën të marr vendim në këtë çështje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.24/2019, i datës 19.02.2019.**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit V.Z., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.65/2018, i datës 13.6.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.494/2018, i datës 30.10.2018, vetëm sa i përket të dënuarit V.Z. dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Në pjesën tjetër, aktgjykimet mbesin në fuqi.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e potencuara në kërkesë, si dhe bazuar në shkresat e çështjes, gjen se i dënuari V.Z., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar narkotike, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273, paragrafi 2. lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe kjo pasi që në shqyrtimin fillestar të

datës 13.06.2018, i dënuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ka qenë i ngarkuar me aktakuzë.

Duhet të theksohet se qëndron fakti se në dispozitiv të aktgjykimit thuhet se "substanca narkotike i akuzuari V. nga V.., e ka transportuar deri te shtëpia e tij në Gj.., kurse pas disa dite me veturën e tij "Mercedes" e ka dërguar deri te ndërmarrja transportuese E.E.". I dënuari ka pranuar këtë gjendje faktike në shqyrtimin fillestar duke pranuar fajësinë dhe gjykata nuk është lëshuar në administrim të provave, por ka vazhduar sipas procedurës për pranimin e fajësisë dhe gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 248, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, sepse pranimi i fajësisë nuk është mbështetur në provat të cilat i janë bashkëngjitur aktakuzës.

Kjo shkelje konsiston në faktin se i dënuari që nga fillimi i procedurës ka deklaruar se nuk i ka transportuar dyert me veturën e cila është konfiskuar, por kjo është bërë nga kompania e dëshmitarit N.B. e cila merret me transportimin e mallrave Kosovë-Evropë dhe anasjelltas dhe bartja është bërë me veturën e kësaj kompanie. Kjo vërtetohet edhe nga deklarata e F.A. të dhënë në polici më datë 12.09.2017 dhe dëshmia e dëshmitarit N.B., e datës 11.09.2017, andaj gjykata e shkallës së parë është dashur që mos ta bëjë pranimin e fajësisë. Megjithatë, kjo gjykatë gjen se kjo shkelje konsiston vetëm sa i përket transportit të dyerve nga shtëpia e të dënuarit deri te kompania transportuese në Ferizaj dhe mjetit me të cilin është transportuar malli, pra vetëm sa i përket këtyre provave, e jo edhe pjesës tjetër të veprimeve të dënuarit V. të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 385, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të KPP-së, sepse gabimisht është zbatuar dispozita e KPP-së, e që me të drejtë e potencon mbrojtësi i të dënuarit dhe si i tillë është juridikisht i paqëndrueshëm.

Gjykata e shkallës së dytë është dashur që sipas detyrës zyrtare të kujdeset për shkeljet e cekura aq më tepër kur këto shkelje janë potencuar në ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe gjykata jep arsyetim i cili nuk korrespondon me shkresat e çështjes. Pra, edhe aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuar më lart, e cila shkelje kushtëzon anulimin edhe të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cekura dhe të mënjanoj dyshimin rreth këtyre fakteve të cekura më lart dhe pasi që ta qartësoj këtë të vazhdojë me procedurë sipas dispozitave të procedurës penale.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.88/2019, i datës 01.04.2019.**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të dënuarit R.A., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.246/2018, i datës 12.11.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.32/2019, i datës 06.02.2019, ndërsa çështja i kthehet gjykatës së shkallës së pare në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435, pararagrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Së pari, gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka pranuar fajësinë, ngase pranimin e fajësisë mund ta konfirmoj gjykata, vetëm në rastet kur aktakuza nuk ka defekte në fushën e fakteve dhe nuk përmban të meta ligjore. Në rastin konkret, aktakuza kishte të meta substanciale, për faktin se nuk përmbante të dhëna të qarta për veprimin inkriminues të dënuarit, andaj në rrethana të tilla nuk do duhej të pranohej fajësia, pavarësisht gatishmërisë së të dënuarit që ta pranoj atë.

Së dyti, me të drejtë mbrojtësi me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pretendoi se dispozitivi është i paqartë, ngase në të nuk është konkretizuar veprimi i të pandehuri. Në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, vetëm është parafrazuar një pjesë e përshkrimit të veprës penale nga neni 374, paragrafi 1. të KPK-së, përkatësisht klauzola gjenerale "në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët". Ligji për Armët parasheh disa forma të mundshme të abuzimit me armë, si mbajtje pa leje të armës, bartje e armës të gjuetisë-shenjëtarisë jashtë kalendarit të lejuar për gjueti-shenjëtari, përdorimi i paautorizuar i armëve, leja e tij ishte jo valide,

apo kishte në pronësi e kontroll ndonjë armë për të cilën personat fizik nuk mund të pajisen me leje përkatëse etj. Gjykata ka qenë e detyruar që në dispozitiv të aktgjykimit të saktësoj qartë, se cilën formë të abuzimit të parashikuar me Ligjin për Armët, e kishte konsumuar i pandehuri. Pa e saktësuar qartë veprimin e të pandehurit, dispozitivi rezulton i paqartë, e që aktgjykimin e bënë juridikisht të paqëndrueshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke e shqyrtuar ankesën e të pandehurit, nuk e ka evituar shkeljen e theksuar më sipër, edhe pse këtë është dashur ta bëjë sipas detyrës zyrtare, konform nenit 394, paragrafi 1. i KPP-së, me çka ka shkelur dispozitat e nenit 394, paragrafi 1. të KPP-së.

9.4. Komente përmbledhëse

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe duke ju referuar dispozitave ligjore të trajtuara më lart, si dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së mund të nxjerrën këto konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1. Konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.7. i KPP-së, e cila shqyrtohet sipas propozimit të palëve, nëse aktgjykimi nuk është hartuar sipas nenit 369 të KPP-së dhe një gjë e tillë ka ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

2. Në nenin 369 të KPP-së është përcaktuar përmbajtja dhe forma e aktgjykimit, të cilin dispozitë ligjore duhet ta kenë në konsideratë gjyqtarët gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit, pasi që mos hartimi i aktgjykimit sipas këtyre dispozitave ligjore, përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të theksuar më lart.

3. Dispozitivi i aktgjykimit duhet të përfshin të gjitha të dhënat e parashikuara në nenin 369, paragrafët 3.-5. dhe në nenin 364 të KPP-së. Në veçanti, gjyqtarët me rastin e shqyrtimit të rasteve, si dhe marrjes dhe hartimit me shkrim të aktgjykimeve duhet t'i kushtojnë rëndësi elementit të parashikuar në nenin 364, paragrafi 1., nën-paragrafi 1. të KPP-së, që ka të bëjë me veprën penale për të cilën shpallet fajtor i pandehuri, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPRK. Siç është theksuar edhe më parë, ky element i dispozitivit të aktgjykimit ka qenë arsye që në disa

raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës janë anuluar aktgjykimet e instancave më të ulta.

4. Gjithashtu, një pjesë shumë e rëndësishme e aktgjykimit është edhe arsyetimi. Siç është theksuar edhe më parë, në nenin 369, paragrafi 6. të KPP-së, është parashikuar se *"gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit".* Kjo nënkupton që në arsyetim të aktgjykimit duhet të paraqiten arsye për fajësinë e të akuzuarit, veprën penale, dispozitat përkatëse ligjore, dënimet, konfiskimin, paraburgimin, shpenzimet e procedurës penale, si dhe çështjet tjera të rëndësishme. Gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit, në arsyetimin e aktgjykimit duhet që gjyqtarët në mënyrë të veçantë të vlerësojnë: a) saktësinë e provave kundërthënëse, b) arsyet e mos miratimit të propozimit konkret të palëve dhe c) arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike. Me fjalë të tjera, arsyetimi i aktgjykimit duhet të jep sqarime për krejt atë që është vendosur në dispozitiv, andaj edhe një aspekt i tillë duhet të jetë në vëmendjen e posaçme të gjyqtarëve gjatë hartimit me shkrim të aktgjykimit. Posaçërisht duhet të theksohet se cili fakt dhe rrethanë me çfarë prove është provuar, e jo vetëm shkurtimisht të numërohen provat e të paraqitet përmbajtja e tyre, pa bërë një vlerësim dhe analizim të provave. Në rastet kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

5. Gjykata Supreme e Kosovës në rastin PML.nr.447/2022, kishte konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ishte përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që në arsyetimin e aktgjykimit e këtij aktgjykimi nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë arsye në lidhje me vlerësimin e saktësisë së provave kundërthënëse, si dhe nuk janë paraqitur arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, me theks të veçantë në propozimet e mbrojtjes për dëgjimin e dy (2) dëshmitarëve. Gjykata Supreme e Kosovës kishte sqaruar se njëra prej të drejtave themelore të të pandehurit në procedurë penale është edhe *"E drejta e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës"*, e drejtë kjo, që është e garantuar edhe me nenin 6, paragrafi 3, pika d. të KEDNJ-së. Nga kjo dispozitë ligjore shihet se i pandehuri ka të drejtë që të thërras dhe të pyes edhe dëshmitarët në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës. Kjo e drejtë e të pandehurit në procedurë

penale mund të kufizohet nga gjykata, vetëm në rastet e parashikuar me ligj, duke paraqitur arsye të qarta, të mjaftueshme dhe bindëse për një gjë të tillë.

6. Gjithashtu, edhe në rastin PML.nr.312/2022, Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që të pandehurit nuk i është dhënë kohë e mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen e tij. Përndryshe, është e rëndësishme që të theksohet se është e drejtë themelore e një të pandehuri që të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi të nevojshme për ta përgatitur mbrojtjen e tij. Në këtë mënyrë, të pandehurit i është mohuar e drejta e tij për t'u njohur me aktakuzën, përkatësisht me natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, e drejtë kjo që garantohet me nenin 30, paragrafët 1. dhe 3. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 § 3 a) të KEDNj-së. Një mënyrë e tillë e të vepruarit, përkatësisht mos informimi në një afat sa më të arsyeshëm për natyrën dhe shkakun e akuzës nuk është në harmoni edhe me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së.[119]

[119] Rasti *"Pelissier dhe Sassi kundër Francës"*, aktgjykimi i datës 25.03.1999, paragrafi 54.

KAPITULLI II

KTHIMI I ÇËSHTJEVE NË RIGJYKIM NË GJYKATËN E SHKALLËS SË DYTË

1. Shqyrtime të përgjithshme në lidhje me kompetencat e Gjykatës së Apelit të Kosovës në çështjet penale

Kompetencat e Gjykatës së Apelit të Kosovës në çështjet penale në radhë të parë janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të KPP-së dhe të Ligjit për Gjykatat.

Kështu, me nenin 20, paragrafi 2. të KPP-së është parashikuar se *"Kompetenca lëndore e Gjykatës së Apelit për procedurë penale përcaktohet në Ligjin përkatës për Gjykatat"*.

Kurse, sipas nenit 21, paragrafit 1. të Ligjit për Gjykatat, *"Gjykata e Apelit vepron si gjykatë e shkallës së dytë, me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës"*, ndërsa, sipas paragrafit 2. të këtij neni *"Selia e Gjykatës së Apelit është në Prishtinë"*.

Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.[120]

Andaj, bazuar në këto dispozita ligjore dhe duke ju referuar strukturës organizative të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës, Gjykata e Apelit e Kosovës është gjykatë apo instancë e shkallës së dytë në raport me çështjet penale që janë shqyrtuar nga gjykatat themelore të cilat veprojnë si gjykata apo instanca të shkallës së parë.

Në këtë mënyrë, nëse një çështje penale është shqyrtuar në gjykatën themelore si gjykatë e shkallës së parë, atëherë ajo çështje mund të shqyrtohet në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëse palët, personat tjerë apo përfaqësuesit e tyre kanë paraqitur ankesë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Andaj, shqyrtimi i një çështje penale nga Gjykata e Apelit të Kosovës është vetëm një mundësi, kuptohet nëse palët, personat tjerë apo përfaqësuesit e tyre paraqesin ankesë ndaj një vendimi të

[120] Neni 8, paragrafi 1. i Ligjit për Gjykatat.

gjykatës themelore.[121] Kështu, një çështje penale mund të marrë epilog përfundimtar edhe pa u shqyrtuar fare nga Gjykata e Apelit e Kosovës dhe kjo mund të ndodhë, përveç tjerash, edhe në dy (2) situata:

Së pari, një situatë e tillë mund të vjen në shprehje në rastet kur nuk është paraqitur fare ankesë kundër vendimit (aktgjykimit/aktvendimit) të gjykatës së shkallës së parë dhe një vendim i tillë është bërë i formës së prerë, pa u shqyrtuar fare nga Gjykata e Apelit e Kosovës. Në praktikën tonë gjyqësore kjo ndodhë zakonisht tek rastet që përfundojnë me marrëveshje për pranimin e fajësisë, me ndërmjetësim, disa situata në procedurën ndaj të miturve, tek rastet që kanë përfunduar me aktgjykim për dhënien e urdhrit ndëshkimor, nëse nuk është paraqitur kundërshtim,[122] etj.

Së dyti, në rastet kur nuk është paraqitur fare ankesë kundër vendimit (aktgjykimit/aktvendimit) të gjykatës së shkallës së parë, por është paraqitur vetëm mjet i jashtëzakonshëm juridik (p.sh. kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë). Edhe në këto raste që nuk janë të rralla në praktikën tonë gjyqësore, çështja penale mund të marrë epilog përfundimtar pa u trajtuar fare nga Gjykata e Apelit e Kosovës, nëse është refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Përndryshe, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, Gjykata e Apelit e Kosovës është kompetente të shqyrtojë:

1. Të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore;
2. Të vendos për konfliktin e juridiksionit ndërmjet Gjykatave Themelore dhe
3. Çështjet tjera të parapara me ligj.

Gjykata e Apelit e Kosovës shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegj prej tre (3) gjyqtarëve profesionist, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.[123]

---

[121] SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010, fq. 85. Paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është vetëm një mundësi e personave të autorizuar, por nuk është edhe detyrim i tyre. Se a do të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit në procedurë penale apo jo, kjo varet nga vullneti i tyre. Madje, kjo nuk është detyrim ligjor i Prokurorit të Shtetit që të paraqes ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin i akuzuari është liruar nga akuza, siç nuk është detyrim as paraqitja e ankesës nga mbrojtja (i akuzuari dhe/ose mbrojtësi) në rastet kur i akuzuari shpallet fajtor.
[122] Neni 496 i KPP-së.
[123] Neni 28, paragrafi 1. i KPP-së dhe neni 23 i Ligjit për Gjykatat.

Çështjet penale në Gjykatën e Apelit të Kosovës varësisht nga natyra dhe specifikat e tyre shqyrtohen në kuadër të këtyre departamenteve/divizioneve, si në vijim:

1. Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal;
2. Departamenti për Krime të Rënda;
3. Departamenti Special dhe
4. Departamenti për të Mitur.

2. Arsyet për kthimin e çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë

Arsyet për kthimin e çështjeve në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, përkatësisht në Gjykatën e Apelit të Kosovës janë në parim disa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që do të trajtohen në vijim të këtij punimi.

Bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës, çështjet mund të kthehen në rigjykim në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përveç tjerash, edhe në këto dy (2) situata:

1. Nëse është paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë vetëm ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës[124] dhe konstatohet se një vendim i tillë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat për shkak të natyrës së shkeljes, detyrimisht imponojnë nevojën e kthimit të rastit në rigjykim në këtë Gjykatë dhe

2. Nëse është paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj vendimit të gjykatës së themelore dhe vendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, mirëpo konstatohet se vetëm vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat për shkak të natyrës së shkeljes, detyrimisht imponojnë nevojën e kthimit të çështjes në rigjykim në këtë Gjykatë, përkatësisht në gjykatën e shkallës së dytë.

[124] Në lidhje me këtë çështje, është e rëndësishme që të theksohet se në nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së është parashikuar se *"Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon"*.

Në vijim të këtij punimi do të trajtohen disa nga situata që kanë qenë arsyet më të shpeshta për kthimin e çështjeve në rigjykim në Gjykatën e Apelit të Kosovës nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.

3. Mos vendosja në lidhje me të gjitha ankesat e paraqitura

3.1. Dispozita ligjore

Neni 398, paragrafi 3. i KPP-së

"Gjykata e Apelit vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim".

3.2. Komentim i shkurtër i dispozitës së lartcekur ligjore

Shpeshherë në praktikën tonë gjyqësore kemi pasur raste kur janë paraqitur disa ankesa ndaj aktgjykimit apo aktvendimit njëjtë të gjykatës themelore. Në situata të tilla, Gjykata e Apelit të Kosovës është duhet që t'i shqyrtojë dhe të vendos për të gjitha ankesat e paraqitura kundër aktgjykimit apo aktvendimit të njëjtë.

Për të gjitha këto ankesa, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vendos me një vendim dhe një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në nenin 398, paragrafi 3. të KPP-së.

Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se *"Gjykata e Apelit vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim"*.

Varësisht nga mënyra e vendosjes dhe rrethanat specifike të rastit, në lidhje me ankesat e paraqitura, Gjykata e Apelit e Kosovës vendos me aktgjykim ose me aktvendim. Në nenet 398 deri 403 të KPP-së janë parashikuar situatat se kur Gjykata e Apelit e Kosovës vendos me aktgjykim dhe kur vendos me aktvendim.

Siç është theksuar edhe më lart, e rëndësishme është që për të gjitha ankesat e paraqitura ndaj një aktgjykimi, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vendos me një vendim.

Një mënyrë e tillë e vendosjes me një vendim për të gjitha ankesat e paraqitura kundër të njëjtit aktgjykim apo aktvendim është në funksion të sigurisë juridike, vendosjes së unike të rastit, si dhe të trajtimit të barabartë të të gjitha palëve.

Bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastet kur për disa ankesa është dashur që të vendoset me aktvendim (p.sh. nëse ankesat janë paafatshme ose të palejuara, etj.), kurse për disa ankesa tjera është dashur që të vendoset më aktgjykim (p.sh. nëse ankesat janë të pabazuara), atëherë për të gjitha këto ankesa, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet të vendoset me një aktgjykim, si një vendim i vetëm.

3.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos vendosjes së të gjitha ankesave me një vendim

Çështja e mos vendosjes së të gjitha ankesave me një vendim nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kështu, në vijim do të paraqitet një (1) rast nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë pikërisht kjo çështje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.401/2022, i datës 10.11.2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të dënuarit M.S., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.164/2022, i datës 10.05.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjen se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash, P.nr.12/2021, i datës 03.6.2021, i dënuari M.S., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale "Keqpërdorimi i besimit" nga neni 342, paragrafi 2. lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së. Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i tij, avokati S.B., e cila ankesë është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës dhe është refuzuar si e pabazuar me aktgjykimin PA1.nr.164/2022, të datës 10.05.2022. Në këtë aktgjykim theksohet se ka vetëm një ankesë, e cila edhe është shqyrtuar. Me shikimin në shkresat e çështjes vërtetohet se edhe i dënuari kishte dorëzuar një ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë e cila ankesë mban vulën e pranimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Dragash, më datë 28.12.2021, mirëpo kjo ankesë nuk është shqyrtuar fare nga Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë kompetente për vendosje sipas kësaj ankese.

Gjykata Supreme e Kosovës thekson se sipas nenit 398, paragrafi 3. të KPP-së, Gjykata e Apelit të Kosovës duhet që vendos për të gjitha ankesa kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim. Andaj, për rrjedhojë Gjykata e Apelit e Kosovës, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të KPP-së, sepse nuk ka zbatuar nenin 398, paragrafi 3. të KPP-së dhe i ka mohuar të dënuarit të drejtën në shqyrtim të ankesës së tij, e cila shkelje kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk u lëshua në shqyrtim të pretendimeve tjera, sepse nga vendosja në gjykatën e shkallës së dytë sipas ankesës së të dënuarit eventualisht do të ndryshonte gjendja e krijuar pa shqyrtimin e të njëjtës.

Në rishqyrtim, gjykata e shkallës së dytë duhet të vendosë sipas të gjitha ankesave të paraqitura dhe pastaj të merr një vendim lidhur me to, duke vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore.

3.4. Komente përmbledhëse

Siç shihet, në çështjen e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke e kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

Arsye për kthimin e çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë fakti se kjo gjykatë nuk kishte vendosur me një vendim për të gjitha ankesat e paraqitura kundër aktgjykimit të njëjtë të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht nuk kishte vendosur edhe për ankesën e të dënuarit, e cila kishte qenë në shkresa të lëndës.

Në këtë mënyrë, është konstatuar se në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të lartcekura të dispozitave të procedurës penale, të cilat edhe e kanë kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, pa u shqyrtuar fare pretendimet tjera.

Bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart dhe duke ju referuar aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme të Kosovës mund të nxjerrën këto dy (2) konstatime të rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore:

1) Se gjykata e shkallës së dytë, përkatësisht Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vendos me një vendim për të gjitha ankesat e paraqitur kundër vendimit të njëjtë dhe

2) Se mos vendosja në këtë mënyrë, përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që mund të ketë për pasojë anulimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

4. Mos njoftimi lidhur me seancën e kolegjit në Gjykatën e Apelit të Kosovës

4.1. Dispozita ligjore

Neni 390, paragrafi 1. i KPP-së

"Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim apo kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtim të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë, njoftimi për seancën e kolegjit i dërgohet, Prokurorit të Apelit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit të tij apo përfaqësuesit të viktimave, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij".

4.2. Komentim i shkurtër i dispozitës së lartcekur ligjore

Fillimisht, duhet theksuar se Gjykata e Apelit e Kosovës vendimet në lidhje me ankesat e paraqitura kundër vendimit të gjykatës së themelore në çështjet penale i merr në seancë të kolegjit ose në shqyrtim.

Kështu, në nenin 391, paragrafi 1. të KPP-së është parashikuar se *"Gjykata e Apelit merr vendim në seancë të kolegjit ose në shqyrtim"*.

Se a do ta mbahet shqyrtimi në Gjykatën e Apelit të Kosovës apo jo, një të e tillë vendoset në seancën e kolegjit.[125]

Në anën tjetër, varësisht nga fakti se a njoftohen palët dhe personat tjerë në lidhje me seancën e kolegjit, seanca e kolegjit mund të mbahet në dy (2) mënyra:

1) Pa njoftimin e palëve ose të personave tjerë ose
2) Me njoftimin e palëve dhe personave tjerë të caktuar.

Rasti i parë, përkatësisht mbajtja e seancës së kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës pa njoftimin e palëve ose të personave tjerë mund të vjen në shprehje në rastet kur kjo Gjykatë vendosë që t'i hedh si të pasafatshme[126] ose të palejuar ankesat e paraqitura.[127] Pra, në raste të tilla, është parashikuar mundësia që Gjykata e Apelit e Kosovës ta mbajë seancën e kolegjit pa i njoftuar palët, nëse ankesat e paraqitura hedhen si të pasafatshme apo të palejuara.

Rasti i dytë, përkatësisht mbajtja e seancës së kolegjit me njoftimin e palëve dhe të personave tjerë të caktuar vjen në shprehje në rastet kur të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim apo kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtim të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë

[125] Neni 391, paragrafi 2. i KPP-së.
[126] Në nenin 399 të KPP-së është parashikuar se *"Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të pasafatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor"*. Sipas nenit 380, paragrafi 1. të KPP-së, kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Pra, afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit është tridhjetë (30) ditë nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.
[127] Në nenin 400 të KPP-së është parashikuar se *"Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj"*.

apo pafajësinë. Pra, njoftimi për seancën e kolegjit, i palëve dhe personave tjerë të caktuar vjen në shprehje në dy (2) situata:

1) Në rastet kur gjykata themelore të akuzuarit i ka shqiptuar dënim me burgim dhe
2) Në rastet kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtim të fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit.

Në raste të tilla, për seancën e kolegjit duhet të njoftohen prokurori i Prokurorisë së Apelit, i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij apo përfaqësuesi i viktimave, i akuzuari dhe mbrojtësit të tij.[128]

Në qoftë se i akuzuari i cili gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit dëshiron të merr pjesë në seancë të kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, atëherë, pjesëmarrja i mundësohet atij.[129]

Përndryshe, mosardhja e palëve ose e ankuesve të tjerë të njoftuar me rregull nuk e pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Në raste të tilla, duhet të konstatohet se palët dhe personat apo ankuesit tjerë siç thuhet të jenë "njoftuar me rregull". Njoftimi në mënyrë të rregullt është një institut juridik që përfshirë një mori të dispozitave ligjore që i referohet dorëzimit të njoftimit palëve dhe personave të tjerë. Këto dispozita ligjore gjenden në KPP (nenet 474-484), por edhe në ligje tjera, p.sh. Ligjin për Procedurën Kontestimore.[130]
Kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit.[131] Megjithatë, një gjë e tillë mund të vjen në shprehje vetëm në rastet kur organet kompetente që e kanë zhvilluar procedurën penale dhe gjykatat themelore e kanë njoftuar paraprakisht të akuzuarit për detyrimin e tij që çdo ndërrim të adresës apo vendqëndrimit ta njoftojnë gjykatën dhe ta kenë njoftuar për pasojat e mos përmbushjes së këtij detyrimi.

Kështu, p.sh. në nenin 152, paragrafi 1. të KPP-së parashikuar detyrimi i prokurorit të shtetit që gjatë marrjes së deklaratës në procedurë paraprake ta informon të pandehurin për detyrimin e tij për të njoftuar për çdo ndryshim adrese ose për çdo qëllim ndryshimi të vendqëndrimit.

[128] Neni 390, paragrafi 1. i KPP-së.
[129] Neni 390, paragrafi 2. i KPP-së.
[130] Neni 483 i KPP-së.
[131] Neni 390, paragrafi 1. i KPP-së.

Madje, në nenin 172, paragrafi 4. të KPP-së është parashikuar se *"Gjatë kohëzgjatjes së procedurës, i pandehuri duhet menjëherë ta njoftojë gjykatën për çdo ndryshim të adresës së tij ose për qëllimin e ndryshimit të vendqëndrimit. I pandehuri njoftohet për këtë detyrim në rastin e marrjes në pyetje për herë të parë ose me rastin e dorëzimit të aktakuzës dhe njëkohësisht paralajmërohet për pasojat e mos përmbushjes së detyrimit siç është paraparë me këtë Kod"*.

Gjithashtu, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet t'i përkujton palët për detyrimet e tyre që, deri në përfundim të procedurës, të njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës.[132]

Në fund, duhet theksuar se edhe pas shpalljes së aktgjykimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që t'i përkujton palët për detyrimet e tyre që, deri në përfundim të procedurës, të njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës.[133]

Çështja e njoftimit për të marrë pjesë në seancën e kolegjit të një gjykate të apelit është trajtuar gjerësisht edhe nga këndvështrimi i të drejtës për një proces të rregullt, nga neni 6, paragrafi 1. i KEDNJ-së.

Në lidhje me këtë çështje, tani më GJEDNJ -a ka një praktikë të konsoliduar, pasi që në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka trajtuar në hollësi këtë aspekt të së drejtës për një proces të rregullt. Kështu, GJEDNJ-ja thekson se *"Parimi se seancat duhet të mbahen në publik përfshin të drejtën e të akuzuarit për të dhënë dëshmi personalisht në gjykatën e apelit dhe nga ky këndvështrim, ky parim ndjek synimin për të garantuar të drejtat e mbrojtjes së të akuzuarit"*.[134]

Sipas qëndrimeve të GJEDNJ-së, *"megjithëse, pjesëmarrja fizike e të pandehurit nuk e ka të njëjtën rëndësi vendimtare për një seancë pranë gjykatës së apelit, ashtu siç e ka rëndësinë pjesëmarrja e tij në një seancë gjyqësore, mënyrë në të cilën zbatohet neni 6 i KEDNJ-së, varet*

[132] Neni 367, paragrafi 3. i KPP-së.
[133] Neni 367, paragrafi 3. i KPP-së.
[134] Shih rastin *"Tierce dhe të tjerët kundër San Marinos"*, aktgjykimi i datës 25.07.2000, paragrafi 94; Rasti *"Colozza kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 12.02.1985, paragrafët 27-29, etj.

nga veçoritë specifike të procedurave përkatëse dhe duhet të merret parasysh edhe tërësia e procedurave në rendin juridik të brendshëm dhe rolin që ka gjykata e apelit".[135]

Gjithashtu, GJEDNJ ka sqaruar se *"kur gjykata e apelit është kompetente për të modifikuar, përfshirë rritjen e dënimit të shqiptuar nga gjykata e shkallës më të ulët dhe kur procedurat e palët mund të ngrenë çështje që përfshijnë një vlerësim të personalitetit dhe karakterit të të akuzuarit dhe gjendjes së tij shpirtërore në kohën e kryerjes së veprës penale, e cila e në një procedurë të tillë me rëndësi vendimtare për të akuzuarin, atëherë është thelbësore për drejtësinë procedurale që të akuzuarit t'i mundësohet të jetë i pranishëm në seancë dhe t'i jepet mundësia për të marrë pjesë në të"*.[136]

4.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos njoftimin për seancën e kolegjit në Gjykatën e Apelit të Kosovës

Çështja e mos njoftimit në lidhje me seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.
Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë pikërisht kjo çështje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.440/2022, i datës 27.122022**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të dënuarit N.H., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.844/2022, i datës 4.7.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtë në rivendosje.

[135] Rasti *"Hermi kundër Italisë"*, aktgjykimi i datës 18.10.2006, paragrafi 60; Rasti *"Ekbatani kundër Suedisë"*, aktgjykimi i datës 26.05.1988, paragrafi 30, etj.
[136] Rasti *"Lacadena Calero kundër Spanjës"*, aktgjykimi i datës 22.02.2012, paragrafi 38; Rasti *"Dondarini kundër San Marinos"*, aktgjykimi i datës 06.10.2004, paragrafi 27, etj.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.646/2017, e datës 28.1.2022, ka shpallë fajtor të dënuarin N.H., për shkak të veprës penale "Keqpërdorimi i besimit" nga neni 269, paragrafi 2. të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me pëlqim të të njëjtit është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2000) euro, të cilën gjobë është obliguar që ta paguaj në afat prej dy (2) muajve, pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, i dënuari pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se i dënuari nuk është njoftuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës për datën dhe kohën e seancës së kolegjit.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, si dhe bazuar në shkresat e çështjes, gjen se nuk ka prova se palët janë të njoftuar se seanca de të mbahet. Nga kjo, me të drejtë potencon i dënuari se i njëjti nuk është njoftuar nga gjykata e shkallës së dytë për datën dhe kohën e mbajtjes së seancës së kolegjit, ku janë shqyrtuar ankesat e palëve dhe i njëjti nuk ka pasur mundësi të deklarohet lidhur me pretendimet ankimore.

Të gjitha këto, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, paraqesin shkelje të drejtës në gjykim të drejtë, e të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kl.nr.104/2016 datë 29 maj 2017, është konstatuar se (bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së) garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafi 1 e 3 të Konventës, vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta për mbrojtje, sipas dispozitës së lartcekur të Konventës, përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundësuar të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shkelur e

drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë duhet që t'i evitoj shkeljet e cekura më lartë, duke i njoftuar me rregull palët për datën dhe orën e mbajtjes së seancës së kolegjit dhe pasi që të sigurohet se palët janë të njoftuara sipas dispozitave të procedurës penale të shqyrtoj pretendimet në kuadër të ankesave të paraqitura dhe pastaj të merr një vendim meritor.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.386/2022, i datës 25.10.2022**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtëses së të dënuarit I.M., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, PA.1.nr.1776/2021, i datës 21.04.2022 dhe çështja i kthehet kësaj gjykate në rigjykim.

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendimet tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i mbrojtëses së të dënuarit për mos informimin për seancën e shkallës së dytë është i bazuar, ngase aktgjykimi i shkallës së dytë kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është marrë pa informimin e të dënuarit.

Siç rezulton në shkresat e lëndës, kolegji penal i gjykatës së shkallës së dytë duke vepruar sipas ankesës së mbrojtëses së të dënuarit nuk e ka njoftuar sipas dispozitave ligjore të njëjtin për datën e seancës. Rrjedhimisht, bazuar në procesverbalin e seancës së kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë del se i dënuari është njoftuar përmes telefonit për seancën e kolegjit dhe pas këtij konstatimi është vazhduar me seancën e kolegjit. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret njoftimi i të dënuarit nuk ka qenë konform dispozitës së nenit 390, paragrafi 1. të KPP-së, ndonëse kjo dispozitë nuk ka përcaktuar afatin e njoftimit, megjithatë njoftimi do të

duhej të aplikohej përshtatshmërishtë sipas dispozitave ligjore që rregullojnë thirrjen e të pandehurit dhe palëve tjera në seancë (neni 287, paragrafi 3. të KPP-së).

Për më tepër, njoftimi i të dënuarit përkitazi me seancën e kolegjit nuk duhet të nënkuptohet si detyrim i karakterit formal, përkatësisht të mjaftohet vetëm me njoftim, por kjo do të duhej të nënkuptonte mundësinë dhe kohën e arsyeshme për të marrë pjesë aktivisht në seancën e kolegjit, përkatësisht me këtë t'i mundësohet që i dënuari të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, përkatësisht paraqes pretendimet e tij në seancën e kolegjit. Ashtu që rrjedhimisht, në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.2 të KPP-së dhe të cilat shkelje kanë ndikuar në të drejtat e të pandehurit të garantuara sipas dispozitave të KPP-së dhe të drejtës, për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 par. 1 dhe 3 pika (c) dhe (d) i KEDNJ dhe vendimeve të GJEDNJ-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në ekzistimin e kësaj shkelje nuk ka vlerësuar shkeljet tjera të pretenduara, meqenëse është evidente që të dënuarit i është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe pjesëmarrja e saj në seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë e cila kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.269/2019, i datës 15.10.2019**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit B.R., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.191/2019, i datës 10.05.2019 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.923/2017, të datës 23.11.2018, i pandehuri B.R., është shpall fajtor për veprën penale kanosje, parashikuar me nenin 185, paragrafi 2. të KPRK-së, për të cilën është gjykuar me dënim me kusht, ashtu që i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, ekzekutimi i të cilit është shtyrë

për një (1) vjet, me kusht që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, brenda kësaj periudhe i pandehuri të mos kryej vepër penale.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. dhe 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtjen të ligjshmërisë dhe gjeti se:

-Kërkesa është e bazuar.

Janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka njoftuar tani të dënuarin dhe mbrojtësin e tij për seancën e kolegjit me qëllim që të paraqesin aspektet dhe argumentet e tyre lidhur me ketë çështje penale.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, duke mos e njoftuar të dënuarin dhe mbrojtësin e tij për seancën e kolegjit është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë e të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së.

Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KL.nr.104/2016 datë 29 maj 2017, është konkluduar (bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së) se garancitë e përmbajtura në neni 6, paragrafët 1 e 3 c të Konventës vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale.
E drejta në mbrojtje sipas dispozitës së lartcekur të Konventës përfshinë të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike duke përfshirë ndihmën juridike falas si dhe të drejtën e të akuzuarit për të qenë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë.

Duke mos ia mundësuar të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e mbajtur në shkallë të dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm i garantuar me Kushtetuarën e Kosovës dhe Konventën Evropiane.

Për arsyet e lartcekura është anuluar vetëm aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe çështja i kthehet të njëjtës në rigjykim e cila duhet të evitoj shkeljet e lartcekura, duke e njoftuar të dënuarin dhe mbrojtësin e tij, për seancën e kolegjit, pastaj të merr vendim në këtë çështje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.38/2019, i datës 12.02.2019**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtëses të të miturit L.B., anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAM.nr.90/18, i datës 14.01.2019 dhe çështja i kthehet kësaj gjykate në rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PM.nr.35/2018, të datës 29.11.2018, të miturve L.B. dhe K.Sh., për veprën penale në bashkëkryerje keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeç, nga neni 235, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, iu ka shqiptuar masën edukative dërgimi në institucionin edukativo-korrektues, në kohëzgjatje prej nga dy (2) vite, e cila masë ka filluar që të ekzekutohet menjëherë më datën 29.11.2018.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në rastin konkret ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (e drejta për një proces të rregullt), paragrafët 1 dhe 3 pika (c) dhe (d) të KEDNJ-së, sepse mbrojtëses së të miturit dhe të miturit i është pamundësuar të merr pjesë në seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës e mbajtur lidhur me çështjen penale kundër tij. Në këtë drejtim, është aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. K/104/16, i datës 04.08.2017 në të cilin është vendosur që në rast se për seancën e gjykatës së shkallës së dytë nuk njoftohen të dy palët, si pasojë e mos njoftimit, gjykata konsideron se, në procedurat para Gjykatës së Apelit të Kosovës, i mituri dhe mbrojtësja e tij janë privuar nga të gjitha të drejtat dhe garancitë. Të miturit nuk iu dha mundësia që të mbrohet, nuk kishte pasur mundësi që të paraqiste mbrojtjen e tij dhe të kundërshtonte argumentet e palës tjetër. Rrjedhimisht, dhe në baza të asaj që u tha më lart, duke pasur parasysh tërësinë e procedurave para gjykatave të rregullta, rolin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe natyrën e çështjes së adresuar dhe vendosur nga ajo, Gjykata konkludon se në rastin konkret ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim

të drejtë të garantuar me nenin 31 (E drejta për gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) paragrafët 1 dhe 3 pika (c) dhe (d) të KEDNJ-së, sepse të miturit i është pamundësuar të merr pjesë në seancën e mbajtur lidhur me çështjen ndaj tij.

4.4. Komente përmbledhëse

Siç shihet, në çështjet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke i kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë. Arsye për kthimin e çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë fakti se të pandehurit dhe/ose mbrojtësit e tyre nuk ishin ftuar fare për seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës shihet se mos njoftimi për seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në raste të caktuara, përveç që përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe shkelje të drejtës në gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së.

Për raste të tilla, me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kl.nr.104/2016 datë 29 maj 2017, është konstatuar se bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e përmbajtura në nenin 6, paragrafët 1 e 3 të KEDNJ-së, vazhdojnë të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. E drejta për mbrojtje, sipas dispozitës së lartcekur të Konventës, përfshin të drejtën e të akuzuarit për të mbrojtur veten, të drejtën për ndihmë juridike, duke përfshirë ndihmën juridike falas, si dhe të drejtën e të akuzuarit që të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet në procedurë. Duke mos ia mundësuar të akuzuarit që të merr pjesë në seancën e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me akuzën penale kundër tij, sipas konkludimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNJ.

5. Mos dërgimi i kopjes së ankesës palëve të tjera për të paraqitur përgjigje në ankesë

5.1. Dispozitat ligjore

Neni 388, paragrafët 1., 3. dhe 4. të KPP-së

"Ankesa kundër aktgjykimit paraqitet në gjykatën e cila ka nxjerr aktgjykimin".
"Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. Sapo të marrë përgjigjen, gjykata do të vazhdojë në pajtim me nenin 377, paragrafin 3 këtij Kodi".
"Kjo gjykatë i përcjell ankesën, përgjigjën dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e ankesës".

5.2. Komentim i shkurtër i dispozitave të lartcekura ligjore

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore, përkatësisht në nenin 388, paragrafi 1. të KPP-së, nëse palët dhe personat tjerë të autorizuar vendosin që të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit, atëherë duhet që ankesa të paraqitet apo të dorëzohet në gjykatën e cila e ka nxjerr aktgjykimit ndaj të cilit paraqitet ankesa.

Fillimisht është e rëndësishme që të theksohet se njëri ndër parimet kryesore të procedurës penale është padyshim parimi kontradiktor, i cili shprehet përmes premisës *"audiatur et altera pars"*, sipas së cilit gjykata në çështjet penale ka për detyrë që gjatë zhvillimit të procedurës penale, para se të marrë vendim lidhur me çështje të caktuara, çdo herë të dëgjojë edhe palën tjetër.[137]

Në procedurën sipas ankesës, ky parim i procedurës penale realizohet në atë mënyrë që gjykata e shkallës së parë para se t'ia dërgojë ankesën gjykatës së shkallës së dytë, duhet që një kopje të ankesës t'ia dërgoj edhe palës tjetër, e cila në afat prej tetë (8) ditëve ka të drejtë që të paraqesë përgjigje në ankesë.

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka, ky parim i procedurës penale është trajtuar dhe nga GjEDNj-ja në disa raste nga praktika e saj gjyqësore, me ç'rast edhe mos respektimi i këtij parimi,

[137] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq. 93; SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 164.

në situata të caktuara është konsideruar edhe shkelje e nenit 6, paragrafi 1. të KEDNJ-së, përkatësisht të drejtës për një proces të rregullt.[138]

Përndryshe, siç është theksuar edhe më lart, në nenin 388, paragrafi 3. të KPP-së është parashikuar se "*Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës".*[139]

Me dërgimin e ankesës palës tjetër, kjo e fundit njoftohet me pretendimet e paraqitura në ankesë dhe ka të drejtë që të paraqesë përgjigje në ankesë, duke paraqitur kundër argumente, me qëllim të përfaqësimit sa më të drejtë të të drejtave dhe interesave në procedurë penale.

Përveç që është detyrim për gjykatën për t'ia dorëzuar ankesën palës tjetër, kjo njëkohësisht është edhe e drejtë e palëve tjera, e cila e drejtë është e ndërlidhur edhe me të drejtën e saj për të paraqitur përgjigje në ankesë.

Përndryshe, dështimi për ta përmbushur këtë detyrim ("mos dorëzimi i ankesës palëve tjera") përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 388, paragrafi 3. të KPP-së, pasi që një shkelje e tillë ndikon ose mund të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.[140]

---

[138] GjEDNj-ja në rastin *"Brandstetter kundër Austrisë"*, aktgjykimi i datës 28.08.1991, paragrafët 67-69, kishte theksuar se *"E drejta për një gjykim kontradiktor do të thotë, në një çështje penale, që si prokurorisë, ashtu edhe mbrojtjes duhet t'i jepet mundësia të kenë njohuri dhe komente mbi dosjet dhe provat e paraqitura nga pala tjetër. Janë të mundshme mënyra të ndryshme në të cilat ligji kombëtar mund të sigurojë që kjo kërkesë është përmbushur. Megjithatë, cilado metodë të zgjidhet, ajo duhet të sigurojë që pala tjetër do të jetë e vetëdijshme për pretendimet që janë paraqitur dhe do të ketë një mundësi reale për të komentuar mbi to. Në rastin konkret, asnjë kopje e parashtresave të Prokurorit të Lartë Publik nuk i është dërguar parashtruesit dhe se ai nuk ishte i informuar as për paraqitjen e tyre"*.

[139] Në nenin 423 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, përgjigja në ankesë emërtohet "Apel kundërshtues". Në paragrafin 1. të këtij nenit është parashikuar se *"Pala që nuk ka bërë ankim brenda afatit mund të bëjë apel kundërshtues brenda pesë ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për apelin e palës tjetër"*.

[140] Gjykata Kushtetutese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.44, të datës 18.07.2000, ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.239, të datës 23.06.1999, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lënë në fuqi një vendim i Gjykatës së Apelit në Durrës. Gjykata Kushtetuese, kishte vendosur që të shfuqizoj vendimin dhe dërgimin e çështjes në rishqyrtim me këtë arsyetim: Nga materialet e dosjes rezulton se nuk ka asnjë dokument apo veprim që të vërtetojë se të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, t'i jetë komunikuar rekursi i ushtruar nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit në Durrës. Në këtë mënyrë është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të KPP-së në të cilën shprehet se *"Akti i ankimit u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që e ka dhënë vendimin"*. Duke mos u përmbushur ky detyrim ligjor, të pandehurit nuk i është dhënë mundësia që të dijë se çështja e tij do të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe njëkohësisht të dëgjohet e të mbrohet rreth parashtrimeve të

Paraqitja e përgjigjes në ankesë nuk është detyrim për palët tjetra, por kjo është vetëm një mundësi që të deklarohen lidhur me pretendimet që janë paraqitur në ankesë.[141] Një gjë e tillë mund të vërtetohet edhe nga vetë përmbajtja e dispozitës ligjore të nenit 388, paragrafi 3. të KPP-së është parashikuar se "*Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve të tjera, të cilat mund të paraqesin përgjigje brenda ...".*

E drejta e paraqitjes së përgjigjes në ankesë i takon vetëm palëve tjera. Për dallim nga Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale, i cili në nenin 388, paragrafin 2. kishte përcaktuar se një kopje e ankesës është dashur që t'i dërgohet "palëve kundërshtare", të cilët edhe kanë pasur të drejtë që të paraqesin përgjigje në ankesë, tani sipas dispozitave ligjore të KPP-së, një kopje e ankesës duhet që t'i dërgohet "palëve tjera" të cilat kanë të drejtë që të paraqesin përgjigje në ankesë. Andaj, sipas kësaj zgjidhje ligjore që është akceptuar në KPP, nga një kopje e ankesës duhet që t'i dërgohet palëve tjera, e jo vetëm palëve kundërshtare, siç ka qenë e parashikuar me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale.
Përgjigja në ankesë duhet të dërgohet në gjykatën themelore e cila e ka marrë aktgjykimin brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. E drejta e dhënies së përgjigjes në ankesë ekziston pavarësisht faktit se në çfarë shkaqesh është bazuar ankesa. Paraqitja e përgjigjes në ankesë i jep mundësi Gjykatës së Apelit që vendimmarrjen e saj lidhur me ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta bëj në mënyrë sa më objektive.[142]

Afati për paraqitjen e përgjigjes në ankesë është tetë (8) ditë dhe fillon të llogaritet nga dita e nesërme pas pranimit të ankesës.[143]

Ankesa kundër aktgjykimi i dërgohet palëve tjera për përgjigje, vetëm pasi gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të konstatojë se ankesa është e afatshme dhe e lejuar. Nëse gjyqtari i

---

bëra nga prokurori në rekursin e tij. Mohimi të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur përbën shkelje me karakter kushtetues, të cilat e bëjnë procesin jo të rregullt, në kuptim të nenit 42, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Cituar sipas: LUARASI, ALEKS: Kodi i procedurës penale me praktikë gjyqësore, Tiranë, 2002, fq. 243-245.

[141] SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 165.

[142] HAJDARI, AZEM : Komentar i Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë, 2016, fq. 944.

[143] Në nenin 445, paragrafi 2. të KPP-së është parashikuar se *"Ora ose dita kur është bërë dorëzimi, njoftimi apo kur ka ndodhur ngjarja që konsiderohet si fillim i afatit nuk llogaritet në afat, por për fillim të afatit merret ora apo dita e parë vijuese".*

vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues konstaton se ankesa është e paafatshme ose palejuar, atëherë e hedh me aktvendim dhe fare nuk i dërgohet palëve tjera.

Në nenin 388, paragrafi 2. të KPP-së është parashikuar se *"Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë e hedh ankesën me aktvendim:*

2.1. Si të paafatshme kur konstatohet se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor; ose
2.2. Si të palejueshme kur konstaton se është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr, ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj".

Me dispozitat ligjore të KPP-së nuk është rregulluar në mënyrë shprehimore përmbajtja e përgjigjes në ankesë. Megjithatë, meqë përgjigja në ankesë është lloj i parashtresës në procedurë penale, atëherë edhe gjithçka që duhet të ketë çdo parashtresë, duhet të ketë edhe përgjigja në ankesë.

Në radhë të parë, përgjigja në ankesë duhet të përmbajë argumente me të cilat hedhen poshtë pretendimet e ankuesit të cilat i ka paraqitur në ankesë.[144]
Duke qenë se përgjigja në ankesë i mundëson palëve tjera që të deklarohen lidhur me ankesën, përmbajtja e përgjigjes në ankesë sillet parimisht në kufijtë e pretendimeve ankimore, me qëllim që ato të kontestohen, mbështetën ose tregohen më ndryshe nga ato të paraqitura në ankesë. Për këtë arsye, në procedurën lidhur me ankesën vendohet lidhur me ankesën dhe jo lidhur me përgjigjen në ankesë.[145]

Nëse palët tjera kanë paraqitur përgjigje në ankesë, atëherë gjykata themelore duhet që nga një (1) kopje të përgjigjes në ankesë t'ia dërgojë ankuesit. Në nenin 388, paragrafi 3., fjalia e dytë e KPP-së është parashikuar se *"Sapo të marrë përgjigjen, gjykata do të vazhdojë në pajtim me nenin 377, paragrafin 3. këtij Kodi"*, kurse në nenin 377, paragrafi 3. të KPP-së është parashikuar se *"Përgjigja paraqitet në gjykatë themelore, e cila ia dërgon përgjigjen palës tjetër"*. Kjo tani konsiderohet risi në KPP, pasi që me Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale nuk ka qenë e

[144] SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 168.
[145] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq. 920.

nevojshme dhe as që ka qenë detyrë e gjykatës themelore që kopjen e përgjigjes në ankesë t'ia dërgojë ankuesit.

Pasi të jetë paraqitur përgjigja në ankesë ose pasi të kalojë afati për përgjigje (nëse nuk është paraqitur përgjigje në ankesë), gjykata themelore duhet që t'ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë, përkatësisht Gjykatës së Apelit të Kosovës për vendosje ankesën, përgjigjen në ankesë (nëse ka) dhe shkresat tjera. Një gjë e tillë është parashikuar në nenin 388, paragrafi 4. të KPP-së, sipas së cilës *"Kjo gjykatë i përcjell ankesën, përgjigjën dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën që është kompetente për shqyrtimin e ankesës".*

5.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e mos dërgimit të kopjes së ankesës palëve të tjera për të paraqitur përgjigje në ankesë

Çështja e mos dërgimit të kopjes së ankesës palëve tjera ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë pikërisht kjo çështje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.424/2022, i datës 22.11.2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të dënuarit R.S., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.901/2022, i datës 05.10.2022 dhe kjo çështje penale i kthehet në rigjykim të njëjtës gjykatë.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.189/2017, të datës 04.03.2022, është shpallur fajtor i dënuari R.S., për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 189, paragrafi 1. të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit, për shkak të kryerjes së kësaj vepre penale është

shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.901/2022, të datës 05.10.2022, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësit të të dënuarit R.S. dhe të përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit D.G., ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pasi i vlerësoj pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoj se:

-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Duke u shqyrtuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimet e paraqitura në të janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP lidhur me nenin 370, paragrafët 6. dhe 7. të KPP dhe me shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat i kanë paraprirë marrjes së një aktgjykimi të tillë, sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.2. lidhur me nenin 388, paragrafi 2. të KPP-së. Në anën tjetër, nga shkresat e lëndës rezulton se ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë kishte paraqitur edhe përfaqësuesi i të dëmtuarit D.G., mirëpo nuk rezulton që një ankesë e tillë t'i jetë dorëzuar të dënuarit dhe mbrojtësit të tij, për të mundur që të paraqesin përgjigje në ankesë, ashtu siç është parashikuar në nenin 388, paragrafi 2. të KPP-së. Në këtë dispozitë ligjore, është parashikuar se "Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve kundërshtare, të cilat mund të paraqesin përgjigje në ankesë brenda 8 (tetë) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës".

Për të vërtetuar një gjë të tillë, gjyqtari raportues i Gjykatës Supreme të Kosovës, duke u bazuar në nenin 435, paragrafi 3. të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të gjitha shkresat e lëndës, duke përfshirë edhe fletë dërgesat, për të shikuar nëse kopja e ankesës së përfaqësuesit të të dëmtuarit t'i jetë dorëzuar palës kundërshtare.

Duke u bazuar në 388, paragrafi 2. të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se është detyrë e gjykatës që një kopje të ankesës t'ia dërgoj palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të ankesës të paraqes përgjigje në ankesë. Në rastin konkret, cilësinë e palës kundërshtare në raport me të dëmtuarin e ka i pandehuri, të cilin e përfaqëson edhe mbrojtësi i tij. Me dërgimin e ankesës palës kundërshtare, kjo e fundit njoftohet me pretendimet e paraqitura në ankesë dhe ka të drejtë që të paraqesë përgjigje në ankesë, duke paraqitur kundër argumente, me qëllim të përfaqësimit sa më të drejtë të të drejtave dhe interesave në procedurë penale. Përveç që është detyrim për gjykatën për t'ia dorëzuar ankesën palës kundërshtare, kjo njëkohësisht është edhe e drejtë e palës kundërshtare, e cila e drejtë është e ndërlidhur edhe me të drejtën e saj për të paraqitur përgjigje në ankesë. Dështimi për ta përmbushur këtë detyrim ("mos dorëzimi i ankesës palës kundërshtare") përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.2. lidhur me nenin 388, paragrafi 2. të KPP-së dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i lartcekur i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të paraqitura më lart, e të cilat kanë rezultuar edhe me shkeljen e parimit të kontradiktor, si njëri prej parimeve kryesore të procedurës penale dhe me shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me një mori vendimesh të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Të gjitha këto shkelje të evidentuara kanë kushtëzuar edhe në anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe kthimin në rigjykim të kësaj çështje pikërisht në gjykatën e shkallës së dytë. Gjykata Supreme e Kosovës thekson se duke u bazuar në nenin 388 të KPP-së, të gjitha veprimet procedurale në lidhje me dorëzimin e ankesës palës kundërshtare dhe kompletimin e mëtejmë të shkresave të lëndës është dashur që t'i ndërmerr gjykata e shkallës së parë. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se "Ankesa kundër aktgjykimit paraqitet në gjykatën e cila ka nxjerr aktgjykimin (gjykatës së shkallës së parë). Kjo gjykatë i dërgon një kopje të ankesës palëve kundërshtare, të cilat mund të paraqesin përgjigje në ankesë brenda 8 (tetë) ditëve nga pranimi i kopjes së ankesës. Kjo gjykatë i përcjell ankesën, përgjigjën dhe shkresat tjera përkatëse në gjykatën që është

kompetente për shqyrtimin e ankesës (gjykata e shkallës së dytë). Ankesa apo kërkesa nga ky nen paraqitet në numër të mjaftueshëm të kopjeve për gjykatën dhe palët kundërshtare".

Duke u bazuar këtë dispozitë ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykata e shkallës së dytë paraprakisht është dashur që ta kontrolloj dosjen dhe nëse vërteton se e njëjta nuk është e kompletuar, në kuptim të dorëzimit në mënyrë të rregullt të aktgjykimit dhe ankesës palëve kundërshtare, atëherë nuk është dashur që ta pranoj fare në shqyrtim këtë çështje penale. Në një situatë të tillë, është dashur që shkresat e lëndës t'i kthehen gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë që si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe ankesat eventuale, t'i dorëzohen në mënyrë të rregullt të gjitha palëve dhe përfaqësuesve të tyre.

Mirëpo, duke e marr për bazë faktin se është anuluar vetëm aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe duke e pasur parasysh se fillimisht gjykata e shkallës së dytë e kishte shtyrë seancën e kolegjit për t'ia dhënë mundësinë palës së dëmtuar që të paraqes ankesë, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që kjo çështje penale t'i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim dhe vendim.

Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së dytë duhet ketë në konsideratë evitimin e vërejtjeve të lartcekura, duke ndërmerr veprimet e përkatëse procedurale, ndërsa më pastaj të marrë një vendim, cili duhet të përpilohet dhe arsyetohet në mënyrën e parashikuar me ligj.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.452/2022, i datës 30.12.2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, e mbrojtësit të të miturit B.H., anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për të Mitur, PAM.nr.107/2022, i datës 12.10.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa, si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. të KPP-së, meqenëse ashtu siç me të drejtë potencohet në kërkesë, të miturit dhe mbrojtësit të tij nuk i janë dërguar ankesat e palës së dëmtuar për të dhënë përgjigje në këtë ankesë, me çka i është cenuar e drejta në mbrojtje dhe nuk është zbatuar dispozita e nenit 388, paragrafi 2. të KPP-së dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Në rishqyrtim, gjykata e shkallës së dytë, duhet të kujdeset që të mënjanohet shkelja e konstatuar dhe pas kësaj të merr vendim lidhur me të gjitha pretendimet ankimore.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.322/2022, i datës 24.08.2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit S.T., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së apelit të Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, PA.1.nr.137/2022, i datës 14.02.2022 dhe çështja i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së dytë.

A r s y e t i m i

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të dënuarit S.T., avokati E.G., pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12 dhe paragrafi 2., nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. të KPP-së, të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se të dënuarit dhe mbrojtësit nuk i është dorëzuar ankesa e palës së dëmtuar për të bërë përgjigje në ankesë, me çka të dënuarit i është mohuar e drejta në mbrojtje dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Po ashtu, mbrojtësi pretendon se në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në dispozitiv theksohet se është aprovuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar,

ndërsa në arsyetim thuhet se është aprovuar ankesa e Prokurorit të Shtetit i cili fare nuk ka bërë ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. të KPP-së, meqenëse ashtu siç me të drejtë potencohet në kërkesë, të dënuarit dhe mbrojtësit të tij nuk i është dërgua ankesa e palës së dëmtuar për të dhënë përgjigje në këtë ankesë, me çka i është cenuar e drejta në mbrojtje dhe nuk është zbatuar dispozita e nenit 388, paragrafi 2. të KPP-së dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Në rishqyrtim, gjykata e shkallës së dytë, duhet të kujdeset që të mënjanohet shkelja e konstatuar dhe pas kësaj të merr vendim lidhur me pretendimet ankimore e duke mos anashkaluar parimin "Reformatio in Peius", nga neni 395 i KPP-së.

5.4. Komente përmbledhëse

Siç shihet, në çështjet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke i kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, përkatësisht në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Arsye për kthimin e çështjeve penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë fakti se palëve tjera nuk i është dërguar ankesa për të pasur mundësi mandej që të paraqesin përgjigje në ankesë.

Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës shihet se mos dërgimi i ankesës palëve tjera, përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 388, paragrafi 3. të KPP-së, pasi që një shkelje e tillë ndikon ose mund të ndikojë në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Përveç që përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, mos dërgimi i ankesës palëve tjera, ka për pasojë edhe me shkeljen e parimit kontradiktor, si njëri prej parimeve kryesore të procedurës penale, si dhe shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së dhe me një mori vendimesh të GJEDNJ-së.

Përndryshe, ka mendime në Gjykatën Supreme të Kosovës që në raste të tilla kur konstatohet se palëve të tjera nuk i është dërguar ankesa për të pasur mundësi që të paraqesin përgjigje në ankesë dhe janë përmbushur kushtet tjera ligjore, atëherë të anulohet vetëm aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, mirëpo çështja penale t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë që kjo gjykatë t'i ndërmerr veprimet që kanë të bëjnë me dërgimin e ankesës palëve tjera dhe kompletimin e dosjes. Kjo për faktin se duke u bazuar në nenin 388, paragrafët 3. dhe 4. të KPP-së, është pikërisht gjykata e shkallës së parë, ajo e cila është e detyruar që kopjen e ankesës t'ia dërgoj palëve tjera, si dhe pas kompletimit të shkresave të lëndës të njëjtat t'ia dërgojë Gjykatës së Apelit të Kosovës për vendosje. Pra, pavarësisht se anulohet vetëm aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, veprimet e lartcekura t'i ndërmerr gjykata e shkallës së parë.

Në kontekst të kësaj çështje dhe për ta evituar këtë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, do të ishte shumë e rëndësishme që Gjykata e Apelit të Kosovës ta ketë në konsideratë një sugjerim të Gjykatës Supreme të Kosovës të paraqitur në rastin Pml.nr.424/2022. Në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës kishte konsideruar se gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit e Kosovës) paraprakisht është dashur që ta kontrollojë dosjen dhe nëse vërteton se e njëjta nuk është e kompletuar, në kuptim të dorëzimit në mënyrë të rregullt të aktgjykimit dhe ankesës palëve kundërshtare, atëherë nuk është dashur që ta pranojë fare në shqyrtim këtë çështje penale. Në një situatë të tillë, është dashur që shkresat e lëndës t'i kthehen gjykatës së shkallës së parë në mënyrë që si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe ankesat eventuale, t'i dorëzohen në mënyrë të rregullt të gjitha palëve dhe përfaqësuesve të tyre.

6. Paqartësia e dispozitivit dhe arsyetimi i pamjaftueshëm i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës

6.1. Dispozita ligjore

Neni 404, paragrafi 1. i KPP-së

Arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës

1. Në arsyetim të aktgjykimit apo të aktvendimit, Gjykata e Apelit të Kosovës vlerëson pretendimet e ankesës dhe tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.

6.2. Komentim i shkurtër i dispozitës së lartcekur ligjore

Vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës në çështjet penale, përveç tjerash duhet të përmbajnë edhe pjesën e arsyetimit, në të cilën pjesë duhet që të paraqiten arsye përkitazi me vendosjen e saj. Para se të trajtohet çështja e arsyetimit, është tejet e rëndësishme që edhe dispozitivi i vendimet të Gjykatës së Apelit të Kosovës në çështjet penale të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe të mos jetë në kundërshtim me arsyetimin e tij.

Në disa raste nga praktika gjyqësore janë vërejtur lëshime të theksuara në këto drejtime, e të cilat për rrjedhojë edhe kanë ndikuar në ligjshmërinë e tyre.
Në anën tjetër, vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës duhet që të përmbajnë edhe pjesën e arsyetimit, me qëllim që të bindën palët, personat tjerë të interesuar dhe opinioni i gjerë për drejtshmërinë e vendosjes së çështjes nga kjo gjykatë.

Arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, qoftë i aktgjykimeve apo aktvendimeve, duhet të fokusohet, në rend të parë, në vlerësimin e pretendimeve të ankesës.

Krahas kësaj, arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duhet të fokusohet edhe në dhënien e vlerësimeve lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore, të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Përmbajtja e arsyetimit, në masë të madhe varet edhe nga lloji i vendimit gjyqësor që është marrë.[146]

Duke u bazuar në këto që u theksuar në lart dhe në nenin 404, paragrafi 1. të KPP-së, në arsyetimin e vendimit (aktgjykimit dhe aktvendimit), Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vlerëson:

1) Pretendimet e ankesës dhe
2) Shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.

[146] HAJDARI, AZEM : Komentar i Kodit të Procedurës Penale, fq. 971.

Sa i përket çështjes së parë, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vlerëson të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë.

Megjithatë, është e rëndësishme që të theksohet se Gjykata e Apelit e Kosovës nuk detyrohet që të shqyrtojë në hollësi çdo pohim të ankesës.[147]

Se në çfarë mase dhe niveli duhet që të vlerësohen pretendimet e ankesës, kjo varet nga rrethanat dhe specifikat e secilit rast veç e veç.

Duke e pasur parasysh arsyetimi i vendimeve gjyqësore duhet të trajtohet edhe nga aspekti i të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt, e drejta për një proces të rregullt nga neni 6 i KEDNJ-së përfshin edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se një aspekt i tillë është trajtuar mjaftueshëm nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore ka theksuar se gjykatat janë të detyruara *"që t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat i kanë bazuar vendimet e tyre"*. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të mbështetura në ligjin e aplikueshëm.[148]

Ndërsa, sa i përket çështjes së dytë, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që t'i tregon edhe shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.

Bazuar në nenin 394, paragrafi 1. të KPP-së, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të shqyrton detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkelje e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, paragrafit 1. të KPP-së ose nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

---

[147] SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP; ELSHANI, XHEVDET: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Komentar, fq. 966.

[148] Rasti KII114/22 me parashtrues Valdet Dumani, aktgjykimi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i datës 24.04.2023. Gjithashtu, shih: Rastin *"Hadjianastassiou kundër Greqisë"*, aktgjykimi i datës 16.12.1992, paragrafi 33.

Shumë çështje që kanë të bëjnë me arsyetimin e vendimeve gjyqësore janë trajtuar në kapitullin e mëparshëm ("Pjesa 9.3.4. Arsyetimi i aktgjykimit"), andaj edhe si të tilla është parë e nevojshme që mos të përsëriten sqarimet e njëjta.

6.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e dispozitivit dhe arsyetimit të vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës

Çështja paqartësisë së dispozitivit dhe mungesës së arsyeve të duhura në vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës kanë qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kështu, në vijim do të paraqiten disa raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit kanë qenë pikërisht këto çështje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.424/2022, i datës 22.11.2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të dënuarit R.S., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.901/2022, i datës 05.10.2022 dhe kjo çështje penale i kthehet në rigjykim të njëjtës gjykatë.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatojë se:

-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Duke u shqyrtuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimet e paraqitura në të janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së lidhur me nenin 370, paragrafët 6. dhe 7. të KPP-së. Duke e analizuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se në arsyetimin e të njëjtit nuk janë paraqitur arsyet të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare për të cilat është paraqitur ankesë nga ana e mbrojtësit të të dënuarit.

Në këtë drejtim, vlen të përmendet fakti se njëri prej pretendimeve ankimore thelbësore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, kishte qenë edhe propozimi për zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë, pasi që i dënuari e kishte dhënë pëlqimin për një të tillë. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk është vlerësuar një propozim i tillë dhe nuk janë paraqitur arsye në lidhje me këtë propozim.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron që gjykata e shkallës së dytë është dashur që me rastin e vendosjes sipas ankesave, e në këtë rast sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit, t'i vlerësojë të gjitha pretendimet ankimore thelbësore dhe propozimet e bëra, si dhe për të gjitha këto të paraqesë arsyet në lidhje me miratimin ose mos miratimin e tyre.

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se mos paraqitja e arsyeve në lidhje me pretendimet thelbësore të paraqitura në ankesë përbën edhe shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe një gjë e tillë është konfirmuar qartësisht edhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nr.KI230/19, të datës 08.01.2021.

- ***Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.109/2023, i datës 24.04.2023***

A K T G J Y K I M

Aprovohen si të bazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve M.M. dhe F.K., ndërsa anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1469/2022, i datës 19.12.2022 dhe kjo çështje penale i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pasi i vlerësoj pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatojë se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtojë dhe analizojë pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve M.M. dhe F.K., konstatojë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që dispozitivi i këtij aktgjykimi është i paqartë, përkatësisht i pakuptueshëm, si dhe nga dispozitivi i aktgjykimit në fjalë rezulton se nuk është vendosur në të tërësi për të gjitha ankesat e paraqitura dhe nuk është shqyrtuar në tërësi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, edhe pse ankesat e mbrojtësve të të dënuarve janë paraqitur për disa baza ankimore.

Të gjitha këto të meta të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2., nën-paragrafët 2.1. dhe 2.7. lidhur me nenet 369, 394, paragrafi 1. dhe 398, paragrafi 3. të KPP-së.

Në këtë mënyrë, nga shkresat e lëndës shihet se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ka këtë përmbajtje si në vijim: “Aprovohet si e bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit M.M., avokatit U.P., Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.85/2020, i datës 07.07.2022, vetëm përkitazi me vendimin mbi konfiskimin e automjetit, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarit M.M., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në tentativë në bashkëkryerje nga neni 315, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së, vendosi dhe udhëzon Policinë e Kosovës, Stacioni Policor në Malishevë, që t’ia KTHEJ veturën e konfiskuar të tipit “Renault Laguna” me targa 0.., II. Në pjesët tjera, aktgjykimi mbetet i pa shqyrtuar”.

Nga kjo del se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë rezulton të jetë i paqartë, përkatësisht i pakuptueshëm, kurse në anën tjetër nuk është vendosur në të tërësi për të gjitha ankesat e paraqitura.

Gjithashtu, nga shkresat e lëndës shihet se ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur te dy mbrojtësit e të dënuarve M.M. dhe F.K., ndërsa nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë fare nuk rezulton që të jetë vendosur në lidhje me ankesën e mbrojtësit të të dënuarit F.K.

Kjo për faktin se nga dispozitivi i aktgjykimit në fjalë vërehet së është vendosur vetëm sa i përket ankesës së mbrojtësit të të dënuarit M.M., në lidhje me kthimin e veturës, por duhet theksuar i njëjti kishte paraqitur ankesë dhe për bazat tjera ankimore, kurse përveç kthimit të veturës, në pjesët tjera, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë kishte mbetur i pa shqyrtuar.

Përveç këtyre paqartësive dhe të metave të dispozitivit, edhe në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është konstatuar se është vendosur vetëm për një ankesë, pasi që në faqen e 4-të të arsyetimit është shënuar se: “Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit,.... dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se: Ankesa e mbrojtësit të pandehurit M.M., avokatit U.P. është pjesërisht e bazuar”.

Në lidhje me këto çështje, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se duke u bazuar në nenin 394, paragrafi 1. të KPP-së, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të shqyrtoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë dhe nëse ekzistojnë shkelje tjera, sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni.

Nga kjo që u theksua më lart, rezulton se me nenin 394 të KPP-së janë përcaktuar kufijtë e shqyrtimit të ankesës nga Gjykata e Apelit e Kosovës, ndërsa nëse janë paraqitur disa ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, atëherë duke u bazuar në nenin 398, paragrafi 3. të KPP-së, Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vendos për të gjitha ankesat kundër të njëjtit aktgjykim me një vendim.

Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç është theksuar edhe më lart dhe si i tillë është juridikisht i paqëndrueshëm, ndërsa këto shkelje, për shkak të natyrës së tyre nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që t'i aprovon si të bazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, ndërsa të anulohet vetëm aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet kësaj gjykate në rigjykim.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së dytë duhet që t'i evitoj të gjitha shkeljet e lartcekura, duke vendosur për të gjitha ankesat e paraqitura kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe duke marrë një vendim të qartë dhe të kuptueshëm, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

6.4. Komente përmbledhëse

Siç shihet, në çështjet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke i kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, përkatësisht në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Arsye për kthimin e çështjeve penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë paqartësia e dispozitivit dhe mos paraqitja e arsyeve të mjaftueshme.

Siç është theksuar edhe më lart, vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës në çështjet penale, përveç tjerash duhet të përmbajnë edhe pjesën e arsyetimit, në të cilën pjesë duhet që të paraqiten arsye përkitazi me vendosjen e saj.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që edhe dispozitivi i vendimet të Gjykatës së Apelit të Kosovës në çështjet penale të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe të mos jetë në kundërshtim me arsyetimin e tij.

Duke u bazuar në nenin 404, paragrafi 1. të KPP-së, në arsyetimin e vendimit (aktgjykimit dhe aktvendimit), Gjykata e Apelit e Kosovës duhet që të vlerëson:

1) Pretendimet e ankesës dhe
2) Shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare.

Në parim, përmbajtja e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në masë të madhe varet edhe nga lloji i vendimit gjyqësor që është marrë.

Është e rëndësishme që të theksohet se e drejta për një proces të rregullt nga neni 6 i KEDNJ-së përfshin edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se një aspekt i tillë është trajtuar mjaftueshëm nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Siç është paraqitur edhe më lart, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në disa raste nga praktika e saj gjyqësore kishte theksuar se gjykatat janë të detyruara *"që t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat i kanë bazuar vendimet e tyre"*. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të mbështetura në ligjin e aplikueshëm.

7. Pjesëmarrja në kolegj e gjyqtarit që është dashur të përjashtohet

7.1. Dispozita ligjore

Neni 38, paragrafi 2. i KPP-së

Bazat për përjashtimin e gjyqtarëve

"Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal. Megjithatë, gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues".

7.2. Komentim i shkurtër i dispozitës së lartcekur ligjore

Shumë çështje që kanë të bëjnë me dispozitën e lartcekur ligjore, përkatësisht me përjashtimin e gjyqtarit janë trajtuar në kapitullin e mëparshëm ("Pjesa 3. Pjesëmarrja në shqyrtim gjyqësor e gjyqtarit i cili është dashur të përjashtohet"), andaj edhe si të tilla është parë e nevojshme që mos të përsëriten sqarimet e njëjta.

Mirëpo, në vijim do të paraqiten disa raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës që i referohen përbërjes së kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës që ka vendosur në çështjet penale.

Duke e interpretuar dispozitën e lartcekur ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës mban qëndrimin se në kolegjin e Gjykatës së Apelit të Kosovës që vendos në lidhje me ankesën kundër aktgjykimit, nuk kanë të drejtë që të marrin pjesë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në kolegjin e kësaj Gjykate që në rastin përkatës ka vendosur sipas ankesës që është paraqitur ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe/ose kundërshtimit të provave.

7.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e pjesëmarrjes në kolegj të gjyqtarit i cili është dashur që të përjashtohet

Çështja pjesëmarrjes në kolegj të gjyqtari i cili është dashur që të përjashtohet ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë. Kështu, në vijim do të paraqiten dy (2) raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë pikërisht kjo çështje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.277/2018, i datës 19.12.2018**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit M.G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.73/2017, i datës 19.01.2018 dhe çështja i kthehet në rivendosje gjykatës së njëjtë.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e të dënuarit, e duke mos u lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera të cekura në kërkesë, gjen se qëndron fakti se gjyqtarët G.Z. dhe S.Q. nuk kanë mund të jenë pjesë e kolegjit për shqyrtimin e ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Kjo nga fakti se me dispozitën e nenit 39, paragrafi 2. të KPP-së, gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues, anëtari i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme, nëse ka marrë pjesë në procedurat e mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues. Rrjedhimisht, sipas dispozitës së paragrafit 2., të nenit 39 të KPP-së, gjyqtari përjashtohet në rastet kur ka marrë pjesë në procedurat e mëparshme në të njëjtin rast penal përveç në rastet kur ka shërbyer si gjyqtar në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë, e që në rastin konkret nuk është, apo kur një gjyqtar ka qenë i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si anëtar i panelit shqyrtues (neni 19, paragrafi 1.21 të KPP-së, përcakton se kolegji shqyrtues apo panel shqyrtues është kolegji i përbërë prej tre gjyqtarëve i cili formohet nga departamenti i njëjtë ose nga Gjykata Themelore për të shqyrtuar dhe gjykuar një kundërshtim kundër urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake). Gjyqtarët e apostrofuar kanë qenë pjesë e shqyrtimit të ankesës kundër vendimit për refuzimin e kundërshtimit ndaj provave dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe me këtë rast kanë shqyrtuar provat në të njëjtën çështje.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga ky fakt e duke mos u lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera, meqenëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin dhe se në marrjen e aktgjykimit kanë marrë pjesë gjyqtarët të cilët nuk kanë mundur të jenë pjesë e kolegjit e që përbënë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së dhe si e tillë kushtëzon anulimin e aktgjykimit të shkallës së dytë.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë duhet të mënjanojë shkeljen e cekur dhe pasi që të vlerësojë pretendimet ankimore të vendos në mënyrë meritore.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.168/2019, i datës 20.06.2019**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit E.A., kurse sipas detyrës zyrtare edhe për pjesën që ka të bëjë me të dënuarin B.G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.328/2018, i datës 28.03.2019 dhe çështja i kthehet asaj gjykate në rivendosje.

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i mbrojtëses së të dënuarit E.A,. është i bazuar, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë kundër të cilit është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12. të KPP-së, sepse në marrjen e këtij vendimi ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohej.

Siç rezulton në shkresat e lëndës në kolegjin penal të gjykatës së shkallës së dytë sipas ankesës me aktgjykimin e evidentuar PAKR.nr.328/2018, datë 28.03.2019, ka vendosur gjyqtarja M.M., e cila ka qenë dashur të përjashtohej, pasi që në të njëjtën çështje penale ka marrë pjesë edhe në kolegjin penal i cili ka vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit E.A., gjatë procedurës përkitazi me kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.779/2017, të datës 05.10.2017.

Me dispozitën e nenit 39, paragrafi 2. të KPP-së, është përcaktuar se “Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtari i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtari që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues”, andaj në rastin konkret në kundërshtim me dispozitën e lartcekur rezulton se në shqyrtimin e ankesës ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në shkeljen e potencuar më lartë nuk ka vlerësuar shkeljet tjera të pretenduara, meqenëse përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin, përkatësisht se në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili ka qenë dashur të përjashtohet, e që kjo përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së dhe si e tillë kushtëzon anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Duke pasur parasysh faktin se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur vetëm në dobi të të dënuarit E.A., Gjykata Supreme e Kosovës, konform dispozitës së nenit 436, paragrafi 2. të KPP-së, ka aplikuar institutin "Beneficium cohasionis", meqë shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të dënuarit E.A., nuk janë të natyrës personale dhe shkojnë në dobi edhe për të dënuarit tjetër B.G., i cili nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

7.4. Komente përmbledhëse

Siç shihet, në çështjet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke i kthyer çështjet penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, përkatësisht në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Arsye për kthimin e çështjes penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë fakti se në përbërjen e kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës kishte marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur që të përjashtohet.

Siç është theksuar edhe më lart, Gjykata Supreme e Kosovës mban qëndrimin se në kolegjin e Gjykatës së Apelit të Kosovës që vendos në lidhje me ankesën kundër aktgjykimit, nuk kanë të drejtë që të marrin pjesë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në kolegjin e kësaj Gjykate që në rastin përkatës ka vendosur sipas ankesës që është paraqitur ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe/ose kundërshtimit të provave.

8. Llogaritja e afatit për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit

8.1. Dispozitat ligjore

Neni 380, paragrafi 1. i KPP-së

"Kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit".

Neni 388, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. i KPP-së

"Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë e hedh ankesën me aktvendim si të pasafatshme, kur konstatohet se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor".

Neni 399 i KPP-së

"Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të pasafatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor".

8.2. Komentim i shkurtër i dispozitave të lartcekur ligjore

Procedura penale përbëhet prej një mori veprimesh procedurale të cilat janë të renditura njëra pas tjetrës sipas një rendi dhe sistemi logjik. Për kryerjen e veprimeve të tilla janë të parapara afatet procedurale. Afatet kanë të bëjnë pikësëpari me veprimet procedurale të palëve. Mirëpo, në procedurë penale hasim edhe afatet të cilat kanë të bëjnë me disa veprime të gjykatës dhe të organeve të tjera të cilat nuk janë afate në kuptimin e plotë të fjalës, por janë afate instruktive.[149] Afati në kuptimin procedural është koha (intervali kohor) brenda të cilit duhet të ndërmerret një veprim procedural.

[149] SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 135.

Afati i ankesës paraqet kohën apo periudhën kohore brenda të cilët palët apo personat e tjerë të autorizuar[150] kanë të drejtë që të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit. Nëse palët dhe personat e tjerë të autorizuar nuk paraqesin ankesë kundër aktgjykimit brenda afatit të përcaktuar me ligj, atëherë këtë të drejtë e humbin.

Afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit është afat ligjor dhe prekluziv.[151]
Është afat ligjor, sepse është i përcaktuar me ligj, ndërsa është afat prekluziv, sepse nuk mund të zgjatet dhe mos paraqitja e ankesës kundër aktgjykimit brenda këtij afati, do të thotë humbje e të drejtës për paraqitjen e ankesës pas këtij afati.

Afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit është i përcaktuar në nenin 380, paragrafi 1. i KPP-së. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se *"Kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit".*

Pra, afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit është tridhjetë (30) ditë, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton se afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit llogaritet nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.

Mirëpo, dita kur është bërë dorëzimi i kopjes së aktgjykimit nuk llogaritet në afat, por që për fillim të afatit merret dita e parë vijuese.[152]

Kur dita e fundit e afatit për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit bie në ditë feste zyrtare, të shtunën ose të dielën ose në ndonjë ditë tjetër kur organi kompetent nuk punon, afati kalon në fund të ditës pasuese të punës.[153]

---

[150] Sipas nenit 381 të KPP-së persona të autorizuar për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit janë: prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit, i dëmtuari ose viktima dhe mbrojtësi i viktimave apo përfaqësuesi i viktimës. Gjithashtu, ankesë mund të paraqesë edhe personi, pasuria e të cilit është konfiskuar.
[151] SHALA, AFRIM: Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, fq. 136.
[152] Neni 445, paragrafi 2. i KPP-së.
[153] Neni 445, paragrafi 4. i KPP-së.

Konsiderohet që ankesa kundër aktgjykimit është e afatshme nëse është dorëzuar para kalimit të afatit të përcaktuar.

Në rastet kur ankesa kundër aktgjykimit dërgohet nëpërmjet postës, postës rekomande apo elektronike apo telegramit ose me ndonjë mjet tjetër si teleks, telefaks ose mjete të tjera të ngjashme, dita e postimit ose e dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për gjykatën që i është dërguar.

Dërguesi apo paraqitësi i ankesës kundër aktgjykimit konsiderohet se nuk e ka lëshuar afatin, kur personi (përkatësisht gjykata) të cilit tentohet t'i dërgohet deklarata nuk e ka marrë me kohë për shkak të gabimeve në mjetet e dërgimit për të cilat dërguesi apo parashtruesi i ankesës nuk ka qenë në dijeni.[154]

Në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës, aktgjykimi i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit në pajtim me dispozitat e nenit 476 të këtij Kodi. Në rastin e tillë, afati për ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimit rrjedhë nga dita e dorëzimit të aktgjykimit të të pandehurit. Kur të pandehurit nuk mund t'i dorëzohet vendimi apo ankesa për shkak të mosdhënies së adresës aktuale apo adresës së kontaktit elektronik, ato vihen në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide.[155]

Nga rregulla se afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit fillon të llogaritet nga momenti i dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, ekzistojnë edhe përjashtime. Kështu, nëse gjykata me rastin e përpilimit me shkrim të aktgjykimit ka bërë gabime emra dhe numra, gabime tjera në shkrim dhe llogaritje, parregullsi në mënyrën e përpilimit të aktgjykimit me shkrim dhe mospërputhje e aktgjykimit me shkrim me origjinalin, me kërkesë të palëve, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare përmirësohen nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues me aktvendim të posaçëm. Në rastin e tillë, afati i ankesës kundër aktgjykimit llogaritet nga dita e dorëzimit të aktvendimit.[156] Përndryshe është e rëndësishme që të theksohet se nëse i pandehuri për shkaqe të arsyeshme nuk paraqet ankesë kundër aktgjykimit brenda afatit, gjykata i lejon kthim në gjendje të mëparshme për paraqitjen e ankesës, nëse brenda tetë (8) ditësh nga pushimi i shkaqeve për mosrespektimin e

[154] Neni 444, paragrafi 3. i KPP-së.
[155] Neni 477, paragrafi 4. i KPP-së.
[156] Neni 371 i KPP-së.

afatit, i pandehuri paraqet kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme dhe paraqet ankesën së bashku me kërkesë.[157]

Pas paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit, është gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ai i cili e verifikon nëse ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues konstaton se ankesa është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, atëherë ankesa hedhet me aktvendim si e pasafatshme.
Kështu, në nenin 388, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1. të KPP-së është parashikuar se *"Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë e hedh ankesën me aktvendim si të pasafatshme, kur konstatohet se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor"*. Nëse ankesa e cila është e pasafatshme nuk është hedhur nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, atëherë një gjë të tillë duhet ta bënë Gjykata e Apelit e Kosovës. Kështu, në nenin 399 të KPP-së është parashikuar se "*Gjykata e Apelit me aktvendim e hedh ankesën si të pasafatshme kur konstaton se është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor".*

8.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e llogaritjes së afatit për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit

Çështja llogaritjes së afatit për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit ka qenë objekt i trajtimit edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë. Kështu, në vijim do të paraqitet një rast nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, ku objekt i shqyrtimit ka qenë pikërisht kjo çështje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.426/2021, i datës 15.12.2021**

A K T GJ Y K I M

[157] Neni 446, paragrafi 1. i KPP-së.

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarës L.T., anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, PA1.nr.392/2021, i datës 18.06.2021 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin PA1.nr.392/2021, e datës 18.06.2021, e ka hedhur si të pasafatshme ankesën e mbrojtësit të të dënuarës L.T.
Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes penale në kuptim të dispozitës së nenit 435, paragrafi 1. dhe nenit 436, paragrafi 1. të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të dënuarës L.T., avokati B.E., pretendon se aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me arsyetimin se ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë është dorëzuar në Postën e Kosovës, më datën 09.03.2021, ndërsa nga shkresa - emaili i datës 27.07.2021 nga menaxheri i Departamentit të Kujdesit ndaj Konsumatorëve vërtetohet se dërgesa R-1.., e destinuar për Gjykatën Themelore në Gjilan është dorëzuar në Postën e Kosovës më datën 05.03.2021, pra në afatin ligjor të paraparë për ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjen se Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PA1.nr.392/2021 e datës 18.06.2021, ka hedhur si të pasafatshme ankesën e mbrojtësit të të dënuarës L.T., duke konstatuar se ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë është dorëzuar në Postën e Kosovës më datën 09.03.2021, pra pas afatit për ushtrimin e ankesës, meqenëse e dënuara e ka pranuar aktgjykimin më datën 19.02.2021.

Në shkresa të lëndës, gjendet kuverta me të cilin është dorëzuar ankesa e mbrojtësit destinuar për Gjykatën Themelore në Gjilan me shenjën R-1.., në të cilën kuvertë është e vërtetë se data kur është dërguar në Postën e Gjilanit është 09.03.2021, mirëpo nga dëftesa për pranimin e dërgesës

nr.2.., vërtetohet se dërgesa me shenjën R-1.., është dorëzuar më datën 05.03.2021, e që vërtetohet edhe nga e-maili, i datës 01.12.2021, nga menaxheri i Departamentit të Kujdesit ndaj Konsumatorëve, i cili e vërteton të njëjtin fakt.

Po ashtu, me të njëjtën e-mail vërtetohet se zyrtarja e Postës me rastin e pranimit të dërgesës, në dëftesë për pranimin e dorëzimit të dërgesës në pjesën ku evidentohet marrësi, në vend që të shkruaj Gjykata Themelore në Gjilan, gabimisht ka shënuar si marrës Gjykatën Themelore në Prishtinë, andaj edhe ankesa me vonesë është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjilan.
Andaj, duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ankesa e mbrojtësit të të dënuarës L.T., avokatit B.E., është dorëzuar në afatin ligjor prej 15 ditësh pas marrjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë andaj edhe e njëjta në rivendosje duhet të shqyrtohet si e afatshme dhe pas shqyrtimit të saj të merret vendim meritor.

8.4. Komente përmbledhëse

Siç shihet, në çështjen e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke e kthyer çështjen penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë, përkatësisht në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Arsye për kthimin e çështjes penale në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë kishte qenë fakti se nuk ishte llogaritur në mënyrën e duhur afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit.

Është e rëndësishme që të theksohet se në rastet kur ankesa kundër aktgjykimit dërgohet nëpërmjet postës, postës rekomande apo elektronike apo telegramit ose me ndonjë mjet tjetër si teleks, telefaks ose mjete të tjera të ngjashme, dita e postimit ose e dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për gjykatën që i është dërguar. Gjithashtu, duhet të përmendet edhe një rregull tepër e rëndësishme për praktikën tonë gjyqësore që ka të bëjë me rastet kur dita e fundit e afatit për paraqitjen e ankesës në ndonjë ditë kur nuk punohet.

Kështu, kur dita e fundit e afatit për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit bie në ditë feste zyrtare, të shtunën ose të dielën ose në ndonjë ditë tjetër kur organi kompetent nuk punon, afati kalon në fund të ditës pasuese të punës.

KAPITULLI III
NDRYSHIMI I AKTGJYKIMEVE TË INSTANCAVE MË TË ULËTA

1. Shqyrtime të përgjithshme në lidhje me kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës në këtë aspekt

Siç është thënë edhe nga tjerët kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitet kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ose kundër procedurës gjyqësore që u ka paraprirë këtyre vendimeve të formës së prerë kur pretendohet se me të është shkelur ligji (ligji penal, shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale ose shkeljeve tjera procedurale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor).

Fillimisht Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrton kërkesën nëse është e afatshme dhe a është e lejuar, respektivisht a është paraqitur nga personi i autorizuar dhe në rast se nuk e hudh kërkesën si të palejuar apo të pa afat dhe vërteton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar, varësisht nga lloji i shkeljes mund të merr aktgjykim me të cilin, e anulon apo ndryshon vendimin e formës së prerë - neni 438 par.1 nënparagrafi 1.1 e 1.2 të KPP-së.

Pra, një nga mënyrat e vendosjes është edhe ndryshimi i aktgjykimeve të gjykatave të instancës me të ulëta, mirëpo, është e rëndësishme të theksohet se jo për të gjitha shkeljet mund të ndryshohen aktgjykimet e instancave me të ulëta, dhe pyetja që parashtrohet është se për cilat shkelje të ligjit Gjykata Supreme e Kosovës e ndryshon aktgjykimin e formës së prerë!

Në të vërtetë në të gjitha rastet kur Gjykata Supreme konsideron se është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit ajo merr aktgjykim me të cilin i ndryshon aktgjykimet e instancave më të ulëta, dhe vlen të theksohet se në këtë drejtim kompetenca e Gjykatës Supreme është e njëjtë me kompetencën e Gjykatës së Apelit si gjykatë e shkallës së dytë në aspektin e ndryshimit të aktgjykimit, mirëpo në aspektin e shqyrtimit të shkeljeve të ligjit penal dhe shkeljeve procedurale shkalla e dytë ka kompetenca më të zgjeruara, sepse shkeljet e ligjit penal dhe disa nga shkeljet procedurale i shqyrton sipas detyrës zyrtare edhe kur aktgjykimi me ankesë nuk kundërshtohet për shkelje të tilla, ndërsa Gjykata Supreme është e kufizuar vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

Vlenë të theksohet, se për dallim prej kodeve të mëparshme procedurale sipas të cilave me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë aktgjykimi i formës së prerë ka mundur të ndryshohet vetëm në favor të personit të dënuar, pra, në rastet kur është shkelur ligji penal në favor të dënuarit vetëm është konstatuar shkelja me qëllim të zbatimit të drejtë të ligjit në të ardhmen, tani ka një risi me kodin e ri të procedurës penale.

Kështu, tani me kodin e procedurës penale që ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2023 është paraparë mundësia e ndryshimit të aktgjykimit të formës se prerë në dëm të pandehurit (neni 4 paragrafi 2 i KPP), por vetëm nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë – neni 438 paragrafi 3 të KPP, dispozitë kjo që në praktiken gjyqësore ka krijuar pasiguri në lidhje me kushtetutshmërinë e neneve në fjalë për këto arsye:

Sipas parimit “ne bis in idem” respektivisht nenit 4 par.1 të kodit të lartcekur, askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale për të cilën është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Sipas par. 2 të të njëjtit nen, me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod parashihet ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike.

Sipas dispozitës së nenit 438 par.1 të KPP-së, kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes: 1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë; 1.2. në tërsi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës me të lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose 1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.

Pra, përkundër që me kodin e ri është paraparë që kërkesa e paraqitur në dëm të dënuarit ka karakter deklarativ, në të njëjtën kohë është paraparë edhe mundësia e ndryshimit të vendimit të formës së prerë në dëm të tij, pa e përcaktuar efektin juridik të ndryshimit (si mund të ndryshohet aktgjykimi lirues i formës së prerë dhe a është kjo dispozitë në kundërshtim me dispozitën e nenit

4 par.1 të KPP-së, në rast se ndryshohet nga ai lirues në dënues a ka të drejtë i pandehuri në ankesë dhe cila gjykatë duhet të vendos lidhur me ankesën, dhe kur një vendim gjyqësor i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë.

Madje, në ketë drejtim me kodin e ri sipas par. 4 të nenit 432, është paraparë mundësia që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë të paraqitet jo vetëm ndaj vendimit të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit, por edhe ndaj vendimit të formës së prerë lidhur me ndërprerjen e paraburgimit.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë për dy raste në praktike një sa i përket vendimit të formës së prerë lidhur me paraburgimin (ku i pandehuri është liruar nga paraburgimi), ka iniciuar kontroll incidental në Gjykatën Kushtetuese dhe duke pasur parasysh se ajo gjykatë është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe për të interpretuar përfundimisht përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën presim që Gjykata Kushtetuese ta jep verdiktin përfundimtar në këtë drejtim.

Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha vendimet lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë merren me aktgjykim, vetëm në rastet kur kërkesa hedhet si e pas asfatshme apo e palejuar merret aktvendim.

2. Arsyet për ndryshimin e aktgjykimeve të instancave me të ulëta.

Vetëm shkeljet e ligjit penal e imponojnë ndryshimin e aktgjykimeve. Shkelja e ligjit penal sipas kodit të procedurës penale respektivisht nenit 385 par.1 të KPP-së ekziston kur:

1.1. vepra për të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale;
1.2. ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
1.3. ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale, sidomos ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë ose faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë;
1.4. lidhur me veprën penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet;

1.5. në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore; ose
1.6. janë shkelur dispozitat për sa i përket llogaritjes së periudhës së paraburgimit, arrestit shtëpiak, çdo periudhe të heqjes së lirisë si dhe dënimit të mbajtur me parë lidhur me veprën penale që është objekt i procedurës penale.

Pra, në rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është shkelur dispozitat e lartcekur, varësisht nga shkelja e konstatuar i ndryshon aktgjykimet e instancave me të ultë duke e liruar nga akuza të dënuarin, duke e refuzuar akuzën, duke e ndryshuar pjesën konfiskuese, kërkesën pasurore juridike dhe vendimin për dënim.

Përkundër faktit se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike me kodet e mëparshme është parapara mundësia që në rastet kur duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka pas dyshim lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara me vendimet kundër të cilave është paraqitë kërkesa, Gjykata Supreme me aktgjykimin me të cilin ka vendosur mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka anuluar vendimet dhe urdhëruar mbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor në gjykatën e njëjtë ose në gjykatën tjetër kompetente të shkallës së parë. Mirëpo, tani me kodin e ri nuk parashihet një mundësi e tillë.

3. Ndryshimi i aktgjykimeve – në rastet kur i dënuari lirohet nga akuza

3.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore

E rëndësishme është se Gjykata Supreme e Kosovës konform dispozitës së nenit 438 të KPP-së ndryshon aktgjykimet e instancave me të ultë dhe merr aktgjykim lirues për shkak se është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit (nenit 385 i KPP) më së shpeshti në këto raste:

a) veprimet inkriminuese të të dënuarit nuk përbejnë vepër penale

c) konkludimet e Gjykatave mbi provat e administruara janë të gabuara, sepse ato nuk i provojnë elementet e veprës penale (subjektive apo objektive) apo faktin se i dënuari e ka kryer veprën penale për të cilën është gjykuar.
d) lidhur me veprën penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet

3.2. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të instancave me të ultë për shkak se veprimet e të dënuarit nuk përbejnë vepër penale

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës supreme të Kosovës rastet më të shpeshta të lirimit nga akuza të të dënuarve janë kur provat të cilat i ka administruara gjykata e shkallës së parë nuk i argumentojnë elementet e veprës penale apo faktin se i dënuari është ekzekutor i veprës penale, pra, konkludimet e gjykatave në bazë të provave të administruara janë të gabuara, kurse me të rralla janë rastet kur veprimet e të dënuarit nuk përbëjnë vepër penale. Në vijim do të jepen raste nga praktika e kësaj Gjykate kur aktgjykimet e instancave me të ultë janë ndryshuar për shkak se veprimet e të dënuarit nuk përbejnë vepër penale.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.327/2022**

AK T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit M.C., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë PM.nr.306/2021, datë 18.02.2022 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.457/2022, datë 16.06.2022, ashtu që i dënuarit M.C., me shënime si në shkresa të lëndës konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP,

Lirohet nga akuza

“ Sepse më datë 9.03.2016, rreth orës 16:05 minuta, në rrugën rajonale Mitrovicë - S.., në fshatin R.., Komuna e M.., duke drejtuar automjetin e tipit Golf IV, ngjyrë e kaltër, me targa .., edhe i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi duke menduar se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë

shkaktimin e saj, nga pakujdesia e ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, shpejtësinë e lëvizjes nuk e ka përshtatur me gjendjen dhe rregullat e rrugës në mënyrë që automjetin të mund ta ndal para çdo pengesë, ashtu që në kundërshtim me nenin 54.1 të Ligjit nr.02/L-70 "Për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor" (LSKRR), në vendin ku shpejtësia e lejuar sipas rregullave të komunikacionit ishte 50 km/h i akuzuari duke vozitur me shpejtësi prej 66km/h në një shkallë-masë të caktuar ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit dhe pasojën e ndaluar, ashtu që derisa ngasësi i biçikletës F.S., ishte duke lëvizur në skajin e djathtë të rrugës përpara veturës se të akuzuarit, në të njëjtin drejtim, për një moment, në kundërshtim me nenin 42 par.1 dhe 3 të LSKRR, në mënyrë të befasishme kthehet majtas duke tentuar që ti kalojë dy shiritat e komunikacionit, duke mos i njoftuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion (me dorën e majtë në pozitë horizontale) dhe duke mos e respektuar distancën e sigurisë deri të vija ndarëse e shiritave gjatë kthimit majtas prej 75 metrave, e cila është më shumë se dy herë krahasuar me distancën e tij prej 31 metrave dhe pa u bindur se a gjendet ndonjë automjet tjetër pas tij në distancë të mjaftueshme të sigurisë prej 41 metrave, me të cilat veprime edhe biçiklisti i ndjeri ka kontribuar në shkallë të theksuar në shkaktimin e aksidentit dhe të pasojës, e në momentin kur i akuzuari e verën se biçiklisti ka filluar kthimin në një mënyrë tenton që ti shmanget aksidentit me dy veprime me manovrim me timon duke e kthyer në të majtë dhe me frenim të vrullshëm, ku edhe përkundër ndërmarrjes së këtyre veprimeve duke dalë me një pjesë të automjetit në shiritin e kundërt të lëvizjes, drejtimi S..,- M.., prapë se prapë me skajin e përparmë të anës së majtë të automjetit e godet biçiklistin, me ç'rast i njëjti rrezohet në parafangon e automjetit e pastaj në rrugë, e si rezultat i kësaj goditje pëson lëndime të rënda trupore, i cili pastaj dërgohet në Spitalin e Mitrovicës, mandej në qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, por që përkundër hospitalizimit dhe mjekimit nuk arrin të mbijetoj dhe vdes më 14.04.2018,

-me çka kishte për të kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, parashikuar me nenin 378 par.9 lidhur me par.6 e 1 të KPRK.

-pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, kurse shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimeve të kundërshtuara në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe pretendimeve në kërkesë Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se:

- Kërkesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me administrimin e provave, e sidomos sipas mendimit dhe konstatimit të grupit të eksperteve të komunikacionit është vërtetuar se aksidenti në trafik në të cilin ka humbur jetën i ndjeri do të shkaktohej edhe sikur i dënuari ta drejtonte automjetin me shpejtësi prej 50 km/h, aq sa ishte e lejuar që do të thotë se aksidenti ka qenë i paevitueshëm për shkak të lëshimeve të ndjerit. Aktgjykimi është në kundërshtim të plotë me konstatimin e ekspertëve të komunikacionit sipas të cilëve rezulton se nuk ka asnjë lidhje kauzale në mes të veprimeve të dënuarit dhe pasojës së ndaluar dhe asnjëra nga gjykatat nuk kanë dhënë sqarime në lidhje me këtë. Ekspertët e komunikacionit kanë konstatuar në super ekspertizën e komunikacionit se shpejtësia e lëvizjes së automjetit " Golf IV" para se të ndodh aksidenti, ka qenë 66 km/h, bazuar në gjurmët e frenimit, ndërsa distanca e automjetit "Golf IV" në momentin kur ngasësi i biçikletës ka arrit te vija ndarëse ka qenë 38.5 metra, kjo distancë është shumë më e vogël se distanca e sigurisë te shpejtësia e kufizuar prej 50 km/h që e ka vlerën 75 metra. Ky rezultat tregon se shoferi nuk ka pasur mundësi teknike për shmangien e këtij aksidenti edhe në rast se do të lëvizte sipas kufizimit të shpejtësisë prej 50 km/h, për shkak të lëshimeve të pjesëmarrësit tjetër të komunikacionit - të dëmtuarit i cili sipas superekspertizës së ekspertëve të komunikacionit ka bërë këto lëshime:

- Ngasësi i biçikletës nuk e ka respektuar distancën e sigurisë deri te vija ndarëse e shiritave gjatë kthimit majtas prej 75 metrave, e cila është më shumë se dy herë krahasuar me distancën e tij prej rreth 31 metra.

- Kthimin majtas e ka bërë befasishëm (të pa pritur) duke tentuar që ti kaloj dy shiritat e komunikacionit, duke mos i njoftuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion (me dorën e majtë në pozitë horizontale).

Duke pasur parasysh ketë gjendje të çështjes, kjo gjykatë vlerëson se në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit M.C., me të drejtë pretendohet se në rastin konkret ndaj të mbrojturit të tij është shkelur ligji penal në dëm të tij.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme në rastin konkret me administrimin e provave nuk është vërtetuar se i dënuari e ka kryer veprën penale dhe me aplikimin e drejt e ligjit penal, në bazë të nenit 364.pika 3. të KPPK u vendos që të lirohet nga akuza.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.118/2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit A.R., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm P.nr.429/2020, datë 8 tetor 2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1565/2021, datë 30 dhjetor 2021, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës të dënuari me shënim personale si në shkresa të lëndës konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP e liron nga akuza sepse:

" Me 22 dhjetor 2019, rreth orës 19:57, në rrugën Prishtinë-Fushë Kosovë, deri sa ishte duke drejtuar automjetin e tipit "VË Tiguan", me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit ..., në shiritin e djathtë të rrugës, nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 54 par.1 të mbi SKRRK-së nr.05/L-088, ka venë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që në zonën me vendbanim të urbanizuar, me kufizim të shpejtësisë 60 km/h, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, ka tejkaluar shpejtësinë e lëvizjes duke lëvizur në momentin e goditjes jo me pak se 70 km/h dhe me të arritur përballë NTP- "N..", me pjesën e parë të anës së djathtë të automjetit e ka goditur në anën e majtë këmbësorin tani të ndjerin G.G., i cili në ato momente sapo kishte filluar të kalonte rrugën nga ana e majtë në të djathtë, shikuar në drejtimin e lëvizjes së automjetit, me ç'rast e ka bartë me automjet e duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse. Aksidentit i ka kontribuar me lëshime këmbësori tani i ndjeri G.G., i cili ka bërë trupimin e rrugës në vend të paraparë për qarkullimin e automjeteve motorike (me katër shirita) jashtë vendbanimit për këmbësorë duke mos pasur kujdes të duhur gjatë trupimit të rrugës, veprimin e kalimit të rrugës, e posaçërisht shiritit të djathtë, e ka

bërë në mënyrë të papritur, të befasishme dhe të pasigurt, si dhe nuk ka ushtruar kujdes të mjaftueshëm gjatë trupimit të rrugës për të mos rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafik.”.

-me çka kishte për kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga 370 par. 9 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, kurse shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa është e bazuar

Sipas super ekspertizës datë 12 janar 2021 të kryer nga tre ekspertë aksidenti është shkaktuar si pasojë e lëshimeve të këmbësorit G.G. dhe kontributit të ngasësit të automjetit “Tiguan”. Lëshimet e këmbësorit janë: e ka bërë trupimin e rrugës në vend të paraparë për qarkullimin e automjeteve motorike (me katër shirita të komunikacionit), jashtë vendkalimit për këmbësorve duke mos pas kujdes të duhur gjatë trupimit të rrugës; veprimin e kalimit të rrugës, e posaçërisht shiritit të djathtë e ka bërë në mënyrë të papritur, të befasishme dhe të pasigurtë; nuk ka ushtruar kujdes të mjaftuar gjatë trupimit të rrugës për mos ti rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion dhe veten. Kurse, kontributi i ngasësit të automjetit VË Taureg është se ka tejkaluar shpejtësinë e kufizuar të lëvizjes (shpejtësia e lejuar e lëvizjes në rruge ka qenë 60km/h, kurse ngasësi i automjetit ka lëvizur me shpejtësi rreth 74 km/h).

Në shqyrtimin gjyqësor është dëgjuar N.L njeri nga tre ekspertët e super ekspertizës i cili e ka mbështet ekspertizën dhe konkludimin e dhënë në të. Mirëpo, sa i përket konkudimit rreth shpejtësisë së lëvizjes së automjetit në momentin e aksidentit ka shtuar se janë bazuar në të vetmen

dëshmi që kanë pas që ka qenë plastika që vendoset në pjesën e pasme të retrovizorit të djathtë, sepse në skicë nuk ka të dhëna për gjurmë të frenimit të automjetit, e që përcaktimi i shpejtësisë sipas kësaj metode mund të ketë devijim standard krahasuar me metodat klasike të përcaktimit të shpejtësisë. Me tej eksperti sikurse në ekspertizën e bërë me shkrim ka deklaruar se ngasësi i automjetit edhe sikur të voziste me shpejtësi prej 60 km/h nuk ka pas mundësi që ta evitojë aksidentin. Madje sipas ekspertit shpejtësia e lëvizjes nga e cila nuk do të vinte fare deri të aksidenti kishte me qenë 20 km/h, kurse kontributi i ngasësit të automjetit manifestohet në natyrën e dëmtimeve të automjetit dhe të lëndimeve të këmbësorit.

Gjykata e shkallës së parë bazuar super ekspertizën e bërë me shkrim nga grupi prej tre eksperteve dhe dëgjimi i njërit nga ekspertët në shqyrtimin gjyqësor vjen në konkludim se i dënuari është përgjegjës penalisht për veprën penale për të cilën është akuzuar, të cilin konkludim e mbeshtet edhe gjykata e shkallës së dytë.

Mirëpo, duke pasur parasysh ketë gjendje të çështjes kjo Gjykatë gjen se pretendimet e mbrojtësit se në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit sepse në veprimet e tij nuk përmbushen elementet e veprës penale për të cilën është shpall fajtor dhe dënuar janë të bazuara, kurse konkudimi i gjykatave se i dënuari është penalisht përgjegjës nuk është i bazuar sepse:

Për tu konsideruar se një person është penalisht përgjegjës për veprën penale të rrezikimi të trafikut publik, ndërmjet veprimit në kundërshtim me ligjin mbi trafikut publik të pjesëmarrësit në trafik dhe pasojës së shkaktuar duhet të ekzistojë lidhja shkakësore apo kauzale, domethënë, nuk ekziston kjo vepër penale, nëse mes drejtimit në kundërshtim me rregullat e trafikut dhe shkaktimit të aksidentit të trafikut ku ndonjë person është lënduar apo ka pësuar apo është shkaktuar dëm material, nuk ekziston lidhja shkakësore që do të mund t'i atribuohej dashjes eventuale apo pakujdesisë së tij.

Bazuar në super ekspertizën e bërë me shkrim dhe të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor del se i dënuari edhe sikur të voziste me shpejtësinë që ishte e lejuar (60 km/h) në rrugën ku kishte ndodh aksidenti nuk do të mund ta evitonte aksidentin, madje aksidenti sipas elaborimit të njërit nga ekspertët do të mund të evitohej vetëm nëse i dënuari do të voziste me një shpejtësi prej 20 km/h (që prapë do të ishte veprim ne kundërshtim me rregullat e trafikut sepse do të pengoheshin

pjesëmarrësit tjerë në trafik), kjo gjykatë vlerëson se në ketë situatë nuk ekziston lidhja kauzale në mes të veprimit dhe pasojës. Kurse, meqë nuk ekziston asnjë korrelacion në mes të veprimit të dënuarit si ngasës i automjetit (tejkalimit të shpejtësisë) dhe aksidentit të shkaktuar kjo gjykatë vlerëson se mendimi i ekspertit sa i përket kontributit të ngasësit të automjetit – tejkalimit të shpejtësisë manifestohet në natyrën e dëmtimeve të automjetit dhe të lëndimeve të këmbësorit është tërësisht i gabuar.

- **Komentet përmbledhëse rreth këtyre dy rasteve**

Në rastet e paraqitura më sipër, por edhe në rastet tjera të kësaj natyre Gjykata Supreme e Kosovës i ka liruar të dënuarit për faktin se nuk ka pas lidhje kauzale mes veprimit dhe pasojës si kushte esencial për të ekzistuar kjo vepër penale. Pra, për të ekzistuar kjo vepër penale nuk është e mjaftueshme vetëm të veprosh në kundërshtim me rregullat e komunikacionit, por të ekzistojë lidhja kauzale mes veprimit në kundërshtim me rregullat e komunikacionit dhe pasojës së shkaktuar, me një fjalë duhet që si rezultat i shkeljes së rregullave të komunikacionit të jetë shkaktuar aksidenti, përndryshe vetëm për faktin se të dy vozitësit e kanë tejkaluar shpejtësinë nuk mund të konkludohet se ata janë përgjegjës për veprën penale. Përkundër faktit se Gjykata Supreme të dënuarit i ka liruar nga akuza në mungesë të provave për shkak se nuk është provuar lidhja kauzale, këto raste janë raste tipike kur vepra penale me të cilën i dënuari është akuzuar nuk përbën vepër penale, ngase në fakt tejkalimi i shpejtësisë hyn në sferën e kundërvajtjes, ndërsa, është shqetësues fakti kur në praninë e ekspertizave të tilla të komunikacionit por edhe të dëgjimit të ekspertit në shqyrtim gjyqësor (se edhe po të vozitës i dënuari në shpejtësinë e lejuar nuk do të mund të shmangej aksidenti) gjykata e shkallës së parë merr aktgjykime dënuese, kurse gjykata e shkallës së dytë e vërteton një aktgjykim të tillë.

3.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të instancave me të ultë për shkak se lidhur me veprën penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet.

Bazuar në përvojën time këto raste janë me te rralla në praktikë, por vijnë në shprehje në rastet kur është zbatuar ligji i cili nuk ka mundur të zbatohet, p.sh kur i dënuari akuzohet për veprime të ndërmarra të cilat nuk kanë qenë inkriminuese, e që me ndryshimet e mëvonshme ligjore janë

inkriminuar. Sipas parimit të ligjshmërisë respektivisht nenit 2 të Kodit Penal askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masat e trajtimit të detyrueshëm për një vepër penale nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si vepër penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë vepër penale.

Sipas dispozitës së nenit 3 të Kodit Penal ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, sipas par.3 të këtij neni nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryesi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar, kurse sipas par. 4 një ligj i cili shprehimisht ka qenë në fuqi për një kohë të caktuar, zbatohet për ato vepra penale që janë kryer gjatë kohës kur ai ka qenë në fuqi edhe në rastin kur nuk është më në fuqi, përveç nëse vetë ligji shprehimisht përcakton ndryshe.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.330/2020**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve R.K., F.I., e B.S., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për të mitur PM.nr.219/2014, datë 11 korrik 2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.641/2019, datë 8 korrik 2020 përkitazi me këta të dënuar, e sipas detyrës zyrtare edhe për të dënuarit A.GJ., Sh.B., M.A., A.P., e Xh.G, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës këta të dënuar me shënim personale si në shkresa të lëndës konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.2 të KPP-së e liron nga akuza sepse:

1. R.K e F.I

a) " Me 10.02.2004 në orët e mbrëmjes duke shfrytëzuar besimin e të miturës B.G., e cila nuk e ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare duke e mashtruar së pari i akuzuari R.K., me të cilin ka pasur lidhje dashurie kohë me parë e ka bindur që të hyn në veturën e tij, hyn në veturë dhe pastaj e shef se brenda ishte i akuzuari F.I., me të cilin i akuzuari R..., është në marrëdhënie frfisnore e të cilët bashkërisht nuk e dërgojnë në shtëpinë e saj por e dërgojnë në fshatin Sllatinë në "Sh..," dhe me të arritur aty të akuzuarit duke iu kërcënuar atë se pari i akuzuari F..., e detyron

që të kryej akt seksual me të, e më pastaj i akuzuari R..., duke vepruar në të njëjtën mënyrë kryejnë aktin seksual me të miturën B.G.

-me çka kishin për të kryer secili veç e veç veprën penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeç, parashikuar me nenin 198 par.1 të KPK-së".

b) të njëjtit të akuzuar R.K e F.I., kanë periudhën prej 20.02.2004 e deri në funde të muajit shkurt 2004 e kanë dërguar të miturën B.G., në Fushë Kosovë, në qebaptoren B.... ku punon i akuzuari A.GJ. dhe pas një bisedë prej një ore me të akuzuarin A.., e kanë shtyrë të njëjtën që të kryejë aktin seksual,

- me secili veç e veç kishin për të kryer veprën penale shtytje në keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeç, parashikuar me nenin 198 par.1 të KPK-së.

2. B.S

"Duke ia mundësuar të akuzuarve R.K., F.I., A.P., e M.Gj., në të ashtuquajturën Sh.., edhe e cila gjendet në fshatin S.., pronë e dajës së tij M.B. të cilin e ka pasnë mbikqyrje nga sa afër saj ka punuar në servisin e tij që të njëjtën shtëpi ta shfrytëzojnë duke iu lënë në dispopzicion të akuzuarve për kryerjen e veprës penale keqpërdorim seksual me të miturën B.G.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale ndihmë në keqpërdorim seksual të personave npën moshën (16) vjeçare, nga neni 198 par.1 lidhur me nenin 25 të KPK-së".

3. A.Gj

"Në periudhën kohore prej 10 shkurtit 2004 gjer në fund të muajit shkurt 2004, i shtyrë nga të akuzuarit R.K. e F.I., të cilët ta sjellin në qebaptore B.., i akuzuari A.., e ka detyruar të njëjtën që të shkoj me të në një hotel në Fushë Kosovë dhe të ketë marrëdhënie seksuale me të,

-me çka kishte për kryer keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeç, parashikuar me nenin 198 par.1 të KPK-së".

4. Sh.B

“Në periudhën kohore prej 10 shkurtit deri në fund të muajit shkurt të vitit 2004 edhe pse e ka ditur se në sh.., në S.., po keqpërdoret seksualisht B.G., i njëjti me veturën e tij e dërgon në ketë shtëpi të akuzuarin A.P., i cila aty ka kryer aktin seksual me B.G.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale ndihmë në keqpërdorim seksual të personave nën moshën (16) vjeçare, nga neni 198 par.1 lidhur me nenin 25 të KPK-së”

5. M.A

“Në relacionin kohor prej 10 shkurt deri në fund të shkurtit të vitit 2004 ka dërguar të miturën B.G., në një banesë në Fushë Kosovës dhe gjatë qëndrimit me të në këtë banesë ka kryer aktin seksual me të njëjtën,

-me çka kishte për kryer keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeç, parashikuar me nenin 198 par.1 të KPK-së”

6. A.P

“Në periudhën kohore prej 10 shkurtit deri në fund të muajit shkurt të vitit 2004 ka shkuar me të akuzuarin Sh.B., në Sh.., në fshatin S.., dhe e ka detyruar të miturën B.G., të kryej akt seksual me të,

-me çka kishte për kryer keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeç, parashikuar me nenin 198 par.1 të KPK-së”.

7. Xh.G

“Gjatë muajit shkurt të vitit 2004 në restorantin A.., në Fushë Kosovë të cilin e mbante vet akuzuari Xh.G., i njëjti pasi që e punëson të dëmtuarën e mitur B.G., e cila ishte e mitur më pas me të në lokalin e tij kryen akt seksual duke qenë në njohuri edhe për moshën e saj,

-me çka kishte për kryer keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeç, parashikuar me nenin 198 par.1 të KPK-së".

Për shkak se vepra penale për të cilën janë shpall fajtor e dënuar nuk ka qenë e përcaktuar me ligj para kryerjes së saj.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, kurse shpenzimet e procedurës penale ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP-së, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesat janë të bazuara

Sipas shkresave të lëndës del se të dënuarit ngarkohen se veprat penale i kanë kryer gjatë shkurtit të vitit 2004, pra, në kohën kur ishte në fuqi Ligji Penal i Kosovës dhe Rregullorja e UNNMIK-ut nr.2001/4 "Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë". Pas ricilësimit juridik të veprave penale në veprën penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeçare – neni 198 par.1 të KPK rezulton se për disa nga të dënuarit (R.K., F.I., e Xh.G.,) kjo vepër penale është shumë më e favorshme ngase për ketë vepër penale maksimumi i dënimit është 10 vite burgim, kurse për veprat për të cilën ata janë fillimisht janë akuzuar maksimumi i dënimit ishte 15 vite burgim, kurse për të dënuarit tjerë (A.P., M.A., A.Gj., Sh.B., e B.S., – të cilët me akuzën fillestare janë akuzuar për veprën penale nga neni 4 pika 2 lidhur me pikën 1 të Rregullores së Unmikut nr.2001/4) vepra penale e ricilësuar është e njëjtë sa i përket dënimit që parashihet me ligj. Mirëpo, pavarësisht kësaj bazuar në përshkrimin e veprimeve inkriminuese sipas veprës penale të ri cilësuar - keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare, nga neni 198 par.1 i KPK-së (vepër penale kjo e paraparë me kodin penal që ka hyrë në fuqi me 6 prill të vitit 2004) dhe genusin apo grupin e veprave penale në kuadër të cilit janë akuzuar fillimisht me akuzë të dënuarit rezulton se kjo vepër

penale nuk ka qenë e përcaktuar si vepër penale sipas ligjit penal që ishte në fuqi në kohën kur të dënuarit ngarkohen ta kenë kryer (Ligjit Penal të Kosovës).

Duke pasur parasysh ketë gjendje të çështjes, kjo Gjykatë vlerëson se në kërkesën e mbrojtëses se të dënuarit B.S., me të drejtë pretendohet se në rastin konkret ndaj të mbrojturit të saj (por edhe të dënuarit tjerë) është aplikuar ligji i cili nuk ka mundur të aplikohet, ngase në kohën kur pretendohet se të dënuarit kanë kryer veprën penale, kjo vepër me këto tipare, nuk ka qenë e paraparë me ligj. Ligji Penal i Kosovës që ishte në fuqi deri në 2004, sanksiononte dhunimin neni 74 par. 2. (*dënimi 3-15 vite burgim*), marrëdhëniet ose veprimet e panatyrshme seksuale me personin që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç etj., Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 "Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovës, e që në nenin 2 sanksiononte trafikimin me njerëz par. 2 (deri në 15 vite burgim), kurse me nenin 4 sanksionohej shfrytëzimi ose sigurimi i shërbimeve seksuale të personit i cili shfrytëzohet seksualisht e që sipas par. 2 të këtij neni parashihej dënimi deri në 10 vjet.

Bazuar në përshkrimin e ngjarjes, si dhe cilësitë e viktimës (*mosha nën 16 vjeç*), nëse nuk bëhet fjalë për trafikim me njerëz dhe shfrytëzim të shërbimeve seksuale, atëherë veprimet e tyre prokurori nuk ka mundur t'i cilësoj sipas nenit 198 e as gjykata të pranoj këtë cilësim juridik, ngase trafikimi me njerëz bie në kapitullin e veprave penale kundërt të drejtës ndërkombëtare, ndërsa vepra penale nga neni 198 në kapitullin e veprave penale kundër integritetit seksual, d.m.th. i përkasin genuseve krejtësisht të ndryshme. Pastaj, nëse sipas prokurorit nuk bëhej fjalë as për dhunim, përkundër faktit se dhunimi (për të cilën janë akuzuar vetëm dy nga të dënuarit) bie ne kapitullin e veprave penale kundër integritetit seksual kjo gjykatë vlerëson se ricilësimi i veprës penale nga prokurori sipas nenit 198 për të gjithë të dënuarit është i gabuar sepse kjo vepër penale nuk ka qenë e paraparë me ligjin i cili ishte në fuqi në kohën kur të dënuarit ngarkohen ta kenë kryer veprën penale. Për këto arsye kjo gjykatë nuk ka mundur ta rikuperoj ricilësimin e veprës penale të berë nga prokurori dhe të pranuar edhe nga gjykatat instancionale.

Prandaj, duke pasur parasysh parimin e legalitetit apo ligjshmërisë – nenit 2 par. 2 i Kodit Penal se askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një vepër nëse para kryerës së saj nuk është përcaktuar me ligj si vepër penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë vepër, kjo gjykatë i ndryshoj

aktgjykimet e kundërshtuara sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i liruar të dënuarit nga akuza, ngase të dënuarit janë akuzuar dhe shpall fajtor për një vepër penale e cila nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale para kryerjes së saj.

Gjykata në raport me të dënuarit: R.K., F.I., A.Gj., Sh.B., M.A., A.P., e Xh.G., i ndryshoj aktgjykimet sipas detyrës zyrtare, duke aplikuar parimin "beneficium cohaesionis", nenit 436 par.2 të KPPK-së, ngase fakte që u shkojnë në favor të dënuarve që kanë paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe e kanë potencuar shkeljen e ligjit penal, shkojnë edhe në favor të atyre që kanë pareshtur kërkesë por nuk e kanë ataku shkeljen e ligjit, sikundër edhe në favor të atyre që fare nuk kanë parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Komenti përmbledhës rreth këtij rasti

Vlen të theksohet se në ketë rast të dënuarit ngarkoheshin se veprat penale i kanë kryer gjatë shkurtit të vitit 2004, pra, në kohën kur ishte në fuqi Ligji Penal i Kosovës dhe Rregullorja e Unmikut nr.2001/4 "Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë", dhe fillimisht të dënuarit ishin akuzuar sipas këtyre ligjeve, por gjatë shqyrtimit gjyqësor kishte ndryshuar ligji penal dhe kishte hyrë në fuqi kodi penal i ri i cili ka hyrë në fuqi me 6 prill 2004. Në fjalën përfundimtare prokurori kishte ndryshuar akuzën duke i ngarkuar të dënuarit për veprën penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeç, nga neni 198 par.1 të KPK-së sipas kodit të ri, por kjo vepër penale nuk parashihej në kohen kur të dënuarit i kishin ndërmarrë veprimet. Ndërsa, çuditërisht gjykata e shkallës së parë nuk e kishte aprovuar ndryshimin e akuzës, por i kishte shpall fajtor të dënuarit sipas akuzës fillestare duke bërë kështu tejkalim objektiv të akuzës, të cilin aktgjykim e anulon Gjykata Supreme, por që në rigjykim të dënuarit shpallen fajtor sipas veprës penale të ricilësuar, e të cilin aktgjykim të shkallës së parë e aprovon edhe shkalla e dytë.

E veçanta e këtij rasti është se jo të gjithë dënuarit kishin ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe jo të gjithë e kishin atakuar shkeljen e ligjit penal përkitazi me faktin se është aplikuar ligji penal i cili nuk ka mundur të aplikohet, pra, vetëm një mbrojtës i ka kundërshtuar aktgjykimet në ketë drejtim. Në fakt Gjykata Supreme përkundër faktit se konform dispozitës së nenit 436 par.1 të KPP në rastet kur vendos mbi kërkesën kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesë pretendon në rastin konkret ka bërë përjashtim

sepse ishte shkelur ligji penal në dëm të të gjithëve të dënuarve, dhe sipas detyrës zyrtare duke aplikuar parimin "beneficium cohaesionis"- par. 2 të nenit të lartcekur i ka ndryshuar aktgjykimet edhe për të dënuarit që nuk kanë parashtrua kërkesë, por edhe të atyre që kanë parashtruar kërkesë por nuk e kanë potencuar këtë shkelje të ligjit penal, ngase faktet që i shkonin në favor të dënuarit që ka paraqitur kërkesë dhe theksuar këtë shkelje të ligjit shkonin në favor të të gjithë të dënuarve tjerë.

3.4. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të instancave me të ultë për shkak se nuk janë argumentuar ndonjëri nga elementet e veprës penale për të cilën është shpall fajtor

Për tu shpallë një person fajtor për vepër penale të caktuara duhet që provat e administruara ta argumentojnë faktin se ai me veprimet e tij ka konsumuar elementet e veprës penale (subjektive dhe objektive), ngase secila vepër penale i ka elementet e posaçme. Në praktikë nuk janë të rralla rastet kur personat akuzohen dhe dënohen për vepra penale, mirëpo që bazuar në provat e administruara gjykatat gabimisht vijnë në konkludim se në veprimet e tyre qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për cilën janë akuzuar.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.240/2018**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të pandehurit I.F., ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.65/2014, datë 17.08.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1070/2017, datë 6.11.2017, ashtu që në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 pika 1.1 të KPP, i dënuari:

Lirohet nga akuza

Sepse me datë 6.12.2011 rreth orës 6:00 në rrugën T.., në Prishtinë i pandehuri se bashku me punëtorët e tjerë të firmës "K..." deri sa ka qenë duke punuar në zgjerimin e rrugës në fjalë, nga

pakujdesia kishin dëmtuar gypin kryesor e si pasojë e këtij dëmtimi ujërat e zeza kanë vërshuar lagjen, në të cilën jeton edhe i dëmtuari Xh.B, me ç'rast ujërat e zeza dhe fekalet kanë depërtuar në shtëpinë e të dëmtuarit dhe si pasojë e kësaj të dëmtuarit i janë dëmtuar orenditë shtëpiake ku vlera e dëmit është vlerësuar të 7.400 €.

-me çka kishte për të kryer veprën penale punime ndërtimore të kundërligjshme, nga neni 294 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Për shkak se nuk është provuar se e ka kryer ketë vepër penale. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil, kurse shpenzimet e procedurës penale ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se

Kërkesa është e bazuar.

Janë të bazuara pretendimet në kërkesë se në rastin konkret është shkelur ligji në dëm të dënuarit. Kështu, siç del nga shkresat e lëndës i dënuari është shpallë fajtor për veprën penale, nga neni 294 par.1 të KPK-së. Element qenësor i kësaj vepre penale është rrezikimi i pasurisë me vlerë të madhe, pra, nuk është përcaktuar dhe specifikuar vlera. Sipas shkresave të çështjes dëmi i shkaktuar nga i dënuari sipas inspektorit IMSH-së, F.A., kap shumën prej 4700 €.

Lidhur me këtë, pra, konceptin e vlerës se madhe Gjykata Supreme e Kosovës më 21 tetor 2010 ka nxjerrë mendim juridik sipas të cilit ka përcaktuar se kur kemi të bëjmë me veprën e tillë penale kjo vepër penale ekziston kur tejkalohet shuma prej 5000 €. Meqë, në rastin konkret dëmi i shkaktuar është në vlerë prej 4700 € dhe dëmi është element përcaktues për ekzistimin e kësaj vepre penale kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të dënuarit nuk përmbushen elëementet e veprës penale për të cilën është shpall fajtor prandaj e liroi atë nga akuza.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.286/2021**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit A.V., ndërsa sipas detyrës zyrtare edhe sa i përket të dënuarit N.Q., ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.432/2017 i datës 18.01.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.310/2021 i datës 02.06.2021, ashtu që,

Lirohen nga akuza

Se prej muajit dhjetor 2016 e tutje në bashkëkryerje e në mënyrë të kundërligjshme kanë uzurpuar pronën e paluajtshme të personit tjetër dhe vazhdojnë t`i mbajnë të uzurpuara ngastrat kadastrale numër P-... dhe P-... në vendin e quajtur "L.." në sipërfaqe prej 2.000 m2, me kulturë bujqësore, e evidentuar në certifikatën numër 2668/16, zona kadastrale P..., Komuna e Sh., pronë e të dëmtuarit, tani të ndjerë B.H., të cilën ai e kishte ble nga S.B.

-me çka kishin për të kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1. lidhur me nenin 31. të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bijnë në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës ndërsa i dëmtuari për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë theksohet se në aktgjykimet e kundërshtuara nuk ceket asnjë element inkriminues i veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, se asnjëherë nuk e ka penguar të dënuarin në shfrytëzimin e parcelës, se edhe nga deklarata e të dëmtuarit del se nuk është takuar me të te prona apo në lokacionin tjetër, përveç një takimi në kafene ku i dënuari ka biseduar me të, pasi e ka pas cilësinë e përfaqësuesit të fshatit.

Gjykata Supreme konstatojë se në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë i cili është përshkruar edhe në këtë aktgjykim, vërtetë nuk ekziston asnjë element-veprim i cili sipas nenit 332.par.1. të KPK-së është element qenjësor i veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme.

Uzurpimi do të thotë pushtim i pronës të paluajtshme që mund të shfaqet me veprime siç janë hyrja në pronë, vënja e kufijve, thurja apo vendosja e sendeve nga uzurpatori, punimi i tokës, mbledhja e frutave nga punimi i tokës, ngritja e objektit dhe veprime të ngjashme me të cilat kryesi vepron sikur pronarë të ishte ai e jo personi që është pronar i paluajtshmërisë.

Në rastin konkret asnjë veprim i këtillë nuk është vërtetuar siç me bazë theksohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e as që janë vërtetuar veprime tjera eventuale si kanosje, detyrim apo diç të ngjashme me të cilin ai eventualisht do të kishte pamundësuar shfrytëzimin e lirë të paluajtshmërisë nga i dëmtuari e që eventualisht kishte treguar për vepër tjetër përkatëse penale.

Për këtë arsye janë të bazuara pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe në dëm të dënuarit është shkelur ligji penal, shkelje kjo nga neni 385 pika 4. të KPPK, sepse në vend të lirohet nga akuza ai është shpallur fajtor, pra, është aplikuar ligji i cili nuk mund të aplikohet.

Gjykata Supreme vërejti se i dënuari N.Q., nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndërsa ky vendim për ndryshimin e aktgjykimeve dhe lirimin e të dënuarve nga akuza e që nuk është i natyrës personale, shkon edhe në dobinë e tij, ashtu që veproj sikur kërkesa e tij të ekzistonte dhe sipas detyrës zyrtare morri vendim të njëjtë edhe për atë, në bazë të nenit 436 par.2 të KPPK.

Nga këto arsye, konform nenit 438. par.1.1 të KPPK u vendos për ndryshimin e aktgjykimeve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndërsa për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pronësoro juridike u vendos në bazë të nenit 454 par.1 dhe 436 par.3 të KPPK.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.414/2022**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojte të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit B.R., aktgjykimet e lartcekura ndryshohen, ashtu që kjo gjykatë, këtë dënuar me shënime personale si në shkresa të lëndës, konform nenit 364, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), e

Liron nga akuza

Sepse: "Më 7 shtator 2019, rreth orës 15:10 minuta, në rrugën "L..,", në Lipjan, me dashje ka përdorë forcën ndaj personit tjetër, ashtu që pasi i dëmtuari F.K., e godet të akuzuarin B.R., me shufër metalike në kokë dhe në shuplakë të dorës, i akuzuari B... e lënë karrocën dhe i shkon në drejtim të dëmtuarit F.., ku i dëmtuari e godet me shufër metalike, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore",

-me çka kishte për të kryer veprën penale sulmi, nga neni 184, paragrafi 1. të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale përkitazi me këtë të dënuar paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

d) Pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.R.,

Mbrojtësi i të dënuarit B.R., në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se gjykata e shkallës së dytë e ka shkelur ligjin penal në dëm të të dënuarit, pasi që i njëjti është shpallur fajtor për veprën penale sulmi, nga neni 184, paragrafi 1. të KPRK, edhe pse nuk janë përmbushur të gjitha elementet e figurës së kësaj vepre penale.

e) Vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës përkitazi me pretendimet e mbrojtësit të dënuarit B.R.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të dënuarit B.R., janë të bazuara, për këto arsye:

Siç është theksuar edhe në pjesën e parë të këtij aktgjykimi, i dënuari B.R., është akuzuar që si bashkekzekutor me B.R., e kanë kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, por pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor është shpallë fajtor për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 187, paragrafi 1. të KPRK dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetëve.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.273/2022, e datës 19 korrik 2022, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të dënuarin Baki Reçica e ka shpallur fajtor për veprës penale sulmi, nga neni 184, paragrafi 1. i KPRK dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur për ankesën e mbrojtësit e të pandehurit B.., dhe sipas detyrës zyrtare e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, duke e shpallë "*fajtor*" të pandehurin (edhe pse ky tani ishte shpallë fajtorë nga gjykata e shkallës së parë, për një vepër penale krejt tjetër nga ajo që ekzistonte në aktakuzën e prokurorit të shtetit), madje duke përshkruar veprimet inkriminuese të veprës penale të sulmit, pra, në një mënyrë e merr rolin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, në aspektin procedural nuk ka pas asnjë mbështetje ligjore në KPP, që ta shpallë fajtor të pandehurin, as që ta ndërtoj një dispozitiv krejt tjetër nga ajo që ka ekzistuar në akuzë, apo nga dispozitivi, respektivisht përshkrimi i veprimeve inkriminuese për të cilën është shpall fajtor nga gjykata e shkallës së parë dhe në këtë rast d.m.th. kjo Gjykatë, në një aspekt ka marr edhe rolin e organit të ndjekjes.

Në fakt, Gjykata e Apelit e Kosovës, ka mundësi t'i vlerësoj ndryshe provat dhe në përputhje me këtë vlerësim të merr vendim tjetër nga ai i gjykatës së shkallës së parë, p.sh. nga aktgjykimi lirues në aktgjykim dënues, ku patjetër i pandehuri shpallet fajtor, mirëpo në asnjë mënyrë nuk ka autorizim ligjor që të pandehurin ta shpallë fajtorë, kur ky tani më është shpallë fajtor.

Gjykata e Apelit e Kosovës mund ta ndryshoj në aspektin juridik-cilësimin e veprës penale, por jo të shkruaj dispozitiv krejt të ri dhe edhe njëherë ta shpallë fajtor të pandehurin.

Kur Gjykata e Apelit e Kosovës e anulon aktgjykimin e shkallës së parë, për shkak të defekteve në fushën e fakteve dhe çështjen nuk e kthen në gjykatën e shkallës së parë, por vendos që çështjen

ta zgjidh në shqyrtim gjyqësor në këtë gjykatë, në rrethana të tilla mund ta shpallë fajtor nëse ka qenë i liruar nga akuza, apo ta liroj nga akuza nëse ka qenë i shpallur fajtor. Mirëpo, edhe në këtë rast, është prokurori i shtetit ai i cili mban të drejtën të ndryshoj aktakuzën në përputhje me faktet e reja që konstatohen në shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e jo gjykata vetë të rishkruaj dispozitiv, ndërsa, duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata e Apelit e Kosovës, i ka tejkaluar autorizimet që me ligj i ka.

Pra, meqë gjykata e shkallës së dytë pretendimet e prokurorit të shtetit në ankesë se i dënuari B.., ka vepruar si bashkëkryerës në veprën penale të vrasjes së rëndë i ka konsideruar si të pabazuara, pra, e ka vlerësuar si të drejtë konkludimin e gjykatës së shkallës së parë se ky i dënuar nuk ka vepruar si bashkekzekutor dhe pastaj ka vlerësuar së nuk është provuar as vepra penale e pjesëmarrjes në rrahje, për të cilën është shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë ajo nuk ka mund ta shpallë fajtor të dënuarin për veprën penale të sulmit.

Në rastet kur kemi të bëjmë me situata, ku në rrahje e sipër, dikush ka pësuar lëndime të rënda apo ka vdekur, nuk mund të bëhet fjalë për sulm, por për pjesëmarrje në rrahje, nëse veprimi i tillë nuk ka karakter të bashkëpunimit.

Nga rrjedha e ngjarjes, nuk del se në rastin konkret kishte pjesëmarrje në rrahje nga ky i dënuar, për faktin se ky përpos që ishte në vendin e krimit, nuk kishte ndërmarr asnjë veprim ndaj tani të ndjerit, siç është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe në arsyetimin e tij, ndërsa me të drejtë gjykata e shkallës së dytë ka konkluduar se nuk janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale.

Mirëpo, meqë gjykata e shkallës së dytë ka konkluduar se në veprimet e të dënuarit të përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk qëndrojnë elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje është dashtë ta liroj nga akuza, por jo të krijojë dispozitiv krejt të ri dhe ta shpallë edhe njëherë fajtor të pandehurin, madje për një vepër tjetër penale.

Pavarësisht të lartcekurave, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se edhe nga provat e administruara dhe vet përshkrimi i ngjarjes, respektivisht i veprimeve inkriminuese nga Gjykata e Apelit e Kosovës për veprën penale të sulmit nuk rezulton se i dënuari me veprimet e tij i ka

konsumuar elementet e kësaj vepre penale, për faktin se sulmi ekziston kur kryesi ka vepruar në trupin e të sulmuarit, i cili sulm nuk ka prodhuar lëndim apo ndonjë pasojë tjetër.

Kështu, në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së dytë theksohet *"se ka përdorë forcën ndaj tjetrit, ashtu që pasi që i dëmtuari F.K., e godet të akuzuarin B.R., me shufër metalike në kokë dhe në shuplakë të dorës, i akuzuari e len karrocën dhe i shkon në drejtim të dëmtuarit F.., ku i dëmtuari e godet me shufër metalike në gjoks, duke i shkaktuar lëndime te lehta trupore"*. Kurse, në arsyetim gjykata përpos që përdorë shprehjen *"i akuzuari B.., e sulmon të ndjerin"* nuk shpjegon me asnjë fjali çfarë ishte ai sulm, a e goditi me grusht, me shqelm etj., pra, nuk është e qartë se në çfarë mënyrë është kryer sulmi, respektivisht ku qëndron sulmi i të pandehurit.

Për arsyet e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës e aprovoj kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit B.R., si të bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuar sa i përket këtij të dënuari i ndryshoj, sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Meqenëse i dënuari B.R., është liruar nga akuza, atëherë shpenzimet e procedurës penale përkitazi me këtë të dënuar do të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës, duke u bazuar në nenin 454, paragrafi 1. të KPP-së.

Komentet përmbledhëse rreth këtyre rasteve

Tek rasti i parë i dënuari është gjykuar dhe shpall fajtor për veprën penale nga neni 294 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të vitit 2004 i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale (6.12.2011) dhe deri në vitin 2013. Sipas dispozitës së nenit 294 par.1 të këtij kodi veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale qëndron në veprim apo mosveprim që është në kundërshtim me dispozitat ose standardet e përgjithshme profesionale të pranuar për projektim, menaxhim a zbatimin e ndërtimit ose punëve ndërtimore dhe në atë mënyrë shkaktohet rrezik për jetën apo trupin e njerëzve ose të pasurisë me vlerë të madhe. Pra, sipas kësaj dispozite nuk përcaktohej vlera e madhe e pasurisë, mirëpo një gjë e tillë ishte bërë nga Gjykata Supreme e cila me mendimin juridik të vitit 2010 ka përcaktuar se dëmi i shkaktuar në pasurinë me vlerë të madhe nënkupton shumën që tejkalon 5000 €. Në rastin konkret nga provat e administruara respektivisht ekspertiza dëmi i shkaktuar ishte në shumë prej 4.700 €, pra, nuk e tejkalonte shumën prej 5000 €, pra, nuk

ishte argumentuar elementi esencial i kësaj vepre penal dëmi i shkaktuar në vlerë që tejkalonte shumën prej 5000 €, prandaj Gjykata Supreme kishte marrë aktgjykim lirues.

Karakteristikë e rastit të dytë është se as në dispozitiv të aktgjykimit nuk theksohet as një element i veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, por as nga provat e administruara nuk argumentohet se i dëmtuari ishte penguar në shfrytëzimin e pasurisë së tij të paluajtshme, prandaj kjo Gjykatë ka marrë aktgjykim lirues.

Kurse, e veçanta e rastit të tretë është se i dënuari me akuzë ngarkohet për veprën penale të vrasjes në bashkëkryerje, shpallet fajtor për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje, nga neni 187 par.1 të KPRK-së, kurse gjykata e shkallës së dytë e shpall edhe njëherë fajtor të dënuarin, por, tani për veprën penale të sulmit, nga neni 184 par.1 të KPRK-së duke përshkruar veprimet inkriminuese të veprës penale të sulmit, pa asnjë mbështetje ligjore. Gjykata e Apelit nuk ka të drejtë të ndërtoj dispozitiv krejt tjetër nga ai që ekziston në akuzë, apo nga dispozitivi i aktgjykimit respektivisht përshkrimi i veprimeve inkriminuese për të cilën është shpall fajtor nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata e Apelit ka të drejtën të vlerësoj ndryshe provat dhe në përputhje me këtë vlerësim të merr vendim tjetër nga ai i gjykatës së shkallës së parë p.sh. nga aktgjykimi lirues në dënues, apo nga aktgjykimi dënues në lirues apo ta ndryshojë në aspektin juridik cilësimin e veprës penale por jo të shkruaj një dispozitiv të ri dhe edhe njëherë ta shpall fajtor të pandehurin.

3.5. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të instancave me të ultë për shkak se provat nuk e argumentojnë faktin se i dënuari është ekzekutor i veprës penale

Në fakt provat në bazë të cilave ngritët akuza duhet të mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale- neni 234 par.1 i KPK-së. Tipari themelor dhe më i vështirë për tu kuptuar i provave është fuqia provuese e tyre apo pesha e tyre në provimin e një fakti apo fakteve relevante, ngase në bazë të fuqisë provuese të tyre gjykata nxjerr konkludim përfundimtar nëse një person është ekzekutor i veprës penale. Nuk janë të rralla rastet kur akuzat ngritën por të akuzuarit edhe shpallen fajtor pa prova të mjaftueshme bazuar vetëm në një provë apo vetëm ne bazë të indiceve fuqia provuese e të cilave nuk është e mjaftueshme për tu shpall një person fajtor.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.191/2020**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit B.B., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.397/2017, datë 12 shkurt 2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.602/2019, datë 14 shkurt 2020, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës të dënuarin konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP e liron nga akuza sepse:

" i akuzuari në cilësinë e personit zyrtar – i.., në Administratën Tatimore të Kosovës e me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshme ka kërkuar ryshfet nga i dëmtuari Sh.G., pronar i firmës "F.., SH.P.K", me seli në Prishtinë për kthimin e mjeteve të rimbursimit të TVSH-së (tatimit të vlerës së shtuar) në atë mënyrë që i pandehuri B.B., në muajin shtator të vitit 2015 është takuar me të dëmtuarin Sh.G., tek një kafene, e cila gjendej në afërsi të Administratës Tatimore të Kosovës-Prishtina 3, në atë mënyrë që i akuzuari ka kërkuar nga i dëmtuari ryshfet shumën e parave prej 1.000 (njëmijë) € për t'ia kthyer mjetet e rimbursimit të TVSH-së, pastaj në një takim tjetër që ishte caktuar nga i akuzuari në muajin tetor të vitit 2015 në bufen e Administratës Tatimore të Kosovës – Prishtina 3, ku i akuzuari i kishte thënë të dëmtuarit se puna e rimbursimit të mjeteve nuk kryhet për 1000 € qysh jemi marr vesh, por për me u krye puna e rimbursimit të mjeteve të TVSH-së ka kërkuar ryshfet shumën prej 5.000 (pesëmijë) € nga i dëmtuari nëse dëshiron për t'ia kthyer mjetet e rimbursimit të TVSH-së, mirëpo i dëmtuari Sh.G., i ka thënë të akuzuarit B.., se nuk t'i jepi asnjëherë 5.000 €, pra "nuk ti jepi paret e mija të cilat i kam fituar me djersën time" duke mos pranuar t'ia jep dhe që nga ajo kohë të dëmtuarit nuk ju kanë kthyer mjetet e rimbursimit të TVSH-së".

-me çka kishte për të kryer veprën penale marrje e ryshfetit, parashikuar me nenin 428 par.1 të KPRK-së.

Për shkak se nuk është provuar se e ka kryer këtë vepër penale.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, kurse shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Kjo Gjykatë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimeve të kundërshtuara gjen se pretendimet e mbrojtësit se në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit sepse nuk është provuar se i dënuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpall fajtor janë të bazuara për këto arsye:

Së pari, nga provat e administruara del se i dënuari në cilësinë e i.., sipas procedurave të rimbursimit të Administratës Tatimore nuk ishte person që kishte kompetencë ekskluzive që të vendoste rreth aprovimit të kërkesës për rimbursim.

Së dyti, dëshmia e te dëmtuarit jo vetëm që është e vetmja provë në këtë çështje por nuk rezulton te jete as kredibile ashtu siç kane konkluduar gjykatat dhe nuk ka mbështetje në asnjë provë tjetër të administruar në ketë çështje. Kjo për faktin se përderisa i dëmtuari pretendon se i dënuari në cilësinë e inspektorit tatimor gjatë muajit shtator dhe tetor të vitit 2015 i kishte kërkuar para, rastin e paraqet më 12.05.2017 në ATK – njësinë e standardeve profesionale, e cila njësi e paraqet rastin në polici. Pastaj, përderisa i dëmtuari në njësinë e standardeve profesionale, në polici dhe në prokurori ka deklaruar se kur i dënuari ia kishte kërkuar paratë me të kishte qenë vetëm me të dënuarin në shqyrtimin gjyqësor deklaron se në kohën kur ia kishte kërkuar paratë i dënuari me të kishte qenë edhe bashkë ortaku i tij N.G., të cilin siç del nga shkresat e lëndës e ka edhe djalë të dajës.
Duke pasur parasysh këtë gjendje nëse i dënuari të dëmtuarit i kishte kërkuar para fillimisht 1000 € pastaj 5000 € që t'ia aprovonte kërkesën për rimbursim pyetja që parashtrohet është pse nuk e lajmëroj rastin menjëherë në polici dhe pse me 12.05.2017 e lajmëroj rastin vetëm në njësinë e standardeve profesionale madje duke theksuar se kishte qenë vetëm me të dënuarin kur ia kishte kërkuar paratë ndërsa tek në shqyrtimin gjyqësor deklaron se kishte qenë më bashkë ortakun e tij N.G., të cilin e ka djalë të dajës dhe pse as ky i fundit se kishte lajmëruar rastin në polici.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.180/2019**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit N.H., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.716/2016, datë 27 shtator 2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.556/2018, datë 25 mars 2019 përkitazi me ketë të dënuar ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës këtë të dënuar konform dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP e liron nga akuza sepse:

"Si person zyrtar duke shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare nuk i ka përmbush detyrat zyrtare me qëllim të mundësojnë të përfitojnë të tjerët dhe të dëmtohet e keqpërdoret pasuria e Qeverisë së Kosovës, dhe seriozisht të shkelën të drejtat e personave tjerë, ashtu që pasi që si Drejtor i P.. në Komisionin Qendror Zgjedhor të Republikës së Kosovës (KQZ) ka bërë deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmerisë së Fondeve dhe këtë e ka aprovuar E.H., si k.., përkatësisht Z.., në KQZ në vlerë prej 472.300.00 € me 14.04.2014. KQZ si autoritet kontraktues (AK) me 16.04.2014 ka publikuar në faqen e Komisionit Rregullativ të P.., (KRPP) njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e Prokurimit "Informimi publik për zgjedhjet e përgjithshme 2014" me nr. prokurimi .., duke caktuar si afat të fundit datën 2.05.2014 për dorëzimin e ofertave e pastaj operatoret ekonomik kanë kërkuar tërheqjen elektronike të dosjes së tenderit nga AK-ja me ç'rast operatori i dëmtuari ekonomik "E." ketë e ka bërë me datë 16.04.2014 në ora 10:16 minuta përmes D.M. të cilit i është dërguar dosja me 16.04.2014 në ora 14:24 minuta, por autoriteti kontraktues ka diskriminuar ketë operator ngase ka shkelur të drejtat e tij nuk i kishte dërguar dosjen identike me atë të operatoreve tjerë duke shkelur nenin 50.4 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) dhe nenin 7.1 të LPP-së e cila dosje e "E." ndryshon esencialisht nga dosjet që u janë dërguar operatorëve tjerë sepse faqja 32 e 33 e "E." ku kanë qenë të specifikuara dokumentet e nevojshme nuk ishin identike me faqen 32 e 33 dërguar operatorëve tjerë me çka tani i akuzuari ka shkelur nenin 69.7 të LPP-së, pastaj pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave Komisioni i AK-së për hapjen e ofertave me 2.05.2014 ka rezultuar se ofertat i kanë dorëzuar 10 operatorë dhe të njëjtin regjistër ia kanë dorëzuar të akuzuarit N.H., ndërsa Komisioni për vlerësimin e ofertave ia ka dorëzuar po këtij të

akuzuari me 10.05.2014 sipas të cilës oferta të përgjegjshme janë “M..” për Lot-1 dhe Lot 2 dhe “A..” për Lot 3, e pastaj i akuzuari N. H. pa e pranuar raportin vlerësues të Komisionit për vlerësimin e ofertave me 8.05.2014 me shkresën .., ka njoftuar K.., të KQZ-së, E.H. për anulimin e aktiviteteve të prokurimit deri me 08.05.2014 me pretekstin se në rrethana të kufizuara kohore në përputhje me nenin 35 të LPP-së, do të zbatohet procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të Kontratës për çka i akuzuari N.H., me postë elektronike me datë 12.05.2014 i kishte njoftuar të gjithë OE që i kanë dorëzuar ofertat e tyre dhe po ketë ditë me shkresën nr.885/2014 e ka bërë njoftimin për KRPP-së, që AK-ja ka zbatuar procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë me çka AK-ja ka shkelur nenin 7.2 të LPP-së që ndalon ekzekutimin e kontratës nëse eliminon konkurrencën apo shkakton diskriminimin dhe pastaj është ftuar vetëm operatori “M..,” duke shkelur nenin 46.6 të Udhëzuesit operativ për KQZ-së që kërkon përzgjedhjen e operatorëve nga OE të përshtatshëm. Autoriteti Kontraktues KQZ-së ka vazhduar me procesin e negocimit të tenderit nga Komisioni i AK-së ku pas hapjes së ofertave është konstatuar se oferta e operatorit “M..” është e përgjegjshme dhe se i plotëson të gjitha kërkesat e cila ka ofertuar me çmim prej 362.005.€ dhe AK-ja ka bërë njoftimin në faqen zyrtare të KRPP-së për dhënie të kontratës këtij operatori me vlerë të përgjithshme prej 358.019.00 € duke shkelur kështu nenin 35.3 të LPP-së që pos tjerash parasheh që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut dhe sipas raportit të Komisionit për vlerësimin e ofertave të AK-së ofertat e disa operatorëve ishin shumë më të ultë se sa të operatorit që u ftua në procedurë negocimi ku AK-së kishte lidhur kontratë me operatorin ekonomik “M..” në vlerë të kontratës 358.019.00€ që në fakt rezulton se është me e madhe se sa ofertat tjera për 164.064 € për sa është dëmtuar buxheti i KQZ-së, ndërsa Kompanisë “E..” ia ka shkelur të drejtat si operator ekonomik në procedurën e Prokurimit duke mos ia dorëzuar dosjen e plotë të tenderit për çka edhe AK-ja kontraktues nuk e ka ftuar në procedurën e negociuar të prokurimit.

-me çka kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare, parashikuar me nenin 422 par.2 të KPRK-së.

Për shkak se nuk është provuar se e ka kryer këtë vepër penale.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil, kurse shpenzimet e procedurës penale ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m i

a) Faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë:

Sipas shkresave të lëndës respektivisht provave të administruara del se: Komisioni Qendror i zgjedhjeve (KQZ) pas aprovimit të buxhetit me vendimin nr. .., datë 15.01.2014 ka miratuar planin final të prokurimit për vitin 2014, meqë viti 2014 ishte vit zgjedhor ku duhej të mbaheshin zgjedhjet e rregullta. N.H. në cilësinë e Drejtorit të prokurimit të KQZ kishte bërë deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmerisë së fondeve në shumë prej 472.300.00 € dhe këtë deklaratë e kishte aprovuar E.H. - Kryeshef Ekzekutiv Administrativ në KQZ-së. Autoriteti kontraktues (KQZ) kishte aplikuar procedurën e hapur për tender dhe më 16.04.2014 ka publikuar në faqen e Komisionit rregullativ të prokurimit publik (KRPP) njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit *" Informimi Publik për zgjedhjet e përgjithshme 2014",* me nr. prokurimi .. Tenderi ishte shpallur prej 15.04.2014 deri më 02.05.2014 në tri loto (Loto 1- produktet e informimit, produksioni i TV-së dhe radio reklamave; Loto II- reklamimi në gazeta, materiali i shtypur; Loto III - transmetimi i TV-së spoteve). Më 30.04.2014 ishte formuar komisioni (në përbërje prej tre vetëve K.S., V.K., e P.Rr.,) për vlerësimin e ofertave. Hapja e ofertave ishte bërë me 30.04.2014 (26 dosje të pranuara, 10 dosje të dorëzuara) dhe në mesin e operatoreve që kishin ofertuar ishte edhe operatori "*E."* kurse si oferta të përgjegjshme (që i kanë plotësuar kushtet) janë konsideruar ofertat nga operatoret ekonomik "M.." – Loto I -139.100,00 € dhe Loto II – 130.00 €, A.. "G.." për Loto III -141.954.00. Rezulton se pa përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave Presidentja e Republikës së Kosovës me 8 maj 2014 kishte marr vendimin 810-2014 me të cilin kishte shpall zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës të cilat duhej të mbaheshin me 8 qershor 2014. KQZ pas vendimit të Presidentes duke pasur parasysh afatin kohor të mbajtës së zgjedhjeve një muaj, si autoritet kontraktues kishte shfrytëzuar procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë - neni 35 i LPP-së. Me këtë rast kishte anuluar aktivitetin e prokurimit në procedurë të hapur dhe për ketë me 12.05.2014 ishte njoftuar KRPP-së dhe të gjithë operatoret ekonomik. Në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit autoriteti kontraktues kishte shfrytëzuar si referencë për t'i ftuar për procedurë të negociuar listën e operatorëve ekonomik nga vlerësimi preliminar i tenderit të anuluar dhe kishte vendosur të procedohet me format e tenderit me një loto. Komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues në ketë procedurë kishte

ftuar vetëm operatorin “M..” si operator të përgjegjshëm (që i kishte plotësuar të gjitha kushtet-konkurruar ne tri loto). Çmimi i ofertës nga ky operator kishte qenë 362.005 €, por gjatë negociatave ishte arritur marrëveshja për zbritje të çmimit për 1.1% për njësi, kurse kontrata është lidhur në vlerë të përgjithshme prej 358.019 €.

Pas lidhjes së kontratës operatori ekonomik “E..” kishte bërë ankesë në Organin shqyrtues të prokurimit (OSHP), i cili organ kishte autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar aktivitetin e prokurimit “Infomimi publik zgjedhjet e parakohshme 2014”. OSHP-ja pas mbajtjes se seancës në të cilën është dëgjuar eksperti, operatorit ekonomik ankues dhe autoritetit kontraktues me vendimin PSH.nr. ..,/2014, datë 2 qershor 2014 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e operatorit “E..”, anuluar kontratën e lidhur mes autoritetit kontraktues (KQZ) me operatorin “M..”, datë 15 maj 2014 sepse e njëjta ishte nënshkruar në kundërshtim me nenin 26 lidhur me nenin 19 par.1 të LPP (nuk ishte nënshkruar nga Kryetarja e KQZ) dhe njëkohësisht kishte urdhëruar autoritetin kontraktues (KQZ) që kontratën për aktivitetin e prokurimit “Informimi publik i zgjedhjeve të parakohshme 2014” me numër prokurimi .., ta lidhë me operatorin “M..” konform nenit 26 par.2 të LPP-së, lidhur me nenin 19 par.2 të LPP-së. Sipas ekspertit të organit shqyrtues ishte i bazuar pretendimi i operatorit ekonomik ankues se është i dërguar një dosje tjetër e tenderit nga dosja origjinale që i është dërguar operatorëve tjerë ekonomik respektivisht autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 50 par. 4 të LPP-së, për arsye se në rastin konkret ka ndryshime në mes të dosjes së dorëzuar operatorit ekonomik ankues dhe operatorëve tjerë ekonomik të interesuar në ketë aktivitet të prokurimit nga ana e autoritetit kontraktues, mirëpo ankesa e operatorit ekonomik ankues ndërlidhet me njoftimin për dhënie të kontratës së publikuar, datë 13 maj 2014 e jo me aktivitetin e Prokurimit të anuluar. Gjatë hetimeve në këtë çështje prokurori kishte urdhëruar edhe ekspertizë financiare. Sipas ekspertizës se ekspertit financiar dosja e tenderit të cilën autoriteti kontraktues (KQZ) ia kishte dërguar operatorit “E..” ndryshon esencialisht nga dosja e tenderit që u është dërguar operatorëve tjerë ekonomik - faqja 32 e 33 e dosjes së tenderit të cilën e kishte pranuar operatori ekonomik “E..” nuk ishte identike me faqen 32 e 33 të dosjes së tenderit e cila u ishte dërguar operatoreve tjerë. Me këtë rast sipas ekspertit është shkelur dispozita e nenit 69, pika 7 të LPP-së, kurse me njoftimin që autoriteti kontraktues ka përdorur procedurën e negociuar të njoftimit për kontratë është shkelur neni 7 par. 2 i LPP-së, sipas të cilës autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutoj asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon

konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose me shumë operatorëve ekonomik. Me rastin e bërjes së ftesës vetëm të një operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit, autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 46 par.6 të Udhëzuesit operativ për prokurim, kurse me njoftimin në faqen zyrtare të KRPP-së për dhënie të kontratës OE "E.." autoriteti kontraktues kishte shkelur dispozitën e nenit 35 par.3 të LPP-së ku thuhet se ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikim të njoftimit në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi që të luaj një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës veçanërisht që ka te bejë me çmimet, afatet e pranimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancionet të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është me i lartë se çmimi i tregut dhe të vlerësoj me kujdes kualitetin e shërbimit ose punës në fjalë. Vlera e kontratës së lidhur ishte 358.019.00 € që rezulton se është me e madhe se ofertat për 164.064.00 € në shumën që sipas ekspertit është dëmtuar buxheti i KQZ-së. Në shqyrtimin gjyqësor eksperti financiar e ka mbështet mendimin dhe konstatimin e tij duke sqaruar se ofertat e pranuara në tenderin e hapur dhe ndryshimi nga oferta e pranuar në tenderin e mbyllur paraqet dëmin e shkaktuar. Sipas dëshmitarit Y.S., del se operatorëve ekonomik gjatë procedurës se hapur të tenderit ky dëshmitar ua kishte dërguar përmes emalit të N.H., sepse ishte i punësuar në bazë të kontratës mbi veprën dhe nuk kishte të drejtë në adresë elektronike. Sipas këtij dëshmitari në lidhje me dosjen e tenderit nuk ishte bërë vërejtje nga askush, në fakt operatorët ekonomik kishin kërkuar sqarime për specifikat e tenderit por jo për mungesë të dokumentacionit, dhe operatoreve ekonomik në lidhje me tenderin e parë dy herë u ishte dërguar dosja e tenderit. Në fakt njësia kërkuese brenda KQZ-sË kishte bërë ndryshime në specifikat teknike dhe si pasojë e këtyre specifikave është parashtruar nevoja që dosja t'u dërgohet edhe njëherë operatorëve ekonomik. Mungesa e faqeve 32 e 33 ishte pasojë e këtyre ndryshimeve, ngase në formularin për dërgimin e tenderit nuk ishte regjistruar kompania "E.." dhe meqë nuk kishte figuruar kjo kompani atëherë dosja as për herë të dytë nuk i ishte dërguar kësaj kompanie dhe në dijeninë e tij përgjegjës për plotësimin e këtij formulari ishte N.H. Pastaj del se me rastin e ngritjes së akuzës operatori ekonomik "E." nuk ishte i përfshirë si palë e dëmtuar por përfshirja e tij si i dëmtuar në rastin konkret është bërë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

b. Vlerësimi juridik i provave nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë

Bazuar në faktet e lartcekura gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se "nga provat e administruara dhe pjesërisht mbrojtja e të pandehurit përtej çdo dyshimi të bazuar mirë është vërtetuar se tani i pandehuri duke vepruar në pozitën e drejtorit të Departamentit të P.., në KQZ në lidhje me tenderin "Informimi publik për zgjedhje të përgjithshme 2014" me rastin e dërgimit të dosjes së tenderit të operatorit ekonomik "E.." kishte diskriminuar ketë operator duke e venë në pozitë të pabarabartë me operator tjerë për arsye se i kishte dërguar pjesërisht dosje tjetër të tenderit në krahasim me operatoret tjerë ashtu që faqet 32 e 33 që kishin të bëjnë me kushtet që duhet t'i plotësojnë operatorët ekonomik i është dërguar deklarata nën betim dhe kërkesa për sekrete afariste, për shkak se operatori ekonomik "E.." nuk ishte në dijeni se duhej të plotësoheshin edhe kushtet që ishin specifikuar në faqet 32 e 33. Kjo kompani nga komisioni vlerësues i KQZ-së, ishte vlerësuar si kompani që nuk i plotësonte kushtet e tenderit, kurse operatori ekonomik "M.." edhe pse kishte ofruar çmime shumë me të larta ishte radhitur në pozitën e parë. Me këto veprime i pandehuri ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale te keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për arsye se me qëllim qe operatorit "E.." t'i pamundësohet pozita e barabartë me rastin e ofertimit në tenderin e hapur nuk i kishte dërguar dosjen komplet dhe atë për kushtet që duhej të plotësoheshin nga operatorët ofertues në ketë tender. Duke qenë një kohë të gjatë në pozitën e Drejtorit të departamentit të p.., ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se me veprimet e tij është duke venë në pozitë të pabarabartë një operator ekonomik kandidat për ofertë dhe po ashtu ishte plotësisht i vetëdijshëm se si pasojë e veprimit të tij ky operator mund të dëmtohej çka me tutje edhe ka ndodhur sepse operatori "E." edhe pse rezultonte me çmimet më të lira të ofruara nuk ishte radhitur si fituese e tenderit dhe në procedurën tjetër të tenderit lidhur me të njëjtin titull ky operator ekonomik nuk ishte thirrur për negocim po ishte shpall fitues operatori "M..". Më tej sipas gjykatës, përtej çdo dyshimi të bazuar është provuar se i pandehuri me të gjitha veprimet e tij operatorin "E.." e ka venë në pozitë të pabarabartë me mosdorëzimin e dosjes së njëjtë të tenderit, ku kishte krijuar bazën që Komisioni vlerësues për oferta këtë kompani ta konsideroj si ofertues që nuk i plotëson kushtet e tenderit dhe e njëjta të përjashtohet dhe për pasojë një kompani tjetër është ftuar në procedurë të negociuar pa publikim të kontratës. Si pasojë e këtyre veprimeve KQZ-së ka lidhë kontratë me operatorin "M.." për shumën prej 472.300 €, ndërsa oferta maksimale për këto shërbime në procedurën e rregullt të tenderimit ishin shumë me të ultë, prandaj nuk ka asnjë dilemë që është dëmtuar buxheti si pasojë e veprimeve të pandehurit". Këto konkludime te gjykatës së shkallës së parë i ka mbështetet edhe gjykata e shkallës së dytë.

c. Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Duke pas parasysh gjendjen e fakteve të përshkruar më lartë dhe konkludimet e gjykatave përkitazi me këto fakte mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit sepse: vepra penale nga neni 422 par.1 të KPK-së, kryhet me dashje direkte, kurse në rastin konkret me asnjë provë të administruar nuk vërtetohet se i dënuari me dashje kishte ndërmarrë një veprim me qëllim që operatorin "E.." ta vendosë në pozitë të pabarabartë me operatoret tjerë. Aktiviteti i Prokurimit lidhur me tenderin Informimi Publik për zgjedhjet e vitit 2014 ishte zhvilluar në dy procedura të ndara të prokurimit dhe atë procedura e hapur me publikim të njoftimit për kontratë dhe procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të cilat janë të pavarura njëra nga tjetra. Anulimi i procedurës së hapur ishte bërë për shkak se Presidentja e Kosovës kishte shpallur zgjedhjet e parakohshme para se te shpallej fituesi i kësaj procedure, dhe ky vendim i Presidentes kishte imponuar ndryshimin e procedurës sepse shërbimet e prokurimit në lidhje me informimin e qytetarëve duhej të zhvilloheshin për 30 ditë e jo për gjashtë muaj. Për anulimin e procedurës së hapur është njoftuar edhe operatori ekonomik "E." dhe i njëjti nuk kishte paraqit kurrfarë kërkese në autoritetin kontraktues që sipas ligjit të prokurimit kishte mundësi ta bëjë (neni 53 pika 1). Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë në mënyrë të pashpjegueshme konstatojnë se vetë fakti se operatori "E." nuk ka pas në dispozicion dy faqe të dosjes se tenderit të parë (procedura e hapur) atë e ka privua nga mundësia që të merr pjesë në tenderin e dytë (procedura pa publikim të njoftimit për kontratë), konstatim ky krejtësisht i pabazuar, aq me tepër kur ky operator edhe në procedurën e hapur e cila ishte anuluar për shkak të vendimit të presidentes nuk kishte aplikuar në tri loto. Pastaj, sipas mbrojtësit sipas Ligjit të Prokurimit nenit 62 - autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit. Procedura e hapur e tenderit "Informimi Publik për zgjedhjet e vitit 2014" është anuluar dhe nuk ka prodhuar kurrfarë pasoje juridike si për operatorin "E." po ashtu edhe për operatoret tjerë. Asnjë dispozitë e Ligjit të Prokurimit nuk përcakton se kalimi prej një procedure në procedurën tjetër të prokurimit në aktivitetin e njëjtë për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme në procedurën e negociuar duhet të

ftohen të gjithë operatorët ekonomik të cilët kanë aplikuar në tenderin e anuluar. Pastaj, neni 35 i Ligjit të Prokurimit parasheh mundësinë që autoriteti kontraktues të negocion vetëm me një operator ekonomik, kurse sipas udhëzuesit operativ për prokurim publik - neni 46.1.*" Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë është procedurë qe e përfshinë autoritetin kontraktues që, pa publik, të negocioj termat e kontratës drejtpërdrejtë me një apo me shumë operator ekonomik. Kjo është një shmangie prej parimeve themelore të çiltërsisë, transparencës, dhe konkurrencës si dhe është procedurë shumë e jashtëzakonshme".*

d. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Kjo Gjykatë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimeve të kundërshtuara gjen se pretendimet e mbrojtësit se në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit sepse në veprimet e tij nuk përmbushen elementet e veprës penale për të cilën është shpall fajtor dhe dënuar janë të bazuara.

Për ekzistimin e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare të parashikuar me nenin 422 të KPK-së duhet të plotësohen kumulaivisht dy kushte: personi zyrtar duhet ta shpërdor detyrën zyrtare me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për peronin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkelë të drejtat e personit tjetër. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në rastin konkret ne veprimet e dënuarit nuk përmbushet asnjëra nga format e kësaj vepre penale për këto arsye:

Së pari në bazë të provave të administruara rezulton me pa mëdyshje se aktiviteti i prokurimit *"Informimi Publik për zgjedhjet e përgjithshme 2014"* fillimisht kishte filluar sipas procedurës se hapur dhe gjate kësaj procedure është evidente se operatorit ekonomik "E." nuk i ishte dorëzuar dosja e tenderit identike me atë të operatorëve tjerë (faqet 32 e 33 ku ishin të specifikuara dokumentet e nevojshme nuk ishin identike me faqet 32 e 33 të dërguar operatorëve tjerë). Por me asnjë provë nuk del i argumentuar fakti se anulimi i kësaj procedurë është bërë me pretekstin e të dënuarit se në rrethana të kufizuara kohore në pajtim me nenin 35 te Ligjit të Prokurimit do të zbatohet procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës ashtu siç ngarkohet me akuzë i dënuari. Ngase, procedura e hapur e prokurimit ishte anuluar për shkak se Presidentja e Kosovës me vendimin .., kishte shpall zgjedhjet e parakohshme të cilat duhej të mbaheshin me 8 qershor

2014 dhe duhej të organizoheshin në afat prej tridhjetë ditëve nga KQZ-ja dhe ky vendim i Presidentes është fakt notor për të gjithë qytetaret e Kosovës, kurse edhe pse ky vendim është administruar si provë gjykatat fare si referohen këtij fakti. Pra, anulimi i procedurës së hapur të prokurimit "Informimi Publik për zgjedhjet e përgjithshme 2014", nuk mund t'i atribuohet pretekstit të dënuarit dhe as qe mund te thuhet se ai ka shkelur nenin 7.2 të LPP-së që ndalon ekzekutimin e kontratës nëse eliminon konkurrencën apo shkakton diskriminimin, sepse anulimi i procedurës se hapur është bërë për shkak të vendimit të Presidentes dhe ka përshirë të gjithë operatoret ekonomik, kurse asnjeri nga operatorët ekonomik edhe kompania "E." pas njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit nuk kanë bërë vërejtje në ketë drejtim.

Së dyti, sa i përket procedurës se negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në dispozitivin e akuzës theksohet:

"është ftuar vetëm M.., duke shkelur nenin 46.6 të Udhëzuesit operativ për KQZ-së që kërkon përzgjedhjen e operatoreve ekonomik të përshtatshëm. Autoriteti kontraktues – KQZ-së ka vazhduar me procesin e negocimit të tenderit nga komisioni i AK-së ku pas hapjes se ofertave është konstatuar se oferta e OE – M.. është e përgjegjshme dhe se i plotëson të gjitha kërkesat e cila ka ofertuar me çmim prej 363.005 € dhe AK-së ka bërë njoftimin ne faqen zyrtare të KRPP për dhënie të kontratës M..-së në vlerë të përgjithshme prej 358.019 € duke shkelur kështu nenin 35.3 të LPP që pos tjerash parasheh që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut dhe sipas raportit të komisionit për vlerësimin e ofertave të AK-së ofertat e disa operatorëve ishin shumë më të ultë se sa ato të operatorit që u ftua në procedurë të negociuar ku AK-së kishte lidhë kontratë me operatorin M.. në vlerë prej 358.019 € që në fakt rezulton se është me e madhe se sa ofertat tjera për 164.064 € për sa është dëmtuar buxheti i KQZ-së, ndërsa kompanisë "E." ia ka shkelur të drejtat si operator ekonomik në procedurën e prokurimit duke mos ia dorëzuar dosjen e plotë të tenderit për çka AK nuk e ka ftuar në procedurën e negociuar të prokurimit".

Mirëpo, për këtë gjykatë nuk është e qartë se në çka konsistojnë veprimet inkriminuese të dënuarit (gjithnjë flitet për autoritetin kontraktues) në këtë fazë të prokurimit. Sipas dispozitës së nenit 4 par.1 nënpar.1.35 të Ligjit të Prokurimit Publik dispozitë kjo që i referohet përkufizimeve të shprehjeve të përdorura në ketë ligj - procedurat e negociuara nënkuptojnë procedurën e prokurimit që i lejojnë autoritetit kontraktues të ftojë dhe të këshillohet me operatoret ekonomik të zgjedhur

nga ai për t'i negociuar kushtet e kontratës me njërin ose me më shumë prej tyre. Kurse, sipas dispozitës së nenit 46 .1 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik "procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë është procedurë që e përfshinë autoritetin kontraktues që, pa publik, të negociojë termat e kontratës drejtpërdrejtë me një apo me shumë operator ekonomik. Kjo është një shmangie prej parimeve themelore të çiltërsisë, transparencës, dhe konkurrencës si dhe është procedurë shumë e jashtëzakonshme". Në rastin konkret autoriteti kontraktues (KQZ) kishte caktuar komisionin vlerësues (në ketë komisioni nuk ishte i dënuari) i cili kishte vendosur që në procedurën e negociuar të përzgjidhet operatori nga lista e operatorëve ekonomik nga vlerësimi preliminar i tenderit të anuluar, dhe kishte përzgjedhur dhe ftuar që të merr pjesë në negociata vetëm operatorin ekonomik "M..," si operator i përgjegjshëm (që kishte plotësuar të gjitha kushtet- kishte ofertuar në tri loto) me të cilin edhe kishte negociuar dhe lidh kontratë (sipas kësaj procedure në një loto) në vlerë të përgjithshme prej 358.019 €. Kurse, është fakt që sipas dispozitës se nenit 46.6 të udhëzuesit pjesëmarrësit në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë duhet të përzgjidhen në mesin e operatorëve ekonomik të përshtatshëm si dhe duhet të ftohen për të marrë pjesë nga ana e autoritetit kontraktues duke mos pas qëllim diskriminimin kundër apo në të mirë të ndonjë operatori ekonomik, mirëpo, në dispozitën e nenit 46.8 të udhëzuesit theksohet se kur autoriteti kontraktues vendos që t'i zhvilloj negociatat me më shumë se një operator ekonomik, negociatat do të zhvillohen sipas dispozitave të neneve 45.14 - 45.22 të Udhëzuesit. Pra, nga interpretimi i këtyre dispozitave te Ligjit të Prokurimit dhe udhëzuesit të këtij del se autoriteti kontraktues ka të drejtë të negociojë edhe me vetëm një operator ekonomik siç edhe ka vepruar në rastin konkret, dhe dispozita e nenit 46.6 e udhëzuesit ka te beje me ftesën e pjesëmarrjeve dhe përzgjedhjes së tyre në ketë procedurë pra, duhet përzgjedhur operatoret ekonomik të përshtatshëm dhe të ftohen për të marrë pjesë nga ana e autoritetit kontraktues duke mos pas qëllim diskriminimin kundër apo në të mirë të ndonjë operatori qoftë kur ftohet një apo me shumë operator).

Së, treti duke pasur parasysh faktin se procedura e hapur apo me publikim të njoftimit për kontratë është anuluar për shkak të zgjedhjeve të parakohshme dhe për të njëjtën arsye autoriteti kontraktues kishte zbatuar procedurën e negociuar pa publikim të kontratës si zgjidhje që e ofronte ligji për prokurimin në raste të tilla konkludimi i gjykatave se "i dënuari ishte plotësisht i vetëdijshëm se si pasojë e veprimit të tij operatori "E." mund të dëmtohej çka me tutje edhe ka ndodhur sepse

operatori “E.” edhe pse rezultonte me çmimet më të lira te ofruara nuk ishte radhitur si fitues i tenderit dhe në procedurën tjetër të tenderit po lidhur me të njëjtin titull ky operator ekonomik nuk ishte thirrur për negocim por ishte shpall fitues operatori – M..” është vetëm supozim i gjykatës që nuk mbështetet me asnjë provë. Madje, gjykata e shkallës së parë operatorin “E.” e përcakton edhe si fitues të tenderit edhe në procedurën e hapur edhe në atë të mbyllur.

Pastaj, nëse për faktin se operatorit “E.” nuk i ishin dërguar dy faqe të dosjes së tenderit në procedurë të hapur ky operator ishte vlerësuar si kompani që nuk i plotësonte kushtet e tenderit dhe për ketë shkak nuk ishte ftuar në procedurën e negociuar atëherë pyetja që parashtrohet është se për cilin fakt nuk u ftuan në procedurën e negociuar edhe operatoret tjerë ekonomik të cilët i plotësonin kushtet, a është dashtë të ftohen edhe ata e pse vetëm operatori “E.” u dashka të jetë i dëmtuar në këtë rast e jo edhe të tjerët që u ishte dorëzuar dosja e plotë e tenderit dhe ishin vlerësuar se i kishin plotësuar kushtet? Si është e mundur që i dënuari të jetë i vetëdijshëm se si pasojë e veprimit të tij operatori “E.” do të mund të dëmtohej e që sipas gjykatës edhe është dëmtuar e të mos jetë i vetëdijshëm për pasojat e veprimit të tij në raport me operatoret e tjerë ekonomik, pra, çfarë veprimi ka ndërmarrë i dënuari në raport me operatoret ekonomik që i kanë plotësuar kushtet respektivisht në çka konsistojnë veprimet e tij në raport me këta operator të cilët nuk janë ftuar në procedurën e negociuar?

Madje, edhe nën supozimin se nuk është respektuar neni 46.6 i udhëzuesit operativ moszbatimi i kësaj dispozite nuk mund t’i vishet të dënuarit si vepër penale ngase nuk argumentohet fakti se ky veprim është ndërmarrë me qëllim të caktuar e aq me tepër ishte komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues ai që kishte ftuar në negociata vetëm një operator ekonomik.

Së, katërti duke pasur parasysh ecurinë e kësaj ngjarje – mënyrën se si është kaluar prej procedurës së hapur të prokurimit në procedurë të mbyllur faktin se autoriteti kontraktues përkitazi me ketë aktivitet të prokurimit kishte mjete të disponueshme në shumë prej 472.300.00 €, kurse në procedurën e negociuar apo të mbyllur kishte negociuar vetëm me një operator ekonomik me të cilin kishte lidhë kontratë në shumë prej 358.019 €, për ketë gjykatë nuk është e qartë se pse autoriteti kontraktues (KQZ) është i dëmtuar në rastin konkret. Për më tepër OSHP-ja, ankesën e operatorit “E.” e ka konsideruar si të bazuar vetëm sa i përket dërgimit të dosjes së tenderit por

nuk e ka anuluar kontratën e lidhur në mes autoritetit kontraktues (KQZ) dhe operatorit ekonomik "M.." për këtë fakt. Kontrata nga ky organ është anuluar vetëm për faktin se është nënshkruar në kundërshtim me nenin 26 lidhur me nenin 19 par.1 të LPP-së (nuk është nënshkruar nga Kryetarja e KQZ) por me të njëjtin vendim është urdhëruar autoriteti kontraktues që kontratën me operatorin "M." ta lidh konform dispozitës së nenit 26 par.2 lidhur me nenin 19 të LPP-së.

Për arsyet e lartcekura kjo Gjykatë vlerëson se në veprimet e të dënuarit nuk është vërtetuar se përmbushen elementet e veprës penale nga neni 422 i KPP-së, siç gabimisht kanë vlerësuar dhe gjykuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, prandaj i ndryshoj aktgjykimet e e këtyre gjykatave dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e liruar të dënuarin nga akuza për ketë vepër penale.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.57/2023**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit N.P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda nr:2019:078275 i datës 28.07.2022 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.477/2022 i datës 21.10.2022 dhe bazuar në nenin 363 par.1 nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i dënuari,

Lirohet nga akuza

Se më datë 09.11.2015, në intervalin kohor prej orës 14:44 deri 15:19 min., në B.., e S.., Komuna e D.., pikërisht në vendin e quajtur "K..", duke qenë se më parë ishte dënuar për vepër penale të vrasjes së rëndë me dashje, e ka privuar nga jeta viktimën tani të ndjerën D.P., nga fshati S.., Komuna e D., në atë mënyrë që derisa e ndjera ditën kritike ishte duke shkuar në punë në këmbë nëpër rrugët e fshatit në drejtim të fshatit S.. dhe kur ofrohet në afërsi të shtëpisë së N.J., kalon i akuzuari me veturën e tij "Jeep Sheroke", me ngjyrë të kaltër - mbyllët, i cili ndalet e merr viktimën me veturë e më pas vazhdon në drejtim të B.., të S.. dhe me të arritur tek vendi i quajtur "K.." e

privon nga jeta në atë mënyrë që nga arma e tipit të panjohur ka shtënë duke e qëlluar dy herë në kokë dhe largohet nga vendi i ngjarjes, kurse kufoma e së ndjerës është gjetur me datë 27.12.2015 në vendin e ngjarje nga disa kalimtar të rastit,

- me çka kishte për të kryer veprën penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.12 të KPRK-së.

Kurse sa i përket dy veprave penale të mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dënimet e shqiptuara në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj merren si të vërtetuara dhe për të cilat dënime bazuar në nenin 80 të KPRK-së, gjykohet me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muaj.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, kurse përfaqësuesi i së ndjerës D.P., për realizimin e kërkesës pasuror - juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

b) Gjetjet e kësaj gjykate përkitazi me pretendimet e kërkesës

Edhe pse mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, por se bazuar në provat e administruara në ketë çështje gabimisht është zbatuar ligji penal kur i dënuari është shpall fajtor për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.12 të KPRK-së. Pra, provat e administruara janë interpretuar në mënyrë të gabueshme dhe janë nxjerr konkludime të gabuara, dhe atë në dëm të të dënuarit, andaj, kjo rrjedhimisht e bën të mundur ndryshimin e aktgjykimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore duke e vendosur këtë çështje në mënyrë meritore.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se meqë në shqyrtimet e kaluara gjyqësore të të dy instancave më të ulëta gjyqësore, janë marrë në konsideratë të gjitha provat e mundshme për vendosjen e kësaj çështje penale, kjo gjykatë duhet t'i jap epilog kësaj çështje penale, për këto arsye: kjo çështje

penale ka filluar prej datës 24.12.2015 (aktvendimi për fillim të hetimit), përkatësisht i datës 08.06.2017 (kur është paraqitur aktakuza) dhe janë marrë katër aktgjykime nga gjykatat e shkallës së parë dhe po aq nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe gjithashtu edhe një aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës, që del se në këtë çështje penale janë marrë nëntë aktgjykime, dhe kur kësaj i shtohet fakti se janë marrë edhe vendime të ndryshme, del se janë tejkaluar standardet kohore të përcaktuar me KPP-së, me nenin 6/1 të KEDNJ, por edhe afati i arsyeshëm kohor për përfundimin e një procesi gjyqësor i aplikuar nga ana e GJEDNJ, të konstatuara në rastet: Cesarini kundër Italisë, Ollson kundër Suedisë, Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë, Marini kundër Shqipërisë, Huseinoviç kundër Sllovenisë dhe Hokanen kundër Finlandës.

Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi pajtohet me konkludimet e nxjerra nga dy instancat gjyqësore se në rastin konkret sipas asaj që ceket në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk rezultojnë të jenë kontestuese rrethanat objektive të rastit dhe atë se: e ndjera D.P., me datë 09.11.2015 kishte dalë nga shtëpia e saj për të shkuar në punë dhe të njëjtën datë edhe është zhdukur. Kufoma e saj ishte gjetur më datë 17.12.2015 në vendin e quajtur “K..”, se e njëjta ishte privuar nga jeta duke u qëlluar dy herë në pjesën e kokës, me një revole të tipit të panjohur. Mirëpo nga këto rrethana, ashtu siç është pretenduar edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, del se kontestuese janë rrethanat subjektive përkatësisht fakti se a ishte kryerësi i veprës penale i pandehuri dhe ishte pikërisht ky aspekt që bëri dallimin mes interpretimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të cilin konstatim e kishte pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë në njërën anë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në anën tjetër.

Gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore aktgjykimet e tyre dënuese i mbështesin në disa prova materiale të cilat do të elaborohen hollësisht në këtë aktgjykim: së pari në lëvizjen e automjetit të të pandehurit në ditën kritike, pra, me datë 09.11.2015 në ora 13:44:13 sekonda, dhe e cila lëvizje regjistrohet nga kamera e vendosur në shtëpinë e N.J., me ç’rast gjykata e shkallës së parë ka paraqitur tri konkludime të cilat nuk janë në harmoni me provat e administruara dhe atë e para se automjeti i të pandehurit ishte ndalur, se ishte hapur dhe mbyllur dera e automjetit dhe pastaj në të kishte hyrë e ndjera D.P.

Mirëpo, këto konstatime të gjykatës së shkallës së parë nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara në provat që gjenden në shkresat e lëndës, meqë faktet e lartë cekura nuk janë vërtetuar me asnjë

provë: së pari *se vetura e të pandehurit ishte ndalur*, dhe kjo mos ndalje e veturës vërtetohet përmes shikimit në video-incizim pasi që koha e aktivizimit të kamerës fillon të ec gjatë tërë kohës, pra duke u nisur nga 13:44:13 sec., e tutje deri në 13:44:28 sec., *fakti se dera e veturës nuk ishte hapur dhe mbyllur*, përveç që vërtetohet përmes shikimit në video-incizim, gjithashtu vërtetohet përmes raportit të AKF-së të datës 08.12.2020, ku është konstatuar se kamerat e vendosura në shtëpinë e N.J., janë aktivizuar me lëvizje të objekteve, ndërkaq në incizimin e "kamerës-3", nuk vërehet hapja apo mbyllja e derës së veturës.

Kurse, fakti i tretë dhe më i rëndësishëm ishte *se e ndjera a kishte hipur në automjetin e të pandehurit* dhe i cili fakt nuk është vërtetuar as edhe me një provë të vetme të drejtpërdrejtë, por as me ndonjë provë rrethanore. Provat që nuk vërtetojnë hipjen e të ndjerës në automjet janë të shumta, por meqë ky është fakt vendimtar në këtë çështje penale, atëherë do të vlerësohen të gjitha provat vendimtare që vërtetojnë të kundërtën e arsyetimit të gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore. Fillimisht asnjë nga dëshmitarët e dëgjuar nuk ka pohuar faktin se e ndjera kishte hipur në automjetin e të pandehurit, dhe për tu mos mjaftuar me dëshmitë e dëshmitarëve, kjo nuk vërtetohet as nga provat materiale, përkatësisht nga raporti i laboratorit të FBI-së në Virgjinia të SHBA, me nr. .., numri i laboratorit .., i datës 06.07.2016, ku konstatohet se nuk është provuar se qimet e flokut apo qimet e tjera që janë tërheqë nga vetura e të akuzuarit të kenë çfarëdo lidhje me viktimën D.P. Përjashtimin e mundësisë së e ndjera ishte në automjetin e të dënuarit e bën edhe raporti i ekspertizës nga Laboratori i Kriminalistikës të TNP-së në Ankara të Turqisë, me numër referues .., i datës 16.05.2015, sipas së cilit vërtetohet se nga shikimi në incizime nuk ka mundur të bëhet identifikimi i tabelave si dhe identifikimi i personave në automjet.

Gjithashtu edhe gjykata e shkallës së dytë përveç që i mbështet të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë, konkludon gabimisht disa fakte të rëndësishme e veçanërisht faktet e konstatuara në faqen e pestë të aktgjykimit të saj se: "*...fakte këto dhe rrethana që pjesërisht nuk i konteston as vet i akuzuari, pra përkitazi me faktet se i akuzuari e mori në automjetin e tij Xhip, tani të ndjerën D.P. dhe vazhdoi rrugën për në drejtim të Lagjes J.., ku edhe kalon pranë shtëpisë së N.J dhe vazhdon përball shtëpisë së G.A, ku më pastaj tani e ndjera edhe është gjetur e vdekur në vendin e quajtur K.., që gjendet në distancë jo të largët nga vendi ku i akuzuari e mori tani të ndjerën D.P., me automjetin e tij...".* Mirëpo, konstatimet e cituara më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të

Kosovës janë në tërësi të paqëndrueshme edhe pa asnjë mbështetje në shkresat e lëndës e aq më pak të pohuara nga ana e të pandehurit, i cili në të gjitha deklarimet e tij ka mohuar kryerjen e veprës penale, pra një përshkrim i tillë është në tërësi imagjinar që nuk korrespondon me provat e administruara.

Gjykata e shkallës së parë tutje në aktgjykimin e saj ka arsyetuar hyrjen e të ndjerës në automjetin e të pandehurit dhe të cilën rrethanë del se e ka vërtetuar përmes dëshmisë së dëshmitarit Q.J., e të cilës dëshmi i jep një rëndësi të veçantë duke e bërë përshkrimin e saj në faqe 33, 36 dhe 37 të aktgjykimit. Mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se përkundër faktit se dëshmia e përshkruar theksohet se është e dëshmitarit Q.J., në fakt përshkruhet deklarimi i dëshmitarit tjetër A.M. Kjo mënyrë e zëvendësimit të dëshmisë së Q.J., me dëshminë e A.M., është e diskutueshme dhe ngre disa probleme të natyrës ligjore.

Së pari, është evident fakti se dëshmitari Q.J., nuk ishte dëgjuar fare gjatë procedurës hetimore dhe dëshmia e tij për herë të parë ishte dhënë me rastin e rigjykimit të çështjes në Gjykatën Themelore në Pejë dhe dëgjimi i tij i dytë në shqyrtimin e parafundit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Dëshmitari Q.J., gjatë dy dëgjimeve të tij gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk ka dhënë asnjë informatë të rëndësishme për veprën penale, për kryerësin dhe rrethana tjera të rëndësishme për procedurën penale, e aq më pak të vërtetojë faktin kryesor të kësaj çështje për hyrjen e të ndjerës në automjetin e të pandehurit. I njëjti pos që pohon faktin se ishte personi që shihej në incizimin e kamerës së shtëpisë së N.J., tutje në tërësi mohon se ishte takuar dhe kishte biseduar me dëshmitarin tjetër përkatësisht zyrtarin policor A.M. Për më tepër, dëshminë e dhënë nga dëshmitari A.M., dëshmitari Q.J., e mohon edhe gjatë ballafaqimit të drejtpërdrejtë me dëshmitarin A.M., (në dy seanca gjyqësore – në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.11.2018 në Gjykatën Themelore në Pejë dhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.10.2020 në Gjykatën Themelore në Ferizaj), duke qenë konsistent në dëshminë e tij se dëshmitarin A.M., për herë të parë e kishte takuar gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Pejë.

Edhe pse qëndron fakti se zyrtari policor - dëshmitari A.M., kishte përpiluar raport zyrtar për bisedën mes tij dhe dëshmitarit Q.J., veprimi i gjykatës së shkallës së parë del të shkojë një hap më tutje dhe në fakt dëshminë e dëshmitarit Q.J., e zëvendëson në tërësi me dëshminë e dëshmitarit A.M., pra, thënë më ndryshe dëshmitari A.M., dëshmoi në tërësi për ngjarjen e dëgjuar nga

dëshmitari Q.J., përkundër që kjo u mohua në tërësi nga ana e dëshmitarit Q.., dhe për më tepër, gjykata e shkallës së parë kësaj dëshmie indirekt i dha një rëndësi vendimtare. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nuk ka dispozitë ligjore për të zëvendësuar një dëshmi të një dëshmitari me dëshminë e dëshmitarit tjetër dhe nuk ishte në autoritetin e gjykatës së shkallës së parë zëvendësimi i kësaj dëshmie, meqë, kjo çështje përveç se nuk ka mbështetje në asnjë dispozitë ligjore është e diskutueshme edhe për faktin se përmes kësaj dëshmie vërtetohet një fakt vendimtar, andaj përpjekja që kjo të vërtetohet përmes një dëshmie indirekte është e pazakontë dhe nuk gjen mbështetje ligjore. Dëshminë e dëshmitarit A.M., e vënë në pikëpyetje edhe aspekte tjera, fillimisht pas përpilimit të raportit .., të datës 21.12.2015 nuk e bëri publik emrin e këtij dëshmitari, përkatësisht e prezantoi vetëm si dëshmitar anonim deri në shqyrtimin gjyqësor të datës 19.11.2018 kur edhe u zbulua identiteti i tij, bisedën e zhvilluar me këtë dëshmitar e bëri vetëm me të, pra, pa praninë edhe të ndonjë personi tjetër (dëshmia e tij në faqen 57 të shqyrtimit gjyqësor të datës 16.11.2020) dhe pa e njoftuar për këtë bisedë as edhe kolegun e tij zyrtarin tjetër policor V.K., i cili ishte hetuesi kryesor i këtij rasti dhe kur këtyre rrethanave u shtohen edhe rrethana tjera veçanërisht duke pasur parasysh faktin se dëshmitari A.M., ishte personi që ndërmori hetimet fillestare në këtë rast dhe që për bisedën e tij dhe dëshmitarit Q.J., nuk e bëri as përpjekjen minimale që dëshminë e këtij dëshmitari ta konvertojë në provë sipas dispozitave ligjore, përkatësisht ta marr në pyetje si dëshmitar me qëllim të përdorimit eventual në fazat e mëvonshme të procedurës penale. Në fakt dëshmitari A.., e ka pas rastin që për dëshmitarin Q.., në atë kohë anonim ta njoftoj gjykatën e shkallës së parë qysh në shqyrtimin fillestar, pavarësisht edhe pse u dëgjua në cilësi të dëshmitarit, nuk e ka dha as edhe një informacion lidhur me njohuritë e tij për dëshmitarin anoni, që më vonë ka dalë të jetë dëshmitari Q.J. Pastaj, vet shprehja e përdorur nga ana e gjykatës së shkallës së parë "dëshmitar anonim" nuk përkon me shprehje adekuate pasi që për tu shpallur dëshmitar anonim një person duhet ndjekur procedurën e përcaktuar (nenet 221 dhe 223 të KPP-së) dhe këtë status mund ta njoh vetëm gjykata dhe nuk është në kompetencën e zyrtarëve policor dhënie e këtij statusi dëshmitarit. Të gjitha këto fakte në tërësinë e tyre gjithsesi e bëjnë mjaft të diskutueshëm rolin e A.M., si dëshmitar kredibil dhe i besueshëm, siç e cilësoi gjykata e shkallës së parë dhe kjo duke e ndërlidhur me faktin se ky dëshmitar ishte personi i kyçur në veprime operative të këtij rasti.

Tutje, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë nuk gjen asnjë mbështetje në provat e administruara, përkatësisht përshkruan faktet që janë në kundërshtim të plotë me shkresat e lëndës, siç është konstatuar në faqen 33 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ku konstatohet se: "*...vërehet që mbyllet dera e veturës nga ana e majtë dhe vetura niset në fillim me shpejtësi normale të nisjes dhe menjëherë shihet qartë përmes video incizimit se me të madhe rritet shpejtësia e lëvizjes se veturës...*" për të vazhduar tutje "*...dhe atë në ora 13:44 e që brenda periudhës kohore deri në ora 14:30 nuk shihet asnjë veturë duke lëvizur në të njëjtin drejtim...".* Por, që të dy këto konstatime nuk janë të qëndrueshme dhe pa asnjë mbështetje në shkresat e lëndës, së pari me asnjë provë nuk konstatohet ndalja e veturës e as nisja e saj e aq më pak hapja dhe mbyllja e derës së veturës, dhe i cili fakt vërtetohet përmes raportit të AFK-së të datës 02.12.2020, ku konstatohet se nuk vërehet hapje apo mbyllje e derës. Kurse fakti i kalimit të veturave tjera në intervalin kohor 13:44 -14:30, vërtetohet përmes një sërë provash materiale të marra nga incizimet e kamerave të shtëpisë së N.J., dhe atë nga shënimet e raportit të policisë të datës 17.12.2015 e konfirmuar edhe me 10 (dhjetë) fotografi (gjashtë të automjetit Grand Cheroke dhe katër të automjetit BMË), ku është konstatuar lëvizja e së paku edhe një veture të tipit BMË dhe atë në ora 13:52:24 në drejtim të njëjtë kah ka lëvizur vetura e të pandehurit. Për më tepër, konstatimi i faktit se prej orës 13:44-14:30 nuk kanë lëvizur automjete tjera është në kundërshtim me vet konstatimet e gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 24.05.2022, me ç' rast në faqen 5, 6 dhe 7 është konstatuar se kamerat e sigurisë nuk janë shikuar deri në këtë kohë, përkatësisht "kamera 1" përfundon së shikuari në ora 14:02:20, "kamera 2" përfundon së shikuari në ora 13:44:31 sec., kurse "kamera 3" përfundon së shikuari në ora 14:02:23 sec., andaj për Gjykatën Supreme të Kosovës është pa asnjë mbështetje në prova fakti i potencuar në aktgjykim se prej orës 13:44 - 14:30 min. nuk ka kaluar asnjë automjet tjetër, kur koha pas orës 14:44:23 sec., as që është shikuar në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.05.2022, andaj, për Gjykatën Supreme të Kosovës është e paqartë se ku e mbështetë gjykata e shkallës së parë këtë arsyetim.

Duke vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me video incizimin e regjistruar nga kamera e shtëpisë së G.A. Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me konkludimet e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore, meqë arsyetimi i tyre është në kundërshtim të plotë me provat e administruara, dhe i pa mbështetur në provat që gjenden në shkresat e lëndës. Vërtetimi i faktit se a kaloi vetura e të pandehurit kah shtëpia e G.A., gjithashtu është një ndër faktet

vendimtare në këtë çështje penale, meqë nuk është kontestues fakti se me datë 09.11.2015 në ora 13:44:51, kishte kaluar një veturë e tipit "Jeep" e ngjashme me veturën e të pandehurit dhe për të cilën çështje gjykata e shkallës së parë theksoi se: "*... kjo veturë është e njëjta me veturën siç ishte regjistruar me kamera te shtëpia e N.J., përkatësisht vetura e të pandehurit...*" Por ky konstatim i gjykatës së shkallës së parë nuk gjen mbështetje në provat e administruara dhe atë fillimisht nga mbrojtja e të pandehurit ku theksohet faktin se nuk kishte kaluar kah kjo shtëpi, por pasi që kishte kaluar shtëpinë e N.J., ishte kthyer në të majtë dhe kishte shkuar kah bunari i fushës dhe te varrezat e fshatit S.. Natyrshëm që Gjykata Supreme e Kosovës nuk u mjaftua për vërtetimin e kësaj rrethane vetëm përmes mbrojtjes së të pandehurit, por kjo është ndërlidhur edhe me prova tjera të administruara nga gjykata e shkallës së parë, pra nga ekspertiza e ekspertëve të forenzikës, ashtu që ekspertët përmes metodave të përdorura të kthjellimit, qartësimit dhe zmadhimit të imazheve të incizimeve dhe me qëllim të ardhjes në përfundim për vërtetimin e faktit nëse vetura e regjistruar te kamera e shtëpisë së N.J., ishte vetura e njëjtë e regjistruar edhe nga kamera e shtëpisë së G.A. Por përkundër kësaj nuk është arritur në përfundim të sigurt se vetura e njëjtë ka kaluar edhe kah shtëpia e G.A., kurse eksperti i forenzikës B.H., nuk kishte konsideruar vetën kompetent për të bërë këtë krahasim, kurse edhe eksperti i komunikacionit nuk e kishte konsideruar vetën kompetent në këtë çështje.

Por, kjo çështje është trajtuar tutje me rastin e daljes së gjykatës së shkallës së parë në vendin e ngjarjes duke angazhuar edhe ekspertë të gjeodezisë me qëllim të matjes së distancës së dy shtëpive (N.J. dhe G.A.,) dhe koha e nevojshme për të kaluar këtë distancë. Megjithëkëtë, gjetjet e gjykatës së shkallës së parë nuk përkojnë me vërtetësinë e provave që janë nxjerr ditën kur është bërë dalja në vendin e ngjarjes. Meqë, siç del nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, i cili ka bërë matjen e largësisë mes pikave, vendit të quajtur "D..,", (pika 1), te vendi i pemës në anën e majtë të rrugës (pika 2), hyrja e shtëpisë së N.J., (pika 3), kurse në ekspertizën e tij të datës 25.05.2022, ka paraqitur të dhëna të detajuara për largësinë e pikave dhe po ashtu është bërë edhe vozitje me automjet për të bërë matjen nga pika fillestare (2) pema në anën e majtë të rrugës e deri te shtëpia e G.A., e që nga kjo vozitje është realizuar me shpejtësi mesatare 40-60 km/h dhe ka rezultuar se rruga është kaluar në kohë prej 1'18":01 (e vërtetuar edhe nga video-incizimi në vendin e ngjarjes). Marrja e kësaj prove në vendin e ngjarjes është bërë me qëllim të matjes së distancës dhe kohës së lëvizjes së automjetit dhe me qëllim të eliminimit të dilemave përkitazi me kohën që nevojitet për

të kaluar nga pika (2) pema në anën e majtë të rrugës deri te shtëpia e G.A., dhe përmes kësaj është vërtetuar fakti se prej vendit pema deri te shtëpia e N.J., distanca ka qenë 449,97 m., kurse distanca mes shtëpisë së N.J., dhe G.A., ka qenë 53,329 m. Por e rëndësishme përmes kësaj provë është vërtetimi i kohës së kaluar me automjet prej vendit të quajtur "P.." e deri te shtëpia e G.A., e cila kohë sipas matjeve në vendin e ngjarjes rezulton të jetë 1'18":01 dhe kjo duke e krahasuar me lëvizjen e automjetit të tipit "Jepp" ditën kritike që kjo rrugë sipas kamerave të dy shtëpive del se është kaluar për vetëm 38" nga ora 13:44:13-13:44:51. Atëherë kjo diferencë në kohë në asnjë rrethanë nuk mund të thuhet se: "*...nuk ishte diferencë e madhe në kohë...*", siç gabimisht konstaton gjykata e shkallës së parë. Por, sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo paraqet një diferencë prej 40 sekonda, meqë sipas një përllogaritje të thjeshtë për tu kaluar kjo rrugë për "38" sekonda automjeti i të pandehurit duhet të lëvizte me shpejtësi rreth 130km/h, e që mundësia e lëvizjes me këtë shpejtësi nëpër rrugë të fshatit do të ishte e dukshme edhe përmes kamerave, por edhe përmes personave tjerë që kanë qenë duke lëvizur në ditën kritike, gjithsesi një faktor shtesë i pamundësisë së lëvizjes me këtë shpejtësi është edhe rruga e ngushtë dhe frekuentimi i automjeteve për shkak të pjesëmarrjes së personave në varrimin e SH.Z.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me konkludimet tjera të nxjerra përkitazi me këto prova nga ana e gjykatës së shkallë së parë, meqë kjo dalje në vendin e ngjarjes nuk është eksperiment, por ishte udhëzim i gjykatës së shkallës së dytë sipas aktvendimit të saj PAKR.nr.366/2021 të datës 29.10.2021 dhe kjo ishte një provë që do të duhej të shqyrtohej në lidhmëni me provat e tjera dhe jo të vlerësohej si e shkëputur, përndryshe është detyrim i gjykatës që secilën provë ta trajtoj në mënyrë të njëjtë dhe pa i dhënë përparësi njërës provë ndaj tjetrës dhe aq më pak të bëhet ndarja në prova dhe eksperimente, siç ka vepruar gjykata e shkallës së parë dhe të cilin arsyetim e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë. Gjithsesi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka kontradiktë të thellë përkitazi me këto prova të marra në vendin e ngjarjes dhe ekspertizën e gjeodetit të datës 25.05.2022, deri sa në disa raste në aktgjykim i quan eksperimente, në faqen e 14 të aktgjykimit i liston si prova të prezantuara dhe atë, procesverbalin e shikimit në vendin e ngjarjes në fshatin S.. dhe në B.., e fshatit S.., vendi "K..", me video - incizim dhe fotografi dhe gjithashtu edhe ekspertizën gjeodezike të ekspertit Z.E. Gjithsesi, kjo provë e ndërlidhur edhe me provat tjera e përjashton mundësinë e kalimit të veturës së të pandehurit rreth shtëpisë së G.A., dhe e përforcon argumentin se lëvizja e tij ishte bërë kah shtëpia e N.J., për të vazhduar te varrezat e

fshatit S.., meqë nuk ishte e mundur sipas matjeve të bëra që distanca prej pemës-afër shtëpisë së N.J., deri te shtëpia e G.A., të kalohet për kohën prej 38 sekonda.

Në vijim të këtij aktgjykimi Gjykata Supreme e Kosovës do të paraqet disa mospajtime me të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi vendin e gjetjes së trupit të të ndjerës. Bazuar në shkresat e lëndës dhe raporti i policisë, nr. .., ref. .., të datës 17.12.2015, del se trupi i të ndjerës ishte gjetur me datë 17.12.2015 në vendin e quajtur "K.." dhe se në këtë raport ishte theksuar fakti se nga vendi ku ishte gjetur trupi i pajetë i të ndjerës është në largësi prej 80 metra larg nga pika e degëzimit të kësaj rruge aty pranë rrugës është një rrugë tjetër e cila ka pjerrtësi mesatare e që shpie në pyll në drejtim të lindjes duke vazhduar nëpër këtë rrugë rreth 20 metra larg në krahun e djathtë shihet trupi i pajetë. Megjithëkëtë, gjykata e shkallës së parë këtë raport për vendin ku u gjet trupi i të ndjerës nuk e merr fare parasysh dhe me këtë i anashkalon edhe disa rrethana të rëndësishme për kryesin e kësaj vepre penale, në rend të parë se si arriti i pandehuri që prej automjetit të tij ta dërgon të ndjerën në vendin ku ishte gjetur trupi i saj. Kjo gjithsesi është e rëndësishme duke e ndërlidhur edhe me gjendjen fizike të të pandehurit që nga shkresat e lëndës del se kishte vështirësi në të ecur, (duke u referua në të dhënat personale në prokurori, aktgjykimin e dytë të Gjykatës Themelore në Pejë, deklarimin e disa dëshmitarëve: S.J., dhe T.P., dhe thirrja e Komisionit mjekësor për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuar ku është thirrur i pandehuri që të paraqitet në këtë komision me qëllim të vlerësimit për të bërë vazhdimin e pensionit të personit me aftësi të kufizuar dhe i cili fakt konfirmohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë e cila në aktgjykimin e saj gjendjen shëndetësore të të akuzuarit e çmon si rrethanë lehtësuese duke konstatuar se: "...*i njëjti për shkaqe shëndetësore nuk mund të ecë në mënyrë normale, pra pa përdorimin e shkopit për ecje*...").

Andaj, nga këto rrethana të konstatuara lindë një pyetje e thjeshtë e cila asnjëherë nuk është trajtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore se a pati mundësi objektive që i pandehuri të e kryejë këtë vepër penale duke marrë parasysh gjendjen e tij fizike në njërën anë dhe gjendjen fizike të të ndjerës në anën tjetër (person në moshë të re dhe me gjatësi rreth 1.70 cm.- bazuar në të dhënat nga shkresat e lëndës) dhe këto dy rrethana duke i ndërlidhur me vendin ku pretendohet se ishte kryer vrasja, vend malor dhe në të dy anët e rrugës e rrethuar me shkurre e drunjtë të lartësive të ndryshme (të vërtetuara nga raporti i këqyrjes në vendin e ngjarjes i skicuar, fotografitë e vendit ku u gjet trupi i pajetë i të ndjerës dhe video-incizimi me rastin e shikimit në vendin e ngjarjes).

Pra, gjykata e shkallës së parë do të duhej që bazuar në këto rrethana të vinte në përfundim se si arriti i pandehuri që të ndjerën ta nxjerr nga vetura e tij të e dërgojë në vendin e ekzekutimit dhe ta ekzekutojë atë me dy plumba në kokë. Por, këto rrethana janë heshtur dhe kanë mbetur pa përgjigje në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kjo është në kundërshtim edhe me përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit të kësaj gjykate dhe në kundërshtim edhe me ekspertizën e ADN e përpiluar nga ana e AFK-së, e datës 15.02.2016 në të cilën është konstatuar se në vendin e ngjarjes ku ishte gjetur trupi i të ndjerës nuk ka përputhshmëri me mostrat e marra të të pandehurit.

Në këtë çështje penale një ndër provat më të rëndësishme që është administruar nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka qenë telefonata e të pandehurit ditën kritike, pra me datë 09.11.2015 në ora 15:19, me ç' rast për realizimin e kësaj telefonate ishte aktivizuar antena Z.., që ishte në afërsi të vendit ku ishte gjetur trupi i të ndjerës dhe gjykata e shkallës së parë ka marrë si fakt të vërtetuar se aktivizimi i kësaj antene paraqet provë të sigurt se i pandehuri në këtë kohë ishte në këtë vend dhe me këtë edhe kryerës i kësaj vepre penale. Por, gjykata e shkallës së parë - Gjykata Themelore në Ferizaj, duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës ka urdhëruar zyrtarët policor për dalje në vendin e ngjarjes, përkatësisht në vendin "K.." dhe nga aty të realizohen thirrje telefonike nga numri i telefonit ... në numrin e telefonit ... dhe të cilat veprime janë realizuar me datë 27.11.2020, kurse pastaj është përpiluar raport nga ana e PTK - Vala për mbulimin e kësaj zone me antena për aktivizim të thirrjeve telefonike. Nga i cili raport është vërtetuar se aktivizimi i antenave nuk mund të merret si provë e sigurt për vendndodhjen e të pandehurit ditën kritike në vendin ku ishte gjetur trupi i pajetë i të ndjerës, kjo posaçërisht duke marrë parasysh raportin e policisë të datës 27.12.2020 me të cilën ishin bërë thirrjet pikërisht nga vendi "K.." dhe atë njëmbëdhjetë thirrje të realizuara nga numri i telefonit ... në numrin e telefonit ... e që nga raporti nga ana e PTK - Vala del se edhe pse thirrjet ishin bërë nga i njëjti lokacion- "K..", megjithatë janë aktivizuar antena të ndryshme, përkatësisht ishin aktivizuar antenat: V.. G-3, C.. G-3, D.. G-3, D.. G-1, K..-1 dhe Gj..-P..-3, por asnjëherë nuk ishte aktivizuar edhe antena e Z.., e kjo duke e ndërlidhur edhe me raportin tjetër të PTK - Vala që është theksuar fakti se aktivizimi i cellave-antenave ndërlidhet me disa faktorë dhe nuk mund të merret e sigurt se aktivizimi i një antene edhe të vërtetojë prezencën e personit në atë vend. Të gjitha këto antena mund të aktivizohen për realizim të thirrjes sepse pika e përafërt që është marrë në këtë rast është në lartësi të madhe në

bjeshkë dhe në atë zonë mund të shërbehet nga sinjale të shumta dhe kur bëhet thirrja ka gjasa që të ndryshon thirrja në cell të ndryshëm, në diferencë të shkurtër kohore, ngase në një cell ku tentohet të bëhet thirrje dhe ai cell ka një problem të shkurtër teknikë, apo një ngarkesë thirrja do të tentohet të bëhet në një cell tjetër.

Përmes këtyre provave përjashtohet çfarëdo ndërlidhje se aktivizimi i një antene të caktuar në këtë rast i antenës Z.., në telefonatën e të pandehurit me datë 09.11.2015 në ora 15:19, nënkupton edhe prezencën e tij në afërsi të këtij vendi. Është e pashpjegueshme për Gjykatën Supreme të Kosovës se si këto prova vendimtare gjykata e shkallës së parë nuk iu kushton fare vëmendje edhe pse i liston si prova të administruara, por fare nuk merret me çmuarjen e besueshmërisë, fuqisë provuese dhe rëndësisë së tyre. Përtej kësaj edhe gjykata e shkallës së dytë e mbulon gabimin e gjykatës së shkallës së parë duke i dhënë vlerë provuese vetëm raportit të parë të PTK- Vala të viti 2018, dhe njëkohësisht duke anashkaluar raportet e mëvonshme të PTK-Vala, dhe për më tepër, është e pashpjegueshme se si gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj nuk bën asnjë analizë e raporteve të reja të PTK-Vala dhe të cilat raporte e ndryshojnë në tërësi gjendjen dhe raportin e parë e bëjnë në tersi jo relevant.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se edhe kjo provë u keqinterpretuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe kjo duke u ndërlidhur edhe me ekspertizën mjeko-ligjore dhe raportin e autopsisë dhe gjithashtu edhe deklarimin e ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.U., (faqja e tretë e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor i datës 29.01.2019) dhe i cili ka dhënë konkludim se nuk është vërtetuar në mënyrë të saktë koha e vdekjes, tani të ndjerës, por "*...bazuar në të gjitha këto shenja kufumore mund të deklaroj me besueshmëri të lartë shkencore se koha e vdekjes ka qenë 20 deri 30 ditë, minimumi rreth një muaj para se të kryhet autopsia*". Kurse konstatimi i gjykatës së shkallës së parë në faqen 45 të aktgjykimit se "*...e që dita e zhdukjes së D.. ishte edhe dita e vrasjes së të njëjtës...*" është konstatim në tërësi i pabazuar dhe i pambështetur në asnjë provë e aq më pak nga ekspertiza mjeko-ligjore, raporti i autopsisë, por as nga dëgjimi i ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. N.U., deklarimi i të cilit u citua më lartë. Pra një konkludim i tillë është tërësisht i pabazuar në provat e administruara, meqë asnjëherë nuk ishte konfirmuar koha e saktë e vdekjes së të ndjerës për shkak të rrethanave se nga zhdukja e saj deri në gjetjen e trupit kishte kaluar një kohë e gjatë dhe përmes asnjë metode shkencore nuk mund të vihet në përfundim se dita e zhdukjes

ishte edhe dita e vdekjes, siç pa asnjë mbështetje konstatohet nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar edhe mbrojtjen e të dënuarit, por, nuk ka dhënë arsye se pse nuk i besoi versionit të mbrojtjes së tij. Në këtë pikë janë të rëndësishme të potencohen tri aspekte: se pari, i njëjti natyrshëm e ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale që është më se e pritshme kur bëhet fjalë për një vepër të kësaj natyre, së dyti, është e rëndësishme të potencohet fakti se i njëjti pos tri deklarimeve gjatë procedurës hetimore gjatë pjesës tjetër të procedurës zgjodhi të drejtën të mbrohet në heshtje, dhe se treti i njëjti për herë të parë u dëgjua pas një periudhe të gjatë kohore nga zhdukja e të ndjerës, pra dëgjimi i tij në polici u bë me datë 22.12.2015, dhe atë në cilësi të dëshmitarit, përkatësisht 46 ditë nga ngjarja e ndodhur. Por, kjo kohë e gjatë e kaluar duket se nuk ka qenë objekt i vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se vlerësohet çdo detaj i mbrojtjes së tij, por, nuk i bëhet analizë kontekstit kohor të mbrojtjes së tij q; gjithsesi është faktor që ka ndikim në saktësinë dhe kujtesën e disa rrethanave për këtë ngjarje. Megjithatë, sipas Gjykatës Supreme të Kosovës kjo mënyrë e vlerësimit të mbrojtjes së të dënuarit nuk është bërë në përputhje me dispozitat e KPP-së, meqë, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një ndarje të qartë të deklarimit të të pandehurit si dëshmitar (intervistë të cilën e ka dhënë me 22.12.2015) dhe si i pandehur (23.12.2015) dhe procesverbali për marrje të deklaratës në procedurë paraprake (02.06.2017), pra, tri deklarimet e tij një si dëshmitar dhe dy të tjerat si i pandehur, i ka vlerësuar bashkërisht, dhe për më tepër, me rastin e dëgjimit në Prokurorinë Themelore në Pejë, pjesa më e madhe e mbrojtjes së të pandehurit është marrë duke bërë ballafaqimin me deklarimet e tij në polici dhe provat e nxjerra gjatë periudhës së hetimit, përkundër faktit se kishin kaluar rreth një e vit e gjysmë nga deklarimi i tij i parë. Përveç kësaj, duke anashkaluar këtë situatë dhe duke i marrë parasysh dy deklarimet e tij në cilësi të pandehurit rrjedh se i njëjti ka qenë konsistent në mbrojtjen e tij duke mohuar kryerjen e veprës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se mbrojtja e të pandehurit ka disa mospërputhje me provat e tjera të administruara, por, dy çështje janë të rëndësishme për tu kushtuar vëmendje. Së pari, mbrojtjes së tij se ditën kritike kishte pohuar faktin se kishte qenë me vajzën e tij në Zyrën e Regjistrimit Civil për lidhjen e kurorës-martesës së vajzës së tij dhe mbrojtjes së tij së kishte qenë pjesëmarrës në varrimin e Sh.Z., që kishte ndodhë me datë 09.11.2015, pikërisht në ditën e zhdukjes së të ndjerës. Sa i përket çështjes së parë pa dyshim se i pandehuri mund edhe të ketë

gabuar me ditën e shkuarjes në Zyrën e Regjistrimit Civil, pasi që shkuarja e vajzës së tij dhe kurorëzimi i saj kishte ndodhur dy ditë më vonë, pra, me datë 11.11.2015 (e vërtetuar nga raporti i hetuesit i datës 06.03.2017 dhe raporti i Zyrës së Regjistrimit Civil të fshatit S.. –D..) e që duke e ndërlidhur me kohën e gjatë prej 46 dite nga zhdukja e të ndjerës e deri në deklarimin e parë të të pandehurit edhe mund të paraqiten gabime duke marrë parasysh kohën e kaluar nga ngjarja e deri te deklarimi i tij. Përtej kësaj duhet shtuar se i pandehuri pohoi faktin se ditën kritike kishte shkuar në ZRC në orët e paradites, me qëllim të njoftimit rreth dokumentacionit të nevojshëm për kurorëzimin e vajzës së tij, e që kjo kohë nuk mund të jetë e sigurt se ka ndodhur pikërisht ditën kritike për shkak të faktorit kohë (nga dita e shkuarjes deri te dita e deklarimit të tij në polici kishin kaluar 46 ditë). Pastaj, e rëndësishme në këtë çështje është edhe ndërlidhja e deklarimit të të pandehurit dhe raportit të hetuesit të marrë në ZRC-ja nga ana e zyrtarëve përgjegjës përkitazi me praninë e të pandehurit në këtë zyre, e që sipas raportit në fjalë del se i pandehuri nuk kishte pasur ndonjë aktivitet të regjistruar në librat përkatës, por, se edhe nga vet deklarimi i tij pohohet fakti se i njëjti në këtë zyre ishte vetëm për qëllim të informimit për dokumentacionin e nevojshëm për kurorëzimin e vajzës së tij dhe jo për marrjen e dokumentacionit, pasi që kurorëzimi i vajzës së tij edhe nga raporti në fjalë del se ishte bërë më datë 11.11.2015.

Kurse, në këtë kontekst është e rëndësishme të trajtohet raporti i policit hetues të datës 22.12.2015 dhe atë raporti i syzimit mes të dyshuarit N.P., dhe vajzës së tij - dëshmitares A.P., dhe i cili raport ka disa të meta të natyrës procedurale: së pari ky syzim është bërë pas dëgjimit të N.P., në cilësi të dëshmitarit, pra i njëjti fillimisht ishte intervistuar si dëshmitar (procesverbali i datës 22.12.2015), i njëjti ende nuk kishte statusin e të dyshuarit e as të pandehurit në procedurë, që del se syzimi-ballafaqimi është bërë mes dy dëshmitarëve. Raporti në fjalë ka edhe mospërputhje kohore për faktin se koha e përpilimit të raportit del të jetë data 22.12.2015 në ora 21:00 dhe aty shënohet "*...pas marrjes së deklaratave nga i dyshimti dhe dëshmitares...*" e që ky raport përmban pasaktësi për faktin se i pandehuri N.P., më datë 22.12.2015 ishte dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, kurse dëshmitarja A.P., është dëgjuar në cilësi të dëshmitares më datë 22.12.2015, por, intervista i saj kishte përfunduar me në ora 21:45 minuta, pra, pas përpilimit të raportit që rrjedh se e njëjta një herë është ballafaquar e pastaj është dëgjuar si dëshmitare.

Përtej këtyre aspekteve, del se raporti në tërsi është përpiluar në kundërshtim me dispozitën e nenit 123 par.1 të KPP-së i cili ishte në fuqi në kohën e marrjes së këtij veprimi, përkatësisht nenit 119

par.1 të KPP-së që aktualisht është në fuqi, pasi që nuk ekziston dispozitë ligjore që lejon këtë mënyrë të raportit dhe aq më tepër që ky raport të ketë statusin e provës në procedurë penale, për më tepër dispozita e nenit 119 par.1 të KPP-së – 123 par.1 të KPP-së (që ka qenë në fuqi në kohën e ndërmarrjes së këtij veprimi), ka përcaktuar që gjatë fazës së hetimit mund të merren prova nga dëshmitarët në tri mënyra dhe atë: marrja në pyetje në procedurë paraprake, marrja e deklaratës në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë, pra mënyra e përpilimit të këtij raporti del të jetë në kundërshtim të plotë me këto dispozita ligjore. Por, pa marrë parasysh faktet e lartë cekura, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se raporti duhet të trajtohet në tërësinë e tij dhe jo në mënyrë fragmentare, siç kanë bërë dy instancat e ulëta gjyqësore, të cila i kanë dhënë rëndësi vetëm deklarimit të dëshmitares se ditën kritike nuk ka qenë në Z.., por vetëm disa rreshta më poshtë pohon faktin se mund të jenë përzier datat dhe që kjo korrespondon edhe me deklarimin e të pandehurit se kishte shkuar në Z.., për marrjen e informatave me qëllim të kompletimit të dokumentacionit për kurorëzimin e vajzës së tij. Natyrshëm se kjo shkuarje e të pandehurit për informata nuk ishte regjistruar në librat e regjistrimit, siç pohuan edhe zyrtarët e Z..,-së, të cilët informatat e tyre i bazuan në regjistrat e nxjerrjes së dokumenteve dhe jo në shkuarjen e të pandehurit në këtë Zyre.

Për më tepër, është e diskutueshme qasja e Prokurorisë së Shtetit përkitazi me këtë raport pasi që ishte një qasje e njëanshme dhe tërësisht jo objektive, mjafton të theksohet fakti se në përpilimin e këtij raporti morën pjesë prokuroria e shtetit dhe disa policë hetues, por me këtë rast kishte mbetur e paqartë pozita e personit N.P., pasi që në këtë fazë ishte dëgjuar vetëm si dëshmitar dhe pastaj ishte përpiluar raporti, pra fillimisht do të duhej që personi të merrte statusin e të pandehurit dhe pastaj do të ishte e arsyeshme edhe caktimi i një mbrojtësi për të pandehurin për një veprim kaq të rëndësishëm procedural, krejt kjo me qëllim të balancimit të palëve në procedurë, siç është shprehur GJEDNJ në disa vendime të saj:, "*...se duhet të ketë barazi të krahëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes...*" rasti Jasper & Britanisë së Madhe nr.27052/95&51, për të vazhduar tutje se: "*... parimi i barazisë së krahëve kërkon një balancë të drejtë midis palëve ku secilës palë duhet t'i jepet mundësia e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk vendosin atë në disavatazh të konsiderueshëm vis-a-vis kundërshtarit të saj...*"- Batsanina & Rusisë nr.3932/02&22. Përndryshe kjo qasje e balancimit të palëve kërkohet në të gjitha fazat e procedurës penale: "*...një gjykim i drejtë nuk do të thotë se neni nuk zbatohet në procedimet para*

gjyqësore...”- Imbrioscia & Zvicrës nr.36 Seria A nr.275, si dhe *“...me qëllim që e drejta për një gjykim të drejtë të qëndrojë sa duhet praktike dhe efektive neni 6&1 kërkon që si rregull avokatit t’i jepet akses që në hetimin e parë të dyshuarit nga policia, përveç nëse është e demonstruar nën dritën e rrethanave të veçanta të çdo çështje që ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë...*”- Salduz & Turqisë nr.36391/02 &50, 55, e që sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ky balancim nuk ka ndodhur në rastin konkret. Përkundër këtyre që u ceken më lartë edhe sikurse të mos ishte vërtetuar me saktësi të plotë mos shkuarja e të pandehurit në Z.., kjo rrethanë nuk mund ta ndërlidh me automatizëm të pandehurin me kryerjen e veprës penale.

Kurse, fakti i pjesëmarrjes së të pandehurit në varrimin e Sh.Z., është i diskutueshëm për faktin se vetëm dy dëshmitar (K.P., dhe Z.Z.,) pohuan këtë fakt, kurse dëshmitarët e tjerë e mohuan se kishin parë të njëjtin në ditën e varrimit, megjithëse nuk duhet anashkaluar faktin se në varrim kishte pasur numër të madh të pjesëmarrësve, për më tepër personat për të cilët i pandehuri deklaroi se kishte qenë në varrim R.H, A.F dhe M.I, asnjë nga ta nuk ishin dëgjuar si dëshmitar. Por, pa marrë parasysh këtë, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se edhe nëse do të vërtetohej me siguri të plotë fakti se i pandehuri nuk kishte marrë pjesë në varrim, megjithatë kjo nuk e ndërlidhë automatikisht të pandehurin me kryerjen e vrasjes së të ndjerës. Është e rëndësishme të theksohet fakti se në këtë çështje penale nuk ka pasur asnjë provë e cila në mënyrë direkte ka vërtetuar se i pandehuri ka kryer këtë vepër penale, për më tepër, edhe provat indirekte që janë administruar nuk kanë mbyllur qarkun e pamundësisë që kryes i kësaj vepre penale të jenë edhe persona të tjerë dhe kjo argumentohet me disa prova që gjenden në shkresat e lëndës, por se hetimet në këtë drejtim të tyre janë anashkaluar dhe njëkohësisht duke u përqendruar kah tani i pandehuri.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se nga provat e administruara nga ana e gjykatës së parë nuk është vërtetuar se autori i veprës penale ishte i pandehuri dhe siç është theksuar në këtë çështje penale nuk ka pasur prova të drejtpërdrejta, por skema e ngjarjes është ndërtuar duke u bazuar në prova rrethanore duke u ndërlidhur hallkat e zinxhirit të ngjarjes. Për këtë arsye është e rëndësishme të theksohet fakti se për gjykimin e një rasti bazuar në prova rrethanore gjithmonë është i nevojshëm standardi i vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe i cili përmbushet vetëm atëherë kur përfundimi i nxjerrë nga këto prova është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxjerrët prej provave të paraqitura. Pra, duhet të sigurohen prova që të mbyllet qarku, përkatësisht të përjashtohet mundësia që personat e tjerë të jenë kryes të veprës penale. Por, cili është zinxhiri

në rastin konkret dhe a u mbyllën të gjitha mundësitë për të ardhur në përfundim se i pandehuri ishte kryesi i kësaj vepre penale gjithmonë duke pasur parasysh përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë: "...kur ofrohet në afërsi të shtëpisë së N.J., kalon i akuzuari me veturën e tij "Jeep Sheroke", me ngjyrë të kaltër – mbyllët, i cili ndalet e merr viktimën me veturë e më pas vazhdon në drejtim të B.., të S.. dhe me të arritur tek vendi i quajtur "K.." e privon nga jeta në atë mënyrë që nga arma e tipit të panjohur ka shtënë duke e qëlluar dy herë në kokë dhe largohet nga vendi i ngjarjes...".

Në fakt rrethana e parë e këtij zinxhiri ishte çështja se a kishte hipur e ndjera në automjetin e të pandehurit e pastaj të vazhduar më tutje me shtjellimin e rrethanave tjera, përkatësisht vazhdimin e udhëtimit në drejtim të vendit të quajtur "K..", dhe pastaj ekzekutimi i të ndjerës me armë të tipit të panjohur duke e qëlluar dy herë në kokë. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastin konkret zinxhiri është shkëputur që në hallkën e parë, meqë nuk u vërtetua fakti vendimtar se e ndjera kishte hipur në automjetin e të pandehurit e vërtetuar përmes: ekspertizës së ADN e përpiluar nga ana e AFK-së e datës 15.02.2016 në të cilën është konstatuar se në vendin e ngjarjes nuk ka përputhshmëri me mostrat e marra të të pandehurit, raporti i laboratorit të FBI-së në Virgjinia të SHBA me nr. .., numri i laboratorit .., i datës 06.07.2016, ku konstatohet se nuk është provuar se qimet e flokut apo qimet e tjera që janë tërheqë nga vetura e të akuzuarit të kenë çfarëdo lidhje me viktimën D.P., dhe përjashtimin e mundësisë se e ndjera ishte në automjetin e të akuzuarit e bën edhe raporti i ekspertizës nga Laboratori i Kriminalistikës të TNP-së në Ankara të Turqisë me numër referues .., i datës 16.05.2015, sipas së cilit vërtetohet se nga shikimi në incizime nuk ka mundur të bëhet identifikimi i tabelave si dhe identifikimi i personave në automjet. Kjo përforcohet edhe përmes raportit të AFK-së të datës 02.12.2020 që nuk vërtetohet madje as hapja dhe mbyllja e derës së automjetit në vendin ku pretendohet se e ndjera ka hipur në automjetin e të pandehurit, dhe gjithashtu asnjë nga dëshmitarët e dëgjuar nuk ka konfirmuar një gjë të tillë, ashtu që duke marrë parasysh se nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme hipja e të ndjerës në automjet, atëherë me këtë bëhet i panevojshëm shtjellimi i mëtejmë i hallkave tjera që ndërlidhin të pandehurin me këtë vepër penale.

Në fillim të pjesës arsyetuese, Gjykata Supreme e Kosovës vuri në pah zgjatjen e këtij procesi gjyqësor për rreth tetë vite dhe e cila zgjatje pa dyshim se duhet t'i atribuohet edhe prokurorisë së shtetit e cila e zhvilloi fazën e hetimeve në këtë çështje penale dhe del se nuk janë zhvilluar hetime

të plota dhe gjithëpërfshirëse. Ku më së miri pasqyrohet me faktin se disa herë kjo çështje penale është kthyer në rigjykim me shkas që të merren prova të reja dhe kjo ka rezultuar me marrjen e provave të reja nga ana e gjykatave të shkallëve të para dhe të cilat prova edhe janë marrë me qëllim të ndriçimit të kësaj çështje penale. Për më tepër, bazuar në shkresat e lëndës, vërehet fakti se prokuroria e shtetit nuk ka ezauruar të gjitha pistat e mundshme të hetimit për vrasjen e tani të ndjerës, por shumë të dhëna të rëndësishme nga faza hetimore nuk u nisën fare apo ato që u nisën nuk u vazhduan dhe veçanërisht dyshimet e para që janë pjesë e shkresave të lëndës dhe të dhënat që paraqitën familjarët e të ndjerës përmes deponimeve të tyre dhe disa dyshime që rrjedhën edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe kjo lehtë vërtetohet me një shfletim të thjeshtë të shkresave të procedurës paraprake para se të zbulohej trupi i të ndjerës dhe të vërtetohej se ishte privuar nga jeta, por edhe gjatë zhvillimeve të shqyrtimeve gjyqësore.

Tutje Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se në dritën e këtyre rrethanave një aspekt i rëndësishëm paraqet fakti i personalitetit të të pandehurit me vet faktin se i njëjti ishte dënuar një herë për vrasje të rëndë dhe kjo padyshim se ishte rrethanë me ndikim edhe në epilogun e dy instancave më të ulëta gjyqësore e që kjo gjithsesi konsiderojmë se shkeli parimin e prezumimit të pafajësisë, siç është konstatuar në disa raste nga ana e GJEDNJ e që ndër to do t' i referohemi rastit Allenet De Ribemont & Francës, aktgjykimi i datës 10.02.1995, seria A, NO 308, ku theksohet se: "Se e rëndësishme është se prezumimi i pafajësisë nga neni 6/2 të KEDNJ, nuk përfshinë ndalesën që gjykata të informohet me të dhënat mbi çështje gjyqësore të të pandehurit nga evidenca e të dënuarve. Në parim gjykata nacionale mund të informohen mbi të gjitha rrethanat, të cilat janë të ndërlidhura me personalitetin e të pandehurit dhe që mund të kenë ndikim në matjen e dënimit, por jo në vërtetimin e përgjegjësisë penale", siç në fakt është vepruar në rastin konkret ku pikërisht e kaluara e tij ka qenë edhe bazë për fajësinë e tij.

Kurse, në rastin tjetër për të kuptuar më mirë shkallën e shtrirjes së këtij prezumimi kjo gjykatë në rastin Nolkenbockhoff & Gjermanisë - aktgjykimi i GJEDNJ-së, të datës 25.08.1987, serie A 123 shprehet: " *I pandehuri ka vdekur pasi që është marrë aktgjykimi dënues kundër të cilit është ushtruar ankesë. Trashëgimtarët e tij kanë kërkuar nga shteti kompensimin e shpenzimeve të mbrojtjes gjatë procedurës, mirëpo gjykata gjermane kërkesë padinë e tillë e ka refuzuar me arsyetimin se gjykata e shkallës së dytë sigurt se do ta kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së*

shkallës së parë". Pra, rrjedhimisht në të dy këto raste është konstatuar se me një qëllim të tillë është shkelur prezumimi i pafajësisë të cilin e garanton neni 6/2 i GJEDNJ-së.

Komentet përmbledhëse të rasteve

E veçanta e rastit të parë është fakti se i dënuari është shpall fajtor për veprën penale të marrjes së ryshfetit, nga neni 428 par.1 të KPK-së, bazuar vetëm në dëshminë e të dënuarit e cila jo vetëm që nuk kishte mbështetje në prova tjera por ishte dëshmi jo kredibile. Ndërsa, tek rasti i dytë me provat e administruara nuk ishte argumentuar asnjë element i veprës penale për të cilën ishte shpall fajtor i dënuari.

Kurse rasti i tretë është rast tipik me të cilin të dënuarit i është shkel e drejta për një gjykim të drejtë dhe arsyeshëm, pra, behet fjalë për një gjykim që kishte zgjatë rreth tetë vite ku janë marrë aktgjykime të shumta dhe të ndryshme, e të cilat kanë rezultuar me dënim kapital. Përveç kësaj e veçanta e këtij rasti është se i dënuari është shpallë fajtor vetëm bazuar në prova rrethanore apo indicie fuqia provuese e të cilave nuk e ka argumentuar standardin e kërkuar – vërtetimin përtej dyshimit të arsyeshëm se i dënuari është ekzekutor i veprës penale.

4. Ndryshimi i aktgjykimeve – sa i përket cilësimit juridik të veprës penale

4.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore

Vlen të theksohet se me ligj nuk theksohet taksativisht ndryshimi sa i përket cilësimit juridik. Me ligj (neni 438 par.1 nënpar.1.1 i KPP) vetëm theksohet se Gjykata Supreme i ndryshon aktgjykimet, e që në mënyrë të njëjtë theksohet edhe për shkallën e dytë. Mirëpo, kjo nënkuptohet nga vet dispozita ligjore, e përveç kësaj me dispozita ligjore një gjë e tillë lejohet për shkallë të parë- neni 359 par.2 të KPP-së, sipas të cilit Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale. Sa i përket ndryshimit të aktgjykimeve sa i përket cilësimit juridik të veprës penale veprohet në mënyrë të njëjtë, pra, në kuadër të përshkrimit të veprimeve inkriminuese në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë dhe gjendjes faktike të

vërtetuar Gjykata vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë elementet e ndonjë vepër tjetër penale (e cila është me e favorshme) jo të asaj për të cilën është akuzuar dhe shpall fajtor.

4.2. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të instancave me të ultë sa i përket cilësimit juridik të veprës penale

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të shpeshta rastet kur aktgjykimet e instancave me të ultë ndryshohen sa i përket cilësimit juridik. Për dallim te ndryshimi i aktgjykimeve në rastet kur të dënuarit lirohen nga akuza ku përshkruhen veprimet inkriminuese te të dënuarit në dispozitiv të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, kur kjo gjykatë i ndryshon aktgjykimet për shkak të ricilësimit të veprës penale vetëm thekson se cila vepër penale përmbushet në kuadër të përshkrimit të verimeve inkriminuese në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.384/2021**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit E.J., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.272/2019 i datës 19.04.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.221/2021 i datës 8 korrik 2021 ndryshohet sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Supreme e Kosovës gjen se, në veprimet e të dënuarit E.J., të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit pasqyrohen vetëm elementet e veprës penale vrasja, parashikuar me nenin 178 të KPRK-së, dhe për këtë vepër e gjykon me 14 (katërmbëdhjetë) vite burgim, ndërsa duke ia marrë si të vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj të shqiptuar për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, konform dispozitës së nenit 76 par.2 pika 2.2. të KPRK-së i shqipton dënim unik me burgim

në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë viteve (15) e katër (4) muajve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 8 mars 2014 e tutje.

Pretendimet e mbrojtësit përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave procedurale refuzohen si të pabazuara.

A r s y e t i m

b) Vlerësimi i kësaj gjykate përkitazi me pretendimet e mbrojtësit sa i përket shkeljes së ligjit penal

Sa i përket kësaj baze ligjore mbrojtësi në kërkesë pretendon se në rastin konkret me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit për faktin se ai është shpall fajtor për veprën penale vrasja e rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.5 të KPRK-së edhe pse në veprimet e tij në drejtim të ndjerit qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes në gjendje të tronditjes së fort mendore, nga neni 180 lidhur me nenin 18 të KPRK-së. Sipas mbrojtjes është e ditur se kur është në pyetje vrasja, janë të rralla apo nuk ekzistojnë fare vrasjet pa praninë e një gjendje afektive. Vetëm tek vrasësit profesionale nuk ka afekt. Gjendja afektive e të dënuarit është dashtë të vlerësohet nga gjykata e shkalles së parë se a ishte me ndikim në vrasjen e shkaktuar. Meqë i dënuari në restorant por edhe në momentin kritik pa fajin e tij u nënçmua, u fye rëndë, e u keqtrajtuar psiqikisht dhe tronditja e tij psikike ishte e intensitetit të fortë sa që ai nuk ishte në gjendje të mendoj se në automjet ishte edhe vëllai i tij, pra ai për një moment të kufizuar kohor nuk ishte në gjendje psikikë që të gjykojë drejt e as të kuptojë rëndësinë e veprimeve të veta dhe aftësia e tij mendre ishte esencialisht e zvogëluar, pra, në veprimet e tij qëndrojnë elemente e veprës penale nga neni 180 lidhur me nenin 18 të KPRK-së, kurse veprimet e tij në raport me vëllain e tij paraqesin vepër penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365 par.1 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mbrojtësit se në veprimet e të dënuarit në raport me të ndjerin B.K., qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes në gjendje të afektit mendor, nga neni 180 lidhur me nenin 18 të KPRK-së, nuk janë të bazuara. Elemente dhe karakteristika të vrasjes në gjendje të afektit mendor janë: sulmi, keqtrajtimi, fyerja e rëndë, dhe tronditja e fortë. Sulmi mund të jetë çdo veprim i njeriut i drejtuar me qëllim që ta lëndoj apo rrezikoj ndonjë të

mirë të mbrojtur të kryerësit të kësaj vepre. Fyerja e rëndë nënkupton cenimin e rëndë të nderit dhe autoritetit të personit tjetër kjo reflektohet me dhembje të madhe psikike, emocionale, dhembje kjo e cila me arsye shkakton revoltë indinjatë. Tronditja e fortë mendore është gjendje e jashtëzakonshme psikike, është gjendje e shkallës së lartë e afektit, gjendje kjo e cila ka ndikim të madh në aftësinë e kryerësit që të veproj pa menduar mirë. Pra, nga kjo rezulton se sulmi dhe fyerja duhet të jenë sipas mënyrës dhe intensitetit të tilla që mund ta sjellin të akuzuarin në gjendje të tronditjes së fortë, pra, jo çdo fjalosje, fyerje apo sulm.

Duke pasur parasysh ecurinë e ngjarjes - takimin paraprak në mes të dënuarit dhe të ndjerit në restorant dhe të tjerëve në të cilin takim sipas provave të administruara del se nuk ka pas tensionim të bisedës, kurse, bazuar në deklaratën e dëshmitarit F.J., (vëllait të dënuarit i cili në këtë rast është lënduar) të dhënë menjëherë pas ngjarjes i cili përkundër faktit se thekson se ka pas bisedë në mes të dënuarit dhe të ndjerit në momentin kritik nuk citon ndonjë fjalë fyese apo pjesë të bisedës, kjo gjykatë vlerëson se ndaj të dënuarit nuk ka pasur fyerje të intensitetit të tillë që do të mund të sjelltë të dënuarin ne gjendje të afektit mendor. Në fakt edhe nën supozimin se i ndjeri ju ka drejtuar me fjalët të dënuarit se “ti nuk je as për grua as për fëmije o pis” dhe “lema djalin edhe sonte” ashtu siç pretendohet në kërkesë sipas vlerësimit të kësaj gjykate këto fjalë nuk janë të intensitetit të tillë për ta sjellë të dënuarin në gjendje të afektit. Pastaj, në ketë çështje juridiko penale janë bërë disa ekspertiza (katër ekspertiza) përkitazi me gjendjen mendore të të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale dhe sipas super ekspertizës së fundit psikiatrike, del se i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kishte aftësi të zvogëluar mendore, dhe i njëjti konstatim dhe konkludim është dhënë edhe në dy ekspertizat e mëhershme. Në rastin konkret sipas vlerësimit të këtij kolegji konstatimet dhe mendimet e eksperteve të super ekspertizës janë në harmoni me parimet shkencore, përvojën e tyre profesionale, pra, mendimin dhe konstatimin e tyre se i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kishte aftësie të zvogëluar mendore, pra, ishte i aftë që të kuptojë rëndësinë e veprimeve të tij, e konsideron si zgjidhje objektive të çështjes, kurse pretendimet e mbrojtësit në ketë drejtim i konsideron si të pabazuara.

Mirëpo, në kontekst të vlerësimit të provave të administruara në ketë çështje juridiko penale kjo gjykatë i vlerësoj veprimet e të dënuarit në raport me të ndjerin B.S., dhe të lënduarin F.J., (vëllai i të dënuarit). I dënuari është gjykuar për veprën penale vrasja e rëndë, parashikuar me nenin 179

par.1 nënpar.1.5 të KPRK, por, ketë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë, kjo gjykatë nuk e vlerëson si të drejtë, për këto arsye:

Për të ekzistimin e veprës penale të vrasjes së rëndë, parashikuar me nenin 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së, është e nevojshme që krahas vrasjes së një personi, të shkaktohet rrezik konkret për jetën e së paku një personi, por, të kryesi duhet të ekzistojë dashja lidhur me veprën penale të vrasjes, si dhe lidhur me shkaktimin e rrezikut konkret për jetën edhe të ndonjë personi tjetër.

Nga shkresat e lëndës nuk rezulton kontestuese se derisa i ndjeri B.. ishte i ulur në ulësen e parë të veturës së Sh.. (djalit të dënuarit) dhe vëllai i të dënuarit ishte i ulur në ulësen e pasme duke pritur dëshmitarin Sh.., i dënuari del nga vetura e tij, ju kishte ofruar veturës së Sh.. e hape derën e veturës dhe me armën e tipit "model 85 - kalibri 9 mm.", me dashje e godet të ndjerin B.. tri herë në pjesë të ndryshme të trupit si pasojë e të cilave vdes, kurse me një plumb e godet vëllain e tij F.J., në gjurin e djathtë (kërcirin e këmbës së djathtë) të cilat sipas ekspertizës ligjore bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore.

Bazuar në këtë gjendje të fakteve rezulton qartë se dashja e të dënuarit ishte që ta privoj nga jetë të ndjerin, por jo edhe ta rrezikoj jetën e vëllait të tij. Veprimet të dënuarit në raport me vëllain e tij sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë ndërmarrë nga pakujdesia dhe nuk mund të përfshihen në veprën penale vrasja e rëndë - me rrezikim të jetës së personit tjetër (neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK), ngase paraqesin veprime të posaçme inkriminuese (të cilat kanë mbetur të pa inkrimunuara, nga ana e prokurorit), prandaj kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë vetëm elementet e veprës penale të vrasjes, nga neni 178 të KPRK-së.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.277 /2021**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve M.K., dhe K.M., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.175/2021 të datës 25.05.2021., përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimin për dënimin ashtu që vepra penale

për të cilën të dënuarit janë shpallur fajtor juridikisht cilësohet si vepër penale grabitje nga neni 317 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, për të cilën gjykohen me dënime me burgim në kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vitesh, në të cilat iu llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 23.01.2012. e tutje dhe dënime me gjobë në shuma prej 500 (pesëqind) euro të cilat janë obliguar t`i paguajnë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesat janë të bazuara.

Në që të dy kërkesat pretendohet se të dënuarit në ngjarjen kritike nuk kanë përdorë armën e vërtet por një shkrepës në formën e revoles, ashtu që nuk është përdorur arma apo mjeti i rrezikshëm, e në anën tjetër, e dëmtuara ka bërë rezistencë ndaj kryesve ashtu që nuk është frikësuar dhe arma imituese në këtë rast te ajo nuk ka krijuar bindjen se fjala është për armë të vërtetë.

Gjykata Supreme konstatojë se në rastin konkret nuk ka qenë kontestues fakti se të dënuarit nuk kanë përdorur armë për kryerjen e veprës penale të grabitjes por një shkrepës që e ka pasur dukjen e armës-revoles. Nga aktgjykimet e kundërshtuara del se ashtu kanë deklaruar të dënuarit, gjatë bastisjes e njëjta edhe është gjetur dhe as gjykata e shkallës së parë e as ajo e shkallës së dytë në këtë pikëpamje nuk kanë pasur dilema.

Nga shkresat e lëndës rezulton se aktakuza është ngritur kundër që të dy të dënuarve për veprën penale të grabitjes nga neni 317 par. 4 lidhur me par. 1 dhe nenin 31 të KPK-së dhe në përshkrimin faktik është cekur se kanë përdorë armë të zjarrit. Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 08.02.2021. prokurori e ka ndryshuar cilësimin juridik dhe të dënuarit i ka akuzuar për veprën penale të grabitjes nga neni 317 par. 3 lidhur me par. 1 dhe lidhur me nenin 31 të KPK-së. Me aktakuzë, i dënuari M.K., është akuzuar edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 366 par.1 të KPK-së, gjegjësisht për atë se ka mbajtur

armën e tipit të panjohur, me të cilën ka kryer veprën penale të lartë cekur të grabitjes. Mirëpo, në procedurën e mëtejme penale, gjykata e shkallës së parë ka marr aktvendimin PKR.nr.28/2021 të datës 25.02.2021. me të cilën është aprovuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit M.K., dhe është hedhur aktakuza për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 366.par.1.të KPK-së dhe në këtë pjesë procedura është pushuar. Andaj, me rastin e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, gjykata fjalën "armë" e ka hequr nga dispozitivi i veprës penale të grabitjes, por ka cekur se është përdorur "arma lodër".

Në kërkesa pretendohet se në këtë situatë, e pasi që në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë figuron se është përdorure arma lodër nuk mund të bëhet fjalë për kualifikimin nga neni 317 par.3 të KPK-së, siç gabimisht ka konstatuar gjykata e shkallës së dytë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, me të drejtë ceket në kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë se kur dihet se në grabitje nuk është përdorur arma e vërtet, nuk mund të bëhet fjalë për kualifikimin juridik nga neni 317 par. 3 të KPK-së.

Megjithatë, kërcënimi me mjet i cili e ka dukjen e armës së vërtetë, paraqet përdorim të forcës gjegjësisht kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, siç kërkohet me dispozitën e nenit 317 par.1 të KPK-së. Qëllimi i të dënuarve ka qenë se ajo të duket si armë dhe të e dëmtuara të formojë bindjen se është armë e vërtetë, ashtu që të dënuarit të arrijnë qëllimin që kërcënimi të duket serioz dhe e besueshme se mund të rrezikohet jeta apo shëndeti i të dëmtuarës. Se është kështu, del nga fakti se të dënuarit kanë mundur të hyjnë në barnatore edhe pa armë-armë lodër dhe t`i thëjnë të dëmtuarës të njëjtat fjalë - "mos livrit!", por vetëm këto fjalë pa kërcënimin me revole, çoftë edhe lodër, nuk do të kishin prodhuar efektin e njejtë te e dëmtuara, ndërsa qëllimi i tyre ka qenë që ajo të mendojë se i rrezikohet jeta.

Nuk ka dyshim as sa i përket faktit se e dëmtuara ka menduar se ekzekutorët i kërcënohen me armë. Ajo ashtu ka deklaruar në të gjitha fazat e procedurës penale dhe asnjë herë nuk ka shprehë dyshim se arma është e vërtetë. Nuk mund të aprovohet pretendimi se e dëmtuara nuk ka qenë e frikësuar, sepse siç pretendohet në kërkesa, ka rezistuar përderisa ekzekutorët i kanë marrë të hollat. Përkundrazi, ajo ka deklaruar se në barnatore punon 10 vite, se asnjëherë nuk ka ndodhur

një ngjarje e këtillë, se ka qenë “tepër e frikësuar” se “edhe sot i kujtohet çdo detaj i ngjarjes dhe e bënë të ndihet keq”.

Andaj, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së dytë me cilësimin juridik për të cilin u bë fjalë, ka bërë shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarve, shkelje kjo nga neni 385 par.1.4 të KPPK-së, ashtu që kërkesat u aprovuan dhe aktgjykimi i shkallës së dytë u ndryshua si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Kërkesat u aprovuan edhe sa i përket vendimit për dënim, sepse përderisa për veprën penale të grabitjes nga neni 317 par.3 të KPK-së parashihet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 deri në 12 vite, për veprën penale nga neni 317.par.1.të KPK-së, parashihet dënimi me minimum shumë më të ulët, gjegjësisht dënimi me burgim prej 3 deri në 12 vite, ashtu që ishte e arsyeshme që ndryshimi i kualifikimit juridik të rezultojë në shqiptimin e dënimit më të ulët. Kjo gjykatë gjeti se duhet shqiptuar dënim sikur ai që është shqiptuar me aktgjykimin e shkallës së parë, gjegjësisht dënim me burgim prej 2 (dy) vitesh dhe dënimi me gjobë në shumë prej 500 euro, duke e aprovuar arsyet të cilat ajo gjykatë i ka dhënë me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.8 /2019**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të mbrojtësit të të dënuarit L.S., ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda Pkr.nr.212/2017 datë 04.06.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.334/2018 datë 31.08.2018, sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimit mbi dënimin, ashtu që gjykata në veprimet e të dënuarit L.S., gjen se formohen elementet e veprës penale të ndihmës në kryerje të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 33 të KPK, dhe për këtë vepër penale ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) €, të cilin dënim me gjobë i dënuari obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagesës i njëjti do t’i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 € të gjobës do t’i llogaritet një ditë burgimi.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i paprekur.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me 436 par.1 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit L.S. pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit të cilat konsistojnë në faktin se nga përshkrimi faktik i veprimeve të dënuarit në aktgjykimi e gjykatës së shkallës së parë, nuk mund të vërtetohet se formohen elementet e veprës penale në bashkëkryerje të grabitjes nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe se në bazë të gjitha provave të administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i dënuari L.S. natën kritike nuk ka marrë pjesë në grabitje por i njëjti gjatë gjithë kohës ka qëndruar në shitoren e tij. Po ashtu, nga të njëjtat prova është vërtetuar vetëm fakti se i dënuari ia ka siguruar numrin e telefonit të dëmtuarit Sh.A., të dënuarit A.A., i cili pastaj edhe ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Mbrojtësi më tutje pretendon se në veprimet e përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë në tërësi formohen elementet e veprës penale të ndihmës për kryerjen e veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa gjen se qëndron fakti se në përshkrim faktik të veprës penale të aktgjykimit të shkallës së parë theksohet "... në atë mënyrë që fillimisht i akuzuari L., të akuzuarit A. ia siguron numrin e telefonit të të dëmtuarit Sh. A. dhe ia jep të akuzuarit A., i cili rreth orës 20:00 e thërret të dëmtuarin Sh.A., nga fshati S.. duke u prezantuar se është A.. djali i A....", çka nënkupton se i dënuari L.. nuk ka qenë prezentë në momentin kur është kryer vepra penale e grabitjes nga neni 329 par.1 të KPK-së dhe se nga dispozitivi i cekur më lartë nuk mund të konkludohet se ka ekzistuar marrëveshja paraprake për kryerjen e kësaj vepre e që nënkupton se mungon elementi i bashkëkryerjes. Gjykata po ashtu nga shkresat e çështjes gjeti se qëndron fakti se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të provave

materiale dhe ka gjet se i akuzuari L.. gjatë gjithë kohës kishte qëndruar në shitoren e tij dhe se vetëm ia ka siguruar numrin e telefonit të dënuarit A.., e që i bënë pretendimet nga kërkesa të bazuara.

Duke u nisur nga fakti se konform nenit 33 par. 2 të KPK-së, ndihma për të kryer një vepër penale përfshinë, por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimin paraprak se do të fsheh provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerën e veprës penale ose përftimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale, kjo gjykatë gjen se tek veprimet e të dënuarit L.., konsistojnë elementet e kësaj forme të bashkëpunimit ku me ndërmarrjen e veprimeve të tilla nuk kryhet vepra penale por vetëm ndihmohet kryerja e saj. Pra veprimet të cilat e përbëjnë ndihmën gjenden jashtë veprimit të kryerjes. Ndihmësi, në këtë rast i dënuari, L.S., nuk ka marrë pjesë në veprimet e kryerjes së veprës penale, por vetëm ka ndihmuar, kontribuar që ajo të kryhet. Nga veprimet e të dënuarit L.., pra vënia në dispozicion e numrit të telefonit të të dëmtuarit Sh.A., të dënuarit A.A., i është mundësuar që të kryej veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

4.3. Komentet përmbledhëse

Në rastin e parë i dënuari është akuzuar dhe shpall fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 nënpar. 1.5 të KPK-së, ngase ka privuar nga jeta dhëndrin e tij kur me dashje e ka venë në rrezik jetën e vëllait të tij. Për ketë gjykatë nuk ka qenë kontestues fakti se i dënuari me dashje e kishte privuar nga jeta të ndjerin, por fakti se a e vuri me dashje në rrezik jetën e vëllait të tij. Duke pasur parasysh ecurinë e ngjarjes provat e administruara për Gjykatën Supreme dashja e të dënuarit nuk ishte vënia në rrezik edhe e jetës së vëllait të tij, në raport me të kishte vepruar nga pakujdesia, prandaj aktgjykimet janë ndryshuar vetëm sa i përket cilësimit juridik.

Sa i përket rastit të dytë i dënuari ishte akuzuar për veprën penale të grabitjes, nga neni 317 par. 4 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPK-së. Prokurori e kishte ndryshuar cilësimin juridik duke e akuzuar sipas 3 të nenit 317 të dënuarin, pra se veprën penale e ka kryer me armë të zjarrit, kurse në përshkrimin faktin në dispozitiv thekohej lodra armë, por edhe nga provat e administruar rezultonte se i dënuari e kishte përdor armën lodër për kryerje të kësaj vepre penale. Meqë me

dispozitën ligjore theksohej armë e zjarrit, kurse në rastin konkret nuk ishte përdor arma e vërtetë Gjykata e ka ricilësuar veprën penale nga par.3 në par.1 të KPK-së ngase kërcënimi me mjet i cili e ka dukjen e armës së vërtetë paraqet përdorim të forcës gjegjësisht kanosjes serioze për ta sulmuar jetën apo trupin e njeriut siç kërkohet me par.1 të nenit 317 të KPK-së.

Karakteristikë e rastit të tretë është fakti se i dënuari është gjykuar për shkak se si bashkekzekutor e kishte kryer veprën penale të grabitjes, por meqë nga provat e administruara kishte rezultuar se vetëm kishte ndihmuar, dhe ndihma si formë e bashkëpunimit nuk konsiston në kryerjen e veprës penale por vetëm të veprimeve që kanë ndihmuar në veprën penale kjo gjykatë e ricilëson veprën penale.

5. Ndryshimi i aktgjykimeve – për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale

5.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore

Shkelja e ligjit penale sipas nënpar.1.3 të nenit 385 të KPP-së, ekziston edhe kur ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose me parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë. Në fakt kjo shkelje nënkupton vlerësimin e gabuar të rrethanave të cilat përjashtojnë ndjekjen penale, si parashkrimi, aministia apo falja ose me parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë, të cilat janë pengesa të ndjekjes penale.

5.2. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të sa i përket parashkrimit të ndjekjes penale

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës supreme të Kosovës janë të shpeshta rastet kur aktgjykimet e instancave me të ultë ndryshohen për shkak se është arritur parashkrimi i ndjekjes penale.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.114/2019**

A K T GJ Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit R.H. ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega suharekë P.nr.224/13 datë 28.09.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1192/2018 datë 28.01.2019, ashtu që kundër të pandehurit

Refuzohet akuza

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datë 15.12.2012 në fshatin G.., Komuna e S. në pompën e derivateve pronar i së cilës është i pandehuri, me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm në mënyrë të paautorizuar e ka shfrytëzuar energjinë elektrike ashtu që në njesorinë të cilit dy pllompa i mungojnë, kurse një pllompë e ka manipuluar të hapur dhe prapë të mbyllur dhe buloni i epërm mungon, njësori elektrik nga ana e jashtme kapaku i epërm e ka një vrimë të shpuar dhe përmes vrimës është penguar puna e diskut të njësorit është gërvishur ku energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast të dëmtuarës K.., në Prizren i ka shkaktuar dëm në shumë prej 587.79 €.

-me çka kishte për të kryer veprën penale vjedhja nga neni 252 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale i ngarkohen mjeteve buxhetore të Gjykatës, kurse e dëmtuara udhëzohet në kontest civil

A r s y e t i m i

Sipas shkresave të lëndës del se vepra penale e vjedhjes është kryer prej datës së pavërtetuar e deri me 15.12.2012, kurse për këtë vepër penale parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në tri vite. Bazuar në dispozitën e nenit 90 par.1 nënpar.5 të KPK-së parashihet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret në rastet kur ka kaluar afati prej 3 viteve, kurse sipas dispozitës së nenit 91 par. 6 të KPK-së ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit. Pasi që për veprën penale vjedhje, nga neni 252 par.1 të KPK-së parashihet dënim me gjobë dhe burgim deri në tri vite rrjedhimisht në rastin konkret rezulton se gjykata e shkallës

së dytë aktgjykimin e saj e ka marrë me 28.01.2019, që nënkupton se kishin kaluar mbi 6 vite nga koha e kryerjes së veprës penale.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.136/2022**

A K T GJ Y K I M

Me rastin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të gjykuarit H.Z., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.265/2020 i datës 30.08.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - PKR.nr.392/2021 i datës 26.11.2021, sa i përket cilësimit juridik të veprës penale ashtu që kjo gjykatë gjen se në veprimet e të gjykuarit përmbushen elementet e veprës penale të vrasjes, nga neni 47 par. 2 pika 4 të Ligjit Penal të Serbisë (i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale), kurse konform dispozitës së nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPP-së ndaj të dënuarit me shënime si në shkresa të lëndës:

Refuzohet akuza

"Se më datën 20.10.1989, rreth orës 9:30, në rrugën "ish E..", në afërsi të kanalit për ujitje në Deçan, i akuzuari në bashkëveprim me tani të dënuarin S.Z., e nga hakmarrja e paskrupullt, me dashje e kanë privuar nga jeta tani të ndjerin Z.U., i moshës 25 vjeçare nga fshati S.., Komuna e D.., në atë mënyrë që për shkak të një rrahje që kishte ndodhur me datë 02 qershor 1989, në fshatin S.., në mes të pandehurit me vëllain e tani të ndjerit, H.., me ta vërejtur tani të ndjerin Z.., e përcjellin për një kohë e pastaj i afrohen nga prapa, fillimisht tani i dënuari S.., e kap për qafe me dorën e majtë, kurse me dorën e djathtë fillon ta godas me thikë në pjesën e përparme të regjionit të gjoksit, e kur i ndjeri në mbrojtje e sipër, së bashku me tani të dënuarin S.., kanë rënë në kanalin e ujit, i akuzuari H.., zbret në kanal e përderisa i dënuari S.., po e mbante për duarsh tani të ndjerin Z.., i akuzuari e godet disa herë me thikë, në shpinë e në pjesë të tjera të trupit, me ç'rast tani i ndjeri, nga tani i dënuari S.. dhe i akuzuari, ka marrë gjithsej 16 goditje me thikë, shumicën prej tyre në organet vitale, e si pasojë e këtyre goditjeve, ai ka ndërruar jetë ne vendin e ngjarjes,

- me çka kishte për të kryer veprën penale vrasje, nga neni 47 par.2 2 pika 4 të Ligjit Penal të Serbisë (LPS)",

-për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Nga shkresat e lëndës del si i dënuari veprën e penale e ka kryer me 20.10.1989, pra, në kohën kur ishte në fuqi Ligj Penal i Serbisë (LPS) dhe aktakuza ndaj tij është ngritë në vitin 1990 dhe vepra penale është cilësuar si vrasje, nga neni 47 par. 2 pika 4 të LPS-së. I dënuari ishte në arrati që nga koha kur ngarkohet se e ka kryer veprën penale, kurse është arrestuar nëpërmjet letër rreshtimit ndërkombëtar dhe është ekstraduar në Kosovë me 8.05.2019. Pas arrestimit të tij Prokuroria Themelore në Pejë, e ka akuzuar për vepër penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.8 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) që ka hyrë në fuqi në vitin 2013, me arsyetim se ky kod është me i favorshëm se ligji penal i Serbisë ngase sipas ligjit që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale për veprën penale të vrasjes, nga neni 47 par. 2 pika 4 të LPRSFJ-së, parashihej dënimi me burgim jo më pak se dhjetë vite apo dënim me vdekje. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor vjen në konkludim si i dënuari është fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e gjykon me njëmbëdhjetë vite burgim (11), i cili aktgjykim vërtetohet nga gjykata e shkallës së dytë, ndaj të cilave aktgjykime është paraqitur edhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

Duke shqyrtuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në raport me shkresat e lëndës kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret ndaj të dënuarit është shkelur ligji penal në dëm të tij (sepse është aplikuar ligji penal me i disfavorshëm për të) për këto arsye:

Është evidente se për veprën penale të vrasjes nga neni të 47 par.2 pika 4 të Ligjit Penal të Serbisë (nenit 30 par.2 pika 4 të Ligjit Penal të ish Jugosllavisë) parashihej dënim me burgim jo me pak se 10 vite apo dënim me vdekje. Mirëpo, pas hyrjes së Kosovës nën administrimin e Kombeve të Bashkuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 datë 12 dhjetor 1999 (e që sipas nenit 3 të saj

konsiderohet se ka hyrë në fuqi me 10 qershor 1999) me nenin 1 par.1.1 pika (a) e (b) është paraparë se si ligje në fuqi në Kosovë janë rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe legjislacioni në fuqi në Kosovë i datës 22 mars 1989. Me këtë Rregullore përkatësisht nenin 1.5 të saj është hequr edhe dënimi me vdekje për të gjitha veprat penale për të cilat është paraparë ky dënim. Rregullorja e lartcekur është ndryshuar me 27 tetor 2000 me Rregulloren nr.2000/59 dhe sipas këtij ndryshimi (neni 1.5) dënimi me vdekje hiqet, por sipas par. **1.6** për çdo vepër penale për të cilën sipas ligjit në fuqi në Kosovë të datës 22 mars 1989 parashihet dënimi me vdekje, dënimi do të jetë me burgim ndërmjet minimumit që parashihet për atë vepër dhe maksimumi prej dyzet (40) vjetësh. Sipas nenit 4 - dispozitave kalimtare kjo rregullore hyn në fuqi me 27 tetor 2000, ndërsa neni i ri **1.6** vlen vetëm për krimet e kryera pas kësaj date.

Meqë me rregulloren e parë vetëm është shfuqizuar dënimi me vdekje dhe nuk është përcaktuar dënimi afatgjatë me burgim deri me ndryshimin e saj që përfshinë periudhën prej 10 qershor 1999 deri me 27 tetor 2000, posaçërisht bazuar nenin 4 të Rregullores se ndryshuar e cila qartë ka përcaktuar se dënimi me burgim afatgjatë vlen vetëm për krimet e kryera pas datës 27 tetor 2000, duke pasur parasysh edhe parimin e ndalimit të veprimit retroaktiv të ligjit penal, faktit se nuk ka bazë ligjore për shqiptimin e dënimit me burgim afatgjatë apo të përjetshëm gjatë kësaj periudhe dhe parimin e zbatimit të ligjit me të favorshëm kjo gjykatë vlerëson se për të gjitha veprat penale të cilat janë kryer deri me 27 tetor 2000 maksimumi i dënimit të shqiptuar me burgim është 15 vite, ngase që nga koha kur është hequr dënimi me vdekje e deri me ndryshimin e rregullores nuk është paraparë dënim tjetër përveç maksimumit të dënimit, e përveç kësaj sipas ligjit penal të Jugosllavisë neni 38 par. 2 për vepra penale për të cilat është parashikuar dënimi me vdekje gjykata ka mund të japë dënim me burgim deri në njëzet vjet por që me heqjen e dënimit me vdekje ka ra poshtë edhe kjo mundësi. Kurse, sipas Kodit Penal te Republikës së Kosovës (të vitit 2013) për veprën penale vrasja e rëndë, nga neni 179 par.1 nënpar.1.8 dhe nenit 31 të KPRK-së, sipas të cilës është cilësuar vepra penale me akuzë parashihet dënim me burgim jo më pak se dhjetë vite ose me burgim të përjetshëm. Pra, rezulton se ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur ngarkohet i dënuari se e ka kryer veprën penale ka qenë me i favorshëm, prandaj kjo Gjykatë e ricilësoj veprën penale sipas ligjit penal që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa duke pasur parasysh kohën kur është kryer vepra penale rezulton se në ketë çështje ka arrit parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Sipas dispozitës së nenit 95 par.1 pika 2 të Ligjit Penal të Jugosllavisë që është i zbatueshëm në rastin konkret ndjekja penale nuk mund të ndërmerrej kur të kenë kaluar pesëmbëdhjetë vjet nga kryerja e veprës penale për të cilën në bazë të ligjit mund të jepet dënimi me mbi dhjetë vjet burgim. Ndërsa, sipas nenit 96 pika 6 të po këtij ligji parashkrimi i ndjekjes penale lind në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës që kërkohet në bazë të ligjit për parashkrimin e ndjekjes penale - ndalesa absolute mbi ndjekjen penale.

Pra, parashkrimi i ndjekjes penale lindë me kalimin e kohës së caktuar nga kryerja e veprës penale deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm. Nuk ka dyshim se në rastin konkret ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, ngase që nga koha e kryerjes së veprës penale (20.10.1989), e deri sa aktgjykimi ka marrë formë të prerë kanë kaluar më tepër se 30 vite, pra parashkrimi absolut ka arritur me 20.10.2019 para se aktgjykimi te behej i formës së prerë.

Meqë, në rastin konkret ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit penal për parashkrim, pavarësisht faktit se mbrojtësi aktgjykimet nuk i kundërshton në ketë drejtim, duke pasur parasysh faktin se sipas dispozitave ligjore ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të këtë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit aktgjykimi i kundërshtuar u dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kurse shpenzimet e procedurës penale konform nenit 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale te Kosovës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.249/2022**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit D.S., ndryshohet aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.156/2019 i datës 09.12.2021, ashtu që ndaj të dënuarit konform nenit 363 par.1.3 të KPPK-së;

Refuzohet akuza

se në kohë të pacaktuar e deri më datën 15.09.2019, ka siguruar në mënyrë të paautorizuar armën e zjarrit – pistoletën e llojit "Zorakl 2", model 914-B të kalibrit 9 mm. me numër serik .., dhe një karikator e cila me datën e lartcekur i është konfiskuar nga policia,

- me çka kishte për të kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPK-së.

Në pjesën që ka të bëjë me këtë vepër penale, shpenzimet e procedurës penale bijën në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

- kërkesa është e bazuar në pjesën që ka të bëjë me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ndërsa nuk është e bazuar në pjesën që ka të bëjë me veprën penale kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Gjetjet e gjykatës për pjesën e aktgjykimit që ka të bëjë me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, pretendimi kryesor në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ishte se me shpalljen e tij fajtor, në dëm të tij është shkelur ligji penal, sepse ka ekzistuar një ndalesë e Ministritë të Punëve të Brendshme, me të cilën për shkak të

shpalljes së afatit për legalizimin e armëve, është pezulluar zbatimi i nenit 374 i KPRK-së (të ligjit i cili në atë kohë është aplikuar).

Gjykata Supreme, duke e vlerësuar këtë pretendim konstatojë se në shkresat e lëndës gjendet vendimi i Ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës numër 536/2018, i datës 23.11.2018, me të cilin është vendosur që të shpallet afati kohor për fillimin e procesit të legalizimit të armëve, në periudhën prej 17.12.2018 deri 17.06.2019 dhe gjatë këtij afati do të pezullohet zbatimi i nenit 374 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Më datën 25.06.2018 nga Ministria është vazhduar afati i legalizimit të armëve për tre muaj, deri më datën 17.09.2019.

Nga shkresat e lëndës rezulton se vepra penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor është kryer prej kohës së pacaktuar deri më datën 15.09.2019. Andaj, i dënuari pa autorizim e ka mbajtur armën para skadimit të afatit për legalizimin e tij, ndërsa në këtë periudhë, sipas vendimit të cekur më lartë, është pezulluar zbatimi i nenit 374 të KPRK-së.

Edhe pse në aktgjykimin e shkallës së dytë është theksuar se i dënuari armën e ka mbajtur pa autorizim një kohë të pacaktuar e deri në ditën e konfiskimit të armës (më 15.09.2019) që paraqet mbajtje pa leje të saj, gjegjësisht vepër penale, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme me vendimin e Ministrit është pezulluar zbatimi i ligjit, gjegjësisht dispozita për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve, ashtu që nuk ka ekzistuar mundësia ligjore për shpalljen e të dënuarit fajtor për këtë vepër penale, pasi që në rastin konkret kanë ekzistuar rrethanat që e kanë përjashtuar ndjekjen penale.

Pasi që me aktgjykimet e kundërshtuara është bërë shkelja e ligjit penal nga neni 385 par.1.3 të KPPK-së, në këtë pjesë u ndryshuan ashtu që u refuzua akuza, konform nenit 363 par.1.3 të KPPK-së ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 454 par.1 të KPPK-së.

5.3. Komentet përmbledhëse

Vlen të theksohet se te rasti i parë është parashkruar vepra penale e vjedhjes madje në kohën kur kishte vendosur shkalla e dytë ishte arritur parashkrimi absolut, kurse kjo shkelje nuk ishte evituar nga shkalla e dytë.

Karakteristikë e rastit të dytë është parashkrimi absolut i vrasjes se rëndë. Në fakt vepra penale ishte kryer me 20.10.1989 në kohën kur ishte në fuqi Ligji Penal i Kosovës, por vepra ishte cilësuar dhe akuza ishte ngritur sipas Ligjit Penal të Serbisë. Meqë i dënuari ishte në arrati nëpërmjet letër rreshtimit ndërkombëtar ishte ekstraduar në Kosovë. Pas arrestimit prokurori e kishte ricilësuar veprën penal të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.8 që kishte hyrë në fuqi në vitin 2013 si ligj me i favorshëm. Mirëpo, sipas vlerësimit të kësaj gjykate ky ligj nuk ishte me i favorshëm se ligji penal i Serbisë pas heqjes së dënimit me vdekje pas luftës. Ndërsa, duke pasur parasysh faktin se me Ligjin e Serbisë maksimumi i dënimit për ketë vepër penale ishte 15 vite pas heqjes së dënimit me vdekje, kjo Gjykatë e kishte ricilësuar veprën penale dhe refuzuar akuzën sepse për ketë vepër penale kishte arritur parashkrimi absolut.

Karakteristika e rastit të tretë qëndron në faktin se kjo Gjykatë nuk ka marrë aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, por për shkak se kanë ekzistuar rrethana që e kanë përjashtuar ndjekjen penale. Në fakt i dënuari për veprën penale të armëmbajtjes ishte ndjekur penalisht në kohën kur kishte ndalesë për ndjekje penale. Kështu, me vendimin e Ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës datë 23.11.2018 ishte shpall afat kohor për legalizim të armëve prej 17.12.2018 deri me17.06.2019 brenda të cilit afat ishte pezulluar zbatimi i nenit 374 i KPK-së, i cili afat ishte vazhduar edhe për tre muaj deri me 17.09.2019.

6. Ndryshimi i aktgjykimeve – sa i përket llogaritjes së paraburgimit

6.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore

Sipas dispozitës së nenit 385 par.1 nënpar.1.6 – shkelja e ligjit penal ekziston edhe kur janë shkelur dispozitat për sa i përket llogaritjes së paraburgimit, arrestit shtëpiak, çdo periudhe të heqjes së lirisë si dhe dënimit të mbajtur me parë lidhur me veprën penale që është objekt i procedurës penale. Kurse, sipas dispozitës së nenit 79 të Kodit Penal – koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo heqje e lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, masën edukativo institucionale dhe dënimin me gjobë. Madje, sipas nenit 80 të kodit penal paraburgimi, heqja e lirisë gjatë procedurës së transferimit të personit në një juridiksion tjetër dhe pjesa e dënimit të cilën e ka mbajtur kryesi sipas aktgjykimit të gjykatës

së huaj do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar nga gjykata në Kosovë për të njëjtën vepër, e nëse dënimi i shqiptuar jashtë Kosovës nuk është i llojit të njëjtë, llogaritja do të bëhet sipas vlerësimit të gjykatës.

6.2 Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të instancave me të ultë sa i përket llogaritjes se paraburgimit

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës supreme të Kosovës nuk janë të shpeshta rastet kur aktgjykimet kundërshtohen për këtë shkeljes së ligjit penale për shkak të llogaritjes së gabuar të paraburgimit, por në fakt paraqiten raste të tilla, atëherë kur kjo shkelje nuk evitohet as nga shkalla e dytë.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.171/2018**

AK T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit A.A., ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan P.nr.290/2014, datë 9.02.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.303/2018, datë 24.04.2018, ashtu që në dënimin e shqiptuar me burgim të dënuarit i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 7.06.2013 deri me 26.06.2013.

A r s y e t i m

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë PP.nr.16/13 datë 8.06.2013 të dënuarit A.A., i është caktuar arresti shtëpiak në kohëzgjatje prej 20 ditësh dhe atë prej 7.06.2013 deri me 26.06.2013, mirëpo, kjo kohë siç del nga aktgjykimi i shkallës së parë nuk i është llogaritur në dënimin e shqiptuar, siç me të drejtë pretendohet në kërkesë e mbrojtësit të tij. Pasi që në dëm të tij është shkelur ligji penal nga neni 385 pika 6 e KPP lidhur me nenin 83 par.1 të KPPK kërkesa në këtë pjesë u aprovua.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.121/2022**

A K T G J Y K I M

Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.A., dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.137/2020 të datës 31.08.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.944/2020 të datës 17.06.2021, vetëm përkitazi me llogaritjen e masës së paraburgimit në atë mënyrë që në dënimin e shqiptuar të dënuarit do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim për qëllim të ekstradimit nga data 12.12.2017 deri me datë 19.01.2018, kurse pretendimet tjera refuzohen si të pabazuara.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa është pjesërisht e bazuar

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë pjesërisht të bazuara, vetëm përkitazi me llogaritjen e masës së paraburgimit në dënimin e shqiptuar meqë dy gjykatat e instancave më të ulëta nuk i kanë llogaritur të dënuarit masën e paraburgimit të kaluar për shkak të ekstradimit. Nga shkresat e lëndës përkatësisht vendimet e Gjykatës së Oberlandit të Nurnbergut dhe Institucionit Korrektues të Nurnbergut i cili dokumentacion është përkthyer në gjuhë shqipe, vërtetohet fakti se i dënuari ka qëndruar në paraburgim nga data 12.12.2017 deri me datë 19.01.2018 dhe atë bazuar në kërkesën e Gjykatës Themelore në Prishtinë për shkak të kërkesës për ekstradim. Nga kjo rrjedh se në rastin konkret duhet zbatuar dispozita e nenit 83 par.1 të KPRK-së, pasi që periudha e kaluar në paraburgim ndërlidhet me veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas aktgjykimit i cili është objekt i shqyrtimit të kësaj gjykate.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.65/2019**

I. Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit N.S., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë KP.nr.593/2018, i datës 03.07.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.376/2018, i datës 06.11.2018, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që për vepra penale për të cilat është shpallur fajtor sipas aktgjykimeve të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.429/2014, datë 18.06.2015, Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.163/2009, datë 18.01.2010, Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.47/2014 të datës 06.08.2014, Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.12/2013, P.nr.463/12-PR1 i datës 13.02.2018, të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.134/2012, të datës 20.06.2014, Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1537/2012, datë 02.09.2016 dhe gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.102/2013 të datës 11.08.2017, ashtu që në dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) vjet, në të cilin i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 04.08.2009 e tutje, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në mbajtje të dënimit sipas aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.8/2014 datë 10.10.2014, sipas të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj.

II. Në pjesën tjetër aktgjykimet mbesin të pandryshuara.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me 436 par.1 të KPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e cekura në kërkesë të mbrojtësit të dënuarit si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes gjen se të dy gjykatat kanë shkelë ligjin penal në dëm të dënuarit respektivisht nenin 72 të KPK-së (tani neni 82 par. 1 të KPK), meqenëse nuk e kanë llogaritur kohën e kaluar në mbajtje të dënimit sipas aktgjykimit të formës së prerë PKR.nr.8/2014 të datës 10.10.2014, ashtu siç me të drejtë është potencuar në kërkesë. Sipas

dispozitës së nenit 72 të KPK (82 par. 1 të KPK), përcaktohet se "nëse personi i dënuar gjykohet për vepër penale të kryer para se të ketë filluar mbajtjen e dënimit të shqiptuar me një dënim të mëparshëm, apo për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim apo me burgim afatgjatë, gjykata shqipton dënim unik për të gjitha veprat penale, duke marrë parasysh dënimin e mëparshëm të shqiptuar. Dënimi ose pjesa e dënimit të cilin personi i dënuar e ka mbajtur llogaritet në dënimin e shqiptuar unik". Pra, sipas kësaj dispozite të dy gjykatat është dashur që në dënimin unik të shqiptuar t'ia llogarisin edhe kohën e kaluar në mbajtje të dënimit sipas aktgjykimit të formës së prerë.

Sa i përket pretendimit se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nënpar. 1.12 lidhur me nenin 370 par. 6,7 dhe 8 të KPPK-së, e cila shkelje konsiston në faktin se gjykata duhet të jep arsyetim lidhur me rrethanat të cilat i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit, kjo gjykatë gjen se, gjykata e cila vendos për bashkimin e dënimeve duhet të niset nga fakti se dënimet e përcaktuara për vepra të veçanta penale sipas aktgjykimeve janë të formës së prerë dhe si të tilla nuk vlerësohen a janë të drejta apo jo. Për më tepër, aktgjykimi për bashkim të veprave, vetëm shqipton dënimin unik për të gjitha dënimet e shqiptuara, sipas rregullave për bashkim të veprave. Arsyetimi i këtij aktgjykimi vetëm e qartëson, se për çka është bërë bashkimi i dënimeve dhe si është bërë shqiptimi i një dënimi të tillë. Gjykata me rastin e shqiptimi të dënimit unik nuk i vlerëson rrethanat e reja që mund të ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sepse ky dënim bazohet në vlerësimin e rrethanave të cilat janë marrë parasysh dhe janë vlerësuar në aktgjykimet e formës së prerë, nga gjykatat paraprake, dhe me këtë rast gjykata vetëm i zbaton dispozitat për bashkim të veprave dhe shqiptimin e dënimit unik për këtë bashkim.

6.3. Komentet përmbledhëse

Sa i përket këtyre rasteve nuk mund të thuhet shumë. Kemi të bëjmë me raste kur gjykata nuk ua ka llogaritë kohën e kaluar në paraburgim deri në ekstradim. Kjo në dënimin e shqiptuar, masën e arrestit shtëpiak dhe dënimin e mbajtur.

7. Ndryshimi i aktgjykimeve – sa i përket pjesës konfiskuese dhe kërkesës pasurore juridike

7.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore

Kjo shkelje ekziston kur gjykata me rastin e marrjes së vendimit për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale apo kërkesës pasurore juridike i ka tejkaluar kompetencat ligjore. Për kërkesat pasurore juridike vendos gjykata. lidhur me kërkesën pasurore juridike - neni 462 i KPP-së. Sipas dispozitës së nenit 457 par.1 të KPP-së, kërkesa pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale vendoset me propozimin e personave të autorizuar në procedurën penale në qoftë se kjo nuk e zvarrit procedurën në mënyrë të konsiderueshme, dhe kërkesa mund të përfshijë kompensimin e dëmit, kthimin e sendit ose anulimin e një veprimi të caktuar juridik. Sipas dispozitës së nenit 458 të KPP-së, propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale e paraqet personi i cili është autorizuar për të ushtruar këtë kërkesë në kontest civil, kurse nëse me vepër penale është dëmtuar pasuria në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore organi ose personi komptent i cili është i autorizuar me ligj të kujdeset për mbrojtjen e kësaj pasurie, mund të merr pjesë në procedurë penale në pajtim me autorizimet që ka në bazë të ligjit të tillë. Ajo çka është e rëndësishme të theksohet se sipas dispozitave ligjore aktgjykimi i formës së prerë sa i përket kërkesës pasurore juridike mund të ndryshohet vetëm me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Sa i përket konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale sipas dispozitës së nenit 271 të KPP-së, para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që është dobi pasurore, prokurori i shtetit e provon në shqyrtimin gjyqësor se pasuria është dobi pasurore e veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar.

7.2. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të instancave më të ultë sa i përket pjesës konfiskuese dhe kërkesës pasurore juridike.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.312/2021**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës së mbrojtësit të dënuarit N.M., për mbrojtje të ligjshmërisë aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik - Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, P.nr.131/2015, datë 24 dhjetor 2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit e Kosovës PA1.nr.306/2020, datë 8 prill 2021, ndryshohen përkitazi me kërkesën pasurore juridike, ashtu që nga obligimi që i dënuari t'ia kompensojë dëmin të dëmtuarës (Doganës së Kosovës) në shumë prej 130.618.52 € zbritet shuma prej 54.004.56 € dhe për këtë pjesë hiqet obligimi i të dënuarit ngase është obliguar edhe në kontest administrativ dhe i dënuari obligohet që t'ia kompensojë dëmin të dëmtuarës vetëm në vlerë prej 76.613.96 €.

Përkitazi me pretendimet tjera kërkesa refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

Kërkesa është pjesërisht e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi e kundërshton edhe kërkesën pasurore juridike. Kështu, sipas tij në këtë çështje penale sipas plotësimit të super ekspertizës të datës 20.11.2019 i dënuari i është shmangur doganave dhe akcizës në shumë prej 130.618.52 €, por, krahas çështjes penale është zhvilluar edhe kontest administrativ lidhur me të njëjtat deklarata doganore (DUD-at) dhe atë gjithsej trembëdhjetë: R-1.., R-3.., R-4.., R-6.., R-1.., R-2.., R-4.., R-6.., R-6.., R-2.., R-9.., dhe R-2.., ku vlera e obligimit shtesë të përcaktuar nga gjykata administrative është 54.004.56 €, pra, për të njëjtën çështje në dy procedura atë penale dhe administrative kemi dy vendime rreth pagesës së njëjtë, dhe një gjë e tillë nuk është e ligjshme sepse për të njëjtën çështje nuk mund të paguhet dy herë obligimi.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura kjo gjykatë gjen se ato janë të bazuara. Në këtë çështje siç del nga shkresat e lëndës respektivisht super ekspertiza, datë 15.07.2019 i dënuari për periudhën që ceket në dispozitiv të aktgjykimit i është shmangur taksave për import të mallrave në shumë prej 145.920.27 €, ashtu që pranë zyrës së doganave e ka paraqitur rrejshëm vlerën e mallit duke e nënvlerësuar atë me rastin e zhdoganimit të mallit. Objekt vlerësimi me këtë super ekspertizë

kanë qenë të dhënat nga dogana e Kosovës dhe nga Dogana e Turqisë si dhe krahasimi i tyre për të llogaritur diferencën në mes të deklarimit që është bërë në doganën e Kosovës dhe deklarimin që është bërë si eksport në Doganën e Turqisë për furnizimet nga firma eksportuese "P.., a.s-Turqi" dhe firmës eksportuese "S.., a.s-Turqi", me firmën importuese NTP "D..", nga Gjilani, pronar i të cilës është i dënuari, gjithsej 42 deklarata eksportuese nga këto dy firma eksportuese të Turqisë. Pas plotësimit të super ekspertizës, datë 20.11.2019 del se janë hequr nga kalkulimi gjashtë deklarata eksportuese dhe pas rivlerësimit të llogaritjes së importit që dogana e Kosovës ka obliguar importuesin NTP – "D.." del se vlera e shmangies nga taksat doganore në këtë rast është 130.618.52 €.

Mirëpo, nga shkresat e lëndës del se në ketë çështje është zhvilluar edhe kontest administrativ. Kështu, rezulton se dogana e Kosovës- sektori i auditimit të jashtëm me aktvendimin nr.04.3.1/213 datë 20.03.2013 e ka obliguar importuesin NTP – "D.." që të paguaj obligim shtesë për 206 deklarata doganore në shumë prej 837.140.10 €. Dogana e Kosovës pas kërkesës së importuesit-të dënuarit për rishqyrtim të vendimit me aktvendimin nr.05.2.1/351/2013 datë 24.04.2017 e ka refuzuar kërkesën e importuesit si të pabazuar.

Pas këtij vendimi importuesi ka iniciuar konflikt administrativ dhe Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë; e paditësit NPT -"D.." dhe e ka anuluar pjesërisht aktvendimin e Doganës së Kosovës ashtu që nga gjithsej 206 - Dud-at e ndryshuar me aktvendimin e doganës, paditësi NTP -"D.." obligohet të paguaj obligimet shtesë në emër të borxhit doganor shumën prej 54.004.56 € (vetëm për 13 deklarata eksportuese të Turqisë në raport me 13 deklaratat doganore të Kosovës). Ky aktvendim është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.45/2019, datë 1.10.2019.

Duke pas parasysh se mbrojtësi pretendon se 13 deklaratat unike doganore të lartcekura për të cilat i dënuari është obliguar që të paguaj në kontest administrativ janë të përfshira edhe në çështjen penale kjo Gjykatë i shqyrtoj me kujdes shkresat e lëndës veçanërisht dokumentet doganore eksportuese të dërguara me 4.02.2013 nga shteti i Turqisë dhe super ekspertizën e bërë në ketë çështje sa i përket këtyre dokumenteve doganore dhe gjeti se pretendimet e mbrojtësit janë të bazuara.

Pas shikimit dhe vlerësimit të dokumenteve doganore eksportuese të dërguar nga shteti i Turqisë, super ekspertizës dhe plotësimit të saj del se trembëdhjetë D..,-at që kanë qenë objekt shqyrtimi me vendimin administrativ, e të cilat i thekson mbrojtësi në kërkesë kanë qenë pjesë e kalkulimit dhe vlerësimit me super ekspertizë – shih super ekspertizën - tabela 1, faqja me numër katër, pra, deklaratat eksportuese të Turqisë prej numrit 16 deri në numrin 28 në tabelën nr.1 janë deklaratat doganore për të cilat bën fjalë mbrojtësi, e për të cilat i dënuari në kontestin administrativ është obliguar që të paguaj obligim shtesë në emër të borxhit doganor, pra, janë të përfshira edhe në çështjen penale, dhe edhe për to është obliguar që të paguaj.

Duke pasur parasysh të lartcekurat kjo Gjykatë aktgjykimet e kundërshtuara në pjesën që ka të bëjë me kërkesën pasurore juridike – obligimin që i dënuari t'ia kompensojë dëmin të dëmtuarës e ndryshoj, ashtu që nga obligimi që i dënuari t'ia kompensojë dëmin të dëmtuarës (Doganës së Kosovës) në shumë prej 130.618.52 € zbritet shuma prej 54.004.56 €, dhe për këtë pjesë hiqet obligimi i të dënuarit ngase është obliguar në kontest administrativ dhe nuk mund të obligohet edhe në procedurën penale.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.297/2021**

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit Xh.TH., ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.804/2017, i datës 31.12.2020. dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.156/2021, i datës 29.04.2021, vetëm përkitazi me detyrimin e të dënuarit për pagimin e kërkesës pronësoro juridike ashtu që hiqet detyrimi i tij që të dëmtuarit B.G., në emër të kompensimit të dëmit-kërkesës pronësoro juridike të paguaj shumën prej 1.690 (njëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjet) euro, por i dëmtuari për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontestin civil.
Në pjesën tjetër kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1 të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar, përveç në pjesën për kërkesën pronësoro-juridike.

Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë ceket se sasia e kafes së marrë në garazhën e të dëmtuarit ka qenë 144 kg dhe me përvetësimin e saj të dëmtuarit i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm. Edhe pse në dispozitiv nuk është cekur vlera e dëmit, i dënuari është obliguar që të dëmtuarit t`ja kompensojë dëmin në shumë prej 1.690 euro, pra, një shumë kjo e precizuar. Sipas nenit 463.par.2.të KPPK, në aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pronësoro juridike e të dënuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontestin civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund të realizojë në kontest civil. Nga kjo rrjedh se gjykata e obligon të dënuarin që të kompensojë të dëmtuarin vetëm nëse e ka vërtetuar lartësinë e dëmit, gjegjësisht për atë pjesë të cilën e ka vërtetuar, mirëpo, në rastin konkret kjo lartësi nuk është vërtetuar pasi që në nuk është cekur në dispozitiv, gjegjësisht në dispozitiv është thënë se fjala është për "dëm të konsiderueshëm". Për këtë arsye, me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë u konstatua se aktgjykimet janë marrë me shkelje të ligjit penal nga neni 385.par.1.4. të KPPK dhe në këtë pjesë u ndryshuan ashtu që u hoq obligimi i të dënuarit për dëmshpërblim dhe i dëmtuari u udhëzua që kërkesën të realizojë në kontestin civil.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.113/2022**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës së mbrojtësit të pandehurit F.Xh., për mbrojtje të ligjshmërisë aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.193/2017, datë 12 gusht 2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.403/2021, datë 12 nëntor 2021, përkitazi me këtë të pandehur ndryshohen në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë - në pjesën konfiskuese, ashtu që sendet e deklaruara jo saktë dhe ato të padeklaruara të cilat precizohen në urdhëresën për sekuestrim të përkohshëm të Gjykatës Themelore në Ferizaj UGJK.nr.40/2015 të datës 20.05.2015 e të cilat janë konfiskuar në mënyrë të përhershme i kthehen të pandehurit-pronarit.

Përkitazi me pretendimet tjera kërkesa refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa është pjesërisht e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka vendosur për konfiskimin e mallrave të pandehurit dhe në kundërshtim me nenin 115 të KPP, për faktin se gjykata urdhëron konfiskimin e përhershëm të sendeve në pajtim me ligjin, vetëm nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbejnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale. Në rastin konkret gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se mallrat e të pandehurit kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbejnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, dhe këto mallra as që janë pasuri e kundërligjshme dhe si të tilla nuk i nënshtrohen automatikisht konfiskimit konform dispozitës së nenit 282 të KPP-së.

Konfiskimin e mallrave të të pandehurit gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar kështu " konform nenit 115 par.2 të KPP, gjykata i ka konfiskuar në mënyrë të përhershme sendet e deklaruara jo saktë dhe atë të padeklaruara, të cilat janë sekuestruar sipas urdhëresës së kësaj gjykate UKGJ.nr.40/2015 të datës 20.05.2015, pasi që të njëjtat kanë mundësuar kryerjen e veprës penale". Mirëpo një arsyetim i tillë sipas mbrojtësit është tërësisht i gabuar dhe në kundërshtim me nenin 115 par.2 të KPP-së, për faktin se çështja penale ndaj të pandehurit ka përfunduar me aktgjykim refuzues, pra, jo me aktgjykim dënues nga rezulton fakti se nuk është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe as që është vërtetuar se mallrat e konfiskuara kanë mundësuar kryerjen e veprës penale. Pastaj, gjykata e shkallës së dytë arsyeton se; "pavarësisht faktit se gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar aktakuzën për shkak të parashkrimit absolut, mallrat në fjalë edhe ashtu janë konfiskuar edhe në bazë të procedurave doganore", mirëpo, një fakt i tillë nuk ka mbështetje në asnjë dispozitë ligjore dhe është në kundërshtim me

dispozitën e lartcekur për arsye se konfiskimi i mallrave në procedurë penale nuk behet nga dogana në procedurë doganore, por konform nenit 115 të KPP-së, bëhet nga gjykata dhe atë vetëm nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbejnë dobi pasurore të fituar me vepër penale.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura në kërkesë në raport me shkresat e lëndës dhe aktgjykimet e kundërshtuara, kjo gjykatë gjen se ato janë të bazuara.

Sipas dispozitës së nenit 112 par.1 të KPP-së, sendet që mund të sekuestrohen përkohësisht janë sende që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, sende ose pasuri që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, ose sende që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh sekuestrimin.

Kurse, sa i përket konfsikimit të përhershëm të sendeve të sekuestruara përkohësisht me dispozitën e nenit 115 par.1 të KPP-së, është paraparë se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht sipas nenit 112 të këtij Kodi në fund të procedurës penale i kthehen pronarit apo poseduesit sipas nenit 116 (sipas të cilit sendet e sekuestruara përkohësisht gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura penale pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskim i e tyre) të këtij kodi, përveç nëse veprimet janë marrë sipas paragrafit 2 të këtij neni apo nëse ndonjë veprim tjetër i lejuar me ligj do të ofronte bazën për të mos kthyer sendet, pasurinë, provat apo paratë. Sipas, par. 2 nenit 115 - gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues urdhëron sekuestrimin e përhershëm të sendeve në pajtim me ligjin, nëse prokurori i shtetit: 2.1. përcakton në aktakuzë ato sende, pasuri, prova apo para të cilat i nënshtrohen sekuestrimit të përhershëm; 2.2. nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale; dhe 2.3. ligji lejon konfiskimin e tyre.

Sipas nenit 282 par.1 të KPP-së, pasuria që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, pa marrë parasysh gjetjet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Poseduesi, shfrytëzuesi ose i pandehuri nuk ka të drejtë ankese. Sipas par.2 të këtij neni pasuria nga paragrafi 1. të këtij neni

përfshinë: 2.1. armët të cilat janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 371 deri 376 të Kodit Penal. 2.2. kimikatet, sendet, substancat, pajisjet ose armët që janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 121, 122, 124, 125, 127, 128, 129, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 143, 144, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 158, 159, 161, 163, 172, 173, 174, 175, ose 176 të Kodit Penal. 2.3. kimikatet ose substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 262, 263, 264, 265, 266, 269, 270, 346, 347, 348, 350, 353, 354 ose 355 të Kodit Penal, si dhe kafshët, të lashtat, ushqimi apo uji i kontaminuar me vepër penale. 2.4. kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 272-280 të Kodit Penal. 2.5. paratë apo sendet e falsifikuara të krijuara apo të përdorura në veprën penale nga neni 292, 293, 301 303 ose i Kodit Penal.

Nga shkresat e lëndës në këtë çështje me urdhëresën e Gjykatës Themelore në Ferizaj UKGJ.nr.40/2015, datë 20 maj 2015 është urdhëruar sekuestrimi i përkohshëm i sendeve pasurore të subjektit "D.." sh.p.k, me seli në Prishtinë (pronësinë mbi mallin e këtij subjekti sipas shkresave të lëndës e ka i pandehuri) dhe atë malli i deklaruar jo saktë dhe malli i padeklaruar i cili është përshkruar në detaje në këtë urdhëresë. Me rastin e ngritjes së aktakuzës në këtë çështje prokurori ka propozuar që malli i sekuestruar përkohësisht të konfiskohet, por nuk rezulton se procedura ka përfunduar me aktgjykim dënues, por, refuzues për shkak të parashkrimit absolut, pra, nuk është vendosur në mënyrë meritore në këtë çështje as në aspektin e përgjegjësisë penale, e as në aspektin e konfiskimit të sendeve respektivisht vërtetimit se malli i sekuestruar përkohësisht ka mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbën dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes dhe bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura kjo Gjykatë vlerëson se me të drejtë pretendohet në kërkesë së konfiskimi i përhershëm i sendeve është bëre në kundërshtim me dispozitat ligjore. Ngase, bazuar në faktin se procedura penale në këtë çështje ka përfunduar me aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit absolut të ndjekës penale kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 115 par.1 lidhur me nenin 116 të KPP, është dashur t'ia kthejë mallin të pandehurit, e jo t'ia konfiskojë në mënyrë të përhershme, ngase në rastin konkret nuk ka pasur bazë ligjore për konfiskim jo vetëm konform dispozitës së nenit 115 par.2 të KPP-së, por as konform dispozitës së nenit 282 (malli i sekuestruar nuk është qenësisht i rrezikshëm apo i paligjshëm) të KPP-së.

Për arsyet e lartcekura kjo gjykatë pretendimet e mbrojtësit sa i përket konfiskimit i konsideron si të bazuara, kurse aktgjykimet e kundërshtuara i ndryshoj sa i përket pjesës konfiskuese sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7.3. Komentet përmbledhëse

Vlenë të theksohet se tek rasti i parë gjykata e kishte obliguar të dënuarin që t'ia kompensojë kërkesën pasurore juridike edhe për pjesën për të cilën ishte zhvilluar kontest administrativ dhe ishte obliguar që ta paguajë këtë pjesë në ketë kontest, dhe një gjë e tillë nuk ishte evituar as nga shkalla e dytë, prandaj në ketë pjesë aktgjykimi ishte ndryshuar nga kjo gjykatë.

Tek rasti i dytë në dispozitiv theksohej se të dënuarit i ishte shkaktuar dëm i konsiderueshëm por që ishte obliguar që të dëmtuarit tia paguajë dëmin në shumë prej 1.690 €, e cila nuk ishte vërtetuar, për çka kjo gjykatë aktgjykimet i kishte ndryshuar ashtu që të dëmtuarin e kishte udhëzuar në kontest civil.

Tek rasti i tretë procedura kishte përfunduar me aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit absolut dhe nuk ishte vendosur as në aspekt të konfiskimit respektivisht vërtetimit se malli i sekuestruar përkohësisht ka mundësuar kryerjen e veprës penale, prandaj kjo Gjykatë konkludon se konfiskimi ishte bërë në mënyrë të kundërligjshëm, sepse nuk kishte bazë ligjore për konfiskim as konform nenit 115 par.2 të KPP-së, i cili ishte në fuqi në kohën e vendosjes as konform nenit 282 të KPP-së, malli i konfiskuar nuk ishte qenësisht i rrezikshëm apo i paligjshëm. Vlenë të theksohet se për sendet që janë të rrezikshme pavarësisht faktit se procedura përfundon me aktgjykim lirues apo refuzues konfiskohen, por në rastin konkret sendet e konfiskuara nuk ishin të tilla.

8. Ndryshimi i aktgjykimeve – sa i përket vendimit për dënim në rastet kur gjykata i ka tejkaluar autorizimet ligjore sa i përket dënimit

8.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore

Shkelje e ligjit penale sa i përket vendimit mbi dënimin konform dispozitës së nenit 385 par.1 nënpar.1.5 të KPP-së, vetëm në rast se gjykatat me rastin e marrjes së vendimit për dënim, dënim

alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim ka tejkaluar kompetencat ligjore. Gjykata i tejkalon kompetencat ligjore kur shqipton dënimin i cili nuk mund të shqiptohet nën minimumin e veçantë ose mbi maksimumin apo shqipton lloj tjetër të dënimit i cili nuk mund të shqiptohet për atë vepër penale.

8.2. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me ndryshimin e aktgjykimeve të instancave më të ultë sa i përket cilësimit juridik të veprës penale

Referuar praktikës gjyqësore këto raste janë me të rralla, megjithatë ka raste kur gjykata i tejkalon kompetencat e veta sa i përket minimumit dhe maksimumit të dënimit.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.154/2018**

AK T GJ Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të miturit B.H., ndryshohet aktvendimi i fomës së prerë i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për të Mitur, PM.nr.9/2018 datë 28.03.2018, ashtu që të miturit B.H., për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 3 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të KPK-së, i shqiptohet masa edukuese mbikëqyrja e shtuar e organit të kujdestarisë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e bashkë me këtë masë i shqiptohen edhe detyrimet e veçanta që të pranojë këshilla psikologjike dhe të mos vizitoj vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek ai. Në rast se i mituri nuk vepron në pajtim me detyrimet e veçanta, msa e shqiptuar edukuese mund të zëvendësohet me masë tjetër edukuese.

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të miturit dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se pretendimet e mbrojtësit qëndrojnë duke u nisur nga fakti se i mituri ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 3 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të KPK-së, për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej 3 muaj deri në 3 vjet, dhe i është shqiptuar masa

edukativo institucionale – dërgimi në institucionin edukativo korrektues në kohëzgjatje prej një viti, edhe pse konform dispozitës së nenit 28 par.1 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur - Gjykata shqipton masën e dërgimit në institucionin edukativo korrektues në rastet kur i mituri ka kryer vepër penale të dënueshme me burgim prej me shumë se 3 vjet dhe ka nevojë për edukim të specializuar, pra në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të mitur, prandaj i ndryshoj edhe vendimet e instancave me të ultë dhe ndaj të miturit shqiptoj masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e e organit të kujdestarisë.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi PML.nr.226 /2020**

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të miturit E.B., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, PM.nr 228/2019 i datës 09.12 2019, si dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAM.nr.18/2020, i datës 04.03.2020, vetëm sa i përket vendimin mbi dënimin, ashtu që kjo gjykatë për veprat penale për të cilat i mituri është shpallur fajtor e gjykon me dënim me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjet e 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim do ti përfshihet koha e kaluar në paraburgim nga data 09.01.2018 deri më datë 29.01.2018 dhe në arrest shtëpiak nga data 29.01.2018 deri më datë 07.02.2018 si dhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.03.2018 e tutje.

Në pjesën tjetër aktgjykimet mbesin të pa ndryshuara.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 pa.1 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Sa i përket shkeljeve të Kodit të Drejtësisë për të Mitur kjo gjykatë gjen se me dispozitën e nenit 35 par.2 të KMD, përcaktohet se "burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se 6 (gjashtë) muaj e as më shumë se 5 (pesë) vjet dhe shqiptohet në muaj dhe vitet të plota. Përjashtimisht, maksimumi i burgimit për të mitur është 10 (dhjetë) vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, ose kur i mituri ka kryer së paku dy vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme më shumë se 10 (dhjetë) vjet". Meqenëse për veprën penale vrasje nga nenin 172 të KPRK-së, nuk përcaktohet dënim me burgim të përjetshëm, kurse për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 366 par.1 të KPK-së nuk parashihet dënim mbi 5 (pesë) vite burgim kjo gjykatë gjen se të miturit E.B., nuk ka mund ti shqiptohet dënim me burgim për të mitur në kohëzgjatje më të lartë se 5 (pesë) vite, për shkak se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me vepër penale të dënueshme me burgim të përjetshëm e as me kryerjen e dy veprave penale ku se cila prej tyre dënohet prej më shumë se 10 (dhjetë) vjet burgim. Andaj, kjo gjykatë duke gjetur se është shkelur ligji penal në dëm të të miturit i ka ndryshuar aktgjykimet e kundërshtuara në kuptim të nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, vetëm sa i përket vendimin mbi dënimin dhe të njëjtin e ka gjykuar me dënim me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjet e 10 (dhjetë) muaj. Kjo gjykatë duke vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat do të ndikonin në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPK-së, ka aprovuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, të vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë duke i marr si të drejta dhe duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë me nenin 32 të KDM dhe 38 të KPK, dhe se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të veprës penale të miturit.

8.3. Komentet përmbledhëse

Vlen të theksohet se ne të dy rastet gjykatat i kanë tejkaluar kompetencat ligjore sa i përket vendimit për dënim. Në rastin e parë duke shqiptuar masë edukativo institucionale për veprën penale për të cilën nuk ka mund të shqiptohet kjo masë, kurse në rastin e dytë duke e tejkaluar maksimumin e dënimit me burgim për të mitur.

KAPITULLI IV
MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT

1. Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave përkitazi me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit me vështrim të posaçëm masën e paraburgimit

Fillimisht duhet kuptuar fakti se masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit nuk janë sanksione por janë masa dhe përdoren me qëllim të sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedure penale, pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe me qëllim që procedura penale të zbatohet në mënyrë të suksesshme, përkatësisht të mos ketë pengesa gjatë zhvillimit të saj.

Me rastin e aplikimit të këtyre masave duhet pasur parasysh zbatimin e disa parimeve të rëndësishme siç janë: parimi i ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe kontrollit gjyqësor. Është e rëndësishme të theksohet fakti se në praktikën gjyqësore vazhdon të mbetet shqetësues arsyetimi i pamjaftueshëm i kërkesave për masat e sigurisë së të pandehurit e veçanërisht masës së paraburgimit dhe po ashtu edhe arsyetimi i mangët nga ana e gjykatave respektive përkitazi me caktimin e këtyre masave.

Me dispozitën e nenit 171 par.158 të KPP-së janë listuar masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit përkatësisht pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe me qëllim të zbatimit të suksesshëm të procedurës penale dhe të cilat janë gjithsejtë tetë masa:

a. thirrja;
b. urdhërarresti;
c. premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin;
d. ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar;
e. paraqitja në stacionin policor;
f. dorëzania;
g. arresti shtëpiak; dhe
h. paraburgimi.

[158] Megjithëse ky doracak ka filluar deri sa në zbatim është Kodi i Procedurës Penale –Kodi nr.08/L-032, kurse vendimet janë marrë nga Kodi i Procedurës Penale Kodi nr. 04/L-123 që ka qenë në fuqi, atëherë referencat ligjore do të jenë në Kodin aktual duke pasur si referencë edhe dispozitat e Kodit paraprak.

Meqenëse në parim, kërkesa për mbrojtën e ligjshmërisë të cilat shqyrtohen dhe vendosen nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës janë vetëm vendimet e përfunduara me formën e prerë, kurse përjashtim bëjnë vendimet lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit[159], atëherë në këtë doracak do të trajtohen vetëm rastet e paraburgimit dhe kjo për shkak të rëndësisë dhe peshës që ka kjo masë me ç'rast përmes kësaj mase cenohen të drejtat fondamentale të personave të privuar nga liria. Në praktikën gjyqësore shpeshherë janë paraqitur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë edhe për masat e tjera nga neni 171 par.1 të KPP-së, mirëpo të njëjtat nuk janë shqyrtuar në mënyrë meritore por janë hedhur si të palejuara.

Në këtë drejtim, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk ka dallim kur vendoset për rastet e paraburgimit dhe për rastet e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të formës së prerë, pra në parim nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës është vërejtur se mund të paraqiten këto situata:

1) refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë;
2) aprovohet/refuzohet pjesërisht kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ose
3) aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim refuzon si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kur vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, nga nenet 386 dhe 432, paragrafit 2. të KPP-së.[160]

Ndërsa, nëse Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;

[159] Duhet theksuar faktin se risi në Kodin e Procedurës Penale- Kodi nr.08/L-032 që aktualisht është në fuqi paraqet fakti se do të shqyrtohen rastet kur bëhet ndërprerja e masës së paraburgimit
[160] Neni 437 i KPP-së.

1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose

1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.[161]

Është e rëndësishme të theksohet fakti se në këtë doracak do të analizohen rastet e caktimit-vazhdimin e masës së paraburgimit në të gjitha fazat e procedurës penale, meqë paraburgimi sipas dispozitave të KPP-së mund të caktohet dhe vazhdohet në tri faza të procedurës penale dhe atë:

a) gjatë fazës së procedurës paraprake;
b) pas ngritjes së aktakuzës; dhe
c) pas shpalljes së aktgjykimit.

Nga kjo arsye në këtë doracak do të analizohen vetëm rastet e paraburgimit dhe atë në tri dimensione:

a. Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë anulimin e vendimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore dhe rastet janë kthyer në rivendosje;

b. Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë ndryshimin e vendimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore te caktimi gjegjësisht vazhdimi i paraburgimit dhe të cilat vendime janë ndryshuar duke hequr masën e paraburgimit;

c. Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë ndryshimin e vendimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore te caktimi gjegjësisht vazhdimi i paraburgimit dhe të cilat vendime janë ndryshuar duke caktuar masë më të butë;

Duke pasur parasysh se paraburgimi është masa më e rëndë e sigurimit të pranisë së të pandehurit në procedurë penale, meqë përmes kësaj mase bëhet kufizimi i lirisë së lëvizjes së të pandehurit. Andaj, për këtë arsye aspekti i caktimit dhe vazhdimit të masë së paraburgimit duhet të jetë sa më

[161] Neni 438, paragrafi 1. i KPP-së.

i kufizuar dhe të përdoret si masa e fundit kundruall masave tjera me të cilin mundet që në mënyrë efektive të bëhet sigurimi i pranisë së të pandehurit.

Sipas legjislacionit në fuqi përkatësisht KPP-së, paraburgimi është fakultativ me përjashtim të rasteve kur pas shpalljes së aktgjykimit shqiptohet dënimi me pesë apo më shumë vite burgim, atëherë paraburgimi ka karakter obligativ.[162]

Meqenëse është masa më e rëndë dhe zbatohet vetëm përjashtimisht, atëherë me dispozitën e nenit 182 të KPP-së dhe bazuar në parimin e ligjshmërisë është përcaktuar se masa e paraburgimit mund të caktohet vetëm nën kushtet dhe në pajtim me procedurat e parapara të KPP-së dhe duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme. Kurse pas caktimit të masës së paraburgimit të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme që në thelb ka për qëllim që paraburgimi të reduktohet në kohën më të shkurtër të mundshme. Paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij.

Paraburgimi është i ndërlidhur ngushtë me parimin e proporcionalitetit që nënkupton se me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t'i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa më e butë dhe se masat hiqen kur pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo zëvendësohen me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet.

2. *Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit*

2.1. Dispozitat ligjore

a) Neni 187, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i KPP-së

[162] Kjo dispozitë i referohet Kodit të Procedurës Penale – Kodi nr. 04/L-123, kurse me Kodin e Procedurës Penale-Kodin 08/L-082 nuk ekziston paraburgimi obligativ por për faktin se shumica e aktgjykimeve që do të analizohen janë sipas Kodi nr. 04/L-123, atëherë është bërë përshkrimi i këtij dallimi mes dy kodeve procedurale.

Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit

"Gjykata mund të caktojë paraburgimin ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se: ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale"

2.2. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Përcaktimi i dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale është një çështje mjaft delikate pasi që kjo është një fazë mjaft e hershme e zhvillimit të hetimeve, për më tepër, në shumicën e rasteve në praktikën gjyqësore vërehet se paralelisht me kërkesën për caktimin e paraburgimit nxjerret aktvendimi për fillimin e hetimit, që paraqet një vështirësi shtesë në përcaktimin e dyshimit të bazuar. Nga kjo rrjedh se gjykata në këtë fazë ka mjaft vështirësi në definimin e dyshimit të bazuar, përkatësisht përcaktimin e kualitetit dhe kuantitetit të provave me qëllim të përcaktimit të ekzistimit apo jo të dyshimit të bazuar.

Konsiderojmë se ligjvënësi e ka lehtësuar punën e gjyqtarëve me rastin e vërtetimit të dyshimit të bazuar duke dhënë një përkufizim i cili është cituar dhe kjo pa dyshim se paraqet një premisë në të cilën duhet të mbështeten gjyqtarët me rastin e vendosjes përkitazi me dyshimin e bazuar. Pra me dispozitën e nenit 19 par. 1.9 i KPP-së, është përcaktuar dyshimi i bazuar " *njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka më shumë gjasa që të ketë kryer veprën penale se sa që të mos e ketë kryer atë dhe i cili dyshim i bazuar duhet të mbështetet në prova të artikulueshme."*

Në këtë aspekt është e rëndësishme të theksohet edhe përkufizimi që KEDNJ-së me dispozitën e nenit 5 par.1 pika c ku ka përcaktuar se "*kushtet e arrestimit ose ndalimit pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj",* ashtu që përmes kësaj dispozite janë formësuar bazat për caktimin - vazhdimin e masës së paraburgimit, gjegjësisht e drejta e lirisë dhe sigurisë. Tutje theksohet fakti se masa e paraburgimit ka karakter të masës procedurale dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të kenë karakter të dënimit, por vetëm arritjen e qëllimeve procedurale.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se ekzistimi apo mos ekzistimi i dyshimit të bazuar si kusht themelor për caktimin e paraburgimit çmohet nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe i cili vlerësim duhet të bazohet në fakte dhe të dhëna që gjenden në shkresat e lëndës dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë i bazuar në supozime. Gjithashtu në këtë aspekt është e rëndësishme të theksohet fakti se bazat e paraburgimit e në këtë rast dyshimi i bazuar nuk duhet vlerësuar në mënyrë abstrakte apo duke bërë citim të dispozitave ligjore, por duhet që për secilin rast të vlerësohen në mënyrë konkrete dhe përmes çmuarjes së lirë të provave që janë në dispozicion deri në momentin kur vendoset lidhur me kërkesën e prokurorisë. Në këtë aspekt është e rëndësishme të potencohet fakti se me vet shprehjen që përdorë ligjvënësi se mund të caktojë paraburgimin paraqet një indikacion të qartë se ligjvënësi nuk ka marrë qëndrim që apriori të caktohet masa e paraburgimit, por ka lënë që kjo çështje të jetë në diskrecion të plotë të gjykatës e cila përmes provave që i ka në dispozicion natyrshëm të ofruara nga palët në procedurë, si nga prokurori i shtetit e po ashtu dhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij pastaj të vendosë se a janë plotësuar apo jo kushtet për përcaktimin e dyshimit të bazuar. Pra përcaktimi i dyshimit të bazuar paraqet pragun fillestar, përkatësisht hapin e parë drejt caktimit të masës së paraburgimit dhe fakti i mos përmbushjes të këtij kriteri në mënyrë automatike përjashton mundësinë e caktimit të paraburgimit. Duke u referuar në përcaktimin e dyshimit të bazuar duhet pasur parasysh edhe faktin se heqja e lirisë duhet të sigurohet mbi bazë të fortë dhe për rrjedhojë nuk është arbitrare e përcaktuar edhe me nenin 5 (1) c të KEDLNJ-së dhe e etabluar përmes vendimeve të GJEDNJ-së, gjegjësisht Gjykatës së Strasburgut ku është vu theksi në faktin se një dyshim duhet të deklarohet si i bazuar në rastin Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, kur ndershmëria dhe bona fides i dyshimit të jenë elementë të domosdoshëm të arsyetimit të dyshimit – por që mund të konsiderohet si i arsyeshëm nëse bazohet gjithashtu në faktet ose informacionin që e lidhin në mënyrë objektive personin e dyshuar me krimin e supozuar. Kështu duhet të ekzistojnë provat e veprimit që përfshinë në mënyrë të drejtpërdrejtë personin në fjalë ose dokumentet apo provat për efekte të ngjashme. Pra, nuk duhet të ndodhë heqje lirie bazuar në ndjenjat, instinktet, thjesht lidhja e bërë ose paragjykimi (qoftë etnike, fetare ose ndonjë tjetër) pavarësisht sesa të besueshme mund të konsiderohen ato si indikatorë të përfshirjes së dikujt në kryerjen e një vepre penale. Kjo nuk nënkupton se prova duhet të jetë ose e mjaftueshme për të justifikuar një dënim, ose të ketë prova për të bërë një akuzë, siç është parë tashmë u njoh në çështjen *Brogan kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* fakti se objekti i marrjes në pyetje në fazën e heqjes së lirisë që lejohet

sipas Nenit 5 (1) (c) është thjesht për të vazhduar hetimin për një vepër penale të mundshme duke konfirmuar ose jo dyshimin që ekziston që nuk mund të jetë sigurisht përfundimtar në këtë fazë, megjithatë duhet të ketë baza për dyshimin mbi të cilin mbështetet çështja.

Teoria dhe praktika gjyqësor kanë pranuar se dyshimi i bazuar nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra dhe të shqyrtuara në përputhje me ligjin të cilat në unitetin e tyre tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe ajo është kryer nga ai që akuzohet dhe i cili dyshim duhet të krijohet mbi bazën e shqyrtimit në seancë të provave të paraqitura nga prokurori dhe i cili dyshim duhet të mbështetet në prova dhe nuk duhet të jetë i supozuar.

2.3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me vërtetimin e dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale

Çështja e vërtetimit të dyshimit të bazuar, siç u tha edhe më lartë është çështje mjaft delikate pasi që është fazë e hershme e procedimit të një çështje penale dhe në fakt është diskrecion i gjykatës që bazuar në çmuarjen e lirë të provave të grumbulluara deri në këtë fazë të procedurës të vërtetoj dyshimin e bazuar.

Kështu, në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.356/2021, i datës 04.10.2021, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për arsye se aktvendimet e kundërshtuara nuk përmbajnë arsyetim përkitazi me dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është caktuar masa e paraburgimit. Për më tepër, meqenëse në këtë rast ishin të përfshirë tre të pandehur rasti është kthyer në rivendosje vetëm përkitazi me të pandehurin E.R, meqë as në kallëzimin penal dhe as në aktvendimin për fillimin e hetimeve por as nga provat që ishin në shkresat e lëndës nuk rezulton se janë argumentuar veprimet e të pandehurit në drejtim të kësaj vepre penale, andaj gjykatë së shkallës së parë i është sugjeruar që të caktoj edhe një herë seancë dëgjimore dhe pastaj të vendosë lidhur me bazueshmërinë e kërkesës së prokurorit të shtetit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 356/2021 i datës 04.10.2021**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit E.R., anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PPRKR.nr.189/2021, i datës 11.09.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, PN1.nr.1054/2021, i datës 17.09.2021 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, i pandehuri ngelet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri. Ndërsa sa i përket të pandehurit M.R, aktvendimi ngel i paprekur.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për krime të rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.189/2021 të datës 11.09.2021, të pandehurit M.R, i ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për veprën marrja e ryshfetit nga neni 421 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 KPRK-së, dhe të pandehurit E.R, për shkak të veprës penale ndihma nga neni 33 në kryerjen e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së, ashtu që paraburgimi do t'iu zgjasë deri më datë 09.10.2021. Të pandehurve paraburgimi u është caktuar konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 e 1.2.3 të KPPRK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1.nr.1054/2021 e datës 17.09.2021, e ka refuzuar si e pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit E.R, dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehuri E.R, avokati H. S, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nënpar.1.2 lidhur me nenin 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë kërkesën si të bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara ti ndryshojë ashtu që të pandehurin ta liroi nga paraburgimi dhe i njëjti të mbrohet në liri, ose masën e paraburgimit t'ia zëvendësojë me ndonjë masë më të butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.120/2021 të datës 01.10.2021, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit E.R, avokati H. S, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se me rastin e caktimit të paraburgimit, prokuroria nuk ka ofruar asnjë dëshmi që e involvon të mbrojturin e tij për veprën penale për të cilën dyshohet, e po ashtu nuk janë përmbushur asnjë kondikt ligjore nga neni 165 par.1 pika 1.1, 1.2.1, 1.2.2 e 1.2.3 të KPPK-së. Se të dy aktvendimet e kundërshtuara janë të pakuptueshme, kundërthënëse si dhe nuk kanë arsyetimin e duhur ligjor. Gjykata e shkallës së parë si dhe ajo e shkallës së dytë nuk kanë ofruar prova të qarta në lidhje me dyshimin e bazuar, si mund të ikë, ndikojë në dëshmitarë dhe si do të përsërisë veprën penale ku më parë nuk ka qenë i dënuar e as që ka ra ndesh me ligjin si dhe cilat janë veprimet konkrete inkriminuese të cilat i ka kryer i pandehuri. Gjykatat po ashtu nuk kanë dhënë një shpjegim të arsyetuar për pamjaftueshmërinë e alternativave të paraburgimit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mbrojtësit janë të bazuara. Aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 të KPPK-së, ngase nuk përmbajnë arsye përkitazi me kushtin e veçantë për caktimin e paraburgimit - dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është duke u hetuar, e që është element qenësor për caktimin apo jo të paraburgimit.

Nga dispozitivi i aktvendimit mbi fillimin e hetimeve por as nga provat në bazë të të cilave është ngritur kallëzimi penal veçanërisht nga deklarata e A.B., rezulton se cilat janë veprimet inkriminuese të të pandehurit në bazë të cilave edhe formohen elementet e veprës penale të ndihmës në kryerjen e veprës penale nga neni 421 të KPRK-së. Në fakt nga përshkrimi faktik në aktvendimin mbi fillimin e hetimeve del se i pandehuri E.., se bashku me të pandehurin A pas

marrëveshjes në mes tyre i kanë fshehur paratë të cilat i pandehuri M.., i ka marrë ryshfet në bodrumin e një banese, por nga deklarata e të pandehurit A.., del se zarfin me para ia kishte dhënë M.., dhe e kishte lënë në veturën e të pandehurit M.., e përveç kësaj me asnjë provë tjetër nuk argumentohen veprimet inkriminuese të të pandehurit E.., në drejtim të veprës penale për të cilën dyshohet.

Sipas dispozitës së nenit 165 par. 2 të KPPK, kur masën e paraburgimit ai i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesë për caktim të paraburgimit e cila nder të tjera përfshin përshkrimin e provave që mbështesin dyshimin e bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale. Nga kërkesa për caktim të paraburgimit del se prokurori nuk ka përshkruar provat që mbështesin dyshimin e bazuar, kurse as provat në bazë të cilave është bërë kërkesa për caktimin e paraburgimit nuk mbështesin dyshimin e bazuar në drejtim të veprës penale për të cilën i pandehuri E.., dyshohet. Andaj, duke i pasur parasysh këto rrethana, aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë u dashtë të anulohen, ndërsa në rivendosje gjykata e shkallës së parë në seancën e dëgjimit duhet të kërkoj nga prokurori që të përshkruaj provat që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën e dyshuar penale dhe pastaj pas vlerësimit të kërkesës së prokurorit të merr një vendim të drejtë në ketë çështje sa i përket masës së paraburgimit.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.273/2022 i datës 07.07.2022, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për arsye se aktvendimet e kundërshtuara nuk përmbajnë arsyetim përkitazi me dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është vazhduar masa e paraburgimit. Në këtë rast është përcaktuar një standard që duhet të përcillet edhe me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit, meqë gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë të detyruara që në çdo aktvendim për vazhdimin e masë së paraburgimit të vlerësojnë dyshimin e bazuar dhe aq më tepër që në këtë rast bëhet fjalë për vazhdimin e kësaj mase. Gjykata Supreme e Kosovës ka vërejtur se nuk është arsyetuar mjaftueshëm dyshimi i bazuar dhe për këtë arsye ka kërkuar gjykatës së shkallës së parë edhe një herë të përshkruaj dhe arsyetoj provat që mbështesin dyshimin e bazuar dhe pastaj bazat e tjera dhe në asnjë mënyrë vetëm të bëj përshkrimin e dispozitave ligjore.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 273/2022 i datës 07.07.2022**

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesa e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurit L.P, kurse aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Renda DKR.PP.nr.60/2022, datë 3.6.2022 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.nr.789/2022, datë 17.6.2022, anulohen dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

I pandehuri mbetet ne paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Rënda DKR.PP.nr.60/2022, datë 3.6.2022, sipas kërkesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore të pandehurit L.P, ia ka vazhduar paraburgimin në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale penale trafikim me njerëz nga neni 165 par. 2 të KPRK-së. Kjo masë i është vazhduar konform nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë deri më datë 4.8.2022.

Duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të pandehurit Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1.nr. 789/2022 të datës 17.6.2022, e ka refuzuar atë si të pabazuar.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë të përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësit e të pandehurit, për shkak të shkeljes së ligjit penale dhe shkeljes së dispozitave të procedurës penale nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj kërkesën si të bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që ndaj të pandehurit të ndërpritet masa e paraburgimi.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.III.nr.95/2022, datë 6.7.2022, në të cilën propozon që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësit pretendojnë se Gjykata Themelore në Pejë dhe ajo e Apelit nuk kanë dhënë asnjë arsyetim konkret dhe relevant lidhur me kushtet për masën e paraburgimit nga neni 187 të KPP-së, jo vetëm përkitazi me dyshimin e bazuar por edhe për bazat ligjore për të cilat i është vazhduar paraburgimi. ngasë se ky dyshim i prokurorisë dhe i gjykatave bazohet vetëm në deklaratën e të dëmtuarës, e cila e ka dhënë me datë 24.2.2022 në Stacionin Policor në Mitrovicë dhe nuk ka asnjë provë tjetër të vetme me te cilën do të vërtetohej dyshimi se i pandehuri ka ndërmarrë ndonjë veprim në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën dyshohet. Gjithashtu mbrojtësit i kontestojnë edhe bazat e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nën par.1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së, për të cilat baza i është vazhduar paraburgimi.

Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësve të të pandehurit se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale (nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPP), pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht, nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete lidhur me dyshimin e bazuar. Në aktvendimet e kundërshtuara vetëm është parafrazuar dispozita ligjore e nenit 187 lidhur me kushtet e nevojshme për caktimin respektivisht vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato më detajisht dhe më konkretisht, e të cilat fakte të specifikuara e të konkretizuara, do të arsyetonin dyshimin e bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale trafikim me njerëz, për të cilën është i dyshuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara më lartë dhe në arsyetim duhet të përmbajë arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që e mbështesin dyshimin e bazuar, rrezikun e ndikimit në dëshmitarë si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Nuk është i mjaftueshëm vetëm përshkrimi i dispozitës ligjore pa i elaboruar edhe provat dhe arsyet konkrete dhe specifike që e mbështesin rrezikun e tillë për të pandehurin konkret.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.302/2022, i datës 04.08.2022, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së

parë për arsye se aktvendimet e kundërshtuara nuk përmbajnë arsyetim përkitazi me dyshimin e bazuar se i mituri ka kryer veprën penale për të cilën është caktuar masa e paraburgimit. Në këtë rast është përcaktuar një standard që duhet të përcillet edhe me rastin e caktimit të masës së paraburgimit edhe te personat e mitur dhe e veçanta e këtij rasti është se ka të bëj me shtetas të huaj, meqë gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë të detyruara që në çdo aktvendim për vazhdimin e masës së paraburgimit të vërtetojnë se dyshimi i bazuar është duke u rritur apo jo dhe mbi bazën e kësaj të vendosin për vazhdimin e masës së paraburgimit dhe jo vetëm të parafrazojnë dispozitat ligjore, siç ka vepruar gjykata e shkallës së parë dhe e ka ri konfirmuar gjykata e shkallës së dytë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 302/2022 i datës 04.08.2022**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të miturit K. A.A, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për të Mitur, Ppr.M.nr.52/00 i datës 19.07.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

I mituri duhet të qëndroj në paraburgimi deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin Ppr.M.nr.52/00 të datës 19.07.2022, të miturit K. A.A, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 367 par.2 të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj.

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të miturit K. A.A, avokati A.P, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.3 dhe nenit 61 par.3 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, me propozim

që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë kërkesën si të bazuar dhe i miturit t'i ndërpretit masa e paraburgimit.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr. 109/2022 të datës 01.08.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të miturit të hudhet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit për të mitur, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të miturit thekson se aktvendimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.3 sepse gjyqtari i çështjes para se të vendosë për vazhdimin e paraburgimit ndaj të miturit nuk i ka ftuar personat prania e të cilëve kërkohet me ligj, se këto shkelje ndërlidhen edhe me nenin 61 par.3 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur ngase nuk është mbajtur asnjë seance dëgjimore për rishqyrtim të vendimit dhe nuk është ftuar as i mituri e as mbrojtësi me rastin e vazhdimit të paraburgimit.

Edhe pse mbrojtësi i të miturit nuk e ka kontestuar dyshimin e bazuar, megjithatë Gjykata Supreme vlerëson se aktvendimi i kundërshtuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë përshkrimin e provave respektivisht, nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete lidhur me dyshimin e bazuar. Në aktvendimin e kundërshtuara vetëm është parafrazuar dispozita ligjore e nenit 187 lidhur me kushtet e nevojshme për caktimin respektivisht vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato më detajisht dhe më konkretisht, e të cilat fakte të specifikuara e të konkretizuara, do të arsyetonin dyshimin e bazuar se i mituri e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 367 par.2 të KPRK-së, për të cilën është i dyshuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara. më lartë dhe në arsyetim duhet të përmbajë arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që e mbështesin

dyshimin e bazuar. Nuk është i mjaftueshëm vetëm përshkrimi i dispozitës ligjore pa i elaboruar edhe provat dhe arsyet konkrete dhe specifike që e mbështesin dyshimin e bazuar për të miturin.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.383/2022 i datës 14.10.2022, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për arsye se aktvendimet e kundërshtuara nuk përmbajnë arsyetim përkitazi me dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është vazhduar masa e paraburgimit. Në këtë aktgjykim përveç arsyetimit të mangët të dyshimit të bazuar është konstatuar edhe vonesa e përpilimit të aktgjykimit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, meqë ankesa do të duhej të vendosej brenda afatit prej 48 orë, kurse në rastin konkret aktvendimi është përpiluar pas 16 ditëve.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 383/2022 i datës 14.10.2022**

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit B.M dhe A.M, e duke vepruar sipas detyrës zyrtare edhe për të pandehurin Sh. M, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PPrKR.nr. 431/22 i datës 12.08.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN. I nr.1146/2022 i datës 12.09.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. Të pandehurit, duhet të qëndrojnë në paraburgimi deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda me aktvendimin PPrKR.nr.431/22 të datës 12.08.2022, të pandehurve: B.M, A.M e Sh.M, për shkak dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale vrasja në tentative nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPRK-së, u ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj e cila masë u është vazhduar deri me datë 22.10.2022. Masa e paraburgimit u është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika l.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPKK-së).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda me aktvendimin, PN. 1.S.nr.1146/2022 të datës 12.09.2022, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve B.M, A.M e Sh. M, dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar: - Mbrojtësi i të pandehurit B.M, avokat F.L nga Prishtina, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të KPPRK-së për vazhdimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'ia miratoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të pandehurit ti ndërpritet masa e paraburgimit, ndërsa kjo masë ti zëvendësohet të njëjtit me një masë më të butë nga neni 173 i KPPRK-së.

-Mbrojtësi i të pandehurit A.M av. A.C nga Prishtina, për shkak të shkeljës esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 të KPPRK-së, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshoj aktvendimin e gjykatës themelore dhe atë të Apelit, ashtu që i pandehuri A.M., të lirohet nga paraburgimi, ashtu që i njëjti të mbrohet në liri ose ti shqiptohet një masë më e butë apo lëndën ta kthej në rivendosje.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.139/2022 të datës 10.10.2022 dhe 13.10.2022, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të pandehurve të efuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit B.M, ndër të tjera thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë janë marrë me shkelje ligjore nga neni 189 par.1 dhe nenit 187 par.1 nënpar. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPRKsë, nga se përveç bazës ligjore kërkohet edhe arsyetim për çdo fakt vendimtar për vazhdimin e paraburgimit, e në

rastin konkret shifet një orvatje e gjykatave me parafrazime ligjore, por të pa argumentuara me prova dhe fakte konkrete.

Mbrojtësi i të pandehurit A.M, në kërkesën e tij thekson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vazhdimin e paraburgimit i vërtetuar edhe me aktvendimin e gjykatës së shkallë së dytë janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 të KPPRK-së, sepse nuk kanë bërë kurrfarë përshkrimi apo shtjellimi për provat që mbështesin kallëzimin penal se ka dyshim të bazuar se i mbrojturi i tij A.M, ka kryer vepër penale për të cilat dyshohet apo të specifikohen se cilat kanë qenë veprimet e të dyshuarit A.., në këtë rast. Po ashtu theksohet në kërkesë se Gjykata e Apelit duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit A.M., ushtruar kundër aktvendimit të shkallës së parë ka vendosur me datë 12.09.2022, ndërsa vendimin e ka përpiluar me datë 28.09.2022, gjë që është në kundërshtim të plotë me afatet kohore të parapara në nenin 189 par.3 ku parashihet se ankesa vendoset brenda 48 orëve nga paraqitja e ankesës.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësve të të pandehurve B. M e A.M, për faktin se si kusht elementar që duhet përmbushet për vazhdimin e paraburgimit është dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale e cila u vihet në barrë, e për të cilin nuk janë dhënë arsye nga prokurori i çështjes. Andaj qëndrojnë pretendimet e mbrojtësve të të pandehurve B.M dhe A.M se aktvendimet e atakuara janë përfshirë me aplikim të gabuar të dispozitës së nenit 189 par.1 të KPPRK-së, dispozitë me të cilën mes tjerash thuhet se aktvendimi për caktimin-vazhdimin e paraburgimit duhet të përmbaj edhe arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale ndaj të cilit zhvillohen hetimet si dhe faktet vendimtare nga neni 187, par.1 nën par 1.2 të këtij kodi.

Duke pasur parasysh ketë gjendje të çështjes, prokurori në kërkesën për vazhdimin e paraburgimit nuk ka arrit të përfshijë provat që mbështesin bazat e artikulueshme për vazhdimin e paraburgimit konform dispozitës së nenit 165 par. 2.5 të KPPRK-së, për të cilat baza e ka kërkuar vazhdimin e paraburgimit, kurse edhe gjykatat e instancës më të ulta në ketë drejtim nuk kanë dhënë arsyet e duhura, kjo gjykatë i anuloj aktvendimet e atakuara me kërkesë. Në rivendosje gjykata e shkallës së parë në seancën dëgjimore duhet të kërkojë nga prokurori sqarime shtesë sa i përket përshkrimit

të provave që mbështesin bazat e artikulueshme për vazhdim të paraburgimit, e pastaj të vendos përkitazi me masën e paraburgimit.

Rrjedhimisht edhe pse kundër aktvendimeve të atakuara i pandehuri: Sh.M., nuk ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi edhe përkitazi me këtë të pandehur, në kuptim të nenit 436 par.2 të KPPRK-së sipas parimit "beneficium cohesionis".

2.4. Komente përmbledhëse - përkitazi me dyshimin e bazuar

Në rastet e paraqitura më sipër, por edhe një numër të madh të vendimeve të kësaj natyre, Gjykata Supreme e Kosovës me një kujdes të shtuar vlerëson kriterin themelor, përkatësisht dyshimin e bazuar si kusht bazik për të caktuar - vazhduar masën e paraburgimit. Pra, është një çështje fundamentale vërtetimi i dyshimit të bazuar duke pasur parasysh nivelin e provave që janë në dispozicion të gjykatës në atë moment. Nga aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Supreme të Kosovës mund të nxjerrën konstatime për rëndësinë primare që duhet kushtuar vërtetimit të dyshimit të bazuar, si kusht themelor për caktimin e masës së paraburgimit dhe faktin se gjatë seancës dëgjimore duhet të vërtetohet ky aspekt dhe gjithashtu që gjatë përpilimit të aktvendimit të arsyetohet posaçërisht kjo bazë.

Bazuar në praktikën gjyqësore dhe rastet të cilat janë paraqitur më lartë është krijuar një mënyrë e arsyetimit abstrakt dhe vetëm duke u numëruar provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe e cila mënyrë nuk paraqet arsyetim të mirëfilltë, meqë gjykata do të duhej që për secilën provë të theksonte rëndësinë dhe besueshmërinë e saj dhe ndërlidhjen me dyshimin e bazuar.

Një segment i rëndësishëm në këtë aspekt është edhe qasja e prokurorisë e cila në kërkesën e saj nuk paraqet të dhëna konkrete të cilat paraqesin dyshimin e bazuar e që pastaj edhe reflekton në arsyetimin e vendimit të gjykatave. Për më tepër, dyshimi i bazuar do të duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës sa mbetet në fuqi paraburgimi dhe se shpesh herë me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit nuk dallon vendimi i caktimit me vendimet e vazhdimit të masës për nga përmbajtja e saj e që konsiderojmë se duhet pasur kujdes pasi që dyshimi i bazuar mund të lëvizë qoftë në rritjen e nivelit të dyshimit të bazuar qoftë në rënien e tij dhe kjo duhet të reflektohet edhe

në vendimet gjyqësore. Konsiderojmë se në këtë duhet pasur parasysh edhe vet rolin e gjyqtarit të procedurës parapake që të përcjell me vëmendje të theksuar zhvillimet e një çështje penale dhe në asnjë rrethanë të mos ndodh që aktvendimet e vazhdimit të paraburgimit dallojnë vetëm për nga data e marrjes së vendimit dhe jo nga përmbajtja e tyre.

3. *Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit*

3.1. Dispozitat ligjore

a) Gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se:
1.2. përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;

1.2.2. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose

1.2.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej."

3.2. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Në rastin në vijim do të trajtohen rastet kur për caktimin e masës së paraburgimit duhet të plotësohen kushtet specifike. Karakteristikë e këtyre kushteve është fakti se të njëjtat nuk duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, pra mjafton që të plotësohet një nga këto kushte me qëllim të caktimit të masës së paraburgimit.

Përcaktimi i kushteve për caktimin e paraburgimeve po ashtu paraqet një çështje që trajtohet nga ana e gjykatave me rastin e caktimit të paraburgimit dhe në këtë aspekt ajo që fillimisht bie në sy në aktgjykimet e analizuara del se pothuajse në pjesën dërmuese të vendimeve arsyetimi përfshin tri bazat, përkundër faktit që këto baza mund të vlerësohen të shkëputura me njëra tjetrën, për më tepër, në shumicën e rasteve në praktikën gjyqësore vërehet se kërkesa vazhdimisht përmban arsyen për tri kushtet e caktimit të paraburgimit, pra rrallë herë ndodhë që të ketë kërkesë vetëm për një bazë që është e mjaftueshme për caktimin e paraburgimit.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se ekzistimi apo mos ekzistimi i kushteve për caktimin e paraburgimit çmohet nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe njëkohësisht është detyrim i arsyetimit të këtyre kushteve me rastin e përpilimit të aktvendimit.

Duke pasur parasysh kushtet e posaçme të paraburgimit në vijim të këtij punimi do të trajtohet secila nga kushtet e veçanta duke filluar së pari me rastet kur i pandehuri *fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij*.

Në këtë kontekst padyshim se fshehja paraqitet në rastet kur i pandehuri shmanget kontaktit me organet që zhvillojnë procedurën apo nuk mund të gjendet në vendbanimin – vendqëndrimin edhe pse nuk është arratisur dhe kjo zakonisht rezulton me shmangien e pranimit të thirrjes edhe pse adresa e tij është e njohur apo nuk e informon organin kompetent për ndryshimin e adresës kur është i obliguar ta përmbushte këtë detyrim. Kurse rrethana e dytë paraqitet kur nuk mund të vërtetohet identiteti i personit dhe në këto raste është e ditur se identifikimi bëhet përmes dokumenteve personale dhe metodave tjera. Legjislacioni ynë nuk ka përfshirë të drejtën e të pandehurit për të mos paraqitur identitetin e tij me rastin e marrjes në pyetje, por nga ai pritet që të jep të dhëna përkitazi me identitetin e tij dhe në rast se nuk mund të sigurohet identiteti i tij, atëherë kjo mund të rezultojë me caktimin e paraburgimit vetëm për këtë bazë.

Kurse sa i përket rrethanave tjera që tregojnë rrezikun e ikjes paraqesin bazën më të shpeshtë për caktimin e paraburgimit dhe kjo zakonisht manifestohet me mos disiplinën e të pandehurit dhe rrethanat tjera që paraqesin rrezik për ikje dhe vështirësimin e procedimit të çështjeve penale. Gjithsesi e rëndësishme është të theksohet se rreziku ikjes nuk duhet të nënkuptuar si një rrezik

abstrakt, por kjo duhet të jetë rrezik konkret dhe duhet të faktohet përmes rrethanave konkrete, siç mund të jetë posedimi i dy shtetësisë, posedimi i ndonjë vendbanimit në ndonjë shtet tjetër apo kur vepra penale për të cilën dyshohet është e asaj natyre që tregon rrezikun e ikjes, përkatësisht rastet kur është në pyetje vepra penale e falsifikimit të dokumenteve zyrtare.

Një çështje mjaft e rëndësishme me rastin e vlerësimit të rrezikut të ikjes është edhe vlerësimi i peshës së veprës penale, sanksionin penal të përcaktuar si dhe dëmin e veprës penale, por këta faktorë duhet çmuar gjithmonë në raport me rrezikun e ikjes dhe në asnjë mënyrë që këta faktorë të jenë si parakusht për rrezikun e ikjes.

Gjithsesi rastet më të komplikuara në praktikë janë vërtetimi i situatave që paraqesin rrezik të ikjes e posaçërisht rrethana tjera që paraqesin një përcaktim mjaft të gjerë dhe të pa definuar dhe i cili përcaktim duhet të bëhet përmes secilit rast konkret dhe pa dyshim se këto janë definuar përmes rasteve të praktikës gjyqësore e që definohen zakonisht rastet kur i pandehuri është në arrati, nuk ka vendbanim apo vendqëndrim të përhershëm, shpesh bën ndërrimin e vendbanimit, dhënia e të dhënave të rrejshme për vendbanim etj. Njëri prej kushteve që mjaft shpesh përdoret për caktimin e paraburgimit nga ana e gjykatave është edhe fakti se i pandehuri është shtetas i huaj apo posedon dy shtetësi të vendit tonë dhe ndonjë vendi tjetër dhe kjo pothuajse është e zakonshme të caktohet paraburgimi në këto raste, por se përkundër kësaj edhe në këto raste duhet vlerësuar rrezikun konkret të ikjes dhe duhet vlerësuar se shteti ynë a ka bashkëpunim të ndërsjellë të ndihmës juridike penale dhe me këtë rast do të mund të bëhej ekstradimi i tij, por se në këtë aspekt një vështirësi paraqesin rastet e shtetasve të Serbisë dhe pa mundësia e sigurimit të prezencës së tyre.

Kushti i dytë i posaçëm për caktimin-vazhdimin e paraburgimit janë rastet "*...kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit"* e cila në literaturë njihet si rreziku i kolezionit dhe paraqitet në rastet se përmes disa formave të ndryshme mund të pengojë rrjedhën e procedurën penale. Ky nën paragraf ka përcaktuar dy forma dhe atë forma e parë kur përmes ndikimit në provat konkrete, kurse forma e dytë përmes ndikimit në pjesëmarrësit e tjerë në procedurë penale, por esenca e dy formave është pengimi i rrjedhës së procedurës penale. Kurse format më të shpeshta në praktikë paraqiten kur i pandehuri dëmton provat materiale, rrezikun e

marrëveshjes me bashkëkryerësit tjerë dhe atë përmes lidhjeve miqësore, familjare, krejt kjo për pengimin e rrjedhës së procedurës penale. Në praktikën gjyqësore kjo bazë është mjaft e shpeshtë që rezulton me caktimin - vazhdimin e paraburgimit dhe se mjaft shpesh gjykatat nuk bëjnë analizë të mirëfilltë të kësaj baze duke arsyetuar edhe në rastet kur provat materiale janë tek organet shtetërore, përkatësisht në institutin e mjekësisë ligjore apo në agjensione tjera e që edhe pse mund të ketë përjashtime, mirëpo ndikimi në këto institucione është mjaft i pabesueshëm se mund të ndodhë. Por se ekzistimi i rrezikut të ndikimit zakonisht ndërlidhet në rastet kur kemi të bëjmë me prova personale, mirëpo ky ndikim duhet të mbështet në ndonjë bazë të caktuar dhe nuk duhet nënkuptuar një besueshmëri e thjeshtë, përkatësisht nëse vetëm do të duhej të dëgjohen disa dëshmitar, kjo apriori nuk do të thotë se do të ketë ndikim i pandehuri. Por duhet të jenë rrethana të posaçme që e tregojnë realizimin e ndikimit, qoftë përmes kontaktit me ndonjë dëshmitar, të dëmtuar apo bashkëpjesëmarrës, apo të bëhet përpjekje për kanosjen, shantazhin apo frikësimin e tyre, por në çdo rast duhet që ky rrezik të jetë konkret.

Në praktikë shpesh herë ndodhin situata që edhe pas dëgjimit të dëshmitarëve paraburgimi vazhdohet po mbi këtë bazë e që është një qasje e gabuar, meqë në momentin kur merren dëshmitarët në pyetje apo sigurohen prova për të cilat është caktuar paraburgimi, atëherë menjëherë do të duhet të hiqet masa e paraburgimit.

Kurse baza e tretë për caktimin - vazhdimin e paraburgimit paraqitet në rastet *"kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej."* Fillimisht duhet theksuar faktin se për të u plotësuar ky kusht duhet të vërtetohet një prej rrethanave të listuara në pjesën e parë të dispozitës ligjore, por që ndërlidhet me rrezikun e përsëritjes, të përfundimit të veprës së tentuar penale apo të kryejë veprën penale për të cilën është kanosur se do ta kryejë. Me një formë dispozita fillimisht ka përshkruar rrethanat të cilat mund të jenë të pritshme për realizimin e veprës të përcaktuar me pjesën e dytë të dispozitës ligjore.

Në këtë pikë të kushteve për caktimin e paraburgimit është e rëndësishme të trajtohet shkalla e rrezikshmërisë së veprës penale e cila mund të kryhet dhe serioziteti i veprës penale që mund të

kryejë i pandehuri dhe me rastin e shqyrtimit të këtij kushti, përkatësisht rrezikut të intercionit paraqet një mori kushtesh dhe që përgjithësisht ndahen në tri grupe. Në grupin e parë bëhet fjalë për rrethanat e veprës penale dhe atë ri kryerja, mënyra e kryerjes, koha e shkurtër kur i pandehuri kryen vepra penale dhe relacioni mes të të pandehurit dhe të viktimës, në grupin e dytë paraqiten rrethanat personale të kryerësit që ndërlidhen me personalitetin e tij, gjendjen shëndetësore, kurse në grupin e tretë e përbëjnë faktorët social, kur i pandehuri nuk është i punësuar dhe jetën e tij e siguron përmes veprave penale.

Përndryshe edhe Gjykata e Strasburgut përmes rasteve të saj ka përcaktuar këtë bazë për parandalimin e krimit dhe të cilat raste janë të rëndësishme dhe në bërjen e vlerësimit të këtyre rasteve duhen marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes veçanërisht historiku i jetës në të kaluarën dhe personaliteti i personit të përfshirë. Fakti që personi i përfshirë ka pasur dënime të mëparshme për të njëjtat vepra penale ose të ngjashme me atë që është nën shqyrtim do të ishte i rëndësishëm përsa i përket veprave penale që duket se janë kryer midis fillimit të hetimeve dhe personit të akuzuar me qëllim ndalimin e tij - *Rasti Asenov kundër Bullgarisë.* Megjithatë vazhdimi i paraburgimit të personit në raste të tilla mund të jetë jo i duhuri kur veprat penale në fjalë nuk mund të krahasoheshin me ato të mëparshmet as nga natyra, as nga shkalla e rëndësisë së tyre- *Rasti Clooth kundër Belgjikës*.

Kështu, në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.218/2019 i datës 29.07.2019, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për dy arsye thelbësore, së pari se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara dhe së dyti se prokuroria nuk ka kërkuar masën e paraburgimit për kushtin e përcaktuar me mundësinë e përsëritjes së veprës penale, por këtë kusht e ka arsyetuar. E rëndësishme është të theksohet fakti se kërkesa për caktimin e paraburgimit dhe kushtet e saj janë detyrim i prokurorit të shtetit dhe se gjykata sipas detyrës zyrtare nuk mund të shtoj ndonjë kusht i cili nuk është kërkuar nga ana e prokurorit të shtetit, përjashtimisht gjykata mund të vendosë të heq ndonjë arsye e që është në favor të të pandehurit, por në asnjë rrethanë të tejkaloj kërkesën e prokurorisë, siç është vepruar me këtë rast i cili në fakt ka krijuar bazën për anulimin e tij. Duhet theksuar faktin se në rastin konkret janë evidentuar edhe shkelje tjera, por gjykatat e dy shkallëve më të ulëta duhet të kenë kujdes që të mos tejkalojnë kërkesën e prokurorit,

meqë vetëm edhe kjo mund të jetë bazë për anulimin e aktvendimeve dhe kthimin e rastit në rivendosje.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 218/2019 i datës 29.07.2019**

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit E.H, kurse aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë PP.nr.234/19 datë 10.7. 2019 dhe ai i Gjykatës şë Apelit të Kosovës. PN.1.DP.nr.700/2019, anulohen dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

I pandehuri mbetet në paraburgim deri ne marrjen e një vendimi të ri. I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktvendimin PP.nr.234/19 të datës 10.07.2019, sipas kërkesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, të pandehurit E. H, ia ka caktuar paraburgimin në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer dy vepra penale të vjedhjes së rëndë, parashikuar me nenin 315 par.1 të KPRK. Kjo masë i është caktuar konform nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pikat 1.2.1 dhe 1.2.2 të KPP- së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do ti zgjasë deri me datë 08.08.2019.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn1.nr.700/2019 date 17.07.2019, është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit dhe është vërtetuar aktvendimi i shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka ushtruar mbrojtësi i pandehurit avokati S.L, për shkak të shkeljes së dispozitave të kodit të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme të aprovojë kërkesën si të bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që ndaj të pandehurit të ndërpritet masa e paraburgimit.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit, ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.Ill.nr.54/2019 datë 26.07.2019, në të cilën propozon që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi që vlerësoi pretendimet ankimore, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme vlerëson se aktvendimi i shkallës së parë i kundërshtuar me kërkesë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 383 par.1 nënpar.1.12 të KPP-së sepse nuk janë dhënë arsye sa i përket fakteve vendimtare - bazave të artikulueshme për të cilat është caktuar paraburgimi. Kështu, sipas dispozitës së nenit 165 par.2 nënpar.2.4 e 2.5 të kodit të Procedurës Penale nëse Prokurori i Shtetit beson se duhet caktuar masën e paraburgimit ndaj një personi, ai i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesë për caktimin e paraburgimit, e cila përfshin përshkrimin e provave që mbështesin dyshimin e bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale dhe përshkrimin e provave që mbështesin bazat e artikulueshme, për të besuar se ka rrezik të arratisjes; personi i arrestuar do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund të përsërisë veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

Pra, sipas kësaj dispozite kushti elementar që duhet të përmbushët për ta caktuar apo vazhduar gjykata ndaj një personi paraburgimin është dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale, kusht ky që sipas vlerësimit të kësaj gjykate në rastin konkret, siç del nga shkresat e lëndës rezulton të jetë i vërtetuar. Mirëpo, Prokurori në kërkesën për caktim të paraburgimit - ka përshkruar provat që mbështesin bazat e artikulueshme, për të besuar se ka rrezik të arratisjes dhe mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e

mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë personale tregojnë rrezikun se i pandehuri mund të ndikoj në dëshmitarë, apo fshehjen e provave apo asgjësimit të tyre, për të cilat baza Prokurori e ka kërkuar caktimin e paraburgimit që gjykata ka dhënë ndonjë arsye konkrete në ketë drejtim, pos që ka aprovuar ato të cilat i ka cekur Prokurori, kurse gjykata e shkallës së dytë të njëjtat rrethana i ka marr, për më tepër kjo gjykatë ka arsyetuar edhe bazën ligjore të mundësisë së përsëritjes së veprës penale për të cilën bazë Prokurori as që e ka kërkuar caktimin e paraburgimit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate nga kërkesa për caktimin e paraburgimit nuk rezulton se Prokurori ka përshkruar provat që mbështesin bazat e artikulueshme për të besuar se ka rrezik të arratisjes, asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, ose ndikimit në dëshmitarë apo të dëmtuar. Kështu, Prokurori në kërkesën për caktim të paraburgimit thekson se ka bazë të artikulueshme për caktimin e paraburgimit konform nenit 165 nënpar.2.5 pika 2.5.1 ngase ka rrezik të ikjes së të pandehurit kur merret parasysh dënimi që parashihet për këto vepra penale, kurse bazën për caktim të paraburgimit konform pikës 2.5.2 të nenit të lartëcekur të ndikimit në hetime e arsyeton me rrethanën se "i pandehuri nuk është deklaruar se çka ka bërë dhe ku i ka lenë sendet e vjedhura, e ky fakt paraqet mundësi reale që i njëjti të asgjësojë apo fshehë objektet e kësaj vepre penale e që janë sendet e vjedhura të cilat ende nuk janë gjetur, e krejt me qëllim të përgatitjes së mbrojtës në favor të vetin "të cilat rrethana sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk paraqesin prova që japin arsye për të besuar se i pandehuri mund të ikë apo të ndikojë në hetime aq me tepër kur ai nuk i mohon veprimet e tij (në njërin rast thekson se s'ka vjedhur ngase s'ka gjetur, kurse për rastin tjetër nuk e mohon sendet e vjedhura madje edhe vet Prokurori në kërkesën për caktim të paraburgimit e thekson faktin se i pandehuri i ka pranuar veprat).

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, faktin se Prokurori në kërkesën për caktim të paraburgimit nuk ka arrit të përfshijë provat që mbështesin bazat e artikulueshme për caktim të paraburgimit konform dispozitës së nenit 165 par.2.5 nenpar.2.5.1 dhe 2.5.2 të KPP, për të cilat baza e ka kërkuar caktimin e paraburgimit, kurse edhe Gjykatat në ketë drejtim nuk kanë dhënë arsye, kjo gjykatë i anuloj aktvendimet e kundërshtuara. Në rivendosje gjykata e shkallës së parë në seancën dëgjimore duhet të kërkojë nga prokurori sqarime shtesë sa i përket përshkrimit të

provave që mbështesin bazat e artikulueshme për caktim të paraburgimit, e pastaj të vendos përkitazi me masën e paraburgimit.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.132/2021 i datës 22.04.2021, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara dhe nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm dhe i plotë për caktimin e paraburgimit. E rëndësishme është të theksohet fakti se kërkesa për caktimin e paraburgimit dhe kushtet e saj duhet të arsyetohen mbi baza konkrete dhe në asnjë mënyrë të parafrazohen dispozitat ligjore dhe pa dhënë argumente të qarta se janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së paraburgimit. Për më tepër, aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë arsyetuar bazën e ikjes gjegjësisht arratisjen e të pandehurit dhe gjithashtu nuk janë paraqitur arsyetime bindëse se do të ndikojnë në dëshmitarë të mundshëm dhe nuk është sqaruar se këta dëshmitar a janë dëgjuar apo jo dhe këto të meta i bëjnë vendimet e paqëndrueshme dhe kushtëzojnë anulimin e tyre.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 132/2021 i datës 22.04.2021**

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit A.O, anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PPrKR.nr.234/21 të datës 31.03.2021 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.341/2021 të datës 08.04.2021 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

I pandehuri duhet të qëndroj në paraburgimi deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPrKR.nr.234/21 të datës 31.03.2021, të pandehurit A.O, për shkak të veprave penale keqpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK, përvetësimi në detyrë nga neni

418 par.1 lidhur me par.3 të KPRK dhe falsifikim të dokumentit nga neni 427 par.1 të KPRK, la ka caktuar masën e paraburgimit për (një) muaj e cila do të zgjasë deri më 29.04.2021. Masa e paraburgimit është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Kundër këtij aktvendimi ankesë kanë paraqitur mbrojtësit të pandehurve, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin, PN1.nr.341/2021 të datës 08.04.2021, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit A.O, av.B.Xh, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i ndryshojë aktvendimet e atakuara dhe masën e paraburgimit dhe ta zëvendësoj me masën e arrestit shtëpiak, dorëzaninë apo masën e paraqitjes në stacionin policor.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.41/2021 të datës 19.04.2021, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se në aktvendimin e shkallës së parë nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme të precizuara në nenin 187 dhe gjykata nuk ka dhënë asnjë arsye të qartë bindëse lidhur me faktet vendimtare mbi dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, se nuk ekziston fare rreziku i ikjes apo fshehjes sepse i pandehuri do të paraqitet në çdo ftesë të Gjykatës dhe është i gatshëm të dorëzoj menjëherë letërnjoftimin dhe pasaportën, se gjykata e shkallës së parë fare nuk ka dhënë arsye se si i pandehuri mund të ndikoj në dëshmitarë apo në prishjen e provave sepse të gjitha provat janë marrë dhe gjinden në polici dhe prokurori, se arsyetimi i gjykatës për përsëritjen e veprës penale është

absolutisht e pabazuar sepse i pandehuri nuk është recidivist dhe se që një vit nuk punon në T..., si dhe gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar masat tjera alternative sipas nenit 173 të KPPK të cilat do të ishin masa të mjaftueshme dhe të arsyeshme për sigurimin e pranisë të pandehurit.

Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 12.1 të KPRK, pasi që gjykatat të instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun e ikjes, ndikimit në dëshmitarë si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale konform nenit 187 par.1 nën par.1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPRK-së për të cilat baza i është caktuar paraburgimi. Në aktvendimet e atakuara vetëm është parafrazuar dispozita ligjore e nenit 187 lidhur me kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit pa i specifikuar ato më detajisht dhe më konkretisht, të cilat fakte do të arsyetonin dhe mbështesin rrezikun e ikjes sepse nuk është e mjaftueshme vetë të theksohet "... ekziston dyshimi për të besuar se ka rrezik të arratiset me qëllim që t'i shmanget rrjedhës së procedurës apo edhe përgjegjësisë penale" pa e konkretizuar se si dhe në ç'mënyrë mund të arratiset. Pastaj arsyetimi dhënë për ekzistimin e rrezikut "... se do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar dëshmitarët apo në ndonjë bashkëpjesëmarrës”, nuk përmban sqarim se a janë dëgjuar ata apo a ka dëshmitarë tjerë të mundshëm dhe cilët janë ata. E po ashtu edhe rreziku i përsëritjes së veprës penale nuk është specifikuar ku në aktvendimet e atakuar thuhet se "duke pasur parasysh peshën e veprës penale, karakteristikat personale të të pandehurit, sjelljen e tij të mëparshme...", duke mos cekur ndonjë rrethanë konkrete e cila arsyeton këtë bazë, ndërsa rreziku i përsëritjes së veprës penale duhet të dëshmohet me fakte konkrete si: personaliteti i të pandehurit, sjellja e tij në të kaluarën e në veçanti nëse ka ndonjë dënim të mëhershëm për vepër të ngjashme penale. Në arsyetim duhet të përmbajë arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet që e mbështesin rrezikun e ikjes, rrezikun e ndikimit në dëshmitarë si dhe rrezikun e përsëritjes së veprave penale. Nuk është i mjaftueshëm vetëm përshkrimi i dispozitës ligjore pa i elaboruar edhe provat dhe arsyet konkrete dhe specifike që e mbështesin rrezikun e tillë për të pandehurin konkret.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.294/2022 i datës 01.08.2021, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara dhe nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm dhe i plotë për caktimin e paraburgimit. E rëndësishme është të theksohet fakti se në aktvendim vetëm janë parafrazuar dispozitat ligjore pa konkretizuar se si dhe në çfarë mënyre i pandehuri mund të arratiset dhe po ashtu nuk është përmendur ndonjë bazë që justifikon përsëritjen e veprës penale e konkretisht nuk janë dëshmuar me fakte konkrete rreziku i përsëritjes duke u ndërlidhur me personalitetin e të pandehurit, sjelljen e tij dhe dënimet e mëparshme të tij.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 294/2022 i datës 01.08.2022**

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit L.J, anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, PPRKR.nr.291/22 të datës 17.06.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN.1.nr.824/2022 të datës 28.06.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

I pandehuri duhet të qëndroj në paraburgimi deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.291/22 të datës 17.06.2022, të pandehurit L.J, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj e cila do t'i zgjas deri më datë 19.08.2022. Masa e paraburgimit është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPK-së.
Kundër këtij aktvendimi ankesë kanë paraqitur mbrojtësit të pandehurit mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin, PN.1.nr.824/2022 të datës 28.06.2022, e ka refuzuar si të pabazuara ankesën dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit L.J, av. D.O, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i prishë aktvendimet e atakuara dhe i pandehuri të lejohet të mbrohet në liri ose të caktojë një masë më të lehtë për sigurimin e të pandehurit në procedurë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr. 104/2022 të datës 27.07.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se vazhdimi i masës së paraburgimit është një nga format më të ashpra të kufizimit të së drejtës së lirisë dhe sigurisë, të garantuara me nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, se arsyet e dhëna nga gjykatat për vazhdimin e paraburgimit janë të pambështetura në prova dhe argumente të cilat ndërtohen mbi hipoteza dhe formulime shabllonike, se dispozitivi i aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë është kontradiktor me vetë veten sepse është përpiluar në kundërshtim me formën e përcaktuar me nenin 370 lidhur me nenin 384 par.1 nënpar.12 të KPPK-së dhe se njëri prej elementeve themelore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është arsyetimi i vendimit gjyqësor.

Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 12.1 të KPRK, pasi që gjykatat të instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun e ikjes si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale konform nenit

187 par.1 nën par. 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPRK-së për të cilat baza i është vazhduar paraburgimi. Në aktvendimet e atakuara vetëm është parafrazuar dispozita ligjore e nenit 187 lidhur me kushtet e nevojshme për vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato më detajisht dhe më konkretisht, të cilat fakte do të arsyetonin dhe mbështesin rrezikun e ikjes sepse nuk është e mjaftueshme vetëm të theksohet "... ekziston dyshimi për të besuar se ka rrezik të arratiset me qëllim që t'i shmanget rrjedhës së procedurës apo edhe përgjegjësisë penale", pa e konkretizuar se si dhe në ç'mënyrë mund të arratiset. Pastaj edhe rreziku i përsëritjes së veprës penale nuk është specifikuar ku në aktvendimet e atakuar thuhet se "duke pasur parasysh mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, pasojën e saj..." duke mos cekur ndonjë rrethanë konkrete e cila arsyeton këtë bazë, ndërsa rreziku i përsëritjes së veprës penale duhet të dëshmohet me fakte konkrete si: personaliteti i të pandehurit, sjellja e tij në të kaluarën e në veçanti nëse ka ndonjë dënim të mëhershëm për vepër të ngjashme penale.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara më lartë dhe në arsyetim duhet të përmbajë arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që e mbështesin rrezikun e ikjes si dhe rrezikun e përsëritjes së veprave penale. Nuk është i mjaftueshëm vetëm përshkrimi i dispozitës ligjore pa i elaboruar edhe provat dhe arsyet konkrete dhe specifike që e mbështesin rrezikun e tillë për të pandehurin.

Në rastin Pml.nr.331/2019 i datës 11.11.2019, aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara dhe nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm dhe i plotë për caktimin e paraburgimit. Në këtë aktgjykim përkitazi me vazhdimin e masës së paraburgimit është paraqitur një informacion jo i plotë se një shtet tjetër është duke kërkuar të pandehurin. Mirëpo kjo pjesë nuk është arsyetuar për faktin se nuk është specifikuar se për cilën vepër kërkohet i pandehuri dhe cili shtet e kërkon atë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 331/2019 i datës 11.11.2019**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit K.S, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPR..nr.653/19, datë

07.10.2019 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1-DP.nr. 1116/2019 i datës 11.10.2019, lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II - I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin PPR.nr.653/2019 datë 07.10.2019, të pandehurit K.S, i ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për dy muaj nga data 08.10.2019 deri më 07.12.2019, bazuar në dispozitën e nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), për veprën penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 lidhur me nenin 28, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin PN1-DP.nr.1116/2019 datë 11.10.2019, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit K.S dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktvendimeve të atakuara, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit K.S av.E.K nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nën par 1.2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK), me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'a aprovoj kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar, të ndryshohen aktvendimet e atakuara, ashtu që masa e paraburgimit të hiqet dhe i pandehuri të lirohet ose masa e aktvendimit t'i zëvendësohet me masën e paraqitjes në stacionin policor, apo të anulohen dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Opinioni i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të akuzuarit është përgjigjur Prokurori i Shtetit Kosovës, me parashtresën KLMP.III.nr.95/2019 datë 08.11.2019, ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit së të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1. lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjetí se: Kërkesa është e bazuar.

Pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

Mbrojtësi i të pandehurit K.S, në kërkesë thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit sipas dispozitës së nenit 187 par.1 pika 1.2.2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK), gjykatat vetëm kanë konstatuar se me gjetjen e të pandehurit duke u mbrojtur në liri ekziston rreziku se i njëjti mund të ndikoj tek dëshmitarët H. D dhe Y.H në mënyrë që të njëjtit të japin deklaratat e tyre në favor të mbrojtësit të tij, se i pandehuri nuk i njeh dëshmitarët në fjalë, të cilët menjëherë e kanë lajmëruar policinë dhe i njëjti është zënë në flagrancë në banesën e të dëmtuarit.

Mbrojtja në kërkesë thekson po ashtu se ndikimi në dëshmitar duhet të verifikohet me prova konkrete, sepse ndikimi mund të kryhet vetëm nga një veprim aktiv nga ana e të pandehurit. Gjithashtu në kërkesë theksohet se në vendin e ngjarjes janë siguruar gjitha provat, prandaj gjykata gabimisht ka konstatuar se i njëjti mund të asgjësoj, ndryshoj apo fshehë provat e veprës penale. I pandehuri K.S ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe është penduar thellë. E po ashtu thekson se sa u përket arsyeve ligjore nga dispozita e nenit 187 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), konstatimet e gjykatave të instancës më të ultë janë në kundërshtim me shkresat e lëndës sepse në procesverbalin e prokurorit të çështjes të datës 23.10.2019, gjatë marrjes në pyetje të pandehurit rezulton se i njëjti është ndaluar nga autoritetet e Gjermanisë, ku ka qëndruar në paraburgim 4 muaj, në Republikën e Shqipërisë 45 ditë në paraburgim, pastaj pas hyrjes në Republikën e Kosovës është ndalur për disa orë, mirëpo i njëjti është liruar pasi që nga organet kompetente edhe të shteteve si më lartë nuk është gjetur ndonjë provë se i njëjti ka kryer veprën penale që ngarkohet.

Kjo Gjykatë vlerëson se aktvendimet e kundërshtuara janë përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar 1.12 të të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), çka me të drejtë pretendon edhe mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, nga se në arsyetimin e tyre nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare përkitazi me përshkrimin e provave që mbështesin bazat e artikulueshme të vazhdimit të paraburgimit dhe pretendimeve të mbrojtësit ndaj kërkesës për vazhdimin e paraburgimit.

Siç del nga shkresat e lëndës ndaj të pandehurit K.S., është nxjerr aktvendimi për fillimin e hetimeve me datë 09.09.2019 për veprën penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315 lidhur me nenin 28 të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), rrjedhimisht prokurori i çështjes fillimisht ka bërë kërkesë për caktimin e paraburgimit e më pastaj edhe vazhdimin e paraburgimit nga bazat ligjore që arsyetojnë rrezikun e ikjes ndikimit në hetime dhe përsëritjes së veprës penale. Pas mbajtjes së seancës dëgjimore Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur përkitazi me kërkesën e prokurorit të çështjes, e ka aprovuar atë dhe të pandehurit i ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj, por vetëm për bazat ligjore (të ndikimit në dëshmitar dhe rrezikut të përsëritjes së veprës penale. Kundër këtij aktvendimi ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit në Gjykatën e Apelit, e cila duke vendosur lidhur me këtë ankesë ka refuzuar të njëjtën dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, kjo Gjykatë vlerëson se nga aktvendimet e kundërshtuara nuk shihet qartë se ekziston rreziku i mundësisë së ndikimit në hetime apo prishje dhe falsifikim të provave si dhe rrezik të përsëritjes së veprës penale.

Prokurori i Shtetit në kërkesën e tij të datës 04.10.2019, vlerëson se duhet vazhduar masën e paraburgimit ndaj të pandehurit, ai i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin - vazhdimin e paraburgimit me provat relevante që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që ngarkohet, për të besuar se ka rrezik të ndikimit në dëshmitar apo rrezik të përsëritjes së veprës penale.

Kurse sipas dispozitës së nenit 187 par .1.1 është parashikuar që gjykata mund të caktoj - vazhdoj paraburgimin ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë gjen se ekziston dyshimi i bazuar se personi i cili ka kryer vepër penale dhe përmbushet njëri nga kushtet ligjore nga pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të nenit 187 respektivisht nenit 165 par.2.5 pika 1.5.1.2.5.2 dhe 2.5.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK).

Pastaj gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për caktimin - vazhdimin e paraburgimit është e obliguar të jap arsye jo vetëm për bazat ligjore të caktimit - vazhdimit të paraburgimit por edhe për gjitha pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit shprehura në kërkesë, kurse gjykata e shkallës së dytë për gjitha pretendimet e cekura në ankesë ndaj vendimit të marrë në shkallë të parë.

Në fakt konform dispozitave të lartë cekura për t'u përmbushur baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit sipas pikave të lartë përmendura kërkohet që të ekzistojnë rrethana konkrete dhe të vërtetuara që paraqesin rrezik objektiv e jo të supozuara dhe abstrakte siç janë dhënë në rastin konkret, pra kërkohet që të ekzistojnë rrethana konkrete që paraqesin rrezik objektiv për ndikim në hetime, për të cilat duhet të dëgjohen dëshmitarët apo rrezik të përsëritjes së veprës penale me ç'rast nuk mjafton të parafrazohen dispozitat ligjore si në rastin konkret ku thuhet duke marr parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet të jetë kryer vepra penale, rrezikshmërinë shoqërore, karakteristikat personale të pandehurit të kaluarën e tij kriminale se i njëjti rezulton që personi është shpallur person në kërkim nga një shtet tjetër, pa e specifikuar qartë se për çfarë vepre penale dyshohet se ka qenë i paraburgosur në shtetet e huaja, se në cilin shtet dyshohet të ketë kryer vepër penale, se në çfarë prove rezulton se i pandehuri është shpallur në kërkim nga një shtet tjetër, se i pandehuri a është recidivist në kryerjen e veprave penale etj.

Meqë nuk janë dhënë arsye të këtilla, kurse arsyet e dhëna janë të pa qarta, aktvendimet janë të mangëta dhe u desh që të anulohen, kurse çështja iu kthye gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
Në rivendosje gjykata duhet të mbaj seancë dëgjimore të vlerësoj edhe njëherë bazat ligjore të theksuara nga prokurori i çështjes dhe të gjitha rrethanat e rastit konkret e pastaj të merr vendim në këtë çështje duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete jo vetëm për bazat ligjore për të cilat ka

kërkuar prokurori i çështjes vazhdimin e paraburgimit, por edhe për të gjitha pretendimet e mbrojtësit.

3.3. Komente përmbledhëse të rasteve për bazat e paraburgimit

Në rastet e paraqitur më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit dhe kishte anuluar aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke kthyer çështjet penale në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Si karakteristikë e përbashkët e këtyre vendimeve paraqet fakti se arsyetimet nuk kanë paraqitur arsyetime bindëse se janë plotësuar kushtet për caktimin - vazhdimin e masave të paraburgimit duke urdhëruar shqyrtimin edhe një herë të bazave dhe rrethanave të cila ishin propozuar nga ana e prokurorit të shtetit. Në të gjitha këto vendime nuk janë theksuar në mënyrë konkrete bazat posaçme për caktimin - vazhdimin e paraburgimit, por vetëm se janë parafrazuar dispozitat ligjore, pa u konkretizuar rreziku konkret në ndonjërën nga pikat e kërkuara. Për më tepër, siç vërehet nga aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës me rastin e kthimit të çështjeve në rivendosje janë dhënë udhëzime të qarta për veprimet që duhet të i ndërmarrin gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore me rastin e rivendosjes së çështjeve.

Në fund është tejet shqetësuese çasja e gjykatave karshi vazhdimit të masës së paraburgimit, me ç'rast nuk vlerësohen në mënyrë të plotë faktet se me kalimin e kohës prej caktimit të paraburgimit do të duhej që të kishte një dinamikë më të lartë të hetimit dhe jo të kemi situata kur edhe vazhdimi i paraburgimit bëhet për bazat për të cilat në ndërkohë kanë pushuar shkaqet dhe arsyet që për atë bazë të vazhdohet paraburgimi.

4. Dispozitat ligjore

Neni 188 Vazhdimi i paraburgimit:

1. Paraburgimi mund të vazhdohet vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake, në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili tregon se ka bazë për paraburgim nga neni 184 i këtij Kodi, se ka filluar hetimi dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përshpejtuar zbatimin e hetimit. I dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të kërkojë vazhdimin e paraburgimit. Prokurori i shtetit ia dorëzon gjykatës kërkesën për vazhdimin e paraburgimit jo më vonë se pesë (5) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit.
2. Kërkesa për vazhdimin e paraburgimit duhet t'i dorëzohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij në afatin jo më vonë se tri (3) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit.
3. Ndaj çdo aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë. Neni 186, paragrafët 3 dhe 4, zbatohen përshtatshmërisht.

4.2. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Në vijim të këtij punimi do të trajtohen rastet kur janë gjetur shkelje me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit dhe në të cilat raste nuk janë paraqitur arsye të vazhdimit të masës dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri te anulimi i vendimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore. E rëndësishme është të theksohet fakti se kushtet për vazhdimin e paraburgimit janë të njëjta sikurse për caktimin e saj me disa përjashtime që duhet të bëhet i ditur fakti se prokurori ka ndërmarrë veprime për përshpejtimin e hetimeve gjatë kohës sa i pandehuri ishte në masën e paraburgimit fillestar, në këtë aspekt është e nevojshme që edhe gjykata në vendimet e tyre duhet posaçërisht të arsyetojnë këtë aspekt të rëndësishëm me rastin e vazhdimit të paraburgimit.

Siç është përcaktuar me dispozitën ligjore vazhdimi i paraburgimit mund të bëhet në tri fazat e procedurës penale dhe atë në fazën paraprake, pas ngritjes së aktakuzës dhe pas marrjes së aktgjykimit.

Duhet pasur parasysh se në momentin e ndryshimit të rrethanave qoftë të dyshimit të bazuar apo kushteve tjera, përkatësisht pushimin e tyre duhet menjëherë të hiqet paraburgimi, kjo e përligjur edhe përmes disa vendimeve të GJEDNJ – *Rasti Winterwerf kundër Holandës.* Një këndvështrim përfundimtar në këtë aspekt të mbikëqyrjes gjyqësore është rishikimi periodik ku gjyqtari vendos

që vazhdimi i ndalimit është i justifikuar. Kjo domosdoshmërisht që ndiqet nga çështja e diskutuar më sipër që rrethanat mund të ndryshojnë dhe, ndërsa motivet për ndalimi mund të ekzistojnë në fazat e hershme të një hetimi, mund të mos mbështetet më çështja në to në një fazë të mëvonshme. Kështu është përgjegjësia e autoriteteve zbatuese të ndalimit që të parashtrojnë çështjen për ndalim mbikëqyrjes gjyqësore në intervale të përhershëm dhe këto intervale nuk duhet të kalojnë një muaj apo dy. Pa këtë mbikëqyrje të vazhdueshme – e cila duhet të jetë rigoroze sa në fillim të shqyrtimit të çështjes – një person mund të mbahen në masën e ndalimit kur kjo nuk do të jetë në pajtim me Konventën, shih rastin *Jecius kundër Lituanisë* arsyet e vetme që u dhanë për ndalimin e kërkuesit në pritje të gjykimit ishin rëndesa e veprës penale dhe forca e provave kundër tij në arkivin e çështjes. Gjykata u shpreh se dyshimi kundër kërkuesit se kishte kryer vrasje mund të kishte justifikuar ndalimin e tij fillimisht, por jo ndalimin e tij për gati pesëmbëdhjetë muaj, veçanërisht kur dyshimi u verifikua u provua jo i bindshëm nga gjykata që e nxori kërkuesin të pafajshëm dhe si rrjedhojë konstatoi ndalimin e tij si të tepruar.

Me qëllim të sqarimit të këtyre dispozitave ligjore janë marrë disa shembuj nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast rrjedh se me rastin e vazhdimit të paraburgimit gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë zbatuar në përpikëri dispozitat e përcaktuara ligjore. Në rastin e evidentuar Pml.nr.111/2019 të datës 26.03.2019, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se në aktvendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa e ligjshmërisë del se nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme, por se janë parafrazuar dispozitat ligjore. Për më tepër, nuk është dhënë arsyetim për dëshmitarët e mundshëm, nuk është konkretizuar se si do të ndikoj i pandehuri në personat e tjerë dhe gjithashtu nuk është arsyetuar rreziku i përsëritjes së veprës penale.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 111/2019 i datës 26.03.2019**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurit Sh.Xh, anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.31/2019 të datës 04.03.2019 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës-

Departamenti për Krime të Rënda, PN. I.nr.277/2019 të datës 13.03.2019, lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II - I pandehuri Sh.Xh, mbetet në paraburgim deri në marrjen e vendimit të ri.

A r s y e t i m i

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.31/2019 të datës 04.03.2019, të pandehurit Sh.Xh për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale keqpërdorimi seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin apo profesionin nga neni 239 par. 1 nën par. 1.3 të KPRK dhe veprën penale nxitja e akteve seksuale me premtimin e rrejshëm për martesë nga neni 240 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj e cila masë do t'i zgjasë nga data 07.03.2019 deri me datën 07.05.2019. Masa e paraburgimit i është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar. 1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK).

Vendimi i Gjykatës së Apelit sipas ankesës

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN. 1.nr.277/2019 të datës 13.03.2019, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve V.V dhe Sh.Xh dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Pretendimet e mbrojtësve në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë
Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësit e të pandehurit Sh.Xh., av. D.O dhe av. F.A, nga Prishtina për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurë penale, me propozim që të aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës të prishet dhe çështja të kthehet në rivendosje ose ndaj të pandehurit të caktohet një masë më e butë.

Opinioni i prokurorit të shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.23/2019 të datës 25.03.2019, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe, pas. vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë pranohet si e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësit e të pandehurit pretendojnë se aktvendimet e atakuara janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale ngase i pandehuri Sh., as mbrojtësit e tij nuk janë njoftuar me kohë me propozimin e prokurorit të çështjes për vazhdimin e paraburgimit ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 191 par.2 të KPPK-së. Po ashtu pretendohet se prokurori i çështjes me propozim, e as gjykatat e instancës më të ultë me aktvendimet e tyre nuk i kanë arsyetuar faktet vendimtare me prova relevante për vazhdimin e paraburgimit. Pastaj në kërkesë theksohet se në bazë të provave që ka në dispozicion mbrojtja, masa e paraburgimit për të pandehurin Sh., nuk është masë e përshtatshme dhe proporcionale që siguron prezencën e të pandehurit në procedurë dhe mundësisë së vazhdimit të papenguar të hetimeve.

Arsyet që i kanë dhënë gjykata e instancës më të ultë

Në këtë çështje penale, sikur se prokurori i çështjes në propozimin e tij e po ashtu edhe gjykatat e instancës më të ultë në vendimet e tyre kanë dhënë arsye po thuaj se të njëjta sa i përket vazhdimit të paraburgimit për të pandehurin Sh.Xh, nga baza ligjore e nenit 187 par.1 nënpar. 1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK) dhe atë: Nga pika 1.2.1 të nenit 187 te KPPK-së, sa i përket frikës për rrezik të ikjes - arratisjes për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, është konstatuar se i pandehuri për shkak të veprave penale për të cilat dyshohet t'i ketë kryer mund shqiptohet dënim mjaft i lartë po që se shpallet fajtor. Vazhdimi i paraburgimit nga pika 1.2.2 të KPPK - justifikohet me frikën se i pandehuri me gjetjen e tij duke u mbrojtur në liri

lehtë mund të ndikoj tek e dëmtuara A.G., në ndryshimin e deklaratës e saj si dhe te dëshmitarët të cilët pritet të dëgjohen nga prokurori i çështjes, e po ashtu bazuar në pikën 1.2.3 të KPPK - së me përshkrimin e gjendjes faktike të rastit, duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale që i vihen në barrë të pandehurit të cilat në mes tyre kanë një distancë kohore, pra i njëjti nga një vepër, dyshohet të ketë kryer vepër tjetër penale, është konstatuar se me gjetjen e të pandehurit duke u mbrojtur në liri i njëjti mund t'a përsërisë veprën penale.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësve të të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë, vlerësoi se aktvendimet e atakuara duhet anuluar me arsyetim si në vijim:

Aktvendimet e atakuara me kërkesë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave te procedurës penale, në çka me të drejtë tërheqin vërejtje mbrojtësit e të pandehurit në kërkesë, ngase për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me bazat ligjore të vazhdimit të paraburgimit nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme mbështetur në prova konkrete si nga propozimi i prokurorit të çështjes e po ashtu as nga gjykatat e nivelit më të ultë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në masë të pamjaftueshme janë dhënë arsye nga gjykatat e instancave më të ulta dhe edhe ato pak arsye që janë dhënë, janë më tepër parafrazime të dispozitave ligjore pa dhënë arsye ligjore, dhe vendimet e tyre i bëjnë të mangëta në drejtim bazës ligjore për vazhdimin e mëtutjeshme të paraburgimit. Në rastin konkret nuk dihet se cilët janë dëshmitarët e mundshëm që pritet të dëgjohen nga prokuroria, ashtu siç thuhet ndër të tjera në propozimin e prokurorit të çështjes "se janë disa persona (emrat e të cilëve me qëllim nuk po i përmendim, por dihen me emër dhe mbiemër)", apo në vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake, ku thuhet se i pandehuri mund të ndikoj te dëshmitarët tjerë të cilët ende nuk janë dëgjuar nga prokuroria.

Për ekzistimin e frikës se i pandehuri do të pengoj hetimet duke ndikuar në dëshmitar apo bashkë kryes duhet të jetë e konkretizuar qartë me faktet të cilat tregojnë se i pandehuri personalisht ka tentuar të ndikoj në dëshmitar, bashkë kryes apo palën e dëmtuar, përkatësisht se ndikimin e tillë e ka tentuar nëpërmes personave tjerë. Prandaj vazhdimi i paraburgimit në bazë të kësaj dispozite

është i arsyeshëm vetëm po qe se me fakte është verifikuar tentimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i të pandehurit për të ndikuar në ndonjë dëshmitar pandehur apo bashkëkryerës, e jo vetëm të supozohet se ndërmarrja e veprimit të tillë është i mundshëm dhe në këtë drejtim të jepen arsye ligjore.

Vazhdimi i paraburgimit sipas nenit 187 par.1 nënëpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, ka të bëjë me situata të ekzistimit të rrezikut të serishëm kriminal nga ana e të pandehurit, duke marrë parasysh rrethanat e kryerjes së veprës penale: recidivist, mënyra e kryerjes, intervali i shkurtër kohor në të cilën i pandehuri ka kryer shumë vepra penale, karakteri i raporteve në mes të pandehurit dhe viktimës, vetitë personale të pandehurit (patologjia e personalitetit, gjendja shëndetësore e tij), pastaj faktorët social etj. Arsyet e tilla nuk janë dhënë as në aktvendimin e shkallës së parë e as në atë të shkallës së dytë.

Për këto arsye kjo gjykatë anuloj vendimet e atakuara me kërkesë ndërsa i pandehuri Sh.Xh., duhet të qëndroj në paraburgim deri në marrjen e një vendimi tjetër nga gjykata e shkallës së parë.

Në rastin tjetër Pml.nr.124/2019 i datës 15.04.2019 aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se në aktvendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa e ligjshmërisë del se nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme, por se janë parafrazuar dispozitat ligjore. Për më tepër, nuk është dhënë arsyetim për rrezikun e ikjes, rrezikun e ndikimit në dëshmitar dhe përsëritjes së veprave penale, pra nuk plotësohet standardi i një aktvendimi të arsyetuar vetëm përmes përshkrimit të dispozitave ligjore, pa arsyetuar në mënyrë specifike rrethanat e lartë cekura.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 124/2019 i datës 15.04.2019**

A K T G J Y K I M

Pjesërisht aprovohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit B.B, anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan - Departamenti i përgjithshëm. P.nr.79/2019 i datës 27.03.2019 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

PN1DP.nr.302/2019 i datës 29.03.2019 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II - I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri nga gjykata e shkallës së parë.

A r s y e t i m i

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan - Departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin P.nr.79/2019 e datës 27.03.2019, të pandehurit B.B, i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë, neni 327 par.1 nënpar.1 të KPRK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do ti zgjasë deri më datë 29.04.2019. Të pandehurit paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 193 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPRK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNIDP.nr.302/2019 e datës 29.03.2019, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit B.B, dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit B.B, av. V.S, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nenin 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën dhe të ndryshojë aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan P.nr.79/2019 18 datës 26.03.2019, ashtu që të pandehurit t'ia ndërpresë paraburgimin dhe ti mundësojë mbrojtjen në liri ose t'ia caktojë ndonjë masë më të butë, apo aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështjen ta kthejë në riprocedurë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.26/2019 e datës 12.04.2019, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit B.B, av.V.S, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit është pjesërisht e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit B.B, av. V.S, konsideron se marrja e vendimit për vazhdimin e masës së paraburgimit edhe për një muaj, me arsyetim se ekzistojnë bazat ligjore të parapara me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK-së, është në kundërshtim me dispozitën e nenit 193 të KPPK-së, paraburgimi mund të vazhdohet nga gjykata e shkallës së parë pa kërkesë të prokurorit vetëm pasi të kenë kaluar dy muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim. Gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë asnjë arsye të vetme se në cilat prova dhe fakte e ka bazuar aktvendimin e kundërshtuar, se cilat prova kanë qenë bazë me rastin e marrjes së aktvendimit, pos citimit të dispozitave ligjore mbi vazhdimin e paraburgimit, sepse në rastin konkret i mbrojturi i tij ka qenë në arrest shtëpiak dhe nuk ka ikur dhe as që ka bërë përpjekje, se i pandehuri nuk ka se si të ndikojë te dëshmitarët e prokurorisë, dëshmitarët kanë dhënë deklaratat e tyre tek organet e hetuesisë, se gjykatat e instancave më të ulëta e kanë paragjykuar epilogun e këtij rasti, andaj nga të lartcekurat mbrojtja propozon si më lartë.

Gjykata Supreme, gjeti pjesërisht të bazuar pretendimin e mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat pretendohen pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun e ikjes, ndikimit në dëshmitarë si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK-së. Në aktvendimet vetëm është cituar dispozita ligjore e nenit 187 lidhur me kushtet e nevojshme për caktimin respektivisht vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato me detajisht dhe me konkretisht, e të cilat fakte të

specifikuara e të konkretizuara, do të arsyetonin dhe mbështesin rrezikun e ikjes, rrezikun e ndikimit në dëshmitarë si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale, e që siç rezulton nga shkresat e lëndës. Këto të meta nuk i ka mënjanuar as gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara më lartë dhe në arsyetim duhet të japë arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike qe e mbështesin rrezikun e ikjes, rrezikun e ndikimit në dëshmitarë si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Nuk është i mjaftueshëm vetëm përshkrimi i dispozitës ligjore pa i elaboruar edhe faktet dhe arsyet konkrete dhe specifike që e mbështesin rrezikun e tillë për të pandehurin konkret.

Për arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar andaj konform nenit 438 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.227/2021 i datës 29.06.2021, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara dhe nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm dhe i plotë për caktimin e paraburgimit. E rëndësishme në këtë rast është fakti se ndaj të pandehurve është ngritur aktakuza dhe përkundër faktit se ligjvënësi nuk ka ndarë periudhën e paraburgimit në mënyrë strikte nga faza paraprake në fazën e aktakuzës, megjithatë u mbetet organeve që zhvillojnë procedurën që të bëjnë një kontroll të masës së paraburgimit kur kalohet prej një faze në fazën tjetër, meqë disa kushte të paraburgimit mund të bien automatikisht pas ngritjes së aktakuzës, kushti i ndikimit në dëshmitar dhe në bashkë të pandehur, meqë del se të njëjtit tani më janë dëgjuar gjatë procedurës paraprake. Në aktvendimet e kundërshtuara shihet se nuk janë arsyetuar mjaftueshëm as dy kushtet tjera të paraburgimit, por vetëm janë cituar dispozita ligjore që e bëjnë vendimin juridikisht të paqëndrueshëm.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 227/2021 i datës 29.06.2021**

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit Q.A, anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1505/21 të datës 04.06.2021 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.DP.nr.614/2021 të datës 14.06.2021 në pjesën që ka të bëjë me të dhe me të pandehurat M.N dhe L.L dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. Të pandehurit Q.A, M.N dhe L.L duhet të qëndrojnë në paraburgimi deri në marrjen e një vendimi të ri.

III. Ndaj të pandehurës A.F vendimi mbetet i paprekur.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin P.nr.1505/21 të datës 04.06.2021, të pandehurve Q.A dhe M.N, për shkak të veprave penale ofrim i lokaleve për prostitucion në bashkëkryerje nga neni 235 par.1 lidhur me nenin 31 e 77 te KPRK dhe mundësim ose detyrim në prostitucion në bashkëkryerje nga neni 234 par.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK, si dhe të pandehurës L.L për shkak të veprës penale mundësim ose detyrim në prostitucion në bashkëkryerje nga neni 234 par.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK, iu ka vazhduar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e cila do t'iu zgjas deri më 05.07.2021. Masa e paraburgimit është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin, PN1.DP.nr.614/2021 të datës 14.06.2021, e ka refuzuar si të pabazuara ankesën dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit Q.A, av.B.E, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitës nga neni 193 lidhur me nenin 187 të KPPK për vazhdimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i

anulojë aktvendimet e atakuara ose t'i ndryshojë dhe masën e paraburgimit dhe ta zëvendësoj me një masën më të butë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.68/2021 të datës 24.06.2021, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se në dispozitat themelore të Kodit të Procedurës Penale hasim në kërkesa ligjore të cilat obligojnë që paraburgimi të jetë në afat sa më të shkurtë kohor, se tashmë është ngrit aktakuza dhe kanë pushuar së ekzistuari kushtet për vazhdim të paraburgimit, se të pandehurit i dihet identiteti dhe vendbanimi, ka treguar adresën e saktë dhe është lajmëruar në polici vullnetarisht pasi që është kthyer në Kosovë, ndërsa nuk qëndrojë pretendimet se i pandehuri mund t'i përsërit veprat penale sepse i njëjti është i martuar, babai dy fëmijëve të vegjël dhe asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin.

Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 12.1 të KPRK, pasi që gjykatat të instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun e ikjes si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale konform nenit nenit 187 par.1 nën par.1 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPRK-së për të cilat baza i ka vazhduar paraburgimi. Në aktvendimet e atakuara vetëm është parafrazuar dispozita ligjore e nenit 187 lidhur me kushtet e nevojshme për vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato më detajisht dhe më konkretisht, të cilat fakte do të arsyetonin dhe mbështesin rrezikun e ikjes sepse nuk është e mjaftueshme vetëm të theksohet "... ekziston rreziku se po të gjendet në liri mund të fshihet, të arratiset me qëllim që t'i shmanget rrjedhës së procedurës apo edhe përgjegjësisë penale", pa e konkretizuar se si dhe në ç'mënyrë mund të arratiset. E po ashtu edhe rreziku i përsëritjes së veprës

penale nuk është specifikuar ku në aktvendimet e atakuar thuhet se "duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra penale, karakteristikat personale të të pandehurit...", duke mos cekur ndonjë rrethanë konkrete e cila arsyeton këtë bazë, ndërsa rreziku i përsëritjes së veprës penale duhet të dëshmohet me fakte konkrete si: personaliteti i të pandehurit, sjellja e tij në të kaluarën e në veçanti nëse ka ndonjë dënim të mëhershëm për vepër të ngjashme penale.

Edhe pse kundër aktvendimeve të kundërshtuara të pandehurat M.N dhe L.L, nuk kanë ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi edhe përkitazi me ta në kuptim të nenit 436 par.2 të KPPRK-së sipas parimit "beneficium cohesionis".

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara më lartë dhe në arsyetim duhet të përmbajë arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që e mbështesin rrezikun e ikjes si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Nuk është mjaftueshëm vetëm përshkrimi i dispozitës ligjore pa i elaboruar edhe provat dhe arsyet konkrete dhe specifike që e mbështesin rrezikun e tillë për të pandehurin konkret.

Sa i përket të pandehurës A.F., të cilës iu është ndërprerë masa vendimi mbetet i paprekur.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.357/2021 i datës 10.12.2019, me ç'rast aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara dhe nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm dhe i plotë për caktimin e paraburgimit. E rëndësishme është të theksohet fakti se aktvendimet e kundërshtuara, por as kërkesa e prokurorit të shtetit për vazhdimin e masës së paraburgimit nuk kanë paraqitur asnjë rrethanë konkrete dhe të vërtetuar që paraqitet rreziku i ikjes - arratisje, ndikimit në hetime në dëshmitar, të dëmtuar apo bashkëpandehur. Për më tepër ky rast paraqet një mos reflektim të pashpjegueshëm të gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore ku nuk merret parasysh faktori i kohës së kaluar nga caktimi i paraburgimit, por masa e paraburgimit vazhdohet edhe pas 13 muajve të hetimeve dhe nuk kërkohet që prokuroria e shtetit të përshpejtoj veprimet hetimore, siç kërkohet me dispozitën e nenit 188 par.1 të KPP-së.

Në këtë aktgjykim Gjykata Supreme e Kosovës ka aplikuar institutin e mirënjohur juridik *Beneficium Cohaesionis*, meqë dy nga të pandehurit nuk kishin paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe rrethanat nuk ishin të natyrës personale.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 357/2021 i datës 10.12.2019**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit F.C, e sipas detyrës zyrtare edhe për të pandehurit F.G dhe I.A, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPR KR.nr.329/2018 datë 15.11.2019 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1- DKR.nr. 1374/2019 të datës 21.11.2019, lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. Të pandehurit si në pikën I të dispozitivit mbeten në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPR KR.nr.329/2018 datë 15.11.2019, të pandehurve: F.C, F.G dhe I.A iu ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për dy muaj dhe atë nga data 15.11.2019 deri më 15.01.2020, për veprat penale në bashkëkryerje grabitje nga neni 329 par,3 lidhur me par. I lidhur me nenin 31, grabitje në tentativë nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 dhe 28, veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par,1 pika 1.9 lidhur me nenin 31 dhe 28 dhe veprën penale mbajtja në pronësi kontroll, posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të nenit 31 dhe 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Paraburgimin gjykata iu ka vazhduar të pandehurve bazuar në dispozitën e nenit 187 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK).

Vendimi i Gjykatës së Apelit sipas ankesës.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda me aktvendimin PN1DKRP.nr.1374/2019 dt. 21.11.2019, i ka refuzuar si të pabazuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve: F.C, F.G dhe I.A, ushtruar kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kush ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë?

Kundër aktvendimeve të atakuara, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit F.C, av. F.K nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 190 par.3 lidhur me nenin 187 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK), me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'a aprovoj kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar, të ndryshoj aktvendimet e atakuara, ashtu që masa e paraburgimit të hiqet dhe të pandehurit ti mundësohet mbrojtja në liri ose aktvendimet e atakuara të anulohen dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të akuzuarit është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KLMP.III.nr. 101/2019 datë 06.12.2019, ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit së të pandehurit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë gjeti se: Kërkesa është e bazuar.
Pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

Mbrojtësi i të pandehurit F.C, në kërkesë thekson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës se dytë me aktvendimet e atakuara kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 187 dhe 189 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), sepse nuk përbëjnë asnjë arsye relevante të pakontestueshme për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit F.C, pas 13 muajsh ende pa ngritur aktakuzë. Gjykatat e instancës më të ultë me rastin

e vazhdimit të paraburgimit kanë dështuar të japin arsyetimin e duhur përkitazi me kushtin parësor ekzistimin e dyshimit të bazuar nga par.1 nën par 1.1 të nenit 187 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), se i pandehuri F., në bashkëkryerje ka kryer veprat penale që i vihen në barrë si dhe kushteve të veçanta nga par.1 nënpar. 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të nenit 187 KPPRK-së. Mbrojtësi i të pandehurit gjithashtu thekson në kërkesë se në mënyrë kronologjike si prokurori i çështjes në kërkesën - propozimin e caktimit të masës së paraburgimit e po ashtu edhe gjykatat e instancës më të ulta në vendimet e tyre që nga caktimi i paraburgimit të pandehurit i kanë vazhduar masën paraburgimit me po të njëjtat arsyetime vetëm me data të ndryshuara. Nga propozimet e prokurorit të çështjes nuk rezulton të ketë dhënë ndonjë arsye të vetme edhe pas 13 muajve qëndrimi në paraburgim të të pandehurit F., apo të jetë ndërmarr ndonjë veprim hetimor për përshpejtimin e procedurës edhe përkundër faktit se kemi të bëjmë me një lëndë mjaft voluminoze.

Kjo Gjykatë vlerëson se aktvendimet kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar 1.12 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), çka me të drejtë pretendon edhe mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, nga se në arsyetimin e tyre nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare përkitazi me përshkrimin e provave që mbështesin bazën e artikulueshme të vazhdimit të paraburgimit dhe pretendimeve të mbrojtësit ndaj kërkesës për vazhdimin e paraburgimit.

Prokurori i Shtetit në kërkesën e tij të datës 10.09.2019, propozon se duhet vazhduar masën e paraburgimit ndaj të pandehurit F.C, F.G dhe I.A, ai i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin - vazhdimin e paraburgimit me dyshimin e bazuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale që u ngarkohen, për të besuar se ka rrezik të ikjes, ndikimi në dëshmitar, të dëmtuar në bashkë të pandehur apo rrezik të përsëritjes së veprave penale, me arsyetim se akoma nuk janë dëgjuar dëshmitarët, të dëmtuarit dhe bashkëpandehurit, sepse sjellja e tyre e mëparshme tregon se janë recidivist veprave penale edhe për faktin se kallëzimi penal përbëhet prej një numri jashtëzakonisht të madh të rasteve për të cilat të pandehurit dyshohet t'i kenë kryer në bashkëkryerje.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata duke ju referuar dispozitës së nenit 187 par.1.1, mund të caktoj - vazhdoj paraburgimin ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë gjen se ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe përmbushet njëri nga kushtet ligjore nga pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të nenit 187, respektivisht nenit 165 par.2.5 pika 1.5.1.2.5.2 dhe 2.5.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK).

Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për caktimin - vazhdimin e paraburgimit është e obliguar të jap arsye jo vetëm për bazat ligjore të caktimit - vazhdimit të paraburgimit por edhe për gjitha pretendimet e mbrojtësit të pandehurit të shprehura në kërkesë, kurse gjykata e shkallës së dytë për gjitha pretendimet e cekura në ankesë ndaj vendimit të marrë në shkallë të parë.

Konform dispozitave të lartë cekura për t'u përmbushur baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit sipas pikave të lartë përmendura kërkohet që të ekzistojnë rrethana konkrete dhe të vërtetuara që paraqesin rrezik objektiv e jo të supozuar dhe abstrakt siç janë dhënë në rastin konkret, pra kërkohet që të ekzistojnë rrethana konkrete që paraqesin rrezik objektiv për ikje - arratisje, ndikim në hetime, si në rastin konkret jo vetëm të theksohet ekziston rreziku i ndikimit në dëshmitar, të dëmtuar apo bashkëpandehur pa i theksuar cilët nga dëshmitarët, të dëmtuarit apo bashkëpandehurit që pritet të dëgjohen apo rrezik të përsëritjes së veprës penale me ç'rast nuk mjafton vetëm të parafrazohen dispozitat ligjore apo një rrjedhë e përshkrimit të veprave penale në kontinuitet ashtu siç rezulton nga shkresat e çështjes.

Meqë nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe relevante as në kërkesën e prokurorit të çështjes e as nga gjykatat vendimet e të cilave janë atakuar, kurse edhe arsyet e dhëna janë të pa qarta dhe të mangëta, aktvendimet e dy instancave më të ultëta gjyqësore u dashtë që të anulohen, kurse çështja iu kthye gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në rivendosje gjykata duhet t'a vlerësoj edhe njëherë kërkesën e prokurorit të çështjes dhe të gjitha rrethanat e rastit konkret e pastaj të merr vendim në këtë çështje duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete jo vetëm për bazat ligjore për të cilat ka kërkuar prokurori i çështjes për vazhdimin e paraburgimit, por edhe për të gjitha pretendimet e mbrojtësit.

Edhe pse kundër aktvendimeve të kundërshtuara të pandehurit F.G dhe I.A nuk kanë ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi edhe përkitazi me ta, në kuptim të nenit 436 par.2 të KPPK-së sipas parimit "beneficium cohesionis".

I pandehuri F.C dhe të pandehurit tjerë, F.G dhe I.A., mbeten në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri nga gjykata e shkallës së parë ashtu siç u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin Pml.nr.42/2022 i datës 02.02.2022, aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara. E rëndësishme është të theksohet fakti se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore kanë bërë arsyetim tërësisht të paqëndrueshëm duke e ndërlidhur rrezikun e ikjes së të pandehurit me faktin se djali i të pandehuri është arratisur dhe i cili arsyetim është vlerësuar i paqëndrueshëm, meqë ikja e djalit të të pandehurit nuk nënkupton a priori ikjen edhe të të pandehurit ngase secili person ka veçorit dhe karakteristikat e tij, andaj kjo mënyrë e arsyetimit në asnjë rrethanë nuk duhet të ndjekur në rastet tjera.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 42/2022 i datës 02.02.2022**

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të akuzuarit Sh.S, anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr. 610/16 datë 10.12.2021 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN. 1S.nr.207/2021 të datës 30.12.2021, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të rënda, me aktvendimin PKR.nr.610/2016 e datës 10.12.2021, të akuzuarit Sh.S, i ka vazhduar masën paraburgimit në

kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale krim i organizuar nga neni 274 par.1, 2 e 3 të KPK-së, mashtrimit nga neni 261 par.2 lidhur me nenin 31 e 71 të KPK-së, nxitja për të kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare nga neni 339 të KPK-së, nxërja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 346 të KPK-së, mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me nenin 23, 24 e 71 te KPK-së, veprës penale legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par. 2 lidhur me nenin 71 të KPK-së, shpërlarja e parave në kundërshtim me rregulloren e UNMIK-ut nr.2004/2, mbi parandalimin e shpërlarjes së parave dhe veprave të ngjashme penale nga neni 32 i Ligjit nr.03/L-96 për parandalimin e shpërlarjeve të parave dhe financimin e terrorizmit nga neni 308 të KPK-së, si dhe veprës penale shmangie nga tatimi nga neni 249 par.1 e 2 të KPK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi të pandehurit do t'i zgjasë deri më datë 13.02.2022. Të pandehurit masa paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 193 par.2 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 e 1.2.3 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin IS.nr.207/2021 e datës 30.12.2021, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Sh.S, ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit Sh.S, av. A.H nga P., për shkak të shkeljeve të dispozitave të nenit 384 par.2.1 lidhur me nenin 5 par.3 e 4 të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ti anulojë aktvendimet e atakuara dhe të urdhëroj zëvendësimin e masës së paraburgimit me dorëzani.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.III.nr. 10/2022 e datës 27.012022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPRK), vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësja e të pandehurit në kërkesën e saj pretendon se aktvendimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë marrë me shkelje esenciale të dispozitës së nenit 384 par.2.1 lidhur me nenin 5 par. 3 dhe 4 të KPPK-së, sepse arsyetimi nuk është bërë në përputhje me dëshmitë - provat, ngase vetëm dyshimi i bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale nuk mund të jetë kusht për vazhdimin e paraburgimit tash e pesë vite. Ndërsa kushtet ligjore konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1 e 1.2.3 të KPPK-së, nuk i përkasin natyrës së kësaj çështje ngase sipas mbrojtëses, të mbrojturit të saj i dihet identiteti nuk do të ikë, sepse tash më ai ka mbajtur pesë vite burgim, dhe se nuk do ta përsërisë veprën penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, gjeti si të bazuara pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarit se aktvendimet e e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale (nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPP), pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht nuk kanë dhënë arsye të mjaftuara dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun e ikjes, si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale konform nenit 187 par.1 nën par.1.2 pika 1.2.1, dhe 1.2.3 të KPP. Në aktvendimet e atakuara vetëm është përsëritur dispozita ligjore e nenit 187 lidhur me kushtet e nevojshme për vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato më detajisht dhe më konkretisht, e të cilat fakte të specifikuara e të konkretizuara, do të arsyetonin dhe mbështesin rrezikun e ikjes si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale, e që siç rezulton nga shkresat e lëndës nuk është arsyetuar dhe argumentuar konkretisht nga gjykata e shkallës së parë e as nga gjykata e shkallës së dytë. Ndërsa, arsyetimi se djali i të akuzuarit është arratisur nuk është arsyetim i pranueshëm dhe i duhur është vetëm supozim, ngase nuk do të thotë se edhe babai i tij, këtu u akuzuari Sh.S., do të arratiset, nga se secili njeri ka karakteristika të personalitet të veçantë dhe individual.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e lartë cekura dhe në arsyetim duhet të përmbajë arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që e mbështesin rrezikun e ikjes, si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Nuk është i mjaftueshëm vetëm përshkrimi i dispozitës ligjore pa i elaboruar edhe provat dhe arsyet konkrete dhe specifike që e mbështesin rrezikun e tillë për të akuzuarin konkret.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.437/2021 i datës 30.11.2021, me ç'rast është anuluar vetëm aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe atë pikërisht për shkak të mos përgjigjes së mjaftueshme në pretendimet ankimore të theksuara nga ana e mbrojtësit të të pandehurit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në fakt gjykata e shkallës së dytë ka përshkruar pretendimet ankimore por nuk është paraqitur arsyetim përkitazi me këto pretendime dhe veçanërisht kohëzgjatjes së masës së paraburgimit para ngritjes së paraburgimit dhe faktit se kemi në bëjmë me çështje të ndërlikuar.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 437/2021 i datës 30.11.2021**

Me miratimin e kërkesës së mbrojtësit të pandehurit B.S dhe sipas detyrës zyrtare dhe për të pandehurit B.B, anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN. 1S.nr. 166/2021 i datës 02.11.2021 dhe çështja i kthehet të njëjtës në rivendosje.

II. Të pandehurit mbeten në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin PPPS.nr.13/2020 e datës 21.10.2021, të pandehurve B.S dhe B.B, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 277 par.1 të KPRK-së, falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 391 par.1 dhe veprës penale kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.1 e 2 të KPRK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi të pandehurve do t'iu zgjasë deri më datë 24.08.2021. Të pandehurve masa e paraburgimit u është vazhduar konform dispozitës së nenit 191 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 c 1.2.3 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1S.nr.166/2021 e datës 02.11.2021, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit B.S, ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit B.S, av. A.Q nga Prishtina për shkak të shkeljeve të dispozitave të nenit 384 par.2.1 lidhur me nenin 190 par.2 e 3 dhe nenit 370 par.7 të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, masën e paraburgimit t'ia zëvendësojë me masën e arrestit shtëpiak apo ndonjë masë më të butë, e nëse e sheh të arsyeshëm këtë masë ta përcjellë edhe me garanci të tjera të parashikuara me KPPK-së.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.III.nr.156/2021 e datës 25.11.2021, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit B.S, av. A.Q nga Prishtina, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën e tij pretendon se aktvendimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 dhe par.2 pika 2.1 të KPPK, sepse ajo nuk i ka vlerësuar fare pretendimet e theksuara në ankesë. Kështu, sipas mbrojtësit në ankesën e parashtruar mbrojtja ka pretenduar se bazuar në kërkesën për vazhdim të paraburgimit prokuroria nuk ka dëshmuar të ketë marrë asnjë veprim të vetëm hetimor brenda periudhës dy mujore të vazhdimit të paraburgimit, dhe se zvarritja e procedurës duhet ti atribuohet prokurorit të shtetit, dhe se në rastin konkret në mungesë të kushteve ligjore për vazhdim të paraburgimit më shumë se 8 muaj, i njëjti duhet të ndërpritet, por gjykata e shkallës së dytë nuk e ka marrë parasysh këtë pretendim të mbrojtësit dhe as që e ka vlerësuar. Pastaj, sipas mbrojtësit gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye se prokuroria ka qenë azhure në ndërmarrjen e veprimeve hetimore për ta arsyetuar vazhdimin e paraburgimit; nuk ka dhënë arsye se si ka mundësi që i pandehuri B.S., të ndikojë në dëshmitar apo si ka mundësi të ndikojë në provat që gjenden në posedim të Agjencisë..., si ka mundësi të ketë qasje në çfarëdo pasaporte, pse

ekziston rreziku i ikjes dhe pse masat tjera më të buta se paraburgimi nuk mund të zbatohen në rastin konkret duke pasur parasysh rrethanat personale të të pandehurit i cili ka ofruar dorëzani, garanci bankare apo çfarëdo mjeti garantues se i njëjti nuk do të arratiset.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit në kërkesë se Gjykata e Apelit nuk i ka vlerësuar pretendimet në ankesën e parashtruar ndaj aktvendimit të shkallës së parë. Në fakt në aktvendimin e Gjykatës së Apelit theksohen pretendimet në ankesa por nuk jepen vlerësimet përkitazi me to veçanërisht sa i përket kohëzgjatjes së paraburgimit para ngritjes së akuzës dhe faktit se kemi të bëjmë me një çështje të ndërlikuar. Përveç kësaj edhe sa i përket bazave ligjore të vazhdimit të paraburgimit jepen arsye të përgjithshme abstrakte por jo konkrete, kurse nuk vlerësohen dhe arsyetohen fare pretendimet ankimore në ketë drejtim. Prandaj, meqenëse nuk janë dhënë arsye të këtilla, aktvendimi është i mangët, prandaj u desh që të anulohet dhe çështja i kthehet Gjykatës së Apelit në rivendosje.

Në rivendosje gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë edhe njëherë të gjitha pretendimet ankimore dhe rrethanat e rastit konkret dhe pastaj me rastin e marrjes së vendimit përkitazi me ketë çështje duhet të jep arsye të qarta për të gjitha pretendimet e parashtruara ankimore.

Me qenë se arsyet për të cilat u anulua aktvendimi i kundërshtuar kanë të pandehurin B.B., konform nenit 436 par.2 lidhur me nenin 397 të KPPK-së parimit "beneficium cohaesionis" aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë u anuluan edhe për të pandehurin B.B., edhe pse ai nuk ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.455/2022 i datës 22.11.2022, me ç’rast është anuluar vetëm aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe atë pikërisht për shkak të mos përgjigjes së mjaftueshme në pretendimet ankimore të theksuara nga ana e mbrojtësit të të pandehurit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në fakt gjykata e shkallës së dytë ka përshkruar pretendimet ankimore, por në këtë përshkrim ka theksuar të dhëna që nuk përkojnë me pretendimet e paraqitura në ankesë, andaj aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë e bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 455/2022 i datës 22.11.2022**

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit V.N, anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN1.nr.1436/2022 i datës 3.11.2022, vetëm përkitazi me këtë të pandehur dhe çështja i kthehet asaj gjykate në rivendosje.

II. I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin 2022:104693 me datë 17.10.2022, të pandehurve S.Sh, A.D, V.N, S.D, B.H, M.Sh, Z.S, F.D, M.Y, A.D, H.I dhe S.Y, për shkak të veprës penale prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge ose veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 268 par. 1 dhe par. 4 lidhur me nenin 275 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, duke filluar nga data 17.10.2022 i cili do të zgjasë deri më datën 16.12.2022. Të pandehurve masa e paraburgimit iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 187 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1.nr.1436/2022 të datës 3.11.2022, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve A.D, S.D, B.H, Z.S, M.Y, H.I dhe S.Y dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit V. N av. F.Sh, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që të aprovohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, të anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovë, apo të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit duke u liruar për t'u mbrojtur në liri apo ndaj tij të caktohet ndonjëra nga masat alternative më e butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr. 160/2022 e datës 21.11.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjës në kërkesë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se gjykata e shkallës së parë në Ferizaj ia ka vazhduar të pandehurit masën e paraburgimit ndaj të cilit vendim ka paraqitur ankesë në gjykatën e shkallës së dytë, e cila e ka refuzuar si të pabazuar ankesën, me arsyetimin se janë përmbushur kushtet për vazhdimin e paraburgimit për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale dhe ekzistimit të bazës ligjore nga neni 187 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, si dhe për faktin se prokuroria akoma nuk ka arritur t'i përfundojë të gjitha veprimet hetimore. Në mes të pandehurit V. N dhe Prokurorisë është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë me datë 30.08.2022, ku i pandehuri ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale. Gjykata e shkallës së dytë as që e ka lexuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, sepse në faqen 5 të aktvendimit citon: "...mbrojtësi i të pandehurit V.N., thekson se të pandehurit i është vazhduar masa e paraburgimit edhe pse nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e kësaj vepre penale...". Aktvendimi i kundërshtuar me këto vlerësime dhe konstatime është jo i ligjshëm dhe i pabazuar, pasi që në ankesë është theksuar marrëveshja për pranimin e fajësisë e po ashtu ankesës edhe i është bashkëngjitur kjo marrëveshje.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit, se aktvendimi i Gjykatës së Apelit i kundërshtuar me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPP, pasi që gjykata e shkallës së dytë nuk ka bërë përshkrimin e ankesës respektivisht nuk

kanë dhënë arsye dhe nuk i ka specifikuar rrethanat dhe provat konkrete nga ankesa, përkundrazi ka theksuar diçka që nuk është thënë fare në ankesë.

Gjykata e shkallës së dytë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara më lartë dhe në arsyetim duhet të jep përshkrimin adekuat të ankesës së mbrojtësit të të pandehurit V.N av. F.Sh dhe po ashtu, në arsyetim duhet të përmbajë arsye konkrete lidhur me provat dhe arsyet me mënyrën e vendosjes.

4.3. Komente përmbledhëse të rasteve

Në rastet e paraqitura më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës, kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kishte anuluar aktgjykimet e Gjykatave Themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke kthyer çështjet penale në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Ligjvënësi në mënyrë taksative ka përcaktuar se masat e paraburgimit hiqen apo masa e tillë zëvendësohet në momentin kur nuk është e nevojshme aplikimi i masës më të rëndë përkatësisht masës së paraburgimit, megjithëse kjo dispozitë është mjaft e qartë por në praktikë nuk gjen zbatim të duhur dhe se edhe nga rastet e analizuara del se gjykatat me një automatizëm vazhdojnë masat e paraburgimit, përkundër faktit që vazhdimisht duhet të i kushtohet kujdes se bazat për vazhdimin e paraburgimit në ndërkohë mund të zbehen dhe është e nevojshme që të kemi një kontrollë të paraburgimit.

Në disa raste vërehet se edhe arsyetimi është i përgjithësuar dhe nuk paraqitet një arsyetim i konkretizuar dhe i qartë dhe veçmas pas kalimit të disa muajve në paraburgim, siç rezulton në një rast të paraqitur në punim del se paraburgimi është vazhduar edhe pas 13 muajve, por pa ndonjë arsye konkrete dhe për më keq vërehet se vendimi prej vendimit dallohet vetëm përkitazi me datën e marrjes së tij dhe jo nga përmbajtja.

Gjithashtu në një rast tjetër është vërtet për studim fakti se djali i të pandehurit është arratisur dhe se mbi këtë bazë ekziston rreziku që edhe babai i tij të arratiset që paraqet një arsyetim tërësisht të

paqëndrueshëm dhe posaçërisht duke pasur parasysh se arsyet e përsëritjes duhet të jenë konkrete dhe të ndërlidhen me personalitetin e të pandehurit dhe në asnjë rrethanë të familjarëve të tij.

Në rastet e paraqitura në mënyrë të qartë vërtetohen faktet se nuk janë trajtuar në mënyrë të duhur kushtet për caktimin - vazhdimin e paraburgimit dhe kjo ka ndikuar që Gjykata Supreme e Kosovës ka kthyer rastet në rivendosje, me ç'rast instancave më të ulëta gjyqësor i janë dhënë udhëzime të qarta se si të veprohet në rastet e trajtimit të serishëm të rasteve dhe vlerësimi i kushteve të paraburgimit të i nënshtrohen një trajtimi konkret dhe gjithëpërfshirës dhe jo një vlerësimi në mënyrë abstrakte.

4. Dispozitat ligjore

Neni 190[163]
Afatet kohore të paraburgimit

1. I paraburgosuri mund të mbahet në paraburgim më së shumti një (1) muaj nga dita e arrestimit në bazë të urdhrit nga neni 188 të këtij Kodi. Pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit.

2. Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se: 2.1. katër (4) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim; 2.2. tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim.
3. Në raste të jashtëzakonshme kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe kur rasti është i ndërlikuar siç përkufizohet në nenin 19 të këtij Kodi, e zvarritja e procedurës nuk mund t'i atribuohet prokurorit të shtetit, përveç afateve të parapara në 87 paragrafin 2. të këtij neni para ngritjes së aktakuzës paraburgimi mund të vazhdohet më së

[163] Duhet theksuar faktin se në këtë punim është përdorur si referencë dispozitat e Kodit nr. 04/L-123, meqë shumica e vendimeve të analizuara janë me këtë Kod, mirëpo edhe dispozitat e nenit 188 të Kodit Nr.08/L-082 janë të ngjashme me dispozitat e Kodit të mëparshëm.

shumti deri në katër (4) muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej dymbëdhjetë (12) muaj.
4. Kur ka shkak të bazuar dhe bindës për të besuar se ekziston rrezik i përgjithshëm apo rrezik i dhunës nëse lirohet i pandehuri në procedurë paraprake, vazhdimi i paraburgimit nga paragrafi 3. të këtij neni mund të vazhdohet edhe për gjashtë (6) muaj tjerë për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muaj.
5. Nëse aktakuza nuk ngritet para kalimit të afateve të parapara në paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni, i paraburgosuri lirohet.

4.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Në këtë pjesë të punimit do të trajtohen dispozitat ligjore të nenit 190 par.2 dhe 3 të KPP-së, meqë ligjvënësi ka përcaktuar limitet kohore të masës së paraburgimit për fazën e procedurës paraprake dhe në këtë rast kemi analizuar vendimin përmes të cilit është ndryshuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe me këtë rast është hequr masa e paraburgimit dhe i pandehuri është urdhëruar që të mbrohet në liri. Kjo pjesë është mjaft interesante për trajtim meqë shumë herë në praktikën gjyqësore janë hasur raste kur përkundër kalimit të afatit kohor të masës së paraburgimit është vazhduar me një masë të tillë e që ka qenë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore. Kodi ka përcaktuar afate strikte ligjore dhe atë varësisht prej dënueshmërisë së veprave penale dhe mbi këtë bazë është përcaktuar limiti kohor i mbajtjes së të pandehurve në masën e paraburgimit.

Rasti që do të paraqitet është rasti Pml.nr.220/2020 i datës 17.08.2020, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe i pandehuri është liruar për tu mbrojtur në liri, për shkak të faktit se vepra penale për të cilën ishin duke i zhvilluar hetimet ishte e dënueshme deri në pesë vjet burgim, por përkundër kësaj të njëjtit i ishte vazhduar masa e paraburgimit më shumë se katër muaj.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 220/2020 i datës 17.08.2020**

Aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit B.P ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Krimeve të Rënda

DKR.PP.nr. 17/2020 i datës 10.07.2020 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.750/2020 i datës 21.07.2020, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti lëshohet për t'u mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin DKR.PP.nr. 17/2020 të datës 10.07.2020, B.P, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se kanë kryer vepër penale dhënia e ryshfetit në bashkëkryerje nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, nga data 12.07.2020 deri me datën 10.09.2020. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.3 të KPP.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1.nr.750/2020 të datës 21.07.2020 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit B. P av. A.H për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.12 lidhur me nenin 187 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 1.2.3 të KPP, me propozim që të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të lirohet që të mbrohet në liri ose ti zëvendësohet me masën e lajmërimit në stacionin policor.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.96/2020 të datës 12.08.2020, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se aktvendimet e kundërshtuara janë marrë në kundërshtim me nenin 187 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 lidhur me nenin 190 par.2 nënpar 2.1 dhe nenin 185 par.2 të KPPRK-së, ngase gabimisht janë zbatuar këto të fundit, sa i përket kushteve ligjore për paraburgim si dhe është injoru dispozita imperative, që në mënyrë taksative përcakton zgjatjen e paraburgimit para ngritjes së aktakuzës, e që sipas kësaj dispozite paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se 4 muaj, kur procedura zhvillohet për vepër penale të dënueshme me më pak se 5 vite burgim. Mbrojtësi më tej cek se kundër të mbrojturit të tij nuk zhvillohet procedurë penale për vepër penale të dënueshme me më shumë se 5 vite burgim, andaj ,,ex lege" duhet të ndërpritet paraburgimi kundër të pandehurit, e jo të interpretohet dispozita në mënyrë të gabuar.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës i pandehuri dyshohet për vepër penale nga neni 422 par.1 të KPK për të cilën parashihet dënimi prej gjashtë muajve deri në pesë vjet. I pandehuri është në paraburgim që nga data 15.02.2020 ndërsa me aktvendimin e fundit i është vazhduar paraburgimi deri me 10.09.2020, pra rezulton qartë se i pandehuri në paraburgim ka qëndruar me shumë se katër muaj, kurse pas kalimit të kësaj periudhe nuk rezulton se Prokurori vazhdimin e paraburgimit e ka arsyetuar me nderlikueshmërinë e rastit.

Sipas dispozitës së nenit 190 par.2 të KPP paraburgimi para ngritjes së akuzës nuk mund të zgjasë me shumë se katër muaj kur procedura zbatohet për vepra penale të dënueshme me më pak se pesë vite burgim. Kurse sipas par.3 të nenit 190 në raste të jashtëzakonshme kur procedura zbatohet për vepra penale të dënueshme me së paku pesë vjet burgim dhe kur rasti është i ndërlikuar siç përkufizohet në nenin 19 të këtij kodi, zvarritja e procedurës nuk mund ti atribuohet Prokurorit të Shtetit përveç afateve të parapara në par.2 të këtij neni para ngritjes së akuzës paraburgimi mund të vazhdohet me së shumti deri në katër muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej 12 muaj.

Sipas dispozitës së nenit 19 par.1.2 çështje e ndërlikuar përfshin çdo vepër penale që përfshin por

nuk kufizohet në më shumë se dhjetë të pandehur, aktivitet të organizuar kriminal, korrupsion ose hetimi i së cilës kërkon prova të shumta mjeko ligjore, analiza kontabiliteti ose bashkëpunim ndërkombëtar.

Në rastin konkret jo vetëm që prokurori nuk e ka arsyetuar vazhdimin e paraburgimit me nderlikueshmerinë e rastit por as që bëhet fjalë për rast të ndërlikuar ashtu siç ka konkluduar shkalla e dytë. Sepse bëhet fjalë për katër të pandehur, dhe hetimi nuk kërkon prova të shumta mjeko ligjore, analiza kontabiliteti ose bashkëpunim ndërkombëtar. Prandaj, kjo gjykatë e aprovoj kërkesën të bazuar, kurse ndaj të pandehurit e ndërpreu paraburgimin.

4.2. Komente përmbledhëse të rasteve

Në rastin e paraqitur më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve dhe kishte ndryshuar aktgjykimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore dhe kishte liruar nga paraburgimi të pandehurin, meqë kishte kaluar afati i përcaktuar ligjor për mbajtjen e tij në masën e paraburgimit. Në rastin konkret por edhe në shumë raste tjera nuk është respektuar afati kohor i paraburgimit dhe me këtë rast janë cenuar të drejtat e të pandehurit të përcaktuara me dispozitat ligjore, Kushtetutën e Kosovës dhe KEDLNJ-së.

Për më tepër Gjykata Supreme e Kosovës ka krijuar një standard që pa marrë parasysh se në cilën gjykatë është çështja duke u trajtuar, atëherë me kalimin e afatit ligjor të veprohet në mënyrë automatike dhe të hiqet paraburgimi. Kurse ky standard është fuqizuar edhe përmes vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës[164] e cila gjykatë në tri raste ka gjetur se janë shkelur dispozitat kushtetuese dhe instrumentet ndërkombëtare si rezultat i neglizhencës së gjyqësorit të rregullt me rastin e mos respektimit të afatit të paraburgimit dhe të cilat raste me siguri do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë që gjykatat e rregullta të trajtojnë sipas standardeve ligjore, kushtetuese dhe standardeve ndërkombëtare të afateve të paraburgimit dhe heqjen e tyre në momentin kur kalohen këto afate.

[164] Shih rastet KI 55/22 dhe KI 85/22,

6. Dispozitat ligjore

Neni 193
Caktimi i paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës

1.Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues në seancë. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesën e tij dhe mendimin e të pandehurit ose mbrojtësit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4. të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht.

2. Pasi të kalojnë dy (2) muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 189, paragrafët 3. dhe 4. të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht.

6.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Në vijim të këtij punimi do të trajtohen rastet kur janë gjetur shkelje me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës. E rëndësishme është të theksohet fakti se legjislacioni ynë nuk ka përcaktuar një ndarje të paraburgimit mes dy fazave të procedurës penale, përkatësisht fazës paraprake dhe fazës së akuzimit, mirëpo vlen të potencohet fakti se gjykata e shkallës së parë ka mundësinë e vlerësimit të masës së paraburgimit gjatë shqyrtimit fillestar por edhe në fazat e më vonshme të vijimit të procesit gjyqësor.

Duhet theksuar faktin se deri sa në fazën paraprake janë të përcaktuar afate kohore për kohën e vazhdimit të paraburgimit, kurse pas ngritjes së aktakuzës nuk ka ndonjë limit kohor të paraburgimit, mirëpo gjykatat detyrohen që çdo dy muaj të bëjnë një shqyrtim të kushteve të paraburgimit dhe pastaj të vendosin për vazhdimin apo heqjen e masës së paraburgimit. Gjithsesi

e rëndësishme është të theksohet fakti se pas çdo vazhdimi të paraburgimit lejohet ankesa dhe se dispozitat e nenit 189 par. 3 dhe 4 të KPP-së zbatohen përshtatshmërisht, përkatësisht dispozitat e ankesës dhe veprimet sipas ankesës dhe gjithashtu varësisht prej situatës edhe në këtë fazë lejohet që paraburgimi të zëvendësohet me ndonjë masë tjetër më të butë.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.484/2023 i datës 21.09.2023, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë ndryshuar dhe të akuzuarit janë liruar të mbrohen në liri meqë në këtë çështje penale rasti ishte kthyer në rigjykim dhe gjykata e shkallë së parë kishte vazhduar masën e paraburgimit me arsyetimin se të akuzuarit do të ndikonin në të dëmtuarën, por të cilat arsyetime të dy instancave gjyqësore nuk janë aprovuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës. E rëndësishme është të theksohet fakti se mundësia e ndikimit në dëshmitar është tejet e limituar në fazën e ngritjes së aktakuzës dhe po ashtu pas kthimit të çështjes në rivendosje, meqë tani më dëshmitarët janë dëgjuar dhe dëshmitë e tyre janë regjistruar në procesverbalet përkatëse dhe të njëjtat mund të përdoren për ballafaqim të dëshmitarit nëse eventualisht devijon dëshminë e tij.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 484/2023 i datës 19.09.2023**

Me miratimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve H.M dhe Sh.G, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.73/2023 i datës 04.08.2023 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.DKR.nr.880/2023 i datës 18.8.2023, ashtu që të pandehurve iu ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtit lirohen menjëherë për t'u mbrojtur në liri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.73/2023 të datës 04.08.2023, të pandehurve H.M dhe Sh.G, secili veç e veç për vepër penale "Dhunimi" nga neni 227, paragrafi 4. pika 4.7. të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit për dy (2) muaj ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'iu zgjasë nga data 04.08.2023 deri me datën 03.10.2023. Masa e paraburgimit iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1. Nën paragrafi 1.1. e 1.2. pika 1.2.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNI.DKR.nr.880/2023 të datës 18.08.2023 i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit H.M av. D.K, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2. pika 2.1. lidhur me zbatimin e gabuar të nenit 190, paragrafi 2. lidhur me nenin 184, paragrafi 1. nën paragrafi 1.1. dhe 1.2. pika 1.2.2. dhe nën paragrafi 1.3. të KPP, me propozim që të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të lirohet për t'u mbrojtur në liri;

- mbrojtësi i të pandehurit Sh.G av. S.M, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2. pika 2.1. lidhur me nenin 385, paragrafi 2. pika 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafi 7. të KPP, me propozim Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar, aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen në atë mënyrë që të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të lirohet që të mbrohet në liri ose aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.200/2023 të datës 18.09.2023, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara.

Në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësit e të pandehurve theksojnë se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, në arsyetim nuk kanë dhënë arsyetim konkret për vazhdimin e masës së paraburgimit. Nuk ekziston mundësia e ndikimit në dëshmitaren, pasi që të pandehurit kanë qenë në liri dhe nuk kanë tentuar të ndikojnë dhe se me asnjë veprim të provuar nuk kanë krijuar rrethanë të re e cila domosdo ndikon në vendimin e gjykatës për vazhdimin e paraburgimit.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara, sepse në vendimet e kundërshtuara, nga përmbajtja e tyre, nuk qëndron baza ligjore për të cilën gjykatat e instancave më të ulëta e kanë vazhduar masën e paraburgimit ndaj të pandehurve.

Vetëm fakti se çështja është kthyer në rigjykim, me sygjerimet që sërish të merret në pyetje e dëmtuara (në cilësi të dëshmitares), në prezencë të psikologut dhe prindit të sajë, pasi që deklaratat nuk janë marrë konform dispozitave ligjore dhe duhet vlerësuar pranueshmërinë e këtyre provave, përkatësisht këtyre deklaratave, pa dhënë asnjë arsye më konkrete për mundësinë e rrezikut të ndikimit në të dëmtuarën – dëshmitaren, qoftë me ofrimin, kontaktimin apo ndonjë mënyrë tjetër të ndikimit direkt apo të tërthortë në të, si dhe fakti se të pandehurit kanë qenë në liri dhe (në shkresat e lëndës nuk ka fakte), se kanë tentuar të ndikojnë në të dëmtuarën.

6.2. Komente përmbledhëse të rasteve të paraqitura më lart

Në rastin e paraqitur më sipër është trajtuar vazhdimi i masës së paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës dhe karakteristikë e kësaj faze të procedurës penale është fakti se tani më kemi një përmbyllje të procedurës paraprake dhe fazës së ngritjes së aktakuzës që paraqet një fazë në të cilën rritet ndjeshëm dyshimi i bazuar kurse mund të zbehen kushtet për vazhdimin e masës së paraburgimit.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës sipas praktikës së konsoliduar të saj është maksimalisht e kujdesshme që edhe në këtë fazë të procedurës penale të përfillen dispozitat ligjore përkitazi me vazhdimin e masës së paraburgimit. Duhet rikujtuar faktin se

dispozitat e vazhdimit të procedurës penale pas ngritjes së aktakuzës vlejnë sikurse edhe për fazat paraprake, pra procedurën hetimore dhe pas shpalljes së aktgjykimit.

Gjithsesi edhe në këtë fazë të procedurës penale gjykatat duhet të kenë një kujdes maksimal me rastin e vazhdimit të procedurës penale dhe siç shihet nga rastet të cilat janë trajtuar gjatë këtij punimi del se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë treguar kujdesin e duhur me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit dhe për këtë arsye edhe ka ardhur deri te anulimi i vendimeve të tyre. Duhet theksuar faktin se kjo fazë e vazhdimit të paraburgimit vjen në shprehje edhe pas anulimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe të tretë duke pasur parasysh faktin se me rastin e kthimit të rastit në rigjykim çështja kthehet në fazën e akuzës, atëherë vlejnë edhe kushtet për caktimin, vazhdimin dhe heqjen e paraburgimit.

Andaj, si konkludim i përgjithshëm është e rëndësishme të kuptohet fakti se masa e paraburgimit është masa e fundit dhe për këtë arsye duhet aplikuar vetëm përjashtimisht.

6. Caktimi i paraburgimit për sigurimin e prezencës

Dispozitat ligjore

Neni 307[165]

Mosparaqitja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor

1. Kur i akuzuari i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e arsyeton mungesën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për të akuzuarin lëshon urdhërarrest në pajtim me nenin 175 të këtij Kodi. Kur i akuzuari nuk mund të sillet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të sillet me forcë. Kur i akuzuari e arsyeton mungesën para arrestimit të

[165] Duhet theksuar faktin se në këtë punim janë përdorur si referencë dispozitat e Kodit nr. 04/L-123, meqë shumica e vendimeve të analizuara janë me këtë Kod, mirëpo edhe dispozitat e nenit 302 par.1 dhe 2 të Kodit Nr.08/L-082 janë të ngjashme me dispozitat e Kodit të mëparshëm.

2. *Kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 187 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Për paraburgimin i cili është caktuar për këto shkaqe, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e neneve 185 deri 203 të këtij Kodi. Po qe se paraburgimi i tillë nuk hiqet më parë, ai zgjat derisa të shpallet aktgjykimi, por jo më shumë se një (1) muaj.*

6.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Në rastin në vijim do të trajtohen rastet që shpesh herë paraqiten gjatë shqyrtimeve gjyqësore, përkatësisht rastet kur të akuzuarit i shmangen paraqitjes gjatë shqyrtimit gjyqësor e që si rezultat i kësaj shpesh herë vie deri te shtyrja e shqyrtimeve gjyqësore që kushtëzon paraqitjen e vonesave në trajtimin e rasteve. Kjo dispozitë është një dispozitë e cila në një formë disiplinon të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor që të jenë të përgjegjshëm dhe të mos ndikojnë në shkaktimin e vonesave dhe prolongim e shqyrtimeve gjyqësore. Ndonëse dispozita rregullon vetëm çështjen e shqyrtimit gjyqësor, kjo padyshim se mund të aplikohet edhe gjatë shqyrtimit fillestar në rast se paraqiten shmangie të tilla. Kjo dispozitë duhet aplikuar sidomos në raste kur janë në procedurë një numër i madh i të akuzuarve dhe të njëjtit mund edhe të bëjnë marrëveshje që çdo seancë gjyqësore të mungoj njëri nga ta e që kjo mund të ndikoj në efikasitetin e trajtimit të çështjes dhe shumë herë edhe në parashkrimin e rastit, andaj gjykata duhet të aplikojnë këtë dispozitë për shmangien e situatave të tilla.

Duhet theksuar faktin se caktimi i kësaj mase ka të bëj ekskluzivisht për mbarëvajtjen e shqyrtimit gjyqësor dhe përjashton bazat për caktimin e paraburgimit, për më tepër, aplikimi i kësaj mase ka kufizime procedurale dhe kohore, përkatësisht deri sa të shpallet aktgjykimi apo më së gjati një muaj, pra që tregon domosdoshmërinë e sigurimit të prezencës së të akuzuarit.

Gjatë punës së Gjykatës Supreme të Kosovës janë hasur raste jo të shpeshta të caktimit të masës së paraburgimit në ndërlidhje të këtyre dispozitave ligjore, andaj në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.460/2022 i datës 25.11.2022, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë

anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se masa e paraburgimit ndaj të akuzuarit është caktuar pa u siguruar prania e të akuzuarit, përkatësisht nuk është caktuar fare seanca dëgjimore në të cilën seancë do të dëgjoheshin sqarimet, komentet dhe propozimet e të gjitha palëve, përkatësisht prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij dhe të cilët do të mund të paraqesin arsyetimet e tyre për mos përgjigjen në thirrjen për seancën e shqyrtimit gjyqësor. Megjithëse edhe baza ligjore e bën të qartë caktimin e paraburgimit pas dëgjimit të palëve mbetet që gjykata e shkallës së parë të reflektoj dhe që në të ardhmen të zbatoj në mënyrë të drejtë këto dispozita ligjore.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 460/2022 i datës 25.11.2022**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit J.B, anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, PM.nr. 224/2020 të datës 24.10.2022 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1M.nr.1449/2022 të datës 08.11.2022 dhe çështja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PM.nr.224/2020 të datës 24.10.2022, të pandehurit J.B, për shkak të veprës penale shmangja nga sigurimi i mjeteve për jetesë nga neni 252 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, ia ka caktuar masën e paraburgimit për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtimin kryesor, i cili zgjatë deri të shpallet aktgjykimi por jo më gjatë se 1 (një) muaj nga dita e arrestimit. Masa e paraburgimit iu është caktuar në bazë të nenit 307 paragrafi 2 të KPPK.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PNIM.nr.1449/2022 të datës 08.11.2022, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit J.B, avokat F.P, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale

nga neni 384 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, lidhur me nenin 307 paragrafi 2 dhe neni 287 paragrafi 3 të KPPK, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën, t'i ndryshojë aktvendimet e atakuara ashtu që të pandehurit t'i hiqet masa e paraburgimit..

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresat KMLP.III.nr. 161/22 të datës 23.11.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se nuk janë plotësuar konditat ligjore për caktimin e masës së paraburgimit për sigurimin e prezencës së të pandehurit, se nuk qëndron konstatimi i gjykatës e shkallës së parë se kinse "me datën 24.10.2022 sërish i pandehuri dhe mbrojtësi i tij nuk prezantojnë në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e njoftojnë fare gjykatën për mungesën e tyre", i cili është i qëllimshëm dhe i njëanshëm sepse mbrojtja ka paraqitur parashtresën PM.nr.224/2020 të datës 19.10.2022 për shtyrjen e seancës të caktuar me datën 24.10.2022, të cilën parashtresë gjyqtarja e çështjes fare nuk e ka arsyetuar, se i pandehuri fare nuk është ftuar për seancën e caktuar me datën 24.10.2022 në ora 13:10 h dhe nuk ka dëshmi se i njëjti është ftuar për seancë gjyqësore ndërsa mbrojtja ka pranuar thirrjen për shqyrtim gjyqësor me datën 18.10.2022 për seancën e caktuar me datën 24.10.2022 që do të thotë 6 ditë para seancës, e cila është në kundërshtim me nenin 287 paragrafi 3 të KPP, ku përcaktohet se të akuzuarit i dërgohet thirrja jo më vonë se tetë (8) ditë para shqyrtimit gjyqësor që ai të ketë kohë të mjaftueshme ndërmjet dërgimit të thirrjes dhe ditës së shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes...", andaj thirrja për shqyrtim gjyqësor është në kundërshtim me këtë dispozitë.

Gjykata Supreme pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit, vlerësoj se aktvendimet e kundërshtuara duhen anuluar, për arsye se këto aktvendime janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheq vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tij.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar konform dispozitave të nenit 307 par. 2 të KPP, e cila dispozitë parasheh se po që se i pandehuri i thirrur rregullisht i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nëse nuk ekzistojnë shkaqet për paraburgimin e tij nga neni 187 të KPP, gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues mund të caktoj paraburgimin për sigurimin e pranisë të pandehurit në shqyrtim gjyqësor, mirëpo ligji decidivisht e specifikon situatën se nëse paraburgimi i cili është caktuar për këto shkaqe përshtatshmërish zbatohen dispozitat e nenit 185 deri në 203 KPP-së. Ndërsa, në këto dispozita ligjore (nenet 185 deri 203 të KPP), është parashikuar se paraburgimi mund të caktohet vetëm pas mbajtjes së seancës së dëgjimit, në të cilën seancë palët kanë të drejtën e deklarimit lidhur me përmbushjen ose jo të kushteve për caktimin e paraburgimit, si masë më e rëndë për sigurimin e prezencës së të akuzuarit në procedurë penale. Andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate dhe duke ju referuar interpretimit të paragrafit 2 të nenit 307, gjykata e shkallës së parë nëse konsideron ose gjen se qëndrojnë bazat apo shkaqet nga ky nen, detyrimisht duhet të cakton seancën dëgjimore, ngase sipas këtij paragrafi nuk mund të caktohet paraburgimi nga kjo bazë pa u mbajtur seanca dëgjimore, e në të cilën detyrimisht duhet të prezantojnë i pandehuri, mbrojtësi dhe prokurori, të cilët kanë të drejtë të japin sqarimet, komentet dhe propozimet lidhur me shkaqet eventual të paraburgimit e sidomos të pandehurit duhet t'i jepet mundësia që të jap arsyet për mos përgjigjen në ftesat e Gjykatës.

Duke pasur parasysh se i pandehuri në vazhdimësi iu është shmangur paraqitjes së parë është dashtë që për sigurimin e prezencës së tij shqyrtimet gjyqësore, gjykata e shkallës të lëshojë urdhër arrestin dhe të sigurojë prezencën e të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor, të caktoj seancë dëgjimore e pastaj të vlerësoj se a ekzistojnë kushtet për caktimin e paraburgimit.

Për arsyet e lartcekura, pretendimet e mbrojtësit janë të bazuara dhe lënda kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje e cila, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara më lartë.

Andaj, në bazë të nenit 438 par. 1 nënpar.1.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6.2. Komente përmbledhëse të rastit për caktimin e paraburgimit për shkak të mos paraqitjes në seancën gjyqësore

Në rastin e paraqitur më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës e kishte miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit dhe kishte anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke e kthyer çështjen penale në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Në këtë rast është e rëndësishme të potencohen disa çështje të rëndësishme dhe atë së pari se i akuzuari duhet ta ketë pranuar thirrjen në mënyrë të rregullt dhe i shmanget paraqitjes në shqyrtimin gjyqësor. Është e rëndësishme të theksohet fakti se kjo masë e paraburgimit anashkalon në tërësi kushtet për caktim të paraburgimit pasi që kjo paraqet rastet vetëm për sigurimin e prezencës së tij gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës përmes këtij aktgjykimi por edhe rasteve tjera po instalon një praktikë që në këto raste patjetër të akuzuarit ti jepet mundësia e paraqitjes së argumenteve të tij përkitazi me mos pjesëmarrjen e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor dhe atë përmes caktimit të një seance dëgjimore. Për më tepër, edhe vet dispozitat ligjore të theksuara në nenin 307 par.2 të KPP-së është përcaktuar se përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e neneve 185 deri 203 të këtij Kodi, e që pikërisht këto dispozita kanë përcaktuar caktimin e një seance dëgjimore, pra konkretisht dispozita e nenit 188 të KPP-së. Andaj, përmes këtij punimi është e pritshme që të unifikohet praktika gjyqësore dhe në këto raste gjykatat para se të caktojnë masën e paraburgimit të mbajnë paraprakisht seancë dëgjimore.

7. Dispozitat ligjore

Neni 367

Paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit:
1. Me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari dënohet me burgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues:
1.1. cakton, vazhdon paraburgim kur ekzistojnë kushtet nga neni 187 paragrafi 1. i këtij Kodi; ose

1.2. ndërprenë paraburgimin nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat është paraburgosur.

2. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shqipton dënim prej pesë (5) ose më shumë vjet burg të akuzuarit ia cakton paraburgimin, nëse ai nuk gjendet në paraburgim, ose ia vazhdon atë kur i akuzuari gjendet në paraburgim.

3. Nëse dënimi i shqiptuar është më i ulët së pesë (5) vjet, atëherë paraburgimi caktohet ose vazhdohet nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 187 par. 1. i këtij Kodi.

4. Trupi gjykues gjithmonë ndërprenë paraburgimin dhe urdhëron lirimin e të akuzuarit nëse: 4.1. është liruar nga akuza; 4.2. është deklaruar fajtor, por është liruar nga dënimi; 4.3. është dënuar vetëm më gjobë ose i është shqiptuar vërejtja gjyqësore; 4.4. i është shqiptuar një nga dënimet alternative, përveç dënimit me gjysmë liri nga neni 61 i Kodit Penal; 4.5. për shkak të llogaritjes së paraburgimit në lartësinë e dënimit, ai veç e ka mbajtur dënimin; ose 4.6. akuza është refuzuar, përveç në rastin kur është refuzuar për shkak të mos kompetencës së gjykatës.

5. Para caktimit ose heqjes së paraburgimit nga paragrafi 3. ose 4. i këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit, nëse procedura është filluar me kërkesën e tij, dhe pastaj dëgjon të akuzuarin apo mbrojtësin e tij.

6. Kur i akuzuari gjendet në paraburgim dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues çmon se ende ekzistojnë shkaqet për të cilat ishte caktuar paraburgimi, paraburgimin e vazhdon me aktvendim të posaçëm. Gjithashtu, me aktvendim të posaçëm e cakton ose e heq paraburgimin. Ankesa kundër aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

7. Paraburgimi i caktuar ose i vazhduar sipas dispozitave të paragrafëve 3. deri 6. të këtij neni mund të zgjasë derisa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykimin e gjykatës themelore.

8. I akuzuari i dënuar me burgim, i cili gjendet në paraburgim, me kërkesën e tij mund të transferohet me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues në institucionin për mbajtjen e dënimit para se aktgjykimi të merr formë të prerë.

7.1. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Në vijim të këtij punimi do të trajtohen rastet kur janë gjetur shkelje me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit. E rëndësishme është të potencohet fakti se me kodin

aktual nuk është paraparë paraburgimi obligativ, por gjithmonë është fakultativ, për dallim prej kodit të mëparshëm në të cilin ishte paraparë paraburgimi obligativ për rastet kur shqiptohet dënimi me 5 (pesë) apo më tepër vite burgimi.

Siç është potencuar edhe më lartë se caktimi - vazhdimi i masës së paraburgimit por edhe heqja e saj mund të bëhet edhe pas shpalljes së aktgjykimit. Përkundër faktit se tani më jemi në një fazë të avancuar të procedurës penale dhe tani më shumë aspekte janë sqaruar dhe kemi një aktgjykim të shpallur nga ana e gjykatës së shkallës së parë, megjithatë në këtë fazë ligjvënësi ka përcaktuar mundësinë e vazhdimit të masës së paraburgimit. Gjithsesi është e rëndësishme të theksohet fakti se në këtë fazë të procedurës penale duhet pasur parasysh se kushtet e paraburgimit janë më të limituara dhe kjo kërkon një analizë të veçantë nga ana e gjykatës e cila e shpall aktgjykimin. Megjithatë edhe në këtë fazë të procedurës penale duhet pasur parasysh se vlejnë disa nga kushtet për caktimin - vazhdimin e paraburgimit, mirëpo ato duhet të trajtohen në prizmin e fazës së procedurës penale. Pra caktimi i masës së paraburgimit është i lejuar vetëm për periudhën kohore sa është shqiptuar dënimi me aktgjykim dhe se duhet gjithsesi të merren parasysh kushtet për shqiptimin e tij dhe se në këtë fazë gjykata duhet të jetë e kujdesshme maksimalisht duke marrë parasysh faktin se në këtë fazë kemi ndryshim të rrethanave pas shpalljes së aktgjykimit.

Në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.232/2022 i datës 08.06.2021, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara për vazhdimin e paraburgimit. E rëndësishme është të theksohet fakti se në këto aktvendime si bazë për vazhdimin e masës së paraburgimit është konsideruar fakti se i pandehuri është shtetas i huaj, përkatësisht i Republikës së Shqipërisë. Megjithatë kjo mënyrë e arsyetimit është e paqëndrueshme, meqë fakti se i pandehuri është shtetas i një shteti tjetër nuk nënkupton rrezikun e ikjes dhe përsëritjes së veprës penale pa pasur rrethana konkrete që ikjen e tij e bëjnë të besueshme. Pra është e nevojshme plotësimi i kushteve dhe rrethanave në mënyrë konkrete dhe jo vetëm mbi bazën që është arsyetuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë, meqë shteti ynë me shumë shtete por edhe me Republikën e Shqipërisë kanë lidhur marrëveshje për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në fushën penale edhe përkitazi me ekzekutimin e dënimit të shqiptuar, andaj kjo bazë si e vetme është tërësisht e paqëndrueshme për vazhdimin e masës së paraburgimit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 232/2022 i datës 08.06.2021**

Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit B.S, anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.677/2021 të datës 26.04.2022 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.606/2022 të datës 11.05.2022 vetëm përkitazi me këtë të pandehur dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.677/2021 i shpallur me datë 26.04.2022 (ndërsa i përpiluar me datën 10.05.2022), të pandehurve A.M dhe B.S., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, i ka shpallur fajtorë dhe i ka gjykuar:

- të pandehurin A.M me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 € (tremijë euro), në të cilin dënim do t'iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.08.2021 e tutje, dhe

- të pandehurin B.S., me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej 3000 € (tremijë euro), në të cilin dënim do t'iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.08.2021 e tutje.

Pas shpalljes së aktgjykimit, me aktvendim të veçantë PKR.nr.677/2021 të datës 24.04.2022 të pandehurve A.M dhe B.S, për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtorë ju është paraburgimi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim. Të pandehurve paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 367 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 187 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 nënpar.1.2.1 dhe 1.2.3 të KPP.

Ne procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr.606/2022 të datës 11.05.2022, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve A.M av. L.M dhe B.S av. Z.S, dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit B.S av. Z.S, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par. 1 nën par. 1.2 lidhur me nenin 384 par. 1 nën par. 1.12 te KPP, me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen sa i përket masës së paraburgimit ashtu që i pandehuri të lirohet nga masa e paraburgimit apo çështja të kthehet në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr. 80/2022 e datës 07.06.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjës në kërkesë dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se aktvendimi për vazhdimin e paraburgimit është i pabazuar ngase i pandehuri është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj e jo me dënim prej 5 (pesë) vitesh ku paraburgimi do të ishte obligator dhe se as rrethanat faktike të rastit e as dispozita ligjore të rastit në fjalë nuk e përkrahin vazhdimin e paraburgimit. Ikja si rrethanë për vazhdimin e paraburgimit ka të bëjë me shmangien e kryerësit ndaj organeve përkatëse deri në vuajtjen e dënimit dhe në rastin konkret i përket më shumë të pandehurit tjetër të çështjes i cili është shtetas i Republikës së Shqipërisë, dhe se vazhdimi i paraburgimit mbi këtë bazë duket si formë e solidarizimit duka ua vazhduar të dyve paraburgimin. I pandehuri për herë të parë bie ndesh me ligjin, gjendjen ekonomike e ka jashtëzakonisht te keqe, nga e cila edhe është shtyrë që të kryej veprën penale, është shtetas i

Republikës së Kosovës, i dihet vendbanimi, njeri familjar, baba i tre fëmijëve, që në seancën fillestare e ka pranuar fajësinë, është penduar thellë.

Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPP, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave respektivisht nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun e ikjes si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale konform nenit 187 par.1 nën par.1.1 e 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPP, për të cilat baza i është vazhduar të pandehurit paraburgimi. Në aktvendimet e kundërshtuara vetëm është parafrazuar dispozita ligjore e nenit 187 të KPP lidhur me kushtet e nevojshme për vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato me detajisht dhe më konkretisht, e të cilat fakte të specifikuara e të konkretizuara, do të arsyetonin dhe mbështesin rrezikun e ikjes dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Gjykatat, ajo e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, këtë rrezik e kanë mbështetur në dënimet e shqiptuara dhe me faktin se i pandehuri është shtetas i Republikës së Shqipërisë, ndërsa për të pandehurin B.S, nuk e kanë theksuar asnjë rrethanë konkrete se ku mbështesin rrezikun e ikjes dhe të përsëritjes së veprës penale.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë, shkeljet e theksuara më lartë dhe në arsyetim duhet të jep arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që e mbështesin rrezikun e ikjes si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale për të pandehurin B.S.

Po ashtu edhe rasti në vijim Pml.nr.442/2021 i datës 01.12.2021, paraqet një mos arsyetim të mjaftueshëm të kushteve të paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit, me ç’rast aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe çështje është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë për faktin se nuk është paraqitur arsyetim i qëndrueshëm përkitazi me plotësimin e kushteve të kërkuara dhe është gjetur se si rezultat i arsyetimit të pamjaftueshëm janë gjetur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë nuk është paraqitur asnjë arsye konkrete për vazhdimin e masë së paraburgimit. Është detyrim ligjor që në secilën fazë të procedurës penale të arsyetohen aktvendimet për vazhdimin e masë së paraburgimit e veçanërisht

edhe në këtë fazë kur mund që kushtet e paraburgimit të ndryshojnë në krahasim me fazën deri në shpalljen e aktgjykimit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 442/2021 i datës 01.12.2021**

Aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të akuzuarit N.M, kurse aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për të Mitur PKR.nr.143/2021 i datës 01.11.2021, dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.nr.1330/2021 i datës 12.11.2021, anulohen dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamentin për të Mitur, aktgjykimin PKR.nr. 143/2021 datë 01.11.2021, të pandehurin N.M., e ka shpall fajtor për veprat penale dhunimi nga neni 227 par.6 lidhur me par.3 nënpar. 3.1 të KPRK dhe kanosje nga neni 181 par.4 të KPRK, për të cilat e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve. Pas shpalljes së aktgjykimit me aktvendim të veçantë PKR.nr. 143/2021 datë 01.11.2021 ndaj të pandehurit është vazhduar paraburgimi konform dispozitës së nenit 367 par.3 të KPP deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo me shumë se dënimi i shqiptuar. Paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 187 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN. 1.nr.1330/2021 të datës 12.11.2021, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit, ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit N.M, avokat S.R, nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale lidhur me vazhdimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, aktvendimet e formës së prerë ti ndryshoj, të pandehurit t'i ndërpritet paraburgimi dhe i njëjti të mbrohet në liri apo t'i anuloj dhe lëndën t'a kthej në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.III.nr. 158/2021 të datës 30.11.2021, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme vlerëson se aktvendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar. 1.12 të KPP, ngase në arsyetimin e tyre nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare përkitazi me bazat ligjore për të cilën i është vazhduar paraburgimi të pandehurit.

Me dispozitën e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 të KPPRK-së, është parashikuar që paraburgimi mund të caktohet ose të vazhdohet ndaj një personi, nëse ekziston dyshimi i bazuar se një personi i tillë ka kryer vepër penale dhe përmbushet njëri nga kushtet nga pika (1.2.1),(1.2.2) e (1.2.3). Kushtet që kërkohen sipas pikës (1.2.3), kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se mund ta përsërisë veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën për të cilën është kanosur ta kryejë. Mirëpo, për t'u përmbushur baza ligjore për caktimin ose për vazhdimin e paraburgimit sipas pikave të lartpërmendura kërkohet që të ekzistojnë rrethana konkrete dhe të vërtetuara që paraqesin rrezik objektiv e jo siç është vepruar në rastin konkret rrethana të supozuara dhe abstrakte

Siç del nga shkresat e lëndës pas shpalljes me dënim unik me katër vite burgim gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPK mirëpo, arsyet e dhëna përkitazi me këtë bazë ligjore i referohen elementeve të veprave penale, në fakt nuk jepen arsye apo rrethana

konkrete që tregojnë se ekziston rreziku i përsëritjes së veprave penale aq më tepër kur merret parasysh se nga shkresat e lëndës del se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, është i ri (diferenca e vogël në mes moshës së të dëmtuarës dhe të pandehurit), i pandehuri është penduar, i ka kërkuar falje të dëmtuarës, ka premtuar se e dëmtuara dhe familja e saj nga ai ndihen të rrezikuar dhe është i gatshëm që pasi që të plotësohen kushtet edhe të lidhë martesë me të, pra, arsyetimet e aktvendimeve të kundërshtuara lidhur me vazhdimin e paraburgimit, nuk përmbajnë arsye konkrete dhe objektive për sa i përket fakteve vendimtare përkitazi me bazën ligjore të vazhdimit të paraburgimit dhe për faktin se nuk janë dhënë arsye të këtilla, aktvendimet janë të mangëta dhe, si të tilla, ato përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e cila shkelje i bën të paqëndrueshme vendimet në fjalë, prandaj u desh që aktvendimet të anulohen dhe çështja ju kthye gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Ndërsa, në rivendosje gjykata duhet t'i vlerësojë edhe një herë të gjitha rrethanat dhe pastaj të merr vendim duke jep arsye të qarta dhe konkrete përkitazi me vendimin që e merr.

Për arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar andaj konform nenit 438 par. I nën par. 1.2 të KPP vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7.2. Komente përmbledhëse të rasteve

Në rastet e paraqitura më sipër është trajtuar vazhdimi i masës së paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit dhe karakteristikë e kësaj faze të procedurës penale është fakti se tani më kemi një përmbyllje të shqyrtimit gjyqësor dhe kushtet e paraburgimit duhet trajtuar në kuptim të kësaj faze të procedurës penale. Duke u bazuar në dispozitat ligjore Gjykata Supreme e Kosovës sipas praktikës së konsoliduar të saj është maksimalisht e kujdesshme që edhe në këtë fazë të procedurës penale të përfillen dispozitat ligjore përkitazi me vazhdimin e masës së paraburgimit. Duhet rikujtuar faktin se dispozitat e vazhdimit të procedurës penale pas shpalljes së aktgjykimit vlejnë sikurse edhe për fazat paraprake, pra procedurën hetimore dhe pas ngritjes së aktakuzës.

Gjithsesi edhe në këtë fazë të procedurës penale gjykatat duhet të kenë një kujdes maksimal me rastin e vazhdimit të procedurës penale dhe siç shihet nga rastet të cilat janë trajtuar gjatë këtij punimi del se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë treguar kujdesin e duhur me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit dhe për këtë arsye edhe ka ardhur deri te anulimi i vendimeve të tyre.

Andaj, si konkludim i përgjithshëm është e rëndësishme të kuptohet fakti se masa e paraburgimit është masa e fundit dhe për këtë arsye duhet aplikuar vetëm përjashtimisht.

8. Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë ndryshimin e vendimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore tek vazhdimi i paraburgimit dhe të cilat vendime janë ndryshuar duke hequr masën e paraburgimit

8.1. Dispozitat ligjore

Neni 173[166]

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit

Me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t'i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa më e butë.

Këto masa hiqen kur pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo zëvendësohen me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet.

Para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr kryetari i trupit gjykues, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod.

[166] Duhet theksuar faktin se në këtë punim është përdorur si referencë dispozitat e Kodit nr. 04/L-123, meqë shumica e vendimeve të analizuara janë me këtë Kod, mirëpo edhe dispozitat e nenit 171 par.2,3, 4 dhe 5 të Kodit Nr.08/L-082 janë të ngjashme me dispozitat e Kodit të mëparshëm.

Shprehja "masë më e butë për të siguruar praninë e të pandehurit" apo "masa më të buta" për qëllim të këtij kodi nënkupton thirrjen, premtimin e të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitjen në stacionin policor, dorëzaninë, arrestin shtëpiak dhe diversionin.

8.2. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

Në këtë pjesë të punimit do të trajtohen vendime të cilat janë ndryshuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe me këtë rast është hequr masa më e rëndë, përkatësisht masa e paraburgimit dhe i pandehuri është liruar të mbrohet në liri. Ligjvënësi në dispozitat e cekura më lartë ka vënë parakushte në rastet kur gjykata shqyrton kërkesën e prokurorit për masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit dhe posaçërisht masën e paraburgimit dhe që këto masa të hiqen posa të krijohen kushtet për heqjen e tyre. Pra është parim i përgjithshëm që në këto raste të shqyrtohen gjithmonë masat tjera dhe nëse ato nuk janë të mjaftueshme pastaj të caktohet masa e paraburgimit si masë mundësia që të hiqen duke pasur parasysh faktin se duhet gjithmonë të vendoset në favor të lirimit nga masa e paraburgimit.

Konsiderojmë se në rastet e paraqitura në këtë punim, por edhe raste tjera, gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë trajtuar me shumë kujdes dhe shpeshherë edhe pse në fakt kanë pushuar shkaqet e vazhdimit të paraburgimit dhe kanë pushuar ato shkaqe në ndërkohë, megjithatë është vazhduar me masën e paraburgimit e që kjo është arsyeja që shpesh herë edhe Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar masën e paraburgimit me lirim të të pandehurit në liri dhe në pritje të gjykimit me qëllim të krijimit të një praktike uniforme, konsiderojmë se tash e tutje kjo praktikë e paraqitur përmes këtij punimi duhet të zbatohet edhe nga instancat më të ulëta të gjyqësorit.

Rasti që do të paraqitet është rasti Pml.nr.85/2020 i datës 16.03.2020, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe i pandehuri është liruar për tu mbrojtur në liri. Nga shkresat e lëndës por edhe nga vendimet e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore vërehet fakti se në këtë rast edhe përkundër faktit se ndaj të pandehurit ishte caktuar masa e paraburgimit dhe pastaj e njëjta ishte vazhduar, megjithatë del se gjatë kësaj periudhe nuk janë

ndërmarrë hetime dhe nuk është ofruar informacion bindës për një vëzhgues objektiv se i pandehuri ka gjasa të konsiderueshme se ka kryer veprën penale. Në këtë rast vërehet një neglizhencë e qartë e Prokurorisë së Shtetit në zhvillimin e hetimeve me prioritet dhe urgjencë në rastet kur të pandehurit janë në paraburgim edhe pse në këtë çështje penale janë të dyshuar edhe persona të tjerë. Pra konsiderojmë se gjykata e shkallës së parë por veçanërisht e shkallës së dytë nuk do të duhej të tregonin fleksibilitet në këto raste, por do të duhej të vepronin dhe të mos toleronin një neglizhencë të Prokurorisë së shtetit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 85/2020 i datës 16.03.2020,**

Aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit S.D, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPR.nr.93/2020 të datës 28.02.2020 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.DP.nr.246/2020 të datës 06.03.2020, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti lëshohet për t'u mbrojtur në liri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPR.nr.93/2020 e datës 28.02.2020, të pandehurit S.D, i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale mashtrim nga neni 323 par.1 të KPRK-së, si dhe veprën penale falsifikim i dokumentit nga neni 390 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë deri më datë 29.03.2020. Të pandehurit paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 191 par.1 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 e 1.2.3 të KPPRK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1.DP.nr.246/2020 e datës 06.03.2020, e ka refuzuar si e pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit S.B, dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të

pandehurit S.D, avokat Sh.H., nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të nenit 432 par.1 nënpar. 1.2 e 1.3 e lidhur me nenin 384 par.1 nënpar. 1.8 të KPPKsë, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ti ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'ia ndërpresë masën e paraburgimit dhe ta lirojë nga paraburgimi, ose çështjen ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.31/2020 e datës 13.03.2020, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit S.D, avokat Sh.H, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit S.D, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, thekson se të dy aktvendimet e kundërshtuara janë të pakuptueshme, kundërthënëse si dhe nuk kanë arsyetimin e duhur ligjor. Në rastin konkret gjykata pa asnjë kompetencë vetë përcakton se ekziston dyshimi i bazuar, se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet. Me këtë veprim gjykata ka bërë tejkalimin e kërkesës së prokurorit të shtetit sepse e njëjta ka ricilësuar dyshimin, nga dyshimi i arsyeshëm në dyshim të bazuar. Gjykata e shkallës së parë si dhe ajo e shkallës së dytë nuk kanë ofruar prova të qarta në lidhje me dyshimin e bazuar, se cilat veprime inkriminuese i ka ndërmarrë i mbrojturi i tij lidhur me veprat penale që i vihen në barrë, koha dhe vendi në të cilën pretendohet se janë kryer veprat penale nuk qëndrojnë, ngase i pandehuri ka qenë vetëm vozitës - taksist, pas orarit të punës në relacionin Sh. – P., i ka vozitur personat A.T dhe A.L., nga Sh., e cila rrethanë fare nuk është shqyrtuar nga prokuroria dhe gjykata. Gjithashtu, i mbrojturi i tij ka një të kaluar të mirë, asnjë herë nuk ka ra ndesh me ligjin, sepse nga provat që janë në shkresat e lëndës është e pamundur që i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën pretendohet, si dhe fare nuk ka qenë prezent kur është bërë falsifikimi i dokumentit në gjykatën themelore, i cili dokument pas verifikimit nga gjykata ka rezultuar se është falsifikuar. Pretendon se mungojnë bazat paraburgim nga cilat është vazhduar dhe se edhe me një masë më të butë mund të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedure.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara.

Siç del nga shkresat e lëndës ndaj të pandehurit S., është caktuar paraburgimi për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale mashtrimi, nga neni 323 par.1 të KPRK dhe falsifikimi i dokumentit nga neni 390 par.1 të KPRK. Pas skadimit të kësaj periudhe Prokurori ka propozuar që të pandehurit ti vazhdohet paraburgimi edhe për një muaj të cilin propozim e ka aprovuar gjykata e shkallës së parë me aktvendimin PPR.nr.93/2020 datë 28.02.2020, i cili është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktvendimin PN.1.DP.nr.246/2020 datë 06.03.2020.

Kështu, sipas dispozitës së nenit 165 par.2 nënpar.2.4 e 2.5 të kodit të Procedurës penale nëse Prokurori i Shtetit beson se duhet caktuar apo vazhduar masën e paraburgimit ndaj një personi, ai i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesë për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit e cila kërkesë përmban përshkrimin e provave që mbështesin dyshimin e bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale dhe përshkimin e provave që mbështesin bazat e artikulueshme, për të besuar se ka rrezik të arratisjes; personi i arrestuar do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund të përsërisë veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

Në kërkesën për vazhdim të paraburgimit, prokurori ka kërkuar që të pandehurit t'i vazhdohet paraburgimi me arsyetim se "Prokuroria në këtë çështje penale është në proces të grumbullimit të provave për përfundimin e procedurës penale, ngritjes së akuzës në ketë çështje penale. Sipas vlerësimit të Prokurorisë ekzistojnë arsye për vazhdimin e paraburgimit sepse ekziston rreziku që i dyshuari S.D, duke pas parasysh seriozitetin e veprave penale dhe rrethanat në të cilat janë kryer ekziston rreziku se ti përsëris veprat penale pasi që i njëjti nuk është shtetas i Kosovës. Po ashtu telefoni i të pandehurit është dërguar për ekspertim, që të shihen dhe vërtetohen lidhjet e tij me të pandehurit tjerë dhe të dëshmohet fajësia i tij, e meqë ekspertiza nuk është kryer është i nevojshëm

që të mbetet në paraburgim sepse pas vërtetimit të fajësisë së të pandehurit i njëjti në rast se nuk i vazhdohet paraburgimi nuk do të jetë i qasshëm organeve të drejtësisë së Republikës së Kosovës". Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate edhe pas skadimit të periudhës së paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji në kërkesën e Prokurorit për vazhdim të paraburgimit nuk rezulton se Prokurori ka ndërmarrë hetime apo ofruar njohuri për informacion të cilat do të bindnin një vëzhgues objektiv se i pandehuri ka gjasë të konsiderueshme ti ketë kryer veprat penale, dhe këto prova apo informacione cilat veprime inkriminues të të pandehurit i argumentojnë respektivisht cilat janë ato veprime inkriminuese konkrete që i pandehuri i ka ndërmarrë në drejtim të veprave penale për të cilat dyshohet aq më tepër kur në ketë çështje ka edhe të dyshuar tjerë e që sipas kërkesës së Prokurorit del se i pandehuri ka bashkëvepruar me ta, dhe çuditërisht këto prova as në kërkesën për vazhdim të paraburgimit nuk theksohen e për më tepër sipas kërkesës tani pritet që të vërtetohen dhe shihen lidhjet e të pandehurit me të dyshuarit tjerë.

Për arsyet e lartcekura kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka vend për paraburgim, prandaj e aprovoj kërkesën si të bazuar dhe ndaj të pandehurit e ndërpreu paraburgimin.

Rasti tjetër që do të paraqitet është rasti Pml.nr.263/2020 i datës 21.09.2020, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe i pandehuri është liruar për tu mbrojtur në liri. Në këtë rast është e rëndësishme të theksohet fakti se përkundër faktit që nuk është e diskutueshme baza e dyshimit të bazuar, megjithatë është vënë në dyshim fakti i ndikimit të të pandehurit në dëshmitaren e rastit, mirëpo i cili dyshim nuk është arsyetuar mjaftueshëm, meqë në rastin konkret del se e dëmtuara tani më është dëgjuar gjatë procedurës paraprake dhe se deklarata e saj është në shkresat e lëndës dhe po ashtu nuk ekziston rreziku i përsëritjes së veprës penale.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 263/2020 i datës 21.09.2020**

Me pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtësit të të pandehurit, A.L, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Ppr.nr.90/2020 datë 31.08.2020 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Departamenti për Krime të Rënda, PN.1.nr.928/2020 datë 08.09.2020, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti lëshohet menjëherë në liri.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Ppr.nr.90/2020 datë 31.08.2020 të pandehurit, A.L, për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 227 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së e cila masë sipas këtij aktvendimi do të zgjaste deri me 28.09.2020.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1.nr.928/2020 e datës 08.09.2020, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit avokat I.Th, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale për caktimin e paraburgimit, me propozim që të pandehurit t'i hiqet masa e paraburgimit dhe i pandehuri të lëshohet në liri.

Përgjigje ndaj kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit për mbrojtjen e ligjshmërisë ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.III.nr.113/2020 e datës 18.09.2020, në të cilën ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit, vlerësoi se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe i pandehuri duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheq vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tij.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, së pari si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e Apelit, me rastin e caktimit të paraburgimit nuk kanë dhënë arsye të qarta dhe të pranueshme sa i përket arsyeve - bazave ligjore për masën e paraburgimit, nuk është dhënë asnjë arsye ligjore, përpos që gjykatat e niveleve kanë parafrazuar dispozitat ligjore, pa i mbështetur fare përfundimet e tyre në rrethana ligjore, e që vendimin e bëjnë të paligjshëm. Gjykata kur cakton ndonjërën nga masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit në proces gjyqësore, duhet të japë arsye të qarta për secilën bazë ligjore, e jo të mjaftohet me parafrazimin e dispozitës ligjore. Në rastin konkret gjykatat e niveleve më të ulëta përpos një parafrazimi të ligjit, nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të dhënë arsye për bazat ligjore të paraburgimit dhe, nga shkresat e lëndës, nuk rezulton se në rastin konkret është përmbushur ndonjëra nga bazat ligjore për caktimin e paraburgimit në të cilat janë thirrur gjykatat e instancave më të ulëta.

Andaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron fakti si i pandehuri do të mund të ndikojë tek e dëmtuara apo dëshmitarja e përmendur, sepse provat gjegjësisht deklaratat e tyre ekzistojnë në shkresat e lëndës. Pra nga e gjithë kjo del se në rastin konkret, nuk rezulton e bazuar druajtja për mundësinë e asgjësimit të provave dhe ndikimit në dëshmitarët e përmendur, e aq më pak në përsëritjen e veprës penale sepse nga shkresat e lëndës nuk rezulton se i pandehuri ka qenë ndonjëherë i dyshuar për vepra tjera penale. Gjithashtu sipas deklaratës së të pandehurit dhe të dëmtuarës ajo tani më i ka ndërprerë raportet me të pandehurin dhe ka filluar lidhje me person tjetër, e që gjasat e përsëritjes së veprës nuk qëndrojnë

Në rastin në vijim Pml.nr.411/2021 të datës 15.11.2021, aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe vetëm njëri nga të pandehurit është liruar për tu mbrojtur në liri, kurse të pandehurit tjetër i është refuzuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ka vazhduar qëndrimi i tij në paraburgim. Konsiderojmë se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore duhet të kenë parasysh rolin dhe kontributin e secilit pjesëmarrës në veprën penale dhe mbi bazën e kësaj edhe të trajtojnë secilin të pandehur veç e veç dhe jo në mënyrë të përbashkët, siç ka ndodhur me këtë rast. Përkundër faktit se të pandehurit kanë qenë në dyshim për veprime të tjera, pra njëri për veprën penale të marrjes së ryshfetit dhe tjetri ndihmë në kryerjen e kësaj vepre penale, megjithatë këta dy janë trajtuar në mënyrë të njëjtë. Megjithatë në këtë rast pa prejudikuar epilogun e tij del se tek i pandehuri si ndihmës në kryerjen e veprës penale është shterur mundësia e ndikimit në

hetime dhe aq më pak në përsëritjen e veprës penale, posaçërisht duke pasur parasysh karakteristikat e tij personale, kurse krejtësisht tjetër paraqitet situata kur është në pyetje i pandehuri tjetër. Andaj mbi këtë bazë duhet pasur kujdes në trajtimin e njëjtë të të gjithë të pandehurve, meqë shpesh herë ndodh që ndaj njërit të pandehurit të pushojnë shkaqet për vazhdimin e paraburgimit, kurse tek i pandehuri tjetër vazhdojnë të qëndrojnë këto shkaqe.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 411/2021 i datës 15.11.2021,**

I.Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit M.R., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PPRKR.nr.189/2021 të datës 05.10.2021 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.1 nr. 1208/2021 datë 20.10.2021.

II. Aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit E.R, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PPRKR.nr. 189/2021 të datës 05.10.2021, datë 08.10.2021 si dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Pn1. Nr.1208/2021 i datës 20.10.2021 (vetëm sa i përket të pandehurit E. R,), ashtu që të pandehurit E.R, i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti lëshohet për tu mbrojtur në liri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore ne Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPRKR 180/2021 të datës PPSKR 180 2021 datës 05.10.2021, dhe aktvendimin 08.10.2021 (vetëm sa i përket të pandehurit E.R), të pandehurit M.R për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale marrje e ryshfeti nga neni 421 par, 3 lidhur me 1, lidhur me nenin 31 KPRK-së dhe të pandehurit E.R, për veprën penale Ndihmë nga neni 33 KPRK-së u ka vazhduar masën e paraburgimit deri me datën 09.12.20021. Masa e paraburgimit u është vazhduar në bazë të nenit 187 par. 1 nënpar. 1.1 dhe 1.2. pika 1.2.2, 1.2.3 të KPPRK-së.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1r.1208 2021 to datës 20.10.2021 i ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të pandehurit M.R dhe B. R dhe e ka vërtetuar aktvendimet e gjykatës së shkallës.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:
- mbrojtësja e të pandehurit av. M.R, dhe av.R.G, nga Prishtina, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të procedurës penale mbi vazhdimin e masës së paraburgimit, me propozim që të pandehurit të ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti të mbrohet në liri.

- mbrojtësi i të pandehurit E.R, av. H.S nga Prishtina, për shkak shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 lidhur me nenin 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme t'a miratoj si të bazuar kërkesën, t'i ndryshoj vendimet e atakuara me kërkesë ashtu që të pandehurit E., t'i hiqet masa e paraburgimit për t'u mbrojtur në liri. Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.Ill.nr.140/2021 të datës 11.11.2021 dhe 12.11.2021, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, e mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

-kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit M.R është e pa bazuar, ndërsa
-kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit E. R është e bazuar

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit M.R., thekson se i pandehuri, gjatë marrjes në pyetje para Prokurorisë së Shtetit në procesverbalin PP/1 nr. 16K/2021 datë 19.10.2021, ka pranuar veprimet e veta dhe ka dhënë sqarime të hollësishme dhe të besueshme për çështjen që është lëndë e hetimit dhe se tani më nuk qëndrojnë asnjë nga rrethanat ligjore mbi të cilat është vazhduar paraburgimi. Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit E.R, theksohet se gjykata e shkallës e as gjykata e shkallës së dytë në aktvendimet e tyre të atakuara me kërkesë nuk kanë dhënë arsye të relevante për kushtin e përgjithshëm dhe kushtet e veçanta për vazhdimin e paraburgimit nga dispozita e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.2, 1.2.3 te KPPRK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit E.R, nuk janë të bazuara nga se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë drejtë kanë gjetur se ekziston dyshimi i bazuar nga neni 187 par.1 nënpar. 1.1 i KPPRK-së, që i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, kusht ky qenësor për vazhdimin e paraburgimit, bazuar në provat e ofruara deri në këtë fazë të procedurës siç janë: aktvendimi për fillimin e hetimeve i dtatës 10.03.2021, aktvendimi mbi zgjerimin e hetimeve ndaj të pandehurve E.R dhe A.B datë 11.09.2021, fotodokumentacioni në shkresat e çështjes deklarata dhënë para Prokurorit të Shtetit, Raporti i Forenzikës i datës 23.09.2021 dhe provat tjera materiale, ndërsa a do të argumentohen këto fakte është çështje që do të vlerësohet në fazat e mëtejme në këtë çështje penale.

Kjo Gjykatë, vlerëson se qëndron baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit M.R sipas dispozitës së nenit 187par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të KPPRK-së, nga se me gjetjen e të pandehurit duke u mbrojtur në liri, ekziston rreziku i asgjësimit fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, duke ndikuar tek njëri tjetri, sepse i pandehuri M.., ka raporte familjare me të dyshuarin E-djalin e tij, ashtu që në këtë mënyrë do të harmonizonin dhe koordinonin deklarimet e tyre e me çka do të pengohej rrjedha normale e procedurës penale.

Po ashtu, qëndron baza për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit M.R në fjalë edhe sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nën par.1.2 pika 1.2.3, të KPPRK-së, duke marrë parasysh peshën e veprës penale, mënyrat dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale me datë 10.09.2021 gjegjësisht në zyrën nr..., të A.Q.P, i pandehuri M. pas orës 16:00 dyshohet se ka pranuar ryshfetin në vlerë prej 8.000 € në mënyrë të kundërligjshme nga i dëmtuari A.H, me qëllim që të pandehurit M. ti sjell fitime pasurore të kundërligjshme, ashtu që pas marrëveshjeve në mes tyre parat i kanë fshehur në bodrumin e një banese ku dhe janë gjetur dhe sekuestruar nga ana e Policisë së Kosovës, rrethana këto që tregojnë se me gjetjen e të pandehurit M. në liri, ekziston rreziku se i njëjti mund të përsërisë veprën penale të natyrës së njëjtë apo të kryej ndonjë vepër tjetër penale.

Andaj, nga arsyet e sipër cekura, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës

së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa mbetja e të pandehurit M. për t'u mbrojtur në liri apo nën masat tjera alternative të parapara nga neni 173 të KPPK, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit E.R, theksohet se gjykata e shkallës e as gjykata e shkallës së dytë në aktvendimet e tyre të atakuara me kërkesë nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme relevante për kushtin e përgjithshëm dhe kushtet e veçanta për vazhdimin e paraburgimit nga dispozita e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.2, 1.2.3 të KPPRK-së. Duke marr parasysh faktin se të pandehurit E.R, i dihet vendbanimi, adresa, është student, kurse nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë rrethanë konkrete objektive që jep arsye për të besuar që me linjën e tij në liri do të ndikoj në hetime apo do të përsërisë vepër penale, duke pasur parasysh edhe faktin se i pandehuri në fjalë dyshohet për ndihmë në kryerjen e veprës penale dhe jo si bashkekzekutor, kjo Gjykatë vlerëson se nuk ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit, prandaj të pandehurit E.R i ndërprehet paraburgimi për t'u mbrojtur në liri.

Rasti tjetër Pml.nr.282/2022 i datës 18.07.2022, është i rëndësishëm për faktin se bëhet fjalë për të pandehurën të cilës i është vazhduar masa e paraburgimit pa u plotësuar kushtet e kërkuara, me ç‘rast aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe i pandehuri është liruar për tu mbrojtur në liri. Është e rëndësishme të potencohet se në këtë rast në mënyrë tipike pasqyrohet se pesha e veprës penale del të jetë dominonte në marrjen e vendimit të vazhdimit të paraburgimit pa kushte të qarta të paraburgimit, meqë nga vet shkresat e lëndës del se bëhet fjalë për një person e cila për nga karakteristikat e saj personale në asnjë rrethanë nuk do të ikë apo arratiset dhe nuk do të ndikoj në dëshmitar.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 282/2022 i datës 18.07.2022**

Me pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtëses së të pandehurës, S.T-K, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentin i përgjithshëm, P.nr.1299/2022 të datës 07.06.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës -

Departamenti i përgjithshëm PN1.DP.nr.855/2022 të datës 20.06.2022 ashtu që të pandehurës i ndërpritet masa e paraburgimit dhe e njëjta lëshohet menjëherë për tu mbrojtur në liri.

A r s y et i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamentin i përgjithshëm, me aktvendimin, P.nr.1299/2022 të datës 07.06.2022, të pandehurës S.T-K, i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par. 1 të KPRK-së, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi të pandehurës do t'i zgjasë deri më datë 07.08.2022. Të pandehurës masa e paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 193 par.1 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 e 1.2.2 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin PN1.DP.nr.855/2022 e datës 20.06.2022, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurës, dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të pandehurës S.T-K, avokatja F.G-B nga Prishtina, për shkak të shkeljeve të dispozitave të KPPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, që ti ndryshojë aktvendimet e atakuara, ashtu që pandehurës t'ia ndërpres masën e paraburgimit ose në rastin më të pavolitshëm t'ia zëvendësojë me njërën nga masat alternative konform dispozitave të KPPRK-së, siç është arresti shtëpiak.

Prokurori i Shteti të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.97/2022 e datës 15.07.2022, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurës të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara, sepse nga vendimet e kundërshtuara nuk dalin bazat ligjore për të cilat e kanë vazhduar masën e paraburgimit ndaj të pandehurës.

Kjo gjykatë konsideron se nuk qëndron baza ligjore e parashikuar me neni 193 par.1 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pikal.2.1 të KPPK, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës, nuk është gjetur ndonjë rrethanë konkrete e cila do të konfirmonte frikën e bazuar se e pandehura do të ikë apo arratiset, të pandehurës i dihet identiteti, e njëjta ka vendbanim të njohur, është familjare nënë e katër fëmijëve të mitur dhe me asnjë veprim nuk e ka vënë në dyshim prezencën e saj në procedurë.

Nuk qëndron as baza ligjore e parashikuar me dispozitat e nenit 193 par.1 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPPK, sepse siç rezulton nga shkresat e lëndës nuk ka arsye për të besuar se e pandehura do të asgjësojë, fsheh apo ndryshojë provat e veprës penale, nuk qëndron fakti se e pandehura do të mund të ndikojë tek dëshmitarët e përmendur në aktakuzë, sepse provat gjegjësisht deklaratat e tyre ekzistojnë në shkresat e lëndës.

Andaj, kjo gjykatë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtëses së të pandehurës për mbrojtje të ligjshmërisë, vlerësoi se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe e pandehura duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se nuk ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit.

Rasti tjetër Pml.nr.365/2022 i datës 26.09.2022, është i rëndësishëm për faktin se bëhet fjalë për të pandehurin të cilit i është vazhduar masa e paraburgimit disa herë pa u plotësuar kushtet e kërkuara, me ç’rast aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë anuluar dhe i pandehuri është liruar për tu mbrojtur në liri. Është e rëndësishme të potencohet se në këtë rast në mënyrë tipike pasqyrohet se pesha e veprës penale del të jetë dominonte në marrjen e vendimit të vazhdimit të paraburgimit pa kushte të qarta të paraburgimit, meqë nga vetë shkresat e lëndës del se bëhet fjalë për një të pandehur i cili për nga karakteristikat e tij personale në asnjë rrethanë nuk do të ikë pasi që ka vendbanim të njohur e gjithashtu nuk ekziston mundësia e ndikimit në dëshmitar pasi që deklarimet e tyre tani më ishin marrë dhe janë në shkresat e lëndës.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 365/2022 i datës 26.09.2022,**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit H.A, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda nr.2022:043293 të datës 29.07.2022 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda PN1.nr.1002/2022 të datës 05.08.2022, ashtu që ndaj të pandehurit ndërpritet paraburgimi dhe i njëjti lëshohet për tu mbrojtur në liri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin nr.2022:043293 e datës 29.07.2022, të pandehurve: I.M, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale në bashkëkryerje marrja e ryshfetit nga neni 428 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 33 dhe ushtrimi i ndikimit nga neni 431.2 te KPRK, M.Sh, për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 par. 3 lidhur me par. 1 dhe veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.2 te KPRK-se, si dhe H.A, për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.3 lidhur me par. 1 dhe veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par 2 te KPRK-së, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë deri më datë 27.09.2022. Të pandehurve paraburgimi u është vazhduar konform dispozitës së nenit 191 par.1 lidhur me nenin 187 par. 1 nenpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PN1.nr.1002/2022 e datës 05.08.2022, duke vendosur përkitazi me ankesat mbrojtësve të të pandehurve, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat dhe e aktvendimin e shkallës së parë e ka vërtetuar. Kundër aktvendimeve të lartëcekura kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit H.A, avokati N.Q, nga F., për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovohet si e bazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, aktvendimet e atakuara me kërkesë të ndryshohen, ashtu që të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr. 135/2022 e datës

23.09.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në kërkesën e tij thekson se gjykata e shkallës së parë, vazhdimin e paraburgimit nuk e ka bazuar në prova të mjaftueshme dhe se me asnjë provë apo fakt konkret nuk është argumentuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën hetohet, se përgjegjësia penale është individuale dhe provat për të krijuar dyshimin e bazuar i referohen të pandehurit, respektivisht të dyshuarit individualisht. Po ashtu, mbrojtja pretendon se nuk janë plotësuar as kushtet e veçanta për vazhdimin e paraburgimit për çka gjykatat e instancës më të ultë janë marrë me shkeljen e nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPRK-së, për faktin se vetëm është theksuar në shumës (për të pandehurit) se të njëjtit mund të arratisen duke mos cekur ndonjë indicie në drejtim të ikjes dhe se i pandehuri te organet e hetuesisë ditën e ndalimit - arrestimit është paraqitur vullnetar në P,. Pastaj shkelje edhe nga neni 187 par.1 nën par. 1.2 pika 1.2.2 se vetëm thuhet se kanë për tu proceduar 30 dëshmitarë, të cilëve nuk u përmenden fare emrat e që nuk është arsyetim i bazuar ligjor për qëndrim në paraburgim.

Andaj, kjo gjykatë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit për mbrojtje të ligjshmërisë, vlerësoi se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe i pandehuri duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se nuk ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara. Në fakt nga shkresat e lëndës rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprave penale, por kanë pushuari se ekzistuari bazat e artikuleshme apo bazat ligjore për të cilat i është caktuar dhe vazhduar paraburgimi deri më tani.

Kjo gjykatë konsideron se nuk qëndron baza ligjore e parashikuar me neni 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pikal.2.1 të KPPK, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës, nuk është gjetur ndonjë rrethanë konkrete e cila do të konfirmonte frikën e bazuar se i pandehuri do të ikë apo arratiset, të pandehurit i dihet identiteti, i njëjtë ka vendbanim të njohur, është familjare baba i tre fëmijëve dhe me asnjë veprim nuk e ka vënë në dyshim prezencën e tij në procedurë, dhe po ashtu nuk ka arsye për të besuar se i pandehuri do të asgjësojë, fsheh apo ndryshojë provat e veprës penale apo të ndikojë tek dëshmitarët dhe ku qëndron fakti se i pandehuri do të mund të ndikojë tek dëshmitarët edhe të pandehurit tjerë, sepse provat gjegjësisht deklaratat e tyre ekzistojnë në shkresat e lëndës.

Po ashtu, duke pasur parasysh rrethanat personale të të pandehurit se i pandehuri nuk kanë rënë në kundërshtim me ligjin më parë, nuk është i evidentuar për ndonjë procedim penal aktual apo të mëhershëm, nuk rezulton as e bazuar frika për mundësinë e përsëritjes së veprës penale. Edhe sa i përket bazës ligjore të parashikuar me dispozitën e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPPK, e përveç kësaj gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me rastin e vazhdimit të masës së paraburgimit nuk kanë dhënë ndonjë arsye konkrete përpos përshkrimit të veprimeve të të pandehurit.

Rasti Pml.nr.461/2022 i datës 24.11.2022, paraqet një rast tipik ku gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë paraqitur arsyetim bindës për bazat e paraburgimit dhe nuk kanë analizuar faktet vendimtare për caktimin e paraburgimit por kanë bërë një përshkrim formal të shkaqeve dhe kritereve të parashikuara. Për më tepër, janë paraqitur të dhëna të pakonfirmuara dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës dhe arsyetimet janë të natyrës supozuese dhe pa mbështetje në prova konkrete.

Në këtë çështje penale është e rëndësishme të potencohet fakti se bëhet fjalë për një rast që edhe mediat kanë luajtur një rol të madh në vendimin e gjykatave më të ulëta pasi që ka qenë një rast mediatik dhe siç shihet nga arsyetimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore edhe aspekti mediatik ka ndikuar në epilogun e këtij rasti edhe pse në fakt bëhet fjalë për vepër penale relativisht të lehtë dhe pa asnjë bazë për caktim të paraburgimit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 461/2022 i datës 24.11.2022,**

Me pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurës A.R, e sipas detyrës zyrtare edhe për të pandehurat A.P dhe R.K, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm DP.PP.nr. 336/2022 të datës 03.11.2022 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP. nr.1561/2022 i datës 11.11.2022, ashtu që të pandehurave iu ndërpritet masa e paraburgimit dhe lëshohen menjëherë për tu mbrojtur në liri.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin DP.PP.nr. 336/2022 të datës 03.11.2022, të pandehurave A .P, A.R dhe R.K, për shkak dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje sulmi nga neni 184 par. 3 nënpar.3.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së u ka caktuar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e cila sipas këtij aktvendimi do të zgjaste deri me datë 01.12.202, konform nenit 187 par. 1 dhe 2 nënpar. 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPRK-së.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PNIDP.nr. 1561/2022 të datës 11.11.2022, e ka refuzuar ankesën e mbrojtëses së të pandehurës si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurës A.R, av. B.A nga P., për shkak të shkeljes esenciale të ligjit të dispozitave të procedurës penale të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën, aktvendimet e atakuara të ndryshohen dhe të pandehurës A.R, t'i ndërpritet masa e paraburgimit për tu mbrojtur në liri.

Prokurori i Shtetit Kosovës, me parashtresën KMLP.III.nr. 162/2021 e datës 23.11.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara, ngase pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurës, kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe e pandehura duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se këto aktvendime janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheq vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tij.

Kjo gjykatë konsideron se nuk qëndron baza ligjore e parashikuar me dispozitat e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPPK, sepse siç rezulton nga shkresat e lëndës nuk ka arsye për të besuar se të pandehurat do të asgjësojnë, fshehin apo ndryshojnë provat e veprës penale, nuk qëndron fakti se të pandehurat do të mund të ndikojnë tek e dëmtuara apo dëshmitarët, sepse provat gjegjësisht deklaratat e tyre ekzistojnë në shkresat e lëndës.

Po ashtu, edhe sa i përket bazës ligjore të parashikuar me dispozitën e nenit 187 par. 1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPPK, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me rastin e caktimit të masës së paraburgimit nuk kanë dhënë ndonjë arsye konkrete përpos përshkrimit të veprimeve të të pandehurave. Kështu, nga shkresat e lëndës del se të pandehurat nuk kanë rënë në kundërshtim me ligjin më parë, nuk janë të evidentuar për ndonjë procedim penal aktual dhe nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë indikacion se me gjetjen e tyre në liri ato do të mund ta përsërisin veprën penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk kanë dhënë arsyetim bindës dhe të qëndrueshëm përkitazi me bazat e paraburgimit. Përkatësisht nuk kanë analizuar në mënyrë faktet vendimtare apo bazat e artikulueshme për caktimin e paraburgimit, për më tepër kanë bërë përshkrim formal të shkaqeve dhe kritereve të parashikuara me ligj, dhe kanë paraqitur të dhëna të pa konfirmuara dhe të cilat bien ndesh me shkresat e lëndës penale pasi që është evidente se dëshmitarja G.N është dëgjuar në cilësinë e dëshmitares, kurse ndikimi në të dëmtuarën është i karakterit abstrakt dhe pa asnjë mbështetje në shkresat e lëndës. Gjithashtu duke vlerësuar arsyetimin e gjykatave respektive përkitazi me nenin 187 par.1 nënpar.1.1 pika 1.2.3 te KPPK-se, është evidente se arsyetimet janë të natyrës supozuese dhe pa

mbështetje në prova konkrete, meqë rreziku i përsëritjes duhet të jetë i konkretizuar dhe i bazuar në prova konkrete dhe në asnjë rrethanë në të dhëna të pakonfirmuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes posaçërisht ka pasur parasysh dhe ka aplikuar nenin 187 të KPPK-së së: "Paraburgimi caktohet vetëm kur përmbushen kushtet e parapare me ligi (përveç dyshimit të bazuar edhe bazat e artikulueshme nga pikat 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të par 1.2 të nenit të lartcekur), dhe në rast se nuk përmbushen këto kushte (165 par.4 i KPP) i pandehuri apo e pandehura lirohet", që nga interpretimi logjik i kësaj dispozite mund të konkludohet se paraburgimi paraqet masën e fundit "ultima ratio" dhe e cila duhet të aplikohet vetëm përjashtimisht dhe nën kushte të përcaktuara dhe të argumentuara.

Edhe përkundër faktit se të pandehurat A.P e R.K nuk kanë ushtruar kërkesa, kjo gjykatë vlerësoi se arsyet për të cilat ka marr vendim në dobi të pandehurës A.R, që nuk janë të natyrës personale shkojnë në dobi edhe të të pandehurave tjera, të cilat nuk kanë parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata konform nenit 397 të KPRK-së, (beneficium cohaesionis) vendosi edhe për këto të pandehura si në dipozitiv të këtij aktgjykimi.

8.3. Komente përmbledhëse të rasteve

Në rastet e paraqitura më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës, kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve dhe kishte ndryshuar aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke i liruar të pandehurit që të mbrohen në liri.

Në këto raste është karakteristike se nuk është përmbushur kushti i dyshimit të bazuar kurse në disa të tjera kushtet e posaçme për caktimin - vazhdimin e paraburgimit dhe vërehet se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore nuk e kanë pasur vëmendjen e duhur me rastin e vazhdimit të masave të paraburgimit. Për më tepër, në dy raste specifike vërehet qartazi se përkundër faktit se nuk ka ekzistuar as edhe një bazë e vetme për caktimin - vazhdimin e masës së paraburgimit, kjo masë është vazhduar me një ndikim mjaft të lartë të mediave pasi që këto raste kanë qenë mjaft mediatike.

9. Rastet kur Gjykata Supreme e Kosovës ka bërë ndryshimin e vendimeve të dy instancave më të ulëta gjyqësore tek vazhdimi i paraburgimit, vendimet janë ndryshuar duke caktuar masë më të butë

9.1. Dispozitat ligjore

Neni 173[167]

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit

Me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t'i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa më e butë.

Këto masa hiqen kur pushojnë shkaqet që i kanë shkaktuar, apo zëvendësohen me masa të tjera më të buta po qe se për këtë plotësohen kushtet.

Para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr kryetari i trupit gjykues, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod.

Shprehja "masë më e butë për të siguruar praninë e të pandehurit" apo "masa më të buta" për qëllim të këtij kodi nënkupton thirrjen, premtimin e të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitjen në stacionin policor, dorëzaninë, arrestin shtëpiak dhe diversionin.

9.2. Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore të lartcekura

[167] Duhet theksuar faktin se në këtë punim është përdorur si referencë dispozitat e Kodit nr. 04/L-123, meqë shumica e vendimeve të analizuara janë me këtë Kod, mirëpo edhe dispozitat e nenit 171 par.2,3, 4 dhe 5 të Kodit Nr.08/L-082 janë të ngjashme me dispozitat e Kodit të mëparshëm.

Në këtë pjesë të punimit do të trajtohen vendime të cilat janë ndryshuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe me këtë rast është zëvendësuar masa më e rëndë përkatësisht masa e paraburgimit me një masë më të butë. Ligjvënësi në dispozitat e cekura më lartë ka vënë dy parakushte në rastet kur gjykata shqyrton kërkesën e prokurorit për masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit dhe atë: së pari të të shqyrtoj parimin e proporcionalitetit dhe të zbatoj masat më të buta kur do të arrinin qëllimin për të cilën caktohen. Pra është parim i përgjithshëm që në këto raste të shqyrtohen gjithmonë masat tjera dhe nëse ato nuk janë të mjaftueshme pastaj të caktohet masa e paraburgimit si masë më e rëndë dhe e fundit për sigurimin e pranisë së së pandehurit gjatë procedurës penale.

Kurse parimi i dytë dhe mjaft i rëndësishëm është se masa e paraburgimit duhet të jetë sa më e kufizuar dhe e njëjta të hiqet, përkatësisht të zëvendësohet me masë tjetër më të butë në momentin e parë kur për këtë të krijohen kushtet.

Konsiderojmë se këto dy parime nuk janë trajtuar me shumë kujdes dhe shpesh herë edhe pse në fakt kanë pushuar shkaqet e caktimit të paraburgimit dhe kanë pushuar ato shkaqe në ndërkohë, megjithatë është vazhduar me masën e paraburgimit e që kjo është arsyeja që shpesh herë edhe Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar masën e paraburgimit me masë më të butë me qëllim të krijimit të një praktike uniforme dhe e cila duhet të zbatohet edhe nga instancat më të ulëta të gjyqësorit.

Në dispozitën e nenit 173 par.4 dhe 5 është përcaktuar kompetenca e gjyqtarit që vendosë përkitazi me këto masa, si dhe sqarimin se cilat janë masat më të buta të cilat mund të zbatohen karshi masë së paraburgimit.

Për ilustrimin e kësaj pjese do të paraqiten disa raste nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës duke filluar me rastin Pml.nr.322/2019 i datës 30.10.2019, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë ndryshuar dhe të pandehurës i është ndryshuar masa e paraburgimit me masë më të butë, përkatësisht me masën e arrestit shtëpiak duke i përcaktuar kushte të veçanta të cilave detyrohet tu përmbahet gjatë kësaj mase.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 322/2019 i datës 30.10.2019**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurës A.S, ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.265/2019 të datës 12.10.2019 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN1.nr.1192/2019 të datës 17.10.2019, ashtu që të pandehurës i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtës i caktohet masa e arrestit shtëpiak, e cila masë do t'i zgjasë deri me datën 10.11.2019.

II. E pandehura A.S, nuk guxon të largohet nga vendbanimi i sajë në rrugën N., nr.. V., P., pa lejen e gjykatës,

III. Obligohet Stacioni Policor më i afërt që të bëjë zbatimin, mbikëqyrjen dhe verifikimin e masës së arrestit shtëpiak,

IV. Gjykata mund të caktojë masën e paraburgimit nëse e pandehura nuk e respekton këtë aktgjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.265/2019 të datës 12.10.2019, të pandehurës A.S për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 165 par.2 lidhur me par. 1 KPRK, ia ka caktuar masën e paraburgimit nga data 10.10.2019. Masa e paraburgimit i është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN. 1.nr.1192/2019 të datës 17.10.2019, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve A.S, S.S dhe J.Sh, dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurës A.S av. B.C, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPP dhe për shkak të vendimit mbi caktimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara ashtu që e pandehura të lirohet nga paraburgimi apo t'i caktohet ndonjë masë e butë.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurës thekson se aktvendimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që janë të pakuptueshme, kundërthënëse dhe nuk kanë arsyetim të duhur ligjor, Gjykatat nuk kanë arsyetuar rrezikun e ikjes, pengimin e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Gjykata nuk kanë dhënë arsyetim për masat alternative përpos paraburgimit, parimisht dhe duke u bazuar nga praktika dhe standardet e vendeve të zhvilluara ku në vend të masës më të ashpër mund të vendosin edhe masa tjera alternative për sigurimin e prezencës së të pandehurës në procedurën penale.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.91/19 të datës 28.10.2019, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurës të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurës, vlerësoi se në rastin konkret nuk është i arsyeshëm caktimi i masës së paraburgimit ndaj të pandehurës, si masë më e rëndë për sigurimin e prezencës së të pandehurës në procedurë penale, edhe pse ekzistojnë kushtet e parapara me nenin 187 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, ndërsa masa e paraburgimit caktohet vetëm nëse asnjë nga masat alternative nuk mund të jenë efektive në aspektin e parandalimit të ikjes, ndikimit në dëshmitarë, të dëmtuar, përsëritjes së veprës penale dhe zhvillimit të pa penguar të

procesit penal, e që një situatë e tillë në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, mund të arrihet edhe me masën arrestit shtëpiak.

Bazuar në këtë Gjykata Supreme vendosi që masën e paraburgimit ta zëvendësoi më masën e arrestit shtëpiak duke i urdhëruar dhe ndaluar të pandehurës që të mos largohet nga vendbanimi i saj, në P, ndërsa përjashtimisht e pandehura mund të largohet nga vendbanimi i sajë vetëm në raste të domosdoshme për përmbushjen e nevojave jetësore respektivisht mjekësore apo kryerjen e ndonjë pune me rëndësi, mirëpo së pari për këtë duhet kërkuar leja e gjykatës.

E pandehura paralajmërohet se në rast se pa leje e shkel këtë masë ndaj sajë gjykata mund të caktojë masën e paraburgimit. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj mase do ta bëjë policia.

Në rastin në vijim do të paraqitet rasti Pml.nr.505/2022 i datës 23.12.2022, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë ndryshuar dhe të pandehurit i është shqiptuar masa e arrestit shtëpiak me detyrime të caktuara.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 505/2022 i datës 23.12.2022**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit A.J, ndryshohet aktvendimi të Gjykatës Themelore Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda 2022:136710 të datës 02.12.2022 dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1DKR.nr.1618/2022 të datës 09.12.2022, ashtu që të pandehurit A.J, masa e paraburgimit i zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak, e cila masë do t'i zgjasë deri më 04.02.2023.

II. I pandehuri nuk guxon të largohet nga shtëpia e tij ku jeton, përveç me leje të posaçme të gjykatës.

III. Gjykata mund të caktojë masën e paraburgimit nëse i pandehuri nuk e respekton këtë aktvendim.

IV. Stacioni Policor në M., detyrohet që të bëjë zbatimin, mbikëqyrjen dhe verifikimin e masës së arrestit shtëpiak për të pandehurit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda me aktvendimin 2022:136710 të datës 2.12.2022, të pandehurit A.J, për shkak të të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila sipas këtij aktvendimi do t'i zgjasë deri më datën 04.02.2023, konform nenit 187 par. 1 dhe 2 pika 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1.nr.1618/2022 e datës 9.12.2022, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit, av. M.P, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale, për shkak të shkeljes së dispozitave tjera të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që të pandehurit t'i ndërpritet paraburgimi dhe i njëjti të mbrohet në liri ose t'i caktohet masa e arrestit shtëpiak.

Prokurori i Shtetit Kosovës, me parashtresën KMLP.III.nr.186/2022 e datës 21.12.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale dhe pas vlerësimit të pretendimeve gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi thekson se si gjykata e shkallës së parë edhe ajo e shkallës së dytë nuk i kanë arsyetuar aktvendimet e atakuara për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit, duke theksuar se të njëjtat janë marrë me shkelje të dispozitave esenciale të procedurës penale, për shkak se nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet për vazhdimin e masës ë paraburgimit dhe se masa e caktuar ndaj të pandehurit, si masë shumë e rëndë e joproporcionale, është e pabazuar dhe e nxjerr në bazë të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, për faktin se i pandehuri nuk ka asnjë lidhje me të dëmtuarin. Pra mbrojtësi e konteston dyshimin e bazuar duke thënë se i njëjti nuk është arsyetuar dhe nuk kuptohet saktësisht se në çfarë prova është mbështetur. Gjithashtu sipas mbrojtësit nuk janë plotësuar kushtet ligjore konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, ngase gjykata nuk ka dhënë arsyetimet e duhura, por vetëm janë parafrazuar dispozitat ligjore, në lidhje me përsëritjen e veprës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit, vendosi se në rastin konkret nuk është i arsyeshëm vazhdimi i paraburgimit ndaj të pandehurit si masë më e rëndë për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale, edhe pse ekzistojnë kushtet të parapara me nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale. Nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka ndonjë rrethanë konkrete apo të posaçme që e tregon se i njëjti do të arratiset, do të pengojë rrjedhën e procedurë penale apo do të përsërit veprën penale, andaj kjo gjykatë vlerëson se edhe me masën e arrestit shtëpiak, mund të sigurohet prania e të pandehurit në procedurë, ndërsa masa e paraburgimi caktohet/vazhdohet vetëm nëse asnjë nga masat alternative nuk mund të jenë efektive në aspektin e parandalimit të arratisjes apo përsëritjes së veprës penale dhe zhvillimit të pa penguar të procesit penal, e që një situatë e tillë në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk ekziston.

Bazuar në këtë Gjykata Supreme vendosi që masën e paraburgimit ta zëvendësoi më masën e arrestit shtëpiak konform dispozitës së nenit 183 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar. 1 e 2 pika 1.2.3 të KPRK-së, duke marr parasysh se familjet janë pajtuar në mes veti, nga se në shkresat e lëndës ekziston një procesverbal i pajtimit në mes familjeve i datës 28.07.2022. I pandehuri paralajmërohet se në rast se pa leje e shkelin këtë masë, ndaj tij gjykata mund të caktojë paraburgimin.

Për ilustrimin e kësaj dispozite ligjore do të paraqitet rasti Pml.nr.325/2022 i datës 22.08.2022, ku aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore janë ndryshuar dhe të pandehurit i është shqiptuar masa e arrestit shtëpiak me detyrime të caktuara.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 325/2022 i datës 22.08.2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit F.K, ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë –Departamenti i Përgjithshëm PP. nr. 60/2022 i datës 02.08 2022 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP. Nr.1095/2022 i datës 10.08.2022, ashtu që të pandehurit F.K masa e paraburgimit i zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak, e cila masë do të zgjas deri më datë 02.09.2022.

I pandehuri nuk guxon të largohet nga shtëpia e tij ku jeton në fshatin L., Komuna e M., përveç me leje të posaçme të gjykatës.

Gjykata mund të caktojë masën e paraburgimit nëse i pandehuri nuk e respekton këtë aktgjykim, kurse Stacioni Policor në M., detyrohet që të bëje zbatimin, mbikëqyrjen dhe verifikimin e masës së arrestit shtëpiak.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PP.nr.60/2022 të datës 02.8.2022, të pandehurit F.K, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi të pandehurit do t'i zgjasë deri me datën 02.9.2022. Të pandehurit masa e paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 187 par.1 nenpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 e 1.2.3 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PNIDP.nr.1095/2022 të datës 10.8.2022 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit F.K, av. B.K, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar, aktvendimet e kundërshtuara t'i ndryshojë ashtu që të pandehurin ta lirojë nga paraburgimi apo masa e paraburgimit t'i zëvendësohet me masën e lajmërimit në stacion policor.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.III.nr. 120/2022 e datës 18.08.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjigjjes në kërkesë dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit konsideron se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë rrethana që e bëjnë të arsyeshëm vazhdimin e paraburgimit, paraburgimi të pandehurit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 187 par.1 e 2 pika 1.2.2 dhe .1.2.3 të KPP, por nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë rrethana që paraqesin rrezik që të ndikojë në dëshmitarë e sidomos në ekspertizën mjeko-ligjore nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe as që mund ta përsërisë veprën penale, ngase me të dëmtuarin janë pajtuar dhe nuk kanë mosmarrëveshje.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e mbrojtësit sa i përket shqiptimit të masës më të butë për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë të bazuara. Në fakt, nga shkresat e lëndës,

rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryes i veprës penale për të cilën dyshohet dhe se vazhdojnë të qëndrojnë bazat ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1 e 2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP, duke marr parasysh faktin se hetimet ende vazhdojnë por mundësia e ndikimit është inferiore pasi që ekspertizën mjeko-ligjore e bën një institut i pavarur si dhe nuk ka edhe rrezik evident të përsëritjes së veprës penale sepse nuk ekzistojnë rrethana konkrete që e arsyetojnë këtë rrezik.

Në rastin Pml.nr.309/2022 të datës 08.08.2022, Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore dhe të pandehurit i është shqiptuar masa e paraqitjes në stacionin policor arrestit shtëpiak, meqë asnjë rrethanë konkrete nuk është theksuar se do ta bënte të besueshëm rrezikun e ikjes, përkatësisht edhe përmes kësaj mase do të mund të sigurohej prezenca e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 309/2022 i datës 08.08.2022**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit G.S, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPR.nr.319/2022 të datës 20.6.2022 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës. PN.1.nr.811/2022 të datës 29.06.2022, ndryshohen ashtu që ndaj në pandehurit G.S ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtit i caktohet masa e paraqitjes në Stacionin Policor, e cila masë sipas këtij aktgjykimi do t'i zgjas deri më 21.08.2022.

II. Detyrohet i pandehuri G.S, që të lajmërohet në stacionin policorë më të përafërt të vendbanimit vendqëndrimin të tij, 2 (dy) herë në javë, çdo të hënë dhe të premte në ora 10:00.

III. Gjykata mund ti caktojë paraburgimin nëse i pandehuri nuk e respekton këtë aktgjykim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPR.nr.319/2022 të datës 20.06.2022 të pandehurit G.S,, për shkak të veprave penale: rrëmbimi në tentativë nga neni 191 par.1 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

(KPRK-së), mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 dhe veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 par.1 i KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, i cili do të zgjasë deri me datën 21.08.2022, konform nenit 187 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me PN.1.nr.831/2022 29.6.2022, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit, G.S, av.S.M nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitës të procedurës penale nga neni 187 par.1 nën par 1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3, nenit 5 par.3 dhe nenit 185 par.2 të KPPR-së të KPPRK-së, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të ndryshoj aktvendimet e atakuara me kërkesë, ashtu që të pandehurit t'i hiqet masa e paraburgimit dhe të njëjtin ta liroj që të mbrohet në liri.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.113/22 të datës 04.08.2022, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit G.S,, në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se aktvendimet e atakuara janë marrë me shkelje të ligjit penal, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e kjo rezulton me shkelje të të drejtave të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të drejtat themelore të parapara me Kodin e procedurës penale, andaj konsiderojmë

se aktvendimet e atakuara me kërkesë janë të kundërligjshme prandaj të njëjtat i kundërshton nga arsyet si në vijim.

Se nga provat e propozuara me aktakuzë nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat për të cilat akuzohet, dhe se marrja e vendimit nga gjykata e shkallës së parë për hudhjen e përsëritshme të akuzës dhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në favor të pandehurit për veprën penale të narkotikëve nga neni 269 par. 1, 1 KPK-së në veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni, kjo nuk e justifikon në asnjë mënyrë ekzistimin e mundësisë së ikjes – arratisjes së të pandehurit për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, siç ka gjetur gjykata e shkallës së parë me rastin e vazhdimit të paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës, e as rreziku i përsëritjes së veprës penale duke pasur parasysh ndryshimin e rrethanave që janë me rëndësi për vendosje lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit, mbrojtja konsideron se tani në këtë fazë të procedurës kanë pushuar së ekzistuari.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit, vendosi se në rastin konkret nuk është i arsyeshëm vazhdimi i paraburgimit ndaj të pandehurit si masë më e rëndë për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale, edhe pse ekzistojnë kushtet të parapara me nenit 187 par. I neni par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, të Kodit të Procedurës Penale. Nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka ndonjë rrethanë konkrete apo të posaçme që e tregon se të njëjti do të arratisen me çka do të pengojë rrjedhën e procedures penale në këtë çështje penale, andaj kjo gjykatë vlerëson se edhe me masën e paraqitjes në Stacionin Policor mund të sigurohet prania e të pandehurit në procedurë, ndërsa masa e paraburgimit caktohet/vazhdohet vetëm nëse asnjë nga masat alternative nuk mund të jenë efektive në aspektin e parandalimit të arratisje dhe zhvillimit të pa penguar të procesit penal, e që një situatë e tillë në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk ekziston.

Bazuar në këtë Gjykata Supreme vendosi që masën e paraburgimit ta zëvendësojë me masën e paraqitjes në Stacionin më të afërt Policor, duke e urdhëruar të pandehurin që të paraqitet 2 (dy) herë në javë, çdo të hënë dhe të premte në ora 10:00 tek stacioni policor në rajonin ku i pandehuri e ka vendbanimin apo vendqëndrimin.

Po ashtu edhe në rastin në vijim Pml.nr.304/2022 të datës 04.08.2022, Gjykata Supreme e Kosovës ka ndryshuar aktvendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore dhe të pandehurit i është shqiptuar masa e paraqitjes në stacionin policor, meqë asnjë rrethanë konkrete nuk është theksuar se do ta bënte të besueshëm rrezikun e ikjes, përkatësisht edhe përmes kësaj mase do të mund të sigurohej prezenca e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe gjithashtu meqë bëhet fjalë për person shtetas të huaj është bërë edhe konfiskimi i dokumentit të udhëtimit – pasaportës si heqje e mundësisë së ikjes së të pandehurit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 304/2022 i datës 04.08.2022**

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit O.J, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PR.nr.221/2021 të datës 06.06.2022 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.760/2022 të datës 10.06.2022, ndryshohen ashtu që ndaj të pandehurit O.J, ndërpritet masa e paraburgimit dhe caktohet masa e paraqitjes në Stacionin Policor, e cila masë sipas këtij aktgjykimi do t'iu zgjas deri me 06.08.2022.

Detyrohet i pandehuri O.J, që të lajmërohet në stacionin policor më të përafërt vendbanimit të tij 2 (dy) herë në javë, çdo të hënë dhe të premte në ora 10:00.

Të pandehurit përkohësisht i konfiskohet dokumenti i udhëtimit- pasaporta. Gjykata mund të caktojë paraburgimin nëse i pandehuri nuk e respekto këtë aktvendim.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPR.nr.221/2021 të datës 06.06.2022 të pandehurit O.J, për shkak të veprës penale shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 228 të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, i cili do të zgjasë deri me datën 6.8.2022, konform nenit 187 par. I nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me PN.1.nr.760/2022 të datës 10.06.2022, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit, av.G.C, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitës ligjore nga neni 187 të KPPK, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të prishen aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që të pandehurit t'i caktohet një masë tjetër më e butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr. 110/22 të datës 01.08.2022, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës dhe gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi thekson se si gjykata e shkallës së parë edhe ajo e shkallës së dytë nuk i kanë arsyetuar aktvendimet e atakuara për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit, duke theksuar se të njëjtat janë marrë me shkelje të dispozitave esenciale të procedurës penale, për shkak se nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet për vazhdimin e masës së paraburgimit dhe se masa e caktuar ndaj të pandehurit, si masë shumë e rëndë dhe jo proporcionale, është e pabazuar dhe e nxjerr në bazë të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, për faktin se i pandehuri nuk ka asnjë lidhje me të dëmtuarën. Pra mbrojtësi e konteston dyshimin e bazuar duke thënë se i njëjti nuk është arsyetuar dhe nuk kuptohet saktësisht se në çfarë prova është mbështetur. Gjithashtu sipas mbrojtësit nuk janë plotësuar kushtet ligjore konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1.e.1.2 pika 1.2.1, dhe 1.2.3 të KPPK-së, ngase gjykata nuk ka dhënë arsyetimet e duhura, por vetëm janë parafrazuar dispozitat ligjore, në lidhje me rrezikun e ikjes dhe përsëritjes së veprës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoj shkresat e lëndës vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit, vendosi se në rastin konkret nuk është i arsyeshëm vazhdimi i paraburgimit ndaj të pandehurit si masë më e rëndë për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale, edhe pse ekzistojnë kushtet të parapara me nenit 187 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale. Nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka ndonjë rrethanë konkrete apo të posaçme që e tregon se i njëjti do të arratiset, do të pengojë rrjedhën e procedurë penale apo do të përsërit veprën penale, andaj kjo gjykatë vlerëson se edhe me masën e paraqitjes në Stacionin Policor, mund të sigurohet prania e të pandehurit në procedurë, ndërsa masa e paraburgimi caktohet/vazhdohet vetëm nëse asnjë nga masat alternative nuk mund të jenë efektive në aspektin e parandalimit të arratisjes apo përsëritjes së veprës penale dhe zhvillimit të pa penguar të procesit penal, e që një situatë e tillë në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk ekziston.

Bazuar në këtë Gjykata Supreme vendosi që masën e paraburgimit ta zëvendësoi më masën e paraqitjes në Stacionin më të afërt Policor, duke e urdhëruar të pandehurin që të paraqitet 2 (dy) herë në javë, çdo të hënë dhe të premte në ora 10:00 tek stacioni policor në rajonin ku i pandehuri e ka vendqëndrimin

I pandehuri paralajmërohet se në rast se pa leje e shkelin këtë masë, ndaj tij gjykata mund të caktojë paraburgimin.

9.3. Komente përmbledhëse të rasteve

Në rastet e paraqitura më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës, kishte miratuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve dhe kishte ndryshuar aktgjykimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore dhe kishte ndryshuar masën e paraburgimit me masa më të buta duke zbatuar pikërisht kërkesat e dispozitës se nenit 173 par.2 dhe 3 të KPP-së, meqë në këto raste por edhe shumë raste të tjera nga praktika gjyqësore del se gjykatat e nivelit më të ulët nuk po tregojnë fleksibilitet në trajtimin e këtyre masave dhe në momentin e caktimit të një mase pastaj me automatizëm po vazhdohet kjo masë e paraburgimit, përkundër faktit se këto masa duhet të

trajtohen me seriozitet dhe në momentin e pushimit të arsyes për aplikimin e tyre të njëjtat të hiqen apo zëvendësohen me masa më të buta.

Karakteristikë e këtyre aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës është fakti se zëvendësimi i masës së paraburgimit është bërë pas disa vazhdimeve dhe kjo tregon se në këtë aspekt duhet të shtohet kujdesi i trajtimit më me seriozitet i këtyre rasteve, meqë edhe sipas dispozitave ligjore por edhe praktikës gjyqësore, masa e paraburgimit duhet të jetë masa e fundit dhe e cila në momentin e parë duhet të hiqet apo duhet të zëvendësohet me masë më të butë.

KAPITULLI V

5.1.KËRKESA PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË

1. Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Fillimisht duhet të ceket se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konform nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale (i cili ka hyrë në fuqi me 17 mars 2023) parasheh një ndryshim në raport me Kodin e Procedurës Penale i cili ka qenë fuqi deri me këtë datë, dhe atë sa i përket konstatimit të shkeljes së ligjit në dobi të pandehurit. Kështu deri më tani Gjykata Supreme, deri në hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale dhe sipas dispozitave të parapara për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka pas këto mundësi:

1. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:
1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;
1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose
1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.

2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë.
Ndërsa me hyrjen në fuqi të Kodit të ri ,është ndryshuar dispozita e nenit 438 paragrafi 2 dhe tani në vazhdim të kësaj dispozite thuhet “përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”, që paraqet një mundësi të re, për të cilën Gjykata Supreme i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese që të jep mendimin e vet, andaj edhe në vazhdim

do t'i referohemi aktgjykimeve të cilat janë marrë deri në hyrje në fuqi të Kodit të Procedurës Penale dhe dispozitave të nenit 438 sipas kodit të mëparshëm[168].

Pra, deri më tani aktgjykimi i Gjykatës Supreme me të cilin është konstatuar shkelja e ligjit në favor të pandehurit, ka pas karakter deklarativ me të cilin nuk është prek forma e prerë e aktgjykimit kundër të cilit është paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Pra, kjo vendoset kur kërkesa aprovohet si e bazuar në dëm të pandehurit dhe pa marrë parasysh peshën e shkeljes (edhe ato më të rëndat), të njëjtat nuk mund të rikuperohen me aktgjykim me të cilin vetëm konstatohet shkelja, duke mos e prek formën e prerë.

Aktgjykimi deklarativ ka për qëllim që nëpërmjet të specifikimit të shkeljeve të krijoj një praktik unike dhe t'i evitoj shkeljet në të ardhmen nga gjykatat e shkallëve më të ulëta. Pra, Gjykata Supreme në praktikën e saj të deritashme ka hasur në një numër të konsiderueshëm të çështjeve penale ku është konstatuar se është shkel ligji në favor të pandehurve e të cilat do të paraqiten më poshtë.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 30/2018, i datës 30 prill 2018.**

Në këtë pjesë do të paraqitet aktgjykimi, ku Gjykata Supreme, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit, ka aprovuar të njëjtën dhe ka konstatuar shkelje në dobi të pandehurit, e duke u nisur nga fakti se të dy gjykatat gabimisht kanë vlerësuar gjendjen faktike e cila drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar.

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit konstatohet se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 94/2017 datë 21.09.2016 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr. 517/2017 datë 04.10.2017, janë shkelur dispozitat e procedurës penale nga neni 432 par. 1 pika 1.3 dhe nenit 433

[168] Megjithëse ky doracak ka filluar deri sa në zbatim është Kodi i Procedurës Penale –Kodi nr.08/L-032, kurse vendimet janë marrë nga Kodi i Procedurës Penale Kodi nr. 04/L-123 që ka qenë në fuqi, atëherë referencat ligjore do të jenë në Kodin aktual duke pasur si referencë edhe dispozitat e Kodit paraprak.

par. 1 dhe 2 të KPPK-së dhe të ligjit penal nga neni 383 par. 1 nën par. 2 dhe neni 385 të KPPK-së në dobi të të pandehurit L.M.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 94/2017 datë 21.09.2016, i pandehuri L.M është liruar nga akuza në mungesë të provave, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par. 1 të KPK. I dëmtuari M.O është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr. 517/2017 datë 4.10.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore Gjilan, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par. 1 pika 1.3 dhe nenit 433 par. 1 dhe 2 të KPPK dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 383 par. 1 nën par. 2 dhe neni 385 të KPPK, me propozim që të aprovohet si e bazuar kërkesa dhe të konstatohet se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal në dobi të të pandehurit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes e në kuptim të dispozitës së nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga Prokurori i Shtetit është e bazuar.

Në kërkesën e paraqitur, KMLP.1.nr.1/2018 datë 16.1.2018, Prokurori i Shtetit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, të cilat konsistojnë në faktin se dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë janë në kundërshtim me njëri - tjetrin, me procesverbalet

e shqyrtimit gjyqësor dhe me shkresat tjera të dosjes penale. Si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë provat e siguruara gjatë hetimit të kësaj çështjeje dhe të administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk i ka vlerësuar drejt dhe për shumë fakte vendimtare nuk janë dhënë arsye ligjore. Kjo sidomos sa i përket deklaratës së të dëmtuarit M.O, dhënë në hetime dhe në shqyrtimin gjyqësor dhe në lidhshmëri me dëshmitë dhe provat tjera. Në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit lidhur me këtë deklaratë thuhet: "Deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit M.O e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor është kontradiktore, ngase ai fillimisht në Prokurori kishte deklaruar se i pandehuri asnjëherë direkt nuk i kishte kërkuar të holla ...", por në të vërtetë i dëmtuari gjatë hetimeve në deklaratën e tij dhënë para prokurorit ka theksuar se pasi që janë marrë vesh me të pandehurin që nënën ta bëjë operacion në Klinikën e Qytetit, ai i ka kërkuar 500 € për pej dhe 500 € tjera i duhen "me i qaros disa kolegë të mi dhe nuk po mbet kurrgjë", e kur i dëmtuari e pyet " a janë boll 1.000 €" i pandehuri i përgjigjet përsëri "veç për penj duhen 500 €". Kjo dëshmi është plotësisht e pranueshme, kredibile dhe provë e drejtpërdrejt e cila vërteton në tërësi përgjegjësinë penale të të pandehurit. Që të dy gjykatat, kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që gabimisht e kanë shpall deklaratën e tillë si kontradiktore dhe jokredibile duke mos dhënë arsyetim se pse kjo dëshmi është jo e besueshme. Edhe sa i përket ligjit penal që të dy gjykatat e kanë shkel të njëjtin në dobi të pandehurit duke ardhur në përfundim se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale që i vihej në barrë me aktakuzë. Sipas dispozitës së nenit 428 par. 1 të KPK-së, (marrja e ryshfetit) këtë vepër penale e kryen "personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër...", pra në rastin konkret i pandehuri me veprimet e veta me vetë faktin që nga i dëmtuari M.O, ka kërkuar para (500 € për penj dhe 500 € për mjekë të tjerë dhe që nuk po i mbetet asgjë tjetër), vërteton se i njëjti ka kërkuar diçka edhe më shumë edhe pse në kuadër të autorizimeve të veta si mjek është dashur të kryejë veprim duke përfshirë edhe ndërhyrjet kirurgjikale, dhe me këtë ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 të KPK-së.

Gjykata Supreme duke i vlerësuar pretendimet e cekura në kërkesën e Prokurorit të Shtetit gjen se të gjitha pretendimet janë të qëndrueshme, kështu nga shkresat e çështjes nuk është kontestuese se i pandehuri L.M- mjek kirurg në Spitalin Regjional të Gj., në kuadër të autorizimeve të tij si mjek – person zyrtar ka pas edhe kryerjen e shërbimit - operimeve të pacientëve të cilët lajmërohen në këtë spital. Po ashtu, nuk është kontestuese se i dëmtuari M.O, ka sjell nënën e tij F.O, dhe se pas

kontrolleve të cilat janë bërë fillimisht në Spitalin e Gj., e pastaj në ordinancën private të L.M, i njëjti më datë 28.10.2013 ka pasur që ta operoj nënën e të dëmtuarit, F.O, dhe për këtë paraprakisht, në ordinancën private të tij, kishte kërkuar nga i dëmtuari 500 € , sipas deklaratës së të dëmtuarit për penj dhe 500 € të tjera për disa mjek tjerë specialist nga P., sepse në Gj., nuk ka mjek që kryejnë këtë operacion, ndërkaq kishte deklaruar edhe se pasi që t'i kryen të gjitha këto nuk po mbetet asgjë. Është e vërtetë se i dëmtuari M.O në deklaratën e tij dhënë në Prokurori më datë 04.11.2013 deklaron se "nuk ka mund me lyp para direkt sepse ne ishim pacient të tij dhe atë natë unë i kam thënë: a janë boll me ti dhanë unë ty 1.000 € dhe i pandehuri është përgjigj "se ato pare nuk janë asgjë sepse 500 € janë për penj dhe 500 € të tjera unë duhet me i qaros do kolegë të mijë dhe nuk po mbesin asgjë" por deklarata e tij e cituar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është nxjerr nga kontesti i deklaratës së tij dhënë në Prokurori sepse nga tërë deklarata e tij rrjedh se i pandehuri nuk i ka kërkuar drejtpërsëdrejti ryshfet për kryerjen e operacionit por në mënyrë të tërthortë ia ka bërë me dije se 1.000 € nuk mjaftojnë prandaj edhe i dëmtuari pasi që në familje kishte marrë pëlqimin edhe të tjerëve ka vendosur që t'ia jep 1.500 deri në 2.000 € dhe sipas deklaratës kjo edhe ishte kërkesa e tij (të pandehurit) dhe për ta vërtetuar këtë dyshim i pandehuri i ka thënë se "herë bëhet ky operacion këtu e herë nuk bëhet e kur të bëhet duart e mija e bëjnë". Që të dy gjykatat kanë dështuar që të japin arsyetim ligjor se pse nuk i kanë besuar deklaratës së dëshmitarit M.O përkundër faktit se kjo është vërtetuar edhe me deklaratën e dëshmitarit policit Sh.H, i cili ka pohuar se i dëmtuari M.O në mëngjesin e datës 28.10.2013 ka ardhur në polici dhe ka njoftuar se një mjek nga Spitali Regjional për me e krye operacionin e nënës së tij ia ka kërkuar 1.500 €. Fakti se plani operativ për simulimin e veprës penale të korrupsionit, regjistrimi në procesverbal, skanimi i parave-bankënotave dhe i tërë simulimi i veprës penale të marrjes së ryshfetit janë shpallur pastaj si prova të papranueshme me aktvendimin e Gjykatës Themelore Gjilan, PKR.nr. 663/2013 datë 18.04.2014, nuk e ndryshon faktin se i dëmtuari ka paraqitur rastin në Policinë Regjionale të Gj..

Nga shkresat e çështjes po ashtu qëndron se në dobi të të pandehurit L.M është shkelur ligji penal kur të dy gjykatat kanë gjetë se në veprimet e të njëjtit nuk formohen elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par. 1 të KPK, e duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit M.O, se i njëjti asnjëherë direkt nuk i ka kërkuar paratë. Duke u nisur nga fakti se konform dispozitës së nënti 428 par. 1 të KPK, vepra penale e marrjes së ryshfetit mund të kryhet duke kërkuar para

direkt apo në mënyrë të tërthortë ndërsa në rastin konkret nga provat të cilat gjenden në shkresat e çështjes në mënyrë të pa dyshuar vërtetohet se i pandehuri në mënyrë të tërthortë ka kërkuar para për veprimet të cilat si mjek është dashur t'i kryejë në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tij, andaj edhe rrjedhimisht është shkel ligji penal në dobi të të njëjtit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 79/2022 i datës 08.04.2020**

Në këtë pjesë do të paraqitet aktgjykimi ku Gjykata Supreme ka aprovuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës dhe ka gjetë se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje të ligjit penal në favor të pandehurve. Pra , Gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të zbatojnë kualifikimin në fjalë por është dashur të refuzohet kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe të mbahet seanca lidhur me këtë çështje penale, ngase faktet në vetë aktakuzën tregojnë se kualifikimi juridik i veprës penale është dashur të bëhet sipas nenit 188 para.2 lidhur me par.1 pika 1.4 dhe nenit 31 të KPRK. Po ashtu, duhet të theksohet se gjykatat nuk janë të lidhura me propozimin e prokurorit e as me kualifikimin juridik por duhet vet të vlerësojnë në bazë të provave dhe rrethanave të gjendjes faktike të cilën e vërtetojnë në seancë gjyqësore apo si në rastin konkret nga shkresat e çështjes.

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, konstatohet se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.nr.4339/2019 i datës 03.12.2019 është marrë me shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.4 të KPPK-së në favor të dënuarve V.I., I.I., F.H. dhe V.K.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr. 4339/19 e datës 03.12.2019, sipas urdhrit ndëshkimor i ka shpallë fajtor të dënuarit V.I., I.I., F.H., për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK, dhe për këtë vepër penale të dënuarve iu shqipton dënim me gjobë në shumën prej 350 (treqind e pesëdhjetë euro), secilit veç e veç të cilin dënim të dënuarit obligohen ta paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë sëaktgjykimit. Të dënuarin

V.K., për veprën penale lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 390 par.1 të KPRK, i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumën prej 300 (treqind euro), të cilin dënim i dënuari obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.4339/2019 të datës 03.12.2019, Prokurori i Shtetit ka ushtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar, dhe konform nenit 438 par.2 të KPPK, të konstatohet se Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.4339/2019 të datës 03.12.2019, ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në arsyetim të kërkesës thuhet se fillimisht prokuroria e më pas edhe gjykata kanë bërë shkeljen e nenit 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, ngase përshkrimi i dispozitivit të aktakuzës është në kundërshtim me këtë nen. Vepra penale e lëndimit të lehtë trupor mund të kryhet sipas nenit 188 par.1 pika 1.4 të KPRK, ashtu sikur e ka kualifikuar prokuroria e më pas sikur e ka aprovuar edhe gjykata, kur kryhet lëndimi trupor ndaj një personi pa përdorimin e një sendi që mund të shkaktoj lëndimin e rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit. Në aktakuzën PP.II.nr.2023-19 në dispozitivin e aktakuzës qartë precizohet se së paku njëri nga të pandehurit ka përdorur shufrën e metalit me të cilën e ka goditur të dëmtuarin në kokë dhe shpinë. Andaj në momentin që prokuroria e më pas edhe gjykata aprovojnë një përshkrim të tillë të kualifikimit juridik, atëherë më nuk kanë mundur të zbatojnë kualifikimin në fjalë por është dashur të refuzohet dhënia e urdhrit ndëshkimor dhe të mbahet seanca lidhur me këtë çështje penale, ngase faktet në vet aktakuzën tregojnë se kualifikimi juridik është dashur të bëhet sipas nenit 188 par.2 lidhur me para.1 pika 1.4 dhe nenit 31 të KPRK-së.

Më tutje në kërkesë pretendohet se shkelje tjetër që ka ndodhur nga ana e gjykatës dhe që ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, është moszbatimi i nenit 360 par.2 të KPPK-së, fakti se gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës. Andaj, pavarësisht faktit se prokuroria e ka kualifikuar veprën penale sipas nenit 188 par.1 pika 1.4 të KPRK, gjykata do të duhej ta zbatonte drejtë këtë nen të KPRK, dhe ta refuzojë propozimin e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor e të caktoj seancën mbi shqyrtimin fillestar, ku do të jepej kualifikimi i drejtë i veprës penale në bazë të përshkrimit faktik nga aktakuza.

Më tutje, pretendohet se gabimi paraprak me ngritjen e aktakuzës dhe kualifikimi i gabuar juridik i veprës penale, e më pas edhe gabimi tjetër me pranimin e këtij kualifikimi juridik të veprës penale nga ana e gjykatës, ka dërguar në marrjen e një vendimi që ka të bëjë me shkeljen e ligjshmërisë së marrjes së vendimit gjyqësor.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se është i bazuar pretendimi i prokurorit të Shtetit. Nga shkresat e lëndës rezulton, se gjykata e shkallës së parë i ka shpallur fajtor të akuzuarit V.I.,I.I.,F.H., për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe V.K., për shkak të veprës penale lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 390 par.1, të KPRK-së. Në dispozitivin e aktakuzës PP.II.nr.2023-19, qartë precizohet se së paku njëri nga të pandehurit ka përdorur shufrën e metalit me të cilën e ka goditur të dëmtuarin në kokë dhe shpinë. Nga kjo rezulton se përshkrimi i dispozitivit të aktakuzës është në kundërshtim me kualifikimin e veprës për të cilën janë shpallur fajtor të dënuarit. Prandaj nga ky përshkrim, rezulton se është i bazuar pretendimi i prokurorit të shtetit se gjykata nuk kanë mundur të zbatojnë kualifikimin në fjalë por është dashur të refuzohet kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe të mbahet seanca lidhur me këtë çështje penale, ngase faktet në vet aktakuzën tregojnë se kualifikimi juridik i veprës penale është dashur të bëhet sipas nenit 188 para.2 lidhur me para.1 pika 1.4 dhe nenit 31 të KPRK-së.

Për këto arsye, janë të drejta pikëpamjet juridike të Prokurorit të Shtetit të Kosovës se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr. 4339/19 i datës 03.12.2019, përkitazi me të dënuarit, është marrë me shkelje të ligjit penal, nga neni 385 par.1 pika 1.4 të KPPK-së, në favor të dënuarve, për

çka kjo Gjykatë vlerësoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar, kurse konform dispozitës së nenit 438 par.1 pika 1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.161/2019 i datës 11 .07.2019**

Në vazhdim do të prezantohet aktgjykimi, ku të dy gjykatat e instancave më të ulëta në faktet e vërtetuara në mënyrë të drejtë, gabimisht kanë aplikuar ligjin penal në dobi të pandehurit, sepse janë nxjerrë përfundimet e gabuara për ekzistimin e veprës penale. Pra, gjykata e shkallës së parë e cila në shqyrtim gjyqësor ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë , megjithatë gabimisht ka aplikuar ligjin penal duke e liruar të pandehurin nga akuza, ndërsa gjykata shkallës së dytë, edhe pse sipas detyrës zyrtare ka obligim që të vlerësoj shkeljet edhe të ligjit penal, gabimisht i vlerëson të gjeturat e shkallës së parë dhe i vërteton konstatimet e gabuara të saj.

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, konstatohet se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.201/2016 i datës 18.07.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.491/2018 i datës 14.02.2019, janë marrë me shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.4 të KPPK-së, sa i përket veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK-së.

II. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës e ushtruar kundër këtyre aktgjykimeve, në pjesën që ka të bëjë me veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 dhe 2 dhe nënpar.2.1 të KPK-së.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.201/2016 datë 18.07.2018, i pandehuri L.Ç., është liruar nga akuza për veprat penale marrja e ryshfetit nga

neni 428 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 dhe 2 dhe nënpar.2.1 të KPK-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, ndërsa të dëmtuarit për realizimin e kërkesave për dëmshpërblim janë udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.491/201 të datës 14.02.2019, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokuroritë të Prokurorisë Themelore në Pejë dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur, Prokurori i Shtetit të Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që shkeljet të konstatohen respektivisht që Gjykata Supreme në kuptim të nenit 439 të KPPK-së, të vendos sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa është pjesërisht e bazuar.

Në kërkesë pretendohet se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 dhe neni 361 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 370 par.7 dhe 10 të KPPK-së, si dhe me shkeljet e ligjit penal.

Në kërkesë më tutje pretendohet se gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka konstatuar se nuk është vërtetuar se i pandehuri L.Ç., ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar dhe se ka marrë aktgjykim lirues për faktin se aktakuza ka mbetur në nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo në atë të bazuar mirë në prova të besueshme se i dënuari ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet, andaj në mungesë të provave është liruar nga akuza e në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK-së. Më tutje gjykata të vetmin arsyetim për lirimin e të pandehurit L.Ç., ka faktin se ditën kritike paratë janë gjetur tek i dënuari N.B. dhe se përkundër sugjerimeve të gjykatës

së shkallës së dytë nuk ka qenë në gjendje të siguroj prezencën dhe marrjen e dëshmisë së tani të dënuarit N., duke minimizuar të gjitha faktet vendimtare që vërtetojnë përtej çdo dyshimit të bazuar mirë se ata si bashkëkryerës me marrëveshje paraprake kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së. Në kërkesë pretendohet se konstatimet e gjykatave janë në kundërshtim të plotë me provat e administruara dhe atë sidomos me provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor si dëgjimi i dëshmitarit B.E., transkripti i incizimit me rastin e pranimit të hollave nga dëshmitari B.E. më datë 08.11.2013, gjatë ekzekutimit të masës së fshehtë teknike të simulimit të veprës penale, transkripti i bisedave telefonike në mes të dëmtuarit dhe të dënuarit N., dhe të pandehurit L., i datës 07.11.2013, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 08.11.2013 si dhe dëgjimin e dëshmitarëve V.P., J.P., G.B., N.K., J.A. dhe A.H.

Vepra penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 të KPK-së.

Sipas kërkesës sa i përket veprës së parë penale i pandehuri L.Ç. si inspektor i Komisionit të P.M.M., pas marrëveshjes paraprake me tani të dënuarin N., si kryeinspektor i këtij Komisioni, ditën kritike më datën 08.11.2013 rreth orës 14:15 në fshatin G., Komuna e K., kishin shkuar tek dëshmitari B.E., nga i cili i dënuari N.,kishte marrë në emër të ryshfetit shumën prej 1.000 €, për të mos e kryer punën e tij zyrtare. Kjo vërtetohet nga deklarata e dëshmitarit B.E. i cili në mënyrë të qartë deklaron se më datën 07.11.2013, pasi që më parë firma e tij ishte inspektuar, ishte takuar me tani të dënuarin N. dhe se i njëjti i kishte thënë “Me dit se kjo punë jetë brenda meje e teje se ndryshe nuk di me ta rregullua, mi jep 1.000 €, pesëqind për mu dhe pesëqind për L., për ta heq qafe e mos me ardhë ma atje”. Dëshmitari e kishte njoftuar policinë dhe në bashkëpunim me ta e kishte lënë takimin më datën 08.11.2013. Ashtu siç ishte planifikuar nga i njëjti janë marrë 1.000 €. Sipas incizimit me rastin e zbatimit të masës së fshehtë teknike të stimulimit të veprës penale, audio-video incizimit të datës 08.11.2013 si dhe transkripti të bisedës telefonike në mes të dënuarit N. dhe të pandehurit L., të datës 07.11.2013 do të vërtetohet se në mes tyre ka ekzistuar marrëveshje paraprake, ku i dënuari N. i thotë të pandehurit L. “Nesër unë e tij duhet me dal bashkë në terren, se më ka thirr me u marr vesh diçka”, duke i thënë “Diçka tha që nji bakshish e jep”, ndërsa i pandehuri përgjigjet “E, e për atje në Gj., ska kurgjo a?”. Prokurori në kërkesë pretendon se i pandehuri L. ishte në dijeni lidhur me bakshishin dhe se po mos ta dinte do të reagonte dhe

vlerësimi i këtyre provave nga ana e gjykatës ka qenë i gabuar. Nga vetë fakti se nga provat tjera vërtetohet se i dënuari N., ka mundur të shkojë me ndonjë inspektor tjetër, mirëpo planifikimi dhe organizimi ka qenë që ata dy të shkojnë e që vërtetohet nga transkriptet e bisedave.

Sa i përket veprës së dytë penale, Prokurori konsideron se gjykata nuk i fali besimin deklaratave të dëshmitarëve të cilët në mënyrë të detajuar e paraqesin ngjarjen se si i pandehuri L., kishte keqpërdor autoritetin e tij me rastin se i njëjti gjatë vitit 2011 e deri më datën 08.10.2013 në regjionin e P., K., D. e Gj., si person zyrtar, nuk i kishte përmbushur detyrat zyrtare me qëllim përfitimi, ashtu që ka lejuar që të veprohet në shumë seperacione pa licencë, duke degraduar ambientin e si shpërblim për këtë të njëjtit i kishin dhënë darka dhe dreka të cilat nuk i mohon as ai vetë me arsyetim se diçka e tillë nuk është e ndaluar. Kjo vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve të cekur më lartë. Të gjitha këto kanë bërë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë të përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për arsye se dispozitivat e tyre janë në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit, kurse ajo që është thënë në arsyetim lidhur me faktet vendimtare është në kundërshtim me përmbajtjen e provave në shkresat e lëndës.

Me vetë faktin se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale është shkel edhe ligji penal në dobi të të pandehurit kur është liruar nga aktakuza.

Gjykata Supreme gjeti se këto pretendime nuk janë të bazuara sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse aktgjykimet përmbajnë arsye ligjore për konstatimet e veta, por janë të bazuara sa i përket shkeljes së ligjit penal për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 dhe 2 dhe nënpar.2.1 të KPK-së. Ky mjet juridik konform dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK-së, nuk lejohet për vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, por kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi sepse ndërlidhej me shkeljen e pretenduar të ligjit penal dhe u konstatua se në faktet e vërtetuara në mënyrë të drejt, gabimisht është aplikuar ligji penal në dobi të pandehurit L.Ç., sepse janë nxjerrë përfundimet e gabuara për ekzistimin e veprës penale.

Kështu në aktgjykimin e shkallës së parë bëhet vlerësimi i provave dhe sidomos i përgjimeve të bisedave në mes të dënuarit N. dhe L., i datës 07.11.2013 dhe transkriptit të këtyre përgjimeve dhe konstatohet se ato nuk përputhen për faktin se i pandehuri L., thotë "E, e për atje në Gj. ska kurgjo a?"(e jo ok ,sikur që është konstatuar në transkript) dhe pastaj e vlerëson se kjo nuk ka qenë miratim dhe pranim i bakshishit (ryshfetit) të premtuar nga B.E.. Këtë fakt e mbështet edhe me atë se i pandehuri L., nuk ka qenë prezent kur të hollat janë dhënë nga B., dhe të njëjtat janë gjetur gjatë kontrollit të policisë tek i dënuari N., dhe me faktin se nga video-incizimi i bërë në vendin e ngjarjes me datën 08.11.2013 shihet se i pandehuri L. ishte duke qëndruar larg së paku 30 metra vendit ku janë dhënë parat. Ndërsa Gjykata e Apelit në aktgjykim gjen se drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur ka konstatuar se nga provat e administruara nuk është provuar se i pandehuri L., ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK.

Duke i vlerësuar pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe nga shkresat e çështjes, Gjykata Supreme konstatoi se nga përgjimet e bisedave telefonike vërtetohet se i pandehuri L. dhe i dënuari N., kanë kontaktuar vazhdimisht dhe se më datën 07.11.2013 janë marrë vesh që të nesërmen, pra më datën 08.11.2013 të shkojnë në fshatin G., tek dëshmitari B.E. (me të cilin paraprakisht ishte marrë vesh N., që të mos veprojnë në kuadër të kompetencave të veta zyrtare, për këtë të paguan shumën prej 1000 €, dhe atë 500 € për atë dhe 500 € për L.) dhe kjo vërtetohet edhe nga biseda ku i dënuari N., thotë "Nesër unë e ti duhet me dal në terren te ky B., se më ka thirr me u marrë vesh diçka" ndërsa L., thotë "a unë mu marrë vesh a ti?", në çka ai përgjigjet "jo, jo unë mirrna vesh me ato" dhe duke shtuar "Diçka tha që nji bakshish e jep", ndërsa qëndron fakti se i pandehuri L. përgjigjet "E, e për atje në Gj. ska kurgjo a?", mirëpo se i pandehuri L., ka qenë në dije për çka flitet vërtetohet nga video-incizimi në vendin e ngjarjes, dhe atë kur B. e pyet N. "L. a e din, e mos të më vjen nesër", N., e pohon duke qesh "Për çka u largu ai" dhe vazhdon pasi që i merr paratë dhe B. insiston që ta din edhe L. që i mori parat, me fjalët "L. e din përmes meje".

Gjykatat vendimet e veta i kanë bazuar edhe në këto prova, që do të thotë se përmbajtja e këtyre bisedave nuk është kontestuar. Megjithatë, kanë nxjerrë konkludim të gabuar lidhur me bisedat e të pandehurve e në ndërlidhje edhe me provat tjera. Gjykata Supreme konstatoi se nga këto biseda vërtetohet se i pandehuri L. ka qenë në dijeni për bisedat e të dënuarit N. dhe B. dhe se është pajtuar me të gjitha që janë marrë vesh ata, pra edhe për marrjen e ryshfetit prej 1000 € për të dytë. Fakti

që ai largohet nga vendi i ngjarjes në momentin kur ka ndodh marrja e parave nga i dënuari N., përshkruhet nga vet N., i cili me plotë vetëdije e thotë se edhe L., e din për këtë punë dhe se mu për atë arsye është larguar nga vendi i ngjarjes.

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë në aktgjykimet e veta drejtë dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe faktet vendimtare por me lirimin e të pandehurit sa i përket veprës së parë penale, kanë nxjerrë përfundime të gabuara për ekzistimin e saj, e që paraqet shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK-së dhe kanë aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet, sepse me aplikimin e drejtë të ligjit penal ai do të shpallej fajtor për veprën penale që ishte objekt i akuzës. Se në veprimet e të pandehurit formohen elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK-së rezulton nga të gjitha faktet e cekura më lartë. Së pari i dënuari N.B., ka kontaktuar me të dëmtuarin B.E., pronar i separacionit "E.." në K., i cili ishte vizituar nga ai dhe dy inspektorët e Komisionit për M.M dhe ka përpiluar një procesverbal për punën e tij ilegale si operator. Komunikimi i të dënuarit N. dhe të dëmtuarit B. ka filluar pas marrjes së procesverbalit, ku N. i ka kërkuar që të takohen në P. Në takim ai i ka thënë se nuk mundem me të ndihmua sepse procesverbalin e ka L., dhe vetëm nëse i jep 500 € për atë dhe 500 € për L., kryhet kjo punë. Pas kësaj i dëmtuari B., ka shkuar në polici dhe në marrëveshje me policinë, me telefon është marrë vesh me N., që të nesërmen pra me 08.11.2013 të takohen në punishten e tij. Nga policia ai është furnizuar me të hollat me numra serik të kopjuara dhe me kamerat e instaluara në trupin e tij me të cilat është regjistruar e gjithë ngjarja. Është fakt i pakontestueshëm se i dënuari N., e ka njoftuar me datën 07.11.2013 të pandehurin L.Ç., se të nesërmen duhet të shkojnë tek B.E., që ishte në kompetencën e tyre dhe në përshkrimin e detyrave të tyre si inspektor respektivisht kryeinspektor të Komisionit për M.M, dhe se kjo vërtetohet edhe nga dëgjimi i përgjimeve telefonike të bisedave të zhvilluara në mes tyre. I dënuari N., e njofton të pandehurin L., se i dëmtuari B., do ta jep edhe një bakshish dhe se i pandehuri L., nuk e vazhdon bisedën në këtë drejtim por i drejtohet me fjalët "e, e për Gj., qysh po e lojmë". Pra, i pandehuri L., nuk e mohon apo nuk e refuzon me asnjë fjalë faktin se i dëmtuari B., do ta jep një "Bakshish", e çka në të vërtetë të nesërmen edhe ndodhë ashtu siç vërtetohet nga audio-video incizimi i kryer në vendin e ngjarjes në separacionin e të dëmtuarit B.E. Edhe nga ky video incizim vërtetohet se, i pandehuri L., largohet nga vendi i ngjarjes në momentin kur i dëmtuari B., jep të hollat të dënuarit N., i cili pas insistimit të tij ia vërteton se i pandehuri L., është në dijeni për marrjen e të hollave

duke ia vërtetuar se ai për atë arsye edhe është larguar nga vendi i ngjarjes dhe se për të gjitha e din nëpërmjet të tij. Së dyti, kjo gjykatë konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se vetë fakti që i pandehuri L., nuk ka qenë prezent në momentin e marrjes së të hollave si ryshfet, tregon se i njëjti nuk ka qenë në dijeni për marrëveshjen e mëparshme të dënuarit N. dhe të dëmtuarit B., e merr si të paqëndrueshëm, sepse nga faktet e cekura më lartë vërtetohet se i pandehuri L., ka qenë në dijeni të plotë për kërkesën e N. dhe se është pajtuar me të, sepse kështu edhe ka ndodhë në vendin e ngjarjes dhe se i njëjti ka qenë personi i cili e ka përpiluar procesverbalin dy ditë më herët. Pra, i pandehuri L., në bisedën e zhvilluar me datë 07.11.2013 me të dënuarin N., ka ditur se për cilin rast bëhet fjalë, e ka ditur se të nesërmen duhet ta vizitojnë në punishten e tij dhe se marrëveshjen ia kishte lënë të dënuarit N., siç edhe vërtetohet nga biseda telefonike por ashtu edhe siç ka ndodhë të nesërmen në vendin e ngjarjes.

Gjykata e shkallës së dytë, duke e arsyetuar vërtetimin e aktgjykimit lirues, gjen se sa i përket përgjimeve të bisedave telefonike në mes të pandehurit dhe të dënuarit N., janë vlerësuar, gjegjësisht edhe këtu në faktet drejtë të vërtetuara gabimisht është aplikuar ligji penal. Kështu, i jepet rëndësi vendimtare faktit që në transkriptet e bisedave telefonike të zhvilluara, kur i dënuari N., i është drejtuar të pandehurit me fjalët “diçka na jep bakshish” i pandehuri i është përgjigjur “okej në rregull është e për Gj., çka po bojmë” ndërsa nga dëgjimi i bisedës del se i pandehuri pas këtyre fjalëve ka thënë “ej” e jo “okej”.

Po ashtu, në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë konstatohet se i dënuari N., i kërkoi të hollat në emër të tij pa prezencën e tij, se i ka marrë të hollat nga i dëmtuari pse ai nuk ishte prezent dhe se të hollat janë gjetë tek ai dhe se transkripti i bisedës së zhvilluar në mes të dënuarit nuk përputhet me video incizimin dhe me dëshminë e të dëmtuarit i cili ka theksuar se i pandehuri L., asnjëherë nuk ka kërkuar nga ai të holla apo shpërblim për kryerjen apo moskryerjen e detyrës së tij.

Kjo gjykatë, gjen se këto konstatime janë të paqëndrueshme e nga e arsyet e cekura më lartë dhe nga këto shkaqe, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar sa i përket shkeljes së ligjit penal në dobi të pandehurit L.Ç. dhe kjo shkelje nga neni 385 pika 4 të KPPK-së, gjegjësisht aplikimi i ligjit cili nuk ka mundur të aplikohet, u konstatua dhe u vendos si nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 438 par.1.3 të KPPK-së.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr.341/2018 i datës 1.04.2019.**

Në aktgjykimin e mëposhtëm , do të prezantohen shkeljet e bëra nga Gjykata Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, e cila ka ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë ashtu që për një të pandehur, është hedhur aktakuza për veprat penale dhe është pushuar procedura penale për shkak se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer vepra penale për të cilat është dyshuar. Me të njëjtin aktvendim duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit, është anuluar aktvendimi i shkallës së parë dhe çështja është kthyer në rivendosje. Pra, gjykata e shkallës së dytë, gabimisht ka marrë rolin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar faktet kontradiktore dhe fuqinë provuese të këtyre fakteve duke konkluduar se i pandehuri nuk është kryes i veprave penale, edhe pse ngase kjo ka mundur të bëhet vetëm në shqyrtim gjyqësor mbi bazën e parimeve të cilat mundësojnë vlerësimin e drejtë dhe të gjithëanshëm të provave. Njëkohësisht, Gjykata e Apelit ka bërë shkeljen e ligjit penal kur në rrethana të njëjta (në shkelje të njëjta) për një të pandehur, ka ndryshuar aktvendimin, ndërsa për të pandehurin e dytë ka anuluar aktvendimin, edhe pse aktvendimi i shkallës së parë ka qenë i përpiluar për të dy të pandehurit njësoj.

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit konstatohet se aktvendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.681/2018 datë 18.09.2018 dhe PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, në pjesën që ka të bëjë me veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së dhe shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK-së, e në dobi të të pandehurve E.B. dhe Rr.H., e duke mos i prekur vendimet e formës së prerë.

A r s y e t i m i

Në këtë çështje penale Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën PPS.nr.13/2017 datë 02.05.2018, kundër të pandehurve E.B, për shkak të veprave penale

keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPKsë, pengim i të provuarit nga neni 394 par.2 të KPK-së, dhe moslajmërimi i veprave penale apo kryerësve të tyre nga neni 386 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe Rr.H., për shkak të veprave penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, dhe të mashtrimit në vazhdim nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK.

Gjykata Themelore në Prishtinë – DKR, me aktvendimin Pkr.nr.112/2018 e datës 25.06.2018, ka refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave për të pandehurit E.B. dhe Rr.H., respektivisht kërkesat e mbrojtësve të tyre.

Gjykata e Apelit të Kosovës - DKR, me aktvendimin PN.nr.681/2018 e datës 18.09.2018, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit E.B., dhe ka ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë ashtu që për të pandehurin E.B., është hedhur aktakuza për veprat penale si më lartë dhe ndaj të njëjtit është pushuar procedura penale për shkak se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer vepra penale për të cilat është dyshuar. Me të njëjtin aktvendim duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit Rr.H., është anuluar aktvendimi i shkallës së parë dhe çështja është kthyer në rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë - DKR në rivendosje, me aktvendimin PKR.nr.112/2018 të datës 21.09.2018, ka refuzuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave për të pandehurin Rr.H., të ushtruar nga avokati i tij T.Rr.

Gjykata e Apelit të Kosovës – DKR, me aktvendimin PN.nr.1014/2018 e datës 21.09.2018, ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të pandehurit Rr.H., dhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktvendimi e shkallës së parë, ashtu që ka aprovuar kërkesën e mbrojtësit të pandehurit Rr.H., dhe për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, ka pushuar procedurën penale për shkak se nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer këtë vepër penale ndërsa për veprën penale mashtrimi në vazhdim nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së, është refuzuar ankesa e mbrojtësit të pandehurit dhe procedura në këtë çështje penale është vazhduar sipas dispozitave procedurale të parapara për caktimin e seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Kundër këtyre aktvendimeve Prokurori i Shtetit ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme të konstatoj se aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.681/2018 i datës 18.09.2018, dhe PN.nr.1014/2018 i datës 18.10.2018, përmbajnë shkelje të dispozitave të procedurës penale si dhe shkelje të ligjit penal, apo çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në këtë kërkesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit Rr.H. av. T.Rr., me propozim që kërkesa të refuzohet në tërësi si e pabazuar ose të kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljeve të ligjit.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë Prokurori i Shtetit pretendon se të dy aktvendimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat konsistojnë në faktin se në aktvendimin PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, Gjykata e Apelit bënë konstatimin se prokuroria nuk ka provuar dyshimin e bazuar mirë se janë kryer veprat penale të përshkruara në aktakuzë e sa i përket të pandehurit E.B. Kështu nga shkresat e çështjes vërtetohet se dëshmitari-i dëmtuari V.H., ka deklaruar se në datat të caktuara më shumë se një herë është takuar me të pandehurin Rr.H., i cili u ka treguar se ky dhe dëshmitari tjetër janë nën hetime e po ashtu i njëjti dëshmitar ka deklaruar se i pandehuri Rr.H., u ka kërkuar shumën prej 100,000.00 €, në mënyrë që rasti kundër tyre të mbyllet dhe se kërkesën e ka bërë në emër të pandehurit tjetër, E.B. Më tutje pretendohet se ky dëshmitar ka deklaruar se në zyrën e Rr.H., ka qenë edhe i pandehuri E.B., dhe i ka thënë dëshmitarit se rasti i hetimeve mund të mbyllet por është shprehur me fjalët “vetëm dëgjojeni këtë djalë” (duke aluduar në Rr.H., i cili u thoshte të dëmtuarve se po vepron në emër të pandehurit E.). Më tutje i njëjti dëshmitar, gjithnjë sipas shkresave, ka pretenduar se ka qenë në zyre së bashku me dy të pandehurit, ku ka biseduar rreth asaj se si rasti i hetimeve mund të mbyllet e cila bisedë

është incizuar, por nga incizimi nuk ka mund të vërtetohet se i kujt është zëri por kanë mbet vetëm deklarimet e dëshmitarëve. Të gjitha këto pretendime janë konfirmuar edhe nga dëshmitari - i dëmtuari i dytë F.B., dhe dëshmia e prindit të dëshmitarit R.H., i cili dëshmon se si janë dhënë 50,000.00 €, tek i pandehuri Rr., e në emër të mbylljes së rastit kundër djalit të tij që punonte në QAD, e cila deklaratë konfirmohet nga prindi i dëshmuarit F.B. Të dy dëshmitarët kanë deklaruar se kanë qenë në zyrën e të pandehurit E., dhe i kanë treguar se i pandehuri Rr., kishte kërkuar para në emër të tij duke i thënë se ka edhe diçka në telefon (duke aluduar në incizimet e bëra). Të gjitha këto prova janë provat të cilat implikojnë të dy të pandehurit në kryerjen e veprave penale për të cilat është ngritur aktakuza dhe të cilat prova e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se këto vepra janë kryer. Ndërkaq Gjykata e Apelit gabimisht ka konstatuar, e duke u bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve nga radhët e Policisë së Kosovës, vartës e të pandehurit E.B., të cilët konfirmojnë se atë ditë ka pas bastisje në Gj., në një rast tjetër penal dhe për këtë bastisja është kryer më vonë se urdhër i lëshuar nga GJPP. Edhe pse kjo mund të jetë e vërtetë ka mbet e paqartë se si Rr.H., e dinte saktë se bastisja do të ndodhte një ditë më vonë, ashtu edhe sikurse kishte ndodhur me të vërtetë.

Sa i përket aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, përkitazi me të pandehurin Rr.H., e për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, Prokurori i Shtetit po ashtu konsideron se gabimisht Gjykata e Apelit ka konstatuar se kjo vepër mund të kryhet nga personi që ka pozitë zyrtare, njëkohësisht duke i tejkaluar autorizimet e veta dhe duke marrë qëndrimin e ligjdhënësit sepse nëse ligjdhënësi ka thënë se kjo vepër mund të kryhet nga "kushdo" as Gjykata e Apelit e as kushdo tjetër nuk mund ta marrë rolin e ligjdhënësit dhe këtë fjalë ta interpretojë si "person zyrtar".

Sa i përket shkeljeve të ligjit penal Prokurori i Shtetit në kërkesë pretendon se gabimisht Gjykata e Apelit konsideron se nuk është provuar dashja direkte me rastin e kryerjes së veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPK-së, sa i përket të pandehurit E.B., ndërkaq po ashtu pretendon se është shkelur neni 7 i KPPK-së, sepse Gjykata e Apelit ka dhënë vlerësim të paqëndrueshëm ligjor dhe të pabazuar kur ka marrë vendim që aktakuza nuk plotëson dyshimin e bazuar mirë dhe ka paragjykuar veprimet e një prokurori të rastit. Kjo nga fakti sepse par.2 i nenit 7 të KPPK-së, precizon të tri organet duhet që me vëmendje dhe përkushtim maksimal

profesional të vërtetojnë faktet kundër të pandehurve dhe ato që shkojnë në favor të tyre. Pra rasti duhet të dërgohet në gjykim ku dhe bëhet vlerësimi i provave dhe prokurori i rastit nëse bindet se nuk është vërtetur përtej dyshimit të bazuar mirë se janë kryer veprat penale, ai në bazë të nenit 7 të KPPK-së, është i obliguar të tërhiqet nga ndjekja penale. Në rastin konkret Gjykata e Apelit ka marrë rol të gjykatës gjykuese duke e gjykuar po thuajse në tërësi rastin duke vepruar në mënyrë arbitrare dhe duke marrë kompetencat e trupit gjykues në shkallë të parë.

Andaj, Prokurori i Shtetit konsideron se është shkelur ligji penal në rastin konkret kur është hedhur aktakuza ndaj të dy pandehurve.

Mbrojtësi i të pandehurit Rr.H., av. T.Rr., në përgjigje në kërkesën e Prokurorit të Shtetit konsideron se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar sepse nga përmbajtja e kërkesës, prima facie del se kërkesa i referohet në tërësi vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për çka nuk mund të ushtrohet kërkesa.

Gjykata Supreme duke i vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe përgjigjen e mbrojtësit të pandehurit Rr.H., av. T. Rr. nga P., si dhe duke u mbështetur në shkresat e çështjes konstatoi se me të drejtë Prokurori i Shtetit pretendon se aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN.nr.681/2018 datë 18.09.2018, sa i përket të pandehurit E.B., dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, sa i përket të pandehurit Rr.H., për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, janë të përfshira në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së, e lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së. Kjo gjykatë gjen se arsyetimi i dhënë në aktvendimet e kundërshtuara është në kundërshtim me shkresat e çështjes dhe atë si më poshtë:

Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN.nr.681/2018 datë 18.09.2018, pa të drejtë lëshohet në vlerësim të provave duke i vlerësuar të njëjtat si prova shfajësuese dhe duke marrë në këtë mënyrë rolin e gjykatës së shkallës së parë. Kështu sa i përket dyshimit të bazuar mirë, kjo gjykatë gjen se vlerësimi i Gjykatës së Apelit “se me asnjë provë qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nuk është vërtetuar”, është konstatim i tillë dhe vlerësim i cili nuk mbështetet në provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës, ashtu siç me të drejtë pretendon Prokurori i Shtetit në mbështetje të

mbrojtjes së ligjshmërisë. Kështu në aktvendim sa i përket veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, konstatohet se nga provat të cilat i ka siguruar prokuroria nuk mund të vërtetohet as minimumi i dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se nga këto prova nuk është vërtetuar se i pandehuri E., ka kërkuar shumën e theksuar nga të dëmtuarit V. dhe F., duke konstatuar më tutje se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë. Kjo gjykatë gjen se në shkresat e çështjes janë dëshmitë e dëshmitarit - të dëmtuarit V.H., i cili deklaron se nga i pandehuri Rr.H., ka marrë zyra me qira në objektin e hotelit G..., bashkë me A.N., kanë aplikuar për një grant në organizatë e tyre e cila kërkesë është refuzuar. I dëmtuari më tutje deklaron se pas 6 muaj pune në P., i pandehuri Rr.H., u kishte treguar se kundër tyre në Departamentin për Hetime Ekonomike është nisur një hetim dhe se për ta përfunduar këtë hetim duhet të jepen 100,000,00 €, duke theksuar gjithnjë se këtë punë e ka në dorë Drejtori i Krimeve Ekonomike (E.B.), me të cilin ai kishte raporte të mira. Më tutje ka vërejtur se i pandehuri E., ka shkuar shpesh në zyrën e të pandehurit Rr., dhe ka vendosur së bashku me të dëmtuarin F., që njëri prej tyre të shkonte në zyrën e tij dhe ta incizonte bisedën. Vetë i dëmtuari V., kishte shkuar në zyre të pandehurit Rr., dhe kur ka pa se ka hy i pandehuri E., duke incizuar, e kishte pyetur të pandehurin E., se çka po bëhej me lëndën e tyre. Atëherë, i pandehuri E., shkurt kishte thënë "vetëm dëgjojeni këtë djalin", duke menduar në të pandehurin Rr. Duke diskutuar dhe duke vlerësuar se çmimi ishte i lartë kishin vendosur që të mos jepnin para dhe të përballen me hetim. Në dëshmi i dëmtuari deklaron se përmes kontakteve me viber me të pandehurin Rr., kanë biseduar për këtë çështje dhe me datën 31.11.2016 në një komunikim me të përmes ëhats-up, i pandehuri Rr., i tregon se nga gjykata është lëshuar urdhëresa për kontroll për datën 01.12.2016 dhe se duhej të jepnin 10,000.00 € që ajo të mos zbatohej. Në të vërtetë urdhëresa është zbatuar me datën 02.12.2016, kur edhe i njëjti është arrestuar bashkë me shokët e tij. Derisa ishin nën masën e arrestit shtëpiak, familjaret e tij pa dijenin e tij të pandehurit Rr., ia japin 25.000 €, e po ashtu duke qenë në dijeni se i njëjti në këtë çështje thirrej në të pandehurin E., kanë shkuar në zyrën e tij dhe i kanë treguar se për të janë dhënë para. Pas të gjithave, ka vendosur që rastin ta lajmëroj në polici. Të njëjtën dëshmi e vërteton edhe dëshmitari F.B., e ndaj të cilit po ashtu kanë filluar hetimet dhe i cili e vërteton se i pandehuri Rr., u kishte kërkuar 100,000,00 €, që kjo çështje të mbyllet dhe se i njëjti i kishte treguar atij dhe të dëmtuarit V., se kishte informata të sigurta nga Departamenti i Hetimit të Krimeve Ekonomike se ata do të arrestoheshin. I njëjti e kishte precizuar se hetimi do të kryhej nga E.B. dhe F.B., dhe se kontrolli

i shtëpisë do të bëhej me datën 1 apo 2 dhjetor 2016. Edhe babai i tij ia kishte dhënë të pandehurit Rr., 25.000,00 €, që ky hetim të përmbyllej. Nga dëshmia e dëshmitarit R1.H1., - babai i të dëmtuarit V., vërtetohet se i njëjti kishte kuptuar se djali i tij V., dhe disa shokë të tij kanë probleme dhe se janë në masën e arrestit shtëpiak. Djali tjetër i tij F., i kishte thënë që të kontaktonin me një preson në Hotelin G.., me emër Rr.H., i cili në takim i kishte thënë se djali i tij ka probleme me polici dhe se ai ka lidhje me persona të rëndësishëm në pushtet dhe se për të kryer këtë punë duhet t'i jepnin 50.000 €. Edhe pse fillimisht ka kundërshtuar më vonë ka kontaktuar me babanë e F., Q.B., me të cilin janë marrë vesh që së bashku t'i bëjnë 50.000 €, dhe përfundimisht në zyrën e Rr., i kanë dhënë 50.000 €, i cili moment është incizuar me telefon. Me kërkesën e tij është përpiluar një shkresë, me shënime personale të pandehurit Rr. (datëlindja, numri personal) të cilën e kishin nënshkruar ai, Q. dhe i pandehuri Rr., e në të cilën shkresë është cekur se këto para janë marrë "për përmbylljen e një procesi". Meqenëse procedura nuk kishte përfunduar dhe V. dhe F., kishin mbetur në arrest shtëpiak kanë kërkuar nga Rr., që ta përfundon këtë punë ashtu siç janë marrë vesh por i njëjti kishte kërkuar edhe 50.000 €, tjera. Në fund kishte vendosur që vet të takohet me të pandehurin E.B., me qëllim që nga ai të kuptonte lidhur me rastin dhe pasi ishte takuar me të në zyrën e tij i kishte thënë se kur janë dhënë paratë është përmendur emri yt. I pandehuri E., kishte këmbëngulur se kjo nuk guxon të ndodhë dhe në zyrën kishte hyrë edhe togeri N.H., i cili ja kishte shpjeguar se dhënia dhe marrja e ryshfetit është vepër penale e njëjtë. Pasi që edhe nga ky takim nuk kishte marrë ndonjë përgjigje konkrete kishte vendosur që rastin ta praqes në polici ku kishte dorëzuar edhe CD, ku kishte fotografuar rastin kur të pandehurit Rr., ia kishte dhënë paratë.

Në shkresat e çështjes gjenden një mori transkriptash të mesazheve dhe komunikimeve në mes të dëmtuarit V.H. dhe Rr.H., si dhe të Rr.H. dhe I.B., dhe të tjerë, nga të cilat vërtetohet se i pandehuri Rr., ishte në dijeni të plotë për kohën, datën se kur do të bëhet kontrolli i banesave të dëshmitarëve V. dhe F., si dhe vërtetohet se i njëjti iu jep udhëzimet e duhura se si duhet të veprojnë dhe se çfarë duhet të bëjnë në rastin konkret, ndërkaq në një bisedë me mesazhe në viber vërtetohet se i pandehuri Rr., në mes të tjerave thotë "o plako ti e nive edhe vet ata çka tha ndryshe nuk kryhet kjo punë, po ma mirë e ki me pagu dhe vazhdon me punë nuk guxon kush me ta lu", në çka dëshmitari V. i përgjigjet "o njeri E**.,** se ka njetin me dek me qet rast, e këta nuk na u hiqen qafe, edhe skam pare o burrë me pagua harraq me pare të fermerëve tybe edhe ashtu jam mbete mbrapa

me punë. Edhe me dashtë skam qysh i arsyetoj tan ato pare", "Rr., i përgjigjet "ani plako ti e din ma mirë veç shumë ma shumë kanë met shku nëpër avokatë e ski me muajt me krye punë se si të niset, djali i Th. me kanë sun ta nimoj ma".

Në një bisedë tjetër nga transkripti i datës 29.12.2019, vërtetohet se i pandehuri Rr., i thotë I.B. " d.m.th është krejt tjetër nuk mundet për pa u krye kjo pengesë që ky të jetë i lirë..... ky avokati e bënë shkresën dhe këta dy bashkë e dorëzojnë në Drejtorinë e Krimeve Ekomomike dhe komandanti i tyre që është i rrethit të juaj, E.B., vendos që a kanë të drejtë të punës a jo kështu që është punë e kryer ajo sa i përket punës dhe më tutje i njëjti ju thotë "ditën e mirë t'i mu më thua kur t'i paguash edhe 50.000 € tjera". Në fakt nga transkriptet e bisedave në mes të V.H., Rr.H., I.B. etj., vërtetohen se të njëjtit kanë bisedime të gjata lidhur me shumën e parave të dhëna, operacionet të cilat do t'i kryejnë policia ku përmenden shumë emra e në mesin e tyre vazhdimisht përmendet edhe emri i të pandehurit E.B., si person i cili është në krye të kësaj pune. Të gjitha këto prova të dorëzuara nga prokuroria, dëshmitë e V.H., F.B., Q.B., R1.H1, S.D., etj., të cilat janë në përputhje me njëra tjetrën, nga CD e cila nuk ka mund të deshifrohet si dhe nga telefoni i cili edhe pse është dërguar në ekzaminim nuk ka mund të vërtetohet zëri i të pandehurit E., e për të cilat incizime të gjithë deklarojnë në mënyrë të njëjtë se çka ndodhet në to, kjo gjykatë konsideron se pa të drejtë Gjykata e Apelit ka ardhur në konstatim se nuk ka pasur asnjë provë e cila ka involvuar të pandehurin E., në veprat penale për të cilat është akuzuar. Për më tepër, arsyetimi i dhënë në aktvendimin e kundërshtuar është plotësisht në kundërshtim me provat e cekura dhe me provat të cilat pa të drejtë Gjykata e Apelit i shtjellon dhe i vlerëson si të ishte gjykatë e shkallës së parë. Gjykata e Apelit më tutje anashkalon në tërësi faktin se i pandehuri Rr., nuk e mohon faktin se ka pranuar shumën prej 36.000 €, duke u thirr në një borxh si dhe duke anashkaluar faktin se në shkresë të nënshkruar nga vet i pandehuri Rr., ceket se këto para janë marrë për përfundimin e një procesi, edhe pse i njëjti mohon se nënshkrimi në këtë shkresë është nënshkrimi i tij. Pra gjykata e shkallës së dytë duke e marrë rolin e gjykatës së shkallës së parë ka pamundësuar që të vërtetohet apo jo fajësia e të pandehurve si dhe vërtetësia apo jo e provave të paraqitura nga prokuroria, e duke i vlerësuar vet provat, edhe pse në mesin e këtyre provave ka pasur prova të cilat e kanë mbështetur dyshimin e bazuar mirë se këta i kanë kryer veprat për të cilat janë akuzuar. Në këtë fazë të procedurës vetëm vlerësohet se a përmbushet minimumi i kërkesës që është dyshimi i bazuar mirë për ngritjen e aktakuzës dhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë nuk ka

mundur të lëshohet në vlerësimin e fakteve kontradiktore e as në fuqinë provuese të këtyre fakteve dhe të konkludoj se i pandehuri nuk është kryes i veprave penale, ngase kjo ka mundur të bëhet vetëm në shqyrtim gjyqësor mbi bazën e parimeve të cilat mundësojnë vlerësimin e drejtë dhe të gjithëanshëm të provave.

Gjykata Supreme gjen se duke e hedhur poshtë aktakuzën dhe duke pushuar procedurën ndaj të pandehurit E.B., është shkel ligji penal nga neni 385 pika 4 të KPPKsë, në dobi të njëjtit nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës. Njëkohësisht, Gjykata e Apelit ka bërë shkeljen e ligjit penal kur në rrethana të njëjta (në shkelje të njëjta) për një të pandehur (E.B.), ka ndryshuar aktvendimin, ndërsa për të pandehurin e dytë (Rr.H.) ka anuluar aktvendimin, edhe pse aktvendimi i shkallës së parë ka qenë i përpiluar për të dy të pandehurit njësoj.

Sa i përket aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1014/2018 datë 18.10.2018, për të pandehurin Rr.H., dhe veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, Gjykata e Apelit gabimisht konstaton se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm nga personi zyrtar edhe pse dispozita e nenit 431 par.1 të KPK-së, qartë përcakton "kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër...., në mënyrë që të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendim marrjen e personit zyrtar....", pra nga kjo dispozitë kushdo mund të kryej këtë vepër penale e jo siç gabimisht ka konstatuar Gjykata e Apelit.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 236/2018 i datës 06.11.2018.**

Nga aktgjykimi i mëposhtëm, shihet se të dy gjykatat gabimisht kanë hedhur akuzën ndaj të pandehurit duke mos dhënë arsye ligjore për këtë dhe të cilat arsye në fakt ishin në kundërshtim me provat të cilat ishin në shkresa të çështjes. Gjykata e shkallës së dytë më tutje në aktvendim fare nuk jep arsyetim për pretendimet ankimore të ushtruar nga zyra e prokurorit të shtetit edhe përkundër faktit se në rastin konkret ka ekzistuar shmangia tatimore e rrjedhimisht te i pandehuri janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar i dënuari.

A K T G J Y K I M

Pranohet si e bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, konstatohet se me aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.2088/2017 datë 23.03.2018, dhe të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.293/2018 datë 18.04.2018, është shkelur dispozita e nenit 384 par. I nënpar. 1.12 të KPPK-së, në favor të pandehurit B.I.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.2088/2017 datë 23.03.2018, është hedhur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP,II.nr.7410/12 të datës 02.05.2017 dhe është pushuar procedura penale ndaj të pandehurit B.I nga P., për shkak të veprës penale nga dispozitivi I i aktakuzës shmangie nga tatimi nga neni 249 par, I të KPK-së, pasi që ka arritur parashkrimit relativ i ndjekjes penale në prokurori, ndërsa për veprën penale në dispozitivin II të aktakuzës shmangie nga tatimi nga neni 313 par.2 të KPRK-së nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin PN.nr.293/1 8 datë 18.04.2018 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë ushtruar kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal , me propozim që kërkesa të aprovohet dhe këto shkelje të konstatohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 435 par. I dhe 436 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:
Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Prokurori i Shtetit në kërkesë pretendon se gjykata e shkallës së parë në momentin e hedhjes së aktakuzës, ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Kjo për faktin se në momentin e ngritjes së aktakuzës me datë 28.04.2017 ka ekzistuar shmangia tatimore në shumën

prej 41,921.95 euro (TVSH+CI+TAP) dhe si e tillë edhe është konstatuar. I akuzuari pas ngritjes së aktakuzës, fillon procedurën administrative. Gjykata e shkallës së parë, pasi që vihet në dijeni se i dënuari në procedurë administrative ka fituar rastin, aktakuzën e hedhë poshtë duke mos u lëshuar fare në pretendimet e Prokurorisë edhe për kundër faktit se në rastin konkret ka ekzistuar shmangia nga tatimi dhe rrjedhimisht ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej. Në kërkesë theksohet se i dënuari B.I, me datë 13.09.2016 lidh një kontratë dhurimi me bashkëshorten e tij, të cilës i dhuron mallin ari në sasi prej 5,623.03 gr., për të cilin mall detyrimet tatimore të pa deklaruara kapin shumën prej 41,921.05 euro. Siç theksohet në kërkesë kontrata e dhurimit është hartuar 5 ditë pas sekuestrimit të përkohshëm të mallit nga Policia e Kosovës dhe se ky mall është administruar nga Agjencia e Sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve , e nga kjo rezulton se kjo sasi ari ende figuron si sasi stoku tek biznesi DPZ "F.." me pronar B.I., dhe se asnjëherë nuk është bartur tek librat e dhuratëdhënësit zonja L.I.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet nga kërkesa se janë shkelur dispozitat e procedurës penale të KPPK-së në favor të të pandehurit qëndrojnë e nga këto arsye:

Nga shkresat e çështjes dhe aktvendimet e kontestuara rezulton se ndaj të pandehurit B.I, është hedhur aktakuza e P.nr.2088/17 dt. 23.03.2018 dhe është pushuar procedura penale ndaj tij për veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 3 13 par.2 të KPRK-së, meqenëse gjykata e shkallës së parë ka gjetur se në veprimet e të pandehurit nuk janë konsumuar elementet e veprës penale të cekur më lartë, me arsyetim se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. I pika 1.12 të KPPK-së sepse arsyetimi i aktvendimit të kontestuar është në kundërshtim me shkresat e çështjes dhe nuk përmban arsyetim të duhur dhe konkret lidhur me faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridike. Aq më tepër arsyetimi nuk ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat të çështjes dhe nuk është në pajtim me nenin 370 par. 7 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së dytë më tutje në aktvendim fare nuk jep arsyetim për pretendimet ankimore të ushtruar nga zyra e prokurorit të shtetit edhe përkundër faktit se në rastin konkret ka ekzistuar shmangja tatimore e rrjedhimisht te i pandehuri janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar i dënuari. Janë të bazuara pretendimet e Prokurorit të shtetit se

Gjykata e shkallës së parë ua ka falur besimin provave të ofruara nga i pandehuri dhe me këtë është shkelur ligji penal në dobi të pandehurit, për faktin se në shkresat e çështjes ekzistojnë prova për pagesën e pjesshme të borxhit në procedurë administrative, por në realitet kjo është i relevante sepse nuk reflekton fare në procedurën penale, rrethanë kjo që mund të merret vetëm si rrethanë lehtësuese, E theksuara si më lartë dëshmohet edhe nga vendimi i ATK-së, si në shkresat e çështjes kur është konstatuar se kontrata e lidhur midis dy bizneseve familjare burrë e grua ka të meta juridike pasi që e njëjta nuk ka mundur të lidhet pas sekuestrimit të mallit nga Policia e Kosovës dhe është i administruar nga Agjencioni i Sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve, nga e cila rezulton se nuk ka pasur dorëzim të mallit sipas kontratës së dorëzuar nga i pandehuri ngase një kontratë e tillë konsiderohet nule pasi që asnjëherë nuk shihet se malli i sekuestruar të jetë tatuar, fakt ky që i pandehuri B.I, i cili ka qenë i vetëdijshëm në momentin e lidhjes së kontratës me qëllim të shmangies së obligimeve qofshin ato tatimore apo edhe si në rastin konkret shmangie nga tatimi ashtu siç parashihet .

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 107/2021 i datës 22.04.2021**

Edhe në aktgjykimin e mëposhtëm vërehet se Gjykata e Apelit gabimisht ka aplikuar ligjin penal duke e liruar nga akuza të pandehurin dhe duke shkel ligjin penal në dobi të njëjtit. Kështu, Gjykata Supreme konstaton në rastet e veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par.3 nën par.3.1 të KPRK , sasia e drunjtëve të prerë nuk ka rëndësi, që do të thotë se edhe nëse është nën sasinë prej 2 m3, siç kërkohet në paragrafin 1 të këtij neni, prapë se prapë përmbushen elementet e veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.3 të KPK. Në favor të kësaj është edhe formulimi i paragrafit 3 në të cilin thuhet "nëse vepra penale nga ky nen kryhet..." e jo "nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni" që tregon se vepra bazë, gjegjësisht sasia e cekur në të, nuk është determinuese dhe e parasheh si vepër penale cilëndo vëllim të drunjëve me kusht që është kryer në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyllin tjetër me destinim të posaçëm dhe me qëllim të shitjes.

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, konstatohet se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.1008/2020 të datës 18.01.2021 është marrë shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK-së.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.284/2020 të datës 21.07.2020 i dënuari A.L. është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me par.3 të KPK dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqindën) euro, të cilin është obliguar ta paguaj në afat prej 3 muajve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nëse nuk e paguan, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi dhe me dënim me kusht, me të cilin i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatja prej 6 (gjashtë) muajve i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale. I dënuari është obliguar të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro dhe shumën prej 30 euro për Programin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Nga ai janë konfiskuar 1,20 m3 trungje të llojit bre dhe e dëmtuara - Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" zyra në P., për realizimin e kërkesës pronësoro juridike është udhëzuar në kontestin civil.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.1008/2020 të datës 18.01.2021 me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, sipas detyrës zyrtare, është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë dhe i dënuari është liruar nga akuza për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit, i cili e mbanë numrin KMLP.I.nr.5/21 të datës 05.03.20121, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penal dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që shkeljet të konstatohen.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i dënuari është fajtor për veprën në fjalë penale por se gjykata e shkallës së dytë, duke e analizuar dispozitën e nenit 349 të KPK ka gjetur se për të ekzistuar vepra bazë penale, pra ajo e parashikuar me paragrafin 1, kërkohet që kryesi, me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e tyre tejkalon 2 m3. Në paragrafin 3 i cili e parasheh formën më të rëndë të vjedhjes së pyllit, kërkohet që nëse vepra penale nga ky nen kryhet (3.1.) në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyllin tjetër me destinim të posaçëm; (3.2.) me qëllim që drunjtë e prerë të shiten, pavarësisht sasisë së drurit të prerë, kryesi dënohet më rëndë. Gjykata e Apelit ka konkluduar se pa ekzistimin e veprës bazë penale të vjedhjes së pyllit, i cili është parashikuar me nenin 349 par.1 të KPK, andaj, pa prerjen e sasisë të drunjtëve prej mbi 2 m3, nuk mund të ekziston forma e cilësuar penale nga neni 349 par.3 të KPK-së dhe pasi që në rastin konkret sasia e drunjtëve të prerë ka qenë 1,20 m3, ka konstatuar se veprimet e të dënuarit nuk paraqesin vepër penale.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se faktet relevante në që të dy aktgjykimet janë vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, por se gjykata e shkallës së dytë me lirimin e të dënuarit nga akuza, gabimisht ka aplikuar ligjin penal, në dobi të dënuarit, duke aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet dhe duke bërë shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK-së.

Me të drejtë pretendohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se janë plotësuar elementet e veprës penale nga neni 349 par.3 të KPK, siç janë prerja e drurit me qëllim të të shitjes, në "Bjeshkët të Nemuna" i cili është park i mbrojtur dhe se në këtë situatë, pavarësisht sa është sasia e druve të prerë, plotësohen elementet konstitutive të veprës në fjalë penale.

Edhe sipas konstatimit të Gjykatës Supreme, në nenin 349 par.3 pika 2 të KPK-së qartazi parashihet se sasia e drunjtëve të prerë nuk ka rëndësi, që do të thotë se edhe nëse është nën sasinë prej 2 m3, siç kërkohet në paragrafin 1 të këtij neni, prapë se prapë përmbushen elementet e veprës

penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.3 të KPK-së. Në favor të kësaj është edhe formulimi i paragrafit 3 në të cilin thuhet "nëse vepra penale nga ky nen kryhet..." e jo "nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni" që tregon se vepra bazë, gjegjësisht sasia e cekur në te, nuk është determinuese dhe e parasheh si vepër penale cilëndo vëllim të drunjëve me kusht që është kryer në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyllin tjetër me destinim të posaçëm dhe me qëllim të shitjes, e të gjitha këto elemente në rastin konkret janë plotësuar.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktgjykimi Pml.nr. 224/2019 i datës 25.10.2021**

Edhe aktgjykimi i mëposhtëm i referohet shkeljeve të ligjit penal në dobi të pandehurit, e cila shkelje sikur edhe shihet nga aktgjykimet e prezantuara paraqet shkeljen më të shpeshtë të konstatuar nga Gjykata Supreme. Pra në rastin konkret gjykatat e instancave më të ulëta drejt e kanë vërtetuar gjendjen faktike por gabimisht kanë aplikuar ligjin penal duke konstatuar se në veprimet e të pandehurit nuk formohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet. Esenca e veprimit të kundërligjshëm e të pandehurit është që nuk ka mundësuar konkurrencë ndaj të gjithë operatorëve të cilit i plotësojnë kushtet ligjore për të marrë pjesë në tenderim-konkurrencë. Po të kishte vepruar ashtu, tenderin ka mundur të fitojë ndokush tjetër, ndërsa ai ka mundësuar që drejtë për së drejti punën të fitojnë operatorët e caktuar, me një kontratë të drejtë për të drejt në mes tij dhe operatorëve dhe për këtë ka qenë në dijeni të plotë. Andaj, te i pandehuri ka ekzistuar dashja e cila përfshinë dijeninë e tij se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po i tejkalon kompetencat e tij dhe faktin se me këto veprime ai mundëson përfitim të kundërligjshëm për personin tjetër.

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, konstatohet se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.111/2019 i datës 23.12.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.107/2021 i datës 29.03.2021 janë marrë me shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.111/2019 të datës 23.12.2020 i pandehurit K.G. është liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2.2 të KPRK. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës ndërsa për realizimin e kërkesës pronësoro juridike e dëmtuara është udhëzuar në kontestin civil.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.107/2021 të datës 29.03.2021 është refuzuar si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar. Ankesa e të dëmtuarit, është hedhur si e palejuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit, i cili e mbanë numrin KMLP.I.nr.13/21 e datës 17.05.20121, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që shkeljet të konstatohen.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

- Kërkesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimet e kundërshtuara del se i dënuari ka qenë i akuzuar se në kohën kritike, në cilësinë e kryesuesit të A.K.P, ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare duke e keqpërdorur pasurinë publike, me qëllim të përfitimit të dobisë për personat juridik “Tv. B.” dhe “Tv.O.”, në atë mënyrë që pa procedurat e tenderimit me që të dy personat juridik më datën 08.01.2015 ka lidhur kontrata për transmetim gjegjësisht ritransmetimin e seancave të Asamblesë Komunale dhe pastaj janë autorizuar pagesat, për “Tv. B.” në shumë prej 1.750 euro ndërsa për “Tv.O.” në shumë prej 6.700 euro, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik 04/L-42 Ligjin

mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive nr.03/L-048 dhe Rregulloren e Thesarit 01/2013 për Shpenzimet e Parasë Publike.
Gjykata e shkallës së parë në bazë të mbrojtjes së të pandehurit, kontratave në fjalë, urdhër obligimeve për pagesa dhe provave tjera të administruara e posaçërisht nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit financiar A.Sh, ka konstatuar se janë vërtetuar dhe arsyetuar në mënyrë ligjore të gjitha veprimet të cilat të dënuarit i vihen në barë. Është konstatuar edhe fakti se lidhja e kontratave dhe pagesat janë bërë në kundërshtim me ligjet që më lartë u cituan sepse janë bërë pa procedurat e prokurimit, të cilat me ligj kanë qenë obligative.

Gjykatat kanë vlerësuar edhe mbrojtjen e të pandehurit se ai me lidhjen e këtyre kontratave pa procedurat e prokurimit, e ka vazhduar një praktikë e cila ka ekzistuar në A.K.P, dhe në momentin kur Zyra e Auditorit ka bërë vërejtje, ai këtë praktikë e ka ndërpre. Sipas tij, në Prizren nuk kanë ekzistuar 3 operator për kryerjen e këtyre shërbimeve por vetëm “Tv.B.” dhe “Tv.O.” edhe pse ligji për prokurim ka kërkuar konkurrencën e së paku 3 operatorëve që i plotësojnë kushtet. Qëllimi i tij nuk ka qenë që tjetrit të mundësojë përfitim të kundërligjshëm por që të sigurohet transparenca në punën e Asamblesë Komunale përmes transmetimit dhe ritransmetimit të seancave të saj.

Duke i vlerësuar të gjitha këto, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në konkludim se mbrojtja e të pandehurit është e bazuar sepse te ai nuk ka ekzistuar dashja e drejtpërdrejtë e cila përfshinë dijeninë e tij se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po i tejkalon kompetencat e tij dhe faktin se me këto veprime ai mundëson përfitim të kundërligjshëm për personin tjetër, se qëllimi i tij ka qenë zbatimi i udhëzimit administrativ për transparencën e seancave të Kuvendit për qytetar dhe se nuk është dëshmuar se me veprimet e të pandehurit personi tjetër ka përfituar dobi pasurore të kundërligjshme.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendohet se gjykatat kanë nxjerr konkludime të gabuara lidhur me qëllimin e të dënuarit dhe nuk i kanë dhënë rëndësi të duhur ekspertizës financiare. Sipas ekspertizës, me rastin e zgjidhjes së operatorëve për transmetimin dhe ritransmetimin e seancave të asamblesë komunale është dashur të ketë procedurë të tenderimit gjegjësisht të konkurrimit të lirë edhe të operatorëve tjerë ekonomik të cilët kishin plotësuar kushtet e tenderit. Shmangja nga procedura e tenderimit ka qenë në kundërshtim të plotë me

dispozitat e Ligjit mbi Prokurimin Publik të Kosovës nr.04/L-042 dhe LMFPP dhe kontratat të me Tv.B dhe Tv.O, nuk kanë mundur të nënshkruhen nga i dënuari.

Në përgjigjen ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, në mes tjerash, theksohet se në kërkesë i jepet rëndësi shumë e madhe ekspertizës financiare por se eksperti ka tejkaluar autorizimet e veta sepse ka dhënë opinione juridike ndërsa gjykata me vend ka aplikuar dispozitën e nenit 7 par.2 të KPPK kur i ka vlerësuar të gjitha provat, pra, edhe ato që shkojnë në favor të pandehurit edhe ato që janë të disfavorshme për te dhe ka nxjerr konkludim të saktë me rastin e marrjes së vendimit të vet.

Gjykata Supreme konstatojë se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat në kërkesë pretendohen, e që janë se i dënuari i është përgjigjur disa pyetjeve të prokurorit i në disa jo, sepse kjo është e drejtë e tij ligjore. Mirëpo, janë të bazuara pretendimet për shkeljen e ligjit penal.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, faktet vendimtare të cilat janë cekur në përshkrimin e veprimeve të dënuarit në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë e të cilat u cituan më lart, janë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe plotë, por gjykatat nga kjo gjendje faktike kanë nxjerr konkludime të gabuara lidhur me ekzistimin e veprës penale për të cilën i dënuari akuzohej.

Nga aktgjykimet del se i dënuari e ka ditur se nënshkrimi i kontratave të cilat pasojnë me pagesën e mjeteve publike, duhej të ndodh pas procedurës së tenderimit, gjegjësisht mundësimit të gjithë operatorëve që në mënyrë të barabartë të konkurrojnë për të fituar mundësinë e dhënies së shërbimit-transmetimit dhe ritransmetimit të seancave të Asamblesë Komunale, të cilën ai e ka kryesuar dhe jo të nënshkruhen me cilëndo operator. Ai këtë nuk e ka mohuar duke u mbrojtur se kështu kanë vepruar edhe paraardhësit e tij dhe ne P., nuk ka pas operatorë tjetër përveç Tv. “B.” dhe Tv “O.”. Megjithatë, kjo gjykatë gjen se veprimet dhe praktika eventuale e gabuar e paraardhësve të pandehurit nuk janë justifikim që edhe ai të vazhdojë me veprime të atilla ndërsa nuk është justifikim as fakti se në atë regjion nuk ka pas operator tjerë teknik sepse operatorët nuk zgjidhen nga një territor i caktuar.

Është e gabuar gjetja e gjykatave si dhe pretendimet në përgjigjen ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë se qëllimi i të dënuarit nuk ka qenë që me veprimet e tij personi tjetër të përfitojë në mënyrë të kundërligjshme dhe se operatorët Tv. “B.” dhe Tv “O.”, kanë kryer shërbimet nga kontrata ashtu që pagesat janë bërë mu për këto shërbime, e jo sikur ato të mos të ishin kryer, pra, ata janë paguar për një punë të cilën e kanë kryer. Esenca e veprimit të kundërligjshëm e të pandehurit është që nuk ka mundësuar konkurrencë ndaj të gjithë operatorëve të cilit i plotësojnë kushtet ligjore për të marrë pjesë në tenderim-konkurrencë. Po të kishte vepruar ashtu, tenderin ka mundur të fitojë ndokush tjetër, ndërsa ai ka mundësuar që drejtë për së drejti punën të fitojnë operatorët e caktuar, me një kontratë të drejtë për të drejt në mes tij dhe operatorëve dhe për këtë ka qenë në dijeni të plotë. Andaj, te i pandehuri ka ekzistuar dashja e cila përfshinë dijeninë e tij se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po i tejkalon kompetencat e tij dhe faktin se me këto veprime ai mundëson përfitim të kundërligjshëm për personin tjetër.

Nga këto arsye Gjykata Supreme konstatojë se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje të ligjit penal ndaj të pandehurit, shkelje kjo nga neni 385.pika 4.të KPPK sepse me aplikimin e drejtë të ligjit penal veprimet e tij duhej të konsideroheshin si vepër penale dhe kjo shkelje, në bazë të nenit 438 par.2 të KPPK, vetëm u konstatua, pa ndikuar në vendimin e formës së prerë.

PRAKTIKA GJYQËSORE E GJYKATËS SUPREME NË ÇËSHTJE CIVILE

Kapitulli VI

CENIMI I PJESËS SË DOMOSDOSHME, ANULIMI I KONTRATAVE, TESTAMENTEVE E TË TJERA

1. Kush janë trashëgimtaret e domosdoshëm

Dispozita ligjore: Ligjit mbi Trashëgiminë i Republikës së Kosovës (më tutje LTK), neni 30.1 i cili definon "Trashëgimtarë të domosdoshëm janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshortët". Neni 30.2 Gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat dhe vëllezërit e trashëgimlënësit, janë trashëgimtarë të domosdoshëm, vetëm në qoftë se janë plotësisht të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete për jetesë. Neni 30.3. Personat e cekur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni janë trashëgimtarë të domosdoshëm kur sipas radhës ligjore të trashëgimit janë thirrur për trashëgim.

1.2 Trashëgimia e domosdoshme

Pjesa e domosdoshme e pasurisë trashëgimore është ajo pjesë e pasurisë me të cilën trashëgimlënësi nuk mundet të disponojë. Në këtë pjesë, të drejtë ekskluzive në trashëgim kanë trashëgimtarët e domosdoshëm. (Shih LTK-në , nenin 30 par.1 dhe 2). Pjesa e domosdoshme e bashkëshortit pasjetues dhe pasardhësve është ½, ndërsa pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të tjerë është 1/3 e pjesës që do t'i takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi radhët e trashëgimit (po aty, shih nenin 31, par. 31.1 dhe 31.2). Pjesa e domosdoshme dhe disponibile e pasurisë trashëgimore.

1.3 Neni 32.1 Llogaritja e pjesës së domosdoshme

Vlera e pasurisë trashëgimore në bazë të së cilës llogaritet pjesa e domosdoshme, llogaritet në këtë mënyrë: së pari, inventarizohen dhe vlerësohen të gjitha të mirat që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes, duke llogaritur këtu të gjitha ato që ka disponuar me testament, si dhe të gjitha borxhet që ia kanë të tjerët, edhe ato që ia ka ndonjë trashëgimtar, me përjashtim të borxheve që qartazi nuk mund të arkëtohen

Nga vlera e përcaktuar e të mirave që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes zbritet shuma e borxheve të tij, shuma e shpenzimeve të inventarizimit e të vlerësimit të pasurisë trashëgimore dhe e shpenzimeve të varrosjes së trashëgimlënësit

Pjesës që mbetet i shtohet vlera e të gjitha dhurimeve që trashëgimlënësi ka bërë në çfarëdolloj mënyre ndaj ndonjë trashëgimtari ligjor, madje edhe e dhurimeve që u ka bërë trashëgimtarëve që heqin dorë nga trashëgimia, si dhe e atyre dhurimeve për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore. Kësaj shume i shtohet edhe vlera e dhurimeve që trashëgimtari në vitin e fundit të jetës së tij u ka bërë personave të tjerë që nuk janë trashëgimtarë ligjorë, me përjashtim të dhurimeve të rëndomta.

1.4 Dhurimi i pasurisë, kontratat e dhurimit dhe ato të mbajtjes së përjetshme

Në nenin 33 të Ligjit mbi Trashëgiminë të Kosovës parashihet se: "dhurimi" konsiderohet si heqje dorë nga një e drejtë, falja e borxhit, çdo transferim i pasurisë në interes të një trashëgimtari në emër të pjesës trashëgimore, ose për të themeluar apo për të zgjeruar familjen, ose për të ushtruar mjeshtërinë, si dhe çdo disponim tjetër pa shpërblim. Kontratat e përjetshme nuk e cenojnë pjesën e domosdoshme, përveç në rastet kur lidhen duke mos e pas qëllim mbajtjen por favorizimin e njërit trashëgimtar apo përjashtimin e tjetrit.

1.5 Komente për mënyrën e zbatimit të dispozitave të cituara më lart

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj ka gjetur se pjesa e domosdoshme cenohet me veprimet e pronarit përtej pjesës me të cilën e ka të lejuar të disponoi, ose kur disponon me atë pjesë në kundërshtim me ligjin, si veprim i pronarit ose në disa raste edhe si veprim i trashëgimtareve duke përjashtuar njërin ose disa prej tyre. Disponimi i pronarit manifestohet përmes kontratës së faljes së pronës njërit nga trashëgimtareve duke përjashtuar trashëgimtaret e tjerë, testamenti i lënë në format e parapara me ligj nga i cili është cenuar pjesa e domosdoshme e trashëgimtareve të tjerë në dobi të njërit trashëgimtarë. Përjashtimi i qëllimshëm i njërit ose më shumë trashëgimtareve me qëllim përfitimi nga trashëgimtaret tjerë, sidomos në praktikën e hasur nga Gjykata Supreme ndodh më së shpeshti tek pasardhësit femra.

Trashëgimia sipas nenit 1.2 të LTK-së nënkupton kalimin me ligj, ose në bazë të testamentit, të pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek një ose më shumë persona (trashëgimtarët ose legatarët) sipas rregullave të caktuara me ligj. Nga kjo rezulton se: me LTK-në parashihen vetëm dy baza të fitimit të pronësisë në bazë të trashëgimit, njëra në bazë të testamentit të personit të vdekur, dhe tjetra, në bazë të rregullave të caktuara me LTK-së. Këto dy

baza të fitimit të trashëgimisë parashihen edhe në nenin 8 të LTK-së *"Trashëgimia fitohet me ligj ose testament. "*

Çdo trashëgimtari ligjor domosdo i takon pjesa e domosdoshme në kushtet e parapara me dispozitat imperative ligjore, madje edhe kundër vullnetit të vet trashëgimlënësit. Personave të cilëve u është garantuar e drejta e trashëgimisë quhen **trashëgimtar të domosdoshëm**, ndërsa pjesa e pasurisë në të cilën ata kanë të drejtë quhet pjesë e domosdoshme. Me dispozitat e cituara definohet në mënyrë të qartë se kush janë trashëgimtarët e domosdoshëm të cilët, në mënyrën e paraparë, pa kushte e fitojnë këtë cilësi dhe cilët janë trashëgimtarët e tjerë të domosdoshëm, të cilët e fitojnë këtë cilësi me kusht.

Personat e cekur në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 30 janë trashëgimtarë të domosdoshëm, kur sipas radhës ligjore të trashëgimisë janë thirrur në trashëgim. **Në grupin e parë** të trashëgimtarëve të domosdoshëm bëjnë pjesë trashëgimtarët e radhës së parë të trashëgimit dhe trashëgimtarët e radhës së dytë të trashëgimit, *por në radhën e dytë vetëm trashëgimtarët e kësaj radhe pa u përfshirë edhe pasardhësit e tyre*. Në grupin e trashëgimtarëve ligjorë, të cilët e kanë cilësinë e trashëgimtarit të domosdoshëm në radhën e dytë, pa diskutim janë bashkëshortja e trashëgimlënësit dhe prindërit e trashëgimlënësit, por jo edhe vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit të cilët në fakt janë pasardhësit e trashëgimtarëve të rendit të dytë, të prindërve të trashëgimlënësit. Ky grup i trashëgimtarëve e fitojnë këtë cilësi sipas ligjit dhe nuk nevojitet plotësimi i asnjë kushti për cilësinë e trashëgimtarit të domosdoshëm. Në grupin e dytë të trashëgimtarëve të domosdoshëm me kusht, janë trashëgimtarët që vijnë në radhë sipas përfaqësimit në radhën e dytë të trashëgimisë dhe atë sipas përfaqësimit të prindërve të trashëgimlënësit dhe trashëgimtarët e radhës së tretë të trashëgimit, por jo edhe përfaqësuesit e tyre. Trashëgimtarët e grupit të dytë për ta fituar cilësinë e trashëgimtarit të domosdoshëm duhet të plotësojnë kushtin e kërkuar me dispozitën e nenit 30, paragrafit 2, të LTK-së.

Trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pasurinë trashëgimore me të cilën trashëgimlënësi nuk mund të disponojë dhe e cila quhet *pjesë e domosdoshme*. Realisht pjesa e domosdoshme është pjesa e pasurisë e cila u takon trashëgimtarëve të domosdoshëm edhe përkundër vullnetit të trashëgimlënësit. Me dispozitën e nenit 30, paragrafit 2, është paraparë se: *"pjesa e domosdoshme e pasardhësve dhe e bashkëshortit përbën ½, ndërsa pjesa e domosdoshme*

e trashëgimtarëve të tjerë 1/3 e pjesës që do t'i takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi radhët e trashëgimisë.

Cenimi i pjesës së domosdoshme të trashëgimit bëhet me rastin e shprehjes së vullnetit të trashëgimlënësit për së gjalli, për ndarjen e pasurisë së tij trashëgimore me testament apo dhurim. Jo rrallë ndodh që testatori, me rastin e bërjes së testamentit i përjashton nga trashëgimia, një apo më tepër trashëgimtar ligjor, duke ia lënë me testament tërë pasurinë e tij trashëgimore, vetëm njërit prej trashëgimtarëve ligjor të tij, duke cenuar në këtë mënyrë pjesën e tyre të domosdoshme të trashëgimit.

Në rastet kur është cenuar pjesa e domosdoshme për shkak të disponimeve të trashëgimlënësit gjatë jetës së tij me testament dhe dhurime, LTK-së ka paraparë edhe mundësinë e disponimeve si me testament ashtu edhe dhurimet por deri në kufijtë e pjesës me të cilën mund të disponojë. Kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme. Pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën disponibile. Kjo vlerë përfshin dhurime dhe disponime me testament për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit të domosdoshëm në pjesën trashëgimore të tij.

Sipas dispozitave të LTK-së, zvogëlimi i disponimeve nëse është cenuar pjesa e domosdoshme fillimisht do të bëhet për disponimet me testament e pastaj nëse nuk plotësohet edhe më tutje pjesa e domosdoshme, atëherë do të zvogëlohen edhe disponimet përmes dhurimit deri në masë që përmbushet pjesa e domosdoshme. LTK e ka përcaktuar edhe radhën e zvogëlimit dhe kthimit, duke paraparë me dispozitën e nenit 39, paragrafin 1, se: "Kur cenohet pjesa e domosdoshme, më parë zvogëlohen disponimet me testament dhe nëse pjesa e domosdoshme nuk plotësohet në këtë mënyrë, atëherë kthehen dhurimet". Nëse trashëgimlënësi gjatë jetës se tij ka disponuar një pjesë të pasurisë së tij edhe me testament edhe me dhuratë, atëherë në kontekstin e kësaj dispozite rezulton se fillimisht do të zvogëlohet disponimi me testament dhe pastaj do të zvogëlohet edhe dhurimi.

Në praktikën gjyqësore ekzistojnë raste kur gjykata ka vendosur për zvogëlimin e disponimeve me testament. Disponimet me testament zvogëlohen në të njëjtën masë, pa marrë parasysh natyrën e tyre dhe vëllimin e tyre dhe pa marrë parasysh a gjenden në një ose më shumë testamente, po që se nga testamenti nuk del diçka tjetër. Trashëgimlënësi ka mundësi që ta përcaktoj radhën e

zvogëlimeve me testament, por nëse nuk ka dhënë një urdhër të tillë atëherë në kuptim të dispozitës së nenit 40 të LTK-së, zvogëlimi bëhet në mënyrë proporcionale. Zvogëlimi proporcional i shërben sigurisë dhe barazisë kur bazë e thirrjes në trashëgimi është testamenti.

E njëjta gjë vlen edhe për disponimet me testament sa i përket legut, përveç nëse trashëgimlënësi ka përcaktuar se një leg është i privilegjuar. Për legun e privilegjuar me dispozitën e nenit 41 të LTK-së është paraparë se: "Në qoftë se trashëgimlënësi ka lënë disa legë dhe ka urdhëruar që ndonjë leg të paguhet para të tjerëve, ky leg do të zvogëlohet vetëm nëse vlera e legëve të tjerë nuk mjafton për t'u plotësuar pjesa e domosdoshme".

Në qoftë se trashëgimlënësi ka disponuar me një pjesë të pasurisë përmes dhurimeve atëherë me dispozitat e LTK-së, është paraparë edhe radha e kthimit të dhurimeve. Kthimi i dhurimeve bëhet duke filluar nga dhurimi i fundit dhe vazhdon në të kundërtën me radhë tek dhurimet më të hershme (neni 43 paragrafi 1 i LTK-së). Dhurimet e bëra njëkohësisht kthehen në mënyrë proporcionale nga vlera e dhurimit (neni 43 paragrafi 2 i LTK-së). Zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve me të cilat është cenuar pjesa e domosdoshme, mund ta kërkojnë vetëm trashëgimtarët e domosdoshëm dhe atë brenda afatit prej tri vitesh nga shpallja e testamentit dhe kthimi i dhurimeve brenda afatit prej tri vitesh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja e tij. Gjykatat gabimisht i trajtojnë kontratat ku pretendohet se është cenuar pjesa e domosdoshme në aspektin e rrezueshmerisë dhe nulitet ndërsa ato duhet të trajtohen në aspektin e cenimit të pjesë së domosdoshme.

Për qëllime të sqarimit të dispozitave të LTK-së, më poshtë do të paraqesim rastet përmes praktikës së Gjykatës Supreme të Kosovës, prishjes së vendimeve të gjykatave të instancës më të ultë.

1) Kur cenohet pjesa e domosdoshme

Kjo situatë në vendin tonë ndodh edhe për shkak të ndikimit zakonor, cenohet në mënyrën më të rëndë e drejta në trashëgimi, sepse një pjesë e trashëgimtarëve, zakonisht femrat, nuk përfshihen në këtë ndarje të pasurisë e cila në fakt në të ardhmen pas vdekjes se trashëgimlënësit do të përbënte masën trashëgimore. Kjo mënyrë e ndarjes faktike të pasurisë së trashëgimlënësit bëhet për së gjalli të trashëgimlënësit, por pa ndjekur procedurën ligjore. Zakonisht në praktikë trashëgimlënësi i ndanë secilit prej trashëgimtarëve (zakonisht meshkujve) nga një pjesë të pasurisë së tij, duke

përjashtuar kështu një pjesë tjetër të trashëgimtarëve. Kjo është një prej mënyrave të vrazhda të cenimit të së drejtës në trashëgimi sepse në shumicën e rasteve trashëgimtarët pas vdekjes së trashëgimlënësit, për shkak të kohëzgjatjes së madhe që ka ndodh nga ndarja faktike e deri të vdekja e trashëgimlënësit, dekurajohen për ta kërkuar të drejtën e tyre. Madje në shumicën e rasteve heqin dorë në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë në favor të trashëgimtarëve që kanë përfituar nga ndarja faktike.

- ***Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.452/2020, datë 07.05.2021***

Gjykata Supreme, ka arritur në përfundim se aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë janë nxjerrë me shkeljet thelbësore të lartpërmendura të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se gjykata e shkallës së dytë dhe të parë, në vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit, nuk kanë dhënë arsye sa i përket vendosjes, dhe për cilat arsye gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve, dhe pretendimi i tyre se me testamentin III Nd.nr.100/95, i datës 28.09.1995, është cenuar pjesa e domosdoshme e paditësve, është jo i bazuar, ndonëse kanë pasur obligim ligjor konform nenit 160 par.4, të LPK-së, me të cilin përcaktohet "Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.", e në rastin konkret gjykatat kanë dështuar të japin arsye lidhur me faktin vendimtar, nëse kemi cenim të pjesës së domosdoshme.

Gjykata e shkallës së parë ka dështuar të japë arsye nëse pjesa e domosdoshme e paditëseve është cenuar, ndërsa gjykata e shkallës së dytë e ka pranuar këtë qëndrim, pa dhënë ndonjë arsye të qartë se pse e pranon këtë qëndrim dhe për cilat arsye ka konsideruar se nuk është cenuar pjesa e domosdoshme.

Gjykata Supreme e Kosovës ka arsyetuar se, "*Sipas dispozitave ligjore pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën disponibile. Kjo vlerë përfshin dhurime dhe disponime me testament për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit të domosdoshëm në pjesën trashëgimore të tij, në rastin konkret gjykata nuk ka dhënë arsye se cila ka qenë pjesa e domosdoshme dhe nëse pjesa e lënë trashëgimi dy trashëgimtarëve, të paditurve ka cenuar pjesën e domosdoshme të trashëgimtarëve tjerë, tani paditëseve".*

Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se, “bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, është e paraparë se palët kanë për detyrë që t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, andaj përgjatë tërë zhvillimit të procedurës, gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse, kështu që në rastin në fjalë, gjykata nuk ka pasur tagër që ex officio të administroj prova të tjera përpos atyre të propozuara nga palët”, nuk mund ta pranoj Gjykata Supreme, pasi në rastet kur gjykata me qëllim të vendosjes së drejtë të çështjes dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes, ka obligim që edhe ex-oficio të caktoj nxjerrjen e ekspertizës përmes ekspertit përkatës, kjo është përcaktuar me nenin 356 të LPK-së, dhe nenit 21 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

Në rastin konkret nëse gjykata nuk ka mundur që të arrijë në përfundim se ka cenim të pjesës së domosdoshme të paditëseve me testamentin III Nd.nr.100/95, të datës 28.09.1995, pasi nuk ka dhënë arsye sa i përket këtij pretendimi, andaj është dashur që faktin nëse kemi cenim të pjesës së domosdoshme ta vërtetoj përmes nxjerrjes së ekspertizës, pasi ka qenë e domosdoshme për të aplikuar drejt të drejtën materiale për vendosje sa i përket kërkesëpadisë së paditëseve.

Për shkak të përfshirjes së aktgjykimit të shkallës së dytë dhe të parë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vlerësohet se tani për tani edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj është vendosur që çështja të kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallë së parë. Në rigjykim, gjykata e shkallë së parë duhet të veproj sipas vërejtjeve të lartcekura, të nxjerrë ekspertizat përkatëse për të vlerësuar nëse ka cenim të pjesës së domosdoshme me testamentin III Nd.nr.100/95, i datës 28.09.1995, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit mbi Trashëgiminë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.43, 01.01.1975), i cili ka qenë ligj në fuqi me rastin e përpilimit të testamentit, anulimi i të cilit kërkohet me pretendim se është cenuar pjesa e domosdoshme. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit duhet të japë arsye të plota lidhur me vendosjen si në dispozitiv të vendimit.

Rasti kur është fshehur ose anashkaluar njëri trashëgimtar.

- ***Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.133/2021 i datës 04.08.2022***

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk e pranoi qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 pika (n) të LPK-së, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 182.1 lidhur me nenin 194 dhe 204 të LPK-së, për të cilin shkak të dy aktgjykimet patjetër është dashur të prishen.

Si me ankesë ashtu edhe me revizion kontestohet ligjshmëria e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, me arsyetim se aktgjykimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë kontradiktor, nga mënyra e vendosjes dhe arsyet e dhëna, të cilin pretendim si të bazuar e pranon edhe kjo gjykatë.

Në aktgjykimin e shkallës së parë shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, qëndron për faktin se aktgjykimi i ankimuar në pikën një, e cila pjesë është objekt i shqyrtimit, është i përfshirë me të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është kontradiktor dhe kundërthënës dhe në kundërshtim të plotë me vet arsyet e dhëna, si dhe provat në shkresat e lëndës, vendosja "*është pronare në bazë të kontributit dhe sipas të drejtës së trashëgimisë në 1/4 pjesë ideale, në patundshmërinë e cila gjendët në lagjen, "...", Komuna e P., të regjistruar në certifikatën mbi të drejtat e pronësisë së paluajtshme me numër të ngastrave si dhe është pronare në pjesën e shtëpisë familjare të ndërtuar në parcelën kadastrale nr.... ZK P., dhe atë banesës në katin e parë, mbi përdhese, me sipërfaqe prej 80m², me të drejtë të shfrytëzimit të hyrjes së përbashkët*", në bazë të këtij dispozitvi është e paqartë se në cilën bazë është aprovuar kërkesëpadia e paditëses Sh. L, ndërsa kjo bëhet kontradiktore edhe nga arsyet e dhëna në arsyetim. Po ashtu sa i përket vendosjes "*si dhe është pronare në pjesën e shtëpisë familjare të ndërtuar në parcelën kadastrale nr... ZK P., dhe atë banesës në katin e parë, mbi përdhese, me sipërfaqe prej 80m², me të drejtë të shfrytëzimit të hyrjes së përbashkët*" është vendosje pa të dhëna të mjaftueshme për ekzekutim, që e bënë aktgjykimin e pa përmbarueshëm në këtë pjesë.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në aktgjykim, ku paditëses Sh. L., i është njohur e drejta e pronësisë në *paluajtshmërinë kontestuese në dy baza, në bazë të kontributit dhe*

*trashëgimisë***,** si dhe pranimit të këtij qëndrimi edhe nga gjykata e shkallës së dytë, për Gjykatën Supreme është e papranueshme, për faktin se këto dy baza garojnë njëra me tjetrën që do të thotë se e përjashtojnë njëra tjetrën, pretendimi i paditëses Sh. L. se ka pasuri e cila është krijuar me kontributin e paditëses, duhet të jetë konkret, në këtë rast duhet të vërtetohet se cila është kjo pasuri, dhe të veçohet nga masa e trashëgimisë, pasi nuk hyn fare në masën e trashëgimisë.

Për Gjykatën Supreme nuk është kontestuese se me aktvendimin trashëgimor T.nr.17/97 të datës 21.01.1998, si trashëgimtarë janë shpallur tre djemtë e të ndjerit dhe i ndjeri I., ish bashkëshorti i paditëses Sh. L., *por kjo gjykatë nuk mund të pranoj përfundimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, se paditësja e trashëgon në tërësi masën trashëgimore të ndjerit I. L., për faktin se gjatë jetës bashkëshortore paditësja dhe i ndjeri I. L., nuk kanë pasur fëmijë, apo të paktën në këtë përfundim ka arritur kjo gjykatë, andaj në këtë situatë duhet të aplikohen dispozitat e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë***,** pasi është ligj i aplikueshëm për shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit I. L., ndërsa sa i përket këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë dhe e dytë nuk kanë dhënë arsye, andaj mos arsyetimi i fakteve qenësore, aktgjykimin e shkallës së parë e bënë kontradiktor, pjesën e dispozitivit dhe arsyet e dhëna, si dhe me shkresat e lëndës, për të cilën arsye ka pasur pretendime ankimore kundër aktgjykimit të shkallës së parë nga i padituri R. L., andaj gjykata e shkallës së dytë është dashur që t'i trajtoj dhe t'i evidentoj këto shkelje.

Sipas Gjykatës Supreme, aktgjykimit të shkallës së parë por edhe të shkallës së dytë i mungojnë arsyet për mënyrën e vendosjes për faktet vendimtare, për më tepër arsyet e dhëna janë kontradiktore në mes vete, nuk janë arsyetuar provat e administruara, të cilat janë në kundërshtim me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata Supreme vlerëson se *në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka aplikuar asnjë dispozitë konkrete të drejtës materiale, por vetëm ka pasur referencë dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë pa theksuar cila dispozitë është aplikuar me rastin e vlerësimit si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, po ashtu njëjtë ka vepruar edhe gjykata e shkallës së dytë, që është shkelje nga neni 184 të LPK-së***,** ku është përcaktuar "Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.", ndërsa me nenin 160.5, të LPK-së, është përcaktuar "Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Në rastet kur paraqitet nevoja, gjykata

deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor."

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e lartpërmendura, (kërkesa sipas padisë të jetë e qartë), duke i pasur parasysh edhe thëniet e tjera të ankesës dhe revizionit, ashtu që të trajtojë dhe të vlerësojë të gjitha pretendimet e palëve për objektin e kërkesëpadisë, ashtu që të saktësojë se për cilën pjesë paditëses Sh. L. i është njohur e drejta e pronësisë sipas kontributit dhe në cilën pjesë në bazë të trashëgimisë, duke e trashëguar të ndjerin ish bashkëshortin e saj I. L.. Ashtu që me rastin e vendosjes, të mund të vendoset pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, përmes administrimit të provave, dhe gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të aktgjykimit duhet të ketë kujdes që i njëjti të jetë në përputhje me nenin 160 të LPK-së, ashtu që vendimi të jetë i ligjshëm me referenca të qarta në dispozita konkrete ligjore të aplikuara me rastin e vendosjes për kërkesëpadinë, si dhe të përmbajë arsye për faktet vendimtare të vendosjes.

Paditësja dhe bashkëshorti i saj, me mjetet e tyre financiare kanë kontribuar më së shumti në ndërtimin e shtëpisë familjare, meqë ishin të punësuar dhe kishin mundësi materiale më shumë se të tjerët e duke përjashtuar kontributin e të paditurit Gj., i cili as fizikisht nuk ka qenë në Pejë, se paditësja pas vdekjes së bashkëshortit të saj, ka interes juridik që të vërtetohet kontributi i saj dhe i bashkëshortit në objektin familjar, duke mos e kontestuar pjesën që i takon të paditurve-trashëgimtarëve të të ndjerit S., sipas aktvendimit T.nr.19/97, se paditësja pret se është pronare e pjesës ideale e objektit familjar ashtu si ishte bërë ndarja me të paditurit S. dhe R., e patundshmërisë nga fleta poseduese Nr... dhe ... ZK P... përveç pjesës që i është shitur familjes B.

Gjykata Supreme, arsyeton më tej se në momentin kur trashëgimtari kupton se *nuk është përfshirë në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë ka të drejtë të kërkoj mbrojtje gjyqësore pranë gjykatës kompetente. Në këtë rast nuk kërkohet anulimi i aktvendimit të gjykatës me të cilin është vendosur për trashëgiminë por kërkohet me padi e drejta sipas pas bazës së trashëgimisë në masën që trashëgimtari ka të drejtë si trashëgimtar ligjor. Nuk kërkohet anulimi i aktvendimit për trashëgimin sepse ai është vendim i natyrës deklarative që shërben për regjistrimin e të drejtës sipas trashëgimisë por nuk përbën akt me të cilin kërkesa e trashëgimtarit të pa përfshirë do të konsiderohej e gjykuar.*

Këto situata nga ana e gjykatave duhet të trajtohen me kujdes të duhur edhe në fazën e sigurimit të kërkesëpadisë, sepse, rëndom në këto raste në gjykatë parashtrohet edhe kërkesa për sigurimin e kërkesëpadisë. Natyrisht këtu duhet aprovuar kërkesa për sigurimin e kërkesëpadisë dhe rrjedhimisht edhe kërkesëpadia.

Situata kur cenohet pjesa e domosdoshme me testament apo dhuratë përfshirë edhe sigurimin e pjesës së domosdoshme nga pjesa e disponuar me testament apo kthimi i dhuratave

- ***Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.114/2022, datë 12.07.2022***

Përveç tjerash aktgjykimi i shkallës parë është marr edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: padia nuk përmban elementet që duhet ti përmbajë çdo parashtresë, në fakt kërkesa në padi është e pa qartë dhe e pa kuptueshme dhe se nuk është e specifikuar saktë kërkesa se çka kërkon paditësi në këtë rast. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit është dashur që padinë e paditësit ta kthejë në korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë përfshirë edhe me *zbatim të gabuar të së drejtës materiale* që rregullojnë llogaritjen e pjesë së domosdoshme dhe zvogëlimin e vlerës, përshirë edhe kthimin e dhuratave. Gjykata Supreme në arsyetimin e saj jep sqarime për mënyrën e llogaritjes së pjesës së domosdoshme.

Me nenin 32 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: *“ Vlera e pasurisë trashëgimore në bazë të së cilës llogaritet pjesa e domosdoshme llogaritet në këtë mënyrë: ”,* me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “ Së pari, inventarizohen dhe vlerësohen të gjitha të mirat që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes, duke llogaritur këtu të gjitha ato që ka disponuar me testament, si dhe të gjitha borxhet që ia kanë të tjerët, edhe ato që ia ka ndonjë trashëgimtar, me përjashtim të borxheve që qartazi që nuk mund të arkëtohen ”, me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “ Nga vlera e përcaktuar e të mirave që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes zbritet shuma e borxheve të tij, shuma e shpenzimeve të inventarizimit e të vlerësimit të pasurisë trashëgimore dhe e shpenzimeve të varrosjes së trashëgimlënësit ”, dhe me paragrafin 4 të këtij neni, përcaktohet se: “ Pjesës që mbetet i shtohet vlera e të gjitha dhurimeve që trashëgimlënësi ka bërë në çfarëdolloj

mënyre ndaj ndonjë trashëgimtari ligjor, madje edhe e dhurimeve që u ka bërë trashëgimtarëve që heqin dorë nga trashëgimi, si dhe e atyre dhurimeve për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore ".

Me nenin 33 të këtij ligji, përcaktohet se: "Në kuptim të këtij Ligji *"dhurim",* konsiderohet çdo heqje dorë nga një e drejtë, falja e borxhit, çdo transferim i pasurisë në interes të një trashëgimtari në emër të pjesës trashëgimore, ose për të themeluar apo për të zgjeruar familjen, ose për të ushtruar mjeshtërinë, si dhe çdo disponim tjetër pa shpërblim *" Me nenin 34 të këtij ligji, përcaktohet se: " Për vlerësimin e dhurimit merret vlera e sendit të dhuruar në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit, e sipas gjendjes së tij në kohën e dhurimit të bërë".*

Me nenin 38 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: " Kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *"Pjesa e domosdoshme cenohet kur vlera e përgjithshme e disponimit me testament dhe e dhurimit tejkalon pjesën disponibile. Kjo vlerë përfshin dhurime dhe disponime me testament për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit të domosdoshëm në pjesën trashëgimore të tij".*

Me nenin 39 paragrafin 1 të këtij ligji, përcaktohet se: " Kur cenohet pjesa e domosdoshme, më parë zvogëlohen disponimet me testament dhe nëse pjesa e domosdoshme nuk plotësohet në këtë mënyrë, atëherë kthehen dhurimet", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se*: " Nëse dhurata nuk mund të kthehet si send (in rem), personi që ka marrë dhuratën duhet të kthejë vlerën e saj sipas dispozitave mbi kthimin në rast të pasurimit pa bazë ".*

Me nenin 43 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: "Kthimi i dhurimeve bëhet duke filluar nga dhurimi i fundit dhe vazhdon në të kundërtën me radhë tek dhurimet më të hershme", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: " Dhurimet e bëra njëkohësisht kthehen në mënyrë proporcionale nga vlera e dhurimit ".

Me nenin 45 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: "Zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve me të cilat është cenuar pjesa e domosdoshme mund ta kërkojnë vetëm trashëgimtarët e domosdoshëm", dhe me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: "Kjo e drejtë nuk mund të cenohet nga kreditorët e trashëgimtarit të domosdoshëm".

Me 46 të këtij ligji, përcaktohet se: *"Zvogëlimi i disponimeve me testament mund të kërkohet brenda afatit prej tri vitesh nga shpallja e testamentit dhe kthimi i dhurimeve brenda afatit prej tri vitesh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja e tij".*

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk e pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit për arsye se: sipas vlerësimit të kësaj Gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Trashëgimia e domosdoshme ligjore në vetvete nënkupton kufizimin e bazës së disponimit me tërë pasurinë nga ana e trashëgimlënësit dhe ky institut ka të bëjë me një pjesë të caktuar të trashëgimisë dhe me një rreth të caktuar të personave. Në këtë kuptim me vullnetin e tij të fundit nuk mundet që në masë të pakufizuar të disponoj me pasurinë e tij dhe se është i detyruar që një pjesë të pasurisë si masë trashëgimore t'ua lë rrethit të caktuar të personave - trashëgimtarëve siç përcaktohet me dispozitat e LTK-së. Pavarësisht kësaj sipas LTK-së, ekziston mundësia që me testament në rastet e caktuara testatori të mund të disponoj me tërë pasurinë e tij, përjashtimisht në rastet kur plotësohen kushtet ligjore për përjashtimin nga trashëgimia ose privimi nga pjesa e domosdoshme.

Pjesa e domosdoshme është e përcaktuar me dispozitat e lartcekura të LTK-së, dhe si e tillë mund të cenohet kur me testament, ose me ndonjë punë tjetër juridike, për në rast vdekje testatori e ka shpërndarë tërë pasurinë e tij dhe trashëgimtarëve të domosdoshëm nuk iu ka lënë asgjë, si dhe në rastet kur testatori duke disponuar me pasurinë e vet me testament ose me ndonjë punë tjetër juridike trashëgimtareve të domosdoshëm iu lenë pjesë më të vogla të trashëgimisë se sa atyre që do t'u takonte sipas ligjit.

Në rastet kur vjen deri te cenimi i pjesës së domosdoshme trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë që të sigurohen nga masa trashëgimore një pjesë që do ti përgjigjej pjesës së domosdoshme. Realizimi i pjesës së domosdoshme mund të bëhet në dy mënyra; a) pjesa e domosdoshme mund të sigurohet nga pasuria që trashëgimlënësi ka disponuar me testament dhe b) kthimin e dhuratave

që i ka dhuruar personave të caktuar me ligj, në afatin e caktuar ligjor nëse nuk ka urdhëruar se në çfarëdo mënyre të sigurohet pjesa e domosdoshme. Ndërsa mënyra e zvogëlimit të disponimeve me testament apo kthimin e dhuratave për realizimin e pjesës së domosdoshme është përcaktuar me nenin 39 të LTK-së.

Kthimi i dhuratave vjen në shprehje për realizmin e pjesës së domosdoshme në rastet kur me zvogëlimin e disponimeve me testament nuk mund të përmbushet cenimi i pjesës së domosdoshme dhe kthimi i dhuratave bëhet në atë mënyrë duke filluar nga dhurata e fundit dhe shkohet kundrejt radhës sipas të cilës janë të dhuruara dhuratat të cilat duhet të kthehen vetëm në atë masë sa është e nevojshme për realizimin e pjesës së domosdoshme dhe me dispozitat e LTK-së, është përcaktuar saktë pozita e dhuratëmarrësit se çka ai duhet të kthejë, ndërgjeshmëria e tij dhe gjendja në të cilën duhet të kthehet dhurata.

Sipas dispozitave të LTK-së, procedura për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme duhet të zhvillohet nga gjykata trashëgimore gjatë shqyrtimit të trashëgimisë vetëm sipas propozimit të palës së interesuar - gjegjësisht trashëgimtarit të domosdoshëm, i cili mund të kërkojë zvogëlimin e disponimit me testament dhe kthimin e dhuratave, me të cilat dhurata është cenuar pjesa e tij e domosdoshme, mirëpo nëse trashëgimtari i domosdoshëm nuk ka marrë pjesë në procedurë trashëgimore, për arsyet e caktuara sipas dispozitave të LTK-së, ai mundet që me padi në procedurë të veçantë të parashtroj kërkesë për shkak të realizimit të pjesës së domosdoshme duke kërkuar zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhuratave.

Sipas dispozitave të LTK-së, afati për paraqitjen e kërkesës për zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve me të cilat është cenuar pjesa e domosdoshme, është tri vjet nga shpallja e testamentit dhe kthimi i dhurimeve brenda afatit prej tri vitesh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja e tij dhe nëse kërkesa paraqitet pas afateve të caktuara sipas dispozitave të LTK-së, kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës.

Në rastin konkret Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm edhe për faktin se të njëjtat nuk kanë arsyetuar faktet vendimtare mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë dhe atë se: Gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dal në vend shikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës/ave kadastrale - kontestuese, në të cilat pala paditëse ka pretenduar se është cenuar pjesa e domosdoshme, gjykata

nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi, të identifikojë saktësisht se cila është/janë parcela/t kadastrale apo pjesa e saj/tyre, në të cilën ka pretenduar se ka të drejtën në realizimin e pjesës së domosdoshme, më saktësisht si në kërkesëpadi lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj/tyre, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë/ve kontestuese dhe cila është gjendja faktike në terren lidhur më atë/ato parcelë/a kadastrale, ekspertiza e ekspertit gjeodet është e mangët, jo e plotë madje edhe konfuze, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se nuk ekzistojnë asnjë nga kushtet se kontrata mbi dhuratën është nule në kuptim të dispozitave të LMD-së,

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që t'i evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave, rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktojë shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerrë prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lart, pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dalë në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë palët, të udhëzojë ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtëshmërisë/ve kontestuese dhe të vërtetojë se a është cenuar pjesa e domosdoshme në rastin konkret.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në praktikën gjyqësore të Republikës së Kosovës, formë mjaftë e shpeshtë e cenimit të pjesës së domosdoshme të trashëgimit është kur trashëgimlënësi si dhuratëdhënës, i falë njërit prej trashëgimtarëve ligjor pjesërisht apo në tërësi pasurinë e tij trashëgimore.

Këto kontrata mbi dhurimin, dhuratëdhënësit zakonisht i bëjnë për t'ia shpërblyer njërit prej trashëgimtarëve ligjor mundin e tij për përkujdesjen e plotë ndaj dhuratëdhënësit në drejtim të ndihmës në raste të caktuara jetësore, si sëmundja, kujdesi i përditshëm për pastrim e veshmbathje të tij dhe në përgjithësi për mirëkuptim dhe sjellje të mira ndaj dhuratëdhënësit, dhuratë kjo e cila nuk lidhet me domosdonë e kryerjes nga ana e dhuratëmarrësit të veprimeve të caktuara në favor të dhuratëdhënësit, sepse atëherë fjala do të ishte për një kontratë tjetër ngarkuese dhe të

dyanshme. Motivet e dhuratëdhënësit për dhurim janë thjeshtë personale dhe as që ka nevojë që ato motive të jenë pjesë e kontratës mbi dhurimin. Mirëpo me rastin e lidhjes së kësaj kontrate mbi dhurimin, jo rrallë dhuratëdhënësi cenon pjesën e domosdoshme të trashëgimtarit ligjor të caktuar, sepse dhuratëdhënësi dhuron gjithë pasurinë e tij trashëgimore. Në këtë drejtim, ligjdhënësi, me disa dispozita ligjore të Ligjit mbi Trashëgiminë të Kosovës, ka bërë përpjekje që të kufizoj disponimin e dhuratëdhënësit me pasurinë e tij trashëgimore deri në masën e cenimit të pjesës së domosdoshme të trashëgimit, ku fillimisht në nenin 33 të këtij Ligji, e bën përkufizimin e asaj se çka konsiderohet dhurim, e në nenin 38 të këtij Ligji, parasheh se kur cenohet e drejta e domosdoshme, çka ndodhë me atë testament apo dhurim. Kështu, sipas nenit 38.1 të këtij Ligji, *"kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimi do të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme",* ndërsa në nenin 39.1 të këtij Ligji, parashihet që *"kur cenohet pjesa e domosdoshme, më parë zvogëlohen disponimet me testament dhe nëse pjesa e domosdoshme nuk plotësohet në këtë mënyrë, atëherë kthehen dhurimet".* Sipas paragrafit 2 të këtij neni, *"nëse dhurata nuk mund të kthehet si send (in rem) personi që ka marrë dhuratën duhet të kthejë vlerën e saj sipas dispozitave mbi kthimin në rast të pasurimit të pa bazë."*.

Në praktikën gjyqësore, e jo rrallë ndodhë që të anulohet kontrata e dhurimit, jo pse është cenuar pjesa e domosdoshme e trashëgimit, por pse kontrata e dhurimit është me të meta juridike, ngase e ka lidhë pala me zotësi të kufizuar për të vepruar gjatë lidhjes së saj. Me një kontratë të tillë të dhurimit është bërë ndarja e pa barabartë e pronës në mes të trashëgimtarëve, për shkak se dhuruesi me rastin e lidhjes së kësaj kontrate ka qenë me zotësi të kufizuar të veprimit. Andaj, trashëgimtarët të cilët janë përjashtuar plotësisht nga trashëgimi, me faktin se e gjithë masa trashëgimore i është dhuruar vetëm njërit prej trashëgimtarëve ligjor dhe atë sipas të drejtës të përfaqësimit, kanë të drejtë që të kërkojnë anulimin e plotë të kësaj kontrate dhe kthimin e plotë të dhurimit në masën trashëgimore, në të cilën kanë të drejtë të kërkojnë trashëgiminë e cila u takon sipas ligjit si trashëgimtarë ligjor.

Sipas të gjeturave të Gjykatës Supreme të Kosovës, në përgjithësi në rastin e vendosjes lidhur me kontratat për dhurim dhe të atyre për mbajtje të përjetshme, gjykatat e instancës më të ulët i qasen nga aspekti i rrezueshmerisë ose nulitetit të kontratave, edhe pse në shumicën e rasteve të kërkesëpadive të paditësve, rezulton se të njëjtit nuk kanë kërkuar anulimin e kontratës mbi

dhuratën ose për mbajtje të përjetshme për pavlefshmëri relative të kontratës e as për shkaqe për pavlefshmëri absolute, mirëpo të njëjtit kërkojnë anulimin e kontratës me pretendimin se është cenuar pjesa e domosdoshme si trashëgimtarë i rendit të parë ligjor në bazë të Ligjit për Trashëgimin e Kosovës, dhe në këtë kuptim Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se këto kontrata duhet të trajtohen në aspekt të cenimit të pjesë së domosdoshme të trashëgimisë.

Lidhur me rastet kur është lidhur kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, jo për qëllimet për të cilat lidhet kontrata e përjetshme

- ***Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.324-2020, datë 29.09.2020***

Pretendimi i revizionit ka qenë se me kontratën për mbajtje të përjetshme është cenuar pjesa e domosdoshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, mbi bazën faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të gjykatës së shkallës së dytë përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, të cilat i pranon edhe Gjykata e revizionit.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar mbajtjen e papenguar në posedim të pronës kontestuese nga ana e S.S., edhe përkundër faktit se e njëjta ka qenë e regjistruar si pronare, gjë që e bënë të panevojshme sipas Gjykatës së revizionit arsyetimin e fitimit të pronësisë mbi bazën e mbajtjes së papenguar. Pretendimin e revizionit, se e ndjera S.S, nuk ka qenë në gjendje shëndetësore të mirë që të disponojë me pasurinë, nuk u vërtetuan sepse nuk ka asnjë dëshmi që e vë në dyshim gjendjen e shëndetit mendor të saj përveç deklarimit të palëve paditëse. Kjo gjykatë i shqyrtoi edhe kushtet e kontratës dhe gjeti se palët kontraktuese janë marrë vesh mbi pjesët përbërëse esenciale të kontratës (neni 26 i LMD), duke e deklaruar vullnetin e tyre lirisht dhe seriozisht, në atë mënyrë që kontratën e kanë legalizuar në Gjykatë, sipas procedurës së paraparë ligjore, andaj pretendimi i cekur në revizion se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar është i pabazuar. Në arsyetimin e vet, Gjykata Supreme thekson se:

Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme është kontratë me detyrime të dyanshme, me ngarkesë dhe në lidhjen e saj përfitojnë dy palët, dhënësi i shërbimeve të mbajtjes dhe marrësi. Me kësi lloj pune juridike pjesa e domosdoshme e trashëgimit nuk cenohet ngase me këtë kontratë pronari i pasurisë ka të drejtë lirshëm të disponoj me pasuri gjatë jetës së tij, dhe në këtë mënyrë duke i siguruar vetës jetë normale në aspektin e obligimit të dhënësit të mbajtjes së përhershme, që deri sa të vdes marrësi i ushqimit në këtë rast pronari i pasurisë, të njëjtit t'i ofroj përkujdesje të merituar ashtu siç në detaje merren vesh në këtë kontratë.

Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme është një prej mundësive ligjore që personat të cilit nuk munden të kujdesen vetë për veten e tyre apo kur këtë kujdes nuk e marrin nga familja, të lidhin kontratë mbi mbajtjen e përjetshme me ndonjë anëtarë të familjes apo edhe me ndonjë person jashtë familjes. Zakonisht, me këtë kontratë përfshihet e tërë pasuria e marrësit të mbajtjes e cila pas vdekjes së tij do ta përbënte masën trashëgimore por që në rastin e lidhjes së kontratës për mbajtjen e përjetshme, ajo pasuri kalon në dhënësin e mbajtjes duke u pamundësuar kështu trashëgimtarëve potencial ligjor të drejtën në trashëgimi, nëse e tërë pasuria është përfshirë me kontratë.

Paraqitja e kësaj problematike në zbatimin e ligjit është vetëm në rastet kur qëllimi i kontratës mbi mbajtjen e përjetshme nuk është mbajtja, por përjashtimi i trashëgimtarëve të caktuar nga trashëgimia. Veçanërisht kjo vjen në shprehje në rastet kur kjo përdoret si punë juridike për të mbuluar realisht përjashtimin e një ose disa trashëgimtareve nga pjesa e domosdoshme.

Kontrata e mbajtjes së përjetshme nuk përmban elementet e parapara në nenin 103 të LMD-së qe do ta bënin me efekt nulë, apo në kundërshtim me parimet e caktuara me kushtetutë dhe ligj. Pretendimi i revizionit për rrezueshmerinë e kontratës në vështrim dispozitave të LMD-së është i paqëndrueshëm, sepse nuk janë shfrytëzuar mjetet ligjore, për të kundërshtuar punën juridike jo të ligjshme sipas paditësve. Sipas nenit 117 të LMD-së, parashihet se *" E drejta për të kërkuar anulimin e rrezueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkaku i rrezueshmërisë, .."*. Kjo e drejtë në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 5 vitesh, nga data e lidhjes së kontratës, ndërsa në rastin konkret, kontrata e lidhur në vitin 1971 kurse padia e ushtruar në vitin 1987, gjë që i bie që ka kaluar afati për të kërkuar rrezueshmëri, sepse padia është paraqitur më 18 qershor 1987, do të thotë 16 vite pas lidhjes së kontratës.

Në rastin konkret gjykata e instancës më të ulët nuk ishin përgjigjur pretendimeve të paditësve se Safije Sylqe, nuk ka mundur të disponoi për së gjalli me pasurinë e paluajtshme sepse ka cenuar pjesën e domosdoshme të trashëgimisë për pasardhësit tjerë të SH.S, Xh. dhe Sh.. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës, vë në pah se e ndjera S.S., përveç pasurisë së përfshirë në kontratën e mbajtjes së përjetshme pas vetës ka lënë edhe pasuri tjetër, dhe se ajo ka disponuar për së gjalli vetëm me një pjesë të pasurisë së saj të përshkruar në kontratë për të cilën ka marrë kundër shpërblim shërbimet e mbajtjes deri në vdekje.

Konkluzione

- *Pjesa e domosdoshme e trashëgimit cenohet: me testament dhe me kontratë mbi dhurimin.*
- *Në disa raste trajtohet se e drejta e domosdoshme cenohet edhe me kontratën mbi mbajtjen e përjetshme kur ajo lidhet jo për qëllim të mbajtjes por për të anashkaluar ndonjë trashëgimtarë,*
- *Sipas praktikës gjyqësore pjesa e domosdoshme e trashëgimit nuk cenohet me lidhjen e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme ngase kjo kontratë është e dyanshme, ngarkuese, që të dy palët kontraktuese marrin detyrime të caktuara ndaj njëra tjetrës, dhe përfundimisht me këtë kontratë pronari i pasurisë ka të drejtë lirshëm të disponojë me pasuri gjatë jetës së tij, dhe në këtë mënyrë duke i siguruar vetës jetë normale në aspektin e obligimit të dhënësit të mbajtjes së përhershme, që deri sa të vdes marrësi i ushqimit në këtë rast pronari i pasurisë, të njëjtit t'i ofrojë përkujdesje të merituar ashtu siç në detaje dakordohen në këtë kontratë.*
- *Gjykata duhet të ketë parasysh se çdo herë duke vendosur sipas padisë për vërtetim pronësie në bazë të trashëgimit në pjesë të domosdoshme të trashëgimit,* ***së pari duhet të vërtetohet se, trashëgimtari a ka të drejtë në pjesën e domosdoshme të trashëgimit****, e pastaj se, me testament apo kontratë dhurimi a është disponuar nga ana e trashëgimlënësit edhe me pjesën e domosdoshme.*
- *të caktohet në pjesë ideale të pasurisë trashëgimore se cila pjesë e saj është pikërisht pjesa e domosdoshme e trashëgimit, dhe pastaj.*
- *Nëse është e nevojshme të zvogëlohet disponimi i trashëgimlënësit me testament,*
- *Nëse është tejkaluar dhurimi duhet të kthehet në masën që nevojitet të plotësohet pjesa e domosdoshme ashtu siç parashihet në nenit 38, 39, dhe 40 të Ligjit për Trashëgimin të Kosovë.*

Kapitulli VII

VENDIMI DHE NDRSHIMI I VENDIMEVE TË GJYKATËS PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRAVE PRINDËRORE

Shqyrtime të përgjithshme në lidhje çështjet statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë.

Ligji Nr.2004/32 Për Familjen i Kosovës, dhe Ligji Nr. 06/L-077 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2004/32 Për Familjen i Kosovës, ka rregulluar fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare.

Në gjykatat e Republikën e Kosovës, janë paraqitur një numër i konsiderueshëm i rasteve me kërkesa, për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim apo anulim. Në këto rast përveç çështjes së shkurorëzimit apo anulimit të martesës janë paraqitur për zgjidhje edhe çështjet statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë.

Në këto raste tani kemi një praktikë gjyqësore të konsoliduar, mirëpo dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për zgjidhjen e martesës, ka ndikuar që të ketë praktikë jo unike lidhur me vendimmarrjen, përveç tjerash edhe për zgjidhjen e çështjeve statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë.

Me nenin 125 paragrafi 1 të LFK-së, përcaktohet se: *"Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar"*, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *"Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë"*.

Me nenin 139 paragraf 1 të LFK-së, përcaktohet se: *"Nëse prindërit jetojnë ndaras, kujdesin prindëror e ushtron prindi me të cilin jeton fëmija, nëse me këtë pajtohet prindi tjetër "*, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se: *" Nëse në rastin e jetës së ndarë prindërit nuk merren vesh se me cilin prej tyre do të jetojë fëmija, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe "*.

Me nenin 140 paragrafi 1 të LFK-së, përcaktohet se: *“ Kur gjykata kompetente në kontestin martesor e merr aktgjykim me të cilin zgjidhet ose anulohet martesa me atë aktgjykim gjykata do të vendos për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur ”*, me paragrafin 2, të këtij neni përcaktohet se: *“Nëse prindërit nuk janë marr vesh për rastin e cekur në paragrafin 1) ose marrëveshja e tyre nuk i përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata pasi të marr mendimin e organit të kujdestarisë dhe të hetoj të gjitha rrethanat, do të vendosë: që të gjithë fëmijët të mbeten të nëna, kurse disa tek i ati, që të gjithë ose disa fëmijë t’i besohen ndonjë personi të tretë”,* ndërsa me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Nëse prindi i cili ushtron kujdesin prindëror pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, gjykata me aktgjykim do të rregullojë edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prind, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës”.*

Me nenin 144 paragraf 1 të LFK-së, përcaktohet se: *“Gjykata ose organi i kujdestarisë i cili merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim e ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme të hetoj të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës”*, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se: *“Në rast se fëmija është me moshë mbi 10 vjeç, gjykata do të marr parasysh posaçërisht nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës. Nëse e mendon të nevojshme gjykata do të merr parasysh mendimin e eksperteve”*.

Me nenin 145 paragraf 1 të LFK-së, përcaktohet se: *“ Nëse fëmija jeton vetëm me njërin prind ose me personin e tretë ose në institucion, prindërit do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën. Në rast kontesti vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente ”.*

Me nenin 290 paragrafi 1 të LFK-së, përcaktohet se: ” Prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur ”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Nëse fëmiu nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri sa fëmiu të arrin moshën 26 vjeç”.*

Me nenin 291 të LFK-së, përcaktohet se: *“Nëse fëmiu i moshës madhore nuk është në gjendje të punojë për shkak të sëmundjes, të metave fizike dhe mentale, dhe i cili nuk ka sasi të mjaftueshme*

të mjeteve financiare për shpenzimet e tij financiare, prindërit kanë për detyrim të sigurojnë ndihmën financiare deri sa një situatë e tillë të mbarojë".

Me nenin 292 të LFK-së, përcaktohet se: *"Nga mosha 15 vjeçare e tutje, fëmiu i cili fiton të ardhura me punën e tij, është i detyruar që financiarisht të kontribuoj për mbajtjen e tij dhe nëse e kërkon nevoja edhe për kontribut të arsyeshëm për mbajtjen e familjes me të cilën jeton ".*

Me nenin 293 të LFK-së, përcaktohet se: *"Prindit të cilit i është hequr kujdesi prindëror nuk lirohet nga detyrat për t'i mbajtur fëmijët e tij.".*

Me nenin 330 paragrafi 1 të LFK-së, përcaktohet se: "*Detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit"*, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *"Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë për të punuar, mundësinë faktike për punësim, kushtet shëndetësore, nevojat personale, detyrimet ligjore dhe të gjitha kushtet tjera relevante"*, ndërsa me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *"Kur alimentacioni kërkohet për fëmiun, gjykata merr parasysh moshën e fëmiut dhe të gjitha nevojat për edukim dhe arsimimin"*.

Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore, për çështjet statusore

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se: në rastet kur martesa është zgjidhur me anulim ose shkurorëzim, ndërsa prindërit, nuk janë marrë vesh për kujdesin prindëror ndaj fëmijëve, ose marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave më të mira të fëmijës/ve, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, pasi që ta marrë mendimin dhe propozimin e organit të kujdestarisë, dhe t'i hetojë të gjitha rrethanat përfshirë edhe mendimin e fëmijës, i cili është i aftë t'i japë pëlqimin e tij/saj, do të vendosë edhe për kujdesin prindëror ndaj fëmijëve, në atë mënyrë që të gjithë fëmijët të mbeten tek nëna, kurse disa tek i ati, që të gjithë ose disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi të tretë.

Gjykata kompetente me rastin e vendimmarrjes për besimin e fëmijës në ruajtje, kujdes dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme, t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës, ndërsa në rast se fëmija është me moshë mbi 10 vjeç, gjykata do të marr parasysh posaçërisht nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës. Nëse e mendon të nevojshme gjykata do të merr parasysh mendimin e eksperteve përkatës.

Nga përmbajtja e nenit 290 të LFK-së, rezulton se: mbajtja financiare e fëmijëve është detyrim ligjor i prindërve, deri sa fëmijët ta arrijnë moshën madhore e nëse ata janë në shkollim respektivisht edukim në fakultet, deri sa fëmija të arrijë moshën 26 vjeçare.

Mbajtja financiare të cilën duhet ta sigurojnë prindërit për fëmijët e tyre të mitur dhe në shkollim e edukim deri në moshën 26 vjeçare, është detyrim ligjor, pa marrë parasysh se cilit nga prindërit i është besuar kujdesi prindëror, edhe në rastin kur prindit i është hequr e drejta prindërore. Mbajtja financiare, përfshinë sigurimin e mjeteve të nevojshme për mirëqenien e fëmijës që përfshinë mirërritjen dhe aftësimin e fëmijës. Ky obligim ekziston edhe në rastet kur prindërit jetojnë bashkërisht me fëmijën dhe kur fëmija për shkaqet e parapara me ligj nuk jeton me prindërit e tij. Ky obligim ekziston edhe kur prindërit nuk janë në marrëdhënie pune, duke marrë parasysh gjithnjë mundësitë reale të prindërve kur krijojnë të ardhura nga burimet tjera përveç marrëdhënies së punës.

Përveç tjerash, nëse i referohemi dispozitave të cituara prindërit janë të detyruar t'i ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur ashtu siç përcaktohet me nenin 330 paragrafi 1 dhe 2 të LFK-së. Nga përmbajtja e nenit 330 paragrafi 1 dhe 2 të LFK-së, rezulton se: kur gjykata kur vendosë për bazën dhe lartësinë e mbajtjes financiare duhet ti detyrojë palët ndërgjyqëse që të sigurojë prova lidhur me gjendjen ekonomike financiare të tyre, apo sipas detyrës zyrtare të kërkojë nga organet kompetente prova lidhur me të ardhurat mujore, gjendjen pasurore, kushtet ekonomike, kushtet e banimit për palët ndërgjyqëse dhe rrethanat tjera të nevojshme, e pastaj të vendos për bazën dhe lartësinë e mbajtjes financiare sepse prindërit së bashku janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijën e tyre të përbashkët, duke marrë për bazë gjendjen financiare të tyre si dhe të gjitha rrethanat tjera që duhet të merren për bazë, për caktimin e lartësisë së mbajtjes financiare e veçanërisht mundësinë e dhënësit të mbajtjes financiare dhe moshën e fëmijëve si dhe nevojat e domosdoshme për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre.

Nga përmbajtja e nenit 125 paragrafi 1 dhe 2, nenit 140 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 145 të LFK-së, janë përcaktuar rregullat se prindërit me marrëveshje mund ta caktojnë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën, i cili jeton vetëm me njërin prind ose me personin e tretë ose në institucion. Një formë e tillë e rregullimit të kontaktit me marrëveshje, është e lejuar përderisa gjykata, nuk konstaton se marrëveshja e tillë është në kundërshtim me interesat e fëmijës. Nëse prindërit e fëmijës, kontaktin personal të fëmijës me prindin me të cilin nuk jeton, ose i cili jeton

me personin e tretë ose në institucion, nuk mund ta rregullojnë me marrëveshje, vendimin lidhur me këtë çështje e merr gjykata kompetente.

Në rastet kur gjykata vendosë se cilit prind, fëmijët e mitur t'i besohen në ruajtje dhe edukim si dhe kontaktin personal të prindit me fëmijët, të cilit nuk iu janë besuar fëmijët në ruajtje, kujdes dhe edukim, duhet që paraprakisht të sigurohet mendimi i organit të kujdestarisë dhe duke u bazuar në të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik si dhe për edukimin e rregullt të fëmijëve. Gjykata me rastin e vendosjes duhet të marrë për bazë moshën kritike të fëmijëve të mitur e veçanërisht, vullnetin, mbikëqyrjen e shtuar nga ana e dy prindërve, ndërrimi i ambienteve sociale dhe rrethanat tjera, të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt në zhvillimin psikik dhe fizik të fëmijëve si dhe edukimin e tyre, e para se gjithash duhet të marrë për bazë mendimin organit të kujdestarisë, nga Qendra për Punë Sociale ku fëmijët kanë vendbanimin/vendqëndrimin, e në rast nevoje edhe mendimin e ekspertit nga lëmi përkatës.

Ndryshimi i vendimeve të gjykatës në çështjet statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë-mbajtjes financiare.

Ligji Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, dhe Ligji Nr. 06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, ka rregulluar edhe mundësinë e ndryshimit të vendimeve të gjykatës në çështjet statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë-mbajtjes financiare.

Me nenin 46 të LPK-së, përcaktohet se: " Për zgjidhjen e kontesteve lidhur me alimentacionin, po që se paditës është personi që kërkon alimentacion, është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin ".

Me nenin 323 të LFK-së, përcaktohet se: " Në kontestet për ushqimi, fëmiu përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor mund të paraqes padi në gjykatën me kompetencë të përgjithshme territoriale ose në gjykatën në territorin e të cilës paditësi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin ".

Me nenin 140 paragraf 4 të LFK-së, përcaktohet se: *"Gjykata, me kërkesën e njërit prind ose të Organit të Kujdestarisë, do të ndryshojë vendimin mbi kujdestarinë, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara"*, ndërsa me paragrafin 5 të këtij neni, përcaktohet se: *"Mendimi i fëmijës,*

i cili është i aftë të japë pikëpamjet e tij/saj, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që i përket atij. Mendimit të tij do t'i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar".

Me nenin 145 paragrafi 2 të LFK-së, përcaktohet se: *"Gjykata kompetente përsëri mund të rregulloj mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve me fëmijët nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara"*.

Me nenin 331 paragrafi 1 të LFK-së, përcaktohet se: *"Gjykata me kërkesën e paditësve apo personave të detyruar mund të ndryshoj vendimin ashtu që të ndërpres, të shtoj, të zvogëlojë mbajtjen financiare ose alimentacionin i cili është përcaktuar me anë të vendimit të mëparshëm gjyqësor nëse rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi kanë ndryshuar"*, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *"Kushtet të cilat mund të ndryshojnë janë nevoja personale dhe rritje e shpenzimeve të jetesës në anë të kërkuesit si dhe statusit financiar të të pandehurit në anën tjetër"*.

Komenti i shkurtër për zbatimin e dispozitave të lartcekura

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, rezulton se palët me ndryshimin e rrethanave mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit sa i përket besimit të fëmijës në ruajtje, kujdes dhe edukim, alimentacion dhe caktimin e kontakteve personale të prindërve me fëmijën e mitur dhe sa i përket mbajtjes financiare të fëmijës dhe në këtë kuptim palët e as gjykata nuk mund të thirret në çështje të gjykuar - res iudicata, por ata në çdo kohë mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit, me kusht që ata kanë për detyrë të vërtetojnë ndryshimin e rrethanave që kanë ekzistuar me rastin e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë kontekst gjykata e shkallës së parë para se të vendos për kërkesëpadinë duhet që me propozimin e palëve apo sipas detyrës zyrtare, të marrë mendimin dhe propozimin e organit të kujdestarisë, t'i marrë në shikim shkresat e lëndës paraprake sipas vendimit gjyqësor i cili kërkohet të ndryshohet, t'i hetojë të gjitha rrethanat përfshirë edhe mendimin e fëmijës, i cili është i aftë të japë pëlqimin e tij/saj, për të krijuar një pasqyrë të qartë për rrethanat e çështjes, e pastaj të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit/ve.

Me dispozitat e LFK-së, janë përcaktuar rregulla se prindërit me marrëveshje mund ta caktojnë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën, i cili jeton vetëm me njërin prind, me personin e tretë ose në institucion. Një formë e tillë e rregullimit të kontaktit me marrëveshje, është e lejuar përderisa gjykata, nuk konstaton se marrëveshja e tillë është në kundërshtim me interesat

e fëmijës. Nëse prindërit e fëmijës, kontaktin personal të fëmijës me prindin me të cilin nuk jeton, ose i cili jeton me personin e tretë ose në institucion, nuk mund ta rregullojnë me marrëveshje, vendimin lidhur me këtë çështje e merr gjykata kompetente.

Gjykata mund ta ndryshojë vendimin e saj me të cilin ka përcaktuar mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin, në rast kur ndryshojnë rrethanat të cilat kushtëzojnë ndryshimin e vendimit gjyqësor, ashtu që fëmija i besohet prindit tjetër, ose njëri prind i pengon kontaktet personale të fëmijës, ndërsa procedura e tillë iniciohet me kërkesën e prindit ose organit të kujdestarisë.

Si rrethana për ndryshimin e vendimit për kontaktin e fëmijës, mund të paraqitet në rastet kur për shkak të rrethanave të ndryshuara, duhet ndryshuar vendimi mbi besimin e kujdesit prindëror, ashtu që fëmija i besohet në kujdes prindëror prindit tjetër ose personit të tretë. Pra, në këtë rast duhet të ndryshohet edhe vendimi i kontakteve personale të fëmijës.

Si rrethanë mund të paraqitet edhe kur prindi të cilit i është besuar kujdesi prindëror e pengon prindin tjetër për mbajtjen e kontakteve personale ashtu siç është caktuar me vendim të gjykatës, ose në marrëveshjen e prindërve. Në këto raste gjykata kompetente mund ta ndryshojë vendimin për kontakte personale të fëmijës, dhe duke ia besuar fëmijën prindit tjetër në ruajtje, kujdes dhe edukim, ose duke i specifikuar rrethanat tjera që kontakti personal i fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar kujdesi prindëror, të zhvillohet nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë.

Gjykata me kërkesën e paditësve apo personave të detyruar mund të ndryshoj vendimin ashtu që të ndërpres, të shtojë, të zvogëlojë mbajtjen financiare ose alimentacionin i cili është përcaktuar me anë të vendimit të mëparshëm gjyqësor nëse rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi kanë ndryshuar, me kusht që ata kanë për detyrë të vërtetojnë ndryshimin e rrethanave që kanë ekzistuar me rastin e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë para se të vendos për kërkesëpadinë duhet ti administroj provat dhe t'i marrë në shikim shkresat e lëndës të cekura më lartë, për të krijuar një pasqyrë të qartë për rrethanat e çështjes në kuptim të nenit 331 paragrafi 1 dhe 2 të LFK-së, e pastaj të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet në çështjet statusore që i referohen

kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë-mbajtjes financiare, ka konstatuar praktikë jo unike, lidhur me vendimmarrjen, përveç tjerash edhe për zgjidhjen e çështjeve statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë.

Këtu do të fokusohemi vetëm sa i përket shkeljeve të LPK-së, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me theks të veçantë tek mënyra e të provuarit, marrja e mendimit nga organi i kujdestarisë, nxjerrja e provës me ekspertizë, plotësimin e kushteve ligjore për besimin fëmijës në ruajtje, kujdes dhe edukim, caktimin e kontakteve personale dhe ushqimisë si dhe ndryshimin e vendimeve të gjykatës në çështjet statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë-mbajtjes financiare.

Në këtë kontekst në praktikën gjyqësore janë paraqitur dilema dhe ka pasur vendimarrje ndryshe përveç tjerash edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave për në çështjet statusore që i referohen kujdesit prindëror, caktimit të kontakteve dhe ushqimisë-mbajtjes financiare, gjatë procedurës nuk e kanë vërtetuar në tërësi gjendjen faktike.

Ka raste kur Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën sipas revizionit ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk kanë ekzistuar kushtet për ndryshimin e aktgjykimeve të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen, për arsye se:

Në rastet kur gjykata vendosë se cilit prind, fëmijët e mitur t'i besohen në ruajtje, kujdes dhe edukim si dhe kontaktin personal të prindit me fëmijët, të cilit nuk iu janë besuar fëmijët ne ruajtje, kujdes dhe edukim, duhet që paraprakisht të sigurohet mendimi i organit të kujdestarisë dhe duke u bazuar në të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik si dhe për edukimin e rregullt të fëmijëve, të kërkojë raporte apo plotësim të raporteve nga Qendra për Punë Sociale, për gjendjen pasurore, kushtet ekonomike, kushtet e banimit për palët ndërgjyqëse dhe për të gjitha rrethanat që duhet të merren për bazë, për caktimin e lartësisë së alimentacionit, e veçanërisht mundësinë e dhënësit të mbajtjes financiare si dhe nevojat e domosdoshme të marrësit të mbajtjes, të verifikojë statusin ekonomik të të paditurit. Gjithashtu, të ketë parasysh mirëqenien e fëmijëve, faktin se fëmijët janë duke vijuar shkollimin, faktin se çfarë orari fëmijët janë në

shkollë dhe se caktimi i kontaktit me orarin e përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë, a do të pamundësonte vijimin e rregullt të fëmijëve në mësim, ose a do të ndikonte në mësim nxënie.

Pasi që gjykatat, me rastin e vendosjes nuk kanë marr për bazë moshën kritike të fëmijëve të mitur, nevojën e fëmijëve për tu rritur së bashku apo ndaras, mbikëqyrjen e shtuar nga ana e dy prindërve, vijimin në shkollë, ndërrimin eventual të ambienteve sociale dhe rrethanat tjera, të cilat do të ndikonin drejt për drejt në zhvillimin psikik dhe fizik të fëmijëve si dhe në edukimin e tyre, nuk i ka dëgjuar palët në cilësi të palës dhe nuk ka caktuar ekspert apo grup të ekspertëve të pavarur nga lëmia përkatëse. Po ashtu, në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka ftuar ekspertin e lëmisë përkatëse, për të dhënë sqarime lidhur me mendimin e dhënë në ekspertizë, ku si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të nenit 362 paragraf 1 të LPK-së, e cila përcakton se: *Eksperti gjithmonë thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes"*. Për konstatimin e gjendjes faktike është dashur që eksperti të ftohet në seancë për të sqaruar dhe për ta arsyetuar mendimin e tij profesional dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë.

Në disa raste, gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar drejtë nenin 6 paragrafi 4, nenit 80 dhe nenit 140 lidhur të LFK-së, për arsye se sipas nenit 6 paragraf 4 të LFK-së, organi i kujdestarisë është pjesëmarrës në procedurë, për mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijës, në kontestet kur zgjidhet martesa me shkurorëzim ose anulim. Në këto raste organi i kujdestarisë zhvillon paraprakisht procedurën për pajtim të bashkëshorteve, dhe në rast se përpjekjet për pajtim nuk kanë pasur sukses, organi i kujdestarisë jep mendim, për besimin e fëmijës në ruajtje, kujdes dhe edukim.

Në bazë të nenit 6 paragrafi 4 të LFK-së, gjykata është e obliguar ta ftojë organin e kujdestarisë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'ia dorëzojë atij të gjitha vendimet. Gjykatat e shkallës së parë, në disa raste kanë dështuar që ta thërrasin Organin e Kujdestarisë në seancë gjyqësore, kur është marrë mendimi i fëmijëve të moshës jo madhore sepse nuk ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i Organit të Kujdestarisë dhe nuk ka prova se i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt.

Në disa raste gjykata e shkalles së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërtetoi në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me caktimin e kontaktit dhe detyrimit që i padituri t'i paguajë paditëses, lartësinë e shumës për alimentacion. Në këto raste gjykata e shkallës së parë, dhe gjykata e shkallës së dytë, nuk i ka vlerësuar rrethanat në kuptim të dispozitave ligjore të LFK-së, pasi që e njëjta

është dashur të detyrojë palët që të sigurojnë prova lidhur me gjendjen ekonomike financiare të tyre, apo të kërkoj nga organet kompetente dëshmi lidhur me të ardhurat mujore, gjendjen pasurore, kushtet ekonomike, kushtet e banimit për palët ndërgjyqëse dhe rrethanat tjera të nevojshme, e pastaj të vendos për bazën dhe lartësinë e alimentacionit, duke marrë për bazë gjendjen financiare të bashkëshortëve si dhe të gjitha rrethanat tjera që duhet të merren për bazë, për caktimin e lartësisë së alimentacionit e veçanërisht mundësinë e dhënësit të mbajtjes.

Sa i përket caktimit të kontaktit gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, nuk e kanë caktuar kontaktin me fëmijët ashtu siç është e përcaktuar me dispozita ligjore dhe me gjendjen faktike, kjo për faktin se të dy gjykatat nuk e kanë marrë parasysh mirëqenien e fëmijëve, nuk e kanë marrë parasysh faktin se fëmijët janë duke vijuar shkollimin, nuk e kanë vërtetuar faktin se në çfarë orari fëmijët janë në shkollë dhe se caktimi i kontaktit me orarin e përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, a do të pamundësonte vijimin e rregullt të fëmijëve në mësim, ose a do të ndikonte në mësim nxënie, e që rrjedhimisht mos vërtetimi i këtyre fakteve nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë, e bënë aktgjykimin të pa ekzekutueshëm dhe në kundërshtim me dispozitën ligjore të LFK-së.

Në disa raste tjera gjykata e shkallës së parë nuk e ka caktuar mënyrën e realizimit të kontaktit, sepse nuk e ka përcaktuar kohën dhe vendin e dorëzim-pranimit të fëmijës, edhe pse ky fakt ka qenë kontestues. Në disa raste nga dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë, e në raste të caktuara të shkallës së dytë, nuk mund të kuptohet se çka gjykata realisht kanë refuzuar dhe çka kanë aprovuar.

Në disa raste gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me ndryshimin e aktgjykimit sa i përket lartësisë së alimentacionit dhe caktimit të kontakteve të fëmijës.

Po ashtu, gjykatat nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i këtyre, kanë bërë shkelje dispozitave të LPK-së.

Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

- ***Aktvendimi Rev.nr.233/23, i datës 24.07.2023***

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1, lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë (në pikën III dhe V), ka të meta të atilla, për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në nshkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet e palëve duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, dhe si pasojë ndryshimi i aktgjykimit të shkallës së parë është në kundërshtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, sa i përket pikës III, V dhe VI, dhe të gjykatës së shkallës së dytë në pikat I, II, dhe III, si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se të njëjta nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare mbi themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë për arsye se:

Me nenin 39 të LFK-së, përcaktohet se: *"(1) Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) konsiderohet marrëdhënia faktike midis burrit dhe gruas që jetojnë në çifte, e karakterizuar nga*

një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie. (2) Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) është e barabartë me statusin martesor nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare reciproke, dhe të drejtat pasurore ashtu siç është specifikuar në këtë ligj. (3) Bashkësia faktike nuk e jep efektin nga paragrafi 2 i këtij neni nëse në kohën e formimit të saj kanë ekzistuar këto pengesa martesore: martesa ekzistuese, gjinia e gjakut në shkallën e ndaluar nga ky ligj, gjinia adoptuese, sëmundja psikike dhe paaftësia për të gjykuar, përveç nëse ndonjë pengesë ka pushuar ndërkohë".

Me nenin 40 të LFK-së, përcaktohet se*: "Njerëzit konsiderohet se jetojnë në bashkësi faktike (bashkësi jashtëmartesore) nëse ata: 1. Kanë të drejtë të martohen, por nuk kanë lidhur martesë ligjore; 2. Kanë bashkëjetuar haptazi sikur një çift bashkëshortor"*.

Me nenin 41 të LFK-së, përcaktohet se: *"Në bashkësi faktike (bashkësi jashtëmartesore), bashkëshortët detyrohen ndaj njëri tjetrit për respekt të njëjtë, mirëkuptim të dyanshëm dhe ndihmë sikur në bazë të martesës ligjore."*.

Me nenin 125 paragrafi 2 të LFK-së, përcaktohet se: *"Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë."*.

Me nenin 128 paragrafi 4 të LFK-së, përcaktohet se: *"Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë."*.

Me nenin 139 paragrafi 2 të LFK-së, përcaktohet se*: "Nëse në rastin e jetës së ndarë prindërit nuk merren vesh se me cilin prej tyre do të jetojë fëmija, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe."*.

Me nenin 140 paragrafi 1, 2 dhe 3 të LFK-së, përcaktohet se: *"(1) Kur gjykata kompetente në kontestin martesor e merr aktgjykimin me të cilin zgjidhet ose anulohet martesa me atë aktgjykim gjykata do të vendosë për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur. (2) Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për rastin e cekur në paragrafin (1) ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata, pasi të marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetojë të gjitha rrethanat, do të vendosë: që të gjithë fëmijët të mbeten për ruajtje dhe edukim*

te njëri prind, që disa të mbesin te nëna, kurse disa tek i ati, që të gjithë ose disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi të tretë. (3) Nëse prindi i cili ushtron kujdesin prindëror pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, gjykata me aktgjykim do të rregullojë edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prind, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës ".

Me nenin 145 paragraf 1 të LFK-së, përcaktohet se: *"Nëse fëmija jeton vetëm me njërin prind ose me personin e tretë ose në institucion, prindërit do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën. Në rast kontesti vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente"*, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se*: "Gjykata kompetente përsëri mund të rregulloj mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve me fëmijët nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara".*

Me nenin 297 të LFK-së, përcaktohet se: *"Ushqimia është mbajtje financiare e bashkëshortëve apo ish-bashkëshortëve".*

Me nenin 298 të LFK-së, përcaktohet se: *"(1) Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose që për arsye tjera nuk mund të punësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundësitë e tij financiare. (2) Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit mund të refuzojë kërkesën për ushqimi, nëse ushqimia është kërkuar nga bashkëshorti me keqbesim ose nëse ai e ka braktisur bashkëshortin pa ndonjë arsye të bazuar".*

Me nenin 299 të LFK-së, përcaktohet se: *"Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqiminë nga bashkëshorti tjetër përderisa ai do të kujdeset dhe e mban fëmiun e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punoj".*

Me nenin 330 paragraf 1 të LFK-së, përcaktohet se: *"Detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit ", ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se: " Gjykata duhet të këtë parasysh gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë për të punuar, mundësinë faktike për punësim, kushtet shëndetësore, nevojat personale, detyrimet ligjore dhe të gjitha kushtet e tjera relevante.".*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore rezulton se: e drejta që bashkëshortit të pasiguruar, t'i caktohet alimentacioni pas zgjidhjes së martesës, më rastin e vendosjes nga gjykata, duhet të plotësohen tri kushte të përgjithshme, e që janë: a) që bashkëshorti që ka detyrim mbajtjen të ketë mjete materiale për dhënien e mbajtjes, b) që bashkëshorti që kërkon mbajtje, të mos ketë mjete materiale për mbajtje dhe c) që bashkëshorti që kërkon mbajtje, të jetë i paftë për punë dhe mos të ketë mundësi të punësimit, ndërsa si kusht i veçantë që duhet të plotësohet, është që personi që kërkon mbajtjen - bashkëshorti, duhet të jetë i pafajshëm për zgjidhjen e martesës.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore të lartcekura, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, rezulton se Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranojë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur bazën juridike të kërkesëpadisë, sa i përket pikave si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilat janë kthyer në rishqyrtim.

Gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërtetoj në mënyrë të drejt dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me caktimin e kontaktit dhe detyrimit që i padituri ti paguaj paditëses, lartësinë e shumës për alimentacion prej 100 (njëqind) €. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, dhe gjykata e shkallës së dytë, nuk i ka vlerësuar rrethanat në kuptim të dispozitave ligjore të LFK-së, pasi që e njëjta është dashur të detyroj palët që të sigurojnë prova lidhur me gjendjen ekonomike financiare të tyre, apo të kërkoj nga organet kompetente dëshmi lidhur me të ardhurat mujore, gjendjen pasurore, kushtet ekonomike, kushtet e banimit për palët ndërgjyqëse dhe rrethanat tjera të nevojshme, e pastaj të vendos për bazën dhe lartësinë e alimentacionit, duke marrë për bazë gjendjen financiare të bashkëshortëve si dhe të gjitha rrethanat tjera që duhet të merren për bazë, për caktimin e lartësisë së alimentacionit e veçanërisht mundësinë e dhënësit të mbajtjes.

Sa i përket caktimit të kontaktit të të padituri (babit të fëmijëve), me fëmijët e tyre, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk e kanë caktuar kontaktin me fëmijët ashtu siç është e përcaktuar me dispozita ligjore dhe me gjendjen faktike, kjo për faktin se të dy gjykatat nuk e kanë marrë parasysh mirëqenien e fëmijëve, nuk e kanë marrë parasysh faktin se fëmijët janë duke vijuar shkollimin, nuk e kanë vërtetuar faktin se në çfarë orari fëmijët janë në shkollë dhe se caktimi i kontaktit me orarin e përcaktuar nga gjykata

e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, a do të pamundësonte vijimin e rregullt të fëmijëve në mësim, ose a do të ndikonte në mësimnxënie, e që rrjedhimisht mos vërtetimi i këtyre fakteve nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë, e bënë aktgjykimin të pa ekzekutueshëm dhe në kundërshtim me dispozitën ligjore të LFK-së.

Në këtë kuptim Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë para se të vendos për kërkesëpadinë e paditëses është dashur të kërkoj dhe ti administroj provat e theksuara, për të krijuar një pasqyrë të qartë për rrethanat e çështjes në kuptim të dispozitave të LFK-së.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj të kërkoj raporte plotësuese nga qendra/t për punë sociale (për gjendjen pasurore, kushtet ekonomike, kushtet e banimit për palët ndërgjyqëse dhe për të gjitha rrethanat që duhet të merren për bazë, për caktimin e lartësisë së alimentacionit e veçanërisht mundësinë e dhënësit të mbajtjes financiare si dhe nevojat e domosdoshme të bashkëshortit jashtëmartesor), të verifikojë statusin ekonomik të të paditurit, gjithashtu të ketë parasysh mirëqenien e fëmijëve, faktin se fëmijët janë duke vijuar shkollimin, faktin se çfarë orari fëmijët janë në shkollë dhe se caktimi i kontaktit me orarin e përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë, a do të pamundësonte vijimin e rregullt të fëmijëve në mësim, ose a do të ndikonte në mësim nxënie, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu në rishqyrtim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendosë në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara të palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

- ***Aktvendimi Rev.nr.53/23, i datës 27.02.2023***

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1, lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë ka vendosur që të ndryshojë pikën I dhe II, të aktgjykimit me shenjën C.nr.1046/21 të datës 07.02.2022, duke u bazuar në gjendjen ekonomike të paditësit pasi që i njëjti është i papunë, sëmundjen e tij, në fakt nuk janë hetuar rrethanat mbi këto fakte që kanë ndikuar në ndryshimin e aktgjykimit.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë

arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Përveç tjerash aktgjykimi i shkallës parë është marr edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 2 pika d), lidhur me nenin 46 të LPK-së, si dhe nenin 323 të LFK-së, për arsye se:

Me nenin 46 të LPK-së, përcaktohet se: " Për zgjidhjen e kontesteve lidhur me alimentacionin, po që se paditës është personi që kërkon alimentacion, është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin ".

Me nenin 323 të LFK-së, përcaktohet se: "Në kontestet për ushqimi, fëmiu përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor mund të paraqet padi në gjykatën me kompetencë të përgjithshme territoriale ose në gjykatën në territorin e të cilës paditësi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin ".

Në këtë kontekst, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata shkallës së parë, para se të vendos për besueshmërinë ose jo të kërkesëpadisë së paditësit, është dashur të vlerësoi të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse kishte konstatuar se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit, të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore), të administrojë provat e nevojshme për vërtetimin e fakteve vendimtare dhe të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm, gjë të cilën në këtë rast nuk e ka bërë. Gjykata e shkallës së parë është dashur që fillimisht të konstatoi kompetencën territoriale të saj, për arsye se me nenin 22 paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: *" Gjykata mund të shpallet jo kompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimit të palës së paditur të parashtruar me anë të përgjegjës në padi ",* me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *" Mbi prapësimin nga paragrafi l i këtij neni gjykata vendosë më së voni në seancën përgatitore, përkatësisht në seancën e parë për shqyrtimin kryesor, po që se seanca përgatitore nuk është mbajtur ",* ndërsa me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *" Gjykata mund të shpallet inkompetente në pikëpamje territoriale, sipas detyrës zyrtare, vetëm kur ekziston kompetenca territoriale ekskluzive e ndonjë gjykate tjetër, por me së voni deri në momentin e paraqitjes së përgjigjes në padi ",* dhe pasi të kishte konstatuar kompetencën e saj lëndore, të vlerësoi kompetencën territoriale sipas prapësimit të palës së paditur, në kuptim të dispozitave

ligjore të cituara me lartë. Pra në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar kompetencën territoriale të saj sipas prapësimit të palës së paditur.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm edhe për faktin se e njëjta nuk ka arritur të japë arsye lidhur me faktet vendimtare mbi themelësinë e kërkesëpadisë dhe atë:

Gjykata e shkalles së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me ndryshimin e aktgjykimit sa i përket lartësisë së alimentacionit për fëmijën. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk ka marr raport nga Qendra/t për Punë Sociale lidhur me ndryshimin e aktgjykimit në pikën I dhe II, që paditësi të paguaj alimentacion për fëmijën në shumën prej 150 €, dhe nuk i ka vlerësuar rrethanat në kuptim të dispozitave ligjore të LFK-së, pasi që e njëjta është dashur të detyroj palët, që të sigurojnë prova lidhur me gjendjen ekonomike financiare të tyre, apo të kërkoj nga organet kompetente dëshmi lidhur me të ardhurat mujore, gjendjen pasurore, kushtet ekonomike, kushtet e banimit për palët ndërgjyqëse dhe rrethanat tjera të nevojshme, e pastaj të vendos për bazën dhe lartësinë e alimentacionit përkatësisht ndryshimin e lartësisë së alimentacionit sepse, prindërit së bashku janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijën e tyre të përbashkët, duke marrë për bazë gjendjen financiare të bashkëshortëve, si dhe të gjitha rrethanat tjera që duhet të merren për bazë, për caktimin e lartësisë së alimentacionit, e veçanërisht mundësinë e dhënësit të mbajtjes financiare dhe moshën e fëmijës, si dhe nevojat e domosdoshme për edukimin dhe arsimimin e fëmijës së tyre, e pastaj të vendos për ndryshimin e lartësisë së alimentacionit.

Po ashtu, edhe pse në këtë rast gjykata e shkallës së parë, për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë ka nxjerr provat e administruara që i referohen gjendjes shëndetësore të paditësit, mirëpo në këtë rast ka qenë dashur që të nxjerrët prova me ekspertizë nga lëmia mjekësore përkatëse, për të përcaktuar saktë gjendjen shëndetësore të tij.

Përveç të cekurave, gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të kundërshtimeve të paditurës gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, nuk ka marr në shikim shkresat e lëndës sipas kontestit C.nr. 465/2015 dhe C.nr.500/17, nuk ka dëgjuar palët në cilësi të palës, etj.

Në këtë kuptim Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë, para se të vendos për kërkesëpadinë e paditësit është dashur ti administroj provat dhe ti marr në shikim shkresat e lëndës të cekura më lartë, për të krijuar një pasqyrë të qartë për rrethanat e çështjes në kuptim të nenit 331 paragrafi 1 të LFK-së, me të cilin përcaktohet se: " Gjykata me kërkesën e paditësve apo personave të detyruar mund të ndryshoj vendimin ashtu që të ndërprejë, të shtojë, të zvogëlojë mbajtjen financiare ose alimentacionin i cili është përcaktuar me anë të vendimit të mëparshëm gjyqësor nëse rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi kanë ndryshuar ", ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: "Kushtet të cilat mund të ndryshojnë janë nevoja personale dhe rritje e shpenzimeve të jetesës në anë të kërkuesit si dhe statusit financiar të të pandehurit në anën tjetër", e pastaj të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Për hir të praktikës gjyqësore, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se palët me ndryshimin e rrethanave mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit sa i përket besimit të fëmijës në ruajtje, kujdes dhe edukim, alimentacion dhe caktimin e kontakteve personale të prindërve me fëmijën e mitur dhe sa i përket mbajtjes financiare të fëmijës dhe në ketë kuptim palët, e as gjykata nuk mund të thirrën në çështje të gjykuar - res iudicata, por ata në çdo kohë mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit, me kusht që ata kanë për detyrë të vërtetojnë ndryshimin e rrethanave që kanë ekzistuar me rastin e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë kontekst Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për faktin se gjykata e shkallës së parë para se të vendos për kërkesëpadinë e paditësit është dashur t'i administrojë provat dhe t'i marr në shikim shkresat e lëndës të cekura më lartë, për të krijuar një pasqyrë të qartë për rrethanat e çështjes e pastaj të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që t'i evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj të kërkoj raport nga Qendra/t për Punë Sociale (për gjendjen pasurore, kushtet ekonomike, kushtet e banimit për palët ndërgjyqëse dhe për të gjitha rrethanat

që duhet të merren për bazë, për caktimin e lartësisë së alimentacionit e veçanërisht mundësinë e dhënësit të mbajtjes financiare dhe moshën e fëmijës si dhe nevojat e domosdoshme për edukimin dhe arsimimin e fëmijës së tyre), të verifikojë statusin ekonomik të paditësit dhe gjendjen e tij shëndetësore, t'i dëgjojë palët në cilësi të palës, të marrë në shikim shkresat e lëndës sipas kontestit C.nr. 465/2015 dhe C.nr.500/17, të nxjerrë provën me ekspertim nga lëmia mjekësore përkatëse, për të përcaktuar sakt gjendjen shëndetësore të paditësit, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësojë rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

- ***Aktvendimi Rev.nr.195/21, i datës 25.05.2021***

A r s y e t i m i

Në këtë gjendje kësisoj të çështjes, Gjykata Supreme nuk mund të pranojë si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesës së kundër padisë së të paditurës-kundër paditëses dhe refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit – kundër të paditurit, pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave në këtë çështje kontestimore përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat arsye doemos është dashur që të dy këto aktgjykime të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 lidhur me nenin 356 dhe 323 të LPK për shkak të cilave të dy aktgjykimet e lartë përmendura duhet prishur në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shkeljet procedurale nga neni 182.2 lidhur me nenin 356 dhe 323 të LPK-së, kanë të bëjnë me faktin se gjykata e shkallës së parë duke aplikuar gabimisht këto dispozita procedurale, pa pasur dijeni profesionale ka vërtetuar fakte të caktuara sipas vlerësimit të lirë, edhe pse të provuarit e

këtyre fakteve apo sqarimin dhe vërtetimin e tyre ka qenë e detyruar që ta bëjë me anë të ekspertizës përkatëse profesionale, nga ana e ekspertit, psikologut të fëmijëve, në pajtim me nenin 356 të LPK-së ku parashihet që gjykata ex officio ose me propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes. Në rastin konkret gjyqtari i çështjes, në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore sipas vlerësimit të lirë ka caktuar mënyrën, kohëzgjatjen dhe vendin e kontaktit të miturës A... me babain duke u udhëhequr nga interesi parësor i të miturës A... .

Vlerësimi i lirë i gjykatës vjen në shprehje për çështje tjera, për shembull rreth vlerësimit të provave, caktimit të lartësisë së dëmit jo material, si në nenin 323 të LPK-së, etj, por jo edhe në rastin e caktimit të mënyrës, kohëzgjatjes dhe vendit të zhvillimit të kontaktit të fëmijës së mitur me njërin prind, kështu që gjykata nuk mund të vendos për këtë çështje sipas vlerësimit të lirë. Përkundrazi, për këtë çështje duhet të vendos në bazë të një ekspertize përkatëse, qoftë të kryer nga Qendra për Punë Sociale kompetente, qoftë nga ana e psikologut të fëmijëve, kjo ngase gjykata nuk disponon me dije profesionale, psikologjike etj., që të vlerësojë se në aspektin psikologjik cili është interesi parësor i fëmijës së mitur, në këtë rast me rastin e caktimit të kohës dhe mënyrës së përshtatshme të kontaktit të fëmijës me njërin prind. Për këtë çështje gjykata vetë nuk mund të vendos pa ndihmën e ekspertizës përkatëse. Në rastin konkret, Qendra për Punë Sociale në I., dy herë ka dhënë mendimin e saj, për pamundësinë e pajtimit në mes të bashkëshortëve dhe për besimin e të miturës A. njërit prind, por jo edhe për mënyrën e caktimit të kontaktit të miturës A. me babain e saj, këtë çështje ia ka lënë gjykatës, por gjykata nuk mund të vendos për këtë çështje sipas vlerësimit të lirë, siç u tha më lartë, pa ndihmën e ekspertizës përkatëse.

Gjykata Supreme vlerëson se për shkak të shkeljeve thelbësore të lartpërmendura procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht, dhe tani për tani rezulton se në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësi soji , e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar kur është aprovuar kërkesa e kundërpadisë së të padituës-kundërpaditëses dhe është refuzuar kërkesëpadia e paditësit-kundërpaditurit.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë, lidhur me kontaktin e të miturës A. me babain e saj, këtu paditësin-kundërpaditurin do të vendos mundësisht me marrëveshje të palëve ndërgjyqëse duke pasur parasysh interesin më të mirë të të miturës A., dhe nëse për këtë çështje nuk ka marrëveshje

midis tyre, për të vendosur se cila është mënyra më e përshtatshme e kontaktimit të miturës A. me babain e saj, cila është koha e përshtatshme dhe kohëzgjatja e këtij kontaktimi si dhe vendi i zhvillimit të këtij kontakti, duke u udhëhequr gjithnjë nga mbrojtja e interesit parësor të fëmijës së mitur këtu A.B., do të sigurojë mendimin e psikologut të fëmijëve, ose të Qendrës për Punë Sociale përkatëse, në përbërjen e së cilës marrin pjesë edhe psikologët, dhe kësisoj do të vërtetojë saktë, se çka është më së miri për interesin e të miturës A., që kontakti të realizohet suksesshëm në mes të saj dhe babait të saj dhe të sigurohet që është ruajtur dhe mbrojtur ky interes i saj me rastin e caktimit të mënyrës, vendit, kohëzgjatjes dhe zhvillimit të kontaktit në mes të miturës A. dhe babait të saj, këtu paditësit-kundër padituri, e pastaj krijohen kushtet që lidhur me këtë çështje kontestimore e drejta materiale të zbatohet në mënyrë të drejtë.

FITIMI I HUMBUR, RENTA E ARRITUR DHE RENTA PËR TË ARDHMEN

Shqyrtime të përgjithshme në lidhje me shkaktimin dhe shpërblimin e dëmit material

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.05.2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012, ka rregulluar marrëdhëniet e detyrimeve, respektivisht shkaktimin dhe shpërblimin e dëmit dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, ekzistojnë dy lloje të shpërblimit të dëmit, shpërblimi i dëmit material dhe shpërblimi i dëmit jomaterial.

Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar edhe rastet ku është aplikuar Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, datë 26.05.1978, si ligj i aplikueshëm. Duhet theksuar se dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, të publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr.29, dt.26.05.1978, dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.05.2012, sa i përket dispozitave për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial kanë përmbajtje pothuaj identike, me përjashtim të disa risive të ligjit të ri, dhe atë: neni 163 - përgjegjësia për zotëruesin e kafshës, neni 164 - përgjegjësia e zotëruesit të ndërtesës, neni 165 - përgjegjësia për shembjen e ndërtimit, dhe neni 187 - shpërblimi në të holla për personin juridik.

Në gjykatat e Republikës së Kosovës, janë paraqitur një numër i konsiderueshëm i rasteve me kërkesa, për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, veçanërisht dëmit të shkaktuar në aksidente të komunikacionit, si dhe në vendin e punës.

Në këto raste tani kemi një praktikë gjyqësore të konsoliduar, mirëpo dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për shpërblimin e dëmit, ka ndikuar që të ketë praktikë jo unike lidhur me bazën dhe vlerësimin e kritereve, për përcaktimin e lartësisë së dëmit, përveç tjerash edhe për fitimin e humbur - gjegjësisht rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: *"1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. 2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. 3. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj."*.

Me nenin 137 të këtij ligji, përcaktohet se: *"Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jomaterial)."*.

Me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: *"Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia"*.

Me nenin 159 të këtij ligji, përcaktohet se: *"1. Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit. 2. Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre. 3. Në qoftë se nuk ka fajësi në asnjërën anë, zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet në pjesë të barabarta, në qoftë se rregullat e drejtshmërisë nuk kërkojnë diç tjetër. 4. Për dëmin që e pësojnë personat e tretë zotëruesit e mjeteve motorike përgjigjen solidarisht."*.

Me nenin 169 të këtij ligji, përcaktohet se: *" 1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t`ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t`i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme."*.

Me nenin 176 të këtij ligji përcaktohet se*: "1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar. 2. Për paragrafin paraprak vihen përshtatshmërish në zbatim dispozitat për përgjegjësinë për përfaqësuesin ligjor dhe ndihmësin. 3. Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do të gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit. 4. Dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e provës për kontributin e atij tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij."*.

Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore, për shpërblimin e dëmit

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se: dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jomaterial). Për të fituar të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë të dëmtuarit, ose pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Tek dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LMD-së. Ndërsa tek fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa.

Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t'ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi, b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm, c) të ekzistojë faji i dëmtuesit, d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këtë raste duhet plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e shkaktari të dëmit, për kompensimin e dëmit, të dëmtuarit.

Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia. Në këtë kontekst kërkohet që veprimet apo mosveprimet e kryesit të dëmit në raport me dëmin e shkaktuar të jenë me dashje apo nga pakujdesia. Dashja nënkupton se dëmi është shkaktuar në mënyrë të qëllimshme apo thënë ndryshe kur dëmtuesi i dëshiron pasojat, ndërsa pakujdesia ekziston kur kryesi nuk ka qenë i kujdesshëm në ndërmarrjen e veprimeve të tij apo nuk ka vepruar, ndonëse është dashur të veprojë.

Nga përmbajtja e dispozitave të LMD-së, rezulton se detyrimi i personit përgjegjës për rivendosjen e gjendjes e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi, pra qëllim primar i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes para shkaktimit të dëmit. Pastaj nëse kjo nuk është e mundur, e që zakonisht

është e pamundur të bëhet rikthimi i plotë i gjendjes së mëparshme, atëherë personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblim në të holla. Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit.

Fitimi humbur, renta e arritur dhe renta për të ardhmen

Me nenin 172 të LMD-së, përcaktohet se: *"1. Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. 2. Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër. 3. Kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç nëse kjo sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme. 4. Në qoftë se debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t`i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse. 5. Për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t`i paguhet një shumë e përgjithshme".*

Me nenin 173 të LMD-së, përcaktohet se, *"1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. 2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër. 3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsideratë fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerr veprimin. 4. Kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me vepër penale të kryer me dashje, gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi për të dëmtuarin."*.

Me nenin 174 të këtij ligji, përcaktohet se, *" Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim."*.

Me nenin 178 të këtij ligji, përcaktohet se: *" 1. Personi, të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson*

nga humbja e ushqimit ose e ndihmës. 2. Ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetej gjallë.".

Me nenin 179 të këtij ligji, përcaktohet se: *" 1. Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me ketë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit. 2. Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t`i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm.".*

Me nenin 180 të LMD-së, përcaktohet se, *"Gjykata mundet me kërkesë të të dëmtuarit, që për të ardhmen ta rritë rentën, por mundet me kërkesë të dëmtuesit ta zvogëlojë ose ta heq, në qoftë se kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të mëparshëm".*

Me nenin 181 të këtij ligji, përcaktohet se, *"1. E drejta e shpërblimit të dëmit në formë rente në të holla në rast të vdekjes së personit të afërt ose të lëndimit trupor ose të shkatërrimit të shëndetit nuk mund t`i bartet personit tjetër. 2. Shumat e shpërblimit, të cilat kanë arritur munden t`i barten tjetrit, në qoftë se lartësia e shpërblimit është caktuar me marrëveshje të shkruar të palëve ose me aktgjykim të formës së prerë.".*

Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore, për fitimin e humbur

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se: si raste të veçanta të shpërblimit të dëmit material janë: shpërblimi i dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, shpërblimi i dëmit material për shkak të shkaktimit të vdekjes, shpërblimi i dëmit material për shkak të cenimit të dinjitetit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta dhe shpërblimi i dëmit material kur dëmin e shkaktojnë shumë subjekt.

Fitim i humbur është një lloj i veçantë i dëmit material. Ky lloj i dëmit ekziston kur i dëmtuari pengohet për t'iu rritur pasuria. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se fitimi i humbur mund të realizohet kumulativisht me dëmin real, nëse ekzistojnë kushtet e caktuar për të.

Fitimi i humbur sipas dispozitave të LMD-së, nënkupton vetëm atë fitim për të cilin është i sigurt se kreditori sipas rrjedhës së rregullt të gjerave ose sipas rrethanave të veçanta të rastit do t'i realizojë.

Shpërblimi i dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtim të shëndetit përfshin shpenzimet e shërimit, të rehabilitimit për të dëmtuarin. Në këto shpenzime përfshihen: barërat, intervenimet mjekësore, furnizime me proteza, për shërim klimatike e të tjera.

Shpërblimi i dëmit material për lëndime trupore dhe për dëmtimin e shëndetit përfshinë edhe fitimin e humbur, për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese të përkohshme, ku hyjnë edhe të ardhurat nga puna të cilat i humbë për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së shërimit.

Shpërblimi i dëmit material për lëndime trupore dhe për dëmtimin e shëndetit përfshinë edhe fitimin e humbur, për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese të përhershme të dëmtuarit, i cili si pasojë e lëndimit e humbë aftësinë punuese, fitimin e të ardhurave personale dhe zvogëlimin e pasurisë. Në këto raste shpërblimi i dëmit bëhet në formë të rentës në të holla.

Sipas dispozitave të LMD-së, shpërblimi i dëmit material në formë të rentës vjen në shprehje në këto raste: a) në rast të vdekjes së personit prej të cilit i dëmtuari ka humbur ushqimin; b) në rast të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit ka pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor në punë në shkallë të caktuar, dhe si pasoj ka pësuar zvogëlim të pasurisë apo humbje të të ardhurave personale, dhe c) në rast të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit janë rritur nevojat e të dëmtuarit në aspektin e ndihmës së personit të huaj, ushqimit të përforcuar, shërimit klimatik apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Në rast të vdekjes, lëndimit trupor, shpërblimi caktohet në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. Veprohet kështu për arsye se pasojat kanë të bëjnë me dëmtimin trupor, humbjen apo zvogëlimin e aftësisë punuese, humbjen ose zvogëlimin e të ardhurave e të tjera. Të gjitha këto e vështirësojnë jetën e të dëmtuarit, e renta në këtë rast caktohet me qëllim të sigurimit të ekzistencës së të dëmtuarit.

Me dispozitat e LMD-së, është përcaktuar mundësia që nëse debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t`i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse. Po ashtu për shkaqe serioze

kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t`i paguhet një shumë e përgjithshme. Mirëpo këto janë përjashtim dhe aplikohen vetëm nëse ekziston rreziku që më vonë nuk mund ta realizojë kërkesën kreditori.

Sipas dispozitave të cituara kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit me të holla të dëmit material janë: a) lartësia e dëmit, b) shkalla e fajit, c) gjendja materiale e të dëmtuarit, dhe d) gjendja materiale e dëmtuesit. Lartësia e dëmit caktohet duke pasur parasysh kriterin objektiv dhe subjektiv. Kriteri objektiv ka të bëjë me vlerësimin e dëmshpërblimit sipas vlerës reale në treg të të mirës së dëmtuar, ndërsa kriteri subjektiv vjen shprehje tek rastet kur dëmi material është shkaktuar me vepër penale me dashje, në këtë rast gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit të dëmit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin. Nëse vlerësimi i dëmit bëhet sipas kriterit subjektiv atëherë sigurisht se lartësia e dëmshpërblimit do të jetë më e madhe se çmimi real i tregut që do të kishte dëmshpërblimi eventual.

Përveç tjerash caktimi i shumës së rentës në të holla, varet nga shkaku për të cilin është gjykuar ky lloj i shpërblimit të dëmit. Nëse është për humbjen e ushqimit apo për zvogëlimin ose humbjen e mundësisë së realizimit të fitimit, në rast të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, për caktimin e saj duhet vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në të. Këto rrethana mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Ndryshimi mund të ndodhë ashtu që ndonjë nga të dëmtuarit - paditësit, për shkak të moshës apo për ndonjë arsye tjetër e humbë të drejtën e ushqimit nga personi tjetër, për të cilën arsye mund të kërkohet ndryshimi i aktgjykimit me të cilin atij i është caktuar shpërblimi në këtë lloj të dëmit. Në këtë kontekst me kalimin e kohës mund të kërkohet edhe ndryshimi i shumës së rentës, varësisht nga ndryshimi i rrethanave, të cilat kanë ndikuar në caktimin e shumës së saj. I dëmtuari por edhe dëmtuesi, kanë mundësinë të paraqesin kërkesën që të rishqyrtohet kërkesa për rentë, edhe përkundër faktit se rasti ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë. Me rastin e paraqitjes së kërkesës pala duhet të paraqes prova se kanë ndryshuar rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të mëparshëm. Çka përbën rrethanë të ndryshuara gjykata duhet në secilin rast të vlerësojë në bazë të provave të paraqitura dhe varësisht nga besueshmëria e tyre të marrë edhe mendimin e ekspertëve, me qëllim që në mënyrë të plotë të vërtetojë nëse kemi të bëjmë me rrethanë të ndryshuar.

E drejta për shpërblimin e dëmit në formë të rentës në të holla, për shkak të lëndimit trupor dhe të dëmtimit të shëndetit është e drejtë personale, e lidhur ngushtë me personalitetin e të dëmtuarit dhe nuk mund të bartet e as të trashëgohet.

Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e shpërblimi të dëmit material, lidhur me fitimin e humbur, rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me vlerësimin se cilat kushte duhet të plotësohen për të fituar të drejtën për të kërkuar fitimin e humbur, rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen.

Këtu do të fokusohemi vetëm sa i përket shkeljeve të LPK-së, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me theks të veçantë tek mënyra e të provuarit, nxjerrja e provës me ekspertizë, plotësimin e kushteve ligjore për të fituar të drejtën, për të kërkuar fitimin e humbur, rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen, si dhe caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit.

Në këtë kontekst në praktikën gjyqësore janë paraqitur dilema dhe ka pasur vendimmarrje ndryshe përveç tjerash edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit, gjatë procedurës nuk e kanë vërtetuar në tërësi gjendjen faktike.

Ka raste kur Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën sipas revizionit ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk kanë ekzistuar kushtet për ndryshimin e aktgjykimeve të goditura me revizion, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Gjykatat e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërtetojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë. Në disa raste gjykatat e shkallës së parë kanë vendosur lidhur me kërkesëpadinë, pa nxjerrjen e provave me ekspertizë nga lëmia përkatëse, me të cilat do të vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë.

Edhe në rastet kur gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë ka nxjerrë provën me ekspertizë nga lëmia përkatëse, mendimi i ekspertit i dhënë në ekspertizë është i mangët dhe jo i plotë, për arsye se eksperti në këto raste ka deklaruar se kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë, mirëpo nuk ka konstatuar qartë se në atë rast a kemi të bëjmë me përgjegjësi primare, sekondare apo solidare në shkaktimin e dëmit. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka ftuar ekspertin e lëmisë përkatëse, për të dhënë sqarime lidhur me përgjegjësinë e shkaktarit të aksidentit/incidentit apo kontributin eventual të pjesëmarrësve në atë aksident/incident, gjegjësisht të sqarojë se a kanë kontribuar paditësit-të dëmtuarit në shkaktimin e aksidenti/incidenti.

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta në kontestet e shpërblimi të dëmit material, lidhur me fitimi humbur, rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen ka konstatuar se aktgjykimet e gjykatave të instancave me të ulëta nuk kanë vlerësim dhe arsyetim, se si është aplikuar e drejta materiale, respektivisht mungon arsyetimi sa i përket ndarjes së përgjegjësisë dhe kontributit të pjesëmarrësve në shkaktimin e dëmit, me rastin e vendosjes nuk kanë arsyetim nëse gjykatat e kanë vlerësuar kontributin e paditësit-të dëmtuarit në shkaktimin e dëmit dhe nëse ky kontribut është llogaritur me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë lidhur me lartësinë e dëmit.

Ka raste kur gjykatat e shkallës së parë, për të konstatuar shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të punës janë caktuar ekspert të lëmisë jo përkatëse, e që është dashur të caktohen ekspert nga lëmia e mjekësisë së punës, duke caktuar me aktvendim të veçantë ekspertin nga lëmia përkatëse dhe duke ia përshkruar saktë detyrat në kuptim të nenit 356, 358, 361, 362, 363, 364 dhe 369 të LPK-së.

Po ashtu, në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka ftuar ekspertin e lëmisë së punës dhe aktuaristikës, për të dhënë sqarime lidhur me mendimin e dhënë në ekspertizë, ku si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të nenit 362 paragraf 1 të LPK-së, i cili përcakton se: “ Eksperti gjithmonë thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes ”. Për konstatimin e gjendjes faktike është dashur që eksperti të ftohet në seancë për të sqaruar dhe për ta arsyetuar mendimin e tij profesional dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë.

Ka raste kur gjykatat e shkallës së parë gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërtetojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të

provuarit të fakteve lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket rentës së arritur dhe rentës për të ardhmen edhe pse në këtë rast gjykata e shkallës së parë, ka nxjerr provën me ekspertim nga lëmi i aktuaristikës, mirëpo në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ka ftuar ekspertin e aktuaristikës për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e tij profesional. Përveç kësaj në këtë rast Gjykata e Apelit ka vlerësuar se e drejta materiale është aplikuar gabimisht për gjykimin e fitimit të munguar - rentës së arritur dhe rentës për të ardhmen, e gjithashtu vlerësimi sipas ekspertizës nuk është bërë në përputhje me provat në shkresat e lëndës, çka nënkupton se gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Po ashtu gjykatat nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i këtyre, kanë bërë shkelje dispozitave të LPK-së.

Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

- ***Aktgjykimi Rev.nr.33/22, i datës 12.09.2022***

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë në pjesën që është prishur dhe është kthyer në rishqyrtim, sipas pikës I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti, nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar

gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës, e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë, edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 1, lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe si pasojë e këtyre lëndimeve, i njëjti ka pësuar zvogëlim të aftësisë punese në shkallë 20%, e në cilësi të ekspertit, për të përcaktuar shkallën e zvogëlimit të aftësisë punese është caktuar eksperti nga lëmi i punës. Ndërsa për të caktuar lartësinë e kërkesëpadisë për rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen gjykata e shkallës së parë ka marr për bazë mendimin e ekspertit nga lëmia e aktuaristikës. Mirëpo nëse i referohemi shkresave të lëndës gjykata e shkallës së parë me provat e administruara nuk ka vërtetuar faktin se paditësi si pasojë e këtij aksidenti, për shkak të lëndimeve të pësuara a ka pasur zvogëlim të ardhurave personale, dhe nëse po cila është diferenca-gjegjësisht i zvogëlimi i të ardhurave personale. Në këtë kuptim e drejta materiale është aplikuar gabimisht, por nuk është ndryshuar aktgjykimi në këtë pjesë sepse ka qenë e pamundur për shkak të shkeljeve të theksuara më lartë.

Nga arsyet e theksuara u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ndërsa për pjesën që është kthyer në rigjykim udhëzohet gjykata e shkallë së parë, që në ri-procedurë, se pari të kostatojë se paditësi si pasojë e këtij aksidenti, për shkak të lëndimeve të pësuara, a ka pasur zvogëlim të ardhurave personale, dhe nëse po cila është diferenca-gjegjësisht cili është zvogëlimi i të ardhurave personal, nëse është e arsyeshme duke marrë për bazë ekspertizën nga lëmia e mjekësisë së punës dhe pretendimet e palëve, të ftojë përsëri ekspertin e aktuaristikës për plotësimin e ekspertizës. Gjykata duhet t'ia caktoj ekspertit detyrat e ekspertizës, në atë mënyrë që ekspertiza të punohet në variantin dhe atë: për rentën e arritur për pagesë deri në ditë kur punohet ekspertiza dhe pas

ekspertizës renta mujore deri sa të ekzistojnë kushte ligjore, eksperti të ftohet në seancë për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e tij profesional dhe pas kësaj gjykata të ndërmerr hapat të tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

- ***Aktvendimi Rev.nr.118/22, i datës 10.05.2022***

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1, lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes, dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë. Në arsyetim

të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë. Nga dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk mund të kuptohet se çka realisht ka aprovuar, për cilat kategori të dëmit dhe çfarë ka refuzuar.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 1, lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë përfshirë edhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për arsye se: Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: *"Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij",* me nenin 158 përcaktohet se: *"Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia "*, ndërsa me nenin 178 përcaktohet se: *" Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihet në zbatim rregulla mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë."*.

Me nenin 188 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se *"Në rast të vdekjes, te lezionimi trupor ose te dëmtimit të shëndetit, kompensimi caktohet, si rregull në formë te rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohe te caktuar"*, me paragrafin 2, të këtij neni, përcaktohet se: *"Renta në të holla e gjykuar për efekt të kompensimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diçka tjetër"*, ndërsa me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *"Kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç në qoftë se sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme."*.

Me nenin 193 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“ Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që ti kompensoj shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij ”*.

Me nenin 201 paragrafi 1 i LMD-së, përcaktohet se: *“Në rast të vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’u gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) kompensimin të drejtë në të holla për dhimbjet e tyre shpirtërore”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, për arsye se edhe pse gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë ka nxjerrë provën me ekspertizë dhe super ekspertizë nga lëmia e komunikacionit rrugorë, mirëpo mendimi i ekspertit/ve i dhënë në ekspertizë dhe super ekspertizë është i mangët dhe jo i plotë, për arsye se eksperti/et nuk janë deklaruar saktë për kontributin eventual të pjesëmarrësve në aksident, pasi që deklarimi i tij/tyre se në këtë aksident të komunikacionit kanë kontribuar të dy pjesëmarrësit, nuk janë të qarta dhe si të tilla janë jo të plota, kontradiktore dhe në kundërshtim në vetvete si dhe në kundërshtim me rrethanat e shqyrtuara dhe provat e administruara, po ashtu të pabazuar në njohuritë shkencore dhe profesionale dhe në rrethana të çështjes, por vetëm të imagjinuara. Gjithashtu, sqarimet e tyre të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor janë të pamjaftuara dhe jo bindëse. Kjo për faktin se nëse i shikojmë me vëmendje madje edhe dy ekspertizat e grupit të ekspertëve janë kontradiktore në mes veti dhe se sqarimet e ekspertëve nga grupi janë njashtu të paqarta dhe konfuze. Përveç kësaj gjykata e shkallës së dytë, iu është referuar përgjegjësisë së ndarë 60% me 40%, me arsyetimin se këtë fakt e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, por një fakt të tillë gjykata e shkallës së parë nuk e kishte vërtetuar. Gjykata e shkallës së dytë, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, për lartësinë e dëmit jomaterial, por nuk ka arsyetuar dhe sqaruar pse ka ardhur në një përfundim të tillë. Gjykata e shkallës së dytë, e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, për lartësinë për rentën e arritur dhe për rentën në të ardhmen, por nuk ka arsyetuar dhe sqaruar pse ka ardhur në një përfundim të tillë. Nuk është ftuar eksperti i aktuaristikës, për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë, ku si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të nenit 362 paragraf 1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Eksperti gjithmonë thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes”.* Në fakt eksperti i aktuaristikës, është ftuar për sqarime mirëpo seanca e caktuar për datë 21.09.2017 është mbajtur në mungesë të palës së paditur, por nëse i referohemi procesverbalit të

shqyrtimit kryesor të datës 13.09.2017, seanca e radhës është caktuar më datë 12.09.2017, në ora 13 e 10, e jo më datë 21.09.2017, edhe pse në këtë procesverbal data e seancës së radhës është përmirësuar me laps kimik në dorëshkrim, të cilën e konteston e paditura edhe me pretendim ankimor e për të cilën gjykata e shkallës së dytë nuk e ka dhënë asnjë arsyetim. Për konstatimin e gjendjes faktike është dashur që eksperti të ftohet në seancë për të sqaruar dhe ta arsyetuar mendimin e tij profesional dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së.

Përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë, vendimin për kamatën e ka ndryshuar në kundërshtim me dispozitat e LMD-së, për arsye se në këtë rast duhet zbatuar neni 277 i LMD-së, e jo siç ka vepruar gjykata e shkallës së dytë në këtë rast.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, udhëzohet që t'i evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) dhe sipas propozimit të palëve, të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, në atë mënyrë që fillimisht, të caktojë nxjerrjen e provës nga lëmia e komunikacionit (përsëritjen e ekspertimit - grupi prej 3 eksperteve nga lëmia e komunikacionit rrugorë), të ftojë ekspertin/et e komunikacionit për sqarime në seancë, të vërtetojë faktin se tani i ndjeri këtu paditësve iu ka siguruar mbajtje financiare para dhe deri në momentin e aksidentit, për të vërtetuar saktë lartësinë e rentës së arritur dhe rentën për të ardhmen, të kërkojë prova materiale nga pala paditëse të cilat e vërtetojnë këtë kategori të dëmit material, duke marrë për bazë vërejtjet e theksuara më lartë, pastaj nëse është e arsyeshme duke marrë për bazë edhe pretendimet ankimore, të caktoj nxjerrjen e provës me ekspertim nga lëmia e aktuaristikës - gjegjësisht plotësimin e saj, ta ftojë ekspertin e aktuaristikës, për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë

nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do të duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

- ***Aktvendimi Rev.nr.308/23, i datës 04.09.2023***

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1, lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pambështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1, lidhur me nenin 160

paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë lidhur me pretendimet ankimore nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim lidhur me vendosje për aprovimin e kërkesëpadisë, duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të bazuara.

Në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore, dhe si pasojë e këtyre lëndimeve e njëjta ka pësuar zvogëlim të aftësisë punese në shkallë 26.25%, e në cilësi të ekspertit, për të përcaktuar shkallën e zvogëlimit të aftësisë punese është caktuar eksperti nga lëmia e punës. Ndërsa për të caktuar lartësinë e kërkesëpadisë për rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen, gjykata e shkallës së parë ka marr për bazë mendimin e ekspertit nga lëmia e aktuaristikës. Mirëpo, nëse i referohemi shkresave të lëndës gjykata e shkallës së parë me provat e administruara nuk ka vërtetuar faktin se lëndimet e pësuara, gjegjësisht zvogëlimi i aktivitetit punues është si pasojë e aksidentit të komunikacionit apo trajtimit jo profesional mjekësor, zvogëlimi i aktivitetit punues është shkaktuar me fajin e të paditurit, nëse po sa ka qenë përgjegjësia e tij. Në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë nuk është sqaruar fakti se sa është kontributi i të paditurit në zvogëlimin e aktiviteti punues dhe se cila është përgjegjësia në këtë rast, mirëpo vetëm është mbështetur në atë se paditësja ka lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me BKS-në, ku paditësja ka marrë shumën prej 30.500 €, pa e sqaruar faktin se paditësja nga BKS, ka marrë shumën e lartcekur për 70%, të përgjegjësisë dhe se pjesa e kontributit prej 30%, a i atribuohet të paditurit apo jo. Gjithashtu edhe gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e saj vetëm ka theksuar se e paditura ka detyrim që të bëjë kompensimin e paditëses në bazë të nenit 172 paragrafi 1 të LMD-së, mirëpo nuk ka dhënë fare sqarime lidhur me kontributin dhe përgjegjësinë e tani të paditurit në shkaktimin e paaftësisë punuese.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, si të drejtë dhe të ligjshëm edhe për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare, siç janë theksuar me lartë.

Gjykata e shkalles së parë në rigjykim, udhëzohet që t'i evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, pastaj të ndërmerrë hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes

faktike, të caktojë shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, në atë mënyrë që fillimisht, konstaton faktin se paditësja lëndimet e pësuara, gjegjësisht zvogëlimi i aktivitetit punues është si pasojë e aksidentit të komunikacionit apo trajtimit jo profesional mjekësor, për shkak të trajtimit jo profesional mjekësor a ka pasur zvogëlim të aktivitetit punues, dhe nëse po cila është shkalla e paaftësisë punuese dhe sa është kontributi i të paditurit në shkaktimin e paaftësisë punuese të paditëses, për të vërtetuar faktin se zvogëlimi i aktivitetit punues është si pasojë e aksidentit të komunikacionit apo trajtimit jo profesional mjekësor, të ftojë ekspertin/et mjekësor për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë (të sqarojnë se cilat janë pasojat konkrete si pasojë e trajtimit joprofesional), të ftojë ekspertin nga lëmia e punës për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë (të sqarojnë se zvogëlimi i aktivitetit punues është si pasojë e aksidentit të komunikacionit apo trajtimit jo profesional mjekësor, për shkak të trajtimit jo profesional mjekësor a ka pasur zvogëlim të aktivitetit punues, dhe nëse po cila është shkalla e paaftësisë punuese dhe sa është kontributi i të paditurit në shkaktimin e paaftësisë punuese të paditëses), të ftojë ekspertin e aktuaristikës për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë, në rast nevojë të kërkojë edhe plotësimin e saj, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses. Me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si me lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

KAPITULLI VII

KONTESTET E PUNËS

SHQYRTIMI PARAPRAK I PADISË, AFATI PËR PARAQITJEN/LEJUSHMERINË E PADISË SI PREZUMIM PROCEDURAL

Shqyrtime të përgjithshme lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, dhe Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka përcaktuar rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.

Procedura kontestimore inicohet me paraqitjen e padisë në gjykatë. Padia është veprimi i parë procedural i paditësit, përmes së cilit paditësi e paraqet kërkesën për ta realizuar një të drejtë të tij, dhe si e tillë është parashtresë formale, përmbajtja e së cilës është e përcaktuar me nenin 253 paragrafi 1, pika a), b), c), d), e) dhe f) të Ligji për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë - LPK).

Nga përmbajta e nenin 253 paragrafi 1, pika a), b), c), d), e) dhe f) të LPK-së, rezulton se padia duhet të përmbajë; a) kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore; b) faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën; c) provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla; d) vlerën e kontestit; e) bazën juridike; dhe f) të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtresë (neni 99 i këtij ligji).

Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore për shqyrtimin paraprak të padisë

Shqyrtimi paraprak i padisë është nën-fazë e detyrueshme e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes juridike. Ky aktivitet procedural duhet të kryhet menjëherë pasi të arrijë padia në gjykatë.

Me nenin 386 paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: *"Gjykata menjëherë pasi të arrijë padia, i fillon përgatitjet për shqyrtim kryesor të çështjes"*, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *"Përgatitjet e tilla përfshijnë ekzaminimin paraprak të padisë, dërgimin e padisë palës së paditur për përgjigje të domosdoshme, mbajtjen e seancës përgatitore dhe caktimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes".* Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se me

shqyrtimin paraprak të padisë, gjykata duhet të vlerësojë të gjitha prezumimet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor.

Me nenin 253 paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: *“ Padia duhet të përmbajë: a) kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore; b) faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën; c) provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla; d) vlerën e kontestit; e) bazën juridike; dhe f) të dhënat e tjera që duhet t’i ketë çdo parashtresë (neni 99 i këtij ligji). ”.*

Me nenin 99 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Parashtresat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit.”.*

Nga përmbajtje e këtyre dispozitave rezulton se në rastet kur parashtresa nuk i përmban elementet e përcaktuara me ligj, atëherë gjykata vepron në kuptim të nenit 102 paragrafi 1, të LPK-së, me të cilin përcaktohet se: *“Kur një parashtresë nuk është e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do të kërkojë nga dërguesi që ta korrigjojë ose ta plotësojë. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për kryerjen e korrigjimeve dhe plotësimeve duke i caktuar një afat prej tre (3) ditësh për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës”.*

Për mosveprim sipas detyrimit nga dispozita e cituar për palën parashihet pasoja juridike me nenin 102 paragraf 3 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Parashtresa do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, e nëse i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, e njëjta do të hidhet poshtë”.*

Në këtë kontekst dhe nga përmbajtja e dispozitave ligjore, rezulton se në çdo rast gjykata nëse konstaton se padia nuk është e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet me nenin 99 paragraf 2 të LPK-së, duhet ta kthejë padinë në plotësim/korrigjim, siç përcaktohet me nenin 102 paragrafi 1 të LPK-së.

Afati për paraqitjen/lejueshmërinë e padisë si prezumimin procedural

Ligji i procedurës kontestimore në kreun XV-të, përmban dispozita lidhur me paraqitjen dhe përmbajtjen e padisë. I njëjti ligj ka rregulluar çështjen e shqyrtimit paraprak të padisë, e në kuadër

të së cilës është paraparë edhe shqyrtimi i afatit për padi dhe vlerësimi i afatit si prezumim procedural, për lejueshmërinë e procesit gjyqësor.

Me nenin 252 të LPK-së, përcaktohet se: *"Gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim (padi detyrimi, vërtetimi dhe ndryshimi) ".*

Me nenin 389 të LPK-së, përcaktohet se: *" Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata mund t'i nxjerrë të gjitha aktvendimet e përmendura në nenin 392 të këtij ligji, përveçse kur kemi të bëjmë me çështjet për të cilat për nga natyra e tyre, apo sipas dispozitave të këtij ligji, aktvendimi mund të jepet vetëm në fazën e mëtutjeshme të procesit kontestimorë ".*

Me nenin 390 të LPK-së, përcaktohet se: *"Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të padituri që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta iniciojë procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmerr masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji).".*

Me nenin 391 paragrafi 1 pika f) të LPK-së, përcaktohet se*: " Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj.".*

Me nenin 393 të LPK-së, përcaktohet se: *"Gjykata, në qoftë se konsideron se nuk ka material procedural të mjaftueshëm për dhënien e aktvendimit mbi ndonjë çështje që është paraqitur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, do të vendosë lidhur me të pasi të arrijë përgjigja në padi e të padituri ose gjatë seancës përgatitore apo në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se nuk është mbajtur seanca përgatitore"* .

Me nenin 78 paragraf 1 të Ligjit të Punës (nr. 03/L-212), përcaktohet se: *"I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqes kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura"*, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *"Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës",* ndërsa me paragrafin 3, të këtij neni, përcaktohet se: *"Vendimi nga*

paragrafi 2 i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh".

Me nenin 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: *"Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.".*

Komenti i shkurtër për zbatimin e dispozitave të lartcekura

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore rezulton se palët për të fituar të drejtën për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore sa i përket të drejtave nga marrëdhënia e punës, duhet që paraprakisht të plotësohen në mënyrë komulative dy kushte procedurale dhe atë: a) punëtori paraprakisht t'i ketë shterur procedurat interne (mjetet e brendshme) për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës, dhe b) që padia në gjykatë të jetë dorëzuar brenda afatit të caktuar.

Të punësuarit me qëllim të realizimit të të drejtave të shkelura nga marrëdhënia e punës duhet paraprakisht t'i ketë shterur procedurat interne (mjetet e brendshme) për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës. Në bazë të nenit 78 të Ligjit të Punës, i punësuari duhet të paraqesë kërkesë tek punëdhënësi për realizimin e të drejtave të shkelura, e për të cilën punëdhënësi do të vendosë brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës. Nëse refuzohet kërkesa e tij apo nuk jepet vendimi lidhur me kërkesën e të punësuarit, pastaj i punësuari në bazë të nenit 79 të Ligjit të Punës, mund t'i drejtohet gjykatës në afatin vijues prej 30 ditësh. Pra, i punësuari nuk mund ta kërkojë mbrojtje gjyqësore sa i përket të drejtave nga marrëdhënia e punës, pa i shterur paraprakisht procedurat interne (mjetet e brendshme).

Realizimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës në gjykatë bëhet me paraqitjen e padisë. Procedura kontestimore iniciohet me padi. Procedura kontestimore nuk iniciohet sipas detyrës zyrtare, por është në dispozicion ekskluziv të palës që pretendon që i është cenuar ndonjë e drejtë. Padia si veprim procedural me shkrim është parashtresë dhe lidhur me padinë vlejnë të gjitha dispozitat që vlejnë edhe për parashtresat. Padia siç u cek edhe më lartë duhet t'i përmbajë të gjitha ato që janë paraparë me nenin 253 të LPK-së. Nëse padia nuk i përmban elementet e përcaktuara me ligj, atëherë gjykata vepron në kuptim të nenit 99 dhe 102 të LPK-së.

Gjykata fillimisht është e detyruar që ta bëjë shqyrtimin paraprak të padisë dhe nga ky shqyrtim varet rrjedha e mëtejme e kontestit dhe zbatimi i dispozitave të caktuara procedurale, nëse gjykata konstaton se nuk ka pengesa procedurale për zhvillimin e mëtejme të procedurës kontestimore do të kalojë në fazën vijuese duke e dërguar padinë në përgjigje e pas kësaj edhe në fazat e tjera si në caktimin e shqyrtimit përgatitor dhe shqyrtimit kryesor.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë shikon a janë plotësuar prezumimet lidhur me: palët (ekzistimi i palës, zotësia për të qenë palë në procedurë, zotësia procedurale, përfaqësimi i rregullt ligjor, përfaqësimi i personave juridik). Pastaj nëse çështja e ngritur me padi hyn në kompetencën gjyqësore, nëse palët kanë lidhur kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre nga arbitrazh, nëse ekziston gjyqvarësia - litispedenca, nëse bëhet fjalë për çështjen e gjykuar apo res iudicata, për objektin e kontestit nëse është lidhur ndonjë ujdi gjyqësore, nëse ka hequr paditësi dorë nga kërkesëpadia, nëse ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi, nëse është paraqitur në afat ligjor dhe nëse paditësi brenda afatit të caktuar ka vepruar apo ka hequr mungesat nga neni 79 dhe neni 102 i këtij ligji.

Padia në kontestet nga marrëdhënia e punës duhet të paraqitet brenda afatit 30 ditor, nga dita e refuzimit të kërkesës, përkatësisht nëse nuk është dhënë përgjigja në kërkesë brenda afatit 15 ditor nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Afati për paraqitjen e padisë është prezumim procedural nga i cili varet lejueshmëria e procesit gjyqësor, e për të cilin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, por që sipas depozitave të LPK-së, vjen në shprehje vetëm në rastet kur me dispozita ligjore përcaktohet në mënyrë specifike se mbrojtja gjyqësore mund të kërkohet vetëm brenda afateve të caktuara, siç është rasti në kontestet e punës, etj.

Hedhja poshtë e padisë për shkak të afatit nënkupton situatën kur gjykata e ka vlerësuar se procesi gjyqësorë është i palejueshëm për shkak se nuk plotësohen kushtet respektivisht prezumimet nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor. Hedhja e padisë mund të bëhet për shkak të pengesave procedurale që lidhen me gjykatën - kompetencën, palët - cilësinë e palëve dhe përfaqësimin, objektin e kontestit si: çështja e gjykuar, litispendenca, ekzistimi i ujdisë gjyqësore, ekzistimi i vendimit mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia apo edhe mungesa e interesit juridik dhe po ashtu mund të hedhet për shkak të parregullsisë formale të padisë nëse edhe pas kërkesës për plotësimin e padisë, pala dorëzon parashtresën të paplotësuar, si dhe në rastin e pengimit të

posedimit dhe kontesteve të punës nëse nuk është parashtruar brenda afati ligjor. Ndërsa, për prapësimet e natyrës materiale gjykata vendos në mënyrë meritore. Për të vendosur për prapësimin e natyrës materiale juridike, gjykata duhet të theksoj rrethanat faktike që lidhen me të drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, natyrën e kërkesave dhe pas vlerësimit të këtyre rrethanave gjykata duhet të vendosë me aktgjykim për besueshmërinë e kërkesëpadisë.

Në këto raste gjykata e shkallës së parë duhet që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës (vlerësimi i prezumimeve procedurale në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë dhe në seancën përgatitore), të vlerësojë afatshmërinë dhe lejueshmërinë e padisë, në kuptim të nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, nëse vlerëson se padia është e pasaftshme duhet të veprojë në kuptim të nenit 391 paragrafi 1 pika f) të LPK-së, e nëse vlerëson se padia është e afatshme dhe e lejuar duhet të caktojë shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve, por edhe sipas detyrës zyrtare të administrojë provat për vërtetimin e fakteve vendimtare, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve.

Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë, në kontestet e punës, vetëm sa i përket afatëshmerisë/lejueshmërisë siç është përcaktuar me nenin 182 paragrafi 1, e lidhur me nenin 391 paragrafi 1 pika f) të LPK-së, si dhe nenin 78 paragrafi 1, 2 dhe 79 të Ligjit Punës.

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta, ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me vlerësimin e afatshmerisë/lejueshmërisë së padisë, në kontestet nga marrëdhënia e punës.

Në këtë kontekst në praktikën gjyqësore janë paraqitur dilema dhe ka pasur vendimmarrje ndryshe përveç tjerash edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar prezumimet procedurale negative për lejueshmërinë e procesit gjyqësor, gjegjësisht nuk ka vlerësuar lejueshmërinë/afatshmerinë e padisë edhe në rastet kur ka pasur kundërshtim nga pala e paditur, në përgjigje në padi, në seancën përgatitor, seancën kryesore, dhe me mjete të goditjes. Po ashtu në disa raste gjykatat kanë vendosur në mënyrë meritore, pa vlerësuar/vendosur paraprakisht për afatshmerinë/lejueshmërinë e padisë.

Ka raste kur Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën sipas revizionit ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1, e lidhur me nenin 391 paragrafi 1 pika f) të LPK-së, si dhe nenin 78 paragraf 1, 2, dhe 79 të Ligjit të Punës, për arsye se: gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë për besueshmërinë ose jo të kërkesëpadisë, është dashur të vlerësojë të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit, edhe në rastet kur ka pasur kundërshtim nga pala e paditur, në përgjigje në padi, në seancën përgatitor, seancën kryesore, dhe me mjete të goditjes. Ndërsa, gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Ka raste kur gjykata e shkallës së parë, ka vendosur sipas padisë të paraqitur pas afatit të përcaktuar me ligj, në mënyrë meritore, e nga shkresat e lëndës ka qenë i pa kontestuar fakti se paditësi vendimin me të cilin i është ndërprerë marrëdhënia e punës, e ka pranuar në mënyrë të rregullt, i cili vendim ka ardhur pas udhëzimit për mjetin juridik, ku është theksuar se: *kundër këtij vendimi i punësuari ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit pranë organeve kompetente të punëdhënësit.* Paditësi kundër atij vendimi ka paraqitur ankesë. Pala e paditur lidhur me ankesën e paditësit nuk ka vendosur. Paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur pas afatit, çka nënkupton se padia e paditësit në atë rast është ushtruar pas afatit ligjorë prej 30 ditëve. Po ashtu, ka raste kur gjykatat e instancave me të ulëta me rastin e vlerësimit të afatshmerisë së padisë, gabimisht kanë vlerësuar se padia është paraqitur pas afatit të përcaktuar ligjor.

- ***Aktvendimi Rev.nr.266/22, i datës 02.11.2022***

A r s y e t i m i

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk

përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit, ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë.

Përveç të cekurave në pikën II, të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka detyruar të padituren që paditëses t'i paguaj shumën prej 8,876.10 €, për periudhën kohore nga data 27.04.2014 - 31.03.2019, mirëpo në fakt nuk mund të kuptohet se për çka realisht gjykata e shkallës së parë e ka detyruar, për pagat e parealizuara apo për diferencën e tyre. Po ashtu në pikën V, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, mirëpo në fakt nuk mund të kuptohet se çka realisht gjykata e shkallës së parë ka refuzuar në këtë rast.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragrafit 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Përveç tjerash aktgjykimi i shkallës parë është marrë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: padia e precizuar si në parashtresën të datës 04.06.2018, 23.07.2018, 25.07.2018, 27.05.2019 si

dhe në fjalën përfundimtare të datës 03.09.2019, nuk përmban elementet që duhet t'i përmbajë çdo parashtresë, në fakt kërkesa në padi është e paqartë dhe e pakuptueshme dhe se nuk është e specifikuar saktë kërkesa se çka kërkon paditësja në këtë rast, sa i përket kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale. Në këtë rast gjykata para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditëses, është dashur që padinë e paditëses ta kthejë në korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe nenit 102 e lidhur me nenin 2 paragrafi 1 të LPK-së. duke i sugjeruar qartë korrigjimet të cilat duhet të bëhen me aktvendim të veçantë, e nëse pala paditëse nuk vepron sipas këtyre sugjerimeve atëherë në këtë rast gjykata të vendos për padinë, e jo siç ka vepruar në këtë rast kur ka vendosur në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditëses.

Me nenin 102 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: *"Kur një parashtresë nuk arrinë të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do të thërras personin që e dërgon ta korrigjoj ose ta plotësoj parashtresën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës "*, me paragrafin 2, të këtij neni, përcaktohet se: *" Në qoftë se parashtresa e lidhur me afat korrigjohet, gjegjësisht plotësohet dhe i dorëzohet gjykatës brenda afatit të caktuar për një gjë të tillë, do të konsiderohet se i është parashtruar gjykatës në ditën kur është paraqitur për të parën herë"*, ndërsa me paragrafin 3, të po këtij neni, përcaktohet se: *"Do të konsiderohet e tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar gjegjësisht pa u plotësuar, parashtesa do të hidhet poshtë".*

Aktgjykimi i shkallës parë është marrë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 391 paragraf 1, pika f) të LPK-së, si dhe nenit 79 të Ligjit të Punës, qëndron për fakti se në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur lidhur me afatshmërinë e padisë, për faktin se nga momenti i përgjigjes në padi e paditura e ka kontestuar aftëshmërinë e padisë, në kuptim të neneve 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Me nenin 79 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, i datës 01.11.2010 , përcaktohet se: *"Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragraf 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej 30 ditësh, mund të inicoi kontest pune në gjykatën kompetente ".* Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditëses, është dashur që të vendos për

aftëshmerinë e padisë. Afatëshmëria e padisë është prezumim procedural nga i cili varet lejueshmëria e padisë dhe në mungesë të plotësimit të këtij prezumimi gjykata nuk mund të lëshohet në themelësinë e kërkesëpadisë.

Aktgjykimet egjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë përfshirë edhe me zbatim të gabuar të se drejtës materiale, për arsye se:

Me nenin 11 paragrafi 1 nga pika 1.1) deri në pikën 1.13) të Ligjit të Punës, është përcaktuar se çka duhet të përmbaj kontrata e punës.

Me nenin 17 paragrafi 2 dhe 3 të këtij ligji, përcaktohet se: *" 2. Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës. 3. I punësuari sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive.".*

Me nenin 55 paragrafi 2 të këtij ligji, përcaktohet se: *"Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës."*

Me nenin 70 paragraf 1, pika 1.1 dhe 1.2 të këtij ligji, përcaktohet se: *" 1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur: 22 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative; 1.2. i punësuari nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës ".*

Me nenin 71 të këtij ligji, përcaktohet se: *" 1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit: 1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike; 1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike; 1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike. 2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku*

tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë ".

Me nenin 72 të këtij ligji, përcaktohet se: *" 1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje. 2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit. 3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. 4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës ".*

Me nenin 80 të këtij ligji, përcaktohet se: *" 1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. 2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente".*

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitave të Kontratave të Punës, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës edhe Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranojë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se të njëjtat nuk kanë arritur të japin arsye lidhur me faktet vendimtare rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë.

Gjykata e shkalles së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërtetojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë, për arsye se: për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë me rastin e vendosjes nuk ka marrë për bazë provat e administruara e në veçanti vendimin për mbledhjen e bordit të datës 20.02.2014, statutin e të paditurës, aktin e brendshëm të

paduturës për procedurat disiplinore, aktin për politikat e personelit, kontratës e punës të datës 16.06.2011 dhe aneks kontratën e datës 01.03.2012. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit të ardhurave personale me saktësisht si në pikën II, të dispozitivi, mirëpo në këtë rast nuk dihet se për çka dhe cilën periudhë kohore kërkohet kompensimi i pagave, a kërkohet kompensimi i pagave të plota apo diferencën e tyre. Edhe pse në këtë rast gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë ka nxjerrë provën me ekspertim nga lëmia financiare, mendimi dhe konstatimi i ekspertit në ekspertizë dhe sqarimet e dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor janë të paqarta, të mangëta dhe të imagjinuara si dhe në kundërshtim me rrethanat e shqyrtuara dhe provat e administruara, eksperti ka hartuar ekspertizën përtej detyrave të përcaktuara me aktvendim nga gjykata, nuk ka kërkuar të dhëna nga punëdhënësi ku paditësja ka qenë në marrëdhënie pune pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga e paditura etj., fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm dhe përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve ndërgjyqëse gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje dispozitave të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që t'i evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, duke vlerësuar të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit dhe nëse konstaton se plotësohen kushtet për zhvillimin e shqyrtimit të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore) dhe sipas propozimit të palëve, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

- **Aktvendimi Rev.nr.205/22, i datës 10.10.2022**

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkalles së parë dhe të dytë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 391 paragrafi 1, pika f), nenit 182 paragraf 2 pika e) të LPK-së, lidhur me nenin 79 të Ligjit të Punës, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika e) të LPK, qëndron për faktin se në këtë rast, gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj. Nga shkresat e lëndës është i pakontestuar fakti se paditësi vendimin me numër 331, të datës 11.02.2016, e ka pranuar më datë 10.03.2016, i cili vendim ka pas udhëzimin për mjetin juridik, ku është theksuar se: kundër këtij vendimi i punësuari ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit pranë organeve kompetente të BKS-së. Këtu paditësi kundër këtij vendimi ka paraqitur ankesë me datë 21.03.2016. E paditura lidhur me ankesën e paditësit nuk ka vendosur. Paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur me datë 05.05.2016, çka nënkupton se padia e paditësit në këtë rast është ushtruar pas afatit ligjorë prej 30 ditëve.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 391 paragraf 1, pika f) të LPK-së, dhe nenit 79 të Ligjit të Punës, qëndron për fakti se në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk ka vendosur lidhur me afatshmërinë e padisë edhe pse e njëjta ka pasur kundërshtim me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor nga ana e të paditurës, sepse sikur e njëjta të vendoste për afatshmërinë e padisë gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë apo sipas kundërshtimeve të paditurës me aktvendim do ta hedh poshtë padinë si të palejueshme, pasi që padia është e paraqitur pas skadimit të afatit ligjor siç përcaktohet me nenin 79 të Ligjit të Punës.

Me nenin 79 të Ligjit të Punës, Ligji nr. 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “ Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragraf 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej 30 ditësh, mund të inicoj kontest pune në gjykatën kompetente ”.

Me nenin 214, të LPK-së, dhe nenin 9, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 214 i ligjit bazik, përcaktohet se: "Revizioni mund të paraqitet: a) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 të këtij ligji, me përjashtim të shkeljeve të parapara në nenin 182 paragrafi 2 pikat (f,h,i dhe m), b) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 të këtij ligji, që është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë, c) për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, d) për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, në qoftë se kjo shkelje është bërë në procedurën para gjykatës së shkallës së dytë. 2. Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. 3. Kundër aktgjykimit të dhënë në procedurën e shkallës së dytë me të cilën vërtetohet aktgjykimi në bazë të pohimit, revizioni mund të paraqitet vetëm për shkaqet nga paragrafi 1 pika a), b) dhe d) të këtij neni. 4. Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë me të cilin vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga paragrafi 1 pika a) e këtij neni, përveç nëse ekzistimi i tyre nuk është përmendur në ankesë, përpos kur bëhet fjalë për shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e revizionit ".

Me nenin 391 paragraf 1 pika f) të LPK-së, përcaktohet se: " Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedhë padinë si të palejueshme nëse padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj ". Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të këtyre ligjeve rrjedh se gabimisht është aplikuar e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, ngase padia është dashur të hedhet si e palejueshme pasi që padija është e paraqitur pas skadimit të afatit ligjor.

Me nenin 227 të LPK-së, përcaktohet se: " *Po që se me dispozitat e neneve të këtij kreu nuk parashikohet ndonjë gjë tjetër, në procedurën sipas revizionit, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e këtij ligji mbi ankesën kundër aktgjykimit, përveç dispozitave me të cilat parashihet mundësia e mbajtjes së shqyrtimit të çështjes kryesore në gjykatën e ankimit.".*

Me neni 195 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, përcaktohet se: *" Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë".*

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 391 paragrafi 1, pika f), nenit 182 paragraf 2 pika e), nenin 214 të LPK-së, dhe nenin 9, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 214 i ligjit bazik të LPK-së, nenin 227 e lidhur me nenin 195 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, si dhe lidhur me nenin 79 të Ligjit të Punës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Aktvendimi Rev.nr.442/21, i datës 12.05.2022**

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon revizionin e palës paditëse dhe vlerëson se aktgjykimi i shkallës së dytë është marrë si rezultat i shkeljeve të dispozitave procedurale nga neni 182 par.2 pika (e) të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale nga neni 79 të Ligjit të Punës.

Gjykata Supreme bazuar në faktet e çështjes vlerëson se pala paditëse me vendimin e të paditurës nr...., të datës ...., është zgjedhur si mësimdhënëse e gjuhës angleze në shkollën "....", ndërsa e paditura duke e zbatuar vendimin e inspektoratit të arsimit nr...., datë ...., ka nxjerr një akt me datë 06.11.2014 me të cilin paditësen e heqë nga lista në të cilën ka qenë e zgjedhur si mësimdhënëse dhe në listë vendoset një person tjetër. Përkundër asaj që ky akt me të cilin paditësja është hequr nga pozita e zgjedhur nuk ka pas këshillë juridike, pala paditëse kundër kësaj mënyre të vendosjes ka paraqitur ankesë te e paditura e cila me shkresën e datës 25.11.2014 i është përgjigjur në ankesë dhe njëkohësisht e ka udhëzuar që ankesën ta referoj në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Pala paditëse, ankesën e ka paraqitur në Ministri të Arsimit, ku me këtë rast Inspektorati i Arsimit në kuadër të kësaj ministrie merr vendim me nr..., të datës ..., me të cilin e aprovon ankesën e palës paditëse, ndërsa e paditura është dashur që ta rishqyrtoj rastin e paditëses, por që i njëjti nuk është respektuar nga e paditura.

Në prani të fakteve të tilla, Gjykata Supreme vlerëson se padia e paditëses nuk mund të konsiderohet e pasafatshme, kjo pasi që e paditura e ka udhëzuar palën paditëse që kundër vendimit të saj dhe për çdo pakënaqësi ankesë të paraqesë në Ministrinë e Arsimit ndërsa me këtë udhëzim te pala paditëse është krijuar pritja legjitime se kundër vendimit të palës së paditur ankesë duhet

paraqitur në një mekanizëm tjetër. Duke u nisur nga fakti që e paditura ka udhëzuar palën paditëse në paraqitjen e mjetit juridik dhe marrë për bazë datën 20.01.2015, të vendimit të marr nga ky institucion dhe datën 05.02.2015 kur është paraqit padia në gjykatë rezulton se padia është paraqitur brenda afatit ligjorë të përcaktuar me nenin 79 të Ligjit të Punës.

Përveç kësaj, Gjykata Supreme vlerëson të afatshme padinë edhe për faktin se Inspektorati i Arsimit është organ ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë dhe rrjedhimisht mekanizëm që duhet shfrytëzuar para se pala t'i drejtohet gjykatës, që në kuadër të detyrave të inspektoratit është edhe inspektimi i pranimit të kuadrit edukativ e mësimor, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat nga nenet 3 dhe 4.3, pika h) të Ligjit për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (Ligji nr. 2004/37, që ka qenë në fuqi dhe është zbatuar në kohën kur është vendos lidhur me çështjen e paditëses)

Në rrethana të tilla rezulton se padia e paditëses është e afatshme, ndërsa në rivendosje gjykata e shkallë së dytë duhet të vendos në lidhje me ankesën e palës së paditur dhe të njëjtën ta shqyrtoj konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

KAPITULLI VIII

SHPRONËSIMI DHE KOMPENSIMI I PRONËS SË SHPRONËSUAR

E drejta e pronësisë është e drejtë reale (sendore) e cila në vete përmban autorizime të gjera që i referohen përdorimit, shfrytëzimit dhe disponimit të lirë me sendin e caktuar. Pronari ka autorizime që sendin e caktuar ta përdorë, shfrytëzojë dhe të disponojë lirshëm me të, ku nga kjo rrjedh se e drejta e pronësisë është absolute dhe e pacenueshme. Me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, shprehimisht përcaktohet që *,"Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti''.*

E drejta e pronësisë private si e drejtë subjektive e karakterit absolut që vepron ndaj të gjithëve "erga omnes" përveç që gëzon mbrojtje juridike me legjislacionin vendor, kjo e drejtë është e garantuar edhe me akte ndërkombëtare, pasi që konsiderohet si e drejtë e njeriut dhe në këtë kontekst është e pacenueshme dhe mund të kufizohet vetëm për interes publik dhe nën kushtet e përcaktuara me ligj.

Me nenin 1 të Protokollit 1 të KEMDNJ shprehimisht parashihet që "Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare''.

Megjithatë nga parimi i cenimit të së drejtës së pronësisë private si një e drejtë e karakterit absolut që vepron ndaj të gjithëve, ka përjashtim për arsye se edhe me aktet ndërkombëtare por edhe me kushtetutën e shtetit tonë e cila është e harmonizuar me aktet dhe standardet ndërkombëtare, nuk preket e drejta e shtetit tonë që të nxjerrë ligje përmes të cilave pronarit të një paluajtshmërie edhe pa vullnetin e tij të lirë, mund t'i merret apo kufizohet e drejta e pronësisë përmes shpronësimit të pronës së tij, nëse një gjë e tillë i shërben interesit publik, e nën kushtet e parapara me ligj, gjithnjë duke iu gjykuar pronarit kompensim i drejtë. Një e drejtë e tillë, pronarit mund t'i kufizohet edhe për sigurimin e pagesës së taksave, kontributeve tjera ose gjobave.

Në kontekst të kësaj, ligjet vendore të cilat i përcaktojnë kushtet për kufizimin e pronësisë, çdoherë duhet të jenë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, dhe zbatimi i tyre po ashtu duhet të

jetë në pajtim me praktikën e krijuar nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ), e cila është kompetente për të vendosur lidhur me të drejtat që burojnë nga Konventa Evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut (KELDNJ). Kjo do të thotë se nxjerrja e ligjeve për shpronësim është e drejtë e shteteve, por duhet të caktohen kushtet ligjore që nuk i cenojnë standardet ndërkombëtare.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e drejta e pronës është njëra nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Pikërisht neni 46 paragrafi 3, e rregullon dhe e garanton mbrojtjen e pronës nga çdo ndërhyrje arbitrare ku shprehimisht përcakton që "Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona". Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund ta bëjë ekspropriimin e pronës, nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve ekspropriohet". Pra, me këtë dispozitë është garantuar e drejta e pronësisë private nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve shtetërore – publike.

Sipas nenit 46 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shpronësimi lejohet në këto kushte: 1. për interes (qëllim) publik, 2. me një kompensim adekuat dhe 3. në kushtet dhe procedurat e parapara me Ligj të veçantë.

Çështja e shpronësimit të pronës së paluajtshme dhe kompensimit të saj, në vendin tonë është e rregulluar me Ligjin nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme të datës 26 mars 2009, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010, i cili është ligj special "lex speciale". Me këtë ligj rregullohet vetëm shpronësimi dhe kufizimi i pronës së paluajtshme nga autoritetet publike (neni 3 par. 2), dhe i njëjti përmban dispozita materiale dhe procedurale për shpronësim, ndërsa me nenin 46 të tij është shfuqizuar Ligji për Ekspropriim i vitit 1978, (GZ e KSAK 21/78), me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e më vonshme të tij.

Me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme, në mënyrë specifike parashikohen këto faza të cilat duhet t'i zbatojnë autoritetet shtetërore: 1. caktimi i interesit të përgjithshëm, 2. punët përgatitore, 3. procedura e shpronësimit dhe 4. vendimi i kompensimit, mirëpo më tutje ne nuk do t'i elaborojmë këto faza nga se ato nuk janë objekt i trajtimit të kësaj teme

Kjo do të ishte si hyrje në problematikën e shpronësimit, ndërsa në elaborimin e mëtejshëm do të ndalemi te kompensimi i shpronësimit, me theks të veçantë te kompetenca lëndore e gjykatës për caktimin e këtij kompensimi në rastet kur kemi të bëjmë me shpronësimin sipas vendimit përfundimtar administrativ, në rast kur kemi të bëjmë me kompensimin e pronës së pa përfshirë me vendimin për shpronësim i cili kompensim rezulton nga humbja e vlerës të pjesës së pa shpronësuar (shpronësim i pjesshëm), dhe në rastet kur kemi të bëjmë me shpronësimin faktik.

Përmbledhje e shkurtër e të gjeturave të përgjithshme nga Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës, sa i përket rasteve të caktimit të kompensimit në tri situatat e përmendura më lartë, kemi gjetur se nga ana e gjykatave të instancës së parë por edhe të dytë, përmes vendimeve të nxjerra nuk aplikohen drejtë dispozitat e Ligjit material, e të cilat vendime në të shumtën e rasteve përfshihen edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Sa i përket caktimit të kompensimit për patundshmërinë e shpronësuar me vendim përfundimtar administrativ, nuk ka dilema gjyqësore e as laramani në vendimmarrje përkitazi me kompetencën lëndore të gjykatave themelore, kjo ngase Ligji mbi Procedurën Jokontestimore Nr.03/L-007, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës nr. 45 më datë 12.01.2009, shumë qartë, prej nenit 215-222 ka rregulluar caktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar. Mirëpo, vendimmarrjet ndryshe janë evidentuar nga ana e Gjykatës Supreme, sa i përket kompetencës lëndore për caktimin e kompensimit në rastet e zvogëlimit të vlerës së pa përfshirë me aktin e shpronësimit dhe caktimit të kompensimit të pronës si shpronësim faktik, gjegjësisht marrje arbitrare e pronës pa respektuar procedurat e përcaktuara ligjore sipas ligjeve në fuqi.

Komenti i shkurtër i dispozitës ligjore, neni 37 par. 1 të Ligjit për shpronësim

Në këtë dispozitë ligjore parashihet që : “Nëse në përputhje me par. 3 të nenit 18 të këtij Ligjit, vendimi përfundimtar autorizon shpronësimin e një pjese të parcelës së pronës së paluajtshme dhe kjo rezulton, ose me arsye pritet se do të rezultojë në humbjen e vlerës të pjesës së pa shpronësuar, pronari i pjesës së pa shpronësuar ka të drejtë të paraqesë ankesë sipas këtij neni dhe të kërkojë nga gjykata kompetente nxjerrjen e një aktgjykimi i cili urdhëron organin shpronësues që të

kompensojë humbjen e vlerës, nëse – dhe vetëm për aq sa ky kompensim nuk është paraparë në vendimin përfundimtar".

Tani për caktimin e kompensimit për humbjen e vlerës të pjesës së pa shpronësuar, në praktikën gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë dhe të dytë, Gjykata Supreme ka vërejtur se në shumë raste është vendosur ndryshe për kompensimin e dëmeve tjera të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim, për anekse të ndryshme në paluajtshmërinë e shpronësuar, pjesët akcesore dhe frutat e saj, fitimin e humbur, kompensimin e humbjes së vlerës për shkak të shuarjes së një servituti real si pasojë e shpronësimit të një prone të paluajtshme, kompensimin në rastin e shpronësimit të pjesshëm ose shuarjes së interesit të siguruar, servitutit personal, të drejtës së ndërtimit, të drejtës së parablerjes, uzufruktit ose të drejtës së shfrytëzimit dhe kompesnimi në rastin e zgjidhjes së kontratës së qiramarrjes.

Edhe pse ankuesi e kërkon kompensimin për kategoritë e dëmit siç është theksuar më lartë, gjykata që e zhvillon procedurën e kompensimit nuk vendos meritorisht për këtë pjesë të kërkesës së ankuesit, ku në disa raste pezullohet e në disa raste ndërpritet procedura jokontestimore për kompensimin e këtyre kategorive të dëmeve, dhe ankuesi – kërkuesi udhëzohet në procedurë kontestimore për realizimin e kësaj të drejte. Po ashtu, është vërejtur se në shumicën e rasteve, gjykatat që zhvillojnë procedurën për caktimin e shpronësimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, përkitazi me kërkesën e ankuesit për kompensimin e vlerës së zvogëluar të pjesës së paluajtshmërisë të mbetur të pa shpronësuar, pezullojnë procedurën e vendosjes sipas rregullave të procedurës jokontestimore dhe këto palë i udhëzojnë në kontest civil, në këtë mënyrë, Gjykata Supreme gjendet para aktit të kryer të pranimit të një qëndrimi të tillë të kundërligjshëm ngase ligjërisht nuk mund të intervenojë për shkak se revizioni në këtë pjesë të aktvendimit të kundërshtuar nuk është i lejuar, pasi që për atë pjesë nuk është vendosur meritorisht nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Për këtë arsye paraqitet si e domosdoshme që të unifikohet praktika gjyqësore e vendimmarrjes për këto çështje.

Gjetjet e Gjykatës Supreme lidhur me mos aplikimin e drejtë të nenit 15 par. 1 e 2, 17, 18, 19, 36 par. 6 dhe 37 par. 1 të Ligjit për Shpronësim

Gjykata Supreme konsideron që nuk ka asnjë pengesë ligjore që në të njëjtën procedurë jokontestimore me rastin e caktimit të kompensimit për shpronësim të paluajtshmërisë, njëkohësisht me aktvendim, në të njëjtën procedurë (procedurë jokontestimore), të vendoset edhe

lidhur me pjesën e ankesës për kompensimin e dëmeve tjera të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim, për arsye se me nenin 23.3.2 të Ligjit të lartpërmendur është përcaktuar se "Zyra për vlerësim të pronës së paluajtshme në aktin e vlerësimit, përfshinë edhe një vlerësim të gjitha dëmeve, nëse ka, të cilat duhet të paguhen sipas ligjit." Po ashtu edhe gjykata në kuptim të nenit 15 par. 1 e 2, 17, 18, 19, 36 par. 6 dhe 37 par. 1 të këtij Ligji, nëse konstaton se shuma e kompensimit dhe/ose dëmeve, e përcaktuar në vendimin e organit shpronësues është më e ulët ose më e lartë se shuma që kërkohet sipas Ligjit, ose kompensimi i këtyre dëmeve nuk është përfshirë fare në vendimin përfundimtar për shpronësim, do të nxjerrë aktvendim me të cilin e ndryshon vendimin përfundimtar të organit shpronësues dhe e rregullon shumën e kompensimit për shpronësim duke e plotësuar edhe me kompensimin e këtyre dëmeve të tjera të pa përfshira në aktin përfundimtar për shpronësim.

Në këto raste gjykatat janë duke vepruar në kundërshtim me nenin 15 par. 1 e 2, 17, 18, 19,36 par. 6 dhe 37 par. 1 të këtij Ligi, si dhe në kundërshtim me nenin 2 të LPK-së, për arsye se nëse i referohemi dispozitave të lartcekura rezulton pa dyshim se gjykata nuk ka asnjë pengesë ligjore në procedurë jokontestimore të vendosë njëkohësisht me aktvendim lidhur me kërkesat e ankuesit, për të gjitha kategoritë e dëmeve të lartcekura, çka ka qenë edhe qëllimi i ligjdhënësit, e jo vetëm për zbatimin e parimit të ekonomizimit të procedurës, por edhe për faktin se pronari ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme, paluajtshmëria e të cilit shpronësohet, të kompensohet plotësisht jo vetëm për pjesën e shpronësuar por edhe për dëmin që vjen si pasojë e këtij shpronësimi e i cili shprehet në zvogëlimin e vlerës së pjesës së pa shpronësuar si dhe kompensimet tjera, me vendimin përfundimtar për shpronësim. Pezullimi apo ndërprerja e procedurës jokontestimore për vendosje lidhur me kërkesën e ankuesit që në këtë procedurë të mos vendoset edhe për kërkesën për kompensimin e vlerës së zvogëluar të paluajtshmërisë së shpronësuar si dhe për kompensimet tjera, pa dyshim është në kundërshtim me nenin 2 të LPK-së, të përshkruar më lartë. Gjykata ka detyrim që të vendosë lidhur me të gjitha kërkesat e paraqitura sipas ankesës respektivisht propozimit, dhe mos vendosja sipas të gjitha kërkesave të tilla, paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës. Faktikisht, vendosja e gjykatës me aktvendim, në procedurë jokontestimore, në mënyrë të drejtpërdrejt ndikon edhe në efikasitetin dhe zvogëlimin e numrit të lëndëve civile në gjyqësorin e Kosovës, dhe në këtë mënyrë në zbatimin efikas të drejtësisë në Kosovë, kjo ngase ankuesi me këtë veprim nuk detyrohet që të iniciojë kontest civil

të veçantë për tu kompensuar për vlerën e zvogëluar të paluajtshmërisë dhe kompensimet tjera, të cilat nuk janë përfshirë me vendimin përfundimtar për shpronësim.

Për këto arsye Gjykata Supreme e Kosovës në Mendimin Juridik nr. 107/2022 të datës 12.05.2022 të aprovuar në Seancën e Përgjithshme të gjyqtarëve, ka konstatuar se gjykata në procedurë jokontestimore e cila zhvillon procedurën e caktimit të kompensimit për shpronësim të paluajtshmërisë, me aktvendim me të cilin cakton kompensimin për shpronësim, me kërkesën e pronarit, zotëruesit të ndonjë interesi, cakton edhe kompensimin për dëmet tjera të pa përfshira në aktin përfundimtar të shpronësimit. Më tutje, në këtë mendim juridik Gjykata Supreme konstaton se, nëse në ankesën për caktimin e kompensimit për shpronësim nuk paraqitet kërkesa edhe për kompensimin e dëmeve tjera të lartpërmendura, e të cilat nuk janë përfshirë në vendimin përfundimtar për shpronësim, të cilat dëme lidhen me tërë paluajtshmërinë e shpronësuar apo me një pjesë të saj, kjo nuk do të thotë se ankuesi nuk ka të drejtë që të kërkojë kompensimin në procedurë kontestimore siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Po ashtu, në të njëjtin mendim juridik Gjykata Supreme konstaton edhe se në rastet të cilat janë në zhvillim e sipër sipas ankesave, për kompensimin e humbjes së vlerës të pjesës së pa shpronësuar dhe për kompensime tjera të përcaktuara më lartë, në të cilat është pezulluar apo ndërprerë procedura jokontestimore për vendosje sipas ankesave/kërkesave të tilla, në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa edhe në gjykatën e shkallës së dytë në procedurë ankimore, është vërtetuar ky pezullim apo ndërprerje e procedurës, apo në mungesë të ankesës në këtë pjesë të aktvendimit, ky pezullim apo ndërprerje e procedurës jokontestimore ka mbetur e pashqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë, pronarit apo zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme i mbetet mundësia e vetme që në procedurë kontestimore të kërkojë kompensimin siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurë Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi *Rev.nr.209/2022 i datës 02.11.2022***

A r s y e t i m

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të palës së paditur, me aktgjykimin Ac.nr.3789/2018, të datës 06.06.2021, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës K.P, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i

Përgjithshëm C.nr.2182/17 i datës 18.05.2018, me të cilin në pikën një të dispozitivit është vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.G. nga fshati ..., Komuna P., dhe detyrohet e paditura K.P., që paditësit t'ia kompensojë dëmin real dhe fitimin e humbur për patundshmërinë - ngastrën kadastrale numër ..., të evidentuar në listën poseduese numër ..., Zona Kadastrale ..., në shumën e përgjithshme prej 32,733.00 € dhe atë: në emër të kompensimit të dëmit real për sipërfaqen 580 m^2 nga ngastra kadastrale numër ..., të marrë nga e paditura me qëllim të ndërtimit të rrugës së asfaltuar, shumën prej 16,820.00 €, në emër të dëmtimit të pronës në pjesën e patundshmërisë ngastrës kadastrale ..., ZK .M në të cilën paditësit i është pamundësuar qasja në sipërfaqe prej 532 m^2, e paditura të kompensojë shumën prej 10,799.60 €, në emër të fitimit të humbur për shkak të asgjësimit të pemëve drufrutore të kompensojë dëmin në shumë prej 5,153.40 €, të gjitha këto në afatin kohor prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm dhe në pikën II të dispozitivit është vendosur që të detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t'ia paguajë shumën e parave prej 1,190.00 euro, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit të paditurës në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i palës së paditur është pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në padi të datës 28.12.2007 dhe në shqyrtimet e mbajtura përmes të autorizuarit të tij ka theksuar se është pronar i ngastrës kadastrale nr..., që evidentohet në fletën poseduese nr..., Zona Kadastrale M, të cilën e ka shfrytëzuar pa pengesa, derisa e paditura duke mos zbatuar asnjë dispozitë ligjore, ka ndërtuar rrugën nëpërmes kësaj ngastre, duke e dëmtuar pronën dhe paditësi pasi që nuk ka mund ta shfrytëzojë paluajtshmërinë dhe të korrë të vjelat nga ajo. Ka theksuar se e paditura nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë për ekspropriimin e tokës dhe paditësi si pronar nuk është kompensuar, andaj është privuar tërësisht nga e drejta për pronë në patundshmërinë. Paditësit i është pamundësuar qasja dhe shfrytëzimi i pjesës së patundshmërisë në sipërfaqe prej 530 m^2, me çka po ashtu ka pësuar dëm material, ku ka kërkuar nga e paditura kompensimin e dëmit real dhe fitimin e humbur për patundshmërinë ngastrën kadastrale nr..., e evidentuar në fletën poseduese ..., ZK M., në shumën e përgjithshme prej 32.733.00 €.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar të paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.2182/17 të datës 18.05.2018, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, e duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestuese se gjatë ndërtimit të rrugës Grashticë – Mramor, nga patundshmëria – pronë e paditësit të përshkruar si në ekspertiza është marrë një sipërfaqe prej 580 m^2 dhe që me atë rast është bërë edhe disniveli ashtu që një pjesë e patundshmërisë është ngritur prej rreth 2.5 m^2 ashtu që pjesa tjetër prej 532 m^2 ka mbetur nën nivelin e rrugës. Nuk ishte kontestuese se Komuna e Prishtinës nuk ka nxjerrë vendim administrativ për eksproprijim të pronarëve që kishin toka në vendin ku do të zbatohej projekti për ndërtimin e rrugës në fjalë. Gjykata përmes ekspertizës së gjeodezisë të datës 12.05.2014 ka vërtetuar faktin se ngastra kontestuese ishte mbushur me zhavorr për shkak të asfaltimit të rrugës lokale Grashticë - Mramor, e cila mbushje është bërë në pjesën e paditësit në sipërfaqe prej 580 m^2, që është marrë nga Komuna e Prishtinës për zgjerimin rregullimin dhe asfaltimin e rrugës lokale. Po ashtu është konstatuar se në një pjesë tjetër të ngastrës ..., është ngritur disniveli prej 2.5 m lartësi dhe për shkak të kësaj paditësit i pamundësohet shfrytëzimi i pjesës së mbetur me sipërfaqe prej 532 m^2, i cili konstatim përputhet me ekspertizën e gjeodezisë të datës 23.03.2009. Nga kjo rezulton se paditësit pa asnjë kompensim i është marrë prona – patundshmëria në sipërfaqe prej 580 m^2, ndërsa sipërfaqja tjetër e të njëjtës ngastër kadastrale prej 532 m^2, është dëmtuar në masë të konsiderueshme (70%) për shkak të disnivelit prej 2.5 m në lartësi, veç kësaj është vërtetuar se në sipërfaqen e dëmtuar rrjedhin ujërat e zeza, të cilat kanë ndikuar në tharjen dhe asgjësimin e pemëve drufrutore në pronën e paditësit. Është konstatuar se lartësia e kompensimit është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit R. B., i cili ka bërë vlerësimin e paluajtshmërisë kontestuese, si dhe nga super ekspertiza e datës 25.05.2015, e ekspertëve të licencuar për vlerësimin e pronave të paluajtshme V. I., S. I. dhe T. Z., të cilët në mënyrë precize dhe të qartë kanë bërë përshkrimin dhe vlerësimin e ngastrës kontestuese, pjesën prej 580 m^2 që është marrë nga e paditura për ndërtimin e rrugës dhe pjesën e mbetur prej 532 m^2 vlerën se sa është dëmtuar, e që është 70%. Në lidhje me marrëveshjen dhe shumat që pretendohet se paditësi është kompensuar, gjykata e shkallës së parë përmes deklaratave të dëshmitarëve ka vërtetuar se shumat të cilat paditësi i ka marrë si kompensim i ka kthyer për shkak se palët nuk kanë arritur që

t'i përmbahen marrëveshjes së nënshkruar, ndërsa paditësi ka mbetur pa u kompensuar. Vendimin për kompensimin e dëmit real dhe fitimit të humbur, gjykata e bazoi në dispozitën e nenit 189 të LMD-së, ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.2 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n), ndërsa në lidhje me pretendimin ankimor për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, është konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike me provat e administruara, ku baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë është vërtetuar nga ekspertizat e gjeodezisë dhe ekspertiza dhe super ekspertiza për vlerësimin e paluajtshmërisë. Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e ankimore për aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kjo pasi që gjendja faktike e konstatuar nxjerr përfundimin e qartë se pala e paditur mban përgjegjësinë për dëmin real dhe fitimin e humbur që i është shkaktuar paditësit, për çka e paditura është e detyruar në kompensimin e dëmit konform nenit 189 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me kërkesën për kompensim të dëmit real në sipërfaqen 580 m^2 nga ngastra kadastrale nr..., të marrë nga e paditura për ndërtim të rrugës, kjo pasi që aktgjykimet e kundërshtuara në këtë pikë nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), të LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta në procedurën gjyqësore të zhvilluar në këtë çështje kanë paraqitur arsye të qarta për faktet vendimtare dhe atë për faktin se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr. ..., ndërsa nga kjo ngastër sipërfaqja prej 580 m^2 i është marrë paditësit nga pala e paditur pa proces të shpronësimit dhe është përdorur për ndërtimin e rrugës lokale Grashticë-Mramor. Përveç kësaj, gjykatat kanë paraqitur arsye të qarta edhe për lartësinë e

kompensimit në këtë pjesë të kërkesëpadisë ku përmes super ekspertizës financiare është vërtetuar se cila është vlera e paluajtëshmërisë të marrë nga pala e paditur pa asnjë bazë ligjore.

Pala e paditur në revizionin e ushtruar pretendon se pala paditëse me të paditurin kanë lidhur marrëveshje për kompensim dhe atë 5000 € nga e paditura, 3000 nga kompania "F.-C." dhe nga M..., 5000 €, mirëpo nga provat e administruara në këtë proces rezulton se shumat janë kthyer nga pala paditëse, gjë që realisht pala paditëse nuk është kompensuar. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me të drejtën e pronësisë në paluajtshmëri, ndërsa për tu marrë kjo e drejtë ose në ndonjë mënyrë për tu kufizuar duhet të ekzistoj baza ligjore. Në këtë rast pala e paditur nuk ka lidhur ndonjë kontratë të shitblerjes me paditësin por as nuk ka zhvilluar proces të shpronësimit për të vlerësuar interesin e përgjithshëm në ndërtimin e rrugës dhe caktimin e kompensimit real për paluajtshmerinë e përdorur për ndërtim të rrugës. Nuk është me rëndësi fakti i potencuar nga e paditura se të tjerët a kanë kërkuar kompensim apo jo dhe për çfarë interesi është shtruar rruga, kjo pasi që çështja e kërkesës për kompensim është çështje e vlerësimit individual të secilit pronar, ndërsa nëse vlerësohet se rruga është shtruar për interes të banorëve atëherë komuna paraprakisht është dashur që këtë interes ta vlerësoj dhe të ndërmarr hapat ligjor që përcaktojnë se si duhet vepruar në raste të tilla.

Me nenin 154 par.1 i LMD-së është parapa që: " K*ush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij"*.Gjykata Supreme vlerëson se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar, dispozitës së sipër cituar, rezulton se në këtë rast kemi të bëjmë me shkaktim të dëmit material ndaj palës paditëse, *kjo pasi që e paditura paditësit ia merr sipërfaqen prej 580m2 nga ngastra kadastrale nr.2251, pa proces të shpronësimit,* për nevoja të interesit të përgjithshëm përkatësisht për ndërtim të infrastrukturës për nevoja të ndërtimit të rrugës lokale Grashticë - Mramor, me ç'rast paditësi më nuk mund ta përdorë paluajtshmërinë e tij dhe i është shkaktuar dëm në vlerën e cila është përcaktuar në super ekspertizën financiare.

Lidhur me vendosjen si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi

Revizioni i të paditurës është vlerësuar i themeltë në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë ku është vendosur që paditësit t'i njihet e drejta në emër të dëmtimit të pronës – pamundësia në qasje në sipërfaqen prej 532 m^2, fitimit të humbur për shkak të asgjësimit të pemëve dhe pikën e dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, ngase

sipas Gjykatës Supreme kemi shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së. Kjo pasi që për vendosje në këtë mënyrë gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë dhënë arsye për faktet vendimtare ndërsa arsyet që janë dhënë janë të paqarta dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës.

Gjykatat paditësit ia njohin të drejtën në kompensim edhe për pjesën tjetër të pronës në sipërfaqe prej 580m^2, me vlerësim se është dëmtuar në masë të konsiderueshme prej 70%. Mirëpo arsyet e paraqitura për këtë pjesë të kërkesëpadisë janë kundërthënëse dhe nuk është qartësuar se dëmi i pretenduar në çka konsiston. Pra paditësi nuk mund ta shfrytëzoj paluajtshmërinë në këtë masë se i është mbyllë qasja në infrastrukturë apo se nëpër të kalojnë ujërat e zeza. Këto janë dy situata të ndryshme që rrjedhimisht duhet sqaruar nga gjykata e shkallës së parë me ekspert përkatës. Nëse bëhet fjalë për ujërat e zeza, nuk ka arsye dhe nuk është qartësuar se me çka është vërtetuar se kemi të bëjmë me ujërat e zeza, pastaj ujërat e tilla a kanë kaluar nëpër këtë paluajtshmëri para se të ndërtohet rruga. Nëse çështja ka të bëjë se paditësit nuk i është lënë mundësia për qasje, gjykata me ekspertin përkatës duhet të dal në vend shikim që duke marrë për bazë pozitën e ngastrës, ajo për çka është përdorë deri më tani, të vlerësohet se a ekziston ndonjë mundësi që të krijohet qasja në këtë paluajtshmëri apo të hiqen ujërat e zeza të konstatuar, në mënyrë që paditësi ta shfrytëzoj këtë paluajtshmëri. Përveç kësaj, ka paqartësi edhe në lidhje me caktimin e lartësisë së vlerës për paluajtshmërinë (siç është cekur të pa shpronësuar), kjo pasi që vlera është dhënë mbi bazën e asaj që është nxjerrë përfundimi se prona është dëmtuar rreth 70%, mirëpo është e paqartë se vlerësimi i tillë në çka është mbështetë dhe caktimi i vlerës a i referohet asaj që paditësi nuk mundet me mbjellë më kultura të ndryshme bujqësore apo që nuk mund ta shfrytëzoj për ndërtim, gjë që janë dy situata të ndryshme për të cilat duhet dhënë arsye të plota.

Kjo gjykatë vlerëson se edhe vendimi në lidhje me fitimin e humbur për shkak të asgjësimit të pemëve duhet prishur, kjo pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë paraqitur arsye për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë pjesë të kërkesëpadisë. Nga shkresat e lëndës rezulton se vendosja për këtë pjesë mbështetet në atë se çka ka deklaruar pala paditëse se sa në prova konkrete. Ekspertizat që gjykatat ju kanë referuar për të mbështetur vendimet e tyre për këtë pjesë të kërkesëpadisë nuk kanë përshkrime të sakta në lidhje me sasinë e pemëve që kanë qenë të mbjella në këtë paluajtshmëri, llojin dhe vjetërsinë e tyre, por vlerësimet mbështeten në pemët që kanë mbetur dhe në atë që është deklaruar pala paditëse. Në këtë rast duhet saktësisht të dihet sa

pemë kanë qenë të mbjella në sipërfaqen që është marrë për ndërtimin e rrugës, llojin dhe specifikat tjera të tyre, për të cilat pretendohet nga paditësi se kanë ekzistuar në paluajtshmërinë para se të merret për ndërtim të rrugës.

Kjo gjykatë vlerëson se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga gjykatat e instancave më të ulëta, mos sqarimit të fakteve vendimtare që kanë të bëjnë me këtë çështje, rezulton se gabimisht është aplikuar e drejta materiale lidhur me pjesën e kërkesës së padisë që ka të bëjë me kompensimin e dëmit në emër të dëmtimit të pronës dhe fitimit të humbur. Andaj mbi këtë bazë është prishur aktgjykimi i shkallës së parë dhe i gjykatës së shkallës së dytë në lidhje me këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditësit.

Për pjesën e aktgjykimit ku çështja është kthyer në rivendosje, gjykata e shkallës e parë udhëzohet që në ri procedurë të evitoj shkeljet e theksuara, të vërtetoj faktet e theksuara që kanë të bëjnë me kërkesën për kompensim të dëmit në paluajtshmërinë e mbetur dhe kompensimin në emër të fitimit të humbur.

Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës, me këtë aktgjykim, ka aprovuar pjesërisht të themeltë revizionin e palës së paditur, ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.3789/2018, të datës 06.06.2021 dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2182/17, të datës 18.05.2018, në pikën I (një) të dispozitivit në pjesën ku është aprovuar kompensimi i dëmit në emër të dëmtimit të pronës, për shkak se paditësit i është pamundësuar qasja në sipërfaqe prej 532 m^2, dhe kompensimi në emër të fitimit të humbur për shkak të asgjësimit të pemëve drufrutore.

- **Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.83/2021 datë 31.03.2022**

Me aktvendim e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.1563/2018 të datës 26.11.2020, është refuzuar e pathemeltë ankesa e propozuesit dhe ankesa e kundër propozuesit, ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, CN.nr.117/2015 i datës 06.02.2018, me të cilin, në pikën I të dispozitivit aprovohet propozimi i propozuesit, ndryshohet vendimi përfundimtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. ... datë ..., dhe raporti i vlerësimit i datës ..., sa i përket ngastrës kadastrale nr. ..., në sipërfaqe prej 571 m^2 në zonën kadastrale Gadime e Ulët, dhe detyrohet kundër propozuesi që t'ia kompensoj propozuesit kompensimin shtesë për

patundshmërinë e shpronësuar me vendimin e lartcekur në shumë prej 6 € për metër katror apo shumën e përgjithshme prej 3,426 € me kamatë vjetore në lartësi prej 7% nga data e vendimit përfundimtar respektivisht akti i vlerësimit i datës 05.05.2015 e deri në pagesën definitive. *Ndërsa, me pikën II të dispozitivit, pezullohet, pjesa e propozimit të propozuesit me të cilën ka kërkuar që kundër propozuesi t'ia kompensoj vlerën e humbur në shumën prej 5,800 € të ngastrës nr..., përkatësisht për sipërfaqen e saj prej 700 m^2 të mbetur jashtë shpronësimit,* në anën perëndimore, si dhe shumën prej 2,156 € për pjesën e patundshmërisë në sipërfaqe prej 770 m^2 të mbetur jashtë shpronësimit në anën lindore, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda do të procedohet për këtë pjesë në procedurë kontestimore.

Kundër aktvendimit të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së dytë, propozuesi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur revizion vetëm sa i përket pikës II të dispozitivit të aktvendimit të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë, me propozim që e njëjta pikë e të njëjtit aktvendim, si dhe aktvendimi i kundërshtuar me revizion i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohen ashtu që të detyrohet kundër propozuesi që t'i kompensoj propozuesit dëmin në emër të zvogëlimit-humbjes së vlerës shumën prej 5,800 € të ngastrës nr...., përkatësisht për sipërfaqen e saj prej 700 m^2 të mbetur jashtë shpronësimit, në anën perëndimore, si dhe shumën prej 2,156 €, për pjesën e patundshmërisë në sipërfaqe prej 770 m^2 të mbetur jashtë shpronësimit në anën lindore , me kamatë prej 7%, si interes i thjeshtë vjetor, që nga data 05.05.2015 e deri në pagesën definitive.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit në kuptim të nenit 228 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), gjeti se revizioni i propozuesit i paraqitur përmes të autorizuarit të tij, është i palejuar, për faktin se në nenin 228.1 të LPK-së, parashihet që palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Në rastin konkret, duke marrë parasysh që në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të shkallës së parë, të vërtetuar me aktvendimin e shkallës së dytë kundër të cilës është paraqitur revizioni, është pezulluar procedura e vendosjes sipas propozimit të propozuesit për kompensimin e vlerës së humbur të patundshmërisë së përshkruar më afër në këtë pikë të dispozitivit, dhe kësisoj, nuk është vendosur në mënyrë meritore për këtë pjesë të propozimit dhe për të njëjtën nuk ka vendim gjyqësor meritor me të cilin gjykohet lidhur me këtë pjesë të propozimit të propozuesit, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në këtë

situatë faktike dhe juridike të çështjes, dhe në pajtim me nenin 228.1 të LPK, revizioni i propozuesit në rastin konkret nuk është i lejuar.

Në këtë rast gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me nenin 15 par. 1, nenet 2, 17, 18, 19, 36 par. 6 dhe 37 par. 1 të këtij Ligi, dhe nenin 2 të LPK-së, për arsye se nëse i referohemi dispozitave të lartcekura rezulton pa dyshim se gjykata nuk ka asnjë pengesë ligjore në procedurë jokontestimore të vendosë njëkohësisht me aktvendim lidhur me kërkesat e ankuesit, për të gjitha kategoritë e dëmeve të lartcekura, çka ka qenë edhe qëllimi i ligjdhënësit, e jo vetëm për zbatimin e parimit të ekonomizimit të procedurës, por edhe për faktin se pronari ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme, paluajtshmëria e të cilit shpronësohet, të kompensohet plotësisht jo vetëm për pjesën e shpronësuar por edhe për dëmin që vjen si pasojë e këtij shpronësimi e i cili shprehet në zvogëlimin e vlerës së pjesës së pa shpronësuar si dhe kompensimet tjera, me vendimin përfundimtar për shpronësim. Gjykata ka detyrim që të vendosë lidhur me të gjitha kërkesat e paraqitura sipas ankesës respektivisht propozimit, dhe mos vendosja sipas të gjitha kërkesave të tilla, paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës.

- **Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.152/2023 datë 12.06.2023**

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të kundërpropozueses, me aktvendimin Ac.nr.4558/19, të datës 09.02.2023, e ka refuzuar të pathemeltë ankesën e kundërpropozueses Komuna e Gjilanit, ndërsa ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.23/15, të datës 21.06.2019, me të cilin në pikën I të dispozitivit është caktuar kompensimi për paluajtshmërinë e shpronësuar të propozuesve H. dhe Sh.. B., të dy nga Gj., nga ana e kundërpropozueses Komuna e Gjilanit, e cila evidentohet si ngastër kadastrale ..., në sipërfaqe prej 620m^2 në vendin e quajtur "...", arë e klasit të dytë, e cila në anën lindore kufizohet me parcelën kadastrale ..., të evidentuar në emër të D. A., në distancë prej 25.20m, në anën veriore kufizohet me parcelën ..., e evidentuar në emër të H. B., në distancë prej 28.70m, në anën perëndimore kufizohet me parcelën ..., me pronar R. P., në distancë prej 24.60m dhe në anën jugore kufizohet me parcelën ..., e evidentuar në emër të Sh. B., në distancë prej 27.90m, dhe e ka detyruar kundërpropozuesen që t'ia kompensojë propozuesve shumën e të hollave

në lartësi prej 73,000.00 €, (shtatëdhjetë e tremijë euro). Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit të autorizuarit të kundërpropozureses në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i kundërpropozuesës është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesit H. dhe Sh. B., të dy nga Gj., kanë kërkuar caktimin e kompensimit për ngastrën kadastrale nr..., duke vlerësuar se kjo paluajtshmëri u është shpronësuar me vendimin e kundërpropozueses Komuna e Gjilanit 01.Nr..., të datës .... Ky eksproprijim ka ndodhë për interes publik, përkatësisht për ndërtimin - rregullimin e rrugës qarkore të qytetit të Gjilanit (Projekt i Komunës) dhe nga kundërpropozuesja, asnjëherë nuk është kompensuar, apo nuk i është caktuar kompensimi për paluajtshmërinë e shpronësuar.

Gjykata e shkallës së parë, në procedurë jo kontestimore të zhvilluar sipas ankesës-propozimit të propozuesit i cili ka kërkuar caktimin dhe kompensimin e vlerës reale të paluajtshmërisë së tij (pasi që kjo nuk i është bërë asnjëherë në procedurë administrative), pas vlerësimit të provave, përfshirë këtu edhe ekspertizën nga eksperti vlerësues, ka caktuar kompensimin në shumë prej 73,000.00 €.

Gjykata e Apelit ka pranuar në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, vlerësimin për lartësinë e kompensimit e ka konsideruar në pajtim me nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me të cilin parashihen rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit. Gjykata e shkallës së dytë gjithashtu ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, prandaj pretendimet ankimore të kundërpropozueses se në rastin konkret është zbatuar gabimisht e drejta materiale në këtë drejtim tregohen si të pabazuara. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, ka përdorur të drejtën e saj në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi Eksproprijimin, që vetë ta caktojë lartësinë e kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar të propozuesit, përmes ekspertizës përkatëse, pasi që është bindur se organi i shpronësimit nuk e ka caktuar shumën adekuate për këtë. Në këtë drejtim edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës nga gjykata e shkallës së parë është marrë në përputhje të plotë me dispozitat e LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta, si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 (n) të LPK-së, dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale, ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 204 të LPK-së, për çka aktvendimet patjetër është dashtë të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast ka kundërthënie mes provave të paraqitura dhe vendosjes lidhur me çështjen, kjo pasi që propozuesit kanë iniciuar procedurën jokontestimore dhe të dy gjykatat e kanë cilësuar si procedurë të tillë mirëpo në shkresa të lëndës përveç vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik, nuk ka ndonjë provë që vërteton faktin se është bërë shpronësimi i ngastrës së propozuesve apo të jetë caktuar ndonjë kompensim nga kundërpropozuesja. Nga vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm nuk mund të vërtetohet se ngastra konkrete është përfshirë në shpronësim, ndërsa nga certifikata e pronësisë rezulton se propozuesit H. dhe Sh. B., ende janë bashkëposedues me nga ½ në paluatjshmërinë që pretendohet se është shpronësuar.

Gjykatat e instancës më të ulët kanë dhënë arsye kundërthënëse dhe në kundërshtim me provat e administruara në lidhje me faktet vendimtare, kjo pasi që gjykatat konsiderojnë se ka vendim përfundimtarë për shpronësim mirëpo në shkresa të lëndës nuk ekziston një vendim i tillë përveç vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm. Në këtë rast është e paqartë se ngastra në fjalë a është shpronësuar apo jo, kjo pasi nga vendimi mbi shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive për rregullimin e infrastrukturës rrugore në Komunën e Gjilanit i datës 27.04.2011 nuk mund të kuptohet se kjo ngastër është pjesë e shpronësimit, ndërsa nuk ka një vendim përfundimtar për të vërtetuar saktë se kur ka ndodhë shpronësimi dhe kjo ngastër a është përfshi në tërsi ose në ndonjë pjesë të saj në shpronësim, në mënyrë që pastaj të lejohej kompensimi për të njëjtën paluajtshmëri.

Në praninë e kundërthënieve të tilla rreth asaj se kjo paluajtshmëri a është përfshi në proces të shpronësimit në vitin 1995 siç pretendon kundërpropozuesi apo pas marrjes së vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm, pastaj gjendjes faktike në teren ku në këtë ngastër është

ndërtuar rruga, vlerësohet nga kjo gjykatë se është e domosdoshme që gjykata e shkallës së parë fillimisht të qartësoj se a kemi të bëjmë me proces të shpronësimit dhe caktim të lartësisë së kompensimit apo kemi të bëjmë me marrjen e paluajtshmërisë pa shpronësim (shpronësim faktik), kjo pasi që nga kjo varet edhe çështja se a duhet të zhvillohet procedura jokontestimore apo kontestimore në këtë çështje. *Nëse kemi të bëjmë me shpronësim dhe trajtohet çështja e caktimit të lartësisë së kompensimit atëherë duhet të zhvillohet procedura jokontestimore, mirëpo nëse bëhet fjalë për shpronësim faktik (pa procedurë të shpronësimit) në këtë rast duhet të zhvillohet procedura kontestimore.*

Si rezultat i shkeljeve të tilla, mos qartësimit të gjendjes reale faktike ka ardhur deri te zbatimi i gabuar i drejtës materiale dhe në rivendosje gjykata e shkallës së parë duhet të evitoj shkeljet e sipërpërmendura dhe të vërtetoj faktet e sipër theksuara, ku fillimisht duhet të qartësoj se për cilën procedurë bëhet fjalë pastaj mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura, si dhe duke zbatuar drejtë dispozitat materiale të vendos për çështjen që do të jetë objekt shqyrtimi.

Për këto arsye me aktvendimin e lartë përmendur, Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar revizionin e kundërpropozueses Komuna e Gjilanit, ka prish aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4558/19, të datës 09.02.2023 dhe aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm CN.nr.23/15, të datës 21.06.2019 dhe çështjen e ka kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

E DREJTA E PARABLERJES

Zbatimi i ligjit material

E drejta e parablerjes ka të bëjë me të drejtën e parablerjes në paluajtshmëri. Një paluajtshmëri, ose bashkëpronësia në një paluajtshmëri mund të ngarkohet në atë mënyrë që një person të ketë të drejtën e parablerjes së saj në raport me blerësit tjerë të mundshëm. Megjithatë nga parimi i mos cenimit të së drejtës së pronësisë private si një e drejtë e karakterit absolut që vepron ndaj të gjithëve, e drejta e parablerjes paraqet një përjashtim i cili manifestohet si kufizim i një prej atributeve të së drejtës së pronësisë, më saktësisht kufizim të së drejtës së disponimit të pronësisë në paluajtshmëri. Pra e drejta e parablerjes si një kufizim i të drejtës së disponimit në paluajtshmëri, titullarit të saj i jep të drejtën e parablerjes së paluajtshmërisë në raport me blerësit tjerë të mundshëm, e të cilën të drejtë të tij duhet ta respektojnë të gjithë, si pronari i asaj paluajtshmërie, ashtu edhe blerësit tjerë potencial të saj.

E drejta e parablerjes mund të krijohet përmes ligjit ose përmes kontratës. E drejta kontraktuese e parablerjes krijohet përmes marrëveshjes ndërmjet pronarit të një paluajtshmërie dhe personit që e ka të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes bëhet e vlefshme ndaj personave të tretë, nëse regjistrohet në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. E drejta e parablerjes mund të caktohet për një apo më shumë raste të blerjes, mirëpo kufizohet në rastin e shitjes nga pronari i cili e ka paluajtshmërinë në kohën e dhënies të së drejtës së parablerjes ose nga trashëgimtarët e saj.

Kjo do të ishte si hyrje në trajtimin e kësaj teme, për të dhënë shpjegime për kuptimin dhe përmbajtjen e të drejtës së parablerjes, ndërsa në elaborimin e më tejshëm do të ndalemi te zbatimi i ligjit material lidhur me të drejtën e parablerjes, nga se në praktikë janë paraqitur dilema se në rastet në të cilat është kërkuar anulimi i kontratave të shitjes për shkak të cenimit të së drejtës së parablerjes, a duhet të zbatohet Ligji mbi Qarkullimin e Paluajtshmërive apo Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, dhe si pasojë ka pasur edhe vendimmarrje ndryshe për çështje të njëjta.

Përmbledhje e shkurtër e të gjeturave të përgjithshme nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës, sa i përket rasteve të anulimit të kontratave të shitblerjes së paluajtshmërive për shkak të cenimit të së drejtës së parablerjes, kemi gjetur se nga ana e gjykatave të instancës së parë por edhe të dytë, përmes vendimeve të nxjerra nuk aplikohen drejtë dispozitat e Ligjit material, e të cilat vendime në të shumtën e rasteve përfshihen edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Në disa raste aplikohen dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive, e në disa raste tjera dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Republikës së Kosovës, dhe këtu në praktikë gjyqësore ka një laramani vendimmarrjeje nga gjykatat e instancës më të ulëta rreth asaj se cili ligj duhet aplikuar lidhur me kërkesat e paditësve për anulimin e kontratave të shitblerjes për shkak të cenimit të kësaj të drejte. Andaj përmes elaborimit të më tejshëm të kësaj çështjeje bëhet përpjekje të sqarohet mirë zbatimi i ligjit material me rastin e vendimmarrjes lidhur me kërkesëpaditë për anulimin e kontratave të shitblerjes për shkak të cenimit të drejtës së parablerjes.

Komenti i shkurtër i dispozitave ligjore që e rregullojnë të drejtën e parablerjes

Para shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, me legjislacionin e brendshëm të saj, ka qenë e rregulluar e drejta e përparësisë për blerjen e pasurisë së paluajtshme, e jo e drejta e parablerjes ashtu siç është sot ligjërisht e rregulluar. Kështu, me Ligjin për qarkullimin e paluajtshmërive (Gazeta zyrtare e KSAK nr.45 datë 30 dhjetor 1981), në nenin 19, 20, 21 dhe 22, e të cilat dispozita ligjore më vonë nuk janë ndryshuar deri në nxjerrjen e Ligjit të Kosovës, për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në vitin 2009, parasheh përparësinë në blerjen e palujtshmërisë:

- të organizatës së punës së bashkuar që merret me prodhimet bujqësore ose kooperativës bujqësore në territorin e së cilës gjendet përkatësisht organizatës së punës së bashkuar që i qeverisë pyjet, për blerjen e tokës bujqësore, pyjeve dhe të tokës pyjore;

- të komunës në territorin e të cilës gjendet toka në rajonin e ndërtimit, pyjet dhe toka pyjore, toka për ndërtim e përfshirë në planin urbanistik si dhe toka për ndërtimin në kufijtë e rajonit ndërtimor,

të cilat me vendim si të tilla i ka caktuar kuvendi i komunës, e të cilat titullari i tyre dëshiron t'i shes,

- të bashkëpronarit, bartësit të së drejtës banesore, përkatësisht komunës në territorin e së cilës gjendet ndërtesa ose banesa, për blerjen e ndërtesës familjare banesore ose banesës, dhe
- të bashkëpronarit-marrësit me qira i cili lokalin afarist drejtpërdrejtë e shfrytëzon së paku 5 vjet, përkatësisht komunës në territorin e së cilës gjendet lokali afarist, për blerjen e lokalit afarist.

Për të drejtën e parablerjes, për të gjitha llojet e patundshmërive të përshkruara më lartë, janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive i përshkruar më lartë, gjithnjë deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, më datën 20.08.2009.

Tani më ky ligj, të drejtën e parablerjes e rregullon pak më ndryshe dhe më të detajuar, ku këtë të drejtë e quan si të "drejtë të parablerjes", e jo të "drejtë në përparësi në blerje", siç e quante Ligji për Qarkullimin e Paluajtshmërive.

Kësisoji në nenin 44 parashihet përmbajtja e kësaj të drejte: "*1. Një paluajtshmëri (ose bashkëpronësia në një paluajtshmëri) mund të ngarkohet në atë mënyrë, që një person të ketë të drejtën e parablerjes. 2. E drejta e parablerjes mund të krijohet përmes ligjit ose përmes kontratës. E drejta kontraktuese e parablerjes krijohet përmes marrëveshjes ndërmjet pronarit të paluajtshmërisë dhe personit që e ka të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes bëhet e vlefshme ndaj personave të tretë, nëse regjistrohet në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. 3. E drejta e parablerjes mund të caktohet për një apo më shumë raste të blerjes, mirëpo kufizohet në rastin e shitjes nga pronari i cili e ka paluajtshmerinë në kohën e dhënies së të drejtës së parablerjes ose nga trashëgimtaret e tij. ".*

Në nenin 45 parashihet njoftimi dhe ushtrimi i të drejtës së parablerjes:

1. Për njoftimin për rastin e parablerjes vlen dispozita relevante e Ligjit për detyrimet ose të një ligji të tjetër të zbatueshëm.

2. Ushtrimi i të drejtës së parablerjes pason përmes deklarimit ndaj të detyruarit për parablerje si dhe është e nevojshme forma e parashikuar për kontratën e shitjes.

Në nenin 46 parashihen efektet e të drejtës së parablerjes: " *1. Me ushtrimin e të drejtës së parablerjes bëhet lidhja e kontratës ndërmjet të titullarit të drejtës së parablerjes dhe të detyruarit për parablerje nën ato kushte, për të cilat është marrë vesh i detyruari i parablerjes me blerësin.*

2. Ndaj personave të tretë e drejta e parablerjes ka efektin e një shënimi për sigurimin e kërkesës për bartjen e pronësisë.".

Në nenin 47 parashihet pagesa e çmimit: *"1. Titullari i të drejtës së parablerjes duhet t'ia paguajë shitësit çmimin e shitjes. 2. Në qoftë se blerësi ose pasardhësi juridik i tij është regjistruar si pronar, atëherë i titullari për parablerje duhet të paguajë çmimin e shitjes së paguar nga blerësi te shitësi.".*

Në nenin 48 parashihet lirimi i titullarit të parablerjes dhe i blerësit: " *1. Përderisa titullari për parablerje ka për t'ia paguar çmimin e shitjes blerësit apo pasardhësit juridik të tij, atëherë ai lirohet nga detyrimi për pagesën e çmimit të blerjes ndaj shitësit. 2. Në qoftë se blerësi apo pasardhësi juridik i tij humb pronësinë si pasojë e ushtrimit të së drejtës së parablerjes, atëherë blerësi lirohet nga detyrimi për pagesën e çmimit të shitjes, përderisa çmimi i blerjes që ka mbetur borxh prej tij nuk është paguar. Ai nuk mund të kërkojë kthimin e çmimit të paguar të shitjes.".*

Në nenin 49 parashihet përjashtimi i titullarit të panjohur të së drejtës së parablerjes: " *Nëse një titullar i të drejtës së parablerjes është i panjohur, ai mund të përjashtohet nga ushtrimi i të drejtës së tij në të njëjtën mënyrë sikur një titullar i panjohur që ka përparësi të njoftimit i cili mund të përjashtohet nga ushtrimi i të drejtës së tij sipas nenit 124 të këtij ligji.* Në nenin 50 parashihet zbatimi i dispozitave për të drejtën e parablerjes :*Dispozitat përkatëse të Ligjit të Detyrimeve janë të zbatueshme në këtë kapitull mbi të drejtën e parablerjes.*

Është shumë me rëndësi të përshkruhet edhe neni 282 paragrafi 1 dhe 2 i këtij Ligji, ku parashihet se: "*1. Ky ligj zbatohet në të gjitha bartjet e pronësisë për sendet e luajtshme dhe të paluajtshme pas hyrjes në fuqi të tij. 2. Në bartjet e paluajtshmërisë, në të cilat në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka ekzistuar puna juridike e marrëdhënieve të detyrimit, por vlefshmëria sipas të drejtës së vjetër është varur prej kushteve plotësuese (sidomos lejimeve ose regjistrimeve), atëherë zbatohen dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të marrëdhënies juridike.".*

Po ashtu edhe në nenin 296 parashihet se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë së vepruari të gjitha dispozitat e ligjeve të mëparshme që kanë rregulluar këtë materie, përveç në rastet kur me këtë ligj është paraparë ndryshe.

Në praktikë gjyqësore, hasim lëndë me kërkesë për anulim të kontratave për shitblerje për shkak të cenimit të përparësisë në blerje të paluajtshmërisë të cilat janë të lidhura para hyrjes në fuqi të

Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, dhe lëndë me kërkesa për anulim të kontratave për shitblerje për shkak të cenimit të drejtës në parablerje të paluajtshmërisë të cilat kontrata janë të lidhura pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, dhe këtu ndodh vendimmarrja ndryshe nëpër gjykatat e instancës më të ultë, ku disa gjykata për grupin e parë të kërkesave zbatojnë dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive, e disa gjykata tjera për të njëjtin grup të kërkesave zbatojnë dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore ani pse ky ligj nuk ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së këtyre kontratave, dhe një numër tjetër i gjykatave zbatojnë dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive edhe për kërkesat për anulimin e kontratave të shitblerjes për shkak të cenimit të drejtës së përparësisë në blerje apo të drejtës së parablerjes, e të cilat janë të lidhura pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore. Andaj, nga kjo rezulton arsyeshmëria e përpunimit të kësaj çështjeje dhe dhënies së opinionit të Gjykatës Supreme.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me zbatimin e ligjit material në rastet kur është kërkuar anulimi i kontratave të shitblerjes për shkak se është cenuar e drejta e përparësisë në blerje.

Nga analizimi i këtyre dispozitave ligjore rezulton pa dyshim, se: Lidhur me paditë e paraqitura të cilat i referohen kërkesëpadisë për anulimin e kontratave për shitblerje për shkak të *cenimit të drejtës së përparësisë* në blerje të paluajtshmërisë, e të lidhura para hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Pronësore, zbatohen dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive, ndërsa, lidhur me paditë e paraqitura të cilat i referohen kërkesëpadisë për anulimin e kontratave për shitblerje të paluajtshmërisë për shkak të *cenimit të drejtës së përparësisë* në blerje të paluajtshmërisë e të cilat janë paraqitur pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, zbatohen dispozitat e këtij Ligji (pra të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore). Po ashtu, dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, zbatohen edhe për kërkesëpaditë për anulim të kontratave për shitblerje për shkak të cenimit të drejtës së parablerjes, që janë të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në rastin e parë, se duhet zbatuar dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive në rastet e kërkesëpadive për anulimin e kontratave për shitblerje për shkak të *cenimit të drejtës së përparësisë* në blerje të paluajtshmërisë, e të lidhura para hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe

të Drejtat Tjera Pronësore, na orienton shumë qartë dispozita e nenit 282 paragrafi 1 dhe 2 e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Pronësore, ku parashihet që: "*Ky ligj zbatohet në të gjitha bartjet e pronësisë për sendet e luajtshme dhe të paluajtshme pas hyrjes në fuqi të tij. Në bartjet e paluajtshmërisë, në të cilat në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka ekzistuar puna juridike e marrëdhënieve të detyrimit, por vlefshmëria sipas të drejtës së vjetër është varur prej kushteve plotësuese (sidomos lejimeve ose regjistrimeve), atëherë zbatohen dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të marrëdhënies juridike".* Andaj, në këto raste doemos duhet zbatuar dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të atij raporti civil juridik, siç është kontrata e shitblerjes, përveç tjerave edhe se Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore nuk ka efekt retroaktiv, pikërisht sipas kësaj dispozite ligjore, pra nenit 282 paragrafi 1 dhe 2.

Në rastin e dytë, lidhur me paditë e paraqitura të cilat i referohen kërkesëpadisë për anulimin e kontratave për shitblerje të paluajtshmërisë për shkak të *cenimit të drejtës së përparësisë* në blerje të paluajtshmërisë e të cilat janë paraqitur pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, zbatohen dispozitat e këtij Ligji (pra të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore). Kjo është kështu nga se me nenin 296 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, parashihet shprehimisht se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë së vepruari të gjitha dispozitat e ligjeve të më parme që kanë rregulluar këtë materie, përveç në rastet kur me këtë ligj është paraparë ndryshe, dhe me paragrafin 1 të nenit 282 parashihet se ky ligj zbatohet në të gjitha bartjet e pronësisë për sendet e luajtshme dhe të pa luajtshme pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Në rastin e tretë, dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, zbatohen edhe për kërkesëpaditë për anulim të kontratave për shitblerje për shkak të cenimit të drejtës së parablerjes, që janë të lidhura pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, e nuk mund të zbatohen dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërive, për shkaqet dhe arsyet e përmendura më lartë për rastin e parë dhe të dytë.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktvendimin Rev.nr.460/2020 datë 04.05.2022***

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3054/16 të datës 28.02.2020, është refuzuar ankesa e paditësit-kundërpaditurit M.B, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në

Prizren - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1082/12, i datës 20.04.2016, me të cilin është vendosur: I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit - kundër të padituri M.B, nga P..., përmes së cilës ka kërkuar që të: Vërtetohet se kontrata e shitblerjes e lidhur në mes të padituve R..., si shitës dhe N..., nga Prishtina - si blerës, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren, me nr. Leg.nr..., e datës ..., nuk prodhon efekt juridik ndaj paditësit M. B, të detyrohet e paditura ndërmarrja "P..., që ngastrën kadastrale ..., lloji i pronës parcelë, lloji i pronës private, me sipërfaqe prej 1719 m^2, në vendin e quajtur "...", lloji i shfrytëzimit të parcelës - bujqësore, shfrytëzimi aktual arat, klasa e kualitetit arë e klasa IV, e cila evidentohet në numrin e lëndës ..., ZK ..., dhe ngastrën kadastrale ..., lloji i pronës parcelë, në sipërfaqe prej 1199 m^2, në vendi e quajtur "...". lloji i shfrytëzimit të parcelës bujqësore, në sipërfaqe prej 1129 m^2 dhe ndërtimore në sipërfaqe prej 790 m^2, e cila evidentohet në numrin e lëndës ..., ZK ...., t'ia dorëzoi paditësit në pronësi dhe posedim të lirë, me çmim dhe në kushte nga kontrata e shitblerjes e sipërshënuar e shpallur pa efekt juridik, gjë që në bazë të këtij aktgjykimi do të bëhet regjistrimi i së drejtës së pronësisë në emër të paditësit ..., nga P..., si tërësisht e pa bazuar. II. Aprovohet pjesërisht kërkesa nga kundërpadia e të padituri të dytë - kundërpaditësit N..., nga P..., dhe obligohet paditësi - kundër i padituri ..., nga P..., që t'ia lirojë pronat përkatësisht ngastrat kadastrale ..., dhe pjesën prej 1/2 të ngastrës kadastrale ..., ZK ...,. III. Refuzohet kërkesa nga kundërpadia e të padituri të dytë - kundërpaditësit P...., nga P..., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet paditësi - kundër i padituri që të paguajë sipas ligjit, pronarit dëmin e shkaktuar në vlerë prej 10 % për çdo ditë nga data 19.10.2012, si dhe fitimin e humbur në vlerë prej 20%, gjer në ditën, muajin përfundimtar të dorëzimit të pronës në posedim dhe shfrytëzim nga të padituri duke iu llogaritur përqindja sipas kontratës së shitblerjes, si dhe kamatën ligjore për mjetet e afatizuara në lartësi 5,5 %, si tërësisht e pa bazuar. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit të paditësit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit - kundër të padituri është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësi më datë 26.11.2012, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të padituave, për vërtetimin e të drejtës së parablerjes, duke kërkuar anulimin e kontratës dhe dorëzimin e paluajtshmërisë.

Me parashtresën e datës 01.03.2013 e paditura e dytë, në gjykatën e shkallës së parë kundër paditësit, ka paraqitur kundërpadi, për vendosjen e mexhës, ndarjen e pronës, lirimin e pronës, kompensimin e dëmit dhe fitimin e humbur.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit-kundër të padituri dhe kundërpadisë së të padituës së dytë - kundërpaditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.1082/12, të datës 13.12.2013, duke vendosur me decidivisht si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: në mes palëve nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi është bashkëpronarë i parcelës ..., me ½, si dhe fqinjë me parcelën ..., dhe se të njëjtat parcela janë shitur nga e paditura e parë të padituës së dytë. Kontestuese ka qenë fakti se e paditura e parë këto parcela para se t'i shiste është dashur që t'ia ofrojë fillimisht për shitje paditësit, pasi që i njëjti pretendon se ka të drejtën e parablerjes. Duke marr parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjygjëse si dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe se njëjta duhet të refuzohet në tërësi, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në të vërtetë në bazë të provave të administruara në këtë çështje juridike gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike (e cila nuk është kontestuese as nga palët) se paditësi ..., ka tërhequr kredi tek e paditura e parë R..., në shumën prej 160,000 €. Për sigurimin e kësaj kredie kanë garantuar me pronën e tij, respektivisht paluajtshmërisë - ngastrës kadastrale ...., S.B,. Pasi që këtu paditësi është vonuar dhe nuk ka mundur të paguajë kështet e kredisë, paluajtshmëritë me të cilat kanë qenë pjesë e kontratës së pengut janë shitur përmes ankandit publik, të organizuar nga ana e gjykatës dhe për të njëjtat si pronarë është shpallur këtu e paditura e parë R...,. E njëjta në bazë të kontratës së shitblerjes të vërtetuar në gjykatë Leg.nr...., të datës ..., këtë paluajtshmëri ia ka shitur ndërmarrjes "P....., nga P..., këtu e paditura e dytë. Tani paditësi pretendon se ka të drejtën e parablerjes për këto ngastra. Me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, gjykata mori parasysh faktin se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur ta bind gjykatën për të drejtën e tij, respektivisht për të drejtën e parablerjes të paraparë sipas dispozitave ligjore (edhe pse paditësi e ka cekur në padi si e drejtë e përparësisë së blerjes, e që në rastin konkret ekziston e drejta e parablerjes ndaj blerësit, pasi që veç pronari i paluajtshmërisë e ka tjetërsuar paluajtshmërinë - ka lidhur kontratë të shitblerjes). Në anën tjetër në bazë të ligjeve të lartë cituara, del se e drejta e përparësisë së blerjes sipas dispozitave

ligjore në fuqi i takon pronarit ose poseduesit të paluajtshmërisë fqinje në rajonin e tokës bujqësore e që në rastin konkret nuk është përmbushur ky kusht i kësaj dispozite ligjore. Sipas vlerësimit të gjykatës, edhe pse këtu paluajtshmëritë të cilat janë objekt kontesti në librat kadastral me rastin e shitjes kanë qenë të evidentuara si kultura bujqësore dhe një pjesë ndërtimore, për gjykatën kjo nuk ka qenë fakt me rëndësi, pasi që gjendja faktike është vërtetuar me rastin e këqyrjes në vend ku është konstatuar se asnjëra prej këtyre paluajtshmërive nuk shfrytëzohet si kulturë bujqësore, të dy paluajtshmëritë shfrytëzohen si kultura ndërtimore në të cilat ka të ndërtuara objekte ndërtimore në të cilat paditësi dhe e paditura e dytë e ushtrojnë veprimtaritë e tyre afariste. Ndërsa në anën tjetër sipas dispozitave ligjore në fuqi e drejta e përparësisë së blerjes në rajonin e tokës ndërtimore i takon komunës në territorin e së cilës shtrihet toka. Kjo parashihet edhe për tokën për ndërtim të përfshirë me planin urbanistik, si dhe me tokën në ndërtim në kufijtë e rajonit ndërtimor, të cilën me vendim e ka përcaktuar kuvendi i komunës, e që në rastin konkret për rajonin në të cilat gjinden paluajtshmëritë kontestuese ekziston plani urban rregullues i cili është miratuar nga ana e Kuvendit Komunal - Prizren, i cili në teren ka filluar të zbatohet që nga data 17.07.2000, që do të thotë para se të lidhej kontrata e shitblerjes për këto paluajtshmëri (kjo është vërtetuar nga vendimi i kuvendit komunal si dhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë). Mbi bazën e të lartcekurave gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar.

Gjithashtu në bazë të provave të administruara gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit, ngase gjeti se përmes kontratës legale të shitblerjes Leg.nr..., të lidhur në mes R..., si shitës dhe P..., si blerës, të datës 19.10.2012, e cila kontratë është kontratë e rregullt dhe e cila është përmbushur në tërësi nga të dyja palët nënshkruese, e paditura e dytë - kundërpaditësja ndërmarrja "P.., nga P..., është bërë pronare e këtu ngastrave kadastrale kontestuese. Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë del se e njëjta ka hyrë në marrëdhënie kontraktuese në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me mirëbesim, ngase ajo ka kontraktuar me palën e cila në momentin e lidhjes së kontratës së lartcekur të shitblerjes, është evidentuar si pronare e ngastrave kadastrale kontestuese dhe mbi bazën e këtij fakti, gjykata vlerëson se ajo në këtë çështje kontestimore, nuk mund t'i bartë pasojat e mosmarrëveshjeve eventuale të cilat ekzistojnë apo kanë ekzistuar në mes të paditësit M.B., dhe të padituës së parë R...,. Prandaj është vlerësim i kësaj gjykate, se paditësi nuk mund të kërkojë anulimin e një kontrate perfekte të shitblerjes e cila është lidhur në mënyrë ligjore nga ana e palëve nënshkruese, e të cilën kontratë e paditura e dytë kundërpaditësja ndërmarrja "P..., sh.p.k., nga P..., e ka lidhur me ndërgjeshmëri dhe mirëbesim, ngase kjo e fundit ka hyrë në marrëdhënie

kontraktuale me pronarin juridik të ngastrave kadastrale kontestuese dhe në të cilën kontratë paditësi M.B., nuk ka qenë palë kontraktuese. Pra e njëjta pas lidhjes së kësaj kontrate ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paluajtshmërive kontestuese, që do të thotë se e njëjta e ka titullin juridik - justus titullus si dhe modus aquirendi.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e saj lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë e ka bazuar edhe në faktin se këtu paditësi, nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi, pasi që me rastin e paraqitjes së padisë në gjykatë ka qenë i obliguar që të deponojë edhe shumën e çmimit të shitblerjes së paluajtshmërisë, për të cilën ka pretenduar se është shkelur e drejta e përparësisë së blerjes, e që i njëjti deri në përfundim të shqyrtimit kryesor nuk e ka bërë deponimin e kësaj shume. Në fakt paditësi më datën 13.01.2013 ka parashtruar propozim lidhur me lejimin e deponimit të shumës në emër të çmimit të shitblerjes, e cila sipas vlerësimit të gjykatës ka qenë e panevojshme, andaj fare nuk ka vendosur lidhur me këtë propozim të palës paditëse, pasi që sipas ligjit në fuqi nuk kërkohet një pëlqim i tillë nga ana e gjykatës, andaj edhe ka vendosur si në dispozitv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, sa i përket pjesës aprovuese të kërkesës nga kundërpadia e të padituri të dytë kundërpaditësit ndërmarrjes “P...” sh.p.k., nga P..., vendosi që ta aprovojë të njëjtën pasi që në bazë të provave të administruara, e sidomos këqyrjes në vend së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka konstatuar se këtu paditësi - kundër i padituri e shfrytëzon në teren të gjithë ngastrën kadastrale ...., edhe pse për të njëjtën është bashkëpronarë me të padituren e dytë - kundërpaditësen, i cili sipas vlerësimit të gjykatës të njëjtën e ka fituar në mënyrë të ligjshme në bazë të kontratës së shitblerjes, andaj edhe ka vendosur si në pilën II, dispozitivit të aktgjykimi. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të kërkesës nga kundërpadia e të padituri të dytë - kundërpaditësit ndërmarrjes “P...” sh.p.k., nga P..., gjykata vendosi që njëjtën ta refuzoi, pasi që këtu i padituri i dytë - kundërpaditësi përveç kundërpadisë së parashtruar me asnjë provë të vetme nuk ka mundur ta vërtetojë një kërkesë të tillë, e as nuk ka parashtruar ndonjë propozim për ndonjë provë lidhur me vërtetimin e këtyre fakteve, andaj në mungesë të provave ka vendosur si në pikën III, të dispozitivit të aktgjykimit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar dispozitave ligjore të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, Ligjit Për Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak te të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës.

Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi pathemelësinë e kërkesëpadisë. Përveç tjerash dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë dhe kontradiktor në vetvete, nga i cili nuk mund të kuptohet se çka realisht gjykata ka refuzuar, çka ka aprovuar dhe çka ka refuzuar.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1, lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallë së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Përveç tjerash aktgjykimi i shkallës parë është marr edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: padia dhe kundërpadia, nuk përmban elementet që duhet t'i përmbajë çdo parashtresë, në fakt kërkesa në padi dhe kundërpadi është e pa qartë dhe e pa kuptueshme dhe se nuk është e specifikuar

saktë kërkesa se çka kërkon paditësi - kundër i padituri dhe e paditura e dytë - kundërpaditësja në këtë rast. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit - kundër të padituri dhe kërkesën në kundërpadi të padituës së dytë - kundërpaditëses, është dashur që padinë e paditësit - kundër të padituri dhe kundërpadinë e të padituës së dytë - kundërpaditëses ta kthejë në korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë përfshirë edhe me zbatim të gabuar të se drejtës materiale, për arsye se:

Gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës/ave kadastrale - kontestuese, në të cilat palët kanë pretenduar se kanë të drejtën e përparësisë në blerjen e paluajtshmërisë, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi - kundër i padituri dhe e paditura e dytë - kundërpaditësja, të identifikojë saktësisht se cila është parcela/t kadastrale apo pjesa e saj/tyre, në të cilën palët kanë pretenduar se kanë të drejtën e tyre me saktësisht si në kërkesat në padi dhe kundërpadi lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj/tyre, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë/ve kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur më atë parcelë/a kadastrale, ekspertiza e ekspertit gjeodet është e mangët, jo e plotë madje edhe konfuze, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend, nuk ka kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e ekspertizës së ekspertit gjeodet sepse nëse i referohemi të njëjtës nga e njëjta rezulton se nuk ka përshkrim të pronës, nuk ka të dhëna të sakta për parcelën/at kadastrale kontestuese si: nuk ka përshkrim të gjendjes faktike në vend - nuk ka të dhëna se objekt kontesti është parcela/t kontestuese apo pjesa e saj/tyre, nuk ka konstatuar se parcela/t kontestuese në momentin e shikimit në vend çfarë kulture ka, duke përshkruar pjesën e saj/tyre sipas kulturave në vend, cila është shtrirja gjeografike e saj/tyre, me cilat parcela fqinje kufizohet, nuk ka kërkuar historiatin e pronës, nuk ka dëgjuar palët në cilësi të palës në kuptim të dispozitave të LPK-së, nuk ka marr në shikim shkresat e lëndës sipas kontratës së shitblerjes dhe shkresat e lëndës së procedurës përmbarimore dhe si pasojë e kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, etj.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm edhe për arsye se gjykata e shkallës së parë, për mënyrën e vendosjes si në pikën I, të dispozitiv të aktgjykimit ju ka referuar nenit 11 -13, të Ligjit për Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme dhe nenit 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, e dispozitat e këtyre ligjeve nuk mund të zbatohen në këtë rast për arsye se raportet e pretenduar të shitblerjes së paluajtshmerisë kontestues pretendohet se janë krijuar pasi që ka hyrë në fuqi Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, i datës 25.06.2009 i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.08.2009, për arsye se:

Me nenin 18 paragrafi 1 të Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore përcaktohet se:

"Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdor, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti".

Me nenin 282 paragrafi 1, të këtij ligji, përcaktohet se: "*Ky ligj zbatohet në të gjitha bartjet e pronësisë për sendet e luajtshme dhe të paluajtshme pas hyrjes në fuqi të tij ".*

Me nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore përcaktohet se: *"Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri ",* ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *"Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dyja palëve në një zyre kompetente ".*

Me nenin 296, të këtij ligji, përcaktohet se: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë së vepruari të gjitha dispozitat e ligjeve të mëparshme që kanë rregulluar këtë materie, përveç në rastet kur me këtë ligj është paraparë ndryshe".*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore rezulton se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale, gjegjësisht dispozitat e Ligjit për Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme dhe dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, dhe si rezultat i zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht, siç përcaktohet me nenet 44, 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që t'i evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, padinë dhe kundërpadinë e paraqitur nga ana palët, t'ia kthejë në korrigjim në kuptim të nenit 99 dhe 102 të LPK-së. Pastaj varësisht prej korrigjimit apo mos korrigjimit të padisë dhe kundërpadisë nga ana e palëve, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë palët, të udhëzoj ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtëshmërisë/ve kontestuese. Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit-raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komunale Kadastrale në Prizren, të kërkohet historiati i pronës për paluajtëshmerinë kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërkimit të të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, dëgjimin dëshmitarëve eventual mundësisht të pronarëve apo poseduesve të palujtëshmerive fqinje, e në rast nevoje edhe ballafaqimin e tyre, dëgjimin e palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës në kuptim të dispozitave të LPK-së, te marrë në shikim shkresat e lëndës sipas kontratës së shitblerjes dhe shkresat e lëndës sipas procedurës përmbarimore dhe provave të propozuara nga palët, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesat e palëve në padi dhe kundërpadi dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si me lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 224 paragraf 2 të LPK-së, u vendos që të pranohet revizioni i paditësit - kundër të paditurit: M.B nga P..., të prishen aktgjykimi

i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3054/16, të datë 28.02.2020, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1082/12, i datës 20.04.2016, dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Referencë në aktgjykimi në Rev.nr. 367/2014 datë 20.02.2015

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5032/2012 datë 14.09.2014, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit të parë dhe e të paditurit të dytë, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Rahovec C.nr.183/2008 datë 12.09.2012, me të cilin në pjesën I. të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është vërtetuar se i njëjti ka të drejtën e përparësisë së blerjes së lokalit afarist-depos e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr...., në vendin e quajtur "C....", e evidentuar sipas fletës poseduese nr..., ZK R...,. Me pjesën II. të dispozitivit është anuluar kontrata mbi shitblerjen e kësaj patundshmërie e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë Leg.nr..., të datës ...,. Me pjesën III. të dispozitivit është obliguar i padituri T.V, që në afat prej 15 ditësh të lidh kontratë për shitblerjen e kësaj patundshmërie me paditësin, nën kushte të njëjta sikur që ia ka shitur këtë patundshmëri të paditurit të dytë, do të thotë për çmimin shitblerës prej 71.580,60 €, (140.000,00 DM). Me pjesën IV. të dispozitivit është vendosur që nëse i padituri i parë nuk e përmbush këtë detyrim, aktgjykimi i gjykatës paditësit do t'i shërbej si bazë juridike për regjistrimin dhe bartjen e të drejtës së pronësisë në këtë patundshmëri në librat kadastral që udhëhiqen në Zyrën Kadastrale në R...,. Me pjesën V. të dispozitivit është konstatuar që paditësi në gjykatë ka deponuar shumën prej 140.000,00 DM, si vlerë e çmimit të shitjes së kësaj patundshmërie , në BPB në P.., më datën 14.01.2002, dhe në pjesën VI. të dispozitivit është vendosur që aktvendimi për caktimin e masës së përkohshme C.nr.135/2001 datë 07.11.2001, mbetet në fuqi derisa kjo çështje juridike të merr formën e prerë ose deri në ndryshimin e rrethanave.

Nga shkresat e lëndës rezulton se objekt kontesti është përparësia e blerjes së paditësit në patundshmërinë e cila udhëhiqet si ngastër kadastrale nr..., me kulturë arë, e klasit të VI, në sipërfaqe prej 00.09.03 ha, në të cilën gjendet e ndërtuar edhe lokali-depoja në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.02.17 ha. Në mes të palëve gjyqësore, ishte jo kontestues fakti se paditësi, nga i padituri i parë , patundshmërinë e lartpërmendur e kishte marrë me qira, që nga viti 1994, deri në vitin 1998, dhe kishte vazhduar shfrytëzimin e të njëjtës nga kjo bazë juridike edhe pas zhvillimit

të luftës në Kosovë në vitin 1999. Këtë patundshmëri i padituri i parë ia kishte shitur të padituri të dytë për çmimin blerës prej 140.000,00 DM, të cilën shumë e kishte pranuar nga i padituri i dytë, dhe kontratën për shitblerjen e kishin vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë Leg.nr...., të datës 05.04.2012. Me që i padituri i parë , paditësit nuk i kishte bërë ofertë me shkrim për blerjen e kësaj patundshmërie, paditësi pretendon se ka të drejtën e përparësisë së blerjes së saj në kuptim të nenit 22 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.45/81, 29/86 dhe 28/88), dhe për blerjen e të njëjtës në Gjykatën Komunale në Rahovec ka deponuar shumën prej 140.000,00 DM.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj gjykata e shkallës së parë , duke gjetur se paditësi, me qira, ka shfrytëzuar depon e cila gjendet në ngastrën e lartpërmendur, për shitjen e materialit ndërtimor, në kohëzgjatje më tepër se 5 vite, dhe se i padituri i parë ia ka shitur të padituri të dytë këtë patundshmëri pa i bërë paraprakisht paditësit ofertë në formë të shkruar, siç kërkohet në nenin 23 të ligjit të lartpërmendur, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj me zbatimin e nenit 22 dhe 23 të ligjit të lartpërmendur ka vendosur në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit të Kosovës, në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuara ankesat e të padituri dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë , duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se nuk mund të pranohet si i bazuar qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës më të ulët me të cilin është pranuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, pasi që aktgjykimet e tyre janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Duke marrë parasysh se është jo kontestuese se lokali-depoja kontestuese e cila ndodhet në ngastrën nr..., me kulturë është arë, dhe në tërë sipërfaqen e saj gjendet material ndërtimor i paditësit i dedikuar për shitje, dhe se sipas vërtetimit të Kuvendit Komunal në Rahovec nr..., të datës 05.12.2003, i cili gjendet në shkresat e lëndës, kjo ngastër është përfshirë në planin e përgjithshëm urbanistik të qytetit të Rahovecit para viti 2001, rezulton se sipas nenit 20 të ligjit të lartpërmendur mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme, vetëm komuna në territorin e së cilës gjendet toka ka të drejtën e përparësisë në blerje (sipas par.1 të këtij neni). Në par.2 të këtij neni, parashihet që kjo përparësi e blerjes ka të bëjë me përparësinë e komunës për blerjen e tokës në rajonin e ndërtimit të përfshirë me planin urbanistik , si dhe me tokën për ndërtimin në kufijtë e

rajonit ndërtimor, të cilën me vendim e ka përcaktuar Kuvendi i Komunës. Andaj, duke marr parasysh se ngastra kontestuese edhe pse me kulturë është arë, sipas vërtetimit të lartë përmendur të Komunës së Rahovecit, e njëjta është tokë ndërtimore e përfshirë me planin urbanistik të qytetit, gjykatat e shkallës më të ulët gabimisht kanë zbatuar nenin 22 dhe 23 të këtij ligji duke gjetur se paditësi ka të drejtën e përparësisë së blerjes së kësaj depoje-lokali. Ky lokal-depo, nga i padituri i parë është i ndërtuar pa leje, i pa legalizuar, kështu që si tërësi së bashku me tokën që përfshin kjo ngastër është shitur nga ana e të paditurit të parë.

Për më tepër, i padituri i parë, edhe pse në kuptim të nenit 20 të ligjit të lartë përmendur nuk e ka pasur për obligim, i njëjti siç rezulton edhe nga dëshmia e dëshmitarit G.H, i biri i paditësit, paraprakisht paditësit i kishte bërë ofertë me gojë, për blerjen e kësaj patundshmërie si tërësi, përfundimisht për shumën prej 160.000,00 DM, të cilën pala paditëse nuk e kishte pranuar duke i ofruar si çmim shitblerës vetëm shumën prej 120.000,00 DM, dhe pastaj i padituri i parë këtë patundshmëri për çmimin shitblerës prej 140.000,00 DM, ia kishte shitur të paditurit të dytë. Kështu që sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, edhe ky fakt vërteton se i padituri i parë nuk ia ka cenuar paditësit të drejtën e përparësisë së blerjes së kësaj patundshmërie.

Për arsyet e dhëna më lartë, aktgjykimet e lartë përmendura të gjykatave të shkallës më të ulët u desh që të ndryshohen, dhe të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit që të vërtetohet se i njëjti ka të drejtën e përparësisë së blerjes së lokalit afarist-depos e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr..., në vendin e quajtur “C...”, e evidentuar sipas fletës poseduese nr... ZK Rahovec, dhe që të anulohet kontrata mbi shitblerjen e kësaj patundshmërie e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë Leg.nr..., të datës 05.04.2012, dhe të obligohet i padituri T.V, që në afat prej 15 ditësh të lidh kontratë për shitblerjen e kësaj patundshmërie me paditësin, nën kushte të njëjta sikur që ia ka shitur këtë patundshmëri të paditurit të dytë, do të thotë për çmimin shitblerës prej 71.580,60 €, (140.000,00 DM), dhe nëse i padituri i parë nuk e përmbush këtë detyrim, aktgjykimi i gjykatës paditësit do t’i shërbej si bazë juridike për regjistrimin dhe bartjen e të drejtës së pronësisë në këtë patundshmëri në librat kadastral që udhëhiqen në Zyrën Kadastrale në Rahovec.

KAPITULLI IX

HUDHJA E MJETEVE TË JASHTËZAKONSHME JURIDIKE - ME VËSHTRIM TË VEÇANTË REVIZIONI

RREGULLIMI LIGJOR

Në bazë të dispozitave të Ligjit Për Procedurën Kontestimore, mjete të jashtëzakonshme juridike janë: Revizioni, Përsëritja e Procedurës dhe Kërkesa Për Mbrojtjen e Ligjshmërisë.

Çështja e shkaqeve të paraqitjes dhe goditjes së vendimeve të instancave përkatëse gjyqësore, efekteve të tyre, lejueshmërisë së tyre, pa lejueshmërisë së tyre, afateve për ngritjen e tyre, autorizimit për paraqitjen e tyre, vendosjes sipas atyre mjeteve etj, janë të rregulluara në mënyrë taksative me dispozitat ligjore të pjesës së parë, kreu i XIV të Ligjit Për Procedurën Kontestimore. (Ligji nr.03/L-006, 30 Qershor 2008, dhe me Ligjin nr.04/L-118 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, 13 Shtator 2012).

DISA NGA DISPOZITAT LIGJORE QË KANË TË BËJNË ME REVIZIONIN

Me dispozitën e nenit 211.1 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore, përcaktohet se " Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi".

Me dispozitën e nenit 211.2 të këtij ligji, parashihet se " Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore – juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro".

Me dispozitën e nenit 211.3, " Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore – juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro".

Me dispozitën e nenit 211.4, parashihet që *"Përjashtimisht edhe kur është fjala për kërkesëpadinë nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar:*

a) në kontestet për ushqim;

b) në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur, për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit;

c) në kontestet nga marrëdhënia e punës të cilat i fillon i punësuari kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës."

Me dispozitën e nenit 508 të LPK-së, parashihet se: Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 Euro. Mirëpo, në ndërkohë, me Ligjin për Gjykatën Komerciale (Ligji nr.08/L-015, GZ e Republikës së Kosovës nr.7, 10 Shkurt 2022), në nenin 14 par.1 të tij, përcaktohet se: Lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës zbatohen ligjet procedurale në fuqi. Ndërsa me par.2 të këtij neni, parashihet se: Përjashtimisht nga par.1 i këtij neni, revizioni lejohet në kontestet me kusht që vlera e kontestit të jetë jo më pak se 30.000 Euro.

Neni 212, parasheh se *" Për revizionin vendos Gjykata Supreme e Kosovës",* ndërsa, sipas nenit 213 *" Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur".*

Me dispozitat e nenit 214, par.1, përcaktohet se revizioni mund të paraqitet: a) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të këtij ligji, me përjashtim të shkeljeve të parapara në nenin 182 par.2 pikat (f, h, i dhe m). b) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 të këtij ligji që është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë. c) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. d) për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, në qoftë se kjo shkelje është bërë në procedurën para gjykatës së shkallës së dytë. Me par.2 të këtij neni, parashihet se: Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me par.3, parashihet se : Kundër aktgjykimit të dhënë në procedurën e shkallës së dytë me të cilën vërtetohet aktgjykimi në bazë të pohimit, revizioni mund të paraqitet vetëm për shkaqet nga par.1 pika a), b) dhe d) të këtij neni.

Me dispozitën e nenit 215 parashihet se: "*Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të*

treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt."

Me dispozitën e nenit 217 të LPK-së, parashihet*: "Revizioni i dorëzohet gjykatës së shkallës së parë e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në numër të mjaftueshëm për gjykatën dhe palën kundërshtare.".*

Ndërkohë që, me dispozitat e nenit 218 (i riformuluar), par.1 parashihet se: "*Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore. Me par.2 të këtij neni, Revizioni është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin; c) nëse personi i cili e ka paraqitur revizionin nuk ka interes juridik për paraqitjen e tij; d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet.".*

Me dispozitën e nenit 221 parashihet se: *" Revizionin e vonuar, jo të plotë dhe të palejueshëm me aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja(neni 218 i këtij ligji).".*

Koment i shkuër për zbatimin e dispozitave të sipërpërmendura

Sikundër rezulton nga dispozitat e sipër përmendura, përkitazi me mundësinë e paraqitjes së revizionit, janë paraparë disa kufizime, si ato që përfshihen në dispozitat e nenit 211 par.2 dhe 3 të LPK-së. Revizioni konsiderohet si mjet i jashtëzakonshëm juridik në sistemin tonë gjyqësor. I njëjti mund të paraqitet ekskluzivisht kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë si dhe kundër aktvendimeve të formës së prerë, siç parashihet me nenin 228 të LPK-së. Nga këtu rezulton se nuk mund të paraqitet revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Afati i paraqitjes është 30 ditë. Dhe duke qenë se është afat ligjor, i njëjti nuk mund të zgjatet as nga palët ndërgjyqëse e as nga gjykata. Afati fillon të rrjedhë dhe llogaritet konform dispozitave të nenit 126 të LPK-së.

Karakteristika e revizionit si mjet i jashtëzakonshëm juridik, rezulton edhe nga dispozita e nenit 213 të LPK-së, "Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur", që d.m.th., se revizioni nuk ka karakter suspenziv dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë mund të përmbarohet edhe pse kundër tij është paraqitur revizioni.

Për sa i përket Revizionit kundër aktvendimit, duhet theksuar se kjo çështje, po ashtu, rregullohet shprehimisht me dispozitat e nenit 228 deri 231 të LPK-së. Në këtë rast veçojmë dispozitën e nenit 230 të LPK-së, sipas të cilës përcaktohet se: *" Në procedurën sipas revizionit kundër aktvendimit në mënyrë adekuate aplikohen dispozitat e këtij ligji mbi revizionin kundër aktgjykimit ".*

Në Kontekstin e mësipërm, duhet theksuar shkurtimisht se edhe dy mjetet juridike të jashtëzakonshme, Përsëritja e Procedurës dhe Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë janë të rregulluara me dispozitat e nenit 232 – 241, përkatësisht, nenit 245 – 251 të LPK-së. Me këto dispozita veç tjerash, përcaktohen arsyet e paraqitjes së tyre, vendimet të cilat mund të goditen, kompetenca e gjykatave përkatëse për vendosjen sipas tyre, afatet e paraqitjes së tyre, lejueshmëria e paraqitjes së tyre, gjë që, më poshtë do të ilustrohen me shembuj nga praktika gjyqësore. Dhe kur jemi këtu, vetëm duhet theksuar se, kur është fjala për Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, për disa çështje që nuk janë paraparë me nenet 245 – 251, konsiderojmë se në mënyrë analoge duhet të vlejnë dispozitat e neneve 212, 213, 220, 221, 222, 223 etj, të LPK-së.

- **Pjesë të shkëputura nga *Aktvendimi Rev. E.nr.58/2022, datë 14.12.2022 (Përmbarimore)***

A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1340/22 të datës 23.08.2022, aprovohet si e themeltë ankesa e kreditorit të përmbarimit S. C. AD, në adresën si më lartë, me pjesën e II të dispozitivit të tij, shfuqizohet Konkluzioni i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.90/20 i

datës 23.06.2020, me të cilin është pezulluar procedura e përmbarimit ndaj debitorit të sipër cekur, ndërsa, me pjesën e III të dispozitivit të tij, refuzohet prapësimi i debitorit, i parashtruar kundër Urdhrit Përmbarimor me nr.P.nr.001/2020 të datës 03.01.2020, dhe Lejohet vazhdimi i procedurës përmbarimore sipas urdhrit Përmbarimor me nr. P.001/20 të datës 03.01.2020 , i lejuar nga përmbaruesi privat.

Kundër aktvendimit të Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, debitori ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i debitorit si i bazuar dhe të anulohet aktvendimi i goditur i Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 230 lidhur me nenin 218 par.2, pika d) të LPK-së (neni 11 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore), gjeti se:

Revizioni i debitorit është i palejuar.

Sipas dispozitës së nenit 68 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore parashihet se " Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore ". Prandaj, duke qenë se, me aktvendimin e sipër përmendur të Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, është aprovuar si e themeltë ankesa e kreditorit të përmbarimit dhe është shfuqizuar Konkluzioni i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.90/20 i datës 23.06.2020, me të cilin është pezulluar procedura e përmbarimit ndaj debitorit të përmbarimit AKP-së- Autoriteti i Likuidimit, Administrator i N. LL. S. LLC dhe është refuzuar prapësimi i debitorit i parashtruar kundër Urdhrit Përmbarimor me nr.001/2020 të datës 03.01.2020 dhe lejohet vazhdimi i procedurës përmbarimore sipas Urdhrit Përmbarimor me nr. P.001/2020 të datës 03.01.2020 i lejuar nga përmbaruesi privat, ndërkohë që, përkitazi me këtë çështje juridike civile – përmbarimore, sipas dispozitës ligjore të sipër cekur, rrjedh se revizioni në procedurën përmbarimore, nuk është i lejuar

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218 të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të LPK-së, u dashtë që ta hedh të njëjtin si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 dhe nenit 230 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Pjesë të shkëputura** ***nga Rev.nr.279/2022,dt.12.07.2022 (Urdhër Mbrojtje)***

A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.930/22 të datës 24.03.2022, është aprovuar si e bazuar kërkesa për urdhër mbrojtje e palës së mbrojtur, me pjesën e II të dispozitivit, caktohet urdhri për mbrojtje me të cilin kryesit të dhunës në familje - palës përgjegjëse i ndalohet që palën e mbrojtur : a) ta shqetësojë, ofendojë, përulë, godas, sulmoj(fizikisht apo seksualisht), ndjek, përcjell, shkatërrojë apo kërcënoj pronën personale, mbaj nën vëzhgim, bllokoi lëvizjen. b) Kontaktoj, direkt apo indirekt, në ç'fardo forme si përmes telefonit, apo rrjeteve sociale. Me pjesën e III, Fëmijët e përbashkët, të miturit R..., e moshës 12 vjeçare dhe N.D, 9 vjeçar, përkohësisht i besohen për përkujdesje nënës së tyre B.D. Me pjesën e IV Kontakti i fëmijëve me babain e tyre caktohet përmes QPS- Prishtinë, ashtu që çdo javë të muajit, ditën e enjte nga ora 12 – 13 në lokalet e QPS-së në Prishtinë. Me pjesën e V, pala përgjegjëse detyrohet që në emër të alimentacionit për dy fëmijët e mitur të paguajë për secilin nga 150 euro në muaj, në xhirollogarinë e palës së mbrojtur, më së voni deri më datë 5 të çdo muaji, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore. Me pjesën e VI, Ndalohet që kryesit të dhunës t'i afrohet palës së mbrojtur në vende publike në largësi prej 10 m, nga banesa në të cilën banon pala e mbrojtur (në rr. "H..."), në largësi prej 100 m, si dhe nga Shkolla Fillore "H.P", në Prishtinë, në cilën fëmijët vijojnë mësimet në largësi prej 50 m. Me pjesën e VII, Masa mbrojtëse e shoqërimit të palës së mbrojtur për marrjen e gjësendeve personale, nga banesa ku palët kanë jetuar së bashku palët ndërgjyqëse, nën shoqërimin e Policisë së Kosovës. Me pjesën e VIII, të gjitha masat e shqiptuara si më lartë kanë kohëzgjatje prej 6 muajve, duke filluar nga dita e shqiptimit të këtij urdhri. Me pjesën e IX, Mos zbatimi i urdhrit për mbrojtje sipas aktvendimit është vepër penale dhe me pjesën e X, ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon ekzekutimin e Urdhrit mbrojtës.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2312/2022 të datës 28.04.2022, refuzohet si e pa bazuar ankesa e palës përgjegjëse, ndërsa, vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.930/22 i datës 24.03.2022.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë pala përgjegjëse ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, Gjykata Supreme e Kosovës, aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët, t'i ndryshojë ose t'i anulojë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur dhe shkresave të lëndës si dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, sipas nenit 230 lidhur me nenin 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i palës përgjegjëse është i palejuar.

Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesën e palës së mbrojtur, ashtu që me aktvendimin e sipër përmendur, ka caktuar urdhrin e mbrojtjes ndaj palës përgjegjëse, të specifikuar si në dispozitivin e të njëjtit, i cili me aktvendimin e sipër përmendur të gjykatës së shkallës së dytë është vërtetuar.

Sipas dispozitës së nenit 228 par. 1 të LPK-së, palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë me të cilin përfundon procesi gjyqësor civil. Duke marrë parasysh këtë, revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit për caktimin e urdhrit për mbrojtje i cili aktvendim në bazë të nenit 18 par.2 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje nr.03/L-182, nuk mund të caktohet më gjatë se 12 muaj, me mundësi vazhdimi jo më shumë se 24 muaj, që d.m.th. se është aktvendim me karakter të përkohshëm.

Masat mbrojtëse të caktuara me urdhër për mbrojtje janë në fuqi për afat të kufizuar, për aq sa është e nevojshme, ndërsa, sipas nenit 20 të ligjit të sipër cekur, aktvendimi për caktimin e urdhrit mbrojtës mund të mbetet në fuqi, të ndryshohet ose të ndërpritet, nëse gjykata vlerëson se kanë pushuar shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri mbrojtës, nga i cili fakt rezulton konstatimi se aktvendimi mbi caktimin e urdhrit mbrojtës nuk e ka karakterin e vendimit me të cilin ka përfunduar çështja juridike me vendimin e gjykatës së shkallës së dytë. Gjithashtu, në llogari të këtij përfundimi, kjo gjykatë, e thekson edhe faktin se me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna

në Familje, si mjet i rregullt juridik, është paraparë ankesa (neni 19 i ligjit të cekur), ndërsa, nuk është paraparë ushtrimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Nga këtu, për faktin se revizioni nuk është i lejueshëm në këtë çështje juridike, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Pjesë të shkëputura nga a*ktvendim Rev.nr.130/2023, datë 10.05.2023 (Vërtetim i pronësisë)***

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.34/2017 të datës 03.02.2022, është aprovuar si e bazuar ankesa e të padituës së dytë, kurse, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2494/09 i datës 14.01.2016, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësit, prishet dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë pala paditëse ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, që të aprovohet si i bazuar revizioni i paditësit, anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.34/2017 të datës 03.02.2022, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2494/2009 i datës 14.01.2016, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur në kuptim të nenit 230, nenit 218 të Ligjit për Procedurën Kontestimore , gjeti se:

Revizioni i paditësit është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi më datë 06.11.2009, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, fillimisht, kundër të padituës të parë, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me të dhënat si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë në procedurën kontestimore, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pjesën I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të saj. Gjykata e Apelit, në procedurën ankimore, me aktvendimin e saj Ac.nr.34/2017 të datës 03.02.2022, ka vendosur që të aprovohet si e bazuar ankesa e të padituës

së dytë, ndërsa aktgjykimin e sipër përmendur të gjykatës së shkallës së parë e ka prishur dhe lëndën ia ka kthyer të njëjtës, në rivendosje.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pasi e shqyrtojë lejueshmërinë e paraqitjes së revizionit, gjeti se i njëjti është i palejuar. Kështu, sipas dispozitës së nenit 228.1 të LPK-së, palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Nga kjo dispozitë ligjore, rrjedh se revizioni mund të paraqitet vetëm kundër vendimit të formës së prerë, me të cilin përfundon procesi gjyqësor civil. Në rastin konkret civil juridik, aktvendimi i goditur, nuk e ka cilësinë / karakterin e aktvendimit me të cilin përfundon procedura në formë të prerë, nga se lënda është kthyer në rivendosje dhe rigjykim, ndaj, procesi gjyqësor, në këtë çështje civile, nuk ka përfunduar dhe se ai, më tutje, duhet të rrjedhë sipas rregullave të LPK-së.

Nga këtu, për faktin se me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së dytë nuk ka përfunduar procedura civile në mënyrë meritore me vendim gjyqësor të formës së prerë, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se revizioni kundër aktvendimit të goditur nuk është i lejuar.

- **Pjesë të shkëputura nga *Aktvendimi Rev.nr.196/2021, datë 24.05.2021 (pengim posedim)***

A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë C.nr.83/2020 të datës 13.11.2020, është refuzuar si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të "Aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar juridikisht dhe vërtetohet se më datë 23.07.2019 i padituri e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e lirë të së drejtës së posedimit të ngastrës kad.nr.., në atë mënyrë se i ka mënjanuar shenjat e mexhës si dhe shufrat e hekurit të murit të themelit kufizues" . Me pjesën e II të dispozitivit, Detyrohet paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës ti paguajë të padituri shumën prej 1007-euro.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë paditësi ka paraqitur revizion, me ç 'rast nuk i specifikon shkeljet as të natyrës procedurale e as të natyrës materiale, me propozim që të "aprovohet revizioni si i bazuar në atë drejtim, siç thuhet në të, që aktvendimi i gjykatës së shkallës

së parë të hedhet poshtësi dhe të nxjerrët vendim i ri nëpërmjet të cilit do të aprovohej kërkesëpadia e paditësit si me bazë ose lëndën do të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje".

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 230 lidhur me nenin 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore , gjeti se:

Revizioni i paditësit është i palejuar.

Sipas dispozitës së nenit 481 par.4 të LPK-së kundër aktvendimit të marrë në kontestet për shkak të pengim posedimit revizioni nuk është i lejuar. Përveç kësaj, për rastin konkret nuk ka vendim të gjykatës së shkallës së dytë, kurse, revizioni mund të paraqitet ekskluzivisht kundër aktgjykimit, respektivisht, aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, pra, nuk mund të ketë revizion kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti mund të paraqitet vetëm kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin është vendosur në lidhje me ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, e jo edhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, siç ka bërë pala paditëse.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218 të LPK-së, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 230 dhe 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin t'a hedh si të palejuar.

- **Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.E.nr.52/2021, datë 18.03.2022 (Vlera e kontestit – Ekonomike)**

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.91/2021të datës 18.05.2021, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.714/20 të datës 22.02.2021, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, ashtu që: me pjesën e II të dispozitivit, vërtetohet se e paditura, duke tentuar ta vë në qarkullim pa pëlqimin e paditëses mallin i cili ka shenjën identike të markës së mbrojtur Y. me tre cepa i njohur si shenja e Mercedes, ka bërë shkeljen e markës tregtare paditëses e cila markë është e regjistruar dhe

mbrojtur me Ligjin për Markat Tregtare të Republikës së Kosovës. Me pjesën e III të dispozitivit, i ndalohet të paditurës që të vë në qarkullim çfarëdo malli apo produkti tjetër i cili përbën shkelje të markës tregtare mall me shenjën identike të markës së mbrojtur Y., me tre cepa i njohur si shenja e Mercedes. Me pjesën e IV të dispozitivit, detyrohet e paditura që me shpenzimet e veta ta asgjësojë mallin e ndaluar nga Dogana e Kosovës i cili është proceduar me numrin e rastit ..., datë 30.10.2018, si dhe shpenzimet e magazinimit sipas faturës për 55 copë Makina – lodra nga plastika me bateri me shenjën e Y., me tre cepa Mercedes. Me pjesën e V të dispozitivit detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë shpenzimet procedurale, në shumën prej 560.00-euro, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, e paditura ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, që të aprovohet revizioni dhe të anulohen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, të refuzohet si e pabazuar në tërësi padia e paditëses, dhe të aprovohet revizioni i të paditurës si dhe të prishen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe lënda ti kthehet në rigjykim, gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës si dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, sipas nenit 218 par.2 pika d), lidhur me nenin 508 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se vlera e kontestit në padinë e paditëses, të dorëzuar në gjykatë më datë 23.11.2018, është 4000.00-euro. Ndërkohë që, me dispozitën e nenit 508 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është përcaktuar shprehimisht se " Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000- euro".

Sipas kësaj dispozite ligjore rrjedh se, në rastin konkret, e duke qenë se vlera e objektit të kontestit në shumë prej 4000 mijë euro, sikundër është caktuar në padi, nuk kalon shumën e paraparë me dispozitën e sipër përmendur ligjore, që d.m.th. nuk kalon shumën prej 10.000-euro, revizioni në këtë çështje juridike civile, nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 218, nenin 505 dhe nenin 508 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Pjesë të shkëputura nga *Aktvendimi Rev.nr.174/2022, datë 11.05.2023 (Vlera e kontestit-Vërtetim i pronësisë)***

A rs y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4895/17 të datës 09.09.2021 është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditëseve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2952/11 i datës 20.06.2016, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëseve, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet që paditëset janë pronare të ngastrës kadastrale nr. ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 47.34 ha, e cila evidentohet sipas fletës poseduese ..., në vendin e quajtur " Kashagija", Zona Kadastrale në P., dhe të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që këtë ngastër kadastrale ta evidentojë dhe ta regjistrojë në emër të paditëseve, për secilën nga ¼ pjesë ideale të paluajtshmërisë lëndore dhe me pjesën e II të dispozitivit, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditëset kanë paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëseve ose të njëjtat të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe të lejueshmërisë së revizionit, si dhe shkresave të lëndës, sipas nenit 218 par.2 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i paditëseve është i palejuar.

Kështu sepse, me dispozitën e nenit 211.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet *se " Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë prestimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3000 mijë euro".* Në rastin konkret civil, fillimisht, me padinë e paditëseve, të paraqitur më datë 16.12.2011, është caktuar vlera e objektit të kontestit në lartësi prej 1000 mijë euro, për këtë vlerë është paguar edhe taksa përkatëse gjyqësore, si në shkresat e lëndës. Mirëpo, në ndërkohë, tek në fazën e paraqitjes së mjetit të jashtëzakonshëm juridik – revizionit, kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, nga ana e përfaqësueses së autorizuar të paditëseve, në të cilin ceket se vlera e kontestit është në shumë prej 20,000 mijë euro. Në kontestet pasurore juridike jo në të holla, pala paditëse duhet të përcakton vlerën e objektit të kontestit. Ndërsa, kur jemi këtu, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 35.2 të LPK-së parashihet se " Në rastet tjera, kur kërkesëpadia nuk ka të bëjë me të holla, vendimtare do të jetë vlera e objektit të kontestit të cilën e ka treguar paditësi në padinë e tij", sikundër është rasti konkret me paditëset, të cilat, në padinë e tyre të datës 16.12.2011, e kanë caktuar vlerën e objektit të kontestit në shumë prej 1000-euro, ndaj, në kontekstin e mësipërm, duke pasur parasysh edhe dispozitën e nenit 36 të LPK-së (Përmirësimi i vlerës së objektit të kontestit bëhet ex officio ose sipas prapësimit të palës, por më së voni në seancën përgatitore ose në seancën e parë të shqyrtimit kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është mbajtur), gjykata e revizionit, nuk ka tagër dhe nuk është e autorizuar të vërtetoi vlerën më të madhe të kontestit, nga këtu, rezulton se revizioni është i palejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 218 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Pjesë të shkëputura nga aktvendimi CML.nr.4/2022 datë 12.05.2022**

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.920/2022 të datës 01.03.2022, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e kryerësit të dhunës në familje dhe është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, C.nr.42/2022 i datës 21.01.2022, me të cilin, është aprovuar kërkesa për urdhër mbrojtje e palës së mbrojtur F.G nga P..., kundër kryerësit të dhunës në familje – palës përgjegjëse A.G nga O.., dhe janë caktuar masat përkatëse mbrojtëse, të specifikuara si në dispozitivin e tij.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, pala përgjegjëse- kryerësi i dhunës në familje ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljes së Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, nga neni 5 par.1 dhe nga neni 3 par.4 të këtij ligji, me propozim që të aprovohet kërkesa në tërësi si e bazuar, të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara të instancave më të ulëta gjyqësore, apo të anulojë dhe çështjen t'ia kthejë në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të palës përgjegjëse, kundër aktvendimit të sipër përmendur, në pajtim me nenin 245.1 dhe nenin 246 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e palës përgjegjëse, është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se pala përgjegjëse A.G nga O., ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i sipër përmendur i gjykatës së shkallës së parë. Ndërkohë që, sipas dispozitës së nenit 246 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore, është paraparë se "Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit nga neni 245 i këtij ligji ngritët nga prokurori publik (tani nga Prokurori Shtetëror - neni 1 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së), në pajtim me ligjin". Nga kjo dispozitë ligjore, rrjedh se kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (si mjet i jashtëzakonshëm juridik) mund ta parashtrojë ekskluzivisht Prokurori i Shtetit e jo si në këtë rast pala përgjegjëse- kryerësi i dhunës në familje. Pra, Prokuroria Shtetërore ka kompetencë ekskluzive në lidhje me paraqitjen e këtij mjeti juridik, ajo ka legjitimitetin real dhe procedural të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Për më tepër, me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje,

nuk parashihet mundësia e paraqitjes të mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të gjykatës me të cilat është vendosur lidhur me kërkesat për lëshuarjen e urdhrit për mbrojtje dhe urdhrit për mbrojtje emergjente.

Prandaj, nga arsyeja e sipër përmendur, Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të palës përgjegjëse, u dashtë që ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221, nenit 245.1 dhe nenit 246 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Pjesë të shkëputura nga aktvendim CML.nr.7/2021, datë 21.09.2021**

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2798/2020 të dt.5.05.2021 është aprovuar ankesa e kreditorit dhe është ndryshuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në P. Ep.nr.267/19 dt.04.02.2020, ashtu që, refuzohet i pabazuar prapësimi i debitorit i paraqitur kundër Urdhrit për Përmbarim ..., i dt.19.03.2019, i lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat B. B., në ..., që kishte të bënte me lejimin e përmbarimit- pagesën e borxhit në vlerë prej 2,028.79 mije euro.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, debitori ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të, siç thuhet në të njëjtën, aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, me propozim që të aprovohet kërkesa, të anulohen aktvendimet e instancave më të ulëta gjyqësore dhe lënda të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në P. .

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të debitorit, kundër aktvendimit të sipër përmendur, në pajtim me nenin 245.1 dhe nenin 246 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e debitorit është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se debitori M. B. nga fsh. ..., Komuna e ..., ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin është ndryshuar aktvendimi i sipër përmendur i gjykatës së shkallës së parë. Ndërkohë që, sipas dispozitës së nenit 246 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore, është paraparë se “ Kërkesa për

mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit nga neni 245 i këtij ligji ngritët nga prokurori publik(tani nga Prokurori Shtetëror-neni 1 i LPNP e LPK-së), në pajtim me ligjin ". Nga kjo dispozitë ligjore, rrjedh se kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (si mjet i jashtëzakonshëm juridik) mund ta parashtrojë ekskluzivisht Prokurori i Shtetit e jo si në këtë rast debitori. Pra, Prokuroria Shtetërore ka kompetencë ekskluzive në lidhje me paraqitjen e këtij mjeti juridik, ajo ka legjitimitetin real dhe procedural të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prandaj, nga arsyeja e sipër përmendur, Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së debitorit, u dashtë që ta hedh si të palejuar.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktvendimi CPP.nr.4/2021, datë 02.07.2021 (Procedura nuk ka përfunduar)***

A r s y et i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës CPP.nr.1/2021 datë 10.03.2021 është pranuar si i bazuar propozimi i të paditurve N. B., Sh. B. dhe A. B. të gjithë nga ..., për përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.37/2016 të datës 23.02.2016. Gjithashtu, me të njëjtin aktvendim, Prishet aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.37/2016 i datës 23.02.2016, në pjesën e I të dispozitivit dhe hedhet, si i palejuar revizioni i paditësit L. B. nga ..., i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3494/2015 i datës 14.10.2015, në pjesën që i referohet hedhjes së ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.725/2015 të datës 15.07.2015 (me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia).

Kundër aktvendimit të sipër përmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës, paditësi ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës, pa i specifikuar konkretisht arsyet (shkaqet) e parapara me dispozitat e nenit 232 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për përsëritjen e procedurës, në bazë të dispozitës së nenit 237 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se propozimi i paditësit është i palejuar.

Sipas dispozitës së nenit 232 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore është parashikuar se procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës.

Në këtë gjendje të çështjes juridiko civile, Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se me aktvendimin e kësaj Gjykate, është pranuar si i bazuar propozimi i të paditurve për përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.37/2016 datë 23.02.2016 dhe është prish aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.37/2016 i datës 23.02.2016, në pjesën e I të dispozitivit dhe hedhet si i palejuar revizioni i paditësit i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3494/2015 i datës 14.10.2015, në pjesën që i referohet hedhjes së ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.725/2015 të datës 15.07.2015 (me të cilin paditësit i kthehet në plotësim padia). Në rastin konkret procedura në këtë çështje juridike nuk ka përfunduar në formë të prerë, prandaj, sipas dispozitës së nenit 237.1 të LPK-së, propozimi për përsëritjen e procedurës kundër aktvendimit të goditur të Gjykatës Supreme të Kosovës është i palejuar, nga këtu edhe është hedhur poshtë. Për më tepër, sikundër u theksua më lart, kjo Gjykatë, duke vepruar sipas Propozimit për Përsëritjen e Procedurës të paditurve, të njëjtin e ka aprovuar dhe e ka prish aktvendimin Rev.nr.37/2016 datë 23.02.2016 dhe tani më nuk ka aktvendim të Gjykatës Supreme, ndërsa kundër të njëjtit aktvendim të nxjerrë sipas Propozimit për Përsëritje të Procedurës, nuk mundet të paraqitet sërish Propozim për Përsëritje të Procedurës, përndryshe , sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, palët ndërgjyqësore pafundësisht do të paraqisnin këtë mjet juridik.

Në kontekstin e mësipërm, e duke marrë parasysh që në kuptim të dispozitës së nenit 240.3 të LPK-së, kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin aprovohet propozimi për përsëritjen e procedurës nuk lejohet ankimi, nga këtu, sipas analogjisë juridike-ligjore, rezulton se edhe kundër të njëjtit aktvendim të kësaj Gjykate, me të cilin është lejuar propozimi për përsëritjen e procedurës, si në rastin konkret, të sipër përmendur, nuk lejohet propozimi për përsëritjen e procedurës, sepse u mor vesh, propozimi për përsëritjen e procedurës u lejua më parë me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës CPP.nr.1/2021 datë 10.03.2021.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.371/2023 dt.12.09.2023 (Vlera kontestit)***

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3197/2020 dt.12.01.2021, refuzohet si e pathemeltë ankesa e paditësit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3846/18 dt.30.04.2019, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit në emër të tri pagave të shpërblimit jubilar t'ia paguajë shumën prej 2.426,04 euro, me kamatën prej 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, dhe me pjesën e II të dispozitivit të tij, secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, të aprovohet revizioni dhe të anulohet në tërësi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ndryshohet ashtu që aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, detyrohet e paditura t'i paguajë paditësit në emër të shpërblimit jubilar shumën e sipër cekur, si dhe shpenzimet e procedurës, sipas propozimit në revizion.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, si dhe shkresave të lëndës, sipas nenit 218 par.2 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i paditësit është i palejuar.

Me dispozitën e nenit 211.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet se "Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me përmbushjen e ndonjë prestimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 euro". Sipas kësaj dispozite ligjore rrjedh se, në rastin konkret, e duke qenë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit është 2.426,04 euro, d.m.th. nuk kalon mbi 3.000 euro, revizioni nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është dashur që të njëjtin ta hedh si të palejuar.

- **Pjesë të shkëputura nga Aktvendim Rev.nr.242/2023 dt.4.07.2023 (Ekspropriimi i v.1995)**

A r s y e t i m

Në pjesën e I të dispozitivit, të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan CN.nr.53/2019 dt.19.04.2019, aprovohet si i bazuar propozimi i propozuesit dhe detyrohet kundër propozuesja, që në emër të patundshmërisë së shpronësuar e cila evidentohet si ngas.kad.nr. i ri kadastral P-..., në sipërfaqe prej 783 m2, në vendin e quajtur "P.", ZK-Gj., e evidentuar në bazë të certifikatës pronësore me nr. të lëndës ..., në pronësi juridike të propozuesit P. Xh., t'i paguajë shumën prej 113,535.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e ushtrimit të propozimit 07.07.2017 e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm dhe me pjesën e II të dispozitivit, obligohet kundër propozuesja që propozuesit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.842,50 euro.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.3156/19 të datës 04.05.2023, është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e kundër propozueses, ndryshohet aktvendimi, i sipër përmendur, i gjykatës së shkallës së parë, vetëm përkitazi me shkallën e kamatës, ashtu që, shumën e përmendur si në pjesën e I të dispozitivit të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, kundër propozuesja detyrohet t'ia paguajë propozuesit me kamatën në lartësi prej 7% vjetore, duke filluar nga data 17.07.2017 e deri në përmbushjen përfundimtare, ndërsa në pjesët tjera, ankesa refuzohet e pa bazuar dhe vërtetohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, në pjesën e I dhe të II të dispozitivit të tij.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, kundër propozuesja Komuna e Gjilanit, ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni dhe

aktvendimet e instancave më të ulëta gjyqësore, siç thuhet në të, të anulohen si të pa bazuar në legjislacionin e Republikës së Kosovës, duke refuzuar propozimin si të pa bazuar në ligj ose çështjen ta kthejë në rigjykim.

Përgjigje në revizion ka paraqitur propozuesi nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të hedhet poshtë si i palejuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 221 lidhur me nenin 218 par.2, p.d) të LPK-së (neni 11 i LPNP e LPK-së) , gjeti se:

Revizioni i kundër propozueses, Komuna e Gjilanit, është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin mbi ekspropriimin me nr.... date...., i lëshuar nga kundër propozuesja, Komuna e Gjilanit, vërtetohet se prona - paluajtshmëria kontestuese është ekspropriuar në emër të kundër propozueses, e cila pronë, pas bartjes së pronësisë, sipas certifikatës pronësore P-.... me nr.të lëndës ... datë ..., evidentohet në emër të propozuesit, P.Xh., në sipërfaqe prej 783 m2. Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, është konstatuar se propozuesi është pronarë i ngastrës së lartë cekur dhe se parcela në fjalë është ekspropriuar në tërësi dhe mbi këtë parcelë është ndërtuar rruga qarkore në Gjilan dhe se, përkitazi me këtë, paluajtshmëria e shpronësuar nuk është kompensuar nga Komuna e Gjilanit. Ndërkohë që, edhe nga eksperti i bujqësisë, në bazë të metodave krahasuese dhe kritereve të aplikueshme ligjore, ka bërë vlerësimin e të njëjtës në lartësinë si në ekspertizën me shkrim, përkatësisht, si në dispozitiv të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë, në këtë gjendje të çështjes dhe pas administrimit të gjitha provave, e ka aprovuar propozimin e propozuesit, ka caktuar kompensimin për paluajtshmërinë e ekspropriuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e kundër propozueses, e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, përveç, për shkallën e kamatës, lidhur me të cilën e ka ndryshuar të njëjtin, dhe ka vendosur si në pjesën I , II, dhe III, të dispozitivit të aktvendimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, në prani të kësaj gjendje juridiko-civile, në mbështetje të dispozitës së nenit 40 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme por, duke pasur parasysh edhe

faktin se sipas dispozitave të nenit 2b, (al. tre dhe katër) të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ekspropriimin G.Z. e KSAK nr.46/86, (në fuqi në kohën e ekspropriimit të paluajtshmërisë së propozuesit - 1995 -) parashihet se " Procedura për caktimin e kompensimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuar është urgjente dhe se *"Kundër Aktvendimit të plotfuqishëm mbi caktimin e kompensimit nuk lejohet revizioni ".*

Nga këtu, sipas dispozitës së sipër përmendur ligjore, përkitazi me rastin konkret juridiko-civil, rrjedhë se në procedurën e caktimit të kompensimit për pasurinë e ekspropriuar, revizioni si mjet i jashtëzakonshëm juridik, është i palejuar (në kontekstin e mësipërm, shih edhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. KI.93/16 dt.23.11.2017).

Prandaj, pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218 të LPK-së, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Pjesë të shkëputura nga *aktvendimi Rev.nr.167/2022 dt.21.04.2022 (Përkitazi me masën e sigurimit)***

Arsyetimi

Me pjesën e I të aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10083/21 të datës 25.01.2022, refuzohet si e pathemeltë ankesa e të padituve – kundërshtarëve të sigurimit, ndërsa, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.238/18 të datës 12.10.2021, vërtetohet në pikën I dhe II të dispozitivit të tij, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit aprovohet si i bazuar propozimi i paditëses – propozueses së masës së sigurimit, caktohet masa e sigurisë dhe iu ndalohet të padituve – kundërshtarëve të masës së sigurimit M.Ç. dhe F. Ç. të dy nga P., shitja, tjetërsimi, ngarkimi me çfardo barre - hipoteke në njësinë kadastrale ..., në sipërfaqe prej 79 m2, e cila evidentohet në emër të M. Ç, në njësinë kadastrale ..., në sipërfaqe prej 80 m2, e cila evidentohet në emër të M.Ç., në njësinë kadastrale ...., në sipërfaqe prej 79 m2 e cila evidentohet në emër të Menderes Çerkezit, në njësinë kadastrale ..., në sipërfaqe prej 79 m2, e cila evidentohet në emër të F. Ç., në njësinë kadastrale ..., në sipërfaqe prej 80 m2, e cila evidentohet në emër të F.Ç., të cilat njësi banesore janë të ndërtuara në ngastrën kadastrale ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 4970

m2, Zona Kadastrale Prishtinë. Me pjesën e II të dispozitivit, detyrohen të paditurit – kundërshtarët e sigurimit Menderes dhe Fatmire Çerkezi që deri në përfundimin e kontestit me vendim të formës së prerë, apo deri në një vendim tjetër të asaj gjykate, të mos i shesin, tjetërsojnë, ngarkojnë me çfardo barre- hipotekë paluajtshmëritë e cekura si në pikën I të dispozitivit të aktvendimit, nën kërcënim të pasojave ligjore. Me pjesën e II të dispozitivit të aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, pika III, IV dhe V e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbeten të pashqyrtuara.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, të paditurit – kundërshtarët e sigurimit kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale (pa i specifikuar të njëjtat), me propozim siç thuhet në të, që revizioni të aprovohet si i bazuar, ndërsa, këtë aktvendim ta anulojë me aprovimin e pretendimeve të paditurve- kundërshtarëve të masës së sigurisë dhe lëndën të ia kthejë gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim.

Përgjigje në revizion ka paraqitur pala paditëse – propozuesja e masës së sigurimit, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur në pajtim me dispozitën e nenit 230, lidhur me nenin 218 par.2 pika d) të LPK-së, (neni 11 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK) ka gjetur se:

Revizioni i të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja -propozuesja e masës së sigurimit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, më datën 29.01.2018, ka paraqitur padi kundër të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit , për shkak të ndarjes së pasurisë së përbashkët, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, lidhur me paluajtshmëritë – ngastrat kadastrale të specifikuara dhe me të dhënat si në petitumin e padisë, përkatësisht, si në dispozitivin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin përkitazi me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, ka gjetur se i njëjti është pjesërisht i bazuar, ndaj, ka vendosur si në pjesën nën I, II , III, IV dhe V të dispozitivit të aktvendimit të sajë.

Gjykata e shkallës ë dytë, në procedurën ankimore, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë , duke u mbështetur edhe në provat shkresore që gjenden në shkresat e lëndës, drejtë ka zbatuar dispozitat

e procedurës kontestimore të nenit 297 të LPK-së, kur ka aprovuar pjesërisht propozimin për caktimin e masës së sigurimit, andaj, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se në rastin konkret civil juridik, aktvendimi i goditur nuk e ka cilësinë e aktvendimit me të cilin përfundon procedura në formë të prerë.

Kështu, sipas dispozitës së nenit 228.1 të LPK-së, është paraparë që palët mund të paraqesin revizionin vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Meqë me aktvendimin e goditur nuk përfundohet procedura kontestimore në këtë çështje juridike në formë të prerë, sipas kësaj dispozite revizioni kundër aktvendimit të goditur nuk është i lejuar, prandaj, kjo gjykatë revizionin e ka hedhur si të palejueshëm.

Nga sa u theksua më lartë e në mbështetje të dispozitës së nenit 221 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Pjesë të shkëputura nga *aktvendimi Rev.nr.568/2021 datë 22.07.2022 (Për shpenzime të procedurës)***

Arsyetimi

Me dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.5241/19 të datës 12.08.2021 është refuzuar ankesa e paditësit, ndërsa, është vërtetuar pika V-të e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.623/14 të datës 17.07.2019, me të cilën është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës, kurse, pika I, II, III dhe IV e dispozitivit të tij, mbeten të pa shqyrtuara.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi ka paraqitur revizion, vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, për shkak të, siç thuhet në të, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i

gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të detyrohet i padituri i parë që paditësit t'i paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 4,090.00 euro, në afat prej 15 ditësh.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit në kuptim të nenit 215 lidhur me nenin 218 par.2 pika d) të LPK-së (neni 11 i Ligjit për Ndryshimin dhe plotësimin e LPK-së) gjeti se:

Revizioni i paditësit është i palejuar.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se në rastin konkret revizioni i paditësit është i palejuar. Kjo për faktin sepse revizioni nuk është i lejuar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin është vendosur për kërkesën akcesore (dytësore), nëse kjo kërkesë nuk përbën kërkesë kryesore, siç edhe është rasti konkret (kamatat, shpenzimet e procedurës, dënimet kontraktuese dhe kërkesat tjera dytësore).

Me dispozitën e nenit 30 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se për konstatimin e së drejtës në paraqitjen e revizionit, vlerë e objektit të kontestit merret vetëm vlera e kërkesës kryesore, ndërsa, kamatat, shpenzimet e procedurës dhe kërkesat tjera sekondare nuk merren parasysh në qoftë se nuk paraqiten si kërkesë kryesore. Si kërkesë kryesore e palës është kërkesa për të cilën zhvillohet kontesti, ndërsa, kërkesat sekondare janë ato që paraqiten lidhur me kërkesën kryesore. Po ashtu, në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar se edhe përkitazi me shpenzimet e procedurës, nuk është i lejuar revizioni. Revizioni, pra, nuk lejohet kundër vendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin është vendosur për shpenzimet procedurale, nëse nuk goditet edhe vendimi për çështjen kryesore, sikundër edhe është rasti konkret. Kështu edhe me dispozitën e nenit 229.3 të LPK-së, parashihet se: "Revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit mbi shpenzimet e procedurës".

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se revizioni i paraqitur është i palejueshëm, ndaj, nga sa u theksua më lartë e në mbështetje të dispozitës së nenit 221 të LPK-së ,u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

- **Pjesë të shkëputura nga aktvendimi EML.nr.1/2021 datë 27.05.2022 (lidhur me Vendimin për Arbitrazhin)**

Arsyetimi

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.504/20 të datës 27.09.2021, shpallet i ekzekutueshëm vendimi i Arbitrazhit të Huaj – Arbitrazhit të Përhershëm, pranë Odës Ekonomike të Serbisë, në Beograd, Vendimi T- ..., të datës 02.06.2020, i korrigjuar dhe plotësuar me Vendimin T- .., të datës 29.06.2020, me të cilin është vendosur në mënyrë meritore në çështjen juridike kontestimore në mes të paditësit – propozuesit Yumis sh.p.k. Nish, kundër të padituri – kundërshtarit të propozimit "P..." Lubizhdë, me seli në Prizren, në tërësi si në dispozitivin e vendimit të lartë cekur.

Kundër aktvendimit të sipër përmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Prokurori i Shtetit, ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të, siç thuhet në të, aktvendimi në fjalë është marrë në kundërshtim me nenin V të Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, respektivisht në kundërshtim me nenin 39.5, pika b) të Ligjit për Arbitrazhin e Kosovës, me propozim që të miratohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa, aktvendimi i lartë cekur, të shfuqizohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, kundër aktvendimit të sipër përmendur, në pajtim me nenin 245.1 dhe nenin 246 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Prokurori i Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktvendimit të sipër përmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me të cilin është shpallur i ekzekutueshëm Vendimi i Arbitrazhit të Huaj- Arbitrazhit të Përhershëm në Odën Ekonomike të Serbisë, në Beograd, T-..., të datës 02.06.2020 i korrigjuar dhe i plotësuar më datë 29.06.2020, me të cilin është vendosur në mënyrë meritore në çështjen juridike kontestimore midis paditësit – propozuesit Y..., sh.p.k. Nish dhe të padituri – kundërshtarit të propozimit P..., SH.P.K." L.., me seli në Prizren, si në dispozitivin e vendimit të lartë cekur.

Ndërkohë që, në këtë gjendje të kësaj çështje dhe në kontekstin e mësipërm, duhet pasur parasysh, se me dispozitën e nenit 37.3 të Ligjit për Arbitrazhin të Republikës së Kosovës, parashihet se "

Kundër aktvendimit të Gjykatës në rastet e parapara me nenin 36, par.2, lejohet ankesa. Për të gjitha aktvendimet tjera të nxjerra nga Gjykata në pajtim me këtë ligj nuk lejohet ankesa" , sikundër është edhe rasti konkret me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin është shpallur i ekzekutueshëm aktvendimi përkatës i arbitrazhit, dhe pasi që e njëjta ka gjetur se shpallja e aktvendimit përkatës të ekzekutueshëm, nuk është në kundërshtim me dispozitat e nenit 39.5 pika a) dhe b) të Ligjit për Arbitrazhin të Kosovës, përkatësisht, nuk ka të bëjë me kontestin që nuk mund të zgjidhet përmes arbitrazhit dhe nuk është në kundërshtim me rendin publik (ordre public) të Republikës së Kosovës. Prandaj, në prani të faktit se kemi të bëjmë me dispozita të veçanta të një Ligji Special, si dispozitat e nenit 36, nenit 37, nenit 38, nenit 39 të Ligjit për Arbitrazhin të Republikës së Kosovës, (e për dallim nga dispozitat e LPK-së, nenit 245 etj, në vazhdim të tij), këtu në rastin konkret civil juridik, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, në kontekstin e dispozitave të sipër cekura, nuk lejohet.

Prandaj, nga arsyeja e sipër përmendur, Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, u dashtë që ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221, nenit 245.1 dhe nenit 246 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT: Këto janë disa nga rastet e praktikës gjyqësore kur mjetet juridike të jashtëzakonshme, nga arsyet e përcaktuara ligjore, janë hedhur si të palejuara nga Gjykata Supreme e Kosovës, pasi që, sikundër u theksua më lartë, këtë nuk e ka bërë gjykata e instancës më të ulët, edhe pse e autorizuar me ligj, përkatësisht, me dispozitën e nenit 218 të LPK-së.

KAPITULLI X

PASURIA E PËRBASHKËT E BASHKËSHORTËVE

1. Baza ligjore

Marrëdhëniet midis bashkëshortëve janë të karakterit personal dhe pasuror dhe bazë ligjore për mënyrën e krijimit dhe efekteve juridike që krijojnë vlejnë dispozitat e Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK).

Ligji për Familjen i Kosovës është ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, ashtu që është riformuluar neni 47. Sipas nenit 1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, është riformuluar nenit 47 dhe është përcaktuar se: *"1. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me kontribut të përbashkët gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë.* 2. *Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës konsiderohet: 2.1. të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort;* 2.2. *ndihma e bashkëshortit e afruar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. 3. Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm.* 4. *Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe.5. Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të përfshijë të drejtat sendore dhe të detyrimeve."*

Neni 46 i LFK-së ka rregulluar çështjen e pasurisë së veçantë të bashkëshortëve, ku është përcaktuar se:

- *Pasuria e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së martesës do të mbetet pasuri e veçantë e tij, (neni 46 paragrafi 1);*
- *Pasuria e veçantë është gjithashtu edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës përmes trashëgimit, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimit të pronësisë, (neni 46, paragrafi 2*);
- *Pasuria që i takon bashkëshortit duke u bazuar në proporcionin e pasurisë së përbashkët është gjithashtu pasuri e veçantë, (neni 46, paragrafi 3);*

- *Një prodhim arti, punë intelektuale apo pronë intelektuale konsiderohet pasuri e ndarë e bashkëshortit/ës që e ka krijuar, (neni 46, paragrafi 4);*

Me nenin 53 të LFK-së është përcaktuar se: *(1) Bashkëshortët, në çdo kohë, mund të pjesëtojnë pasurinë e tyre të përbashkët me marrëveshje. (2) Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet kur bashkëshortët caktojnë ose kërkojnë t'u caktohen pjesët e tyre në pasurinë e përbashkët dhe kështu bëhen pronarë në pjesë të caktuara. (3) Marrëveshja nga paragrafi 1 dhe 2 e këtij neni duhet të bëhet medoemos me shkrim në pajtim me kërkesat formale, të përcaktuara me ligjin në fuqi mbi pasurinë për arritjen e marrëveshjeve të tilla.*

Ndërsa me dispozitën e nenit 55 paragrafi 1 përcaktohet se: *"Pjesa e pasurisë së bashkëshortëve përcaktohet duke përdorur kriteret e njëjta ashtu siç janë përcaktuar në nenin 54 (1)."* ndërsa në paragrafin 1 të nenit 54 përcaktohet se: *"Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët". 2) Gjykatat kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të parapara sipas këtij neni".*

2. Komenti i shkurtër i dispozitave të cituara

Nga përcaktimi ligjor i kuptimit të pasurisë së përbashkët bashkëshortore rrjedh se për ekzistimin e saj duhet të plotësohen dy kushte në mënyrë komulative, si ekzistimi i bashkësisë martesore apo marrëdhëniet jashtëmartesore dhe puna gjatë vazhdimit martesës apo *në marrëdhëniet jashtëmartesore, që me ndryshim të ligjit pjesa e fjalisë: "me punë gjatë vazhdimit të martesës" është zëvendësuar me fjalinë "me kontribut të përbashkët gjatë vazhdimit të martesës")* . Ekzistimi i martesës dhe krijimi i pasurisë gjatë vazhdimit të martesës është kusht për tu konsideruar pasuri e përbashkët e cila mund të jetë objekt i pjesëtimit në mes të bashkëshortëve. Pa ekzistimin e bashkësisë martesore nuk mund të flitet për ekzistimin e pasurisë së përbashkët, sepse asaj do t'i mungonte baza juridike mbi të cilën lind pasuria e përbashkët. Nëse bashkëshortët nuk kanë jetesë të përbashkët dhe kanë vënë në dijeni njëri tjetrin se nuk duan që të jetojnë së bashku, atëherë edhe

pse ekziston kurora kjo pasuri e krijuar në këto rrethana konsiderohet pasuri e veçantë. Andaj, me këtë pasuri secili nga bashkëshortët ka të drejtë që të disponojë lirshëm ndërsa me pasurinë që është krijuar gjatë jetës së përbashkët bashkëshortët nuk mund të disponojnë lirshëm, sepse kërkohet pëlqimi reciprok për administrimin dhe disponimin e lirë të saj. Sa i përket punës së përbashkët apo kontributit të përbashkët, nuk duhet kuptuar vetëm aktivitetet që sjellin vlera pasurore, por edhe veprimet dhe aktivitetet e tjera që ndikojnë në plotësimin e nevojave familjare siç janë mirëmbajtja e shtëpisë, kujdesi dhe edukimi i fëmijëve, kujdesi dhe ruajtja e pasurisë etj.
Deri me hyrjen në fuqi të plotësim ndryshimit të ligjit për familje përkatësisht riformulimit të nenit 47 të këtij ligji, praktika gjyqësore në vendosje lidhur me këto raste ka qenë unike sa i përket interpretimi dhe zbatimi sistematik i të gjitha dispozitave që i referohen pasurisë së përbashkët, vlerësimit për pasurinë e përbashkët dhe pjesëtimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.
Nga praktika e deritanishme e gjykatave të të gjitha instancave shihet se gjykatat vendosin lidhur me kontributin e bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët përmes vërtetimit të faktit vendimtar se cila pasuri e përbashkët është krijuar gjatë bashkësisë martesore, pastaj sa është vlera e kontributit të secilit bashkëshort veç e veç në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe kur kjo ngritët nga palët në procedurë bëhet dallimi në mes të pasurisë së veçantë apo pasuri e përbashkët.
Riformulimi që i është bërë nenit 47, përkatësisht paragrafit 3 të këtij neni, ku është përcaktuar se kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm, në praktikë gjyqësore ka sjell dilema dhe paqartësi se si të vendoset në këto rast marrë për bazë faktin se janë në fuqi dhe nuk janë ndryshuar dispozitat nga neni 54, par1, lidhur me nenin 55 paragrafi 1 të LFK-së, ku paracaktohet qartë se gjykata në rast të mosmarrëveshjes duhet ta vlerësojë kontributin e bashkëshortëve, ndërsa gjatë procesit të provuarit në procedurë gjyqësore mund të rezultojë që nuk është i barabartë. Nga kjo shihet se ka kolizion mes këtyre dispozitave ligjore dhe nëse pranohet ndryshim plotësimi pavarësisht kolizionit ekzistues të dispozitave, kontestet gjyqësore të paraqitura pas plotësim ndryshimit do të përfshihen në të provuarit e rrethanave se cila pasuri është krijuar gjatë vazhdimit të martesës, ndërsa pjesëtimi do të jetë i barabartë.

Një çështje me rëndësi për procedurën gjyqësore e që ndërlidhet me pjesëtimin e pasurisë së përbashkët është edhe koncepti se pasuria e veçantë e bashkëshortëve mund të fitohet para martesës por edhe gjatë martesës. Në çdo rast kur në gjykata është kontestuese rrethana se pasuria objekt

kontesti është e veçantë apo e përbashkët, duhet që objekt i të provuarit përveç fakteve tjera të administrohen prova edhe për këtë rrethanë. Është e thjeshtë në procedurën gjyqësore të konstatohet se pasuria objekt kontesti nuk është e përbashkët për shkak se është krijuar para lidhjes së martesës, por është shumë më sfiduese për gjykatën të konstatohet se pasuria objekt kontesti nuk është e përbashkët kur ajo është fituar gjatë martesës Është detyrë e të provuarit në procedurë gjyqësore se cila është pasuria e përbashkët, andaj gjykata procesin e të provuarit dhe faktet e konstatuara nga procesi i të provuarit duhet t'i kualifikojë në pajtim me dispozitat e LFK-së, nga do të rrjedh se nuk përbenë pasuri të përbashkët as pasuria e fituar gjatë martesës me trashëgimi, dhurim, ndonjë formë ligjore tjetër, pasuri e bazuar në proporcionin e pasurisë së përbashkët, ndonjë prodhim arti, punë intelektuale apo pronë intelektuale.

Për tu përjashtuar nga ndarja e pasurisë për situatat e sipër theksuara duhet të provohet se është krijuar apo fituar në një mënyrë të tillë (*si më lartë*) e që e përjashton kualifikimin e pronës së përbashkët.

2. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e pasurisë së përbashkët dhe pjesëtimit të saj

- **Pjesë të shkëputura nga *aktvendimi Rev.nr.132/2023, datë 11.09.2023***

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 n) të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 204 të LPK-së, për çka aktgjykimet patjetër është dashtë të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët kanë dhënë arsye të paqarta dhe kundërthënëse në lidhje me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, përkatësisht janë dhënë arsye të paqarta dhe kundërthënëse në lidhje me faktin vendimtarë se paditësi me të padituren - ish bashkëshorten a kanë jetuar së bashku në kohën kur pretendohet se është blerë banesa që është objekt kontesti. Në lidhje me këtë fakt ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj çka gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar dhe përmbajtja e provave të paraqitura dhe thëniet në procedurë. Pala paditëse gjatë gjithë procesit gjyqësor ka pretenduar se banesa është blerë ne vitin 2013, në këtë kohë kanë qenë duke jetuar me të padituren dhe se edhe ai ka kontribuar në blerjen e saj, ndërsa nga provat e paraqitura rezulton se banesa faktikisht është blerë në vitin 2013 dhe pagesat janë bërë në këtë kohë por se kontrata mes të padituravе është lidhur në vitin 2016. Për një fakt të tillë gjykatat nuk kanë dhënë arsye në aktgjykimet e atakuara, e gjithashtu nuk janë dhënë arsye në lidhje me faktin se paditësi a ka jetuar me të padituren pas periudhës kur është shkurorëzuar, a kanë lindur fëmijë pas shkurorëzimit dhe si ka ardhur deri te krijimi i pasurisë së tillë.

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë në procesverbalin e datës 30.08.2018 ka refuzuar pranimin e provave që ka bashkangjitur paditësi, mbi bazën e të cilave konsideron se vërtetohen faktet që kanë të bëjnë me çështjen objekt shqyrtimi. Kjo gjykatë vlerëson se veprimi i tillë i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me parimin bazë të procedurës - parimin e shqyrtimit dhe të hetimit, të paraparë medispozitën e nenit 7 paragrafi 1, i LPK-së, me të cilën është përcaktuar se: "*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*", ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: "*Palët ndërgjyqëse kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e tyre*". Veprimi i tillë bie ndesh edhe me parimin e së vërtetës materiale, i përcaktuar me nenin 8 paragrafi 1, të LPK-së, që parasheh se: "*Se cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit*", ndërsa në paragrafin 2, përcaktohet se: "*Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku*". Me këtë rast gjykata ka refuzuar pranimin e provave duke dhënë vlerësim për to në këtë fazë të procedurës që është e papranueshme, kjo pasi që palët në procedurë mund të paraqesin prova në fazat e procedurës në të cilat lejohet me LPK, ndërsa gjykata duhet që ato prova t'i administroj dhe me rastin e hartimit të aktgjykimit të njëjtat t'i vlerësoj në raport me çështjen

që është objekt i shqyrtimit. Nuk mundet që gjykata provat mos t'i pranoj dhe në të njëjtën kohë mos pranimin e tyre ta vlerësoj se sa lidhen ato me çështjen objekt shqyrtimi.

Në rrethana të tilla rezulton se gjykatat e instancës më të ulët kanë aplikuar gabimisht të drejtën materiale, përkatësisht nenet 45 dhe 46 të Ligjit për Familjen të Kosovës, kjo pasi që nuk është arritur që me prova konkrete të vërtetohet fakti që pasuria për të cilën paditësi pretendon se ka të drejtën e bashkëpronësisë ½ është pasuri e veçantë e të paditurës-ish bashkëshortes. Në këtë rast nuk mund të merren si fakte vendimtare kontrata e vitit 2016 kur e paditura e ka blerë banesën, pastaj fakti që ajo figuron si pronare në regjistrat kadastral dhe se kush e ka në shfrytëzim, por duhet që me prova konkrete të vërtetohet fakti vendimtarë se në kohën kur është blerë banesa kontestuese ndërgjyqësit a kanë jetuar së bashku- përfshirë edhe bashkësinë faktike. Një fakt i tillë nuk është qartësuar nga gjykatat e instancës më të ulët, madje për këtë fakt ekzistojnë kundërthënie në arsye të paraqitura, kjo pasi që gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit konstaton se paditësi me të paditurën martesën e ka zgjidhur në vitin 2002, ndërsa nuk ka arsye dhe vlerësim të provave në lidhje me pretendimin e paditësit se përkundër zgjidhjes së martesës ai ka vazhduar të jetojë së bashku me të paditurën, kanë lindur fëmijë pas kësaj periudhe dhe se banesa kontestuese është blerë në kohën kur ata kanë jetuar së bashku. Përveç kësaj, gjykatat kanë nxjerrë përfundime për çështjen, mirëpo nuk është vlerësuar prova e bashkangjitur nga paditësi e titulluar dëshmi, datë 09.05.2014, e cila përmban emrin dhe mbiemrin e paditësit, të paditurës dhe nënshkrimet e tyre, gjë që është e paqartë se ndërlidhur edhe me provat tjera çfarë rëndësie dhe roli ka kjo provë në raport me çështjen objekt shqyrtimi.

Gjykatat e instancës më të ulët kanë vlerësuar se paditësi me të paditurën ka jetuar vetëm deri në vitin 2002 dhe se në kohën e blerjes së banesës nuk kanë qenë në bashkësi martesore, ndërsa ky përfundim është nxjerr mbi bazën e konstatimit se: "*përfundimi i tillë është nxjerr mbi bazën e provave të administruara në këtë proces*". Kjo gjykatë vlerëson se konstatimi i tillë është i pamjaftueshëm për faktet e tilla vendimtare, ndërsa gjykatat kanë për obligim që konstatimin e ekzistimin apo jo të një fakti ta mbështesin në prova konkrete të cilat duhet vlerësuar, pastaj të nxirret përfundimi lidhur me çështjen objekt shqyrtimi.

Për shkak të shkeljeve të tilla gabimisht është aplikuar e drejta materiale, përfshirë këtu edhe neni 58 i Ligjit për Familjen të Kosovës, kjo pasi që gjykatat mbi bazën e provave të paraqitura,

pretendimeve të ngritura nga paditësi, nuk kanë dhënë asnjë vlerësim se për çfarë arsye nuk ka gjetur aplikim dispozita e nenit të lartpërmendur që ka rregulluar çështjen e pasurisë së fituar edhe në situatat kur kemi të bëjmë me bashkësinë faktike - bashkësinë jashtëmartesore.

Kjo gjykatë vlerëson se në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të eliminoj shkeljet e tilla, fillimisht duhet të vërtetohet se paditësi me të padituren pas zgjidhjes së martesës në vitin 2002 a ka vazhduar të jetojë në bashkësi jashtëmartesore me të padituren, ashtu siç është pretenduar nga paditësi se pas zgjidhjes së martesës ka vazhduar të jetoj me të padituren dhe kanë lindur edhe fëmijë. Pastaj faktin se kur është blerë banesa, në kohën kur paditësi pretendon se ka jetuar me të padituren në bashkësi jashtëmartesore dhe si rezultat i kontributit të tij, apo banesa është blerë nga e paditura dhe se kjo është rezultat i pasurisë që e paditura e ka fituar përmes trashëgimisë, dhurimit apo ndonjë formë tjetër ligjore të fitimit të pronësisë.

Kryerja e veprimeve të mësipërme, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të dalin gjatë rigjykimit, do ta lejojnë gjykatën e shkallës së parë që, në përputhje me kërkesat e ligjit procedural dhe material, të mund të arrijë në përfundime më të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes që është objekt shqyrtimi.

- **Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.530/2021, datë 25.07.2022**

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 pika (n) të LPK, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 182.1 lidhur me nenin 194 dhe 204 të LPK, për të cilin shkak të dy aktgjykimet patjetër u deshtë të prishen.

Si me ankesë ashtu edhe me revizion kontestohet ligjshmëria e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, me arsyetim se aktgjykimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë

kontradiktor, nga mënyra e vendosjes dhe arsyet e dhëna, të cilin pretendim si të bazuar e pranon edhe kjo gjykatë.

Në aktgjykimin e shkallës së parë shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, qëndron për faktin se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është kontradiktor dhe kundërthënës dhe në kundërshtim të plotë me vet arsyet e dhëna, si dhe provat në shkresat e lëndës, vendosja të aprovohet kërkesëpadia e paditëses duke e detyruar të padituri, që të njëjtës në emër të kontributit të përbashkët gjatë bashkësisë martesore nga data 12.03.1993 e deri më 29.12.2014, t'ia paguajë shumën prej 25.034.96 €, pa dhënë asnjë arsye se cila ka qenë pasuria e përbashkët e krijuar gjatë martesës, paditësja në padinë e saj nuk ka asnjë pretendim se cila është pasuria e tyre e përbashkët e krijuar gjatë martesës, kjo për faktin se nuk është e mjaftueshme vetëm që të kontribuohet gjatë ekzistimit të bashkësisë martesore, por nga ky kontribut edhe të krijohet pasuri e përbashkët e cila me rastin e ndarjes i nënshtrohet edhe vlerësimit të kontributit në krijimin e të njëjtës nga secili bashkëshort, apo në një familje më të gjerë të secilit anëtarë të bashkësisë familjare. Andaj mos arsyetimi i fakteve qenësore, aktgjykimin e shkallës së parë e bënë kontradiktor, pjesën e dispozitivit dhe arsyet e dhëna, si dhe me shkresat e lëndës, për të cilën arsye ka pasur pretendime ankimore kundër aktgjykimit të shkallës së parë nga i padituri, andaj gjykata e shkallës së dytë ka qenë dashtë t'i trajtoj dhe t'i evidentoj këto shkelje, pasi paraqesin shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, për të cilat aktgjykimi ka qenë dashtë të prishet, për të cilën shkelje gjykata e shkallës së dytë ka qenë dashtë të kujdeset sipas detyrës zyrtare sipas nenit 194, të LPK-së, dhe sipas pretendimeve në ankesë, dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta prish konform nenit 198.2 të LPK.

Ndonëse është obligim i gjykatës në bazë të nenit 160 par.4, të LPK-së, që arsyetimi i aktgjykimit të përmban, kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar palët, provat që i kanë propozuar palët, cilat fakte i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato me rastin e vendosjes, aktgjykimit të shkallës së parë por edhe të shkallës së dytë i mungojnë arsyet për mënyrën e vendosjes për faktet vendimtare, për më tepër arsyet e dhëna janë kontradiktore në mes vete, nuk janë arsyetuar provat e administruara, të cilat janë në kundërshtim me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së dytë dhe të parë po ashtu kanë bërë aplikim të gabuar të dispozitave materiale, duke i parafrazuar dispozitat ligjore, pa dhënë arsye se pse një dispozitë konkrete duhet të zbatohet, në bazë të nenit 47, të Ligjit mbi Familjen i Kosovës, është përcaktuar se "*Pasuria e përbashkët (1) Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë; (2) Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve; (3) Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët. (4) Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh*". Bazuar në këtë dispozitë për të ju nënshtruar ndarjes pasuria e përbashkët, duhet që pasuria e përbashkët të ekzistoj në momentin e ndarjes. Në rastin kur kemi kontest, siç është në rastin konkret, gjykata duhet të sigurohet se cila është pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, apo e anëtareve të bashkësisë familjare, dhe me rastin e ndarjes për pasurinë e përbashkët duhet të aplikoj dispozitat 54 dhe 55 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës, për të përcaktuar kontributin e secilit bashkëshort, aplikimi i gabuar i të drejtës materiale është rezultat edhe i mos vërtetimit në tërësi të gjendjes faktike.

Kërkesa e palës paditëse është parashtruar për kontributin e saj, për gjatë ekzistimit të martesës dhe ky kontribut duhet të llogaritet prej kur faktikisht paditësja ka filluar bashkësinë martesore me të padituri, i cili kontribut duhet të vlerësohet varësisht se sa është rritur pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, por edhe pasuria e përbashkët e familjes së të padituri në të cilën kanë bashkëjetuar, siç është përcaktuar me Ligjin e Familjes në nenin 58, par. 1, ku shprehimisht thotë: "*Pasuria e fituar përmes punës së përbashkët të burrit dhe të gruas në marrëdhëniet jashtëmartesore (partneritet pa bashkëjetesë) konsiderohet pasuri e tyre e përbashkët*". Po ashtu si te pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, edhe te pasuria e përbashkët e anëtarëve të bashkësisë familjare, secili anëtarë mund të pretendoj se i takon pjesa e tij me rastin e ndarjes në proporcion me kontributin. Por e drejta në kërkesën dhe pjesëtimin e sendit ekziston vetëm nëse sendi është fituar deri sa ka funksionuar ekonomia e përbashkët e bashkësisë familjare, në rastin kur në këtë bashkësi anëtarët fillojnë të funksionojnë të pavarur, konsiderohet se bashkësia është shkëputur dhe nga ky moment pasuria e fituar nuk i nënshtrohet ndarjes dhe pjesëtimit. Gjykata e shkallës së parë nga shtjellimi i çështjes nuk ka arritur në përfundimin se cila ka qenë pasuria e krijuar dhe nëse ka pasuri të krijuar deri sa paditësja dhe i padituri kanë qenë në martesë, nuk mund të kërkohet si kontribut derisa nuk ka pretendim se është krijuar pasuri e përbashkët. Po ashtu kërkesa e

paditëses për pasurinë e krijuar duhet të specifikohet, dhe nëse vlerëson se kjo pasuri është krijuar në familjen e gjerë, si të paditur duhet të përfshihen edhe anëtarët e tjerë të kësaj bashkësie familjare, dhe duhet të vlerësohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, gjithmonë në kuptim të dispozitave të ligjit për familjen.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e lartpërmendura, (kërkesa sipas padisë të jetë e qartë duke e specifikuar cila është pasuria e krijuar gjatë martesës), duke i pasur parasysh edhe thëniet e tjera të ankesës dhe revizionit, ashtu që të trajtoj dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e palëve, ashtu që të vërtetoj faktin nëse gjatë ekzistimit të martesës në mes të paditëses dhe të padituri, por edhe anëtareve tjerë të bashkësisë familjare është krijuar pasuri e përbashkët. Ashtu që me rastin e vendosjes, të mund të vendoset pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, përmes administrimit të provave, dhe gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të aktgjykimit duhet të ketë kujdes që i njëjti të jetë në përputhje me nenin 160 të LPK-së, ashtu që vendimi të jetë i ligjshëm, dhe të përmbajë arsye për faktet vendimtare të vendosjes.

- **Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi Rev.nr.147/2021, datë 13.06.2022**

Arsyetimi

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë pasi që mbi gjendjen faktike të konstatuar e drejta materiale në këtë çështje juridike kontestuese nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Në këtë rast Gjykata Supreme nuk ka pranuar zbatimin e të drejtës materiale të referuar nga gjykata e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, ngase nga faktet dhe provat e paraqitura rezulton se pala paditëse në asnjë fazë të procedurës nuk ka arritur të dëshmoj krijimin e pasurisë së përbashkët si kusht esencial për të fituar të drejtë në pjesëtimin e pasurisë dhe eventualisht edhe kompensimin financiar në emër të kontributit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat nga nenet 47 dhe 54 të LFK-së.

Gjatë procedurës së zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, ashtu siç e ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti që gjësendet dhe mobilet kanë qenë të palës paditëse, përkatësisht kanë qenë dhurata nga prindërit e saj. Ligji për Familjen

me nenin 46 par.2 të LFK-së ka përcaktuar se pasuri e veçantë konsiderohet pasuria që është fituar gjatë martesës përmes dhurimit, ndërsa në këtë rast nuk ka qenë kontestues fakti që paditëses mobiliet i janë dhuruar nga prindërit, andaj në rrethana të tilla e sipas dispozitës ligjore të cekur rezulton se kjo pasuri që i është dhuruar paditëses nuk ka mundur të trajtohet si pasuri e përbashkët dhe rrjedhimisht në emër të saj të caktohet kompensim.

Në këtë rast edhe kreditë që janë marrë nga palët ndërgjygjëse është pranuar dhe njëherit është konstatuar në vendimin e shkallës së parë se këto mjete janë përdorë për përmbushjen e nevojave familjare dhe nuk rezulton se prej këtyre mjeteve financiare palët ndërgjygjëse të kenë krijuar pasuri të përbashkët. Gjykata Supreme vlerëson se nuk mund të gjykohet kompensim në emër të kontributit të dhënë në bashkësinë martesore ose jashtëmartesore për një periudhë të caktuar kohore për rastet kur konstatohet se bashkëshortët gjatë martesës ose bashkësisë jashtëmartesore nuk kanë krijuar fare pasuri të përbashkët. Në këtë rast është vërtetuar që paditësja me të paditurin në bashkësi martesore nuk kanë krijuar pasuri të përbashkët në mënyrë që më pas të krijohet mundësia për të kërkuar pjesëtim të pasurisë dhe eventualisht edhe kompensimin financiar në emër të kontributit. Pra kushti është që fillimisht të konstatohet se gjatë martesës është krijuar pasuri e përbashkët, pastaj të identifikohet se cila është pasuria e përbashkët, cili është kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe pastaj të pjesëtohet pasuria sipas kritereve që përcakton LFK në nenin 54 paragrafi 1.

Gjykata Supreme vlerëson se as martesa e as bashkësia jashtëmartesore nuk duhet nënkuptuar si themelim të marrëdhënies së punës për njërin bashkëshort dhe detyrimin e tjetrit që në rast të zgjidhjes së martesës apo pushimit të bashkësisë jashtëmartesore të kompensojë për kontributin në familje edhe kur nuk ka pasuri të përbashkët. Kriteri i kontributit në kujdesin për fëmijët, familjen, shtëpinë etj., është i rëndësishëm kur ka pasuri të përbashkët, ndërsa në raste kur nuk ka pasuri të përbashkët nuk mund të gjykohet asnjë lloj kompensimi.

4. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Nga praktika e deritanishme e Gjykatës Supreme lidhur me rastet që kanë të bëjnë me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, marrë për bazë kohën kur janë paraqitur rastet për trajtim në gjykatën e shkallës së parë dhe kohën kur ka hy në fuqi plotësim ndryshimi i Ligjit për Familjen,

rezulton se nuk është hasur në ndonjë vendim të kësaj gjykate me të cilin është prishur apo ndryshuar vendimi i gjykatave të instancës më të ulët në rastet kurë kanë trajtuar çështjen pasurisë së përbashkët dhe pjesëtimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 47 të Ligjit për Familjen, i riformuluar sipas Ligjit NR. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës.

Nga praktika e deritanishme gjyqësore për raste të tilla, Gjykata Supreme ka vërejtur se gjykatat e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë vendosin lidhur me kontributin e bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët, pa e vërtetuar më parë faktin se, cila pasuri e përbashkët është krijuar gjatë bashkësisë martesore, pastaj cili është kontributi i secilit bashkëshort veç e veç në krijimin e pasurisë së përbashkët, nuk bëhet dallimi në mes të pasurisë së veçantë dhe pasurisë së përbashkët etj. Shihet gjithashtu se në mënyrën si vendoset në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, që pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, lidhur me pjesën e aprovuese është e pacaktuar dhe nuk dihet se çfarë është miratuar nga kërkesë-padia dhe çfarë është refuzuar njëkohësisht. Sipas praktikës së kësaj gjykate, kurë bëhet fjalë për pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve dhe madhësinë e saj që do të duhej t'i takonte secilit nga bashkëshortët me rastin e ndarjes së kësaj pasurie, duhet që së pari të ekzistojë pasuria e përbashkët e bashkëshortëve ngase pa ekzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve nuk mund të bëhet fjalë për ndarjen e pasurisë së përbashkët e aq më tepër për lartësinë e kontributit të secilit bashkëshort në krijimin e kësaj pasurie. Pas identifikimit të pasurisë së përbashkët dhe madhësisë së kësaj pasurie, mund që të bëhet vërtetimi i kontributit të secilit nga bashkëshortët në administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët, ndërsa këto janë fakte relevante juridike për zgjidhjen sa më të drejtë të kontesteve të kësaj natyre. Kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët, përcakton madhësinë e pjesës së përbashkët, e cila do t'i takonte secilit prej bashkëshortëve, me rastin e ndarjes së kësaj pasurie, nëse bashkëshortët nuk merren vesh lidhur me ndarjen e kësaj pasurie. Vlen të theksohet se në praktikë, ka padi me të cilat kërkohet që të vlerësohet kontributi i bashkëshortit gjatë jetës së përbashkët të bashkëshortëve në familjet e mëdha. Ndonëse në Ligjin për Familjen nuk ka dispozita të posaçme që e rregullojnë një gjë të tillë, vlerësojmë se kjo do të duhej që të bëhej në analogji me nenin 54 të LFK dhe në përpjesëtim me madhësinë e pasurisë që do të duhej t'i takonte bashkëshortit me rastin e ndarjes së pasurisë në familjet e mëdha.

Në rastin e referuar Aktgjykimi Rev.nr.147/2021, i datës 13.06.2022, Gjykata Supreme ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së dytë dhe të shkallës së parë dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e palës paditëse, me të cilën është kërkuar shuma konkrete në emër të kontributit për fitimin e pasurisë së përbashkët të fituar me punë gjatë martesës, duke vlerësuar se palët ndërgjyqëse gjatë bashkësisë martesore nuk kanë krijuar pasuri të përbashkët në mënyrë që më pas të krijohet mundësia për të kërkuar pjesëtim të pasurisë dhe eventualisht edhe kompensimin financiar në emër të kontributit. Është pranuar që në raste të tilla fillimisht të konstatohet se gjatë martesës ose bashkësisë jashtëmartesore është krijuar pasuri e përbashkët, pastaj të identifikohet se cila është pasuria e përbashkët, cili është kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe pastaj të pjesëtohet pasuria sipas kritereve që përcakton LFK në nenin 54 paragrafi 1.

Gjykata Supreme ka vlerësuar se as martesa e as bashkësia jashtëmartesore nuk duhet nënkuptuar si themelim të marrëdhënies së punës për njërin bashkëshort dhe detyrimin e tjetrit që në rast të zgjidhjes së martesës apo pushimit të bashkësisë jashtëmartesore të kompensojë për kontributin në familje edhe kur nuk ka pasuri të përbashkët. Kriteri i kontributit në kujdesin për fëmijët, familjen, shtëpinë etj., është i rëndësishëm kur ka pasuri të përbashkët, ndërsa në raste kur nuk ka pasuri të përbashkët nuk mund të gjykohet asnjë lloj kompensimi. Nuk mund të gjykohet kompensim në emër të kontributit të dhënë në bashkësinë martesore ose jashtëmartesore për një periudhë të caktuar kohore për rastet kur konstatohet se bashkëshortët gjatë martesës ose bashkësisë jashtëmartesore nuk kanë krijuar fare pasuri të përbashkët.

Siç u tha edhe më lart, të gjeturat e kësaj gjykate ju referohen rasteve kur çështja e pasurisë së përbashkët dhe pjesëtimit të saj është trajtuar sipas nenit 47 të Ligjit për Familjen të Kosovës, ndërsa nuk është hasur në ndonjë vendim të Gjykatës Supreme që ka vendos për prishje apo ndryshim të vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët kur kanë vendosur në bazë të nenit 47 të riformuluar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës.

Me plotësim ndryshimin e LFK-së, është krijuar kolizion mes dispozitave të nenit 74 të riformuluar dhe dispozitave nga nenet 54 dhe 55 të këtij ligji, të cilat nuk janë riformuluar e as shfuqizuar, andaj kjo për praktiken gjyqësore do të paraqet vështirësi në lidhje me trajtimin e këtyre rasteve, përkatësish ndarja e pasurisë së përbashkët të bëhet në mënyrë të barabartë duke e vërtetuar vetëm krijimit e pasurisë së përbashkët, pa pasur nevojë që të vlerësohet kontributi, apo ndarja e pasurisë

të bëhet sipas procesit ku fillimisht bëhet identifikimi e pasurisë së krijuar gjatë vazhdimit të martesës, vërtetimi i kontributit për krijimin e pasurisë së përbashkët dhe rrjedhimisht pjesëtimin e saj.

Nga kjo rezulton se pas hyrjes në fuqi të plotësim ndryshimit të LFK-së, kolizionit të krijuar mes dispozitave të sipër theksuara, i mbetet praktikës gjyqësore që të vendosa se a do ta marrë si të barabartë kontributin e bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe rrjedhimisht në çdo rast pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bëhet në mënyrë të barabartë (neni 47 i riformuluar) apo do të vlerësohet kontributi në krijimin e pasurisë së përbashkët (neni 55 paragrafi 1 lidhur me nenin 54 paragrafi 1 të LFK-së).

FITIMI I PRONËSISË NË BAZË TË TRASHËGIMIT- RADHA E DYTË E TRASHËGIMISË DHE E DREJTA E PËRFAQËSIMIT

1. Baza ligjore

Ligji për Trashëgimin i Kosovës në nenin 14 paragrafi 1, ka përcaktuar se: *"Pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij",* në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: *"Prindërit e trashëgimlënësit trashëgojnë gjysmën e pasurisë në pjesë të barabarta, kurse gjysmën tjetër të pasurisë e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit"*, në paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: "*Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka lënë bashkëshort, prindërit e trashëgimlënësit e trashëgojnë tërë pasurinë në pjesë të barabarta*", ndërsa me paragrafin 4 është përcaktuar se: " *Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para tij, bashkëshorti trashëgon tërë pasurinë"*.

Me dispozitat e nenit 15 është rregulluar e drejta e përfaqësimit nga ana e vëllezërve dhe motrave dhe pasardhësve të tyre. LTK-së në paragrafin 1 të nenit 15 ka paraparë se: "*Në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e largët të tij, sipas dispozitave të këtij ligji që vlejnë për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe pasardhësit e tjerë të tij*", ndërsa në paragrafin 2 të nenit të njëjtë përcaktohet se: "*Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte secilit prej tyre sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë pasardhësit përkatës, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni".* Me dispozitën e nenit 16 të LTK-së është paraparë se: "*Në qoftë se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, e nuk ka lënë asnjë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgon prindi tjetër, e në qoftë se edhe ky ka vdekur para trashëgimlënësit, pasardhësit e tij trashëgojnë pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'u takonte të dy prindërve, sipas nenit 15 të këtij ligji".*

Ndërsa me nenin 17 të LTK-së me të cilën është paraparë se: "*Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit e nuk kanë lënë asnjë pasardhës, tërë pasurinë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit*".

2. Komenti i shkurtër i dispozitave të sipërcituara

Në sistemin tonë pozitiv është bashkëshorti i trashëgimlënësit që trashëgon në të dy radhët edhe në radhën e parë edhe në radhën e dytë. Në radhën e parë në mënyrë të barabartë me trashëgimtarët tjerë (fëmijët e trashëgimlënësit) ndërsa në radhën e dytë trashëgon në rast se trashëgimlënësi nuk ka lënë pasardhës. Për dallim nga radha e parë që trashëgon në mënyrë të barabartë me trashëgimtarët tjerë, tek radha e dytë bashkëshorti i trashëgimlënësit trashëgon ½ e pasurisë-masës trashëgimore, ndërsa ½ e trashëgojnë prindërit e trashëgimlënësit.

Çështja që është ngritur në praktikën gjyqësore ka të bëjë me të drejtën e përfaqësimit në radhën e dytë, që sipas kësaj gjykate kjo e drejtë ekziston dhe si e tillë është përcaktuar medispozitat e nenit 15 të LTK-së ku është rregulluar e drejta e përfaqësimit nga ana e vëllezërve dhe motrave dhe pasardhësve të tyre. Në kuptim të dispozitave të nenit të sipër theksuar rezulton së vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit do të kenë të drejtën në trashëgimi në raport me trashëgimlënësin (vëllain apo motrën) në radhën e dytë sipas përfaqësimit, pasi që LTK nuk ka përcaktuar se në rast se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesa që kish pas mi taku atij t'i shtohet prindit tjetër. Edhe në rastin kur para trashëgimlënësit kanë vdekur të dy prindërit e trashëgimlënësit ½ e pasurisë që kishte me iu takuar prindërve të trashëgimlënësit sipas të drejtës së përfaqësimit ju kalon vëllezërve dhe motrave.

E drejta e përfaqësimit edhe në radhën e dytë vjen në shprehje derisa sa ka trashëgimtarë sipas përfaqësimit në këtë radhë. Për shembull nëse ka vdekur njëri prind i trashëgimlënësit apo të dy prindërit e trashëgimlënësit para trashëgimlënësit atëherë sipas përfaqësimit vijnë në shprehje vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit, por në qoftë se edhe ndonjëri nga vëllezërit apo motrat e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, atëherë vijnë në shprehje fëmijët e vëllezërve apo motrave të trashëgimlënësit, d.m.th. nipat apo mbesat. Në të gjitha rastet vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit vetëm nga ana e atit trashëgojnë në pjesë të barabarta pjesën e pasurisë trashëgimore të atit, vëllezërit dhe motrat vetëm nga ana e nënës trashëgojnë në pjesë të barabarta vetëm pjesën e nënës, kurse vëllezërit dhe motrat të së njëjtës nënë dhe të të njëjtit atë, trashëgojnë në pjesë të barabarta me vëllezërit dhe motrat nga ana e të atit pjesën e të atit, kurse me vëllezërit dhe motrat nga ana e nënës pjesën e nënës.

LTK e ka rregulluar edhe situatën kur njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit por nuk ka lënë pasardhës (neni 16 LTK). Në kontekstin e kësaj dispozite na rezulton se në qoftë se ka vdekur njëri prind i trashëgimlënësit dhe nuk ka pasardhës atëherë pjesa nga masa trashëgimore që kish për t'i takuar prindit që ka vdekur para trashëgimlënësit i shtohet prindit pasjetues. Gjithashtu me dispozitën e njëjtë është paraparë edhe situata kur të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit me ç 'rast është përcaktuar se kur të dy prindërit kanë vdekur atëherë pjesën që do tu takonte të dy prindërve (1/2 e tërësisë) do ta trashëgojnë pasardhësit e tyre, pra vëllezërit dhe motrat e sipas përfaqësimit nipat dhe mbesat.

Në praktikën gjyqësore tek radha e dytë e trashëgimisë janë paraqitur raste kur është kontestuar nga ana e bashkëshortit pasjetues e drejta e pasardhësve të prindërve të trashëgimlënësit, me idenë se kur kanë vdekur të dy prindërit e trashëgimlënësit para trashëgimtarit nuk vjen në shprehje e drejta e përfaqësimit. Një nxitje e tillë është ndikuar në njëfarë mase nga përmbajtja e dispozitës së nenit 14 par.4, me të cilën është përcaktuar se: "Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para tij, bashkëshorti trashëgon tërë pjesën e tij" , si dhe neni 17 të LTK-së me të cilën është paraparë se: "*Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit e nuk kanë lënë asnjë pasardhës, tërë pasurinë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit*". Për këtë çështje praktika gjyqësore është treguar mjaft e prerë duke i interpretuar dispozitat e nenit 15, 16 dhe 17, në atë mënyrë që edhe në radhën e dytë vjen në shprehje e drejta e përfaqësimit nëse ka trashëgimtarë sipas radhës përkatës dhe vetëm në rastin kur prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur pa lënë trashëgimtarë dhe përfaqësues që i përfaqësojnë trashëgimtarët e prindërve, atëherë e tërë pasuria trashëgohet nga bashkëshorti.

3. Praktika e Gjykatës Supreme

- ***Pjesë të shkëputura nga Rev.nr.133/2021, datë 04.08.2022***

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 pika (n) të LPK-së, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore, të parashikuara me nenin 182.1 lidhur me nenin 194 dhe 204 të LPK-së, për të cilin shkak të dy aktgjykimet është dashur të prishen.

Si me ankesë, ashtu edhe me revizion kontestohet ligjshmëria e aktgjykimeve të gjykatave të instancës më të ulët, me arsyetim se aktgjykimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë janë kontradiktor, nga mënyra e vendosjes dhe arsyet e dhëna, të cilin pretendim si të bazuar e pranon edhe kjo gjykatë.

Në aktgjykimin e shkallës së parë shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, qëndron për faktin se aktgjykimi i ankimuar në pikën I, e cila pjesë është objekt i shqyrtimit, është i përfshirë me të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është kontradiktor dhe kundërthënës dhe në kundërshtim të plotë me vet arsyet e dhëna, si dhe provat në shkresat e lëndës, vendosja se "*është pronare në bazë të kontributit dhe sipas të drejtës së trashëgimisë në 1/4 pjesë ideale, në patundshmërinë e cila gjendët në lagjen, "Z...", Komuna e P..., të regjistruar në certifikatën mbi të drejtat e pronësisë së paluajtshme me numër të ngastrave nr..., nr..., nr...., nr...., nr...., nr..., nr.... dhe nr...., ZK Pejë, si dhe është pronare në pjesën e shtëpisë familjare të ndërtuar në parcelën kadastrale nr...., ZK Pejë, dhe atë banesës në katin e parë, mbi përdhese, me sipërfaqe prej 80m², me të drejtë të shfrytëzimit të hyrjes së përbashkët*", në bazë të këtij dispozitvi, është e paqartë se në cilën bazë është aprovuar kërkesëpadia e paditëses ..., ndërsa kjo bëhet kontradiktore edhe nga arsyet e dhëna në arsyetim. Po ashtu sa i përket vendosjes se, "*si dhe është pronare në pjesën e shtëpisë familjare të ndërtuar në parcelën kadastrale nr...., ZK Pejë, dhe atë banesës në katin e parë, mbi përdhese, me sipërfaqe prej 80m², me të drejtë të shfrytëzimit të hyrjes së përbashkët*" , është vendosje pa të dhëna të mjaftueshme për ekzekutim, që e bënë aktgjykimin e papërmbarueshëm në këtë pjesë. Në këtë rast gjykata ka vendosur sipas kërkesës së palës paditëse të precizuar, por në momentin kur parashtresa dhe kërkesa e saj, nuk është e qartë dhe nuk mund të veprohet sipas të njëjtës, gjykata duhet ta kthejë në plotësim dhe përmirësim, ashtu që në rastin konkret objekti i kërkesës ka është dashur të ketë të përfshira të gjitha të dhënat e nevojshme, përfshirë të dhënat e detajuar nëse kemi të bëjmë me objekt ndërtimorë të ndarë në njësi apo shtëpi të përbashkët në kate me një hyrje të përbashkët, në këtë rast nuk mund të arrijmë në përfundim nëse në katin e parë është vetëm kjo

banesë apo ka edhe banesë tjetër, andaj në formën si është formuluar është me të dhëna të pamjaftueshme për t'u ekzekutuar aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në aktgjykim, ku paditëses Sh.L., i është njohur e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese në dy baza, në bazë të kontributit dhe trashëgimisë, si dhe pranimit të këtij qëndrimi edhe nga gjykata e shkallës së dytë, për Gjykatën Supreme është e papranueshme, për faktin se këto dy baza garojnë njëra me tjetrën, që do të thotë, se përjashtojnë njëra tjetrën, pretendimi i paditëses se ka pasuri e cila është krijuar me kontributin e paditëses, duhet të jetë konkret, në këtë rast duhet të vërtetohet se cila është kjo pasuri, dhe të veçohet nga masa e trashëgimisë, pasi nuk hyn fare në masën e trashëgimisë.

Për Gjykatën Supreme nuk është kontestuese se me aktvendimin trashëgimor T.nr.... të datës 21.01.1998, si trashëgimtarë janë shpallur tre djemtë e të ndjerit dhe i ndjeri I.L, ish bashkëshorti i paditëses Sh.L, por kjo gjykatë nuk mund të pranojë përfundimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, se paditësja e trashëgon në tërësi masën trashëgimore të ndjerit I.L, për faktin se gjatë jetës bashkëshortore paditësja dhe i ndjeri I.L nuk kanë pasur fëmijë, apo të paktën në këtë përfundim ka arritur kjo gjykatë, andaj në këtë situatë duhet të aplikohen dispozitat e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë, pasi është ligj i aplikueshëm për shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit I. L, ndërsa sa i përket këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë dhe e dytë nuk kanë dhënë arsye, andaj mos arsyetimi i fakteve qenësore, aktgjykimin e shkallës së parë e bënë kontradiktor, pjesën e dispozitivit dhe arsyet e dhëna, si dhe me shkresat e lëndës, për të cilën arsye ka pasur pretendime ankimore kundër aktgjykimit të shkallës së parë nga i padituri R. L, andaj gjykata e shkallës së dytë ka qenë dashtë t'i trajtoj dhe t'i evidentoj këto shkelje, pasi paraqesin shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, për të cilat aktgjykimi ka qenë dashtë të prishet, po ashtu mos aplikimi adekuat i dispozitave materiale, e për të cilën shkelje gjykata e shkallës së dytë ka qenë dashtë të kujdeset sipas detyrës zyrtare sipas nenit 194, të LPK-së, dhe sipas pretendimeve në ankesë, dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta prishë konform nenit 198.2 të LPK.

Ndonëse është obligim i gjykatës në bazë të nenit 160 par.4, të LPK-së, që arsyetimi i aktgjykimit të përmban, kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar palët, provat që i kanë propozuar palët, cilat fakte i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato me rastin e vendosjes, me aktgjykimet e shkallës së parë por edhe të shkallës së dytë, i mungojnë arsyet për mënyrën e vendosjes për faktet vendimtare, për më tepër arsyet e

dhëna janë kontradiktore në mes vete, nuk janë arsyetuar provat e administruara, të cilat janë në kundërshtim me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka aplikuar asnjë dispozitë konkrete të drejtës materiale, por vetëm ka pasur referencë dispozitat e Ligjit për trashëgiminë pa theksuar cila dispozitë është aplikuar me rastin e vlerësimit si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, po ashtu njëjtë ka vepruar edhe gjykata e shkallës së dytë, që është shkelje nga neni 184 të LPK-së, ku është përcaktuar "Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.", ndërsa me nenin 160.5, të LPK-së, është përcaktuar *"Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor."*.

Gjykata Supreme ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që të mbetet i pa shqyrtuar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1006/18 të datës 26.11.2020, sa i përket vendosjes si në pikën I, të dispozitivit lidhur me shpenzimet e procedurës, dhe pikës II, të dispozitivit, pasi në këtë pjesë i padituri nuk ka ushtruar revizion.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e lartpërmendura, *(kërkesa sipas padisë të jetë e qartë)*, duke i pasur parasysh edhe thëniet e tjera të ankesës dhe revizionit, ashtu që të trajtojë dhe vlerësojë të gjitha pretendimet e palëve për objektin e kërkesëpadisë, ashtu që të saktësojë se për cilën pjesë paditëses Sh.L i është njohur e drejta e pronësisë sipas kontributit dhe në cilën pjesë në bazë të trashëgimisë, duke e trashëguar të ndjerin ish bashkëshortin e saj I.L. Ashtu që me rastin e vendosjes, të mund të vendoset pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, përmes administrimit të provave, dhe gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të aktgjykimit duhet të ketë kujdes që i njëjti të jetë në përputhje me nenin 160 të LPK-së, ashtu që vendimi të jetë i ligjshëm me referenca të qarta në dispozita konkrete ligjore të aplikuara me rastin e vendosjes për kërkesëpadinë, si dhe të përmbajë arsye për faktet vendimtare të vendosjes.

- ***Pjesë të shkëputura nga*** **Rev.nr.342/2015, datë 17.12.2015**

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme duke vendosur sipas revizionit të paditurës, të njëjtin e ka hedhur si të palejueshëm. pasi që nga shkresat e lëndës del se paditësit në padinë e dorëzuar në gjykatë e ka caktuar vlerën e kontestit në shumë prej 50.00 Euro, ndërsa nga dëftesa nr._____, e datës 20.06.2007, ka rezultuar se në emër të taksës gjyqësore për padinë është paguar taksa në shumë prej 5 Euro, andaj sipas dispozitës së nenit 382 paragrafi 3 i LPK-së, dhe nenit 2 pika j), të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut, nr.2001/10, e cila ka hyrë në fuqi me datë 21.06.2001, është paraparë se revizioni nuk është i lejuar në kontestet juridiko-pasurore, në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në të holla, dorëzim të sendit ose përmbushje të ndonjë prestimi, nëse vlera e objektit të kontestit, të cilën paditësi e ka cekur në padi nuk kalon shumë prej 1.600.00 DM, përkatësisht 800.00 Euro, andaj edhe revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar.

- ***Pjesë të shkëputura nga Rev.nr.332/2022, datë 02.11.2022***

A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se nuk mund të pranojë një përfundim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm, nga se sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimet e cekura janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 8, nga neni 182.2 pika (n), ndërsa, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë me shkelje edhe nga neni 182.1 lidhur me nenin 204 të LPK-së dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, e që për pasojë, gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e tyre, prandaj, për këtë shkak të dy aktgjykimet është dashur të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se ka kundërthënie midis dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit, se arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përmban arsyet për faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike,

arsyet e paraqitura janë të paqarta dhe kontradiktore. Nuk ka një analizë të provave të zhvilluara nga gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ato nuk janë vënë në relacion krahasues dhe vlerësues, veç e veç dhe së bashku, sikundër që edhe për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumenteve – shkresave, etj.

Kështu, nuk ka deklarim të gjykatave së instancës më të ulët lidhur me faktet relevante me rëndësi për vendosje të drejtë, të plotë dhe të ligjshme të çështjes juridike civile, siç është fjala rreth kundërshtimit të paditurve përkitazi me ekzistimin apo mos ekzistimin e interesit juridik për ngritjen e padisë (neni 254.2 LPK), që përfaqëson shkelje nga neni 182.1 të LPK-së. Nuk ka deklarim të gjykatave të instancës më të ulët as lidhur me çështjen se paditësi, gjatë dhënies së deklaratës trashëgimore, gjatë zhvillimit të procedurës trashëgimore (2012) nuk u ka kontestuar të paditurve të drejtën e trashëgimisë në pasurinë që është objekt i kontestit. Kundërthënie midis dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit si dhe përmbajtjes së dokumenteve, përkatësisht shkresave të lëndës, në kontekst të kërkesës së paditësit, që të paditurit t'i pranojnë atij, të drejtën e pronësisë (në njërën) dhe të bashkëpronësisë (për dy tjera në pjesën nga 1/2) në paluajtshmëritë kontestuese, ngas. kad. Nr... dhe ... (si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë), të cilat, u kuptua se, as nuk evidentohen në emër të tyre, e në anën tjetër, me aktvendimin e sipër përmendur të trashëgimisë, rezulton se ata, paditësi dhe të paditurit tjerë, janë shpallur trashëgimtarë me nga 1/3 , në tërë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit A.Gj, si në dispozitiv të aktvendimit për trashëgiminë të datës 23.05.2012, si dhe në masa e kufij si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, të cilat nuk përputhen me shkresat tjera të lëndës – ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, përkatësisht, skicën dhe të dhënat e paraqitura nga ai, e të cilat rrethana dhe fakte, nuk janë vënë fare në relacion krahasues dhe vlerësues. Nuk ka deklarim të qartë, të plotë nga gjykatat e instancës më të ulët, rreth përmbushjes ose jo të konditave ligjore përkitazi me parashkrimin fitues - mbajtjen (Usucapio – neni 28.4 i LMTHPJ-së) dhe se a ka arritur pala paditëse të provojë se është në posedim me mirëbesim apo jo (neni 72.2 të LMTHPJ-së), a e ka ditur se pasuria evidentohet në emër të ndjerit A.Gj dhe se në pasurinë trashëgimore të lënë nga ai, si trashëgimlënës, janë të thirrur në bazë të ligjit edhe trashëgimtarë të tjerë. Po ashtu, nuk ka deklarim të saktë, të plotë rreth faktit se kur është nis procedura trashëgimore dhe a ka pasur ndarje fizike apo jo midis palëve ndërgjyqëse, sikundër, as rreth faktit se i ndjeri Xh. Gj, djali i A.Gj, a ka hequr dorë nga e drejta e trashëgimit apo jo. Gjithashtu, nuk ka deklarim të qartë dhe të provuar, shpjegim dhe arsye

konkrete nga gjykatat e instancës më të ulët, përkitazi me konstatimin e tyre (lidhur me sintagmën) se i ndjeri A.Gj, qysh sa ishte gjallë *"ka tentuar që të ndajë"* pasurinë e vet dhe siç thuhet në arsyetim të aktgjykimit, *" këtë e ka kundërshtuar vëllai tjetër, M",* pra, me fjalë të tjera, vërtetë nuk është e qartë as forma, as mënyra e ndarjes së pasurisë, përkatësisht, se ka pasur apo jo ndarje të pasurisë së paluajtshme të sipër përmendur. Kundërthënia vijuese midis dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit, sikundër u theksua në kontekstin e mësipërm, është rreth masave dhe dimensioneve të ngas.kad. nr.... dhe masave e dimensioneve që përmban skica e ekspertit të gjeodezisë, që gjendet në shkresat e lëndës, për të gjitha këto rrethana dhe fakte relevante të sipër përmendura, nuk janë dhënë arsye përkatëse dhe nuk ka deklarim të saktë, të plotë e ligjor nga gjykatat e instancës më të ulët, e të cilat janë me rëndësi vendimtare për marrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit që kanë të bëjnë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanojë të metat e lartë cekura, t'i vlerësojë të gjitha provat dhe shkresat e lëndës duke i vënë në relacion krahasues dhe vlerësues, veç e veç dhe së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me qëllim që të vërtetojë të gjitha faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, të ketë parasysh edhe pretendimet tjera të revizionit, si dhe të ketë parasysh, po ashtu, përveç dispozitave të LPK-së, dhe ato të së drejtës materiale, edhe faktin se është zhvilluar apo jo procedurë jo kontestimore (pas trashëgimisë) rreth ndarjes së pasurisë së paluajtshme, përkatësisht, dispozitat e nenit 178.2 , nenit 180.1, nenit 179, nenit 200 të LPJ-së, etj, dhe pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

4. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Nga aktgjykimet e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë që kanë arritur në Gjykatën Supreme të Kosovës, e që disa prej tyre janë marrë si objekt shqyrtimi për nevojat e këtij punimi, vërehet se gjykatat e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë vlerësime të ndryshme sa i përket të drejtës së përfaqësimit në radhën e dytë të trashëgimisë. Gjykatat e shkallës së parë në raste të caktuara duke interpretuar vetëm dispozitën e nenit 14 par. 4 të LTK-së, kanë nxjerrë përfundime

se në rastet kur vdes trashëgimlënësi dhe nuk ka lënë pasardhës tërë masën trashëgimore e trashëgon bashkëshortja, pavarësisht faktit që trashëgimlënësi ka lënë prindër apo kur prindërit kanë vdekur para trashëgimlënës por që trashëgimlënësi ka vëllezër dhe motra apo edhe mbesa e nipa. Në këtë rast gjykatat nuk kanë marrë për bazë dispozitat nga nenet 15, 16, 17 të LTK-së, ku nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton qartë se edhe në radhën e dytë të trashëgimisë vjen në shprehje e drejta e përfaqësimit nëse ka trashëgimtarë sipas radhës përkatës dhe vetëm në rastin kur prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur pa lënë trashëgimtarë dhe përfaqësues që i përfaqësojnë trashëgimtarët e prindërve, atëherë e tërë pasuria trashëgohet nga bashkëshorti. Në këtë situatë kushti për ta trashëguar në radhën e dytë tërë pasurinë bashkëshorti është që në anën e prindërve të trashëgimlënësit të kenë vdekur prindërit dhe të njëjtit të mos kenë trashëgimtarë tjerë as sipas përfaqësimit.

Në kuadër të praktikës gjyqësore, vërehen rastet kur gjykata ja njohin të drejtën palës në një paluajthsmeri duke përdorë bazën e kontributit dhe atë të trashëgimisë. Në rastit Rev.nr.133/2021, datë 04.08.2022, referuar për nevojat e këtij punimi, shihet se gjykatat e shkallës më të ulët palës paditëse ia njohin të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese në dy baza, në bazë të kontributit dhe trashëgimisë. Gjykata Supreme në rastin e paraqitur ka vlerësuar se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i shkallës së dytë është i papranueshëm kjo pasi që mbi dy baza nuk mund të njihet e drejta e pronësisë dhe gjithashtu baza e kontributit dhe baza e trashëgimisë garojnë njëra me tjetrën, përkatësisht përjashtojnë njëra tjetrën. Nëse pala pretendon se pasuria e krijuar, e që është objekt i trashëgimisë është rezultat edhe i kontributit të saj, atëherë duhet të vërtetohet se cila është kjo pasuri dhe të veçohet nga masa e trashëgimisë, pasi nuk hynë fare në masën e trashëgimisë. Në masën trashëgimore hynë vetëm pasuria që është e trashëgimlënësit dhe pastaj çdo trashëgimtarë, varësisht nga radha e trashëgimisë, mund të kërkojë vërtetimin e pronësisë në pjesën që i takon e sipas bazës së trashëgimisë.

Në rastin e paraqitur rezulton se të dy gjykatat kanë përjashtuar përfaqësimin në radhën e dytë të trashëgimisë ngase kanë konstatuar se paditësja e trashëgon në tërësi masën trashëgimore të ndjerit – bashkëshortit, për faktin se gjatë jetës bashkëshortore paditësja dhe i ndjeri nuk kanë pasur fëmijë, ndërsa nuk merr për bazë faktin se trashëgimlënësi përveç bashkëshortes ka lënë edhe vëllezër dhe motra. Nga arsyetimi i aktgjykimeve të instancës më të ulët shihet qartë se nuk është vlerësuar kundërshtimi i të paditurve e as që është trajtuar vendosja në raport me të drejtën e

përfaqësimit në radhën e dytë të trashëgimisë. Kjo ka qenë edhe një nga arsye që Gjykata Supreme ka prish aktgjykimet e instancës më të ulët dhe ka kërkuar që ndarja e masës trashëgimore të bëhet në përputhje me rendet ligjore të trashëgimisë dhe sipas dispozitave të LTK-së.

Ndërsa në rastin paraqitur Rev.nr.342/2015, të datës 17.12.2015, shihet se gjykata e shkallës së parë ka pranuar trashëgimtarë të radhës së dytë sipas të drejtës së përfaqësimit, përkatësisht ka pranuar se vëllezërit – paditësit mund ta trashëgojnë vëllain e tyre të ndjerë - trashëgimlënësin pasi që trashëgimlënësi ka vdekur pa lenë pasardhëse dhe në rastin konkret të paditurës - bashkëshortes i takon gjysma e pasurisë sipas trashëgimisë në rendin e dytë ligjore, ndërsa prindërve të trashëgimlënësit do tu takonte gjysma në pjesë të barabarta, mirëpo meqenësë prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit atëherë pjesa që do tu takonte atyre u kalon vëllezërve dhe motrave të trashëgimlënësit, e në rastin konkret paditësve sipas të drejtës së përfaqësimi. Një përfundim të tillë e ka pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë, mirëpo këtë çështje nuk ka mundur ta trajtojë Gjykatën Supreme ngase për shkak të vlerës së kontestit revizioni është hedhur i palejuar.

Përkundër faktit që në praktikë gjyqësore ekzistojnë ende raste të tillë kur vihen dilema në lidhje me çështjen e përfaqësimit në radhën e dytë të trashëgimisë, duhet pas parasysh se për këtë çështje praktika gjyqësore e kësaj gjykate është treguar mjaftë e prerë duke i interpretuar dispozitat e nenit 15, 16 dhe 17, në atë mënyrë që edhe në radhën e dytë vjen në shprehje e drejta e përfaqësimit nëse ka trashëgimtarë sipas radhës përkatës dhe vetëm në rastin kur prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur pa lënë trashëgimtarë dhe përfaqësues që i përfaqësojnë trashëgimtarët e prindërve, atëherë e tërë pasuria trashëgohet nga bashkëshorti.

MUNGESA E ARSYETIMIT LIGJOR TË VENDIMEVE

1. Baza ligjore

Ligji i Procedurës Kontestimore me nenin 16.1 ka përcaktuar se: "*Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet ta ketë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit*" Ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është përcaktuar se: "*Arsyetimi i aktgjykimit përmban; kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato".*

Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykim mundet që ta refuzojë ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur *(neni 195.1, pika d) të LPK-së).* Ndërsa menenin 204 të LPK-së është përcaktuar se: "*Në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj"*. Me nenin 214 par.1 të LPK-së është përcaktuar se revizioni mund të paraqitet: a) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182. paragrafi 2 të këtij ligji, me përjashtim të shkeljeve të parapara në nenin 182 paragrafi 2 pikat (f,h,i dhe m).

2. Komentimi i shkurtër i dispozitave ligjore të cituara

Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke iu dhënë njëkohësisht mundësinë për ta kundërshtuar atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Meqë aktgjykimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të bëhet e mundur, duhet hartuar arsyetimi i vendimit në të cilin gjykata tregon me qartësi faktet, ligjin e zbatueshëm dhe arsyet që e kanë shtyrë për të vendosur në një mënyrë të caktuar ndërmjet disa mundësive.

Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit përveç se duhet të ndjekë secilin hapë në procesin e arsyetimit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ajo gjithashtu duhet të japë arsyetimin e saj edhe duke u fokusuar në kërkesat respektivisht pretendimet e palëve ndërgjyqësore.

Hapi i parë - paraqitja e kërkesave të palëve. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit që i referohet paraqitjes së kërkesave të palëve, gjykata duhet të paraqesë në mënyrë objektive kërkesat e palëve,

realisht secilën kërkesë dhe secilin pretendim, sepse nga kërkesat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqësore rrjedhë pastaj edhe epilogu i arsyetimit të aktgjykimit.

Hapi dytë - Paraqitja e fakteve dhe provave që i kanë propozuar palët. Ky hap i arsyetimit të aktgjykimit është tejet me rëndësi sepse mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga palët ndërgjyqësore, gjykata do të japë edhe vlerësimin për themelësinë e kërkesëpadisë.

Hapi tretë - Specifikimi se cilat nga faktet janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte. Në këtë hap të arsyetimit të aktgjykimit, gjykata specifikon se cilat fakte janë vërtetuar dhe rrjedhimisht jep arsyetimin se përse janë vërtetuar ato fakte. Sigurisht, për të vlerësuar se cilat fakte duhet të vërtetohen gjykata mbështetet në disa rrethana që kanë të bëjnë me natyrën e çështjes kontestuese, bazën juridike të cilës i është referuar pala, rrethanave kontestuese, etj. Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohen se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato. Gjykata në këtë hap të arsyetimit duhet të ketë edhe një vlerësim-arsyetim për vlerën provuese/fuqinë provuese të secilës provë të administruar dhe rrjedhimisht besueshmërinë e saj.

Hapi i katër- Dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit: Në pjesën e analizës për përfundimin e gjykatës lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë përveç hapave të tjerë të arsyetimit të përshkruar më lartë, pjesa e përshkrimit të dispozitave materialo-juridike për rastin konkret është tejet e rëndësishme, sepse përmes zbatimit të normës materiale do të përcaktohet nëse rrethanat faktike të çështjes kontestuese konsumojnë elementet e normës juridike për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar. Konsiderohet si pjesë qenësore e arsyetimit të aktgjykimit referenca e gjykatës në normën materialo-juridike, në të kundërt aktgjykimin do ta kualifikojë në shkelje për të cilat çështja kthehet në rishqyrtim.

Nëse gjykata e shkallës së dytë gjatë trajtimit të mjetit juridik konstaton se duhet vërtetuar vendimi i shkallës së parë, atëherë në arsyetim të vendimit duhet konstatuar se nuk ekzistojnë shkaqe ankimore për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkaqet për të cilat mund të goditet aktgjykimi. Në këtë rast gjykata e shkallës së dytë në arsyetim të aktgjykimit duhet të paraqes arsye të qarta për vlerësimet që i ka bërë në lidhje me pretendimet ankimore për shkelje të

dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale.

Mos arsyetimi i një vendimi meritor paraqet shkelje esenciale me rëndësi absolute të dispozitave të procedurës kontestimore, me ç 'rast vendimi në të gjitha rastet prishet nga gjykata me lartë dhe çështja kthehet në rigjykim (neni 182, par.2, shkronja n të LPK-së). Në rast se gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, mirëpo në arsyetim të aktgjykimit nuk ka vlerësuar pretendimet ankimore që kanë qenë vendimtare, atëherë vendimi i tillë anulohet nga Gjykata Supreme në bazë të pretendimeve të ngritura në revizion nga pala me interes dhe çështja kthehet në rigjykim (nenet 194, 204 dhe neni 214 par. 1), që ka përcaktuar se revizioni mund të paraqitet: a) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të këtij ligji, me përjashtim të shkeljeve të parapara në nenin 182 paragrafi 2 pikat (f,h,i dhe m).

3. Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjen e arsyetimit të aktgjykimit

- ***Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Rev.nr.234/2023, datë 02.08.2023***

Arsyetimi

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të drejtë dhe të ligjshëm ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2, pika n) të LPK-së, dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 204 të LPK-së, për çka aktgjykimet patjetër është dashtur të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët kanë dhënë arsye të paqarta dhe kundërthënëse në lidhje me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, përkatësisht konstatimit të mungesës së lidhjes kauzale shkak pasojë, pra lidhja e tillë kauzale mungon për shkak se paditësi nuk ka qenë prezent në automjetin e aksidentuar apo se lëndimet që janë evidentuar në raport

mjekësor dhe ekspertizë mjekësore nuk janë si pasojë e aksidentit. Këto janë dy situata të ndryshme për të cilat gjykatat është dashur të japin arsye të qarta.

Në lidhje me faktin se paditësi ka qenë apo jo në automjetin- minibusin në cilësinë e kondukterit ekzistojnë paqartësi dhe kundërthënie në mes konstatimeve të gjykatave dhe provave në shkresa të lëndës. Paditësi pretendon se ka qenë duke punuar dhe atë kondukter në minibusin e aksidentuar dhe se për këtë si provë ka propozuar shoferin e minibusit meqë nuk është evidentuar në raportin e policisë. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë ka refuzuar dëgjimin e shoferit, me arsyetim se vërtetimi apo jo i faktit që ai ka qenë prezent në automjet nuk vërteton se ai ka pësuar lëndime si pasojë e aksidentit në fjalë. Mirëpo kjo gjykatë vlerëson se një konstatim i tillë është në kundërshtim me provën tjetër, në këtë rast ekspertizën mjekësore në të cilën është konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime trupore dhe se nëse vërtetohet që ai ka qenë prezent në autobus mund të konkludohet se këto lëndime janë si pasojë e aksidentit. Pra përmes ekspertizës është vërtetuar se paditësi ka lëndime trupore, por që kjo është kushtëzuar me vërtetimin e faktit se paditësi ka qenë apo jo në automjet.

Nëse fakt vendimtar qenka fakti se paditësi ka qenë apo jo në minibus ditën e aksidentit, atëherë gjykata për këtë është dashur të jep arsye të qarta, por jo mungesën e lidhjes kauzale ta konstatoj duke u thirrë në atë që paditësi nuk ka qenë në automjet, ndërsa t'i anashkaloj provat si deklaratën e shoferit të minibusit ku paditësi ka punuar dhe deklaratën e policit i dëgjuar në këtë çështje që ka konstatuar se paditësi ka qenë në vendin e ngjarjes.

Përveç kësaj, është e paqartë se refuzimi është bërë për shkak se raporti i lëshuar nga QKMF, datë 19.12.2013 nuk është valid - nuk është evidentuar në librat e protokollit apo që kjo provë për gjykatën nuk ka qenë bindëse, pasi që ka vlerësime kundërthënëse në këtë aspekt. Nëse është dyshuar në raportin në fjalë, gjykata ka pasë mundësi që sipas detyrës zyrtare të kërkojë nga institucioni që e ka lëshuar të dhëna në lidhje me atë se a është lëshuar nga QKMF në Vushtrri, kush e ka lëshuar dhe arsyeja e lëshimit të këtij raporti. Gjykata nuk ka dhënë ndonjë vlerësim në lidhje me këtë provë por theksin e ka vënë te fakti që raporti nuk është protokolluar.

Kjo gjykatë vlerëson se të dy gjykatat e instancës më të ulët në kundërshtim me të drejtën materiale apo nenin 136 të LMD-së, kanë nxjerrë përfundimin për çështjen objekt shqyrtimi dhe gabimisht kanë nxjerr konkluzionin sa i përket lidhjes kauzale mes aksidentit dhe lëndimeve të paditësit,

duke u bazuar vetëm në raportin e policisë dhe në raportin e QKMF-së, datë 19.12.2013, me konstatim pa numër protokolli, ndërsa nuk kanë bërë përpjekje të merren me faktin se paditësi a ka qenë duke punuar në pozitën e konduktorit në Minibusin "Fiat" dhe se ditën e aksidentit a ka qenë i pranishëm, i cili fakt më së miri ka mundur të qartësohet nga deklarimi i shoferit të minibusit. Pastaj gjykata nuk ka marrë për bazë deklarimin e policit që ka theksuar se paditësi ka qenë atë ditë në vendin e ngjarjes dhe gjithashtu ekspertizën mjekësore ku është konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime trupore dhe se këto lëndime mund të kenë lidhje me aksidentin nëse vërtetohet se ai ka qenë pjesëmarrës në automjet.

Kjo gjykatë vlerëson se në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet t'i eliminoj shkeljet e tilla, fillimisht duhet të vërtetohet se paditësi a ka qenë pjesëmarrës në automjetin- minibus ashtu siç është pretenduar, a ka pësuar lëndime trupore dhe se lëndimet e pësuara a janë si pasojë e aksidentit në fjalë apo nga ndonjë arsye tjetër që nuk ka të bëjë me aksidentin (lidhja kauzale shkak - pasojë) dhe për këtë kryesisht apo sipas propozimit të palëve ta ftojë ekspertin e dëgjuar më herët për të dhënë sqarime apo plotësime në mendimin e tij, apo të caktohet nxjerra e provës së re me ekspertizë përkatëse, që pastaj mbi bazën e natyrës së lëndimit dhe pasojave, brenda kërkesave të padisë, të vendoset për lartësinë e dëmit sipas të gjitha kategorive të kërkuara.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktvendimi, Rev.nr.146/2023, datë 14.09.2023***

Arsyetimi

Gjykata Supreme vlerëson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e atakuar nuk ka dhënë arsye në lidhje me pretendimet ankimore të ngritura nga kundër paditësi. Nëse i referohemi çështjeve që janë ngritur nga pala kundërpaditëse në ankesën e saj, mund të shihet çartë që gjykata e shkallës së dytë vetëm në dispozitiv ka trajtuar ankesën ndërsa në arsyetim nuk ka asnjë arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë, as në aspektin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, aspektin e gjendjes faktike të vërtetuar si dhe në raport me pretendimin për aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Përfaqësuesi i palës kundërpaditëse në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë është thirr në shkelje esenciale të dispozitave procedurale nga neni 182.1, pika n) të LPK-së, ndërsa Gjykata e Apelit në raport më ketë pretendim vetëm ka konstatuar se: "*Aktgjykimi i goditur nuk ka*

të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, i qartë, nuk ka kontradiktë me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit, dhe në të ka arsye, përkatësisht janë dhënë arsye të mjaftuara dhe të qarta për faktet vendimtare". Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së dytë mbi bazën e formulimit të tillë nuk ka trajtuar ankesën e paraqitur nga kundërpaditësi - nuk ka vlerësuar pretendimin ankimor të sipër theksuar, ngase në këtë rast vetëm është konstatuar se nuk ekziston shkelja dhe është përsëritë formulimi i dispozitës, ndërsa nuk ka asnjë arsye në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar. Në ankesën e paraqitur janë ngritur një varg pretendimesh për shkelje esenciale, ndërsa gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë asnjë përgjigje edhe pse këtë e ka për obligim që ta bëjë ashtu siç është përcaktuar me nenin 204 të LPK-së.

Nëse pala në ankesë pretendon se nuk janë paraqitë arsye të qarta për faktet vendimtare, apo arsyet të cilat janë paraqitur janë kundërthënëse dhe në kundërshtim me provat e administruara, gjykata që vepron sipas ankesës ka për obligim që në vendimin e saj të identifikojë faktet vendimtare të çështjes, a janë paraqitë arsye për faktet vendimtare, si dhe a ekzistojnë kundërthënie mes atyre që janë thënë në arsyetim në raport me përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit dhe thënieve në procedurë. p.sh, në ankesën e paraqitur është atakuar vendimi i shkallës së parë edhe për faktin se është bazuar në deklaratat e dhëna në formë të shkruar nga dëshmitarët I.Z, B.Z dhe R.Z, përkatësisht pretendohet se këto prova nuk mund të merren për bazë në procedurë civile, shihet që gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për çështjen ka administruar këto prova dhe vendimin e ka mbështetur edhe mbi bazën e tyre, ndërsa Gjykata e Apelit ka pas për obligim që të jap përgjigje në raport me pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me këto prova. Pra, cila ka qenë rëndësia e këtyre provave në raport me çështjen, nxjerrja e tyre dhe vlerësimi a është bërë duke respektuar rregullat e parimit direkt ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 të LPK-së. Sipas këtij parimi, gjykata, me anë të shqisave personale, njihet me natyrën dhe përmbajtjen e mjeteve provuese dhe pa ndërmjetësimin e tjetërkujt, vendosë për vlerën provuese të tyre, si dhe merr vendim meritor të bazuar në materialin që ka grumbulluar vetë. Ky parim ka të bëjë me faktin se gjykata në gjykimin e çështjes civile duhet të jetë prezentë në dëgjimin e palëve, në marrjen e provave, si dëgjimi i dëshmitarëve, provave shkresore, etj.

Pala në ankesë është thirrë edhe në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.1 të LPK-së, duke paraqitur edhe arsye për shkeljet e pretenduara, mirëpo Gjykata e Apelit në

aktgjykimin e saj nuk ka dhënë asnjë arsye për pretendimet e tilla të paraqitura nga pala ankuese, përkatësisht kundërpaditësi.

Në raport me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e që është kontestuar nga përfaqësuesi i kundërpaditësit me ankesën e paraqitur, gjykata e shkallës së dytë në arsyetim të vendimit nuk ka paraqitur asnjë arsye në lidhje me faktet vendimtare, pastaj nuk ka arsye në lidhje me atë se a është vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë. Nuk mjafton që gjykata ankimore vetëm të konstatoj se: "*me vlerësim të drejtë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë në mënyrë bindëse dhe në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike relevante për marrjen e vendimit të drejtë në këtë çështje juridiko civile,* ngase nga ky konstatim nuk mund të kuptohet se me cilat prova cili fakt është vërtetuar, cili fakt ka qenë vendimtarë që kundërpaditësi të jetë bashkëpronar në 1/3 dhe jo pronar i vetëm i objektit, me cilat prova janë vërtetuar dhe cilat fakte kanë quar deri te përfundimi se edhe kundërtëpaditurit janë bashkëpronar të objektit.

Gjykata e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsye në raport me të drejtën materiale të aplikuar nga gjykata e shkallës së parë, pra nuk mund të kuptohet se cili është vlerësimi i kësaj gjykate në raport me pretendimet ankimore të ngritura nga pala kundërpaditëse e që kanë të bëjnë me aplikimin e të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë rast çështja e ngritur nga kundërpaditësi ka të bëjë me vërtetimin e të drejtës së pronësisë në objekt, gjykata e shkallës së parë ia ka njohur të drejtën e bashkëpronësisë me 1/3, mirëpo gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë asnjë vlerësim sa i përket dispozitave materiale që janë aplikuar nga gjykata e shkallës së parë, pra fitimi i bashkëpronësisë e jo i pronësisë siç ka kërkuar kundërpaditësi në çka mbështetet, cilat fakte kanë quar në një përfundim të tillë, cila është baza mbi të cilën kundërpaditësi dhe kundërtëpaditurit të jenë bashkëpronar të objektit.

Për shkak të shkeljeve të tilla Gjykata Supreme vlerëson se çështjen duhet ta kthejë në gjykatën e shkallës së dytë, kjo me qëllim që Gjykata e Apelit duke marrë për bazë ankesën e paraqitur nga i autorizuari i kundërpaditësit, t'i shqyrtoj të gjitha pretendimet ankimore dhe të jap arsye të qarta ashtu siç është përcaktuar me nenin 204 të LPK-së, dhe brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë e sipas nenit 194 të LPK-së. Duhet pasur parasysh se drejta për të pasur një vendim gjyqësor

të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

- ***Pjesë të shkëputura nga Aktvendimi, Rev.nr.50/2023, datë 12.05.2023.***

Arsyetimi

Gjykata Supreme vlerëson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e atakuar nuk ka dhënë arsye në lidhje me pretendimet ankimore të ngritura nga paditësja dhe pala e paditur. Nëse i referohemi çështjeve që janë ngritur nga pala paditëse në ankesën e saj, mund të shihet çartë që gjykata e shkallës së dytë vetëm në dispozitiv ka trajtuar ankesën ndërsa në arsyetim nuk ka asnjë arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë nga pala paditëse, as në aspektin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale si dhe as në aspektin e aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Pala paditëse ka ngritur çështjen e të drejtës në kompensim të dyfishtë të pagave sipas nenit 80 të Ligjit të Punës si dhe çështjen e kompensimit të kamatës, mirëpo Gjykata e Apelit nuk ka dhënë asnjë arsye për pretendimet e tilla, ndërsa në bazë të nenit 204 të LPK-së, gjykata e shkallës së dytë ka për obligim që t'i vlerësoj pretendimet ankimore të palëve të cilat kanë qenë vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

Përveç kësaj, nga arsyetimi i Gjykatës së Apelit rezulton se kjo gjykatë nuk ka trajtuar as pretendimet ankimore të palës së paditur në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë. Nuk mjafton që gjykata vetëm të konstatoj se nuk ekzistojnë këto shkelje dhe ta përsëritë formulimin e dispozitës, por është obligim që të paraqiten arsye të qarta në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar nga pala. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka trajtuar fare pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me ndryshimet organizative që janë bërë te e paditura, përkatësisht vendimet që janë marrë më herët e që i kanë parapri njoftimit dhe vendimit Nr...., datë 30.12.2016, për rëndësinë e këtyre vendimeve në këtë proces, a ka ndodhë vërtetë riorganizimi dhe si është vepruar në raport me pozitën e paditëses pas procesit të tillë. Duhet pasur parasysh se drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Për shkak të shkeljeve të tilla Gjykata Supreme vlerëson se çështjen duhet ta kthej në gjykatën e shkallës së dytë, kjo me qëllim që Gjykata e Apelit duke marrë për bazë ankesat e paraqitura nga

palët ndërgjygjëse, t'i shqyrtojë të gjitha pretendimet ankimore dhe të japë arsye të qarta ashtu siç është përcaktuar me nenin 204 të LPK-së dhe brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë e sipas nenit 194 të LPK-së.

4. Të gjeturat nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës

Nga praktika e Gjykatës Supreme janë të shpeshta rastet kur kjo gjykatë anulon aktgjykimin e shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë që ka lënë në fuqi atë të shkallës së parë, për faktin se të dy gjykatat kanë nxjerr përfundim për një çështja duke shkelur dispozitat e procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika, (n) e cila përcakton se: "nëse aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos nëse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye, apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit, për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit". Në rastin e paraqitur si referim aktvendimi, Rev.nr.234/2023, datë 02.08.2023, Gjykata Supreme ka identifikuar shkelje të dispozitave procedurale nga neni 182.2, pika n) të LPK-së, kjo pasi që gjykata e shkallës së parë për çështjen që ka qenë objekt shqyrtimi përkatësisht faktin vendimtarë se paditësi ka qenë apo jo në automjetin minibusin në cilësinë e kondukterit ekzistojnë paqartësi dhe kundërthënie në mes konstatimeve të gjykatave dhe provave në shkresa të lëndës, ndërsa e njëjta shkelje është bërë edhe gjykata e shkallë së dytë që ka pranuar përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa përkundër që pala në ankesë ka ngritur pretendim të tilla për shkelje procedurale, gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj nuk i ka vlerësuar pretendimet ankimore, përkatësisht nuk ka dhën arsye të qarta për to.

Në raste të tilla kur anulohen vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, një prej të metave kryesore të identifikuara është mos specifikimi i mënyrës së vërtetimit të secilit fakt vendimtar dhe mosdhënia e vlerësimeve për mënyrën se si janë vërtetuar faktet në kuptimin e besueshmërisë së mjetit provues të përdorur. Përveç pjesës që ka të bëjë më faktet e çështjes, provat e administruara, vlerësimin për faktet dhe provat, në praktikën gjyqësore vërehen të meta edhe sa i përket tregimit se cilat norma materialo-juridike janë përdorur për ta nxjerrë gjykata përfundimin e caktuar. Pastaj

ekzistojnë të meta që lidhen me arsyet e tregimit se si norma e caktuar materialo-juridike është zbatuar në kuptim të fakteve konkrete të çështjes kontestuese.

Në kuadër të praktikës gjyqësor të kësaj gjykate vërehen se janë në rritje rastet kur Gjykata Supreme anulon vetëm aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe rastin e kthen në rivendosje në gjykatën e shkallës së dytë. Në të dy rastet e referuara në shtjellimin e kësaj teme aktvendimi, Rev.nr.146/2023, datë 14.09.2023 dhe aktvendimi, Rev.nr.50/2023, datë 12.05.2023, Gjykata Supreme ka identifikuar shkelje nga gjykata e shkallës së dytë që ka vepruar sipas mjetit juridik-ankesës ngase referuar çështjeve që janë ngritur nga pala në ankesë mund të shihet çartë që gjykata e shkallës së dytë vetëm në dispozitiv ka trajtuar ankesën ndërsa në arsyetim nuk kanë dhën arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë, as në aspektin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, aspektin e gjendjes faktike të vërtetuar si dhe në raport me pretendimin për aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Në njërin nga rastet e paraqitura pala në ankesë është thirr në shkelje esenciale të dispozitave procedurale nga neni 182.1, pika n) të LPK-së, ndërsa pretendimin e tillë ankimor Gjykata e Apelit e ka vlerësuar me konstatimin e vetëm se: "*Aktgjykimi i goditur nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, i qartë, nuk ka kontradiktë me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit, dhe në të ka arsye, përkatësisht janë dhënë arsye të mjaftuara dhe të qarta për faktet vendimtare".* Nga praktika gjyqësore vërehet se janë në rritje rastet kur gjykata e shkallës së dytë vlerëson pretendimin ankimor vetëm mbi bazën e një konstatimi të tillë, pa dhën arsye të qarta për shkeljen konkrete të pretenduar nga pala ankuese. Në këtë rast Gjykata Supreme ka vlerësuar se gjykata e shkallës së dytë mbi bazën e formulimit të tillë nuk ka trajtuar ankesën e paraqitur nga kundërpaditësi, nuk ka vlerësuar pretendimin ankimor të sipër theksuar, ngase në këtë rast vetëm është konstatuar se nuk ekziston shkelja dhe është përsëritë formulimi i dispozitës, ndërsa nuk ka asnjë arsye në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar.

Gjykata Supreme ka vlerësuar se gjykata e shkallës së dytë nuk ka paraqitur arsye në vendimin e saj as në raport me pretendimet ankimore të paraqitur nga pala në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, duke mos pranuar si arsyetim të mjaftueshëm konstatimin se: "*me vlerësim të drejtë të provave të administruara, gjykata e shkallës*

së parë në mënyrë bindëse dhe në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike relevante për marrjen e vendimit të drejtë në këtë çështje juridiko civile" Është vlerësuar se nga ky konstatim nuk mund të kuptohet se me cilat prova cili fakt është vërtetuar, cili fakt ka qenë vendimtarë që kundër paditësi të jetë bashkëpronar në 1/3 dhe jo pronar i vetëm i objektit, me cilat prova janë vërtetuar dhe cilat fakte kanë quar deri te përfundimi se edhe kundër të paditurit janë bashkëpronar të objektit. Në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe në raport me të drejtën materiale, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së dytë nuk ka paraqitur arsye në lidhje me aplikimin e të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë, pretendim ankimor në të cilin është thirr pala apo për të cilin gjykata e shkallës së dytë është dashur të kujdeset sipas detyrës zyrtare. Nga rezulton se nuk mund të kuptohet nga arsyetimi i vendimit se cili është vlerësimi i kësaj gjykate në raport me të drejtën materiale të aplikuar nga gjykata e shkallës së parë.

Çështja e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është trajtuar në kuadër të jurisprudencës kushtetuese, ku është konsideruar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Lidhur me pamjaftueshmërinë e arsyetimit të vendimit nga gjykata, kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr.KI 89/13, ku gjykata ndër të tjera në këtë vendim ka konstatuar se: "*Ne këto rrethana, Gjykata Supreme, në rastin e parashtrueses, nuk i plotësoi detyrimet e saj sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së, për të dhënë mjaftueshëm arsyet e duhura për refuzimin e kërkesëpadisë së parashtrueses me revizion. Në bazë të fakteve dhe rrethanave tërësisht të ngjashme me ato të rastit të saj, parashtruesja e kërkesës në mënyrë legjitime mund të priste refuzimin e revizionit të ushtruar nga punëdhënësi i saj".*

Me çështjen e arsyetimit të vendimeve është marrë në vendimet saj edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku ndër të tjera është thënë se: "*Arsyetimi i aktgjykimit është një përbërës kyç i gjykimit të drejtë dhe është esencial për ndarjen e drejtësisë dhe është treguesi më i mirë që dëshmon se gjykatat i kanë të bazuara thëniet në vendimet e tyre. Funksion i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë (shih, Tatishvili kundër Rusisë, aktgjykimi i GJEDNJ-se, i 9 korrikut 2007, paragrafi 58. Dhe rastin Hirvisaari kundër Finlandes, me ndryshimet përkatëse, paragrafi 30, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 27 shtatorit 2001).*

KAPITULLI XI

PROCEDURA E CAKTIMIT TË EKSPERTIZËS DHE ZBATIMI ADEKUAT I LIGJIT TË PROCEDURËS KONTESTIMORE NGA GJYKATAT E INSTANCAVE MË TË ULTA

1. Puna e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me zbatimin adekuat të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në raport me procedurën për përcaktimin e ekspertizës.

Ekspertiza në procedurën kontestimore është një provë shumë e rëndësishme dhe shpesh e domosdoshme që duhet të realizohet, që njëkohësisht paraqet një veprim procedural shumë kompleks dhe delikat. Ligji për Procedurën Kontestimore i vitit 2008 (Ligji nr. 03/1-006), trajton në mënyrë specifike temën e ekspertizës në kuadër të kreut XXII-të, i cili i referohet provave dhe sigurimit të provave, nëpërmjet dispozitave të neneve 356 deri në 372. Formalisht, gjetjet dhe mendimi i ekspertit, qoftë në procedurën kontestimore, penale apo në përgjithësi, në çdo procedurë gjyqësore, vlerësohet si çdo provë sipas vlerësimit të lirë të gjykatës dhe bazuar në parimin e vlerësimit të lirë të provave. Megjithatë, në praktikë, kur bëhet fjalë për këtë lloj prove, kjo faktikisht nuk është gjithmonë kështu.

Gjyqtarët që nuk kanë njohuritë e nevojshme për çështjet e caktuara profesionale, të cilat nuk janë të karakterit juridik, janë të prirë që nganjëherë mekanikisht dhe apriori t'i pranojnë konstatimet dhe mendimet e ekspertëve.

Si rrjedhim, në rastet e tilla duket se edhe rezultati i procedurës, respektivisht në zgjidhjen e lëndës së tyre, 'gjykon' eksperti në vend të gjykatës.

Pavarësisht, se gjyqtarët nuk kanë njohuri të caktuara profesionale në fushën me të cilën merret eksperti, të njëjtit, do të duhej që në masën e nevojshme të shpreh gjithmonë edhe qëndrimin e duhur kritik karshi konstatimit dhe mendimit, dhe nëse shtrohet çështja e saktësisë së tij, t'i drejtohet mundësive ekzistuese procedurale, të tilla si e ekspertiza shtesë dhe plotësuese.

Shpesh ndodhë që nxjerrja e provave me ekspertizë është e panevojshme, gjë që çon në zvarritje të procedurës dhe ekspertiza të shtrenjta, për të kuptuar më pas se paraqitja e kësaj prove nuk ishte as e nevojshme, sepse kërkesëpadia nuk ishte e bazuar për disa arsye të tjera. Në praktikë

shpeshherë shpërfillen konstatimet dhe mendimet e ekspertëve të dhëna gjatë procedurës dhe përcaktohet një ekspert i dytë, pastaj ekspertiza i besohet ekspertit të tretë etj., dhe në këtë mënyrë krijohen shpenzime të mëdha dhe zgjatet kohëzgjatja e procedurës dhe gjendja faktike në lëndë bëhet më e ndërlikuar. Në rastet e sipërpërmendura nuk dihet nëse gjykata ka urdhëruar ekspertizë të re për shkak se ka dyshuar në saktësinë e gjetjeve dhe mendimit të parë, apo për shkak se ekspertët nuk janë sqaruar lidhur me faktet relevante, përkatësisht faktet vendimtare. Sipas dispozitave të nenit 357 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pala që propozon ekspertizën është e detyruar të tregojë objektin në propozim dhe të propozojë një person për ekspertizë, lidhur me nevojën e ekspertizës vendos gjykata në çdo rast konkret, pas kësaj, gjykata ia dorëzon këtë propozim palës kundërshtare me qëllim të sqarimit. Eksperti është i detyruar t'i përgjigjet thirrjes së gjykatës, të paraqes gjetjet dhe mendimin e tij me shkrim në përputhje me dispozitat e nenit 359, paragrafi 1 i LPK-së. Gjetjet japin të dhënat bazë lidhur me objektin e ekspertizës dhe gjendjen në shkresa të lëndës dhe provat e ofruara, ndërsa mendimi i ekspertit duhet të tregojë në bazë të cilave rregulla të profesionit, shkencës dhe aftësive eksperti ka arritur në përfundimin e tij.

Gjyqtari, gjatë ekzaminimit të ekspertit duhet të shënojë në procesverbal vetëm faktet thelbësore, si, vërejtjet që kanë theksuar palët, gjegjësisht përfaqësuesit e autorizuar të tyre dhe të tentojë që të gjitha paqartësitë që janë të pranishme në mendimin e palës, t’i mënjanoj në seancën e dhënë. Nëse gjykata konstaton se ekspertiza është e paqartë ose e paplotë ose ka dallime ndërmjet disa ekspertizave të punuara, atëherë gjykata mund të urdhërojë ekspertizën plotësuese në përputhje me dispozitat e nenit 366, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ose të urdhërojë ekspertizë të re në përputhje me dispozitat e nenit 369 paragrafi 2 të LPK-së. Gjykata duhet t'i kërkojë palës që kundërshton konstatimin e ekspertit të konkretizoj vërejtjet, do të thotë të shpjegojë pse i konsideron joprofesionale gjetjet e ekspertit. Eksperti, është personi i cili ka njohuri të duhura profesionale dhe si rregull i mundëson gjykatës të vërtetojë faktet që janë objekt i të provuarit, duke paraqitur ekspertizën e tij (konkludimin) të nxjerrë nga faktet e lëndës që i është vënë në dispozicion të tij. Nëse asnjëra palë nuk propozon ekspertizë, ose nëse nuk siguron shpenzimet për ekspertizë brenda afatit të dhënë, gjykata do të vendosë lidhur me të provuarit e faktit që do të kryhej me ekspertizë, duke zbatuar rregullat mbi barrën e të provuarit sipas dispozitave të nenit 319 par. 1 të LPK-së.

Ekspertizën, si rregull, e realizon një ekspert (neni 358, paragrafi 1 i LPK-së), dhe kur gjykata vlerëson se çështja është e ndërlikuar, mund të jenë dy ose më shumë ekspertë (neni 358, paragrafi 2 i LPK). Gjykata duhet tu mundësoj palëve që të deklarohen lidhur me përzgjedhjen e ekspertëve, sepse me këtë parandalon keqpërdorimin e kompetencave procedurale nga palët, për të kërkuar më vonë përjashtimin e ekspertëve në një situatë ku një ekspert i caktuar tashmë ka kryer ekspertizën, gjë që mund të qojë në zvarritje të procedurës kontestimore.

Gjykata do ta lirojë ekspertin, me kërkesën e tij, nga detyra e punimit të ekspertizës për arsyet për të cilat mund të mos ofroj dëshminë ose përgjigjen në përgjigjet e caktuara, gjykata mundet që ekspertin ta liroj nga detyra edhe për arsye tjera të justifikuara, (neni 359, paragrafët 2, 13, LPK), ndërsa përjashtimin nga detyra e ekspertizës mund ta kërkoj edhe personi i autorizuar i organit apo i institucionit ku eksperti është i punësuar (neni 359, par. 4 i LPK-së). Pala është e detyruar të paraqesë kërkesë për përjashtim tek ekspertit kur ka arsye për përjashtim, dhe më së voni para fillimit të nxjerrjes së provave me ekspertizë, në të njëjtën pala duhet të deklarojë edhe rrethanat në të cilat e mbështet kërkesën për përjashtim. Lidhur me kërkesën për përjashtim të ekspertit vendosë gjykata, (neni 360 paragrafi 2, 3, 14 i LKP-së), kurse kundër aktvendimit me të cilin aprovohet ose refuzohet kërkesa për përjashtimin e ekspertit, nuk lejohet ankesa (neni 360 par. 5 i LPK-së).

Është gjithmonë detyrë e gjykatës të ftojë një ekspert që para gjykatës të arsyetoj të gjeturat me me gojë dhe me shkrim, në përputhje me dispozitën të nenit 162 paragrafi 1 i LPK-së

Me rëndësi është të theksohet se gjykata duhet të analizojë gjetjet dhe mendimin e ekspertit, d.m.th. të arsyetojë në aktgjykim, me shënimin se eksperti nuk guxon të vendosë, pra të gjykojë në vend të gjykatës, gjykata nga ana e saj duhet kërkojë sqarimet e nevojshme, në mënyrë që me ndihmën e ekspertit të kuptojë natyrën dhe rëndësinë e fakteve të kontestuara. Objekt i ekspertizës nuk mund të jetë interpretimi dhe zbatimi i ligjit, madje edhe kur eksperti, në mendimin e tij lëshohet në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, mendimi i tij për këto çështje nuk është juridikisht i rëndësishëm. Gjyqtari duhet të paraqesë qëndrimin e gjykatës edhe kur ai qëndrim përkon me konstatimin dhe mendimin e ekspertit për një çështje juridike. Çdo ekspertizë ka specifikat e veta, të cilat duhet të dalin në pah gjatë hartimit të një aktvendimi për caktimin e ekspertizës. Gjykata është e detyruar t'i japë ekspertit një urdhër të saktë se në cilin drejtim duhet të kryejë ekspertizën dhe çfarë rrethanash duhet t'i kushtojë vëmendje, çfarë faktesh duhet të paraqesë dhe çfarë pyetjesh

duhet t'i përgjigjet. Kur merret një aktvendim me të cilin caktohet nxjerrja e provave në praktikë shpesh ekspertiza jepet në formë të përgjithësuar, sepse nuk përmban një objekt të precizuar dhe plotësisht të fokusuar të objektit të ekspertizës. Shpesh ekspertëve u jepet liria dhe u mundësohet shikimi i shkresave të lëndës ashtu që vet të vlerësojnë se çfarë është relevante i mundëson ekspertit të rishikoj shkresat e lëndës, të gjitha këto me qellim të dhënies së mendimit, dhe i cakton afatin deri kur duhet të dorëzoj gjetjet edhe mendimin e tij në formë të shkruar. Nëse eksperti ofron prova të paqarta, të paplota ose kontradiktore, gjykata do të urdhërojë ekspertin të plotësojë ekspertizën, dhe shpjegojë paqartësitë në gjetjet dhe mendimin e tji, dhe do ti caktoj afatin për mënjanimin e mangësive. Në rast se janë caktuar më shumë ekspertë, ata mund që paraqesin gjetjet dhe mendimin e tyre të përbashkët, dhe nëse gjetjet dhe mendimet e tyre nuk pajtohen, secili ekspert paraqet ndaras gjetjet e mendimet e tij. Nëse të dhënat e ekspertit kanë dallime thelbësore, ose të gjeturat e ekspertit janë të paqarta, të paplota ose kundërshtuese në raport me rrethanat e vërtetuara, dhe këto mangësi nuk mund të eliminohen me dëgjimin e serishëm të ekspertit, ose nëse ka dyshime për saktësinë e mendimit të dhënë - gjykata me propozimin e palës do të caktojë ekspertizë të re në pajtim me ligjin. Gjykata në seancë do t'i diskutojë vërejtjet dhe do të përpiqet t'i harmonizoj gjetjet dhe mendimet profesionale të ekspertëve, nëse në seancë nuk pajtohen të gjeturat dhe mendimet e ekspertëve, gjegjësisht nëse gjykata vlerëson se faktet vendimtare nuk janë sqaruar sa duhet, gjykata do të urdhërojë ekspertizën e re, të cilën do t'ia besojë një eksperti tjetër dhe për këtë do të njoftojë palët. Gjykata vlerëson çdo konstatim dhe mendim të ekspertit nga pikëpamja e logjikës, zbatueshmërisë së metodave të ekspertizës dhe zbatimit të standardit të personit mesatar, dhe vetë gjykata, sipas parimit të lirisë së vlerësimit gjyqësor të provave, vlerëson këtë prove. Në rastin e mospërputhjes së gjetjeve dhe mendimit, nuk duhet me automatizëm të caktohet ekspertiza e re, duhet bërë përpjekje që kontradiktat të largohen me dëgjimin, dhe vetëm më pas të përcaktohet ekspertiza e re. Në praktikë, ndodh që të përdoren gjetjet dhe mendimet e ekspertëve të dhëna në raste të tjera, respektivisht që gjykata pa pëlqimin e palëve ndërgjyqëse të shfrytëzoj, gjegjësisht t’i pranoj, me çka shkelin parimin e drejtpërdrejtë, sipas të cilit gjykata vendos për kërkesë padinë, në bazë të shqyrtimit gojor, të drejtpërdrejtë dhe publik dhe parimi i drejtpërdrejtë konstaton se aktgjykimi nuk mund të bazohet në prova që nuk janë paraqitur në seancën kryesore. Një provë e tillë nuk mund të përdoret pa pëlqimin e palëve.

2. Gjetjet nga praktika e Gjykatës Supreme

Vërtetimi i gjendjes faktike është baza e çdo procedure gjyqësore, ekspertët gjyqësorë luajnë një rol kyç në situatat kur duhet të vërtetohen fakte nga fusha profesionale dhe të analizohen çështje komplekse. Gjykatat ri-angazhojnë vazhdimisht ekspertë gjyqësorë me përvojë, të cilët prandaj janë të mbingarkuar me punë. Për shkak të kësaj ngarkese të madhe me lëndë, ekspertët vonohen në punimin e gjetjeve dhe opinioneve të tyre, duke shkaktuar kështu zvarritje të procedurave gjyqësore. Ekspertët gjyqësorë me më pak përvojë nuk kanë njohuri për nevojat e procedurave gjyqësore, kështu që gjetjet dhe mendimet e tyre janë të cilësisë më të ulët dhe gjyqtarët shmangin angazhimin e tyre. Duke qenë se nuk u jepet mundësia për t'u paraqitur para gjykatës, ata nuk kanë mundësi të fitojnë përvojën e nevojshme dhe mbeten në një rreth vicioz ku angazhohen rrallë ose madje kurrë. Gjyqtarët nuk shfrytëzojnë kompetencat që i kanë në dispozicion me ligj, me qëllim të menaxhimin e punës së ekspertëve gjyqësorë dhe për të siguruar mbarëvajtje të papenguar të gjykimit. Seancat gjyqësore shpesh shtyhen, ndërsa procedurat gjyqësore zvarriten për shkak të vonesës së ekspertëve gjyqësorë ose të palëve. Në fakt, eksperti gjyqësorë shumë shpesh tejkalon afatin për dorëzimin e gjetjeve dhe mendimit të tij. Një nga arsyet është se detyra e ekspertit është shumë shpesh e përcaktuar në mënyrë të paqartë, ose është shumë e gjerë dhe e pa precizuar mjaftueshëm. Gjyqtarët duhet të përdorin kompetencat e tyre procedurale në mënyrë që detyra e ekspertit të precizohet më qartë. Gjyqtarët duhet të jenë më të trajnuar për analizën e gjetjeve dhe mendimin e paraqitur të ekspertëve. Nuk duhet të caktohet marrja e provave përmes ekspertizës aty ku nuk është e domosdoshme. Nëse është e nevojshme, mund të shqyrtohet edhe mundësia e aprovimit e pikëpamjeve juridike të Gjykatës Supreme me të cilin do të qortoheshin rastet ku përdorimi i gjetjeve dhe mendimit të ekspertit është i pranueshëm si provë, dhe kur këto propozime të tilla të të provuarit nuk duhet të miratohen.

Gjykatat duhet të monitorojnë në mënyrë më cilësore punën e ekspertëve gjyqësorë. Duhet të zbatohen metoda të thjeshta për menaxhimin gjatë procesit gjyqësor për të përmirësuar efikasitetin dhe për të forcuar përgjegjësinë e ekspertëve gjyqësorë, si për shembull: (a) në aktvendimin për caktimin e ekspertizës, të specifikohet data e saktë për dorëzimin e gjetjeve dhe mendimit të ekspertëve; (b) shikimi më i shpeshtë i shkresave të lëndës jashtë seancës për të monitoruar ekzekutimin në kohë të të gjitha veprimeve procedurale; (c) monitorimin e respektimit të afateve dhe pranueshmërinë e justifikimeve për tejkalimin e tyre. Gjykatat dhe palët duhet të marrin

kompetenca më të mëdha për të përcjellë punën e ekspertëve gjyqësorë dhe për t'i sanksionuar ata, për shembull: gjykatat duhet të marrin kompetenca për të filluar procedurën kundër një eksperti gjyqësor apo edhe për ta shkarkuar atë. Në përputhje me dispozitat e nenit 362, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Kontestimore, gjykata mund ta dënojë ekspertin nëse nuk i përgjigjet thirrjes ose refuzon të dëshmojë pa arsye të justifikuar.

Kur duhet të caktohet një ekspertizë? Duke pasur parasysh praktikën e deritanishme gjyqësore, mund të vërehet se paraqitja e provave me ekspertizë caktohet më shpesh sesa është e nevojshme dhe se gjykatat jashtë mase mbështeten në punën e ekspertëve. Një nga arsyet për këtë është se te gjyqtarët e shkallës së parë ekziston ngurrimi se Gjykata e Apelit nuk do ta mbështesë vendimin e gjyqtarit të shkallës së parë, nëse nuk mbështetet nga gjetjet dhe mendimet e ekspertëve. Qëndrimi se ekspertiza përcaktohet shumë shpesh mund të jetë pasojë e angazhimit të tepërt të ekspertit në të ashtuquajtura lëndët "shabllon". Lëndët të cilat gjykata i quajnë në emër të përbashkët "shabllonë" janë ato në të cilat disa palë kanë kërkesa shumë të ngjashme ose identike, dhe në të cilat palë e paditur shumë shpesh është shteti, respektivisht organet shtetërore, ose kompanitë e sigurimeve sipas bazës së auto përgjegjësisë. Lëndët klasike "shabllon" janë paditë për kompensimin dëmit material dhe jo material si pasojë e aksidenteve në komunikacion, kontestet e punës për pagesën e pensioneve dhe të shpërblimit jubilar, si dhe kompensimi për pagesën e mëditjeve, etj. Duket se ekziston një numër i madh i lëndëve të tilla, ku ekspertiza rregullisht caktohet për gati të gjitha lëndët "shabllon".

Gjetjet dhe mendimet e paraqitura të ekspertëve shpeshherë i nënshtrohen ndryshimeve, përmes kërkesës së gjykatës për plotësimin ose korrigjimin e gjetjeve dhe opinioneve. Gjyqtarët shpesh japin detyra të paqarta, tepër të gjera apo edhe të gabuara për ekspertët ose nuk i kontrollojnë në mënyrë adekuate gjetjet dhe mendimet e paraqitura.

Një numër i konsiderueshëm i aktgjykimeve prishen sipas ankesave për shkak të mangësive në gjetjet dhe mendimet e ekspertit, pra nga procedura e ekspertizës.

Ekspertët gjyqësorë nuk respektojnë plotësisht afatet në procedurat gjyqësore, praktika e deritashme tregon se ekspertët shpesh vonojnë paraqitjen e gjetjeve dhe opinioneve, gjë që çon në vonesa në procedurat gjyqësore. Seancat ndonjëherë anulohen ose shtyhen për shkak të mungesës së ekspertëve, ose për arsye të tjera, që mund t'i atribuohen ekspertëve.

Si ekspertët ashtu edhe gjyqtarët duhet të organizojnë më mirë kohën kur palëve u jepet e drejta ti rishikojnë gjetjet dhe mendimet e ekspertit. Kjo praktikë çon në shtyrje të shpeshta të seancave, sepse palët kanë një arsye legjitime për t'i kërkuar gjykatës shtyrjen e seancës në mënyrë që ata të mund të shqyrtojnë gjetjet dhe opinionin dhe të sqarohen lidhur me gjetjet.

Ekspertit i jepet e gjithë shkresa e lëndës për këqyrje jashtë gjykatës, gjë që paraqet problem si nga aspekti i efikasitetit ashtu edhe nga integriteti i procedurës. Gjatë procedurës, gjykata mban një dosje të vetme të lëndës që përmban ekzemplarët origjinale të të gjitha dokumenteve. Nëse caktohet nxjerrja e provave me ekspertizë, gjykata fton ekspertin që të marrë dosjen e çështjes nga gjykata, ta shqyrtojë dhe ta kthejë pas përfundimit të ekspertizës. Lejimi i largimit të dosjes së çështjes nga gjykata bën të mundur ndryshimet e palejueshme në përmbajtjen e dosjes ose, të paktën, krijon perceptimin se kjo është e lehtë. Gjithashtu, kjo praktikë shpeshherë ndikon negativisht në efikasitet, sepse nuk mund të kryhet asnjë veprim tjetër në procedurë derisa eksperti të ketë kryer ekspertizën dhe ta kthejë dosjen në gjykatë.

3. Referim në shpjegimet e vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

- ***Pjesë të shkëputura nga*** **aktvendimi Ac.nr. 117/2023 datë 10.05.2023**

Arsyetimi

Duke marrë parasysh shkresat e plota të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka vërtetuar se eksperti i fushës së financave ka përpiluar gjetjet dhe mendimin e tij më datën 28.06.2017, në të cilën ka vërtetuar se paditësja ka të drejtën e bashkëpronësisë mbi banesën lëndore me ½ të pjesës, se i njëjti është deklaruar dhe i është përgjigjur pyetjeve të gjykatës dhe palëve më datë 19.12.2017. Në vitin 2008, përfaqësuesi i autorizuar i të padituri në atë seancë të mbajtur ka theksuar vërejtjet lidhur me ekspertizën e punuar, kështu që me propozimin e tij është bërë një ekspertizë e re nga një grup ekspertësh të financave më datën 30,05.2018, në të cilën kanë konstatuar se paditësja ka të drejtën e bashkëpronësisë në banesën lëndore në ¼ të pjesës ideale. Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se grupi i ekspertëve financiarë i caktuar nga gjykata nuk kishte marrë pjesë në seancën gjyqësore të mbajtur më 03.07.2018, ndërsa i autorizuari i paditëses ka paraqiutur vërejtjet ndaj gjetjeve dhe mendimit të tyre. Në rastin konkret, mendimi i ekspertit nuk është marrë sipas rregullave të Ligjit të Procedurës kontestimore, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka pasur

obligimin që sipas detyrës zyrtare saktë të konstatoj gjendjen faktike, duke ofruar provuar me leximin e gjetjeve dhe mendimit të ekspertit, si dhe përmes dëgjimit të ekspertëve, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitën e nenit 362 par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore, ku përcaktohet se eksperti gjithmonë ftohet në seancën e shqyrtimit kryesor. Me nenin 366, paragrafi 1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore, parashihet që ,citohet: " Kur shihet se ekspertimi është i mangët ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjërës nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese. Në rast të këtillë ekspertit i caktohet një afat brenda të cilit duhet të dorëzohet konstatimi dhemendimi me shkrim". Më pas, me dispozitën e nenit 369, paragrafët 1 dhe 2 të ligjit përkatës, parashihet që, citohet: "Kur janë caktuar më tepër se një ekspert, të gjithë ata mund ta paraqesin konstatimin dhe mendimin e përbashkët po që se nuk ka dallime midis tyre. Në qoftë se ekzistojnë dallime në konstatimet dhe mendimet e tyre, atëherë secili nga ta paraqet konstatim dhe mendim te veçantë. 369.2 Në qoftë se të dhënat e ekspertëve në konstatimin e ekspertëve dallohen esencialisht, apo nëse konstatimi i tyre është i paqartë, jo i plotë apo kontradiktor me vete veten apo me rrethanat e shqyrtuara, e këto të meta nuk mund të evitohen me dëgjimin e përsëritur të ekspertëve, do të përsëritet ekspertimi me ekspertë të njëjtë apo me ekspertë të tjerë". Për Gjykatën Supreme të Kosovës, ngelet e paqartë se sa është realisht pjesa e bashkëpronësisë së paditëses mbi banesën lëndore në bazë të kontributit martesor.

Detyra e gjykatës së shkallës së parë ishte të vepronte në përputhje me dispozitën e nenit 438, paragrafi 1, pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të shtyj seancën, të caktonte një seancë të re dhe të ftonte të gjithë ekspertët financiarë që të marrin pjesë në seancën e radhës, sepse kjo është e nevojshme për marrjen e një vendimi legjitim.

Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se aktgjykimet e instancës më të ulët duhet të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Në procedurën e përsëritur, gjykata e shkallës së parë do të caktojë seancën, do të ftojë të gjithë ekspertët e fushës së financave të caktuar nga gjykata për të shprehur mendimet e tyre në lidhje me gjetjet e bëra, për t'iu përgjigjur pyetjeve të gjykatës dhe palëve në procedure, nëse është e nevojshme të urdhërohet ekspertiza plotësuese dhe pas kësaj do t'i vërtetojë në mënyrë të padyshimtë të gjitha pyetjet apo faktet e lartpërmendura. Do të vërtetohen poashtu edhe fakte të

tjera trelevante, dhe në një gjendje të tillë të vërtetuar faktike do të zbatoj në mënyrë të duhur të drejtën material dhe të marrë një vendim të drejtë dhe ligjor.

4. Puna e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me zbatimin adekuat të Ligjit për procedurën kontestimore, në raport me procedurën e shqyrtimit paraprak të padisë.

Seanca përgatitore në procedurën kontestimore në Kosovë ka ekzistuar për disa dekada, por praktika e deritanishme gjyqësore ka treguar se seanca përgatitore akoma nuk e ka arritur funksionin e saj themelor për përshpejtimin dhe përqendrimit të procedurës kontestimore. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me një qasje graduale dhe disi sipërfaqësore (të redaktuar) dhe jo të plotë ndaj reformave të zbatuara, por edhe me të kuptuarit jo të drejtë të domethënies së kësaj faze të veçantë në praktikën gjyqësore, domethënë kuptimit të disa detyrave të caktuara që pritet të ndërmerren. Qëllimi i këtij punimi është që gjyqtarët e Gjykatës Supreme të japin rekomandime se si shqyrtimi paraprak, përkatësisht shqyrtimi i padisë, si një nga fazat e procedurës në kuadër të seancës përgatitore, të bëhet sa më efikas.

Ligji për Procedurën kontestimore i vitit 2008 (Ligji nr. 03/L-006) njeh shqyrtimin paraprak të padisë, e cila duhet të jetë një fazë e veçantë përgatitore në kuadër të seancës përgatitore, respektivisht në kuadër të procedurës të shkallës së parë, e cila tregon se qëllimi evident i ligjvënësit ishte që futja e një faze të tillë të përshpejtonte dhe përqendronte procedurën.

Zbatimi më efikas i shqyrtimit paraprak të padisë është thelbësorë për procedurën në tërësi, praktika gjyqësore dhe përvoja e deritashme kanë treguar se koha shtesë e investuar në fazat më të hershme të procedurës mund të shkurtojë kohëzgjatjen e saj në rrjedhën e mëtejshme të procedurës, dhe më pas edhe të kohëzgjatjes s saj në përgjithësi. Qëllimi i shqyrtimit paraprak të padisë është arritja e tri gjërave:

a) të përfundojë kontestin ose procedurën në fazën më të hershme të procedurës, kur nuk janë plotësuar të gjitha kushtet procedurale, d.m.th kur, për shkak të dispozicionit (veprimeve dhe lëshimeve (mosveprimeve)) të palëve, tashmë ekzistojnë kushte për vendimmarrje meritore;

b) më pas të tentohet të arrihet zgjidhje paqësore e kontestit në ato lëndë kur kjo është një metodë më e përshtatshme për zgjidhjen e kontesteve sesa zhvillimi i procedurës kontestimore;

c) dhe së fundi, në ato raste kur përfundimi i kontestit nuk është i mundur as me zgjidhjen paqësore të kontestit, të përcaktohet qartë objekti i kontestit dhe objekti i shqyrtimit, të planifikohet dhe kontrollohet mbledhja e materialit procedural, si dhe të caktohet mënyra dhe rrjedha kohore e shqyrtimit në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, respektivisht të lëndës.

Shqyrtimi paraprak, respektivisht shqyrtimi i padisë shërben për të shqyrtuar ekzistencën e supozimeve themelore procedurale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, në mungesë të të cilave nuk lejohet mbajtja e procedurës kontestimore, Disa nga ato supozime për gjykatën janë të përgjithshme, sepse ato duhet të ekzistojnë në çdo procedurë kontestimore, siç është rasti me: paanshmërinë e gjykatës (neni 67 i Ligjit për Procedurën Kontestimore): juridiksioni gjyqësor absolut (neni 17 i LPK-së.), dhe juridiksionin relative (neni 19, 201 22 i LPK-së); përbërjen e gjykatës (neni 15 i LPK-së): në zhvillimin e procedurës sipas rregullave të procedurës kontestimore (neni 1 dhe 12 i LPK-së); kuptueshmëria dhe plotësia e kërkesës (neni 253 i LPK-së); zotësia e palës për të qenë pale në procedure kontestimore, si dhe rregullsia e përfaqësimit të palëve (nenet 73, 74 dhe 76 të LPK-së). Ligji për procedurën kontestimore me dispozitat e nenit 253, paragrafi 1, pikat a), b), c), d), e) dhe) parashikon përmbajtjen e padisë. Padia duhet të përmbajë:

- një kërkesë e caktuar në lidhje me kërkesat kryesore dhe dytësore,
- faktet mbi të cilat paditësi e mbështet kërkesën e tij;
- provat që vërtetojnë faktet e dhëna,
- vlerën e kontestit;
- bazën ligjore; dhe
- informacionet tjera që duhet të përmbajë çdo parashtresë (neni 99 i këtij ligji).

Ligji për procedurën kontestimore përmes dispozitave të nenit 391, përcakton se cilat janë pengesat procedurale, përkatësisht arsyet për të cilat gjykata detyrohet ta hedhë poshtë padinë si të palejueshme, për arsyet si më poshtë:

• Mungesa e juridiksionit të gjykatës • paafatshmëria e padisë • Rrjedha e procedurës kontestimore • Çështje e gjykuar/ujdi gjyqësore • Mungesa e interesit juridik e paditësit parashtrim të padisë për vërtetim • Pengesat procedurale që nuk mënjanohen brenda afati (mangësitë formale të padisë,

përfaqësimi ligjor). Gjithashtu, me dispozitën e nenit 280 të LPK-së, ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e shtyrjes së vendosjes lidhur me pengesat procedurale, si në situatën në vijim: Nëse konsideron se nuk ka bazë të mjaftueshme për të marrë vendim për një çështje që ka lindur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, gjyqtari do t'ia lë që të vendosë për këtë çështje pas marrjes së përgjigjes ndaj padisë ose në seancën përgatitore, përkatësisht në seancën për shqyrtimin kryesor, në rast se seanca përgatitore nuk është mbajtur.

- Të dhëna të tjera që çdo parashtresë, përfshirë edhe padinë, duhet të përmbajë në përputhje me dispozitat e nenit 99, paragrafi 2 të LPK, janë: emri i gjykatës (përfshirë departamentin, me përjashtim të rasteve kur padia është ngritur në një degë të një gjykate ku në vend të departamentit shënohet emri i degës së gjykatës themelore).
- - emri dhe mbiemri (i personit fizik), dhe në rastin e personit juridik, emri i personit juridik: vendbanimi ose qëndrimi (i personit fizik), dhe në rastin e një personi juridik (selia e një personi juridik) të palëve;
- -vendbanimi ose vendbanimi i përfaqësuesve ose përfaqësuesve ligjorë (nëse palët kanë përfaqësues ligjor);
- objektin e kontestit;
- përmbajtjen e deklaratës; dhe
- nënshkrimin e parashtruesit të kërkesës.

Në rastet kur parashtresa nuk përmban elementet e përcaktuara me ligj, dispozita e nenit 102, par. 1 të LPK-së parashikon si më poshtë, citohet: *" Kur një parashtresë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtresën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhe treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës". Ndërsa dispozita e nenit 390 të LPK-së, parasheh si vijon, citohet: "Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta inicioj procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmerr masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji).*

Në rast të mosveprimit në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar në dispozitën e cituar, pala i nënshtrohet pasojave juridike të parashikuara në dispozitën e nenit 102, paragrafi 3 të LPK-së, i cili thotë, citohet: " 3. Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë". Së fundi, edhe çështja e taksave gjyqësore të paguara ose të papaguara është një kriter që trajtohet si prezumim procedural, duke pasur parasysh se dispozitat e nenit 253, paragrafi 4.1, 253, paragrafi 5, parashikojnë pasojat në rast të mos pagesës së taksave. Bazuar në këtë që u parashtrua më lartë, shohim se LPK dhe praktika gjyqësore janë mjaft të qarta në këtë pjesë, që do thotë se padia gjithmonë duhet kthyer për plotësim kur i mungojnë elementet që duhet ti përmbaj padia, si dhe çdo parashtrim tjetër (dispozita e nenit 99, paragrafi 2 i LPK-së.

Sa i përket kërkesave të caktuara nga pikëpamja e çështjes kryesore dhe kërkesave dytësore, edhe LPK-së, edhe praktika gjyqësore janë në harmoni të plotë dhe si pengesë formale e konsiderojnë mos precizimin e padisë.

Në këtë kontakt duhet theksuar se në rast se gjyqtari rastit konstaton se padisë i mungon elementi i precizimit të padisë, i njëjti ka për detyrim që padinë ta kthej në plotësim/korrigjim në pajtim me dispozitën e nenit 102, par. 1 të LPK-së. Me rëndësi është të theksohet se praktika gjyqësore, kur bëhet fjalë për këtë element të padisë, është më formale në raport me vet LPK-në, pasi që LPK nuk precizon formalisht se kërkesëpadia duhet formuluar në një mënyrë të caktuar, përderisa praktika gjyqësore kërkon që ky element i padisë të marrë formën e petitiumit, i cili në fakt paraqet propozimin e përmbajtjes së dispozitivit të vendimit meritor.

Kjo mënyrë e të vepruarit në praktikën gjyqësore i përgjigjet logjikës së procedurës gjyqësore civile, pasi nuk diskutohet se procedura kontestimore inicohet me synimin që gjykata t'i ofrojë paditësit mbrojtjen gjyqësore të përmbajtës së caktuar.

Në përputhje me dispozitën e nenit 253, pika 1, pika b) të LPK-së, mund të konkludohet se faktet mbi të cilat paditësi mbështet kërkesën e tij përfaqësojnë një nga elementët e domosdoshme të padisë. Dispozita e nenit 99, par. 2, ndër të tjera, parasheh që parashtresa duhet të përmbajë deklaratë, ndërsa paragrafi 3, neni 99 parasheh si në vijim: *"Në qoftë se deklarata përmban ndonjë kërkesë, pala duhet në parashtresë t'i tregoj faktet mbi të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat kur është nevoja për një gjë të këtillë".*

Në përputhje me dispozitën e nenit 253, paragrafi 1, pika c) të LPK-së, mund të konkludojmë se provat mbi të cilat paditësi themelon kërkesën e tij përfaqësojnë një nga elementët e domosdoshëm të padisë, mirëpo, në praktikën gjyqësore, gjykatat janë mjaftueshëm të kujdesshme kur flasim për paraqitjen e provave si elemente të domosdoshme të padisë. Në fakt, kur flasim për provat si elementë të padisë, nëse i referohemi dispozitave të LPK-së nga neni 102 paragrafi 1, neni 99 pika 2 dhe 3, mund të konstatojmë se paditësi është i detyruar të paraqesë prova në padi, ndërkohë që praktika gjyqësore është mjaft e qartë në lidhje me këtë situatë, si dhe mbizotëron mendimi se edhe pse në padi nuk është paraqitur asnjë provë, ajo duhet konsideruar e rregullt dhe duhet qasur procesit të vendimmarrjes meritore. Arsye për këtë është fakti se edhe në mungesë të provave mund të nxjerrët aktgjykimi në bazë të pranimit, por në fund të fundit mund të vendoset në mënyrë meritore me hedhjen poshtë të kërkesës si të pabazuar, që do të thotë se gjykata nuk duhet të zbatoj procedurën e korrigjimit të padisë për shkak të mungesës së provave.

Dispozita e nenit 253 par. 1 pika d) e LPK-së, parashikon që padia duhet të përfshijë edhe vlerën e objektit të kontestit, por kjo në praktiken gjyqësore nuk konsiderohet si element i domosdoshëm, pa të cilin nuk mund të zhvillohet procesi gjyqësorë. Në rast se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e kontestit në padi, ose nëse për vlerën e dhënë ka paraqitur shumën që është shumë e ulët ose shumë e lartë, gjykata sipas detyrës zyrtare ose sipas kundërshtimit të palës së paditur, dhe atë më së voni në seancën përgatitore, dhe nëse e njëjta nuk është mbajtur, atëherë në seancën e shqyrtimit kryesor, por para se të filloj shqyrtimi, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme përcakton vlerën objektit të kontestit. Vlera e objektit të kontestit është e rëndësishme, pasi në varësi të vlerës, përcaktohet nëse pala mund të ushtroj revizion kundër aktgjykimit/aktvendimit. Në varësi të vlerës përcaktohet edhe taksa gjyqësore, si dhe shuma e shpenzimeve të përfaqësimit në rast se për përfaqësuesin angazhohet avokat. Dispozita e nenit 253 paragrafi 3 i LPK-së, parashikon si në vijim, citohet: “Gjykata do të veprojë sipas padisë edhe kur paditësi nuk e ka treguar bazën juridike të kërkesëpadisë.” Nga kjo dispozitë arrihet në përfundimin se baza juridike është element fakultativ i padisë pa të cilin zhvillohet i gjithë procesi gjyqësor. Rëndësia e bazës juridike si element i padisë është evidente pasi përcaktimi i bazës juridike mbi të cilën paditësi ka bërë cilësimin juridik të fakteve i ndihmon gjykatës për drejtimin e pjesës provuese të procedurës.

Së fundi duhet theksuar si në vijim: për ekzistimin e prezumimeve procedurale gjithmonë duhet vendosur menjëherë, mirëpo, nganjëherë për verifikimin e ekzistimit të disa prezumimeve

procedurale, është e nevojshme të gjykata të ketë qasjen/shikimin e plotë në argumentimin e palëve, dhe atë në argumentimin e të paditurit në përgjigjën ndaj padisë, mbase edhe sqarimet në seancën përgatitore.

5. Gjetjet nga praktika e Gjykatës Supreme

Kur flasim për shqyrtimin paraprak të padisë, vetëm nga pikëpamja e rregullsisë së saj formale, në praktikën gjyqësore hasen shumë probleme dhe mënyra të ndryshme të procedimit si nga gjykatat themelore ashtu edhe nga Gjykata e Apelit në Kosovë. Ka raste kur çështja shqyrtohet sipas revizionit, ku Gjykata Supreme konstaton të meta formale në padi, të cilat duhet të ishin eliminuar në fazën e procedurës së shkallës së dytë sipas ankesës, ose në fazën e procedurës së shkallës së parë, të shqyrtimit paraprak të padisë. Përveç kësaj, vërehen edhe mangësi në zbatimin e dispozitave lidhur me kthimin e padisë në plotësim. Disa gjykata nuk arrijnë që në aktvendimin me të cilin padia kthehet në plotësim të përcaktojnë qartë detyrimin e plotësimit të mangësisë së identifikuar dhe të ofrojnë njoftim lidhur me pasojat në rast të mosveprimit. Prandaj, ka raste kur padia kthehet në plotësim për tu precizuar kërkesë padia, pa kurrfarë indikacionesh për plotësimet që duhet bërë. Në ato raste ku padia nuk është kthyer në plotësim në fazën e shqyrtimit paraprak, por ndodh në fazat e tjera të procedurës, paraqitet edhe një mënyrë e kthimit të padisë për plotësim që nuk përputhet me dispozitat ligjore. Gjykatat zakonisht shënojnë në procesverbal se padia kthehet për plotësim, pa specifikuar saktësisht se çfarë duhet të plotësohet dhe rrjedhimisht edhe pa informatën lidhur me pasojat e mospërmbushjes së këtij detyrimi. Kjo mënyrë e kthimit të padisë për plotësim, përmes një konstatimi të thjeshtë këtij në procesverbal, nuk mund të pranohet si i rregullt. Detyrim i gjykatës është që të përpilojë një aktvendim të veçantë ku do të kërkojë mënjanimin e mangësive formale.

Një situatë tjetër e papranueshme që paraqitet në praktikë është se gjykata e shkallës së parë kërkon plotësimin e padisë me provat e propozuara dhe dorëzimin e provave, të cilat pala nuk i ka deklaruar fare në përmbajtje të padisë. Kjo mënyrë procedimi nuk mund të pranohet si e drejtë për disa arsye: fillimisht, është në diskrecionin e palëve që të paraqesin prova të propozuara në lidhje me vërtetimin e fakteve vendimtare dhe më pas, ligjërisht, palët kanë të drejtën për të bërë propozimet e tyre rreth sigurimit të provave edhe në seancën përgatitore. Për më tepër, procedura mund të përfundojë meritorisht, edhe nëse palët nuk paraqesin propozimet e duhura për sigurimin e provave. Në një rast të tillë kur nuk paraqiten prova, gjykata e hedhë poshtë si të pabazuar

kërkesëpadinë, gjë që do të mundësoj nxjerrjen e vendimit meritor lidhur me besueshmërinë e kërkesëpadisë.

Ligji aktual për Procedurën Kontestimore ka kompetenca të shumta që i mundësojnë gjykatës të zhvillojë në mënyrë efektive seancat përgatitore, megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme që palët dhe përfaqësuesit e tyre të ndihmojnë gjykatën në këtë detyrë.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktvendimi Ac.nr. 34/2023 datë 24.04.2023***

A r s y e t i m i

Më 26 korrik 2010, përfaqësuesja e autorizuar B.B, dorëzon një parashtresë me shkrim me të cilin për shkak të ekzistimit të interesat juridik kërkon njoftim lidhur me statusin e procedurës kontestimore numër: C.nr.412/08. Më datën 03.01.2014 gjyqtari i rastit ka mbajtur seancën shqyrtimin, ku kanë marrë pjesë i autorizuari i paditësve, i autorizuari i të padituës dhe i autorizuari i B.B, numri i lëndës është C.nr. 421/11, sipas të njëjtës është nxjerrë aktvendimi me të cilin aprovohet kërkesa e B.B, se është paditëse dhe ndërhyrëse kryesore në lëndë. I autorizuari i ndërhyrëses kryesore, B.B, ka bërë precizimin subjektiv dhe objektiv të kërkesë padisë për disa herë, ka parashtruar disa kërkesa me shkrim, ka propozuar lëshimin e masës së përkohshme ashtu që gjyqtari i rastit më datën 25.04. 2017 nën numrin C.nr. 421/11, caktoi seancën ku si paditës paraqitet B.B, kurse si e paditur : F.Q dhe të padituri, citohet; "të padituri II, III, IV, V dhe VI". Gjykata Supreme e Kosovës udhëzon në dispozitën e nenit 273 paragrafit 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku thuhet se me pëlqimin e të dy palëve ndërgjyqëse personi i tretë që ka ndërhyrë në gjykim mund të zërë vendin e palës për të cilën ka ndërhyrë dhe kjo e fundit të dalë jashtë gjykimi me pëlqimin e të dy palëve ndërgjyqëse, në vend të palës në anën e së cilës është, mund ta zërë palën e tretë që është ndërhyrës në kontest. si ndërhyrës dhe që kjo palë të dalë nga gjykimi ose procesi gjyqësor. Për Gjykatën Supreme të Kosovës mbetet e paqartë nëse në rastin konkret se a ka pasur sukcesion procedural, gjegjësisht nëse ndërhyrësi e ka zënë vendin e paditësit, nëse po, kur dhe në çfarë mënyre.

Për Gjykatën Supreme mbetet absolutisht e paqartë se çfarë ka ndodhur me numrin e lëndës: C.nr.412/08, si është krijuar numri i ri i lëndës: C. nr.421/08, kush janë paditësit dhe cilët janë të padituri, dhe në anën e kujt është B.B - ndërhyrësja kryesore në kontestin e rastit konkret. Është

e paqartë se cili është objekti i kontestit, gjykata e shkallës së parë ka urdhëruar ekspertizë nga ekspertët përkatës, ka bërë inspektim në vend, në shkresat e lëndës janë dy histori të lëshuara me kërkesë të B.B, të njëjtat nuk janë mjaftueshëm të qarta, kështu që mbetet e paqartë pse gjykata e shkallës së parë nuk ka kërkuar zyrtarisht nxjerrjen e historikut dhe as nuk ka ftuar zyrtarët që kanë nxjerrë historitë e mëparshme për të sqaruar dyshimet dhe paqartësitë. Në rastin në fjalë, ndërhyrësja ka propozuar që gjykata t'i lejojë saj të marrë pjesë ose të ndërhyjë në rast si ndërhyrës, duke deklaruar se është pronare e ngastrës kadastrale lëndore, e cila përndryshe është pronë e të paditurës këtu. Sipas dispozitës së nenit 271 nënparagrafi 1 i Ligjit të Procedurës Civile, personi i cili ka interes juridik për suksesin e njërës palë në një proces gjyqësor ndërmjet palëve të tjera mund t'i bashkohet asaj padi si paditës ose si i paditur. Është e rëndësishme që ai të ketë një interes ligjor që pala me të cilën u bashkua të ketë sukses në mosmarrëveshje. Interesi ekziston kur të drejtat dhe detyrimet e ndërhyrësit varen nga rezultati i procedurës. Në rastin konkret ndërhyrësi nuk ka treguar se kujt i bashkohej, paditësit, rivalëve këtu, apo të padituri? Gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar që të urdhërojë avokatin e ndërhyrëses që të plotësojë deklaratën për bashkimin ose ndërhyrjen në kontest dhe më pas të veprojë në pajtim me dispozitat e nenit 387 paragrafi I pika f) të Ligjit për Procedurën Civile.

Në rastin në fjalë, ndërhyrësja ka propozuar që gjykata t'i lejojë asaj të marrë pjesë ose të ndërhyjë në proces në cilësinë e ndërhyrësit, duke deklaruar se është pronare e ngastrës kadastrale në fjalë, gjë që në fakt është prone e të paditurës këtu. Sipas dispozitës të nenit 271 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë civile, personi që ka interes juridik në procedurën kontestimore që zhvillohet mes personave tjerë, ku njëra pale fiton, mundet t’i bashkëngjitet asaj procedure kontestimore. Ndërhyrësi mund ti bashkohet qoftë paditësit ose të paditurës. Me rëndësi është që ai ka interes juridik që pala të cilës i është bashkuar të fitoj në kontest. Interesi ekziston kur të drejtat dhe detyrimet e ndërhyrësit varen nga rezultati i procedurës. Në rastin konkret ndërhyrësja nuk ka theksuar se kujt i bashkohet, paditësve – rivalëve këtu apo të paditurës. Gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar që të urdhërojë të autorizuarin e ndërhyrëses që të plotësojë deklaratën për bashkimin ose ndërhyrjen në procedurën kontestimore dhe më pas të veprojë në pajtim me dispozitat e nenit 387 paragrafi 1 pika (1) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Në rastin në fjalë, si gjykata e shkallës së parë ashtu edhe ajo e dytë gabimisht e kanë cilësuar ndërhyrësen si paditëse, Gjykata Supreme rikujton se ndërhyrësi mund të ushtrojë të drejtën e tij

në procesin gjyqësor të nisur me padinë e tij, por në rastin konkret, ndërhyrësja ka paraqitur një deklaratë për tu bashkuar në procesin kontestimore të inicuar sipas padisë së personave tjerë.

Pozicioni procedural i ndërhyrësit është si më poshtë: ai nuk është palë. as përfaqësues i palës, ndërhyrësi ka pozicionin e asaj pale që i është bashkuar.

Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se aktgjykimet e instancës më të ulët duhet të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Në procedurën e përsëritur, në mënyrë të qartë do të përcaktohet se cili është objekti i kontestit, dhe kush janë palët në procedurë, kush është ndërhyrës, cili është interesi i tij juridik konkret dhe cilës palë i bashkohet.

KAPITULLI XII

ZBATIMI I GABUAR I TË DREJTËS MATERIALE SI DHE ZOTËSIA PROCEDURALE E PALËVE

1. Gjendja faktike e vërtetuar gabimisht, si pasojë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale

(Gjykata Supreme në disa raste ka konstatuar se për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe dispozitave të LPK-së është vërtetuar gabimisht gjendja faktike, për të cilën arsye vendimet e gjykatave më të ulëta është dashur të prishen, sepse propozimet për nxjerrjen e provave të caktuara janë refuzuar edhe pse ato duhej aprovuar, pastaj situatat ku disa prova të caktuara janë paraqitur pa pasur nevoj, dhe ku faktet vendimtare mbetën të pavërtetuara, pa vërtetimin e të cilave nuk është e mundur vendosja meritore, siç këtë e përcaktojnë dispozitat e LPK).

Në procedurën kontestimore gjykata vendos për pretendimet e palëve ndërgjyqëse. Gjykata e merr vendimin duke zbatuar të drejtën materiale mbi gjendjen e vërtetuar faktike (nenet 2-9 të LPK). Marrëdhënia ndërmjet së drejtës materiale - gjendjes faktike është e dyanshme, përkatësisht nuk ka zbatim të drejtë të së drejtës materiale pa vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe anasjelltas, jo të gjitha faktet vendimtare do të vërtetohen nëse gjykata zbaton gabimisht të drejtën materiale. Pra, kemi një gjendje faktike të kontestuar, respektivisht kontest për ekzistimin e një gjendjeje faktike, me të cilën ndërlidhet një pyetje juridike, gjegjësisht kontesti lidhur me efektin juridik ose pasojat juridike të gjendjes faktike. Me rastin e marrjes së vendimit, gjykata është e lidhur me rregulloret dhe provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe qëllimi i kontestit është zbatimi i drejtë i rregulloreve përkatëse në gjendjen e vërtetuar faktike.

- ***Pjesë të shkëputura nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme:***

"Pretendimin e paditëses se grada 3 e pagës nuk është e duhur, në procedurën e zhvilluar gjykata fare nuk e ka verifikuar. Është e vërtetë që edhe te kontratat e punës, si dhe tek të gjitha kontratat tjera të punës ekziston liria e kontraktimit, por ka qenë e domosdoshme të vërtetohet përmes shikimit në aktet e brendshme të paditurës nëse grada e pagës e cila i është ofruar paditëses, (pasi që bëhet fjalë për kontratën tipike (shabllon kontratës) sipas qasjes) është në përputhje me normat e të paditurës, si dhe nëse normat e brendshme të paditurës përcaktojnë gradën e pagës në

lartësinë e paraqitur në kontratë. Gjykatat e instancës më të ulët, nuk janë marrë me vërtetimin e faktit të lartpërmendur, por duke u bazuar në atë që paditësja me vullnet të lirë ka nënshkruar kontratën e punës, kanë konkluduar se paditësja ka qenë e njoftuar me të gjitha elementet qenësore të kontratës, dhe se është pajtuar me kushtet në kontratë, andaj kërkesë padia është e pabazuar".

Në rastin konkret, paditësja ka parashtruar padi për diskriminim, të cilin gjykatat e instancës më të ulët e kanë shpërfillur dhe janë fokusuar në faktin se kontrata e punës është lidhur me vullnetin e lirë të palëve kontraktuese. Gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë vërtetuar pretendimet e paditësit se punonjësit në të njëjtin vend pune, me të njëjtat kushte pune dhe me të njëjtin kualifikim profesional kanë gradë më të lartë dhe se bëhet fjalë për diskriminim, dhe në këtë drejtim provat e propozuara nga paditësja nuk u prezantuan fare. Për shkak të këtij lëshimi të gjykatave të instancës më të ulët, nuk janë vërtetuar të gjitha faktet thelbësore, përkatësisht nëse veprimi i të paditurës e ka vendosur paditësen në pozitë të pafavorshme në krahasim me punonjësit e tjerë dhe nëse ka diskriminim në rastin konkret, siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 1, pikat a) dhe b) të Ligjit për Diskriminim.

Si pasojë e lëshimeve të sipërpërmendura dhe mos vërtetimit të të gjitha fakteve të nevojshme për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, aktgjykimet e instancës më të ulët, janë prishur dhe është urdhëruar një gjykim i ri për këtë çështje juridike.

Nga i njëjti aktgjykim:

Për arsyet e lartpërmendura, aktgjykimet e instancës më të ulët duhej prishur, ndërsa lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në përsëritje të procedurës dhe rivendosje. Në procedurën e përsëritur në mënyrë të vlefshme duhet vërtetuar pretendimet nga padia në lidhje me atë nëse për vendin konkret të punës, me aktet e brendshme të paditurës është përcaktuar një gradë ndryshe nga ajo e ofruar me kontratë, nga e cila varet veprimi i mëtejme i gjykatës.

Bazuar në këtë që u parashtrua, përfundimi që nxirret është se gjykatat kanë detyrimin që duke u kujdesur për marrëdhënien konkrete juridike, si për natyrën e të njëjtës, ashtu edhe për rrethanat që e përcjellin këtë marrëdhënie, të reagojnë në atë mënyrë që të vërtetojnë se cilën të drejtë materiale duhet zbatuar në secilin rast konkret, si dhe cilat fakte është e nevojshme të vërtetohen për zbatimin e duhur të së drejtës materiale, duke i shfrytëzuar të gjitha mundësitë të dhëna me Ligjin për Procedurën Kontestimore, si dhe në rast nevoje edhe për autorizim nga neni 356 të po

këtij Ligji. Ngase parakusht për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale është vërtetimi i plotë dhe drejtë i gjendjes faktike. Mirëpo, kjo marrëdhënie është e dyanshme, sepse pa zbatim të drejtë të së drejtës materiale nuk është e mundur të vendoset se cilat fakte duhet vërtetuar, dhe cilat nuk janë relevante për zgjidhjen e çështjes konkrete juridike.

2. Zotësia e palës për të qenë palë në procedurë dhe përfaqësimi (nenet 73-76 dhe 79 të LPK-së).

Në procedurën kontestimore marrin pjesë gjykata dhe palët. Nga njëra anë është paditësi, respektivisht personi që kërkon nga gjykata marrjen e një vendimi që zgjidh çështjen juridike dhe nga ana tjetër është i padituri, personi ndaj të cilit merret vendimi i gjykatës.

Ligji për Procedurën Kontestimore në nenin 73, par. I parashikon se: "Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik". Prandaj ekzistenca e zotësisë për të vepruar nuk është kusht që personi fizik të ketë statusin e palës në procedurë. Palë në procedurë, në kushte të caktuara, mund të jetë edhe një fëmijë i pa lindur.

Paragrafi II i nenit të njëjtë të LPK-së, jep mundësinë që me rregullore të veçanta të rregullohet mundësia që edhe format tjera të bashkimit që nuk mund të përfshihen në konceptin e personit juridik, të fitojnë statusin e palës në procedurë.

Paragrafi III i të njëjtit nen të LPK-së, i jep mundësinë edhe gjykatës që me efekt juridik, vetëm në çështjen konkrete, t'ua njohë cilësinë e palës edhe formave të caktuara të bashkimit.

Mirëpo, në rastin e personit që ka zotësinë e palës për të marrë pjesë në procedurë në mënyrë të pavarur, i domosdoshëm është ekzistimi i zotësisë procedurale. Kur bëhet fjalë për personat fizik, ekzistimi i zotësisë për të vepruar nënkupton edhe ekzistimin e zotësisë procedurale. Zotësia procedurale, si kusht për pjesëmarrje të pavarur në procedurë është paraparë me nenin 74 të LPK-së.

Në rastin e personave juridikë, është e nevojshme që ata të përfaqësohen nga një person fizik i autorizuar, i cili sërish duhet të ketë zotësinë procedurale, respektivisht zotësinë për të vepruar.

Neni 75 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton përfaqësimin e një pale që nuk ka zotësi procedurale, ndërsa neni 79 në paragrafët I dhe II i jep mundësinë gjykatës që palës që nuk ka

zotësi procedurale dhe nuk ka përfaqësues ligjor, t'i caktoj një përfaqësues të përkohshëm, me detyrimin për të informuar për këtë organin e kujdestarisë (paragrafi IV i të njëjtit nen).

Në pajtim me këtë që u parashtrua, i logjikshëm është detyrimi i gjykatës, i përcaktuar me nenin 26 të LPK-së, që gjatë gjithë rrjedhës së procedurës të kujdeset sipas detyrës zyrtare për ekzistimin e zotësisë për të qenë palë dhe zotësisë për të vepruar, të personit që paraqitet si palë në procedurë, si dhe për përfaqësimin e drejtë të personit që nuk i posedon këto zotësi, apo i ka të kufizuara.

Megjithatë, në praktikë vërehet se nganjëherë gjykatat nuk e përmbushin këtë detyrim të tyre në mënyrën e përcaktuar ligjore, dhe se ekzistimi i zotësisë për të qenë palë, e mbi të gjitha zotësia për të vepruar supozohen lehtësisht, pa verifikimin e nevojshëm, atëherë kur për këtë lind nevoja, apo kur shfaqet dyshimi për ekzistencën e saj.

- ***Pjesë të shkëputura nga Rev.nr. 107/722, data 21. 13. 2022***

A r s y e t i m i

"Mirëpo gjatë gjithë rrjedhës së procedurës si në shkallën e parë, po ashtu edhe në procedurën sipas ankesës, përshkohet teza për sëmundjen mendore të paditësit. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë, sipas propozimit të paditurit, më datën 20.11.2015 nxjerrë aktvendimin për ekspertizë të gjendjes psikologjike të paditësit, nga eksperti përgjegjës. Mirëpo kjo ekspertizë nuk është punuar për arsye të panjohura, pasi që në shkresa të lëndës nuk pretendohet se aktvendimi është tërhequr".

Në shkresa të lëndës gjendet mendimi i mjekut – psikiatër dr. I.G., ku mes tjerash, shprehimisht thuhet se, "Si ekspert psikiatër rekomandoj që personi të vihet në mbikëqyrje të detyrueshme spitalore…".

Më pas, Gjykata Supreme në vendimin e njëjtë rikujton gjykatat e instancës më të ulët për detyrimin, që për ekzistimin e zotësisë për të qenë palë, respektivisht zotësisë për të vepruar, duhet të kujdesen sipas detyrës zyrtare:

Më pas, në të njëjtin vendim, Gjykata Supreme u kujton gjykatave më të ulëta detyrimin që duhet të kenë parasysh ekzistimin e zotësisë së palës ose të biznesit sipas detyrës zyrtare:

"*Marrë parasysh këtë që u parashtrua, shtrohet pyetja nëse personi në fjalë mund të jetë fare palë në proces dhe nëse ka zotësi procedurale? Me nenin 76 të LPK-së, përcaktohet detyrimi i gjykatës që gjatë kohëzgjatjes së procedurës të kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse posedon zotësinë procedurale…. . Në pajtim me këtë, sapo të ketë lindur dyshimi për zotësinë procedurale, dhe në zotësinë për të vepruar në përgjithësi, gjykata ka pasur detyrimin që këtë dyshim ta mënjanoj përmes angazhimit të ekspertit të duhur, dhe në rast se tregohet e nevojshme të angazhoj edhe Qendrën për Punë Sociale dhe shërbimet tjera përkatëse".*

Lëshimi i detyrimit në fjalë sjellë deri te shkelja thelbësore procedurale për të cilën Gjykata Supreme kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe pashmangshmërisht rezulton në prishjen e vendimeve të përfshira me një shkelje të tillë, siç është rasti edhe në vendimin e Gjykatës Supreme, tashmë i cituar:

"Duke mos vepruar në mënyrën e sipërpërmendur, gjykatat e instancës më të ulët kanë bërë shkelje thelbësore nga neni 182, paragrafi II ,pika k) të LPK, në lidhje me nenin 215 të LPK, për të cilat shkelje Gjykata Supreme është e detyruar të kujdeset sipas detyrës zyrtare. Për arsyen e theksuar, aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët duhej prishur, pa u lëshuar Gjykata Supreme në verifikimin e zbatimit të së drejtës materiale, si dhe në vlerësimin e pretendimeve në revizion".

Si konkludim, bazuar në të gjitha që u parashtruan shtrohet nevoja që gjykatat të mos i marrin lehtë (shkarazi) zotësinë për të qenë palë dhe zotësinë procedurale, të veprojnë me supozimin se ato ekzistojnë në çdo rast. Në fakt, nganjëherë kjo është e lehtë për t'u konstatuar, mirëpo nuk ndodh gjithmonë, veçanërisht kur bëhet fjalë për zotësinë procedurale. Por, edhe atëherë gjykatat kanë në dispozicion mundësinë e konsultimit me Qendrën për Punë Sociale, institucionet përkatëse shëndetësore dhe të ngjashme, sepse vetëm në atë mënyrë do të respektojnë detyrimin e përcaktuar me ligj, që për ekzistimin e zotësisë për të qenë palë dhe zotësinë procedurale të kujdesen sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës

Pallati i Drejtësisë – Lagjja "Prishtina e Re", Prishtinë

T1: +383 (0) 38/200 18775

T1: +383 (0) 38/200 18779

Email: gjykatasupreme@rks-gov-net

PËRMBLEDHJE NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME NË CËSHTJE PENALE DHE CIVILE

Gjykata Supreme e Kosovës
Pallati i Drejtësisë – Lagjja "Prishtina e Re", Prishtinë
T1: +383 (0) 38/200 18775
T1: +383 (0) 38/200 18779
Email: gjykatasupreme@rks-gov-net